

## FALENDERIME

Fillimisht dua të falenderoj profesorët e Departamentit të Historisë të Universitetit të Elbasanit ku unë kam realizuar procesin e kualifikimit shkencor, në veçanti, Prof. As. Dr. Majlinda Peza-Perriu, Prof. As. Dr. Rudina Mita-Todri dhe Prof. As. Zhuljeta Kadilli-Daja, për ndihmën e veçantë që më kanë ofruar përmes sugjerimeve e vërejtjeve të tyre duke më mirëkuptuar dhe mbështetur për realizimin e këtij punimi. Falenderoj profesorët e Institutit të Historisë në Tiranë, Prof. Dr. Fatmira Musaj dhe Prof. Dr. Hamit Kaba për mbështetjen e pakursyer që tregojnë ndaj studiuesve të rinj.

Falenderime për punonjësit e Arkivit të Shtetit e të Arkivit të Muzeut në Elbasan, si edhe të Bibliotekës Kombëtare në Tiranë dhe Bibliotekës së Elbasanit për ndihmesën e tyre të vyer.

Një falenderim i veçantë dhe mirënjohje e sinqertë i shkon udhëheqësit tim shkencor Prof. Dr. Roland Gjini i cili nëpërmjet udhëzimeve të dhëna ka ndikuar në formimin tim shkencor dhe në përfundimin me sukses të këtij punimi.

Falenderimin më special ia drejtoj prindërve që me dashuri më mësuam të punoj me këmbëngulje; Sokolit, frymëzimit tim; dhe Sandros, burimit të forcës sime, përfaqësuesit të gjeneratës më të re të familjes së madhe të Nosëve.

Ju falenderoj!

### ABSTRAKT

Ky punim synon të trajtojë dhe analizojë përfshirjen e Lef Nosit në lëvizjen politike dhe arsimore, çlirimtare dhe shtetformuese shqiptare në një periudhë kohore që nis me zhvillimet e lëvizjes kombëtare të fillimshkullit të XX, zhvillohet më tej me ngjarjet që paraprinë e pasuan shpalljen e Pavarësisë dhe krijimin e shtetit të parë shqiptar, si edhe pozicionimin e tij gjatë situatave konfliktuale, që prodhoi në mjedisin politik shqiptar, Lufta e Parë Botërore dhe përplasjet politike të mesit të viteve '20 të shekullit të kaluar. Studimi kërkon gjithashtu të evidentojë edhe faktorët që kanë kushtëzuar qëndrimet, pikëpamjet, angazhimet politike dhe në tërësi aspektet kryesore të veprimtarisë politike të Lef Nosit në rrugën e vështirë të ngritjes, mëkëmbjes, ringritjes e konsolidimit të shtetit të pavarur shqiptar deri në mesin e dekadës së tretë të shekullit XX. Përmes këtij studimi, morëm përsipër që në dritën e të dhënave të reja të përcjellim një histori të veprimtarisë politike të Lef Nosit, veprimtari e cila është sa e gjerë aq edhe komplekse dhe e shtrirë në një periudhë kohore të ngjeshur me ngjarje historike në të cilat ai ka qenë pjesëmarrës aktiv si organizator, si drejtues dhe si politikan. Duke hulumtuar aktivitetin e tij, arrijmë të shohim tek ai njeriun e përkushtuar e të sakrifikuar për kombin, si dëshmi historike.

**Fusha:** Historia

**Fjalët kyçe:** Lëvizja Kombëtare, gjuha dhe shkolla shqipe, politikan, publicist, ministër, mbrojtës i çështjes kombëtare, kryetar bashkie, aktivist i Shqipërisë etnike, antikomunist.

### ABSTRACT

This paper aims to address and analyze the involvement of Lef Nosi in the Albanian political and educational movement, liberation and state building in a period that begins with the developments of the national movement of the early twentieth century, and develops further with the events preceding the declaration of independence and the creation of the first Albanian state, as well as its positioning during the conflict situations, which produced in the Albanian political environment, the First World War and the political clashes of the mid-20s of the last century. The study also seeks to identify the factors that have conditioned the attitudes, views, political commitments and in general the main aspects of Lef Nosi's political activity on the difficult path of creating, recovering, restoring and consolidating the independent Albanian state by the middle of the decade the third of the twentieth century. Researching his activity, we undertook in the light of new data to convey a history of Lef Nosi's political activity, an activity which is as wide as it is complex and extends over a period of time packed with historical events in which he has been an active participant as an organizer, as a leader and as a politician. By researching his activity, we come to see in him the man dedicated and sacrificed for the nation, as historical evidence.

**Field:** History

**Keywords:** National Movement, Albanian language and school, politician, publicist, minister, defender of the national cause, mayor, activist of ethnic Albania, anti-communist.

PËRMBAJTJA

|                                                                                                                |     |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| <b>PARATHËNIE</b>                                                                                              | 6   |
| <b>HYRJE</b>                                                                                                   | 13  |
| <br><b>KREU I. NË FILLIMET E VEPRIMTARISË POLITIKE (1900- 1911)</b>                                            | 20  |
| <b>I. 1</b> Lef Nosi në rradhët e Lëvizjes Kombëtare të fillimshekullit të XX.                                 | 20  |
| <b>I. 2</b> Shoqëria e shqiptarëve të Londrës “Ana Kombëtare e Shqipërisë”.                                    | 32  |
| <b>I. 3</b> Veprimtaria e L. Nosit për shkollën e gjuhën shqipe pas lirive të shpallura nga xhonturqit (1908). | 42  |
| <b>I. 4</b> Gazeta “Tomorri”- zëri i propagandës së interesave shqiptare.                                      | 59  |
| <br><b>KREU II. NGA LUFTA PËR PAVARËSI NË SHTETIN E PARË SHQIPTAR (1912- 1914)</b>                             | 71  |
| <b>II. 1</b> Roli i L. Nosit në rrugën drejt shpalljes së Pavarësisë (1912).                                   | 71  |
| <b>II. 2</b> Veprimtaria e Ministrit të Postë-Telegrafës në Qeverinë e Përkohshme të Vlorës.                   | 85  |
| <b>II. 3</b> Qëndrimi i Lef Nosit ndaj veprimtarisë së Esat Pashë Toptanit.                                    | 101 |
| <br><b>KREU III. LEF NOSI GJATË VITEVE TË LUFTËS SË PARË BOTËRORE (1914- 1918)</b>                             | 111 |
| <b>III. 1</b> Realiteti politik shqiptar në prag të Luftës së Parë Botërore.                                   | 111 |
| <b>III. 2</b> Fillimi i kryengritjes së Shqipërisë së Mesme dhe largimi i princ Vedit.                         | 119 |
| <b>III. 3</b> Angazhimi politik i L. Nosit gjatë Luftës së Parë Botërore.                                      | 123 |
| <b>III. 4</b> Lef Nosi dhe “Kopështi Letrar”.                                                                  | 133 |
| <br><b>KREU IV. POZICIONIMI I LEF NOSIT NË JETËN POLITIKE TË VENDIT GJATË VITEVE 1920- 1924</b>                | 139 |
| <b>IV. 1</b> L. Nosi në Kongresin e Durrësit dhe Konferencën e Paqes në Paris.                                 | 139 |
| <b>IV. 2</b> Qëndrimi i L. Nosit në situatën politike të viteve ’20.                                           | 154 |
| <b>IV. 3</b> Lef Nosi në krye të Bashkisë së Elbasanit.                                                        | 165 |
| <br><b>NË VEND TË EPILOGUT</b>                                                                                 | 171 |
| <b>I.</b> Qëndrimi i L. Nosit gjatë regjimit zogist dhe pushtimit fashist të vendit.                           | 171 |
| <b>II.</b> Përfshirja e tij në radhët e Ballit Kombëtar.                                                       | 177 |

|                                                                                                           |            |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| <b>III. Qëndrimi i L. Nosit gjatë pushtimit gjerman e përballja me kundërshtarët politikë pas luftës.</b> | <b>184</b> |
| <b>PËRFUNDIME.</b>                                                                                        | <b>199</b> |
| <b>BIBLIOGRAFIA.</b>                                                                                      | <b>204</b> |
| <b>SHTOJCË.</b>                                                                                           | <b>209</b> |
| <b>PËRMBLEDHJE NË ANGLISHT</b>                                                                            | <b>213</b> |

**LEF NOSI  
NË JETËN POLITIKE SHQIPTARE TË VITEVE 1900-1924**

**DEKLARATË E VËRTETËSISË SË PUNIMIT**

DEKLAROJ NË PËRGJEGJËSINË TIME TË PLOTË SE KY PUNIM ËSHTË HARTUAR NGA UNË DHE PËR ÇDO INFORMACION APO IDE, E CILA NUK ËSHTË IMJA, KAM RESPEKTUAR TË GJITHA RREGULLAT E CITIMIT DHE REFERIMIT.  
DEKLAROJ SE NË KËTË PUNIM NUK KA VEND PLAGJATURA.

### **Parathënie**

*Studimi me temë “LEF NOSI NË JETËN POLITIKE SHQIPTARE TË VITEVE 1900-1924” ka për qëllim që në mënyrë objektive të pasqyrojë duke hedhur dritë, në gjithë veprimtarinë politike të Lef Nosit, veprimtari e cila është sa e gjerë aq edhe komplekse dhe e shtrirë në një periudhë kohore të ngjeshur me lëvizje arsimore, kulturore e çlirimtare, në të cilat ai ka qenë pjesëmarrës aktiv si organizator, si drejtues dhe si politikan. Ky punim, fryt i një pune disavjeçare, nisi si një nxitje, e cila në kuadër të kërkesave për rishikimin e historisë së popullit shqiptar në dritën e burimeve të reja arkivore, synon të evidentojë, realisht dhe larg subjektivizmave, tërësinë e pikëpamjeve, veprimeve dhe qëndrimeve politike të Lef Nosit. Kjo shtysë u bë edhe motivi bazë për të hulumtuar, me vërtetësi dhe seriozitet, veprimtarinë e aktivistit nga Elbasani, qytet i cili ishte identifikuar qysh herët si një vatër e rëndësishme e arsimit shqiptar dhe e lëvizjes kombëtare, që prej viteve të para të shekullit të XX, kohë kur L. Nosi filloi të spikasë me aktivitetin e tij në kuadër të lëvizjes për fitimin e të drejtave kombëtare, e deri në mbarim të situatave konfliktuale, që prodhoi në mjedisin politik shqiptar, Lufta e Parë Botërore dhe përplasjet politike të mesit të viteve '20 të shek. XX.*

*Me përfundimin e luftës forcat komuniste shqiptare që erdhën në pushtet, pa institucionin e zgjedhjeve të lira, burgosën, luftuan e madje likujduan, jo vetëm politikisht por edhe fizikisht, kundërshtarët e tyre politikë që ishin gjithashtu shqiptarë. Një ndër këta kundërshtarë të vijës politike të udhëheqjes komuniste ishte edhe Lef Nosi i cili ishte ndër ato figura që për dekada të tëra u mohua nga regjimi, i cili jo vetëm e shpërfilli, por mbi të derdhi akuza të cilat merrnin jetë nga pozicionimi i tij delikat në momentet e përplasjeve mbipolitike të viteve 1943-1944 e njëkohësisht frymëzoheshin edhe nga bindjet politike të L. Nosit i cili, në të vërtetë, urrente komunizmin. Historiografia shqiptare heshti, zbehu, madje edhe i mohoi apo tjetërsoi gjurmët që ai kishte lënë në histori. Edhe kur nisëm këtë punim, të fokusuar në kontributin e L. Nosit në jetën politike të vendit, ajo që unë kisha të njohur apo lexuar në faqet e librave të historisë, ishte jo vetëm shumë pak por edhe shumë ndryshe. Edhe në ato raste kur kisha ndeshur emrin e tij, kryesisht, ai ishte pjesë e “kronikës së zezë” në shtypin komunist të kohës. Teksa njihesha me veprimtarinë e tij, e gjeta krejt të ndryshëm dhe shumë më shqiptar se ata që kishin marrë përsipër ta gjykonin për antishqiptarizëm. I qetë, serioz, njeri që nuk mbante inate politike, i kthjellët në mendimet e tij dhe këmbëngulës në idealet që mbronte. Nisur nga këto elemente fillova të kuptoja të gjitha ngjarjet, të gjitha veprimet e tij të dobishme e të padobishme për realitetin shqiptar.*

*Ndërkohë, pas viteve '90, kishte nisur procesi i rishikimit të fakteve dhe i vlerësimit të rolit e veprimtarisë së figurave që kishin drejtuar vendin apo kishin pasur role të rëndësishme në periudha të*

caktuara të historisë sonë. Zbulimi i dokumentave dhe fakteve të reja, kishte bërë të mundur të hidheshin poshtë një pjesë e madhe e tezave dhe e konkluzioneve të historiografisë zyrtare shqiptare gjatë periudhës së diktaturës komuniste, duke paraqitur kështu edhe pjesën tjetër të të vërtetës historike e cila hidhte dritë edhe mbi platformën politike të Lef Nosit.

Hapat e para për studimin e personalitetit historik të aktivistit elbasanas u ndërmorën menjëherë pas ndryshimeve demokratike në vend. Lef Nosi u bë i pranishëm në disa trajtesa shkencore e historike, kombëtare e ndërkombëtare, që u ndërmorën më vonë, të cilat u kushtohen ngjarjeve dhe figurave kryesore kombëtare të gjysmës së parë të shekullit XX, para dhe pas shpalljes së pavarësisë. Tërësia e dokumenteve të mbledhura e të përgatitura për botim nga Lef Nosi, por që nuk u botuan dot kurrë prej tij, arritën të shohin dritën e publikimit vetëm falë nismës së Institutit të Historisë, e në veçanti të punës së vyer të Prof. Dr. Ferit Dukës dhe Prof. Dr. Marenglen Verlit. Përmes botimit të këtyre dokumenteve jo vetëm krijohet një tablo akoma më e qartë e veprimtarisë së shtetit shqiptar në vitet e para të ekzistencës së tij, por ridimensionohet edhe kontributi i Lef Nosit në lëmin e kërkimeve studimore të historisë politike të shtetit shqiptar.

Mijëra faqe dokumentash historike, me shumë vlera studimore, të mbledhura e të ruajtura me fanatizëm nga Lef Nosi, sot përbëjnë një nga thesaret më të çmuara në fushën e shkencave albanologjike. Në historinë e një kombi trashëgimia është “shkolla” që të ushqen me dije mbi veprimtarinë e atyre që, mes sakrificash dhe rreziqesh, punuan për të ruajtur të gjallë historinë e vlerat e një populli; është “diploma” që vërteton ekzistencën e të sotmes.

Veprimtaria shumëdimensionale e Lef Nosit, si një varg interesant ngjarjesh, me të gjitha ngritjet e uljet në intesitetin e ndërmarrjeve të tij, me tërësinë e dritë-hijeve që përbëjnë spektrin e angazhimeve që ai ka realizuar, filloi të tërheqë vëmendjen e studiuesve, bashkëqytetarë të tij, dhe të mjaft historianëve të mirëfilltë në fushën e historiografisë shqiptare të cilët përmes shkrimeve të tyre, me vlera të rëndësishme studimore, u bënë edhe një faktor nxitës për ndërmarrjen e një nisme të tillë për ta prezantuar, përmes një punimi shkencor, veprimtarinë politike të Lef Nosit.

Parë në këtë këndvështrim, ky punim synon të trajtojë dhe analizojë përfshirjen e L. Nosit në lëvizjen politike dhe arsimore, çlirimtare dhe shtetformuese në një periudhë kohore që nis me zhvillimet e lëvizjes kombëtare të fillimshekullit të XX, zhvillohet edhe më tej me ngjarjet që paraprinë dhe pasuan shpalljen e Pavarësisë dhe krijimin e shtetit të parë shqiptar dhe pozicionimi i tij në përplasjet e brendshme politike nga v. 1913 deri në v. 1924. Studimi kërkon gjithashtu të evidentojë edhe faktorët që kanë kushtëzuar qëndrimet, pikëpamjet dhe angazhimet e tij, politike apo me ndikime politike, në jetën e vendit por gjithmonë duke iu përmbajtur me seriozitet trajtimit objektiv, larg interpretimeve subjektive dhe të njëanshme. Për këtë arsye në procesin e hulumtimit shkencor jemi mbështetur në metodologjinë e njohjes dhe vlerësimit të dokumenteve të përdorura, burimeve arkivore, artikujve publicistikë apo studimeve të

tjera, në kontekstin e ballafaqimit dhe krahasimit edhe me materiale të tjera shkencore, duke patur si kriter kryesor vërtetësinë dhe besueshmërinë e tyre. Ky punim merr përsipër që në dritën e të dhënave të reja të përjellë një histori të jetës politike të Lef Nosit, parë nëpërmjet dokumentave, për të plotësuar atë pjesë që ishte e zbrazët, ishte ndryshuar apo ishte shpërfillur, për shumë shkaqe, nga mendimi historik zyrtar i para v. '90 në Shqipëri. Në këtë kuadër, në qëndrimet dhe interpretimet e parashtruara për aspekte të caktuara të kësaj platforme, figura politike e L. Nosit është trajtuar duke u nisur jo nga paragjykimi për "heroin" apo "tradhtarin", por është parë në raport me atë çka ai ka dhënë në të vërtetë.

Duke iu referuar tematikës që ky studim përcjell, përmes evidentimit të veprimtarisë së Lef Nosit sipas kriterit kronologjik, kemi konceptuar një strukturë të përbërë nga një hyrje, katër kapituj, të ndarë secili në disa nënçështje, një epilog dhe një rubrikë përfundimesh, të cilat më konkretisht po i pasqyrojmë më poshtë:

**Hyrja** jep një panoramë të përgjithshme për sa i përket prejardhjes familjare të Lef Nosit, mjedisit ku ai u lind, u rrit e u arsimua dhe në veçanti ku do të startojnë edhe angazhimet e tij të para në lëvizjen kombëtare. Një vend të rëndësishëm zë gjithashtu edhe paraqitja përgjithësuese e aktivitetit të tij në sinkron me kriterin kronologjik të zhvillimit të ngjarjeve kryesore politike në vend. Ajo fokusohet në pasqyrimin e aspekteve më kryesore të rolit të L. Nosit gjatë etapave më të rëndësishme të historisë moderne shqiptare gjatë thujtse tre dekadave të para të shekullit të XX. Gjithashtu përgjatë saj është dhënë një tablo përmbledhëse e aktivitetit shumëdimensional të Lef Nosit si arkivist, folklorist, etnograf, mbledhës i materialit arkeologjik, detyrë për të cilën u vlerësua jo vetëm nga shqiptarët por edhe nga miq të huaj të Shqipërisë e të shqiptarëve. Si e tillë hyrja shërben si një prolog i angazhimeve të L. Nosit në jetën politike të vendit gjatë viteve 1900-1924, problematikë që përbën edhe boshtin kryesor të analizës në temën tonë.

Kapitulli i parë, "**Në fillimet e veprimtarisë politike. (1900-1911)**", synon të paraqesë dhe të trajtojë përfshirjen e Lef Nosit në zhvillimin e ngjarjeve politiko-arsimore të fillim shek. XX, kohë kur në trevën e Elbasanit ishin evidentuar format e para të qëndresës antiosmane të cilat kishin nisur që prej përfshirjes së popullsisë së rajonit në zhvillimet politike që kishte prodhuar Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878). Në këtë kohë në rajonin e Elbasanit lëvizja për shkollën shqipe ishte shkrirë me luftën e armatosur që kishte bashkuar myslimanë e ortodoksë në dobi të çështjes së çlirimit kombëtar. Edhe i riu elbasanas do ta gjejë me vend dhe do të punojë në mbështetje të kërkesave me natyrë autonomiste që synonin njohjen zyrtare të gjuhës shqipe dhe hapjen e shkollave kombëtare e gjatë të cilës do t'i duhet të përballet si me presionin e pushtetit qendror osman ashtu edhe me qëndrimin e Patrikanës së Stambollit që me politikën e saj ishte vendosur në një pozicion diametralisht të kundërt ndaj çdo përpjekje që synonte zgjimin kombëtar të shqiptarëve. Në vijimësi të këtij kapitulli, në çështjen e dytë të tij, një vend të rëndësishëm zë parashtrimi i pikëpamjeve politike të Lef Nosit si lidhur me marrëdhëniet që shqiptarët duhet të vendosnin me Fuqitë e Mëdha ashtu edhe me përpjekjet që ai do të zhvillojë për të projektuar në një vend përfundimor, qendrën drejtuese të lëvizjes kombëtare. Këtu zënë vend edhe idetë e tij politike rreth ngritjes së një shteti shqiptar



mbi bazën e vlerave të qytetërimit perëndimor që u pasqyruan në programin e shoqërisë “Ana Kombëtare Shqiptare” e cila, sipas emërimit fillestar që ajo pati, u ideua si një parti politike, koncept që ishte i huaj për rrethet shqiptare të kohës, por që nuk u bë dot pjesë e realitetit të prekshëm shqiptar. Çështja e tretë e këtij kapitulli pasqyron përpjekjet e kontributin që do të japë L. Nosi në situatën e re të krijuar pas shpalljes së Kushtetutës (1908) në funksion të zhvillimit të arsimit dhe shkollave shqipe, përmes ngritjes gjatë kësaj periudhe të disa prej klubeve dhe shoqërive patriotike e kulturore, të cilat jo vetëm u shndërruan në institucione arsimore dhe kulturore mbarëkombëtare, por njëkohësisht morën përsipër organizimin dhe përgatitjen e kushteve për zhvillimin e punimeve të Kongresit Arsimor në Elbasan. Të tilla ishin klubet “Bashkimi”, “Vllaznia”, “Bashkimi i ri” dhe shoqëria muzikore “Afërdita”, figurë qendrore dhe mjaft aktive e të cilave ishte L. Nosi. Njëkohësisht kemi pasqyruar si përpjekjet që ai, bashkë me patriotë të tjerë, do të bëjë për mirëfunksionimin e Normales së Elbasanit ashtu edhe qëndresën ndaj orvajtjeve të qeverisë turke për të futur në shkolla alfabetin arab për mësimin e gjuhës shqipe. Në çështjen e fundit të këtij kapitulli kemi vënë theksin në aktivitetin intelektual të L. Nosit në fushën e publicistikës, realizuar përmes botimit të të përkohshmes politike dhe letrare “Tomorri”, e cila do të shndërrohet në tribunën ku përfaqësuesit e lëvizjes përparimtare e më demokratike të kohës do të ngrenë zërin rreth problemeve që rëndonin mbi çështjen shqiptare dhe ku iu bë jehonë ngjarjeve, problemeve dhe shqetësimeve të kohës. Angazhimi i Lef Nosit për çështjen kombëtare, përmes botimeve e shkrimeve në “Tomorri”, ndërsa u mbështet dhe u lëvdua nga atdhetarë shqiptarë në vend e në kolonitë e mërgimit, në anën tjetër, përballë politikës ndëshkuese që kishte nisur të ndërmernte qeveria xhonturke, e vuri atë përballë një rreziku serioz për jetën.

Në kapitullin e dytë, **“Nga lufta për pavarësi në shtetin e parë shqiptar (1912-1914)”**, jemi fokusuar në trajtimin e rolit të L. Nosit në ngjarjen më të rëndësishme të historisë së popullit shqiptar, në rrugëtimin drejt Shpalljes së Pavarësisë, që nis me veprimtarinë e tij aktive në kuadrin e çetave antiosmane që u formuan në trevën e Elbasanit gjatë kryengritjeve të viteve 1911-1912, ku ai do të jetë një prej figurave qendrore të Komitetit Revolucionar të Elbasanit, dhe kulmon me punën e vazhdueshme dhe këmbëngulëse si ministër i Postave e Telegrafave në qeverinë e re shqiptare të dalë nga Kuvendi Kombëtar i Vlorës. Në këtë kuadër, veçanërisht kemi pasqyruar drejtimet kryesore të veprimtarisë së tij për ngritjen dhe organizimin e sistemit postar shqiptar e për vendosjen e kontakteve telegrafike jo vetëm në gjithë hapësirën shqiptare por edhe, e sidomos, me botën e jashtme lidhja me të cilën, në ato momente kur po diskutohej fati i tokave dhe i popullsisë shqiptare, merrte një rëndësi akoma edhe më të madhe. Në kushtet kur shtetit të ri shqiptar i mungonin financat dhe arka ishte bosh, Lef Nosi synonte që përmes shitjes së pullave postare, të cilat ai vetë i kishte ideuar dhe për të cilat kërkesat ishin të mëdha, si brenda edhe jashtë vendit, të mund të rriteshin të ardhurat shtetërore. Ndonëse ishte caktuar të drejtonte Ministrinë e Postave, ai do të punojë me këmbëngulje për përdorimin e gjuhës shqipe në të gjitha zyrat postare e telegrafike, si edhe për mbrojtjen

dhe zgjerimin e shtrirjes të rrjetit të shkollave shqipe. Përmes shfrytëzimit të burimeve zyrtare të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, shkrimeve në shtypin e kohës dhe në veçanti të materialeve që Lef Nosi ka grumbulluar dhe ruajtur mbi veprimtarinë e shtetit shqiptar, në çështjen e fundit të këtij kapitulli synojmë të paraqesim qëndrimin që ai mbajti ndaj përpjekjeve separatiste dhe ambicjeve politike të Esad Pashë Toptanit për pushtet. Me anë të letërkëmbimeve të tij, sidomos me Luigj Gurakuqin, kemi synuar të pasqyrojmë përpjekjet që ai bën për të shmangur gjakderdhjen dhe luftën vëllavrasëse mes shqiptarëve e për rrjedhojë të ruajë e të forcojë pozitat e brendshme dhe të jashtme të shtetit kombëtar shqiptar.

Kapitulli i tretë, **“Lef Nosi gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore (1914-1918)”**, prirët të evidentojë situatën në vend që prej janarit të v. 1914, kur Qeveria e Vlorës dha dorëheqjen dhe njëkohësisht përfundoi edhe aktiviteti i L. Nosit si ministër i Postave, por jo kontributi i tij në këtë fushë. Në vazhdim gjejmë pasqyrim zhvillimet politike pas ardhjes së princ Wied-it në krye të shtetit shqiptar, ngjarje që u mirëprit nga veprimtari elbasanas por që fatkeqsisht nuk realizoi idealin e tij për një shtet shqiptar të modelit perëndimor. Realiteti i brendshëm kaotik shqiptar dhe dështimet në marrdhëniet me jashtë e çuan drejt falimentimit qeverisjen e princ Wied-it në Shqipëri. Në vijim të këtij kapitulli, një vend të rëndësishëm zë trajtimi i situatës së përgjithshme politike në vend pas largimit të princ Vidit nga kryeqyteti shqiptar, veprim i cili jo vetëm do të ndezë edhe më shumë kërkesën për princin turk nga kryengritësit e Shqipërisë së Mesme, por do të zgjojë edhe një herë synimet politike të Esad Pashës për të zënë kryet e shtetit shqiptar. Përballë anarkisë së përgjithshme që kishte përfshirë vendin e kur tokat shqiptare, në veri e në jug të vendit, ishin pushtuar nga fqinjët ballkanikë, Lef Nosi zgjedh të kundërshtojë, jo vetëm politikisht por edhe ushtarakisht, planet për pushtet të Pashait Toptanas dhe të organizojë qëndresën antiserbe në veri të vendit. Një vend të rëndësishëm do të zërë edhe pasqyrimi i veprimtarisë së L. Nosit në situatën e re që u krijua pas pushtimit austro-hungarez të vendit dhe përpjekjet e tij, si pjesë e një grupi veprimtarësh nismëtar, për të organizuar një kongres kombëtar në Elbasan i cili do të kërkonte të ringrinte qeverinë shqiptare të paraluftës dhe indirekt do ta identifikonte Elbasanin si qendrën e re të shtetit kombëtar. Në vëmendje të këtij studimi, gjatë këtij kapitulli, do të jetë edhe kontributi që ai dha, përmes insistimit pranë autoriteteve austro-hungareze në qytet, për të shpëtuar popullsinë nga mjerimi dhe shkatërrimet që kishte shkaktuar pushtimi serb i këtyre trevave. Pjesë e këtij aktiviteti është edhe pjesëmarrja e tij në formimin e shoqërisë kulturore “Qarku Letrar” në Elbasan e cila përmes propagandimit të vlerave kulturore, materiale e shpirtërore, synonte të vihej në mbrojtje të identitetit etnik kombëtar shqiptar. Këtë mision ai e realizoi përmes botimit në faqet e revistës “Kopështi Letrar” të pjesëve me shumë vlerë të folklorit shqiptar që ai i kishte mbledhur ndër vite me aq shumë kujdes.

Në kapitullin e katërt **“Pozicionimi i Lef Nosit në jetën politike të vendit në vitet 1920 -1924”** më së shumti jemi përqëndruar në trajtimin e qëndrimeve që L. Nosi do të mbajë ndaj zhvillimeve politike në vend gjatë v. '20, e cilësuar kjo si periudha më demokratike në historinë politike të shtetit shqiptar midis dy

luftërave botërore. Kësaj periudhe i parapriu pjesëmarrja e L. Nosit në Kongresin e Durrësit dhe në qeverinë që doli prej tij. Edhe pse në kushte shumë të vështira, ai do të japë kontributin e tij si Ministër i Ekonomisë dhe Ushqimit në qeverinë e Durrësit dhe më pas si përfaqësues i delegacionit qeveritar në Konferencën e Paqes në Paris për të mbrojtur çështjen shqiptare dhe të drejtat kombëtare të rrezikuara nga fituesit e Luftës së Parë Botërore. Gjatë kësaj kohe ai do të jetë një nga figurat kryesore që mori pjesë në themelimin e federatës “Atdheu” e cila synonte që përmes zhvillimit të arsimit e kulturës, të arrihej përparimi ekonomik e shoqëror i vendit. Në veçanti, në këtë kapitull është trajtuar përfshirja e L. Nosit në fushatën e ashpër zgjedhore të viteve 1921, gjatë së cilës ai u radhit në krahun përparimtar të përfaqësuar nga grupimi politik “Popullorët”, dhe në vitin 1923 si pjesë e grupimit politik “As i Pashës, As i Beut” që do të luftojë për shkëputjen e vendit nga prapambetja feudale dhe nisjen e rrugëtimit drejt zhvillimeve demokratike. Në çështjen e fundit jemi përpjekur të evidentojmë punën që L.Nosi bëri në krye të Bashkisë së Elbasanit, pas triumfit të kryengritjes së Qeshorit të v.1924, kohë pas së cilës ai do të tërhiqet përkohësisht nga jeta politike e vendit.

Në përmbyllje të këtij punimi kemi konceptuar një **“Epilog”** për të evidentuar qëndrimin e L. Nosit dhe pikëpamjet e tij politike në disa momente kyçe: së pari , gjatë viteve të monarkisë shqiptare, në kushtet e depërtimit ekonomik, politik e ushtarak italian deri në pushtimin fashist të vendit. Së dyti, në kushtet e organizimit të qëndresës antifashiste dhe formësimit të organizatave dhe partive politike, kohë kur L. Nosi e gjen me vend të pozicionohet në të djathtën antikomuniste shqiptare. Së treti, jemi përpjekur të analizojmë pozicionimin e L. Nosit gjatë pushtimit gjerman të vendit përmes pasqyrimit si të gjendjes së brendshme politike e ushtarake ashtu edhe të zhvillimeve në arenën ndërkombëtare pas kapitullimit të Italisë fashiste, angazhimit të tij në Këshillin e Lartë të Regjencës, si dhe përballjen e Lef Nosit me forcat komuniste të cilat, me mbarimin e luftës, erdhën në pushtet.

Punimi mbyllet me disa **“Përfundime”** mbi veprimtarinë e L. Nosit në jetën politike shqiptare për periudhën e marrë në studim dhe pasqyrimit e bibliografisë së përdorur.

Në evidentimin e këtij spektri të gjerë angazhimesh të Lef Nosit në jetën politike shqiptare, të shtrirë në disa dekada, është shfrytëzuar një material i larmishëm burimor, arkivor dhe bibliografik, zyrtar dhe publicistik, publik dhe vetjak. Kështu për lëndën e përdorur, në rradhë të parë, është shfrytëzuar materiali dokumentar i nxjerrë nga fondet e Arkivit Qendror të Shtetit, në të cilin është shqyrtuar fondi personal i Lef Nosit dhe i personaliteteve të tjera historike, I. Qemalit, Fan Nolit, L. Gurakuqit, Aqif Pashës, Mit’hat Frashërit e shumë të tjerë, me të cilët ai ka bashkëpunuar apo ka pasur kontakte e letërkëmbime; fondet e Prefekturës së Elbasanit, të organizatave dhe institucioneve ku ai jo vetëm ka aderuar por me anë të të cilave evidentohet edhe qëndrimi e angazhimi i tij politik; është hulumtuar Arkivi i Institutit të Historisë, kryesisht fondet e arkivit të Vjenës dhe dokumentat angleze dhe ato gjermane, botimi i Institutit të Historisë me dokumenta të nxjerra nga fondi i Lef Nosit “Dokumenta historike 1912-1918” etj. Veprimtaria dhe

mendimi politik i Lef Nosit është pasqyruar edhe nëpërmjet akteve zyrtare që mbajnë nënshkrimin e tij, si edhe përmes korrespondencave që ka pasur me miq shqiptarë e të huaj. Ndër burimet arkivore është përdorur edhe materiali i vjelë nga Arkivat e Muzeut Etnografik e qarkut të Elbasanit, kujtime të bashkëkohasve të tij, fondet e Albanologjisë në Muzeun Kombëtar dhe në Muzeun e Elbasanit etj.

Gjithashtu, për të realizuar një panoramë sa më të plotë të veprimtarisë politike të L. Nosit kemi shfrytëzuar edhe studime, botime, artikuj, kumtesa e tekste të autorëve vendas dhe atyre të huaj të cilët i referohen veprimtarit elbasanas apo kohës kur ai jetoi dhe veproi. Një trajtim mjaft interesant dhe shumë i frytshëm iu bë figurës së Lef Nosit edhe në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare që u mbajt në qytetin e Elbasanit me rastin e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë ku me mjaft vlerë, në lëmin e tematikës tonë, rezultojnë kumtesat e studiuesve të njohur si Muharrem Dëzhgiu, Fatmira Musaj, Marenglen Verli, Roland Gjini, Dritan Egro, Tomorr Plangarica etj.

Burime mjaft të rëndësishme rezultuan edhe të dhënat e nxjerra nga shtypi shqiptar i kohës, ai periodik kombëtar dhe lokal, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, në të cilin ai ka shprehur qëndrimin e tij rreth çështjes shqiptare apo ku është bërë e qartë veprimtaria e tij politike. Si të tilla përmendim gazetatat “Kalendari Kombiar” Sofje (1905- 1908), “Kombi”, “Flamuri”, “Dielli” Boston Mass, “Trumbeta e Krujës”, “Drita” Sofje, “Lirija” e “Bashkimi” Selanik (1908-1910), “Tomorri” (1910), “Drita” Manastir (1912), “Liri e Shqipërisë” (1911), “Përlindja e Shqypëniës”, botim periodik i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, “Taraboshi” e “Shqypnia e re” (1913-1914), “Republika” Shkodër, “Shkumbini” Elbasan (1921), “Ura e Shkuminit” (1923), “Koha” Korçë, (1925), “Bashkimi i Kombit” (1943-1944), revistat “Albania” Londër, (1907-1909), “Kopështi Letrar” Elbasan (1918-1919), “Hylli i dritës” (1943-1944), Fletorja Zyrtare (1943-1944) etj.

## HYRJE

Elefther (Lef) Nosi lindi në Elbasan në 9 prill 1877. Ai rridhte nga familja e njohur e Nosëve të Elbasanit,<sup>1</sup> të cilët kishin fituar emër jo vetëm mes ortodoksëve të kalasë por edhe tek popullsia muhamedane e qytetit.<sup>2</sup> Vëllezërit Nosi njiheshin në qytet si tregtarë që me kapitalet dhe pronat e tyre kishin fituar një pozitë të konsiderueshme që nga mesi i shekullit XIX- fillimi i shekullit XX e deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore. Në Elbasan, qytet i cili konsiderohej si qendra më e rëndësishme ekonomike e Shqipërisë së Mesme,<sup>3</sup> vëllezërit Nosi kishin në pronësi fabrikën e sapunit<sup>4</sup> dhe tregtia që ata zhvillonin i kapërcente kufijtë e tregjeve të trevave shqiptare. Ajo që i kishte bërë Nosët të njohur në trevën e Elbasanit Overclock-PClidhej edhe me faktin se, në kushtet kur në vend mungonte një klasë e vërtetë e mesme, përfaqësuesit e shtresës së tregtarëve e zejtarëve të mëdhenj, së bashku me ato të pronarëve të mëdhenj të



*Lef Nosi i ulur në të djathtë*

tokave e çifligarëve, jo vetëm do të bëhen protagonistët kryesorë në zhvillimet politike dhe arsimore gjatë Rilindjes Kombëtare e më pas, por do të vlerësohen për veprimtarinë e tyre edhe nga studiues, udhëtarë e miq të huaj që vizitonin vendin.

Ai ishte më i vogli i 5 djemve të Anës e Stiljan Nosit. Mësimet e para i mori në vendlindje, në shkollën greke të lagjes “Kala” të Elbasanit, ndërkohë që, fshehurazi, mësoi shkrim e lexim në gjuhën shqipe. Gjatë viteve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878-1880), në kuadër të lëvizjes kombëtare, në Elbasan u zhvillua një lëvizje e gjerë patriotike fakt për të cilin ky qytet u konsiderua edhe si kandidatura më e mirë për kryeqytet e vilajetit autonom shqiptar<sup>5</sup>, kërkesë që zuri vend të rëndësishëm në punimet e kuvendit të dytë të Dibrës, në 20 tetor 1880. Mirëpo me rënien e Lidhjes, popullsia e

këtij qyteti do të përballlet me goditjen e autoriteteve turke të cilat, në bashkëpunim edhe me Patrikanën e Stambollit, ndiqnin dhe ndëshkonin çdo shfaqje të lëvizjes kombëtare shqiptare. Në këto kohë të vështira të

<sup>1</sup> Arkivi Qendror i Shtetit (AQSH), F. 32, D. 41, f. 601. Sipas gojëdhënës familja e Nosëve është e ardhur nga Greqia. Sa për kohën e ardhjes së tyre nuk dihet me saktësi pasi nuk ka dokumente të shkruara. Por ajo që dimë është se në fillim të shekullit XX në Salaminë, përkundërt Pireut, jetonin ende 4-5 familje Nosi që ruanin zakone të ngjashme me Nosët në Shqipëri. Me kalimin e kohës ky fis u shtua dhe u nda në 3 degë: Nosi, Shuteriqi e Marku, të cilët u vënë fëmijëve të njëjtët emra dhe festojnë të njëjtat festa.

<sup>2</sup> AQSH, F. 32, D. 46, f. 608. Dhemitrios Nosi (Mimë Nosi) ishte mjeshtër i punimit të armëve i cili kishte fituar të drejtën e punimit të armëve të Sulltanit.

<sup>3</sup> Shkodra, Zija. *Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare*, 1984, f. 233

<sup>4</sup> Duka, Valentina. *Qytetet e Shqipërisë në vitet 1912-1914*, Toena, 1997, f. 26. Firma tregtare Nosi në Elbasan drejtohej nga vëllezërit Nosi: Anastasi, Veniamini, Nikolla, Grigori dhe Lef Nosi.

<sup>5</sup> Elbasani-Enciklopedi, EL, Sejko, 2003, fq. 344



shtypjes osmane, kur shqiptarëve u mohohet edhe e drejta elementare e shkrimit në gjuhë të mëmës, do të rritet dhe formohet edhe i riu ortodoks Lef Nosi. Për shqiptarët nacionalizmi ishte pasioni i madh i jetës publike, ishte një ideal gjithëpërfshirës, i plotë, pa kompromise. Virulenca e patriotizmit shqiptar e kishte prejardhjen në faktin se identiteti kombëtar iu ishte mohuar vazhdimisht shqiptarëve.<sup>6</sup> Popullsia ortodokse e Kalasë ishte përfshirë masivisht në zhvillimet politike dhe arsimore të qytetit dhe nga radhët saj kishin dalë mjaft përfaqësues me kontribute të rëndësishme në lëvizjen patriotike që kishte nisur në vend. I edukuar në mësonjëtorën e lagjes Kala dhe i rritur nën ndikimin e veprave të Dhaskal Todrit dhe Kostandin Kristoforidhit, ai i dha rëndësi të veçantë mësimi të përhapjes së gjuhës shqipe. Vetë pavarësia e Shqipërisë erdhi pikërisht nga përpjekjet e vazhdueshme për shkrimin dhe gjuhën shqipe. Studimet e mesme ai i kreu në gjimnazin grek të Athinës dhe po aty nisi studimet e larta në degën e farmacisë. Mundësinë për frekuentimin e shkollave në Athinë e kishin një numër i kufizuar i të krishterëve të pasur të Elbasanit.<sup>7</sup> Pas dy vjet studimesh në Athinë, të cilat nuk mundi t'i përfundojë për shkak të problemeve ekonomike, L. Nosi kthehet në qytetin e lindjes, Elbasan. Fillon të punojë me ngulm për të fituar një kulturë të gjerë, aq sa për të flitet se ka qenë një autodidakt i vërtetë.<sup>8</sup> Në këtë kohë Elbasani ishte jo vetëm vatrë e arsimit dhe kulturës shqipe, por edhe qendër e rëndësishme e lëvizjes politike e asaj kombëtare në përgjithësi. Ai gjeti në këtë qytet një mjedis të flaktë patriotik që kishte dalë në mbështetje të vendimeve të Kuvendit të Dibrës dhe që ishte treguar i gatshëm për t'u bashkuar me Lidhjen e Pejës në mbrojtje të tokave shqiptare që rrezikoheshin nga copëtimi. Patriotët elbasanas, në mbështetje të dhanë kësaj lidhjeje, gëzonin përkrahjen edhe të popullsisë së qytetit, e cila shpalli besën e bashkimit me Lidhjen Shqiptare të Pejës. Në maj të vitit 1899, Lidhja Shqiptare e Pejës u shtri edhe në Elbasan me të cilin ishte bashkuar edhe popullsia e Çermenikës dhe e Shpatit.<sup>9</sup> Politika që Porta e Lartë ndoqi për t'u përgjigjur kërkesave autonomiste të shqiptarëve; politika e përdorimit të forcës dhe dhunës, ndikuan fuqishëm në qëndrimin dhe angazhimin e ardhshëm të Lef Nosit në lëvizjen kombëtare e cila në Elbasan do të vazhdojë të zhvillohet edhe pas shtypjes së Lidhjes së Pejës në fundin e v. 1900.

Pikërisht në këtë kohë starton edhe aktiviteti i tij politik. Gjatë kësaj periudhe lëvizja kombëtare shqiptare kishte bërë hapa të rëndësishëm përpara drejt kërkesës për realizimin e autonomisë. Ai veprroi dhe u dallua si mbrojtës i çështjes kombëtare, luftëtar i përhapjes së arsimit shqip, propagandues i kulturës kombëtare, botues, politikan etj. Përpjekjet e L. Nosit u shtrinë edhe kundër veprimtarinë helenizuese që Patrikana e Stambollit ndiqte ndaj popullatës ortodokse shqiptare, me qëllim final- shkombëtarizimin e tyre përmes besimit fetar. Aktiviteti i tij njohu një shtrirje shumë të gjerë. Por në këtë punim synojmë, kryesisht, të vëmë theksin tek kontributi që Lef Nosit do të japë në jetën politike shqiptare.

---

<sup>6</sup> Rocca, Roberto Marozzo. *Kombësia dhe feja në Shqipëri. (1920-1944)*, TR, 1994, fq. 11

<sup>7</sup> Clayer, Nathalie. *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*, Tiranë: Përpjekja, 2009, fq. 91.

<sup>8</sup> Arkivi i Muzeut Elbasan (AME), F. 22, D. 3.

<sup>9</sup> Myzyri, Hysni. *Shkolla Normale e Elbasanit*, Tiranë, AlbPAPER, 2004, fq. 156

Në fillimet e shekullit XX lëvizja arsimore e kulturore në vend karakterizohet nga një ngritje e shkallës së saj të organizimit, e cila gjeti shprehjen në krijimin e një rrjeti të tërë shkollash, klubesh e shoqërish patriotike të cilat jo vetëm u shndërruan në institucione arsimore e kulturore mbarëkombëtare por njëkohësisht mbajtën peshën kryesore në zhvillimin e ngjarjeve politiko-arsimore në kuadër të lëvizjes kombëtare shqiptare. Duke përfituar nga liritë e shpallura nga xhonturqit, L. Nosi do të kontribuojë në përhapjen e arsimit dhe kulturës në gjuhën shqipe dhe merr pjesë në kongreset arsimore që u zhvilluan nga rrethet patriotike shqiptare. Ai do të bëhet inisiator i hapjes së një shkolle shqipe për ortodoksët e qytetit të tij të lindjes<sup>10</sup> dhe sëbashku me patriotë të tjerë elbasanas do të punojë me zell për t'u mësuar të rinjve gjuhën e nënës. Ky aktivitet zhvillohej në një kohë kur, lëvizja për gjuhën e shkrimit shqip konsiderohej jo vetëm si një dukuri arsimore por, më së shumti si një lëvizje me karakter të mirëfilltë politik. Veprimtaria e tij në këtë periudhë, në lëmin e shkrimit dhe përhapjes së shkollave shqipe, do të rezultojë me një rëndësi primare në procesin e formësimit të identitetit kombëtar dhe konsolidimin e ndjenjave nacionale.

Tablonë e pikëpamjeve dhe qëndrimeve të tij politike, përkundrejt pushtetit xhonturk në vend, e konturojnë jo vetëm korespondencat në gazeta të ndryshme të komuniteteve shqiptare, por edhe iniciativa e guximshme që ai do të ndërmarrë përmes botimit dhe nxjerrjes në qarkullim në mjedisin e ndezur patriotik shqiptar të të parës gazetë në qytetin e Elbasanit, të të përkohshmes “Tomorri”, e cila do të shndërrohet në tribunën kryesore të mendimit patriotik të kohës.

Politika antishqiptare e qeverisë xhonturke dhe përvoja e grumbulluar gjatë kryengritjes së vitit 1910, kishte nxjerrë në plan të parë organizimin e forcave të armatosura dhe të kryengritjes së përgjithshme për sigurimin e të drejtave kombëtare shqiptare. Në këto momente historike, Lef Nosi e gjejmë të pozicionuar në radhën e protagonistëve kryesorë të kryengritjes antiosmane të viteve 1911-1912 në zonën e Elbasanit.

Fillimi i luftës së Parë Ballkanike në tetor të 1912-ës dhe përparimi i shpejtë i ushtrive serbo-malazeze e greke në territorin shqiptar, forcoi bindjen në rradhët e patriotëve shqiptarë se zgjidhja më e drejtë e çështjes kombëtare ishte shpallja e pavarësisë. Lef Nosi u përfshi, madje u bë pjesë aktive e ngjarjeve politike dhe përpjekjeve për shkëputjen e Shqipërisë nga Perandoria Osmane.

Në 28 nëntor 1912, Lef Nosi merr pjesë në Kuvendin Kombëtar të Vlorës si delegat i Elbasanit dhe si i tillë është një ndër nënshkruesit e Aktit të Pavarësisë dhe për më tepër është ai që e ruajti këtë dokument me rëndësi të jashtëzakonshme për shqiptarët, për ta ribotuar atë disa vite më vonë për të kujtuar dhe festuar 25 vjetorin e shpalljes së Pavarësisë. I përfshirë në kabinetin e parë qeveritar shqiptar ai punon me ngulm për ngritjen dhe shtrirjen e rrjetit postar e telegrafik në të gjithë territorin shqiptar. Ndjek me shqetësim diskutimin e çështjes shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (17 dhjetor 1912) dhe njëkohësisht angazhohet për zgjidhjen e problemeve të brendshme në vend.<sup>11</sup>

---

<sup>10</sup> Gazeta “Lirija”, Selanik, 1909, 7 shkurt

<sup>11</sup> AQSH, F.32, D. 55.

Me fillimin e vitit 1914, Ismail Qemali jep dorëheqjen dhe mbyllet 14 muaj të veprimtarisë së Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Kështu përfundoi edhe detyra zyrtare e Lef Nosit në Ministrinë e Postë-Telegrafave, sektor në të cilin gjatë kësaj kohe Shqipëria bëri përparime të shpejta e të dukshme. Ndërkohë ai vazhdoi me kujdes punën mbi grumbullimin, ruajtjen e sistemimin e të gjithë dokumentacionit zyrtar të shtetit shqiptar (1912-1914), punë të cilën nuk do ta braktisë edhe më pas. Nëse shqiptarët, sot, njohin deklaratën e shpalljes së pavarësisë dhe firmëtarët e saj, e botuar në vitin 1937,<sup>12</sup> merita për këtë kujtesë historike i takon veprimtarit elbasanas, i cili e ruan këtë dokument unik si një certifikatë lindjeje për shtetin shqiptar dhe jo për qëllime përfitimi personal, sikurse një gjë të tillë nuk e bëri as me pullat postare të Perandorisë Osmane të ruajtura prej tij por që i vuri në shërbim të arkës së shtetit të parë shqiptar.

Që prej 1913-ës, Lef Nosi ishte deklaruar kundër politikës antishqiptare së ndjekur nga Esat Pashë Toptani dhe mbështeti vendimin e Ndërkombëtarëve për të sjellë në krye të shtetit shqiptar një princ nga dyert e familjeve evropiane perëndimore. Vjeshta e vitit 1914 solli shpërthimin e Luftës së Parë Botërore flakët e së cilës do të përfshijnë edhe ndërtesën e brishtë të shtetit të sapolindur shqiptar. Në këtë kohë Lef Nosi, së bashku me veprimtarë të tjerë, do të vihen në mbrojtje të çështjes kombëtare në kushtet e pushtimit të huaj dhe do të përpiqen të shmangin rrënimin ekonomik, social, politik e moral të shoqërisë shqiptare. Këto përpjekje do ti vazhdojë edhe mbasi përfundimi i konfliktit ndërkombëtar do të sjellë largimin e trupave pushtuese nga tokat shqiptare duke lënë pas jo vetëm plagët e shkatërrimeve të mëdha por edhe pikëpyetje të shumta për të ardhmen e shqiptarëve dhe shtetit shqiptar.

Në momentet e përplasjeve të ashpra politike të viteve '20 e në veçanti gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet parlamentare të v. 1923, ai pozicionohet në rradhët e borgjezisë së re të përfaqësuar nga grupimi politik “As i Pashës, as i Beut”.<sup>13</sup> Falë qëndrimit të tij progresist dhe reputacionit të mirë që gëzonte në popull, pas triumfit të kryengritjes së vitit 1924, atij do ti caktohet detyra, jo e lehtë, e drejtimit të Bashkisë së Elbasanit mision të cilit, edhe në kushtet e hezitimeve të shumta për shkak të situatës jo të favorshme politike në vend, jo vetëm që nuk do ti bëjë bisht por përpiqet ta nxjerr nga ngërçi i brendshëm politik.

Pikërisht në kohën kur proceset demokratike kishin marrë hov, ai do të botojë “Dokumenta historike për t’i shërbyer historisë sonë kombëtare” (1924), duke integruar këtu të gjitha dokumentet, telegramet, letërkëmbimet, fonogramet, shkresat, proklamata e procesverbale të periudhës 1912- 1918. Me vendosjen e “Legalitetit” (1925), kur spiralja e progresit shënon rënie, thyhen aspiratat demokratike të shumë patriotëve, ndër të cilët edhe ato të Lef Nosit. Pas përmbysjes së Qeverisë së Nolit dhe rikthimit në pushtet të Ahmet Zogut, në janar të vitit 1925, L. Nosi largohet nga detyra e kryetarit të bashkisë së Elbasanit dhe shkëputet përkohësisht nga skena politike, duke u dhënë plotësisht mbas gjurmimit e mbledhjes së dokumenteve historike. Në kushtet e rritjes së influencës italiane në Shqipëri ai vazhdon të jetë figurë qendrore e rretheve

---

<sup>12</sup> Po aty, D. 40.

<sup>13</sup> “Ura e Shkuminit”, vjeshtë e III- të, 1923, Elbasan



nacionaliste që luftojnë për të mbrojtur pavarësinë politike shqiptare. Qëndrimin e tij kundërshtues ndaj përpjekjeve të Italisë dhe elementëve italoofil në vend, për ta shndërruar Shqipërinë në zonë të ndikimit absolut italian, ai e kishte shprehur edhe më herët, kohë kur ai u vu në mbrojtje të pavarësisë së shtetit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris (1919).

Ndonëse ishin kundërshtarë politik gjatë viteve 1922-1924, Lef Nosi nuk e luftoi pushtetin e Zogut por ndërkohë as nuk pajtohet, madje e kundërshton, politikën e depërtimit italian në vend gjatë regjimit zogist.<sup>14</sup>

Lufta e Dytë Botërore solli zhvillime të reja politike në mjedisin shqiptar jashtë të cilave nuk mund të qëndronte Lef Nosi. Pas agresionit fashist të 7 Prillit 1939, Shqipëria humbi pavarësinë, fakt ky që solli reagimin e rretheve nacionaliste shqiptare. Lef Nosi nuk ishte zogist por ishte anti-italian. Si kundërshtar i regjimit të ri, në vitin 1941, ai do të internohet në Itali ku do të vendosë kontakte edhe me nacionalistë të tjerë shqiptarë në emigracion. Pas kthimit në atdhe, Lef Nosi do të pozicionohet në krahun e djathtë të rezistencës që kishte nisur në vend kundër pushtuesve fashist.

Zëvendësimi i trupave fashiste italiane nga forcat gjermane, të cilat deklaruan se nuk ishin pushtues por ishin neutralë e kalimtarë, u shoqërua me hyrjen në qeveri të figurave të tilla me autoritet e kontribut të njohur në çështjen kombëtare, të cilët e pranuan ofertën e pushtetit, duke u bazuar në angazhimin gjerman për njohjen e shtetit etnik shqiptar dhe në frikën në rritje ndaj rrezikut komunist. Antikomunizmi i L. Nosit dhe afrimi i tij me gjermanët u bë aktiv sidomos pas mohimit të marrëveshjes së Mukjes nga krerët e PKSH-së. Sipas tij politika shqiptare e atyre kohëve kërkonte që nacionalistët të ishin në krye të qeverisë pasi një plan ata e kishin për Shqipërinë. Lef Nosi, më i moshuari, 67 vjeç, zgjidhet kryetar i Përkohshëm i Kuvendit Kombëtar dhe anëtar i Këshillit të Lartë të Regjencës deri në 25 tetor 1944. Duke parë përparimin e forcave komuniste, politikanë e ushtarakë me bindje antikomuniste në vend, ndër të cilët edhe Lef Nosi, u grumbulluan në qytetin e Shkodrës. Në 12 nëntor 1944 ata zhvilluan një mbledhje në kuvendin françeskan të Shkodrës duke patur për qëllim organizimin e qëndresës deri në një zbarkim të menduar anglo-amerikan, tek i cili kishin besim se do të ndalonte vendosjen e plotë të regjimit komunist në Shqipëri. Por ngjarjet rrodhën ndryshe.

Me mbarimin e luftës, skica marksiste e forcave politike që morën pushtetin në vend, filloi të gjykojë *a priori* një periudhë historike dhe një klasë politike, pa analizuar rrethanat, aktivitetin e qëndrimet konkrete të secilit protagonist të kësaj klase. Faktet tregojnë se një pjesë kryesore e këtyre politikanëve ishin figura të njohura me kontribute në historinë e kombit shqiptar, personalitete që gëzonin respekt në opinionin publik. Midis tyre gjendet edhe figura e Lef Nosit, emri i të cilit ndodhet në listën e 107 të pushkatuarve pa gjyq, në qytetin e Elbasanit, nga pushteti i ri popullor.<sup>15</sup>

---

<sup>14</sup> Neuwirth, Hubert. *Qëndresë dhe bashkëpunim në Shqipëri*, Tiranë, 2006, fq. 45

<sup>15</sup> AME, D. 22, D. 4.

Regjimi u tregua i ashpër sidomos me të gjithë funksionarët e lartë që kishin bërë pjesë në qeveritë e viteve 1939-1944 apo kishin mbajtur poste drejtuese në administratën e kësaj periudhe. Ndër ta ishte edhe Lef Nosi i cili, pas largimit nga Regjenca, qëndroi për rreth 2-3 muaj në fshatrat e Elbasanit. Në fillim të vitit 1945 ai zbulohet në Tiranë nga agjentët e sigurimit, arrestohet dhe në shkurt të 1946-ës, bashkë me Padër Anton Harapin e Maliq Bushatin, iu zhvillua gjyqi në Tiranë dhe në moshën 69 vjeçare, u pushkatua.<sup>16</sup>

Ai la pas jo vetëm gjurmët e aktivitetit të tij politik, dëshmi të angazhimit atdhetar, por u la brezave trashëgim thesarin e mbledhur gjatë një jete, pronë e kujtesës sonë kombëtare historike. Me ato 10-ra e 100-ra faqe të shkruara e të përkthyer, figura e veprimtaria e Lef Nosit krijon hapësira për përgjithësime.

Lef Nosi ishte një njeri me kulturë të gjerë dhe kishte letërkëmbime të shumta me personalitete të shquara brenda e jashtë vendit. Veçojmë këtu kontaktet e tij me albanologun e shquar Norbert Joklin; bashkëpunimin, kryesisht në fushën e folklorit e të etnografisë, me ballkanologun gjerman, Gustav Vajgand; me studiuesen e njohur angleze Margaret Hasluck, nga ku përfitoi shumë prej saj, veçanërisht në metodologjinë shkencore të punëve studimore; vendos kontakte, për fushën e arsimit shqip, me misionarët amerikan në Shqipëri, Fines e Violet Kenedi dhe Telford T. Erikson, që mbërritën në vend gjatë vitit 1908.<sup>17</sup> Është mjaft i njohur edhe si mbledhës i relikave, antikave, grumbullues i madh i materialit arkivor dhe i dokumentave në fusha të ndryshme të shkencës.<sup>18</sup>

Me pak fjalë, do të na duheshin disa epitete për të përcaktuar punën e tij: arkivist, folklorist, etnograf, numizmat, mbledhës i materialit arkeologjik etj, duke i sjellë shërbime kolosale kombit.

Në Arkivin Qendror të Shtetit gjenden dokumenta të shumta që kanë të bëjnë me personalitetin e Lefther (Lef) Nosit, të natyrës biografike, politike, e shoqërore, letërkëmbime, studime në fushën politike, historike, gjuhësore, arkeologjike etj. Ndër më të spikaturat janë grumbullimi e sistemimi i dokumentave historike, gjithë materiali i gjykatës turke, arkivi i Sheriatit të Elbasanit i cili fillon që nga viti 1560. Ai gjurmon regjistrat e vjetër të esnafëve të krishterë e atyre musliman.<sup>19</sup> Dokumentet e mbledhura prej tij janë jo vetëm në gjuhën shqipe por edhe në gjuhët osmanisht, greqisht, italisht, anglisht e frëngjisht. Madje ai kishte caktuar edhe një shkruer, Ashim Hakanin, duke e paguar atë çdo muaj për përkthimin e tyre.<sup>20</sup> Regjistrimi i këtij materiali është bërë në mënyrë kronologjike sipas rradhës së marrjes ose lëshimit të dokumentit. Ishte arkivues i gjetjeve arkeologjike, parave e armëve të vjetra dhe informacioneve që shërbejnë si burim për studime arkeologjike. Ruan shënime e dokumenta historike e topografike rreth

---

<sup>16</sup> *Elbasani-Enciklopedi*, Elbasan, Sejko, fq. 240

<sup>17</sup> Po aty, fq. 320

<sup>18</sup> AME, F. 22, D. 3.

<sup>19</sup> AQSH, F. 32, D. 43

<sup>20</sup> *Elbasani- Enciklopedi*, vepër e cituar, fq. 507

qyteteve të Elbasanit, Korçës, Vlorës, Beratit etj.<sup>21</sup> Madje me emrin e Lef Nosit janë të lidhura edhe përpjekjet e para në Elbasan, në fillim të shekullit XX, për ngritjen e muzeut historik- arkeologjik.

Me veprimtarinë e tij, Lef Nosi është një ndër nismëtarët e etnografisë dhe folkloristikës shqiptare. Shpëton dorëshkrimet e Dhaskal Todrit, Kostandin Kristoforidhit,<sup>22</sup> shumë materiale të të cilit nuk ishin bërë të njohura më parë, të cilat, në 1918- ën do të botohen prej Lef Nosit në faqet e të përkohshmes “Kopështi Letrar”; ruan shënimet e Jovan Muzakut, dhespotit të fundit të Epirit, rreth gjenealogjisë së familjes Muzaka;<sup>23</sup> grumbullon informacion mbi vezirët e Shqipërisë si Ali pashë Tepelenën, Bushatllinjët, Zogollët;<sup>24</sup> ruan dokumenta biografike për Ali Çaushtin, Hamdi Ohrit, Sadik Zharrin, Xhile Liçin;<sup>25</sup> arkivon materiale mbi ngjarje të ndryshme historike në vend gjatë sundimit turk, mbi veprimet e serbëve, për aktivitetin e Ismail Qemalit, Hasan Prishtinës, Bajo Topullit, Esat Toptanit, Ahmet Zogut e për kryengritjen e Haxhi Qamilit;<sup>26</sup> mbledh, për qëllime studimi, një material shumë të pasur folklorik siç është cikli i kreshnikëve e këngët legjendare, fraza popullore e gojëdhëna; gjurmoi dhe ia la trashëgim brezave të famshmin dorëshkrim të Papa Totasit që lidhet drejtpërdrejtë me origjinën e shqipes së shkruar, ruan materiale studimore mbi Shqipërinë, gjuhën shqipe dhe shqiptarët.<sup>27</sup> Biblioteka e tij numëronte më se 10 000 vëllime me vlera të padiskutueshme albanologjike e ballkanologjike.

Ndonëse ishte me një kulturë të gjerë, njohës i disa gjuhëve të huaja, turqisht, greqisht, anglisht, frëngjisht e italisht, tërë këtë thesar, që ai e ruajti me mjaft fanatizëm, nuk arriti ta trashëgojë.<sup>28</sup> Mbas vitit 1945, prona e Lef Nosit u shtetëzua dhe pjesa më e madhe e periodikëve dhe librave me një vlerë mjaft të madhe kaluan në pronësi të Bibliotekës Publike të qytetit të Elbasanit, dhe më pas, në kohë të ndryshme, një pjesë e mirë e tyre iu kaluan Bibliotekës Kombëtare. Pasurinë e madhe që mbledhi, ai nuk arriti ta botonte vetë, por ajo u përkthye dhe u përshkrua më vonë nga specialistë shqiptarë.

Lef Nosi nuk ishte vetëm mbledhës e gjurmues i kësaj pasurie, por edhe veprimtar i lëvizjes politike e shoqërore në vend, aktivitet për të cilin ai ka marrë vlerësimin e drejtuesit të shtypshkronjës “Vlora” në vitin 1924, S. Hallkokondi, e shprehur përmes fjalëve: “Tue qenë se biografi e Zotëries suaj në jetën politike e kombëtare është më e shkëlqyera, ka nevojë të sipërmeritueshme të përshkruhet si në faqet e Historisë Kombëtare gjithashtu edhe në pjesë historike të fjalorit gjithfarësh që do të vihen në shtyp...Ndaj, jeni të lutur, të na çoni fytyrën e shkëlqyer, si dhe biografinë ku është nevoja të përshkruhen ngjarjet kombëtare ku

---

<sup>21</sup> AQSH, F. 32, D. 39

<sup>22</sup> Po aty, D. 49

<sup>23</sup> Po aty, D. 44

<sup>24</sup> Po aty, D. 48

<sup>25</sup> Po aty, D. 50

<sup>26</sup> Po aty, D. 132

<sup>27</sup> Po aty, D. 134

<sup>28</sup> AME, F. 22, D. 3.

keni marrë pjesë...mbështetjen, mendimin, programin e bazat tuaja në çështje kombëtare...”<sup>29</sup> Ka kaluar gati një shekull dhe veprimtaria politike e Lef Nosit ende nuk është e plotë në faqet e Historisë Kombëtare.

## KREU I. NË FILLIMET E VEPRIMTARISË POLITIKE

### I.1 Lef Nosi në Lëvizjen Kombëtare të fillim shekullit XX

Lef Nosi jetoi dhe punoi në fundin e shekullit XIX dhe më së shumti në gjysmën e parë të shekullit XX, periudhë e cila, në historinë e Shqipërisë, përfshin edhe epokën kur u zhvilluan platformat e përpjekjet për çlirim kombëtar, pavarësi, dije dhe kulturë në kuadrin e Rilindjes sonë kombëtare. Idealet e Rilindjes kishin dhe bartësit, luftëtarët dhe shprehësit e tyre. Në radhët e këtyre veprimtarëve që lanë gjurmë në procesin e formimit të vetëdijes kombëtare, të diturisë e arsimit, u rreshtua edhe Lef Nosi i cili me veprimtarinë e tij në fushën arsimore, si mbrojtës e mësonjës i gjuhës amtare, si propagandues e luftëtar i kulturës dhe i të drejtave kombëtare, do të bëhet një nga zëdhënësit dhe interpretët e aspiratave të Rilindjes në shërbim të kombit shqiptar.

Në vitet ‘90 të shekullit XIX qyteti i Elbasanit dhe rrethinat e tij ishte shndërruar në një vatër të rëndësishme të arsimit shqiptar dhe e lëvizjes kombëtare<sup>30</sup> e cila gjatë kësaj kohe kishte shënuar një ngritje të re, si në shkallën e organizimit të qëndresës së armatosur, ashtu dhe në zhvillimin e mëtejshëm të mendimit politik kombëtar. Me fillimin e shek. XX, lëvizja për gjuhën dhe shkrimin e shqipes do të konsiderohej jo thjesht një dukuri gjuhësore por do të marrë më së shumti përmasat e një lëvizjeje të natyrës politike në kushtet kur, nën Perandorinë Osmane, shqiptarëve iu ishte mohuar gjuha dhe shkolla shqipe, të cilat ishin shprehja më e qartë e identitetit kombëtar. Një kontribut të rëndësishëm në kuadrin e zhvillimit të lëvizjes patriotike ka dhënë në veçanti popullsia ortodokse e qytetit e cila për shkak të kësaj veprimtarie do t’i duhet shpesh të përballlet me masat ndëshkuese të Patrikanës së Stambollit.

Çështja shqiptare, e rrezikuar qysh herët nga situata konfliktuale territoriale me popujt fqinjë, duke ndërthurur brenda saj interesa kombëtare e ndërkombëtare, do të bëhet platforma mbi të cilën L. Nosi do të mbështesë veprimtarinë e tij, tek e cila ushtruan një ndikim të fuqishëm si faktorë të brendshëm ashtu edhe ata të jashtëm, kontaktet e dendura që ai do të vendosë me përfaqësues të shquar të lëvizjes kombëtare si edhe vetë realiteti shqiptar.

---

<sup>29</sup> AQSH, F. 32, D. 55/2.

<sup>30</sup> Myzyri, Hysni. *Shkollat e para kombëtare shqipe*, Tiranë, 1978, fq. 133

Shtypi i fundit të shekullit të XIX na jep dëshmi që vërtetojnë përhapjen e shkrimit e të librit shqip jo vetëm në qytetin e Elbasanit, por edhe në rrethinat e tij, rajon në të cilin lëvizja për shkollën shqipe ishte shkrirë me luftën e armatosur që kishte bashkuar myslimanë e ortodoksë, të fshatit e të qytetit, në dobi të çështjes së çlirimit kombëtar. Në faqet e revistës “Albania”, që dilte në Bruksel, do të gjejë pasqyrim situata në Elbasan gjatë 1897-ës ku ndër të tjera shkruhej se: “... ka pasur shumë raste konfliktesh mes autoriteteve turke dhe banorëve, gjithë dyqanet janë transformuar në shkolla e mund të thuhet me siguri se gjithë elbasanasit kultivojnë gjuhën e tyre dhe çështjes së gjuhës kombëtare i japin një rëndësi politike”.<sup>31</sup>

Shekulli i XIX po përfundonte duke u lënë trashëgim shqiptarëve regjimin mesjetar osman i cili godiste fort çdo përpjekje që synonte të lehtësonte peshën e sundimit otoman disashekullor. Shtypja ekonomike e politike e administratës osmane, rritja e ndërhyrjes së shteteve të huaja, kryesisht atyre fqinje ballkanike, në trevat shqiptare i dhanë një impuls të ri zgjerimit të lëvizjes “me pushkë e me penë” në vitet e para të shekullit XX. Në pranverën e vitit 1900 konsulli austro-hungarez i Durrësit, pas vizitës që bëri në Elbasan, do t’i shkruante Vjenës: “Për ngritjen e idesë kombëtare Elbasani është një qendër e rëndësishme... ideja kombëtare ka pushtuar atje shtresat e gjera të popullit, gati çdo familje ka një, dy anëtarë që dinë të shkruajnë dhe lexojnë shqip”.<sup>32</sup> Ishte ky mjedis patriotik që do të frymëzojë angazhimin e Lef Nosit në jetën politike të vendit.

Në këtë fillimshekulli (XX), duke vlerësuar drejt situatën e brendshme dhe të jashtme politike, edhe veprimtari i ri, pak mbi të 20-at, Lef Nosi do t’i bashkangjitet idesë së Shqipërisë autonome, kërkesës së përgjithëshme të myslimanëve e të krishterëve për njohjen zyrtare të gjuhës shqipe dhe për ngritjen e shkollave kombëtare. Duket se tek ai kishin zënë vend thirrjet e Faik Konicës përmes faqeve të revistës “Albania” se: “...është detyrë e “mëmëdhetarëve të vërtetë” që të përpiqen të këndohet dhe të shkruhet gjuha shqip, të hapen ca shkolla, të shëndoshet dhe të rritet mendimi kombiar, të çahet dhe udhëra të mira e të shumta nëpër Shqipëri që të ngjallet tregëtia dhe bujqësia...”.<sup>33</sup> Sikurse edhe shumë shqiptarë të tjerë “në shpirtin e të cilëve zinte dashuria për mëmëdheun e që ditë për ditë po mblidheshin rreth e rrotull flamurit tonë për të luftuar atë luftën e mirë dhe pa gjak nga e cila do të dalë i fortë dhe i math Kombi Shqipëtar”,<sup>34</sup> edhe L. Nosi, i vetëdijshëm gjithashtu edhe për rreziqet që i kanoseshin Shqipërisë nga monarkitë fqinje ballkanike dhe për qëndrimin e diplomacisë evropiane, e cila nuk e shihte me sy të mirë lëvizjen çlirimtare të shqiptarëve madje ishte e gatshme të ndihmonte Turqinë për ruajtjen e *status quo*- së në Ballkan, përkrahën idenë, e shprehur edhe më parë nga Ismail Qemali në platformën e tij për autonominë

<sup>31</sup> Revista “Albania”, Bruksel, 1897, nr. 15

<sup>32</sup> Graceni, Bardhyl. *Aleksandër Xhuvani*, Tiranë, 1980, fq. 19.

<sup>33</sup> Jorgaqi, Nasho. *Faik Konica*, Vepra 3, Tiranë, Duda, 2001, fq 15. Artikull i revistës “Albania”, 31 mars 1898.

<sup>34</sup> Po aty

e shqiptarëve,<sup>35</sup> se “udha më e drejtë për çlirimin e Shqipërisë ishte ajo e përhapjes në popull e shkrimit dhe e këndimit shqip, e dijeve dhe diturisë”.<sup>36</sup>

Që nga koha e kongresit të Berlinit shqiptarët po luftonin për të shkëputur nga turqit autonominë dhe njohjen e tyre si komb. Në të gjitha memorandumet e projektet autonomiste të hartuara gjatë ekzistencës së Lidhjes së Prizrenit, bënte pjesë edhe kërkesa për shkolla në gjuhën shqipe. Përballë presionit të lëvizjes kombëtare shqiptare dhe rreziqeve që kishte sjellë për Perandorinë Osmane kriza lindore e viteve 1875-1878, Porta e Lartë kishte qenë e detyruar, që për të parën herë, të bënte disa lëshime të përkohshme<sup>37</sup> të cilat i dhanë mundësi zhvillimit të veprimtarisë arsimore e kulturore e cila synonte “përhapjen e mësimi të gjuhës shqipe me anën e shkollave dhe të teksteve shkollore”.<sup>38</sup> Kjo veprimtari u finalizua më në fund me hapjen e shkollës kombëtare në Korçë, ndërkohë që përpjekjet u shtrinë edhe në shumë qytete të tjera shqiptare. Dolën në qarkullim një numër organesh të reja dhe libra e fletore nisën të botoheshin nga shtypshkronjat shqiptare. Dëshmi të përpjekjeve e të arritjeve në drejtim të hapjes së shkollave shqipe gjejmë në rreshtat e njërit prej organeve të shtypit shqiptar të kësaj kohe dhe konkretisht në gazetën “Shqipëria” të Bukureshtit e cila filloi të botohej në vitin 1897, ku ndër të tjera shkruhej: “Vivlla kërkonen, shkolla hapenë edhe ndë tërë vendin rëfëhet një etje për mësim.”<sup>39</sup>

Dëshira për të mësuar dhe për të çelur shkolla shqipe shtroi edhe problemin se si do të siguroheshin mjetet e nevojshme materiale që mungonin. Librat kërkoheshin jo vetëm nga shkollat, por edhe nga të gjithë ata që dëshironin të mësonin shkrimin e leximin shqip. Mirëpo sjellja e tyre nga Sofja e Bukureshti, ku ato shtypeshin, bëhej gjithnjë e më e vështirë. Sulltani i alarmuar prej hovit të shpejtë që mori lëvizja kombëtare ndaloi përsëri përdorimin e shqipes. Dënime me burgime të rënda u dhanë për mësonjësit e shqipes e për të gjithë ata që mbanin botime shqip të fshehura.<sup>40</sup>

Për shkak të vështirësive ekonomike, i sapokthyer nga Athina, ku kishte rënë në kontakt me rrethet patriotike në mërgim, Lef Nosi do të japë kontributin e tij, edhe financiar, për futjen në vend, fshehurazi, të librave, gazetave e broshurave në gjuhën shqipe duke i ardhur kështu në ndihmë veprimtarisë së atdhetarëve shqiptarë jashtë vendit. Ndërkohë qeveria osmane vazhdonte të qëndronte e vendosur në politikën e saj antishqiptare. “Në bazë të urdhërave turke më të reja” - do të shkruante konsulli austro-hungarez i Shkodrës – “dënohet posedimi i një libri shqip ose përdorimi i gjuhës shqipe në korrespondencë. Veçanërisht të ndaluar janë gazetat shqipe që janë shtypur jashtë dhe vendasit (shqiptarët) tregojnë një guxim e sakrificë jo të vogël, kur i ruajnë ato ose i japin hua dorë më dorë”.<sup>41</sup> Në kushte të tilla patriotëve shqiptarë u mbetej

<sup>35</sup> Naska, Kaliopi. *I. Qemali në lëvizjen kombëtare shqiptare*, Tiranë, 1987, fq. 34-35

<sup>36</sup> *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi. II, Tiranë, 2002, fq. 323

<sup>37</sup> Myzyri, Hysni. *Shkollat e para...*, vepër e cituar, fq. 37

<sup>38</sup> Po aty, fq. 39

<sup>39</sup> Gazeta “Shqipëria”, Bukuresht, viti 1897, nr. 27, dt. 8 nëntor

<sup>40</sup> Durham, Edith. *20 vitet e trazirave të mëdha*, Tiranë, 2001, fq. 110

<sup>41</sup> Myzyri, Hysni. *Shkollat e para...*, vepër e cituar, fq. 212-213

të vepronin vetëm në fshehtësi. Mirëpo përballë kësaj lëvizje në rritje Porta e Lartë ndërmori masa të menjëherëshme. Me anë të një urdhërese dërguar vilajeteve shqiptare, ajo urdhëronte që "...t'i ndiqnin botimet në gjuhën shqipe, të kontrollonin shtëpitë e atyre personave që ishin të dyshimtë për mbajtjen e tyre dhe ata që do të kapeshin me të tilla, të bëheshin përgjegjës."<sup>42</sup> Filloi një valë e gjerë ndjekjesh, presionesh, arrestimesh e burgimesh në rradhët e atdhetarëve dhe qytetarëve të thjeshtë shqiptarë që akuzoheshin për tradhëti të lartë dhe për përhapjen e shkrimeve të ndaluara. Njëri prej tyre ishte edhe veprimtari elbasanas.

Në 22 shkurt të vitit 1901 Lef Nosi, i dyshuar për posedim dhe shpërndarje në popull të botimeve në gjuhën shqipe, arrestohet në Elbasan<sup>43</sup> nën akuzën "për faje politike". Ndërkohë që motivi i vërtetë, në kushtet e rritjes së presionit të brendshëm politik kundër pushtetit absolutist të sulltanit, ishte rritja e kontakteve që turqit e rinj kishin vendosur me lëvizjet e popujve të shtypur të Perandorisë, rrjedhimisht edhe me figura të njohura të lëvizjes kombëtare shqiptare, pjesë e së cilës ishte edhe veprimtari elbasanas. E ndërsa gjykata e Selanikut hedh poshtë kërkesën e tij për pafajësi, L. Nosi do të vuaj dënimin për 9 muaj në burgun e Elbasanit.<sup>44</sup>

Gjatë kësaj kohe lëvizja kombëtare e drejtuar nga patriotë shqiptarë që ndodheshin në mërgim kishte arritur në përfundimin se Shqipëria duhej të fitonte autonominë administrative në kuadrin e Perandorisë Osmane. E thënë akoma më qartë, kërkohej që të gjitha trojet ku flitej gjuha shqipe e ku shqiptarët përbënin shumicën e banorëve, të bashkoheshin në një vilajet që do të quhej Shqipëri, "duke pasur për kryeqytet Ohrin ose Elbasanin".<sup>45</sup>

Kështu në vjeshtën e vitit 1901, pasi kishte përfunduar dënimin e tij, Lef Nosi bashkë me patriotë të tjerë elbasanas, i ndodhur në kryeqendrën e ideuar të vilajetit shqiptar që prej vjeshtës së vitit 1880 në kuvendin kombëtar të Dibrës,<sup>46</sup> dhe i përfshirë në lëvizjen autonomiste, vazhdoi t'i kushtoj një vëmendje të veçantë problemit të gjuhës dhe shkollës shqipe si shtylla kryesore ku do të mbështetej bashkimi politik i shqiptarëve. Qeveria turke ndërsa ndalonte, me ndëshkime të rënda, mësimin e gjuhës shqipe dhe botimin e librave shqip, në anën tjetër hapte shkolla turke dhe bënte përpjekje që fëmijët shqiptar të rriteshin duke besuar se ishin turq. Në të njëjtën kohë kjo politikë inkurajoi grekët që me propagandën e tyre, se të krishterët ortodoksë në Shqipëri i përkisnin kishës helene, filluan të hapin shkolla greke për shqiptarët ortodoksë. Ndërsa patriotët shqiptarë përpiqen të shfrytëzojnë lëvizjen e xhonturqve kundër absolutizmit sulltanor për të siguruar të drejta dhe liri për kombin, atyre iu desh të përballeshin edhe me qëndrimin e Patrikanës së Stambollit e cila, sikurse edhe më parë, vazhdonte të kërkonte ndihmën e autoriteteve osmane

<sup>42</sup> Po aty

<sup>43</sup> AQSH, F. 32, D. 37, f. 87

<sup>44</sup> Po aty, D. 30, f. 2

<sup>45</sup> Naska, Kaliopi. *Ismail Qemali...*, Tiranë, 1987, fq. 37

<sup>46</sup> *Elbasani-Enciklopedi*, vepër e cituar, fq. 344. Varoshi, Liman. *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*. 300 delegatët e mbledhur në kuvendin e Dibrës (23 tetor 1880) pasi diskutuan rreth çështjes së vilajetit autonom shqiptar shfaqën mendime e bënë propozime për kryeqendrën e vilajetit dhe kandidatura më e fortë kishte qenë Elbasani si qendër e vendit.



dhe të bashkëpunonte me to për t’iu kundërvënë lëvizjes e veprimtarëve shqiptarë. Patriarku grek u shty aq thellë me veprimet e tij sa që kërcënonte me komunikatë çdo shqiptar ortodoks që do të përdorte “gjuhën e mallkuar” në kishë qoftë, apo në shkollë.<sup>47</sup>

Në fillim të vitit 1902 u bënë arrestime të reja. U shtuan organet e policisë publike dhe sekrete. Zyrat postare kishin marrë instruksione që të konfiskonin “korespondencën e dyshimtë” të shqiptarëve dhe broshurat në gjuhën shqipe. Kontrollit të policisë i nënshtroheshin sidomos karvanet e qiraxhinjve, të cilët shkonin e vinin në mënyrë periodike midis qyteteve të mëdha të vendit.<sup>48</sup> Në marsin e atij viti, Lef Nosi arrestohet përsëri bashkë me dy patriotë të tjerë elbasanas si “të dyshimtë” për marrëdhënie me komitetet shqiptare jashtë vendit, ndërsa në të vërtetë ishin ndaluar gjatë rrugës duke shkuar në Durrës për fjalorin e Kostandin Kristoforidhit, të cilin i biri, Stefani, ia kishte shitur, për borxhet që i kishte, tregtarit elbasanas, Veniamin Nosit. Ky i fundit, me shpresën që ky fjalor të shihte dritën e botimit, ia kishte shitur konsullit grek të Durrësit. Vetë Kristoforidhi sa ishte gjallë ishte përpjekur mjaft që ta vinte në shtyp fjalorin e tij me anë të shoqërisë shqiptare të Bukureshtit, por pa ia arritur qëllimit. As e shoqja e Kristoforidhit, ndonëse ishte përpjekur më shumë se një herë ta shiste fjalorin, nuk mundi dhe deri në vitin 1900, kohë kur ajo ndërron jetë, dorëshkrimi ruhej në shtëpinë e Kristoforidhit. Që prej asaj kohe, kishte dy vjet që fjalori ndodhej në Arkivat e Ministrisë së Jashtme të Greqisë dhe kishte pak gjasa që ai të botohej së shpejti.<sup>49</sup> Për këtë arsye Lef Nosi, bashkë me Stefan Kristoforidhin e Mihal Berberin, nisen drejt Durrësit. Këtë e dëshmon edhe fakti se në momentin e arrestimit të vetmet materiale “kompromentuese” që iu gjetën Lef Nosit me vehte ishin 9886 groshë të cilat iu konfiskuan kur atë e burgosën.<sup>50</sup> Lajmin e arrestimit të tyre e bëri të ditur një nga organet më të rëndësishme të shtypit shqiptar të fillimit të shekullit XX-të, gazeta “Drita” e Sofjes në të cilën do të shkruhej: “...i biri i shpirt- ndriturit Kristoforidh, Lef Nosi dhe Mihal Berberi nga Elbasani, të tre kishin vajtur në Durrës për fjalëtoren e Kristoforidhit që ja patnë shitur konsullit të Greqisë, i cili i kishte thirrur t’u paguante çmimin e kësaj libre...por konsulli n’anë tjetër i tradhtoj...dhe ato i zunë nga an e qeverisë turke në mest t’udhës nga Kavaja në Durrës! Djalën e të ndjerit Kristoforidh e çuan në Shkodër lidhur, ndërsa dy të tjerët (L. Nosi e M. Berberi – E.A) në Elbasan dhe në burk”.<sup>51</sup> Pasi qëndroi për disa muaj në burgun e Elbasanit, Prokuroria e Gjykatës së Apelit të vilajetit të Selanikut, të cilës iu paraqitën aktet hetimore të padisë së të drejtës botore kundra të arrestuarit, Lefther Nosit, nga lagjia Deruni Kala e Elbasanit, “i pandehur se ka pas marrëdhënie dhe korespondencë me komitet shqiptarë dhe

<sup>47</sup> Durham, Edith. *20 vitet e trazirave të mëdha*, Tiranë, 2001, fq. 108

<sup>48</sup> Myzyri, Hysni. *Shkollat e para kombëtare shqipe*, Tiranë, 1978, fq. 223

<sup>49</sup> Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë e Letërsisë, *Aleksandër Xhuvani*, vepraII, Tiranë, 1990, fq. 13

<sup>50</sup> AQSH, F. 32, D. 1 f. 1

<sup>51</sup> “Drita”, Sofje, nr. 9, viti 1902, f. 4

grekë... pasi shqyrtoi vendimin e seksionit të Lutjeve të Gjykatës së Diktimit, vendosi në gusht të vitit 1902, të dërgojë në Selanik, nën roje, të burgosurin Lef Nosi”.<sup>52</sup>

Ndërkohë që atë e nisin drejt burgut të Selanikut, ku do të qëndrojë për 5 muaj, në Elbasan do të arrestohen edhe dy vëllezërit e tij: Anastasi, anëtar i Këshillit Administrativ të Prefekturës, dhe Veniamini, tregtar nga Elbasani i cili burgoset nën akuzën “për tradhëti dhe intriga” por lirohet, për mungesë provash, me vendim të Gjykatës luftarake të Manastirit.<sup>53</sup>

Politika ndëshkuese që ndiqte Porta e Lartë pati për pasojë jo vetëm rritjen e qëndresës së popullit shqiptar, por nuk la indiferente as Fuqitë e Mëdha. Trajtimin e keq të shqiptarëve nga Turqia, Vjena e shikonte si shkakun kryesor të pakënaqësisë së tyre. Madje ministri i Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, në letrën dërguar kryeministrit turk, Said Pashës, jo vetëm vlerësonte të drejta kërkesat kombëtare të shqiptarëve, por edhe theksonte se nuk ishin të nxitura nga jashtë, siç pretendonte Porta e Lartë, por ishin të lidhura me “ndjenjat që kanë lindur tek populli shqiptar”.<sup>54</sup>

Në një situatë të tillë, në 22 shkurt 1903, gjykata e Selanikut i jep pafajësinë Lef Nosit, i cili lirohet nga burgu i Jedi Kullës në Selanik<sup>55</sup> e kthehet në Elbasan, ku vazhdon të punojë për çështjen kombëtare. Zëri i tij do t’i bashkohet thirrjes së atdhetarëve për zbatimin në vilajetet shqiptare të disa masave me karakter thellësisht kombëtar si: njohja zyrtare e kombësisë shqiptare, e drejta e mësimin në gjuhën amtare, futja e saj në ceremonitë fetare etj.

Por politika osmane nuk ishte kundërshtarja e vetme e Lëvizjes Kombëtare. Po aq i rrezikshëm ishte edhe qëndrimi i Patrikanës greke të Stambollit që me politikën e saj i shërbente helenizimit grek e kishte marrë një pozicion kryekëput kundërshtar kundrejt zgjimit kombëtar shqiptar dhe me çdo mjet e mënyrë luftonte e pengonte përhapjen e shkrimit dhe këndimit në gjuhën shqipe. Ekzistenca në Shqipëri e katër bashkësive fetare kryesore, myslimane synite, ortodokse, katolike dhe ajo e bektashinjve, u kishte lejuar fuqive të huaja që të paraqitnin pretendime mbi Shqipërinë, sikurse mbulonte Athina synimet e saj aneksioniste ndaj tokave shqiptare përmes përpjekjeve të saj për t’i konsideruar grek popullsinë ortodokse shqiptare. Nga ana tjetër fetë u kishin lejuar shqiptarëve që të ruanin identitetin e vet kombëtar përballë asimilimit grek, serb apo bullgar.<sup>56</sup> Në këtë kohë, veprimtari ortodoks, Lef Nosi do të bëhet pjesë e asaj lëvizje që kishte nisur në zonën e Elbasanit që në gjysmën e dytë të shekullit XIX e cila drejtohej kundër Patrikanës Ikumenike dhe priftërinjve grekë që përpiqeshin ta përdornin fenë ortodokse në Shqipëri për qëllimet e tyre helenizuese. Ai do t’i bashkohet kauzës së propaganduar nga drejtuesi i lëvizjes unite në Elbasan, nga arkimandriti Germanos (Papa Jorgji Theohari) “një kishë, një komb”, i cili në një letër të

<sup>52</sup> AQSH, F. 32, D. 59, f. 1

<sup>53</sup> Po aty, f. 18-19

<sup>54</sup> *Historia e popullit shqiptar*, Vëll. II, TOENA, Tiranë, 2002, fq. 306

<sup>55</sup> AQSH, F. 32, D. 37, f. 88

<sup>56</sup> Rocco, Roberto Moroco. *Kombësia dhe feja në Shqipëri*, Tiranë, 1994, fq. 9

nëntorit të vitit 1900 do të shkruante: “Qëllimi im është protesta ...kundër Patrikanës Ikumenike, e cila duke shkelur edhe detyrimet klerikale të saj, është bërë një vegël ekskluzivisht e politikës greke që nuk synon asgjë tjetër veçse të bëjë shkombëtarizimin e të gjithë popujve jogrek që varen prej saj dhe futjen e tyre nën zgjedhën e gjuhës e të qytetërimit grek.”<sup>57</sup> Nisur nga qëllimi i saj, lëvizja që kishte nisur e që do të vazhdonte deri në vitin 1907, kishte përfshirë në rradhët e saj jo vetëm veprimtarë ortodoksë por edhe patriotë elbasanas të përkatësive të tjera fetare si Aqif Pashë Biçakçiun, fakt ky që dëshmon për karakterin e mirëfilltë patriotik të kësaj lëvizje, patriotizëm ky i pohuar edhe nga publicistja e njohur angleze, Edith Durham, e cila në librin e saj “Brenga e Ballkanit” shkruan se në qytet “patriotizmi qëndronte mbi të gjitha doktrinat fetare”. Në luftën për çështjen kombëtare shqiptarët ortodoksë nuk kishin munguar të dalloheshin, por pjesëmarrja e tyre ishte realizuar kryesisht nga bashkësitë e diasporës, të Rumanisë, Bullgarisë, Egjiptit, Shteteve të Bashkuara, ku greqizimi i ndërmarrë nga Fanari dhe i fuqizuar pastaj nga Athina nuk kishte ndikuar kaq thellë sa në vend, ose ishte vënë me dashje në pikëpyetje falë fitimit ndërgjegjes së vet kombëtare shqiptare.<sup>58</sup> Ngritja që përjetoi Lëvizja Kombëtare në vend në fillim të shekullit XX, u shoqërua si me zgjerimin e veprimtarisë së shqiptarëve në mërgim që kishin krijuar mjaft shoqëri atdhetare, të cilat u shndërruan në qendra të përhapjes së ideve të çlirimit kombëtar, ashtu edhe në formimin e çetave të armatosura që do të shërbenin jo vetëm si formacione lufte, por edhe si njësi të propagandës kombëtare. “Për të çelur udhën e qytetërisë - bëhej thirrje në faqet e “Kalendarit Kombiar”, organ i kolonisë shqiptare në Sofje - duhet t’i lemë mënjane gjithë kombet dhe ta kërkojmë në mest të flakës në vendin t’ënë...koha u shtrenjtua shumë për ne...për të kuptuar të drejtat tona në vendin tënë, të parën herë duhet të marrim në dorë armën e fortë e cila është dituriya e tu qepemi shkronjave shqip...pa t’u rrimë kundrejt edhe dhelpënravet të huaja me kraharor hapur e me pushkë në dorë...”<sup>59</sup> Në nëntor të v.1905, në Manastir, u krijua me nismën dhe nën drejtimin e Bajo Topullit, një komitet i fshehtë shqiptar me emrin “Për lirinë e Shqipërisë” që kishte marrë përsipër të kryente veprimtari edhe të natyrës politike,<sup>60</sup> i cili vendosi lidhje me 8 vetë në Elbasan<sup>61</sup> që u bënë propaganduesit e idesë së luftës së armatosur kundër zgjedhës osmane. Ndonëse Lef Nosi ishte shquar tashmë si një aktivist i çështjes kombëtare mungesa e të dhënave nuk na lejon të hedhim më tepër dritë lidhur me kontaktet që ai pati me këtë komitet të fshehtë.

Ndërsa Fanari grek shton presionin mbi bashkësinë e shqiptarëve ortodoksë për t’i përthithur ata brenda sferës së kulturës greke, Lef Nosi do ta shohë zgjidhjen e çështjes kombëtare të lidhur ngushtë me problemin e gjuhës. “Shenja e kombësisë është gjuha – shkruante Sami Frashëri- e çdo komb mbahet nga

<sup>57</sup> Gjini, Roland. *Unitizmi*, Elbasani- Enciklopedi, fq. 604

<sup>58</sup> Rocco, Roberto. *Vepër e cituar*, fq. 48

<sup>59</sup> “Kalendar kombiar”, Sofje, Mot` i Nëntë, 1905, *Ç’bën Mëmëdheu?*, fq. 108

<sup>60</sup> *Historia e popullit shqiptar*, Vëll. II, TOENA, Tiranë, 2002, fq. 319

<sup>61</sup> Myzyri, Hysni. *Shkolla Normale e Elbasanit*, Tiranë, 2004, fq. 191

gjuhët.”<sup>62</sup> Në këto kushte L. Nosi vazhdon t’i kushtojë një vëmendje të veçantë problemeve të gjuhës dhe të shkollës shqipe, zgjidhjen e të cilave i shikonte si leva të rëndësishme të ngritjes së nivelit të ndërgjegjes kombëtare, të përparimit të shqiptarëve dhe të bashkimit të tyre politik.

Mirëpo përballë kushteve të rënda të zhvillimit të lëvizjes arsimore në vend, kur Porta e Lartë kishte urdhëruar mbylljen e shkollave dhe asgjesimin e librave shqip, kurse Patrikana greke dënonte të gjithë ata që merreshin me “gjuhën e mallkuar”, shqipen, patriotët shqiptarë, ndër të cilët edhe Lef Nosi, u shtënguan të ikin nga Shqipëria e të vendosen në dhe të huaj ku të punonin në liri të plotë për kombësi. “Kështu fara e nacionalizmit shqiptar e hedhur në Sofje, Kajro, Londër e Boston mbinte pak nga pak, por me siguri.”<sup>63</sup> Gjithnjë në shërbim të çështjes shqiptare, arsimit e kulturës kombëtare, Lef Nosi në vitin 1906 ndërmerr një udhëtim, fillimisht drejt Londrës ku qëndroi vetëm pak kohë, gjatë të cilave bëri edhe një vizitë mjeksore për sytë,<sup>64</sup> dhe më pas nis për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ku vendoset në Filadelfia për të vazhduar luftën që kishte nisur me rrethet e atjeshme patriotike. Meqënëse SHBA-të ishin vendi ku Liria kishte gjetur kulmin e saj, ortodoksët shqiptarë që shkonin në atë vend, duke parë se popullsia të ndryshme që jetonin atje merreshin me kulturë e me çështjet e tyre kombëtare, kjo atmosferë filloi t’u ndriçojë mendjen dhe nisën të formohen grupe nacionalistësh që merreshin me çështje shqiptare.<sup>65</sup>

Shoqëritë atdhetare të mërgimit luftuan jo vetëm kundër zgjedhës osmane, por edhe kundër politikës asimiluese e përçarëse që Patrikana ndiqte ndaj shqiptarëve jo vetëm në Shqipëri por edhe në kolonitë e tyre jashtë vendit. Të ndodhur larg ndikimit të Patrikanës dhe të ndikuar nga fryma armiqësore që kishte mbjellë helenizmi grek kundër shqiptarëve, nacionalistët shqiptarë në Amerikë filluan të punojnë edhe më fort me gjuhën shqipe dhe shqiptarët. Njëkohësisht një masë e rëndësishme për të përballuar ndikimin e Patrikanës ishte edhe krijimi i një kishe kombëtare proçes ky i vlerësuar edhe nga studiuesja Nathalie Clayer, për të cilën “Çështja e fesë dhe ajo e krijimit të kombit mbeten të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën”.<sup>66</sup> Kjo kërkesë, e shtruar që në fundin e shekullit XIX e që u shndërrua në domosdoshmëri në fillimin e shek. XX, është e lidhur ngushtë me emrin e Fan S. Nolit. “Shqiptarët e Amerikës na kanë nderuar...- do të shkruhej në faqet e gazetës “Drita” në qershor të 1906-ës- ...shoqërirat janë filluar të ngrihen atje duke patur ndër ment të ndihnin të ngjallet mëmëdheu. Dëgjojmë se duan të bëjnë një kishë shqiptare ku do të bëhet i tërë shërbimi i kishës në gjuhë shqipe. Bravo ju qoftë burra trima! Tregoni botës dhe grekomanëve fanatik se Perëndia kupton shqip dhe se ka folur shqip përpara se të flas greqisht...”<sup>67</sup> Shqiptarët ortodoksë të mërgimit ishin të bindur se për t’i çliruar bashkëbesimtarët e tyre nga ndikimi grek dhe për t’iu kthyer atyre ndërgjegjen kombëtare duhej një Kishë ortodokse shqiptare e pavarur, afirmimi i të

<sup>62</sup> *Historia e popullit shqiptar*, Vëll. II, TOENA, Tiranë, 2002, fq. 342

<sup>63</sup> Selenica, Teki. *Shqipëria në 1927*, Tiranë, 1928, fq. 18

<sup>64</sup> AQSH, F. 32, D. 55/2, f. 31

<sup>65</sup> Frashëri, Mehdi, *Probleme shqiptare*, Tiranë, 2001, fq. 54

<sup>66</sup> Clayer, Nathalie. *Historia e shqiptarëve*, “Feja, krijimi i kombit dhe shoqëria”, Tiranë, 2012, fq. 122

<sup>67</sup> “Drita”, Sofje, nr. 79, 1 qershor 1906, f. 2

cilës, i kuptuar si pajtim dhe aleancë ndërmjet fesë dhe atdheut, ishte një akt i realizuar më parë apo ishte vënë në diskutim edhe në vende të tjera ballkanike në luftën e tyre për liri. “Padyshim në Shqipëri ekzistonte një gjendje e veçantë- do të vlerësojë në studimin e tij, Roberto Marocco della Rocca, tek “Kombësia dhe feja në Shqipëri”, - pasi ortodoksia nuk ishte feja e shumicës dhe për pasojë nuk mund të ishte një faktor vendimtar uniteti dhe identiteti kombëtar si në Greqi, Bullgari apo Rumani, por një Kishë ortodokse shqiptare autonome do të bënte që lëvizja për pavarësinë e vendit të shënonte një hap përpara.”<sup>68</sup>

Mirëpo ndërsa patriotët shqiptarë të Amerikës hidhnin hapa të rëndësishëm për ngritjen e kishës shqiptare, bandat greke, me veprimtarinë e tyre në krahinat jugore shqiptare, përpiqeshin që me anë të terrorit dhe të propagandës të largonin popullin nga lëvizja kombëtare e të përndiqnin këdo që punonte për përhapjen e shkrimit dhe mësimin të gjuhës shqipe. Madje histeria e klerit grek dhe përgjithësisht e grekëve arrin deri aty sa t’u thonë shqiptarëve që merreshin me gjuhën shqipe – jo shqiptarë, por – të shqiptarizuar (allvanistë).<sup>69</sup> Është ky shqetësimi që përshkon letërkëmbimet e dendura mes Lef Nosit e Aleksandër Xhuvanit gjatë viteve 1906- 1907, por edhe më pas. “Më vjen keq - shkruante A. Xhuvani në letrën dërguar L. Nosit në korrik të 1906-ës nga Athina – se kudo që vete, nuk mundem aspak me e ndjek mësimin e gjuhës tonë nga shkaqe që të gjithë e dimë. Dhe më fort më vjen keq tani që u hap çështja për themelimin e gjuhës sonë...”<sup>70</sup> Pasi del hapur kundër propagandës antishqiptare të shtypit grek që përpiquej të errësonte luftën e shqiptarëve për çlirim kombëtar dhe pa shpresë se do të mund të vazhdonte studimet në Fakultetin e Filologjisë në Athinë, në gusht të 1906-ës, A. Xhuvani largohet nga Greqia në drejtim të brigjeve të Italisë Jugore (Napoli), dhe prej andej mendon të niset drejt Amerikës. “Unë dhaskalëkun grek e mendoj me tmerr- shkruan përsëri A. Xhuvani- pasi s’do mundem me punu aspak për Shqipëri. Sa për Amerikën, ajo aty është nëse më gjen Lefi ndonjë punë”.<sup>71</sup> Mirëpo edhe në Amerikë veprimtarët shqiptarë ishin përballur me qëndrimet penguese të qarqeve greke të atjeshme të cilat i shqetësonte fakti që shqiptarët ortodoksë të Amerikës, që ata i konsideronin grekë të Epirit, jo vetëm që ndjeheshin etnikisht dhe kombëtarisht shqiptarë, por qëndronin edhe në radhët e para të lëvizjes për të drejtat kombëtare të popullit shqiptar. Rrethet nacionaliste të diasporës greke përdorën të gjitha mënyrat për të neutralizuar veprimtarinë e lëvizjes patriotike shqiptare në SHBA.<sup>72</sup> Ndërsa përpjekjet për bashkimin e shoqërive shqiptare në Amerikë, në një shoqëri të vetme, nuk patën sukses, duke i lënë ato të ndara nga njëra-tjetra dhe të pafuqishme, L. Nosi largohet nga SHBA dhe vendoset përsëri në Londër për të projektuar, disa muaj më vonë sëbashku me F. Konicën, edhe formimin e, sikurse u quajt në emërtimin origjinal në gjuhën angleze,<sup>73</sup> të një partie të shqiptarëve në mërgim e cila, sikurse do ta trajtojmë edhe më poshtë, ishte vazhdim i

<sup>68</sup> Rocco, Roberto. Vepër e cituar, fq. 48

<sup>69</sup> Frashëri, Mehdi. *Probleme shqiptare*, Tiranë, 2001, fq. 54

<sup>70</sup> AME, F. 20, D. 10, nr. 33, f. 2-3

<sup>71</sup> Po aty

<sup>72</sup> Duka, Valentina. *Çështje të historisë bashkëkohore*, Tiranë, 2003, fq. 35

<sup>73</sup> “The National Albanian Party”, F. 32, D. 6

përpjekjeve të shqiptarëve të diasporës për të krijuar shoqëri e klube të shqiptarëve në mërgim që synonin të propagandonin e të kërkonin të drejtat e kombit të tyre përmes mbështetjes së qytetërimit perëndimor. Një gjë të tillë e dëshmon edhe fakti se kjo shoqëri u projektua të ngrihej në tokën e një prej Fuqive të Mëdha - Anglisë, tek e cila synohej të sigurohej “aleati i madh” ndërkombëtar i çështjes shqiptare.<sup>74</sup> “Nga ana ime – do të shkruante në këtë kohë Faik Konica në faqet e gazetës “Albania” – Z. L. Nosi, i cili është një nga të parat shtëpi të krishtera t’Elbasanit, ka punuar shumë për Shqipërinë, për të cilën pati nderin të vuaj një a dy vjet si i burgosur politik. Kombi shqiptar pret shumë nga z. L. Nosi”.<sup>75</sup> Gjatë kohës së qëndrimit të tij në Londër, bashkë me Faik Konicën, ai kishte nisur punën për krijimin e një qendre të lëvizjes sonë kombëtare jashtë Shqipërisë.<sup>76</sup>

Në kushtet e intensifikimit të veprimtarisë shkombëtarizuese të Patrikanës Ikumenike, Lef Nosi nga Londra do të kthehet në Shqipëri për të mbështetur Lëvizjen Kombëtare në vend. Nëpërmjet shtypit të kohës patriotët shqiptarë kundërshtuan përpjekjet e qendrave të huaja klerikale për të përçarë shqiptarët sipas besimeve fetare, veprimtari e cila kishte gjetur përkrahës edhe në rradhët e klerikëve të lartë, interesat ekonomike e shpirtërore të të cilëve i kishin lidhur ngushtë me Patrikanën greke të Stambollit. Presioni i kishës ortodokse ishte bërë tepër shqetësues dhe rëndonte kryesisht mbi popullsinë shqiptare ortodokse që kishte qenë edhe objektivi kryesor i politikës helenizuese.

Me pseudonimin Mal’i Vashës, veprimtari ortodoks, Lef Nosi, do të shfrytëzojë faqet e gazetës “Drita”, *“të parës gazetë që doli me qëllim që t’i shërbej kombit e që ka përhapur mendimet kombiare”*,<sup>77</sup> për të demaskuar qëndrimin e priftërinjve grekë dhe instrumentave të tyre politiko-fetarë të klerit vendas, kundër gjuhës dhe kombësisë shqiptare. Në faqet e historisë sonë janë shënuar përpjekjet që personalitete të ndryshme të kombit shqiptar kanë bërë për shqiptarizimin e besimeve të tyre. Në radhët e tyre ishte rreshtuar edhe L. Nosi për të cilin këto përpjekje, për njohjen e shkrimeve të shenjta dhe për të meshuarit në kishë në gjuhën e vet kombit, kishin për qëllim jo vetëm që shqiptarët, sikurse edhe kombe të tjerë ortodokse, të njohin e të kuptojnë në shqip çdo lajm të mirë të ungjillit, por për më tepër synonin ndërgjegjësimin e shqiptarëve mbi identitetin kombëtar të tyre. “Darkën e ujit të bekumun- do të shkruante L. Nosi në shkrimin “*Letër nga Elbasani*” – na e mbini kryepriifti i ri, Janni, nga an` e Durrësit. Si gjithë uratat e Fanarit desh ene ky të shfaqë shpejt atë djallëzinë që kanë kundër gjuhës e kombësisë shqiptare”.<sup>78</sup> Zëri i L. Nosit ishte zëri i kundërshtimit të të gjithë ortodoksëve të Elbasanit që vazhdonin t’u shkeleshin të drejtat e tyre. “Në mëngjest kur po bekonte ujtë në kishë, një nga kantorët, z. Mine Bibaja, pasi u tha kaqi herë në greqisht desh ta thotë edhe një herë në shqip, si asht zakon e thuhet për vite...Veç kur përnjiherë

<sup>74</sup> AQSH, F. 32, D. 6

<sup>75</sup> Gazeta “Albania”, Vit i II, 1907, fq. 111

<sup>76</sup> Kjo përpjekje do të marrë jetë me themelimin e shoqërisë “Ana Kombëtare e Shqipërisë” në vjeshtë të 1907-ës.

<sup>77</sup> “Kalendari kombiar”, Sofje, 1907, fq. 4

<sup>78</sup> “Drita”, Sofje, 26 shkurt 1907, *Letër nga Elbasani*, nr. 88, f. 2



urata me za të naltë e me zemërim bërtet..ene meqenë se kështu qi ndodhi erdh policia me ushtar aty... Të gjithë u ndezën por s'ish kohja për të fol e për të ba gja".<sup>79</sup> E shqetësuar nga kryengritjet popullore, ndonëse me karakter lokal, si edhe nga veprimtaria e çetave të armatosura, të cilat gjatë viteve 1905- 1908 kishin marrë një karakter më të organizuar, qeveria turke kishte gjetur zgjidhje tek përdorimi i forcës. "Qeveria zuri të përndjek shqiptarët; po harron që shqiptarët kanë dalë për të luftuar kundër grekëve e kundër shqehëve...që janë armiqt e Shqipërisë si dhe të Tyrqisë."<sup>80</sup> - do të shkruhej në atë kohë në faqet e "Kalendarit kombiar", organ i shqiptarëve të Sofjes. Në një situatë të tillë edhe protesta e besimtarëve ortodoks elbasanas do të ishte vënë menjëherë përballë përdorimit të dhunës qeveritare. Ndaj banorët, sikurse na e bën të ditur Lef Nosi në shkrimin e lartpërmendur, pakënaqësinë e tyre e shprehën në një tjetër formë. Në këtë kohë, si kleri i lartë ashtu edhe kleri famulltar në Shqipëri, merrnin një taksë nga popullsia ortodokse ku ushtronin detyrën fetare. Kjo taksë mbante emrin "epihorisis" dhe për të ishte në dijeni edhe qeveria e cila, kur ishte nevoja, ndihmonte me xhandarmarinë e saj për mbledhjen e kësaj takse.<sup>81</sup> Në këto kushte revolta e besimtarëve elbasanas u shpreh në formën e mosbindjes ekonomike. "Nga shkakut i kësaj pune të ligë qi bani- vazhdonte letren Mal'i Vashës- e cila asht majt me gojë gjithë atë ditë ndër të krishterët e këtushëm, disa shtëpija s'deshën me ia dhanë të hollat që i paguajmë vit për vit dhe ia thanë sheshit priftënavet që hiqte prapa se kto të holla s'ia japim se ky përveç që qenka anmiku i gjuhës sonë, po qenka ene i fesë së krishtit, fjalët e porosiat e të cilit nuk le qi tu dëftohen të krishtenvet në gjuhën e vet që ti kuptojnë e ti mbajnë në ment".<sup>82</sup> Që shqiptarët të drejtën e përdorimit të gjuhës së tyre në kishë e kishin fituar në luftë të vazhdueshme me Fanarin grek u theksua edhe atë ditë kur një nga banorët vendas i tregon kryepriiftit të ri të Durrësit fotografinë e mitropolitit grek të Korçës, Fotit, "të cilin e vranë shqiptarët se ndiqte gjuhën shqipe – si shenjtëria jote sot në kishë". Kjo kishte qenë gjuha me të cilën shqiptarët iu ishin përgjigjur përpjekjeve shkombëtarizuese- helenizuese të kishës greke. "Qofshin për jetë ata shqiptarët e vërtetë - do të përfundojë shkrimin e tij Lef Nosi - që i dëftejnë sheshit me punë dashuninë e tyre me gjuhën sikurse e dëftyen sot këta t'Elbasanit".<sup>83</sup>

Tashmë lufta për shkrimin dhe gjuhën shqipe mbështetej nga veprimtaria e forcave të armatosura shqiptare. Që prej pranverës së vitit 1906, e më pas gjatë 1907-ës, kishte filluar dalja në mal e çetave të para të armatosura, të cilat vepronin vazhdimisht përreth Elbasanit, veçanërisht në zonën e Shpatit, sikurse ishte çeta e Jonuz Topuzit, Ymer Dervishit, Sadik Zharrit etj. Fillimisht, veprimtaria e tyre më së shumti, konsistonte në mbrojtjen e banorëve të zonës nga dhuna dhe persekutimet e ushtruara nga administrata turke për mbledhjen e taksave, marrjen e nizamëve dhe për konvertimin e popullsisë së kësaj krahine në fenë

<sup>79</sup> Po aty

<sup>80</sup> "Kalendar kombiar", Sofje, 1907, fq. 24

<sup>81</sup> Frashëri, Mehdi. *Probleme shqiptare*, Tiranë, 2001, fq. 88

<sup>82</sup> "Drita", Sofje, 26 shkurt 1907, *Letër nga Elbasani*, nr. 88, f. 2

<sup>83</sup> Po aty



islame. Jo në pak raste edhe çeta e krijuar nga Bajo Topulli kishte shkelur nëpër zonat e Shpatit dhe të Bërzeshtës.<sup>84</sup> Formimi i tyre dhe fillimi i luftës së organizuar u përkrahën dhe u propaganduan në mënyrë të veçantë nga organet e shtypit atdhetar shqiptar siç ishte gazeta “Drita” e Sofjes e cila u shndërrua në organ të komitetit “Për lirinë e Shqipërisë”. Luftëtarë të pushkës e të penës dhe pjesëmarrës të çetave të udhëhequra nga Bajo e Çerçiz Topulli, Mihal Grameno etj, shfrytëzuan faqet e kësaj gazete për të bërë propagandë kombëtare e për të bindur njerëzit se “duhet të bëhen gati që të dalin edhe me kraharor hapët të luftojnë me qeverinë duke kërkuar arsimimin e tyre me anën e gjuhës së vendit...”<sup>85</sup>.

Në këtë moment të ngritjes së lëvizjes sonë kombëtare Lef Nosi do të gjendet në vijën e parë të përpjekjeve për të forcuar ndërgjegjen kombëtare dhe për të bashkuar popullin shqiptar kundër politikës së regjimit osman dhe veprimtarisë antishqiptare të fqinjëve ballkanikë. “Sot qi anmiqt na kan vumun armët e tyne në krahanurt – bën thirrje Lef Nosi në faqet e gazetës “Drita” në maj të 1907-ës – e s’ka metun gja tjetër ma veç se me tjeq kamzën qi të na marrin edhe shpirtin! Sot për neve o vllazën, asht kohja e shtrenjtë qi duhet gjithë të bashkumun e me flamurin e shenjtë ndër duer, të përpiqemi për atë çështjen, për atë gjallënimin e vetvetes t’onë...Sot pra asht kohja qi duhet të squhemi nga gjumi qi flemë në kamë, e tuke hapun sytë, me tmerr të madh, ta shofim plumin e armëvet t’anmikut, të cilat janë mështetë në krahanurt t’onë... e pret vetëm një të hekun gisht e ta shpojn tejprtej zemrën t’onë”.<sup>86</sup>

Është koha kur populli i Elbasanit në maj të vitit 1907, i pakënaqur nga administrata osmane dëboi mytesarifin dhe komandantin e xhandarmarisë. Revolta u shtri e përfshiu edhe popullsinë e zonave përreth. E shqetësuar nga këto ngjarje dhe nga lajmi se kryengritësit kërkonin pavarësinë, qeveria osmane dërgoi në Elbasan katër batalione të komanduara nga Shemsi Pasha, të cilat shtypën me forcë lëvizjen kryengritëse në këtë sanxhak.<sup>87</sup>

Ngjarjet e vitit 1907, ndryshe nga sa pritej nga autoritetet qeveritare, nxitën një ngritje të re në ndërgjegjen nacionaliste të elbasanasve. Në këtë kohë Lef Nosi do të shfrytëzojë përsëri faqet e gazetës “Drita” në të cilën, në maj të vitit 1907, do të botojë shkrimin “*Letër nga Elbasani*” ku ai iu drejtohej bashkëatdhetarëve të tij me thirrjen për të luftuar në mbrojtje të të drejtave kombëtare jo vetëm përballë presionit të administratës osmane por edhe kundër lakmive pushtuese të shteteve fqinje, në veçanti të bandave greke, të cilat në kushtet e krizës së brendshme të sistemit osman, tentonin të rifitonin terren në krahinat jugore shqiptare. “Për pak ditë malet e fshatrat e Toskërisë kan me u mushun me gjaksorë, me anmiq të ndytë po themi, me grekë – do të shkruante L. Nosi me pseudonimin Mal’i Vashës – të cilët do jenë të porositun të vrasin fëmij, gra, pleq, njerës të pafajshëm, do djegin, do pjekin, do prishin, do shkretojnë e do përmbysin vetëm që ti shtijnë drithmën njerëzisë që ta mohojnë atdhenë e gjuhën e vet, e të

<sup>84</sup> Peza, Majlinda. *Zhvillimet politiko-arsimore në trevën e Elbasanit në vitet 1878-1914*, Doktoratë, Tiranë, 2014, fq. 33

<sup>85</sup> “Drita”, Sofje, nr. 82, dt. 2 gusht 1906, f. 2

<sup>86</sup> Po aty, nr. 89, dt. 18 maj 1907, f. 1

<sup>87</sup> *Historia e Shqipërisë II*, Tiranë, 1984, fq. 365

mos e quajnë ma Shqipënin e Poshtme – Toskëni, por t’a quajnë Ipiros. Fjalë qi ene ajo vetë asht shqip sikur se asht thanë ene përdoret deri sot në gjithë Shqipëni... nga dibranët, në Elbasan e Toskëni”.<sup>88</sup> Në Athinë, në kohën kur vazhdonte studimet, L. Nosi ishte njohur thelbësisht me tendencat e qarqeve politike e fetare greke për të ndryshuar, qoftë edhe me dhunë, konfiguracionin etnik të viseve të Shqipërisë Jugore duke sjellë edhe të ashtuquajturit “argumenta shkencore” që provonin se ato vise, në të kaluarën e lashtë, kanë qenë banuar nga grekët në një territor të quajtur Epiri i Veriut. Shqiptari ortodoks nga Elbasani, nuk mund të pajtohej me të tilla argumenta që po përdoreshin gjithnjë e më shpesh në faqet e shtypit grek, sidomos pas vitit 1905. Ndaj në kushtet kur Porta e Lartë vazhdon politikën e mohimit të kombësisë shqiptare, e kur fqinjët ballkanikë presin veç çastin “që t’mëshijnë emnin Shqiptar prej faqes së gjindjevet t’botës”<sup>89</sup> Lef Nosi, pa marrë parasysh pasojat, ndonëse dy herë ishte burgosur për shkaqe politike, u bën thirrje të gjithë shqiptarëve: “Andaj pra, o vllazën, kudo qi janë shqiptarë të zgjumun nga gjumi duhet të përpiqen me sa fuqi kanë për të sqmun me të shpejtë ene vëllazënit e tjerë qi flenë gjumin e padijes; të ngrifen shoqëri të raja, të forcohen ato qi janë e të lidhen njena me tjetrën qi kështu në pak kohë komiteti i shqiptarëve të dali në fushët të kombevet t’lirë, si një djalë i ri e i vërtetshëm, që si trembet e si stepet as nonji rreziku. Atëherë ene Bajo Topulli me shokë të panumërt e të bamun gati për vdekje kan me i ardh rreth e rreth kufivet t’Shqipnisë si shqiponja me fletë e me flamurin e shenjtë të lirisë ndër duer, qi të shtëmanget çdo anmik”.<sup>90</sup> Këto thirrje të botuara në shtypin shqiptar të kohës janë dëshmi e ngritjes së mendimit politik të Lef Nosit, i cili në mënyrë të qartë shpreh idenë se çështja kryesore për zgjidhjen e problemit kombëtar e për çlirimin e tokave shqiptare, ishte bashkimi i të gjithë shqiptarëve në një lëvizje të organizuar.

E shqetësuar nga veprimtaria e komitetit të Manastirit dhe e çetave shqiptare, qeveria turke u vu menjëherë në ndjekje të tyre. “Qeverija zuri të rrëfejë një pabesi kundër shqiptarvet- shkruhej në faqet e “Kalendarit kombiar”- mjaft shqiptarë të pafajshëm u dënuan, u dërguan në vende të largëta, ca u burgosën...ajo jep leje për Shqehët dhe Grekëvet që të punojnë, që të vin’ në vendin tënë dhe të na prishin gjuhënë dhe kombësinë, po shqiptarëvet u ka lidhur duartë...”.<sup>91</sup> U morën masa të rrepta kundër anëtarëve e përkrahësve të Komitetit, madje, në fillim të 1907-ës, u shpallën në gazetën zyrtare të vilajetit të Manastirit emrat e atdhetarëve që duhej të dorëzoheshin e të arrestoheshin sa më parë.<sup>92</sup> Në kushtet e rritjes së presionit të brendshëm qeveritar, Lef Nosi merr rrugën drejt Anglisë për të vazhduar aty punën që kishte nisur disa muaj më parë bashkë me patriotë të tjerë të lëvizjes kombëtare.

<sup>88</sup> “Drita”, Sofje, nr. 89, dt. 18 maj 1907, “Letër nga Elbasani” nga Mal’i Vashës

<sup>89</sup> Po aty

<sup>90</sup> Po aty

<sup>91</sup> “Kalendarit kombiar”, Sofje, 1908, *Ngjarjet e motit 1907*, fq. 22

<sup>92</sup> *Historia e popullit shqiptar*, Vëll. II, TOENA, 2002, fq. 322

Këto ndjekje e vështirësuan por nuk e ndërprenë as veprimtarinë e Komitetit e as atë të çetave shqiptare. Madje politika antishqiptare e qarqeve qeveritare nxiti tek Lef Nosi e luftëtarëve të tjerë të çështjes kombëtare, që në vjeshtë të 1907-ës, idenë për shkëputje nga Perandoria Osmane.

## **I.2 Shoqëria e shqiptarëve të Londrës “ Ana Kombëtare e Shqipërisë”**

Me rritjen e presionit qeveritar udhëheqësit e Komitetit të Manastirit u shtrënguan ta shpërngulin qendrën e vet në Bukuresht, ndërsa shumë veprimtarë e përkrahës të tij u detyruan të largoheshin nga atdheu e të bashkoheshin me shoqëritë shqiptare në mërgim. Prej andej u morën masa për sigurimin e ndihmave financiare për luftën e armatosur të çetave në Shqipëri madje u organizuan edhe mitingje proteste (SHBA) kundër terrorit qeveritar dhe dhunës së bandave greke.<sup>93</sup> Tashmë në rradhët e veprimtarëve të Lëvizjes Kombëtare, mes të cilëve edhe Lef Nosi, ishte forcuar bindja se Perandoria Osmane, që vuante pasojat e lëvizjeve çlirimtare dhe ndërhyrjeve të Fuqive të Mëdha, nuk mund t’u siguronte shqiptarëve asnjë të drejtë kombëtare, “Tyrqija ishte bërë një me armiqtë tanë për të prishur Shqipërinë”,<sup>94</sup> - do të shkruhej në faqet e “Kalendarit kombiar”, ndaj për shumë shqiptarë rrugëzgjidhja filloi të shihej tek shkëputja e plotë dhe e menjëhershme nga kjo Perandori, vepër e cila nuk mund të kryhej pa një qendër të përbashkët të bashkërendimit të veprimtarisë së shqiptarëve dhe as pa aleatë në rradhët e shteteve të fuqishme që edhe më parë kishin marrë në dorë fatin e popujve të Ballkanit.

Ndërsa ndiqte me vëmendje zhvillimin e ngjarjeve në Shqipëri nga diaspora, ku ai punonte në fillim të 1907-ës bashkë me veprimtarë të tjerë të shoqërive patriotike, Lef Nosi mbështet idenë që qarkullonte shpesh në faqet e shtypit shqiptar të Amerikës “...për të krijuar një parti – siç shkruante gazeta “Kombi”, - në një prej kryeqyteteve evropiane për të siguruar përkrahjen e nevojshme”<sup>95</sup> pa të cilën ai kishte bindjen se veprimtaria e çetave të armatosura në vend nuk do të mund të shndërrohej në një lëvizje të organizuar mirë dhe pa përkrahjen e Fuqive të Mëdha evropiane nuk do të mund të sillte rezultatet e dëshiruara për fatet e kombit shqiptar.

Mjaft interes paraqesin pikëpamjet politike të Lef Nosit lidhur me marrëdhëniet që shqiptarët duhet të vendosnin me Fuqitë e Mëdha. Përkrahjen e “miqve të huaj me randësi”- siç i quante L. Nosi, ai i shihte si një faktor i rëndësishëm jo vetëm ndaj politikës antishqiptare që vazhdonte të ndiqte Porta e Lartë, por edhe kundër lakmive që fqinjët ballkanikë kishin ndaj tokave shqiptare. “E para gjë e vënë re prej të huajve që thellojnë çështjen shqiptare dhe lëvizjen kombtare t’onë- shkruante Lef Nosi në 1907-ën – është se ne i kemi

---

<sup>93</sup> Duka, Valentina. *Çështje të historisë bashkëkohore...*, Tiranë, 2003, fq.33-37

<sup>94</sup> “Kalendar kombiar”, 1908, fq. 23

<sup>95</sup> Duka, Valentina. *Çështje të historisë bashkëkohore...*, Tiranë, 2003, fq. 37

punët politike pa themel e pa të lidhur. Dhe mjerisht ashtu është me të vërtetë. Ne s'kemi as program e as të parë (leader) të zgjedhur që ta vërë në punë atë program e të na përfaqësojë në sy të botës".<sup>96</sup> Kjo ishte një kërkesë që edhe më parë, që prej fillimit të shek. XX, Faik Konica e kishte propaganduar me forcë përmes shkrimeve në revistën "Albania" ku ndër të tjera ai shkruante: "...Atdhetarëve shqiptarë u mungon bashkimi në vijë të punës kombëtare: shkurt, s'kanë një besni kombëtare (politique nationale)".<sup>97</sup> Këto pikëpamje na bëjnë të mundur të kuptojmë edhe qëllimin e lëvizjeve të kryera nga Lef Nosi përgjatë viteve 1906-1907 nga Anglia në Amerikë dhe anasjelltas në kërkim të bashkëpunimit me shqiptarët e tjerë të Londrës dhe ato të Amerikës në fushën e bashkimit kombëtar e për të siguruar aleatë të çështjes shqiptare në qarqet e diplomacisë ndërkombëtare. Një prej burimeve që na ndihmon të hedhim dritë mbi këtë bashkëpunim dhe planet e hartuara prej tyre, janë letërkëmbimet e Konicës me L. Nosin dhe veprimtarë të tjerë të çështjes kombëtare. Midis tyre është një letër e Konicës drejtuar At. St. Gjeçovit në Shkodër, në janar të vitit 1907, ku ndër të tjera ai shkruante: "Nja dy muaj më parë shkuan këtej disa shqipëtarë m'udhë për n'Amerikë. Një nër ta ish një elbasanas .... që sot ndodhet në Londër prej disa javësh".<sup>98</sup> Mungesën e informacionit, në këtë letër, rreth emrit të elbasanasit e plotëson një tjetër shkrim i Konicës në gazetën "Albania" ku ndër të tjera ai shkruante: "...Lef Nosi ka qenë tani shpejt n'Amerikë, duke shkuar edhe në të vajtur edhe në të ardhur nga Londoni, ku ndenji mjaft kohë. Ishim bashkë tërë ditën dhe munda t'i çmoj hollësinë e mendjes dhe drejtësinë e zemrës".<sup>99</sup> Këto biseda mes tyre, për organizimin e lëvizjes kombëtare, i konfirmon edhe letra e sipërpërmendur. "...Ishim bashkë tërë ditën, edhe folmë gjerë e gjatë për organizimin e nevojshëm të forcave të çkatërruara të Kombit. Mendimet e mia i pëlqeu (elbasanasi) pa përmbajtje (restriksion), edhe mu lut që t'i shtie në të shkruara... Janë dy kartëra, njëra programa, tjetra një "ekspoze" në formë letre... Atdhetari elbasanas i mori më të shumtën kartëra n'Amerikë ku nisi një propagandë të shëndoshë që t'i bëjë të pëlqyera".<sup>100</sup> Ndërsa të dy veprimtarët e lëvizjes kombëtare bashkoheshin rreth idesë se Shqipëria gjendej në rrethana tepër të veçanta për të pasur mundësinë e zhvillimit pa një mbështetje të jashtme, kushte të cilat u impononin atdhetarëve shqiptarë të rrisnin përpjekjet për të siguruar përkrahjen e ndonjë shteti të shëndoshë e të madh që do t'i mbështeste në rrugën e përparimit të kombit, ecuria e pikëpamjeve të tyre mbi aleatin e mundshëm të çështjes shqiptare kishte gjetur pikëtakimin vetëm në vitin 1906. Fillimisht F. Konica, nisur nga përkrahja e politikës austriake për çështjen shqiptare, e në veçanti ndaj zhvillimit të kulturës dhe gjuhës shqipe, ishte i bindur se: "...nëse Shqipëria duhej të zgjidhte një krah, për shumë arsye, krahu më i volitshëm duhej ai i Austrisë".<sup>101</sup> Mirëpo këtë mendim ai do ta braktisë teksa vë re se "situata e

<sup>96</sup> AQSH, F. 32, D. 6, f. 1

<sup>97</sup> Jorgaqi, Nasho. *Faik Konica*, Vepra 3, Tiranë, 2001, fq. 61, artikull i "Albanias"-s, viti 1900.

<sup>98</sup> Po aty, vepra 4, fq. 159

<sup>99</sup> Gazeta "Albania", Vit i II, 1907, fq. 111

<sup>100</sup> Jorgaqi, Nasho. *Faik Konica*, vepra 4, fq. 159

<sup>101</sup> Po aty, fq. 141, letër e Konicës drejtuar një funksionari të lartë, dt. 23 korrik 1904

Shqipërisë njëhej në mënyrë shumë të pamjaftueshme në Vjenë”,<sup>102</sup> dhe fillon të shpresojë tek ndihma britanike për çlirimin e gjithë Shqipërisë.<sup>103</sup> Është koha kur edhe Lef Nosi, që kishte jetuar gjatë gjithë kësaj periudhe në Shqipëri dhe ishte njohur me interesat e huaja, veçanërisht ato italo-austriake që përplaseshin në vend, pas udhëtimit që kishte bërë vitin e fundit (1906) drejt Amerikës ishte njohur jo vetëm me përpjekjet e shumta të emigrantëve shqiptarë për të ngritur shoqëri e klube patriotike por edhe me ndikimin e elementëve grek të atjeshëm në veprimtarinë e këtyre shoqërive. Në lidhje me këtë fakt na jep të dhëna edhe studiuesja e njohur V. Duka e cila vë në dukje se: “...në punën e tyre patriotike, veprimtarët shqiptarë edhe në Amerikë, ballafaqoheshin me qëndrimet penguese të elementëve grekomanë. Themelimi i shoqërive të para shqiptare si edhe propaganda e tyre pro çështjes shqiptare, nuk shikohej me sy të mirë prej disa qarqeve greke të atjeshme...”.<sup>104</sup>

Duke kërkuar ta gjejë aleatin e çështjes kombëtare tek një shtet i madh, L. Nosi mendonte se ky vend ishte Anglia. “Në Angli – theksonte ai- do të mundim të gjejmë ndihmën morale dhe landësore që na duhet”.<sup>105</sup> Përzgjedhja e Anglisë ka të ngjarë të lidhet edhe me idenë që kishte nisur të qarkullonte në gjirin e diasporës shqiptare të Amerikës, në fillim të vitit 1907, për bashkimin e të gjitha shoqërive shqiptare *...me një program dhe me një qëllim*,<sup>106</sup> ide e cila, sikurse pohon edhe studiuesja e çështjeve historike të diasporës shqiptare të Amerikës, Prof. Asoc. Valentina Duka, mbeti vetëm në letër.<sup>107</sup>

I kthyer nga SHBA, ku mes shqiptarëve që jetonin atje kishte dëgjuar të flitej shpesh për domosdoshmërinë e krijimit, në një prej kryeqyteteve të Evropës, të një partie e cila do të propagandonte programin politik të shqiptarëve në botë, çka do t’u siguronte edhe mbështetjen ndërkombëtare, në 4 tetor 1907, L. Nosi do të bëhet një ndër propaganduesit e programit të një tjetër shoqërie, të “Anës Kombëtare të Shqipërisë” (“The National Albanian Party”) me qendër në Londër, qytet që për veprimtarin elbasanas me orientim properëndimor, i cili gjatë viteve të studimeve të tij në Athinë ishte njohur me rolin që kishte luajtur Britania e Madhe në luftën për pavarësi të Greqisë e të popujve të tjerë të Ballkanit, ishte “vendi më i mirë nga pikëpamja politike”.<sup>108</sup>

Sikurse për shumë veprimtarë atdhetarë të diasporës shqiptare, edhe për L. Nosit ishte e fortë bindja se fillimi i luftës së armatosur pa përkrahjen e Fuqive të Mëdha evropiane nuk do të sillte fitoren e të drejtave të kombit shqiptar. Një qëndrim i tillë lidhej edhe me faktin se koha kishte treguar se ndërsa rendi osman në gadishull ishte dobësuar vazhdimisht, Fuqitë e Mëdha kishin fituar më tepër kontroll në jetët e popujve të Ballkanit. E paafte për të mbrojtur e vetme vehten, Perandoria Osmane kishte qenë e shtrënguar

<sup>102</sup> Po aty, fq. 142

<sup>103</sup> Po aty, fq. 180

<sup>104</sup> Duka, Valentina, vepër e cituar, fq. 35

<sup>105</sup> AQSH, F. 32, D. 6, f. 1

<sup>106</sup> V. Duka, vepër e cituar, fq. 31

<sup>107</sup> Po aty, fq. 32

<sup>108</sup> AQSH, F. 32, D. 6, f. 4

t'i bënte Evropës lëshime të njëpasnjëshme.<sup>109</sup> Ndërhyrjet e Fuqive në grindjet mes Portës dhe subjekteve të saj, tregonin se, në fund, të gjithë kufijtë ballkanikë do të përcaktoheshin nga traktatet ndërkombëtare. Fati i shteteve të vogla do të varej nga pazaret e bëra në emër të tyre nga Fuqitë e Mëdha. Përballë situatave të tilla shqiptarët duhet të zgjidhnin me kujdes dhe maturi aleatët e tyre ndërkombëtar. Në funksion të këtij qëllimi ishte zgjedhja e kryeqendrës së shoqërisë “Ana Kombëtare”. “Vende që nga liria e nga paanësia, bien pas këtij kërkimi- theksonte Lef Nosi- janë Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës”.<sup>110</sup> Por SHBA-të ishin tepër larg, kurse Britania e Madhe jo vetëm që ishte më afër Shqipërisë, por për Lef Nosit kishte “...më të madhen randësi politike. Në Angli u gatua liri e grekëve, bullgarëve e shumë viseve të tjera; është ajo që drejton mendjen e botës- opinionin publik- të kombeve të qytetëruara. Pra Londra – përfundon gjykimin e tij L. Nosi rreth aleatëve të mundshëm e më të favorshëm të lëvizjes kombëtare, - duket vendi më i mirë për politikën tonë.”<sup>111</sup>

Historia e një shekulli më parë (XIX), kishte treguar se ishte Londra ajo që kishte tërhequr diplomacinë evropiane në tavolinën e diskutimeve për krijimin e një shteti autonom grek e madje më vonë ishte ajo që vendosi që Greqia duhej të ishte një mbretëri e pavarur nën garancinë e tre Fuqive të Mëdha (Anglisë, Francës e Rusisë) ku, që në fillim, u duk qartë se nga tre protektorët, Britania e Madhe ishte ajo që mbizotëronte.<sup>112</sup>

Lufta që Lef Nosi, bashkë me shqiptarët e tjerë të diasporës kishte nisur, ishte një luftë politike që synonte shkëputjen përfundimtare të Shqipërisë nga Perandoria Osmane e cila tashmë do të drejtohej nga shoqëria “Ana Kombëtare”. Nisur nga burimet që kemi shfrytëzuar mund të gjykojmë se “Ana Kombëtare” ndonëse në emërtimin origjinal u quajt “The National Albanian Party” më shumë se një parti politike ajo përfaqësonte një lëvizje politike e cila prezantonte një platformë që përfaqësonte të gjithë shqiptarët dhe synonte të tërhiqte vëmendjen e Fuqive të Mëdha për çështjen shqiptare. Ndonëse në emërtimin struktural të këtij fondi në arkivat shtetërore (AQSH) është shënuar *Organizata “Ana Kombëtare”*,<sup>113</sup> në përmbajtjen e statutit të saj nuk e gjejmë të jetë përdorur një i tillë përcaktim nga vetë themeluesit e saj. Ky fakt na bëhet i njohur edhe përmes analizës së dokumentit final të “Anës Kombëtare” i cili në asnjë rresht të tij nuk përmend terminologjinë “parti” apo “organizatë” politike por qëllimi i tij ishte: “*Të shfaqurit e qëllimit t’one quhet **program** dhe njerzit e lidhur bashkë për të zbatuar një program quhet një **anë**.*”<sup>114</sup> Pra “Ana Kombëtare” nuk ishte gjë tjetër veçse një “Program Kombëtar”. Madje edhe hartuesit e këtij dokumenti, F. Konica dhe L. Nosi, kanë nënshkruar si “Pjesëtarë të Parë” të saj që synojnë të fitojnë mbështetjen jo vetëm të shqiptarëve të Londrës por të të gjithë kolonive shqiptare “*duke sprapsur njerëz të njohur si intrigant e*

<sup>109</sup> Jelavich, Charles e Barbara. *Themelimi i shteteve kombëtare të Ballkanit, 1804-1820*, Dituria, 2004, fq. 33

<sup>110</sup> AQSH, F.32, D. 6, f. 4

<sup>111</sup> Po aty

<sup>112</sup> Jelavich, Charles e Barbara. *Themelimi i shteteve kombëtare të Ballkanit, 1804-1820*, Dituria, 2004, fq. 47

<sup>113</sup> AQSH, F. 102 “Koleksion i shoqërive dhe klubeve shqiptare”, D. 13 “Organizata Ana Kombëtare e Shqipërisë”, v. 1908.

<sup>114</sup> AQSH, F.32, D. 6, f. 1



*punë-prishës*”.<sup>115</sup> Mirëpo nisur nga konteksi i kohës kur po zhvillohen këto përpjekje si edhe nga analiza e organizimit të këtij programi kombëtar duket se ai është një tjetër hap në vazhden e përpjekjeve të shqiptarëve për të krijuar shoqëri e klube që luftojnë jo vetëm për të drejtat kombëtare por edhe për shkëputjen përfundimtare të shqiptarëve nga Perandoria Turke dhe organizimin e tyre sipas modeleve perëndimore. Në mbështetje të këtij arsyetimi vjen edhe një tjetër dokument i ruajtur në arkivat shtetërore, në fondin e lartpërmendur,<sup>116</sup> me emërtimin “Degë e Anës Kombëtare”, që daton në fund të qershorit të v. 1911, në programin 27- pikësh të së cilës është përdorur vazhdimisht termi *Shoqëria Ana Kombëtare*.<sup>117</sup> Nisur nga këto të dhëna jemi të mendimit se Ana Kombëtare e Londrës ishte një tjetër përpjekje e shqiptarëve të diasporës për të krijuar shoqëri patriotike që synonin bashkimin e shqiptarëve rreth çështjes kombëtare dhe drejtimin e kësaj lufte politike në një prej vendeve demokratike të perëndimit.

Dokument themelor i kësaj shoqërie, një prej drejtuesve të së cilës ishte edhe L. Nosi, njihet si “Programi, organizimi dhe politika e Anës Kombëtare të Shqipërisë” dhe është i hartuar në 24 pika të ndara në katër pjesë kryesore: 1- Programi i pasqyruar në 5 pika, 2- Organizimi në 10 pika, 3- Politika në 3 çështje themelore, 4- dhe pjesa e fundit ishte Disiplina në 6 pika.<sup>118</sup> Në përmbajtjen e këtij programi gjejmë pasqyrim, mjaft qartë e në mënyrë konkrete, idetë politike të Lef Nosit për ngritjen e shtetit të ri shqiptar mbi bazën e vlerave të qytetërimit perëndimor. Ky program parashikonte që:

- Shqipëria të bëhej një mbretëri më vete. Kjo pikë e programit, sikurse bëhet e ditur në letrën që njofton themelimin e kësaj shoqërie, ishte hartuar: “...pas mësimit që u dha tani shpejt prej Norvejes<sup>119</sup> (Norvegjisë- E. A) e cila ndonëse republikane e gjeti me udhë të bëhet Mbretëri dhe të zgjedh për mbret një princ i cili, i lidhur nga gjaku me më të shkëlqyera dymbretërore të Evropës, të jetë i zoti t’i sjell dobi vendit”.<sup>120</sup> Duke analizuar këtë pikë të parë të programit del se L. Nosi, F. Konica e të tjerë shqiptarë të mbledhur në Londër, emrat e të cilëve nuk na bëhen të njohur në këtë dokument, kishin ideuar, në vitin 1907, krijimin e një mbretërie shqiptare të drejtuar nga një mbret të zgjedhur nga Evropa, mbretëri e cila u ngrit vetëm pas vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1913) që zgjodhi princ V. Vidin në krye të shtetit monarkik shqiptar (1914).
- Në mbretërinë shqiptare të përfshiheshin të katër vilajetet shqiptare të Janinës, Kosovës, Manastirit dhe Shkodrës. Pra kjo mbretëri do të shtrihej në ato territore ku shqiptarët përbënin shumicën e popullsisë.

<sup>115</sup> Po aty, f. 4

<sup>116</sup> AQSH, F. 102, D. 13 “Degë e Anës Kombëtare”, 23 qershor 1911.

<sup>117</sup> Po aty, f. 1-8

<sup>118</sup> AQSH, F.32, D. 6, f. 1-4

<sup>119</sup> Në vitin 1905 në Norvegji, pas dy referendumeve u vendos së pari shpërbërja e unionit me Suedinë, dhe së dyti shteti i ri i Norvegjisë u shpall monarki e drejtuar nga princi danez Karl i cili mori emrin mbretëror norvegjez Haakon VII. Familja mbretërore norvegjeze i përkiste shtëpisë pricërore të Gjermanisë veriore. Wikipedia: Historia e Norvegjisë.

<sup>120</sup> AQSH, F.32, D. 6, f. 1-4



- Sllavëve e gregëve që mbeteshin brenda kufirit të mbretërisë shqiptare do mund t'u shpërblehej toka nëse donin të iknin, ose, me anë të një komisioni të veçantë të bëhej shkëmbimi i tokës dhe i pasurisë me shqiptarët e mbetur përtej kufirit e që donin të zinin vend në mbretërinë shqiptare.
- Të gjithë subjektet e mbretërisë që s'ishin shqiptarë nga gjaku do të gëzonin të drejta të barabarta me shqiptarët; do t'u sigurohej liria e pasuria.
- Mbretëria shqiptare do të ruante paanshmërinë në fushën e fesë; çdo feje do i sigurohej liria sipas kanuneve.

Parimi themelor i “Anës Kombëtare” do të ishte “besa, burrëria, drejtësia e njerëzia”. Kryefjala e kësaj shoqërie do të ishte “Energji pa shtazëri”<sup>121</sup> e cila ishte shprehje e angazhimit të anëtarëve të kësaj shoqërie në lëvizjen për ndërkombëtarizimin e çështjes së të drejtave politike të kombit shqiptar përmes sigurimit të përkrahjes së Fuqive të Mëdha evropiane.

Lef Nosi u zgjodh pjesëtar i Parë i Anës Kombëtare të Shqipërisë bashkë me Faik Konitzën e Michele Prakën dhe sikurse përcaktohet qartë në pikën e parë të kapitullit mbi Politikën: “I Pari, secili nga tre anëtarët që u zgjodhën Pjesëtarë të Parë, do të ketë tre detyra:

- a- të përhapunit të programit të Anës Kombëtare
- b- të lidh miqësi me anët politike të huaja
- c- të mbajë disiplinë (urdhër dhe paqe) në mes të pjesëtarëve të Anës”.<sup>122</sup> Duke qenë një prej pjesëtarëve të parë të kësaj shoqërie, L. Nosi mori përsipër të bëjë të ditur qëllimin e Anës Kombëtare dhe synimet e programit të saj, jo vetëm për të siguruar ndihmën e shteteve të huaja për Shqipërinë, por edhe për të kundërshtuar “gojë të liga” që flisnin për përçarje e qëndrim të ftohtë të shumë atdhetarëve shqiptarë të dalë në Evropë në lidhje me çështjen kombëtare. “*Këta shqiptarë duhet ta dinë se kur të kërkojmë ndihmën e një vendi të huaj*”, - u drejtohet të gjithë shqiptarëve Lef Nosi- “*duhet t'u tregojmë se çfarë apo kush na udhëheq e cili është programi ynë. E pasi njohin programin tonë, do na ndihmojnë jo se jemi komb i vjetër, trim e i ndershëm, por se kërkojmë gjëra të arsyeshme e të drejta.*

*Programi s'është i nevojshëm vetëm për të huajt, por sidomos për shqiptarët që duan të dinë ku po i shpiem.*

*Nëse doni të më bëni të punoj për ju, duhet të më thoni ç'qëllim keni.*

*Nuk arrini të kërkonin ndihmën time në emër të bashkimit, por duhet të më tregoni themelet mbi të cilat më thërrisni ta trajtojmë bashkimin tonë. Këtë e bën programi, që është themeli i çdo bashkimi...”.<sup>123</sup>*

<sup>121</sup> Po aty

<sup>122</sup> Po aty

<sup>123</sup> Po aty

Gjithnjë me vështirimin drejt perëndimit, Lef Nosi e shikonte të ardhmen e shtetit shqiptar në formën monarkiste të qeverisjes: *“Është fat të besojmë se Evropa monarkiste do të na lejojë, në u çliroftim, të jemi mbretëri me një princ nga dyert mbretërore të Evropës për mbret. – do të shkruante L. Nosi në thirrjen e lartpërmendur. - Edhe sikur të duam të jemi ndryshe e të zgjedhim një princ jashtë këtyre dyerve (s’ka shqiptar me ment të kërkojë Selanikun), s’na dëgjojnë Fuqitë e Mëdha. Ndaj është mirë që gjithë burrat me mendje të pjekur ta kuptojnë këtë e mos largohen nga realiteti me ëndërrime të kota”*.<sup>124</sup> Për Lef Nosit, një princ i zgjedhur nga familjet e shteteve të përparuara të Perëndimit, përbënte një element kyç në përpjekjet për ngritjen e shtetit shqiptar.

Por ndërkohë Lef Nosi, sikurse edhe një pjesë e rretheve patriotike shqiptare në mërgim, nuk ishte në favor të përpjekjeve të ndërmarra nga I. Qemali për të fituar përkrahjen e Greqisë për çështjen shqiptare. Ndonëse qëllimi i marrëveshjes që bëri I. Qemali me palën greke, në shkurt të vitit 1907, ishte “mbrojtja kundër agresionit të ardhshëm të bullgarëve dhe racave (kombeve) të tjera sllave,<sup>125</sup> në logjikën e qëndrimit politik të Lef Nosit, Greqia nuk mund të shihej si aleati më i favorshëm për Shqipërinë në kushtet e rritjes së rrezikut sllav. Marrëdhëniet shumëshekullore të fqinjësisë mes dy popujve nuk karakterizoheshin vetëm me shfaqje simpatie për njëri-tjetrin. Goditjet e bandave greke në viset jugore të vendit kishin qenë po aq të dhunshme sa edhe sulmet e ushtrisë sllave ndaj shqiptarëve të krahinave veriore e verilindore. Madje përballë kërkesave e rezistencës së shqiptarëve, ortodoksia sllavo- greke kishte gjetur gjuhën e përbashkët, atë të përdorimit të forcës kundër shqiptarëve.

Në këto rrethana, përmes propagandimit të programit të shoqërisë “Ana Kombëtare”, Lef Nosi vë theksin në krijimin e një Shqipërie të bashkuar e të fortë ku edhe pakicat kombëtare të jenë të lira e të barabarta me shqiptarët. *“Artikujt 3 e 4 – shkruante ai - u sigurojnë mendjen e pakicave të racave të tjera që ndodhen në Shqipëri dhe që qahen te bota e qytetëruar se raca shqiptare do ti mundojë, në u çliroftë. Ndërsa artikulli 5 u siguron paqen e lirinë atyre që janë të nxehtë pas fesë”*.<sup>126</sup>

Ndonëse programi i kësaj shoqërie kishte kërkesa të ngjashme me 5 pikat e “Shpalljes” së firmosur nga I. Qemali, që kishin të bënin konkretisht me krijimin e “një atdheu shqiptar të lirë dhe të pavarur...ku ishte vendosur liria fetare e bashkëpunimi i gjithë popujve bashkëjetues...”,<sup>127</sup> ajo që i ndante ishte rruga që ato synonin të ndiqnin për realizimin e programeve të tyre. Ndërsa I. Qemali shpresonte tek bashkëpunimi me Greqinë për të siguruar “drejtësi e barazi për popujt e Lindjes”,<sup>128</sup> shoqëria “Ana Kombëtare” dhe L. Nosi kërkonin, që me mbështetjen e Perëndimit, të realizonin krijimin e Mbretërisë Shqiptare me monark evropian.

<sup>124</sup> Po aty

<sup>125</sup> Naska, Kaliopi. *Ismail Qemali...*, Tiranë, 1987, fq. 51

<sup>126</sup> AQSH, F. 32, D. 6, f. 3

<sup>127</sup> Naska, Kaliopi. *I. Qemali...*, Tiranë, 1987, fq. 52

<sup>128</sup> Po aty

Për orientimin perëndimor të veprimtarëve dhe drejtuesve të kësaj shoqërie flet mjaft qartë edhe mënyra e organizimit dhe e hartimit të politikës së saj “...të cilat nuk kanë nevojë të mbrohen- do të shkruante Lef Nosi- *sepse rrjedhin prej programit dhe do të kuptohen prej të gjithë atyre që dinë se si janë ndërtuar anët politike në vise të qytetëruara*”.<sup>129</sup> Duke qëndruar në vijën e parë të veprimtarëve të lëvizjes kombëtare, L. Nosi ishte bërë një nga protagonistët kryesorë të lëvizjes politike e kulturore të fillimshekullit XX, që synonte çlirimin e vendit nga sundimi i huaj dhe zhvillimin e tij sipas modeleve të përparuara perëndimore.

Ndërkohë përmes analizës së pjesës së dytë, të modelit të organizimit të kësaj shoqërie, vihet në dukje se një prej synimeve kryesore të saj ishte krijimi i degëve dhe shtrirja e saj kudo ku ndodheshin shqiptarë. Veprimtarët të cilët do të dëshironin të anëtarësoheshin në radhët e saj duhet të betoheshin se do t'i shërbenin “Anës Kombëtare” me besë (besnikëri-E.A). Vitin e parë të anëtarësimit, sikurse bëhet e ditur në kapitullin mbi organizimin e kësaj shoqërie,<sup>130</sup> pjesëtarët duhet të paguanin një shumë prej 20 frangash, ndërsa në vitet në vijim shuma reduktohej në 10 franga në vit. Pjestarët e çdo Qendre duhet të zgjidhnin me shumicë votash (gjysëm+1) (50%+1) një kryetar, i cili mund të emërojë një ose më shumë sekretarë të tij, sipas nevojës, dhe tre këshilltarë, me mandat 6 vjeçar dhe të drejtë rizgjedhjeje, të cilët jo vetëm do të ndihmonin kryetarin por edhe do të kontrollonin mbledhjen e pagesave. Në mbarim të mandatit ata mund të zgjidheshin përsëri por nuk do të paguheshin, as ata dhe as sekretarët e emëruar prej tyre. Krerët e secilës degë do të mblidheshin e do të zgjidhnin me  $\frac{3}{4}$  e votave, për 3 vjet, një të Parë dhe tre kryekëshilltarë si edhe do të përcaktonin vendin më të mirë nga pikëpamja politike për të vendosur kryeqendrën e të Parit dhe kryekëshilltarëve. Pagesat e të gjithë degëve do të dërgoheshin në kryeqendër dhe do të përdreshin prej të Parit sipas kanuneve (Rregullores-E.A) të miratuara nga të gjithë anëtarët. I Pari dhe kryekëshilltarët do të paguheshin, por në mbledhjet që do të zhvilloheshin çdo tre vjet ata duhet të paraqisnin shumën e pagesave. I Pari, me njohjen dhe pranimin e tre Kryekëshilltarëve, do të paguante sekretarët, detyrimet e faturat, do të shpërndanin ndihma, do të jepnin shpërblime për punët e kryera, por i gjithë dokumentacioni, i postës dhe i bankave, do të mbahej, do të ruhej e do t'u jepej pasardhësve në kryesinë e shoqërisë “Ana Kombëtare”. Ndërkohë, në fund të çdo viti, do të bëhej bilanci i të ardhurave dhe shpenzimeve, një kopje e të cilit do t'i dërgohej çdo kryetari dege. Ndonëse ishte detyrë e të Parit të propagandonte programin e shoqërisë dhe të lidhte miqësi me vende të tjera, duhej që ai, sapo të hynte në bisedime dhe në marrëveshje me të huaj, të mos luante as nga fjalët e programit dhe as nga kuptimi i saj. Të paktën një herë në tre muaj ai do t'u dërgonte krerëve një letër ku u bëhej e njohur “shteti i punëve”.<sup>131</sup> Gjithashtu ai ishte edhe arbitri që

<sup>129</sup> AQSH, F. 32, D. 6, f. 2

<sup>130</sup> Po aty

<sup>131</sup> Po aty, f. 3. Kapitulli mbi Politikën, pika 18.

siguronte ruajtjen e disiplinës mes pjesëtarëve të “Anës Kombëtare”, detyra të cilat ai i realizonte me anë të tre departamenteve të veçanta.

Në program, në kapitullin mbi Disiplinën, janë përcaktuar edhe mënyrat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Në rast konflikti mes të Parit dhe kryekëshillëtarëve, i Pari ka për detyrë të thërrasë një komision prej 7 vetash, të zgjedhur prej krerëve, që gjykojnë me shumësi fuqiptotë prej 4 votash, vendim i cili është përfundimtar dhe fajtori duhej të tërhiqej ose të largohet nga “qeveria” (kryesia- E.A) e kësaj shoqërie. Në rast konflikti mes anëtarëve të shoqërisë së Anës Kombëtare të Shqipërisë, i Pari zgjedh një Gjyq të Nderit prej 7 vetash, i cili, me tërësinë e votave, dënon fajtorin. I Pari mund të thyejë gjykimin e parë, ndërsa gjykimi i dytë i Gjyqit të Nderit është përfundimtar. Në rregulloren e shoqërisë ishte theksuar se ishte në të mirë të mbarëvajtës së punëve, por edhe për arsye ekonomike, që krerët të mos e kundërshtonin të Parin, “veçse kur është ndonjë nevojë vërtetë e rëndë”. Kjo mund të ndodhte në mbledhjet e trevjeshme, ku i Pari që tërhiqej paraqiste një përmbledhje të punës së bërë në krye të kësaj shoqërie.<sup>132</sup>

Ky model organizimi, që mund të ndryshohej vetëm me pëlqimin e tërësisë së krerëve, ishte forma e qeverisjes që L. Nosi dhe themeluesit e tjerë të shoqërie kishin marrë përsipër t’u bënë të njohur jo vetëm shqiptarëve, por edhe botës së qytetëruar në rradhët e së cilës ata kërkonin të siguronin miqtë e çështjes shqiptare. Ndërsa ky program u pëlqye dhe u miratua prej disa shqiptarëve të mbledhur në Londër,<sup>133</sup> themeluesit e “Anës Kombëtare” nisën punën për të propaganduar qëllimet e përmbajtjen e tij tek të gjitha rrethet shqiptare. “*Ju lutem ato (programin dhe rregullimet) t’i këndonit me kujdes dhe në i pëlqefshi, t’i përhapni për miq tuaj duke më dërguar listën e anëtarëve që bëtë... me shpresën se do ti jipni punës të gjithë rëndësinë që meriton*”.<sup>134</sup> Mungesa e burimeve të mëtijshme nuk na lejon të njohim më tej listën e anëtarëve që pranuan këtë program dhe aktivitetin e mëtijshëm që ajo ushtroi, por nga ana tjetër ky fakt nuk bëhet pengesë për ta përcaktuar këtë përpjekje dhe njerëzit që e propaganduan atë si projektuesit e parë të shpëputjes përfundimtare nga Perandoria Osmane dhe ngritjes së një shteti të pavarur shqiptar, 5 vjet përpara se këto projekte të bëheshin realitet.

Ndërkohë duke iu referuar burimeve arkivore rezulton se kjo shoqëri nuk u mjaftua vetëm me propagandimin e qëllimeve dhe organizimit të saj, por u bënë edhe përpjekje për krijimin e degëve të “Anës Kombëtare”, përpjekje të cilat u ndikuan edhe nga ndryshimet politike që ndodhën në Perandorinë Osmane gjatë vitit 1908 e më pas. Një fakt të tillë e dëshmon edhe dokumenti, pa autor, i nxjerrë nga fondi i klubeve e shoqërive patriotike, me nënshkrimin “Degë e Anës Kombëtare të Shqiptarëve”<sup>135</sup> në të cilin vazhdon të ruhet qëllimi dhe organizimi i “Anës Kombëtare” me qendër në Londër, i vitit 1907, por programi i saj i

<sup>132</sup> AQSH, F. 32, D. 6, f. 3-4

<sup>133</sup> Po aty, f. 4

<sup>134</sup> Po aty

<sup>135</sup> AQSH, F. 102, D. 13

është përshtatur ndryshimeve politike të periudhës së shpalljes së kushtetutës së vitit 1908, e reflektuar kjo në katër kërkimet e kësaj dege të cilat, më konkretisht, janë:

1. Katër vilajetet e sotme të Kosovës, Janinës, Shkodrës e Manastirit të njihen Shqipënië por me gjuhë zyrtare shqipen e turqënishten. Pra Shqipënia të mos ndahet nga Perandoria Ottomane e flamuri i saj.
2. Sundimi i këtyre katër vilajeteve të bahet prej nënpunsish shqiptarë po të drejtë e të paanshëm dhe arësimi të bahet me anë të gjuhës shqipe.
3. Pagesat që do të mblidhen në Shqipënië të prishen për sundimin, arësimin, zhvillimin ekonomik të sajë dhe për çdo gjë tjetër që është nevojë për përparim e vëndit.
4. Shërbimi ushtarak i shqiptarëve të bahet në Shqipënië edhe kufijtë e sajë në kohë paqeje të ruhen gjithmonë prej ushtarësh e oficerësh shqiptarë. Vetëm në kohë lufte me shtete të huaja të jenë të detyrumun shqiptarët me shërby ushtarakisht jashtë kufijvet t' Shqipëniës.”<sup>136</sup>

Sikurse konstatohet nga përmbajtja e këtij dokumenti, i datës 23 qershor 1911, programi i degës së shoqërisë “Ana Kombëtare” jo vetëm që iu është përshtatur kërkesave autonomiste të kësaj kohe, por njëkohësisht edhe intesiteti i veprimtarisë së saj ka qenë në përputhje me zhvillimet e lëvizjes kombëtare në tokat shqiptare. Ndërsa në vitin 1907 formimi i një qendre të lëvizjes kombëtare, në kushtet e presionit të Portës së Lartë, rezultonte gati i pamundur brenda kufijve të saj, pas triumfit të revolucionit xhonturk (1908) dhe lirive të shpallura prej tyre u bë e mundur krijimi i një qendre të tillë organizative në Manastir anëtarë të së cilës u bënë shumë njerëz të dëgjuar dhe të shquar si nga radhët e popullsisë myslimane edhe të asaj të krishtere. “Manastiri do të jetë qendër e të gjithë Shqipërisë si edhe për shqiptarët që jetojnë jashtë Shqipërisë. – shkruhej në njoftimin e shoqërisë “Bashkimi”, me nënshkrimin “Shoqëria e shqiptarëve” të Manastirit, i datës 11/24 gusht 1908. - Këtu do të kemi një shtypshkronjë të madhe, do të shtypim një fletore me emrin “Bashkim” e cila do të mbrojë të drejtat tona kundra armiqvet tanë dhe do të lajmërojë gjithë mbrothësitë që do të kemi pas kësaj ndë Shqipëri. Kjo shoqëri u themelua e tillë që secilido atdhetar, si ata që jetojnë jashtë Shqipërisë edhe ata që jetojnë ndë Shqipëri, të mundin, po të duan, të japin ndihmën e tyre”.<sup>137</sup> Ky klub kishte për qëllim “t’i ndihmojë gjuhës shqipe, mësonjëtoreset dhe për të përhapurit e mjeshtëritet ndë Shqipëri”.<sup>138</sup> Që nga ky moment qendra e lëvizjes kombëtare zhvendoset në tokat shqiptare dhe për shoqërinë “Ana Kombëtare” të shqiptarëve të Londrës nuk dëgjojmë të flitet për disa kohë.

<sup>136</sup> AQSH, F. 102, D. 13, f. 1

<sup>137</sup> AQSH, F. 102, D. 97, f. 2

<sup>138</sup> “Lirija”, Selanik, nr. 9, 8 vjesht e I 1908, f. 2

### I.3 Veprimtaria e Lef Nosit për shkollën e gjuhën shqipe pas lirive të shpallura nga xhonturqit (1908)

Përvoja që Lëvizja Kombëtare kishte fituar vitet e fundit, kishte treguar se një nga rrugët për të krijuar kushte të favorshme në luftën për autonominë e Shqipërisë ishte përmbyjsja e regjimit autokratik të sulltanit dhe vendosja e një rendi kushtetues, që të njihte të drejtat kombëtare të popujve të shtypur.<sup>139</sup> Pikërisht kjo kërkesë krijoi pikën e takimit midis lëvizjes kombëtare shqiptare dhe lëvizjes së turqve të rinj gjatë vitit 1908, të cilët përveç parrullave të huazuara nga Revolucioni Francez për “*lirinë, barazinë, vëllazërinë dhe drejtësinë*”, u bënë shqiptarëve edhe premtime të reja ku u linin të kuptonin se “së paku do të trajtoheshin njëllëj si kombet e tjerë të Turqisë evropiane”.<sup>140</sup> Për turqit e rinj tokat shqiptare përbënin pjesën më të rëndësishme që ato mbanin në Evropë, të cilat mund edhe t’i kishin mbetur besnike po të kishin ditur t’i përdornin. Për atdhetarët shqiptarë ishte e qartë se çështja kombëtare nuk gjente zgjidhjen përfundimtare përmes marrjes së pushtetit nga xhonturqit. Synimi ishte të përdorej politika e tyre për sigurimin e të drejtave të kombit shqiptar. Sikurse e treguan edhe ngjarjet e mëvonshme, ndonëse turqit e rinj u larguan shpejt nga programi i tyre, ata nuk u hodhën dot menjëherë në luftë kundër kërkesave kombëtare shqiptare dhe përkohësisht bënë disa lëshime e dhanë disa liri.

Kështu revolucioni xhonturk dhe shpallja e kushtetutës, më 23 korrik 1908, krijuan kushte disi më të favorshme për zhvillimin e lëvizjes shqiptare, sidomos asaj kulturore kombëtare. Ishte koha gjatë së cilës pothuajse të gjitha forcat politike shqiptare u bashkuan me mendimin se lëvizja kombëtare duhej të zhvillohej duke respektuar këtë regjim, duke përfutur prej lirive të shpallura dhe pa shtruar si qëllim të afërt përmbyjsjen e tij me anë të dhunës, me rrugën e kryengritjes së armatosur.

Hyrja në fuqi e kushtetutës së re nxiti një shpërthim të ri të ndjenjave kombëtare shqiptare. Një varg klubesh u ngritën përgjatë territorit shqiptar, nga Follorina në Mitrovicë, dhe në të gjithë Shqipërinë nga Preveza në Shkodër dhe nga Janina në Prizren. Shumë të mërguar nxituan të ktheheshin në tokën e tyre amtare dhe së bashku me ta edhe organizatat nga ku kishin luftuar për të propaganduar idealin kombëtar nga streha e vendeve më liberale.<sup>141</sup>

Edhe në qytetin e Elbasanit, i cili gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare u shndërrua në një qendër të luftës për çlirim kombëtar, dhjetra patriotë të edukuar me ndjenja të forta atdhedashurie filluan të ngrenë klube e shoqëri kulturore, të cilat rritën e forcuan ndjenjën e krenarisë kombëtare dhe vetëdijen politike e manifestuar në ngjarjet politike lokale antiosmane.<sup>142</sup> Ishin këto klube që u shndërruan në shkollë e qendra për mësimin dhe përhapjen e shkrimit shqip. Liritë e siguruar me shpalljen e Hyrjetit nxitën veprimtarinë

<sup>139</sup> *Historisë e Shqipërisë*, Vëll II, Tiranë, 1984, fq. 409

<sup>140</sup> Myzyri, Hysni. *Shkolla Normale...* Tiranë, 2004, fq. 159

<sup>141</sup> Swire, Joseph. *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie*. DITURIA, 2005, fq. 83-84

<sup>142</sup> Kotherja, Hyqmet. *Historiku i Bashkisë së Elbasanit 1912-2002*, Silver, 2003, fq. 18

patriotike të Lef Nosit, i cili në faqet e shtypit të kohës do të vlerësohet menjëherë si “atdhetar i shkëlqyer”.<sup>143</sup>

Gjatë vitit 1908, por edhe në vazhdim, ai do të mbështesë veprimtarinë e anëtarëve të klubit “Bashkimi”, i cili “zhvilloi një aktivitet jashtëzakonisht të madh si në pikëpamje patriotike e politike, ashtu edhe në atë gjuhësore”.<sup>144</sup> Përsa i përket qëndrimit të Lef Nosi ndaj aktivitetit që zhvilloi ky klub i cili, sipas studiuesit elbasanas Hysni Myzyri, daton thuhet në të njëjtën kohë me çeljen e shkollës së parë shqipe në Elbasan, ky qëndrim u shpreh përmes mbështetjes morale e materiale për nismën që anëtarët e klubit “Bashkimi” kishin marrë për të hapur të parën shkollë shqipe në qytet në 2 gusht të 1908-ës. Çelja e kësaj shkolle u prit me mjaft entuziazëm nga L. Nosi i cili, në atë kohë ndodhej në Londër, nga ku, sëbashku me drejtorin e revistës “Albania”, Faik Konicën, do t’u shkruajnë patriotëve elbasanas për të përcjellë kënaqësinë “mbi përpjekjet e bëra për themelimin e shkollave në gjuhët e nanës”.<sup>145</sup> 21 topa u zbrazen për të përgëzuar këtë ngjarje të rëndësishme.<sup>146</sup> Ky gëzim do të pasqyrohet edhe në urimin “*Rroftë Shqipëria*”,<sup>147</sup> fjalë të cilat përmbyllin letrën që L. Nosi dhe F. Konica iu dërgojnë patriotëve elbasanas. Pak ditë më vonë L. Nosi, në 8 shtator 1908, do të dërgojë një shumë prej 60 groshë, si mbështetje ekonomike për këtë klub.<sup>148</sup> Nuk do të kalojë shumë kohë kur Lef Nosi do të bashkohet me radhët e klubit “Bashkimi” të Elbasanit, fakt të cilin e vërteton edhe një material arkivor i formës së një dëftese që klubi “Bashkimi” i lëshon anëtarit të saj, Lef Nosit.<sup>149</sup>

Shkolla e parë shqipe në Elbasan u hap pikërisht në ndërtesën ku më parë ishte shkolla fillore publike turke por ku prej gushtit filloi që mësimi të bëhet në gjuhën shqipe. “Mbasi kjo shkollë nga gëzimi u hap në gusht, - do të shkruante L. Nosi në një korespondencë të tij për gazetën “Lirija”, - pas një mueseji kur zunë të hapen shkollat që mbaheshin prej guvernës ( qeverisë- E.A), zunë të venë dhe djemtë që mësoneshin aty më parë, dhe kështu nga nevoja u bashkuan djemtë duke u mësuar turqisht e shqip bashkë”.<sup>150</sup>

Është fakt se shoqëritë atdhetare, që u krijuan në këtë kohë, edhe pse në statutet e tyre nuk i prezantonin hapur qëllimet e tyre, duke mbajtur lidhje të vazhdueshme me patriotët shqiptarë brenda e jashtë vendit, e shtrinë veprimtarinë edhe në fushën politike në favor të interesave kombëtare të popullit shqiptar. Në rrethanat e krijuara, lufta e tyre u orientua jo vetëm kundër zgjedhës osmane, por edhe kundër politikës asimiluese e përçarëse që Patrikana greke e Stambollit ndiqte ndaj shqiptarëve. Sikurse Porta e Lartë, ashtu edhe Patrikana, nuk e dëshironin zgjimin e kombit shqiptar, pasi atëherë “myslimani shqiptar nuk do të ish më për Turkun por për vendin e vet. Po kështu edhe i krishteri shqiptar do të kuptonte se nuk

<sup>143</sup> “E vërteta”, Pera, Stamboll, 6 mars 1911, nr. 2, f. 1

<sup>144</sup> Çausi, Abedin. “Mësimi i gjuhës shqipe në Elbasan”, në *Kujtime nga lëvizja për çlirim kombëtar*, Tiranë, 1962, fq. 297

<sup>145</sup> AQSH, F. 32, D. 53, f. 1

<sup>146</sup> “Lirija”, Selanik, 4 gusht 1908, fq. 4.

<sup>147</sup> AQSH, F. 32, D. 53, f. 1

<sup>148</sup> AQSH, F. 32, D. 7, f. 1.

<sup>149</sup> AQSH, F. 32, D. 7, f. 3

<sup>150</sup> “Lirija”, Selanik, nr. 28, 7 shkurt 1909, fq. 3



ishite grek dhe do të punonte për atdhen e vet e jo për Grekun”.<sup>151</sup> Kërkesa për krijimin e një kishe ortodokse shqiptare me priftërinj shqiptarë dhe me shërbesat në gjuhën shqipe, u bë në maj të vitit 1907 dhe suktesi i këtyre përpjekjeve u duk vetëm në shkurt të vitit 1908 me dorëzimin e Fan. S. Nolit si prift në një nga kishat e Nju Jorkut. Ndërsa në 22 mars të atij viti u zhvillua liturgjia e parë ortodokse në gjuhën shqipe në Boston.

Kjo ishte një fitore e madhe në luftën që kishin nisur shqiptarët, ndaj Noli “*prift i shqiptarëve të Amerikës*”, siç i nënshkruante ai letrat dërguar veprimtarit elbasanas, Lef Nosit, kërkoi angazhimin patriotik të të gjithë mëmëdhedashësve shqiptarë për fitore të tjera. Në vitin 1908 Noli i shkruan L. Nosit: “Ka dy muaj që një prift shqiptar në Amerikë ka marrë lejen të meshojë shqip ... por prej dy muajsh e këtej meshat bëhen thjesht anglisht ... Edhe ju e të gjithë ortodoksët e Elbasanit mund të mblidheni e t’i dërgoni një letër Patrikanës ku t’i kërkon t’ju dërgojë një dhespot që të dijë shqip dhe t’ju jap leje të meshoni shqip në gjithë kishërat”.<sup>152</sup> Burimet e kohës japin të dhëna se në këtë kohë (v. 1908) në Elbasan ekzistonte një dege e shoqërisë Lidhja Ortodokse me qendër në Korçë e cila përfshinte popullsinë ortodokse të qytetit dhe synonte përmbushjen e disa objektivave kryesore ku ndër më e rëndësishmja do të konsiderohej përpjekja për t’i shkëputur Patriarkanës Greke të drejtën për të zhvilluar ceremonitë fetare në gjuhën shqipe dhe njëkohësisht futjen e mësimi të gjuhës shqipe në shkollat ortodokse të qytetit.<sup>153</sup>

Në 21 shkurt 1909, ortodoksët e Elbasanit u mbledhën në klubin “Bashkimi”, në parinë drejtuese të të cilit bënte pjesë edhe Lef Nosi, dhe pasi lexuan “një letër të Kishës orthodhokse të Shën Gjergjit të Bostonit dhe një letër nga komisioni i kishës në Korçë, zgjodhën një komision për Elbasanin të përbërë nga 12 këshilltarë, që të mirren vesh me komisionet e tjerë të Shqipërisë dhe të kërkojnë nga Patriarkana të drejtat fetare”.<sup>154</sup>

Edhe pse në kushtet e sundimit të huaj e nën presionin e përçarjeve fetare të ushqyera nga Patrikana greke, atdhetarët elbasanas, në kuadër të lëvizjes kombëtare arsimore, nuk i ndërprejnë përpjekjet për të bërë të mundur mësimin e gjuhës shqipe në shkollat e huaja, turke e greke, të qytetit. Madje në dhjetor të vitit 1908 klubi i Elbasanit, për të shmangur pengesat që xhonturqit u nxirrnin përpjekjeve për hapjen e shkollave shqipe, u kishte propozuar të gjithë klubeve shqiptare që t’i përcillnin parlamentit turk dhe deputetëve shqiptarë në të, kërkesën për njohjen zyrtare të kombësisë shqiptare, plotësimi i së cilës do t’u siguronte shqiptarëve të drejtat kombëtare në lëmin e kulturës dhe të arsimit.<sup>155</sup> Nga ana tjetër, bisedat e zhvilluara në mjediset e kishës së kalasë, pas meshës, mbi domosdoshmërinë e futjes së gjuhës shqipe në ritualet fetare, që në kohën kur Lef Nosi kishte qenë fëmijë, kishin kultivuar tek veprimtari i ortodoks, ndjenjën e përkushtimit ndaj çështjes së kulturës shqipe, lëvizje të cilës atdhetarë të tjerë shqiptarë si Dh. Todri, K.

<sup>151</sup> Selenica, Teki. *Shqipëria në 1927*, Tiranë, 1928, fq. 19

<sup>152</sup> AQSH, F. 32, D. 55, f. 3

<sup>153</sup> Swire, Joseph. *Shqipëria...*, DITURIA, 2005, fq. 72.

<sup>154</sup> “Lirija”, Selanik, 1909, 21 shkurt.

<sup>155</sup> *Histori e popullit shqiptar*, Vëll. II, TOENA, 2002, fq. 402

Kristoforidhi, Hysen Ceka etj, ia kishin hedhur themelet. Pas një pune disa vjeçare, Lef Nosi kishte arritur të mbledhte mjaft dokumenta mbi gjuhën dhe shkollat shqipe, sikurse kishte ndër duar, atë kohë, alfabetin e monsinjor Mjedës (1908) apo alfabetin shqip të shoqërisë “Agimi” të Shkodrës,<sup>156</sup> i cili ishte vlerësuar edhe si alfabeti më i përshtatshëm për shkrimin e gjuhës shqipe nga konferenca episkopale e majit të v. 1902, i organizuar me nismën e Vjenës. Mungesa e një alfabeti të përbashkët për shkrimin e gjuhës shqipe konsiderohej si një nga problemet më të rëndësishme të lëvizjes sonë kombëtare në fillim të shek.XX me të cilin ishin të lidhura edhe interesat të huaja politiko-fetare. Këtë e dëshmon edhe pohimi i konsullit austro-hungarez, Kral, i cili do të shkruante: *“Unifikimi i alfabetit është i ngutshëm për arsye kombëtare dhe gjuhësore, është pastaj i nevojshëm edhe nga pikpamja jonë politike dhe, veçanërisht nga ajo e politikës kishtarë, pse pa të do të jetë e vështirë të sigurohet paqja në episkopatin shqiptar dhe zhvillimi i qetë i shkollave tona”*.<sup>157</sup>

E vërteta është se gjuha shqipe në atë kohë po vazhdonte të shkruhej me disa alfabete, praktikë e cila jo vetëm që dëmtonte unitetin kombëtar por edhe e vështirësonte përdorimin e literaturës shqipe të botuar me aq shumë sakrifica. Në kushtet kur Italia e Austro-Hungaria po shtypnin libra shqip për qëllimet e tyre e jo për të inkurajuar çështjen kombëtare shqiptare, duke përdorur secila nga një alfabet të ndryshëm i cili ndryshonte herë pas here, kjo përpjekje e shqiptarëve ishte mjaft e domosdoshme.<sup>158</sup> Rritja e shpejtë e lëvizjes për arsim kombëtar pas shpalljes së kushtetutës turke, çelja e shkollave të reja shqipe të ditës e të natës, përhapja e gjerë e shkrimit dhe leximit shqip shtruan si detyrë emergjente caktimin e një alfabeti të njësuar e të detyrueshëm për të gjithë shqiptarët, detyrë që e mori përsipër ta zgjidh kongresi arsimor që do të mbahet në Manastir më 14 - 22 nëntor 1908. Përcaktimi i vendit, datës dhe programit të Kongresit ishte vendosur nga klubi i Manastirit pa u konsultuar me klube apo shoqëri të tjera shqiptare brenda apo jashtë vendit. Nxitimi me të cilin po organizohej ky kongres nuk u prit pa skepticizëm nga rrethet e ndryshme shqiptarësh. Për këtë problem F. Konica do të shkruajë L. Nosit i cili kishte lënë Londrën dhe kishte marrë rrugën drejt vendlindjes. *“Qirjazi me ca të tjerë botuan te gazetatat që kanë për të mbajtur një “kongres” në Manastir. Thonë: Kush të dojë le të vijë. Do me thënë në qofshin 20 veta si ju (L. Nosi – E. A), të cilët të kenë mejtuar për këtë çështje, fjala e tyre nuk do të ketë nonjë rëndësi fare në u ndodhçin atje 21 hamaj e bujq me mëndje tjetër...Nuk ka këtu njerës të zgjedhur me arësye dhe të ftuar, s’ka një program pune; Kush të dojë le të vijë!”*.<sup>159</sup> Parë në këtë kontekst mendojmë se ardhja e Lef Nosit në Elbasan nuk lidhet shumë me dëshirën për të marrë pjesë në të,<sup>160</sup> edhe pse kjo pjesëmarrje shihej si domosdoshmëri nga disa përfaqësues të lëvizjes kombëtare sikurse ishte A. Xhuvani i cili ende pa mbërritur Lefi në Elbasan do të shkruajë F.

<sup>156</sup> AQSH, F. 32, D. 131, f. 4

<sup>157</sup> Hoxha, D. Ibrahim. *Nëpër udhën e penës shqiptare*, Tiranë: 1986, fq. 198

<sup>158</sup> Durham, Edith. *20 vitet e trazirave të mëdha*, Tiranë, 2001, fq. 221

<sup>159</sup> Faik Konica, Vëll. 4, vepër e cituar, fq. 160-161

<sup>160</sup> Po aty, fq. 162

Konicës në Londër: “...se po të merremi vesh ne të dy, - shkruante F. Konica, - ju dhe unë (L. Nosi e F. Konica – E.A) *çështja e alfabetit do të zgjidhet me një herë.*”<sup>161</sup> Prej mëse një viti këta dy veprimtarë të çështjes kombëtare kishin punuar dhe hartuar programe për bashkimin e gjithë shqiptarëve dhe zhvillimin e tyre të pavarur sipas modeleve perëndimore, por mbajtja e të parit kongres arsimor i gjeti përsëri jo të bashkuar rrethet patriotike shqiptare. “*Shpejtimi i tyre, methudhat e tyre, pa lënë kohë mjaft sa të mbidhen të jashtëm dhe pa u dërguar as thirrjen që të mësojnë se do të bëhet një i tillë “kongres”, - do ti shkruante Konica L. Nosit në letrën e sipërpërmendur, - të gjitha këto faqin sheshit që këta njerës paskan frikë nga bisedimi.*”<sup>162</sup> Sikurse del në pah nga letërkëmbimet mes dy veprimtarëve, kur L. Nosi niset për në Shqipëri ai nuk e kishte biseduar me Konicën dhe as e dinte nëse do të merrte pjesë në kongres. Një fakt të tillë na e pohon edhe një letër, që mendojmë se është shkruar nga L. Nosi, dërguar F. Konicës nga një prej përfaqësuesve të Elbasanit që morën pjesë në Kongresin e Manastirit por që nuk ishte delegat i zgjedhur në të cilën ndër të tjera shkruhej: “Kartat e zotnis tuaj s’më ranë në dorë në kohë, po si vajta në kongres të Manastirit dhe u ktheva prej andej...Përpara se të vete në kongres të pata shkrumun për të pytë në kishit njimend me shku, se po të mos vishit as mendojem tu shku...”<sup>163</sup> Por ndërsa për pjesëmarrjen në kongres dy aktivistët e gjuhës e kulturës kombëtare nuk kishin marrë ndonjë vendim të përbashkët, ajo që kishin diskutuar shpesh mes tyre ishte çështja e shndërrimit të Elbasanit në qendër të të gjithë shqiptarëve. “*Në doni ta bëjmë Elbasanin qendrën e Shqipërisë, siç e folmë njëqind herë, - i shkruante Konica, Nosit, - kuptoni or mik se çështja e alfabetit të xgjidhet n’Elbasan. Një problem kombëtar bisedohet dhe xgjidhet në një qëntër kombëtare.*”<sup>164</sup> Kjo është një tjetër arsye e rëndësishme që e kthen përsëri veprimtarin elbasanas në qytetin e tij të lindjes ku të shumtë ishin ata që prej kohësh kishin punuar në fushën e gjuhës dhe kulturës kombëtare. Këtë mendim duket se Lef Nosi do ta ndajë edhe me anëtarët e klubit “Bashkimi” të Elbasanit, të cilët ndërsa e mirëpritën lajmin për organizimin e kongresit arsimor kombëtar, nuk hezituan ti kërkonin klubit të Manastirit rishikimin e mundësive për mbajtjen e kësaj mbledhje të përgjithshme në qytetin e Elbasanit. Nuk bëhej fjalë për të penguar aksionin e nisur për mbajtjen e këtij kongresi por ishte një përpjekje për ta zhvendosur selinë e punimeve të tij në qendër të tokave shqiptare, në Elbasan. “*Neve s’ngulim kamë që të bahet e tona, - thuhej në letrën e dërguar nga përfaqësuesit e klubit të Elbasanit për organizatorët e kongresit, - sepse as patëm as nuk kemi qëllim, qi të kundërshtohemi, veç deshëm vetëm të shfaqim mendimet e tana.*”<sup>165</sup>

Në 14 nëntor 1908 Kongresi filloi punimet të cilat zgjatën 8 ditë. Në të morën pjesë 32 delegatë me të drejtë vote, që përfaqësonin 26 qytete dhe shoqëri të ndryshme shqiptare brenda e jashtë vendit, dhe 18

<sup>161</sup> Po aty, fq. 160

<sup>162</sup> Po aty, fq. 161

<sup>163</sup> AQSH, F. 13 “Faik Konica”, D. 4, f. 6-7, dt. 5 shëndre 1908, Elbasan

<sup>164</sup> Faik Konica, Vëll. 4, vepër e cituar, fq. 161

<sup>165</sup> AQSH, Fondi 102, Klubi Shqiptar “Bashkimi”, Dos. 5. Elbasan më 12-të vjeshtës së dytë 1908, f. 4

delegatë të tjerë si pjesëmarrës pa të drejtë vote.<sup>166</sup> Klubi “Bashkimi” i Elbasanit vendosi të dërgojë në Manastir zotërinjtë: Taq Anastasin (Budën), Simon Shuteriqin, Kamber Efendi Sejдинin.<sup>167</sup> Ndërkohë si delegatë me të drejtë vote Elbasani, në Manastir, u përfaqësua nga Dh. Buda e S. Shuteriqi.<sup>168</sup> Sikurse rezulton nga disa burime, duket se në këtë kohë edhe Lef Nosi i ka dhënë fund qëndrimit fillestar skeptik ndaj procesit të organizimit, por jo qëllimit të kongresit, dhe vendos të marrë pjesë në punimet e tij, pa të drejtë vote.<sup>169</sup> “*Mjerisht deri sa qeshë pa u nisun karta nga ju skishja marrë dhe dëshirë kisha të njihja disa atdhetarë; ja këtë shkak më shtyni të vete si delegat i klubit të këtushëm bashkë me tre shokë të tjerë.*”<sup>170</sup>

Në kujtimet e tij mbi ngjarjet historike në vend, L. Nosi do të shkruajë: “Gjithë shqiptarët e dinë si ishte puna deri më 1908; me rrugën e re që kish nis Perandoria Otomane u pa e nevojshme të mbledhen përfaqësuesit e kombit për të përcaktuar vijën që duhet ndjekur për të mirën e kombit”.<sup>171</sup> Megjithëse problemi i njehsimit të alfabetit zuri vendin kryesor në punimet e Kongresit, gjatë ditëve të zhvillimit të tij u organizuan edhe mbledhje të fshehta ku u diskutuan çështje me karakter të mirëfilltë politik. “E strehuar nën hijen e *abc*-së, - theksonte Lef Nosi- Kongresi i Manastirit që një shkak për bisedime më të larta dhe këmbëza mbi të cilën u mbështet një nga shtyllat e bashkimit dhe vëllazërimit të shqiptarëve”.<sup>172</sup> Në Kongres u miratua edhe një program kombëtar prej 18 pikash ku vendin kryesor e zinin kërkesat politike për njohjen zyrtare të kombësisë shqiptare dhe të gjuhës shqipe, të cilat do të realizoheshin përmes themelimit të shkollës së pavarur shqipe ose, e thënë ndryshe, duke vendosur gjuhën shqipe si gjuhë mësimi në gjithë shkollat shtetërore turke në Shqipëri. Miratimi i këtij programi politik jo vetëm përmbysi shpresat e xhonturqve për ta kufizuar Kongresin në çështjet e alfabetit, por theksoi edhe karakterin e pavarur që kishte ruajtur Lëvizja Kombëtare në rrugën e realizimit të autonomisë së Shqipërisë. Vendimet e Kongresit përbënin një arritje të rëndësishme jo vetëm në lëmin e arsimit por edhe në fushën politike pasi i dhanë fund kaosit që ishte krijuar në përdorimin e alfabetit dhe u pritën me mjaft entuziazëm kudo në Shqipëri por edhe jashtë saj.

Pas përfundimit të punimeve të Kongresit, një delegacion i klubit shqiptar të Stambollit, i përbërë nga Riza bej Dibra, Abdyl bej Kolonja (Ypi) dhe Haxhi Vildon efendi Dibra, bëri një turne nëpër Shqipëri duke qëndruar për tre ditë në Elbasan. “E 25-ta ditë e vjeshtës së tretë [8 dhjetor 1908], - shkruante Lef Nosi nën pseudonimin Mal’i Vashës, - që një ditë e shëndritçme, një ditë, e cila do të jetë historike dhe e padalme nga mend e vendësvet të qytetit t’Elbasanit”. Delegatëve të klubit të Stambollit iu bë një pritje shumë entuziaste nga popullsia e qytetit. Atë ditë, që në mëngjes “nisi një lëvizje e madhe e një bujë e cila s’ishte pa nonji herë

<sup>166</sup> *Historia e Shqipërisë*, Vëll. II, Tiranë, 1984, fq. 422

<sup>167</sup> AQSH, F. 102, D. 102, f. 10, dt. 19 vjeshtë e II, 1908

<sup>168</sup> Po aty, D. 121, f. 7

<sup>169</sup> AQSH, F. 102, Klubi Shqiptar “Bashkimi” Elbasan, D. 5, letër e datës 19 vjeshtë e II, 1908.

<sup>170</sup> AQSH, F. 13, D. 4, f. 6, dt. 5 shëndre 1908, Elbasan.

<sup>171</sup> AQSH, F. 32, D. 131, f. 4

<sup>172</sup> Po aty

në këtë qytet. Të mëdhenj e të vegjël baheshin gati qi ti dalin përpara delegatëve të klubit të Stambollit, të cilët vishin qi t'na binë bashkimin e shejtë, atë bashkim qi do ngjalli kombin shqiptar e do e kllasi në vallet t'kombevet të fortë e të qytetënumë".<sup>173</sup> Përmes këtij informacioni na rezulton se organizator i kësaj lëvizje që kishte nisur në qytet ishte klubi "Bashkimi" i Elbasanit, në hyrje të godinës së të cilit ishte ngritur flamuri shqiptar e me të cilin u bashkuan të gjithë djemtë e shkollave, mysliman e të krishterë, me flamuj në duar e me kësula të bardha në të cilat shkruhej "Rroftë Lirija". Gjatë pritjes së delegacionit morën pjesë Këshilli Sundues dhe ai Kontrollues me të gjithë anëtarët e vet, dhe një shumicë e panumërt njerëzish të cilëve Abdyl Ypi (Kolonja) u drejtohet me fjalët: "mir se ju gjejmë o djemtë e Shkuminit plak"<sup>174</sup> Vizita e delegacionit e klubit shqiptar të Stambollit në qytet jo vetëm u prit me mjaft entuziazëm nga banorët por sikurse shprehet L. Nosi në këtë shkrim "...i bashkoi vërtetë elbasanasit në një mend e një zemër".<sup>175</sup>

Të mbështetur në vendimet e Kongresit të Manastirit, atdhetarët shqiptarë, në Elbasan e më gjerë, i shtuan përpjekjet për hapjen e shkollave të reja shqipe, përpjekje që ndeshi jo pak vështirësi. Në kushtet kur hapja e shkollave shqipe, nga klubet apo nga vet populli, përballej me shumë kundërshti, u bënë përpjekje që mësimi i gjuhës shqipe të përfshihej në sistemin shtetëror shkollor. Kështu veprimtarët e klubit "Bashkimi" të Elbasanit arritën të mbledhin mjetet e nevojshme financiare për të paguar mësuesit që do të jepnin mësimin e shqipes në shkollat shtetërore. Me gjithë kundërshtimin e valiut të provincës së Manastirit, nga varej Elbasani, me këmbënguljen e atdhetarëve elbasanas, gjuha shqipe filloi të mësohej në shkollat turke të qytetit qysh në vjeshtën e vitit 1908. "Më parë se të marr armët për Shqipërinë – do të shkruante F. Konica në revistën "Albania" – edhe Bajo Topulli kishte qenë profesor te shkollët e guvernës, kurse tani kishte qëllim të hapte një shkollë në Elbasan. Uroj ti vejë qëllimi mbarë që ta bëjmë pak nga pak Elbasanin qendër të kombit...".<sup>176</sup>

Krahas mësimin të gjuhës shqipe në shkollat greke të Elbasanit, ku Lef Nosi punonte si mësues i shqipes, bashkë me Petër Avramin, Simon Shuteriqin dhe zonjat Parashqevi e Athina Cico,<sup>177</sup> në periudhën shtator- tetor 1908, elementët nacionalistë, Lef Nosi e Petër Dodbiba, ngritën në kala një shkollë shqipe nate për të krishterët e kalasë ku jepnin mësim vullnetarisht njerëz me kulturë. Sipas informacionit që përcjell artikulli i botuar nga Simon Shuteriqi në gazetën "Lirija",<sup>178</sup> numri i nxënësve në këtë shkollë ishte diku mbi 40 nxënës, shifër që erdhi vazhdimisht duke u rritur, dhe në të jepnin mësim Lef Nosi, Fot Papajani dhe Josif Haxhmima i cili, në janar të v. 1909, do të kalojë të japë mësim bashkë me Fetah Cekën në shkollën e natës që u hap në klubin "Bashkimi" të Elbasanit.<sup>179</sup> Pas kësaj lëvizje në shkollën e natës së të krishterëve të

<sup>173</sup> "Lirija", Selanik, 1908, nr. 20, 13 dhjetor. f. 3

<sup>174</sup> Po aty

<sup>175</sup> Po aty

<sup>176</sup> Revista "Albania", Bruksel, vit i 11, 1907, fq. 111

<sup>177</sup> *Normalja në fokus të bashkëkohësisë*, Silver, 1999, fq. 48

<sup>178</sup> "Lirija", Selanik, 1909, 3 janar, f. 2

<sup>179</sup> Po aty, 7 shkurt 1909, f. 3

Kalasë mësues të gjuhës shqipe ishin vetë L. Nosi bashkë me F. Papajanin, Dhimitër Delianën e Matthe Papajanin.<sup>180</sup> Lajmi për çeljen e kësaj shkolle nate pasqyrohet në artikullin e botuar në gazetën “Lirija” të Selanikut nga Rrasë e Bardhë (pseudonimi i Josif Haxhimimës), ku ndër të tjera thuhej: *“Me gëzim ju lajmërojmë prapëse të krishterët e këtushëm hapnë një mësonjëtoare nate ene mësimet po epen rregullisht”*.<sup>181</sup> Në këtë kohë, në caktimin e mësuesve të shkollave të porsaçelura, ndiqej parimi: *“Mësuesi përveç dijes, metodës pedagogjike, duhet të jetë atdhetar dhe i njohur si i tillë. Lipset të jemi të sinqertë se punën e lartë që do të marrë përsipër e ka me zemër e koshiencë, për detyrat me të cilat do të ngarkohet”*.<sup>182</sup> Për të vlerësuar punën e mësuesve të shkollës së natës të çelur nga Lef Nosi, Simon Shuteriqi do të shkruajë në gazetën “Kombi” të shqiptarëve të Amerikës se: *“këta zotërinj të ndershëm pa nonjë farë pajtese, pa nonjë farë fitimi murën përsipër këtë punë të shenjtënueshme”*.<sup>183</sup> Në këtë shkollë zhvilloheshin lëndët: mësim gjuhe, histori dhe shkronjë; mësimet ndiqeshin nga më tepër se 80 nxënës “që po mësojnë me shumë zell”- shkruante Lef Nosi, me pseudonimin Mal’i vashës, si korrespondent i gazetës “Lirija” për Elbasanin, në v. 1909.<sup>184</sup> Gjatë këtij viti, L. Nosi mbulonte, për këtë gazetë, zonën e Elbasanit, Peqinit, Kavajës e Durrësit dhe shërbente njëkohësisht si korrespondent për librat e shtypshkronjës “Mbrothësia” në Sofje. Kjo shkollë pati jetë derisa filloi ndjekja nga Xhemijeti (shoqëri e xhonturqve). Pas mësimet të alfabetit dhe shkrimit të shqipes, disa tregtarë e zanatçinj filluan t’i mbajnë shënimet në gjuhën shqipe. Njëkohësisht filloi përdorimi i gjuhës shqipe në kisha, zyrtarisht e pa rezerva.<sup>185</sup>

Përmes burimeve të shtypit të asaj kohe konstatohet se në muajin prill 1909, këndimet e shenjta të “javës së madhe” në Elbasan u kënduan shqip mbi bazën e fletoreve të shqipëruara nga Fan Noli. *“Simvjet, këndimet e shenjta të javës së madhe, këtu u kënduan thjesht shqip”*.<sup>186</sup> – do të shkruhej në faqet e gazetës “Lirija” për lajmet që vinin nga Elbasani, shkrim i cili s’ka autor por njohim korespondentin e këtij organi për Elbasanin, dhe ai ishte L. Nosi. – *“Nga priftinint’onë të përndershëm e kangëtorët kishtarë Papa Venemini, Papa Dhimidri Truka, zoti Mim Bibaja, z. Lazar Monçi, ene z. Taq papa Venemini, me fletoret e të përndershmit priftit t’onë Fan S. Nolit shërbesën e “javës së madhe” e kënduan thjesht shqip, ene kshtu gëzunë zemrat e shpirtrat e atyne shqiptarëve që faleshin në kishë, të cilët nuk dilnin prej kishe pa u dhanë fund atyne këndimeve të mallnyshme e të kuptushme”*.<sup>187</sup> Ngjarjet në kishën e Shën Mërisë, në Elbasan, shënuan një kthesë të madhe në historinë e kishës ortodokse shqiptare pasi i dha fund përdorimit të gjuhës greke në ceremonitë fetare ortodokse dhe i hapi rrugën përpjekjeve për krijimin e kishës autoqefale shqiptare. Mirëpo kjo atmosferë shqipdashëse shënoi edhe fillimin e konfliktit mes Mitropolisë, nga njëra

<sup>180</sup> Po aty

<sup>181</sup> “Lirija”, Selanik, 3 janar 1909, f. 2.

<sup>182</sup> “Lirija”, Selanik, 7 shkurt 1909, f. 3

<sup>183</sup> “Kombi”, Boston. Mass, 1908, 4 shtator

<sup>184</sup> “Lirija”, Selanik, 3 janar 1909, f. 3

<sup>185</sup> AME, F. 1, D. 2, f. 2, “Kujtimet e Taq Delianës”

<sup>186</sup> “Lirija”, Selanik, nr. 41, 25 prill 1909, f. 3

<sup>187</sup> Po aty



anë, dhe klerit e popullsisë, nga ana tjetër, pasi edhe kleri ortodoks elbasanas ishte për përdorimin e shqipes në kisha. Në shtator të v. 1909 gjuha shqipe u fut si gjuhë mësimi edhe në shkollat e komunitetit ortodoks të qytetit.<sup>188</sup>

Në një korrespondencë për gazetën “Lirija”, Lef Nosi njofton mbi gjendjen e arsimit në Elbasan, shkollat që funksiononin dhe mësuesit që jepnin mësim në to. “Klubi [Bashkimi-E.A] me të ardhurat e përmuajshme, si edhe me 200 napolonat q’u mblodhnë për të mbajtur shkollën shqipe, - shkruante Lef Nosi-tani po mban mësonjës nëpër të tëra shkollat tyrqisht a greqisht për të mësuar shqip. Sikundër edhe në Shpat ku po mësohet vetëm shqipja e jo tjetër gjuhë...”.<sup>189</sup> Ngritja e shkollave shqipe dhe përhapja e mësimi e gjuhës shqipe solli shtimin e nevojave për abetare e libra të tjerë shqip.

Gjatë kësaj kohe (1909) L. Nosi, në dyqanin e tij, krahas mallrave të tjera, kishte siguruar e mbante edhe libra shqip; madje në një kënd të dyqanit kishte krijuar një bibliotekë personale, ku mbante, sikurse shkruante Mit’hat Frashëri në faqet e gazetës “Lirija” “jo vetëm shumë libra shqip, por edhe mjaft të tjerë në gjuhë inglisht, italisht dhe të tjerë. Kështu dyqani bëhej vend i disa djelmoshave që kuvendojnë për gjëra mësimi”.<sup>190</sup> Mirëpo përpjekjet e klubeve e shoqërive patriotike për shkollën shqipe, qysh prej periudhës së parë pas revolucionit, u kundërshtuan nga xhonturqit të cilët përdorën të gjitha mënyrat për të mbjellë përçarjen fetare mes shqiptarëve e për të penguar ngritjen e ndërgjegjes kombëtare.

Ndërsa komiteti xhonturk “Bashkim e Përparim” orvatej të zhdukte klubet shqiptare dhe atdhetarët e përfshirë në lëvizjen për arsimin e kulturën kombëtare, më 18 prill 1909 u themelua në Elbasan klubi “Vllaznia” i cili kishte për synim “...të sqojë gjendjen e këtij qyteti me anët e gjuhës së nanës, domethanë me anë të Shqipes, qi të marrë vesht cilt armiqt qi e kan rrethu mrenda e jashtë...”.<sup>191</sup> Duke iu referuar burimeve të shtypit të kohës konstatojmë se në formimin e këtij klubi morën pjesë shumë atdhetarë shqiptarë, hoxhallarë, bejlerë e agallarë. Në emër të këtyre atdhetarëve fjalën e mori Lef Nosi, “i cili – sikurse shkruhet në artikullin e gazetës “Lirija”- dëfteu gat’ e ganë qëllimin e shenjtë të klubit “Vllazënia”, mbi përgjithësimin e gjuhës shqipe, me alfabetin e miratuar në Kongresin e Manastirit, nëpër ato vende që ende nuk janë zgjuar e nëpër ato fshatra që janë ende në errësirë”.<sup>192</sup> Pak ditë më vonë shkronjëtorja e klubit “Vllaznia” do të bëjë të ditur lajmin e hapjes së këtij klubi: “Të 18-ën ditë të Prillit u hap në këtë qytet klubi “Vllaznia” për me përhapun gjuhën shqipe në qytet si dhe nëpër fshatrat e rrethina. Hapja e tij zyrtarisht u kremtue me gëzim të madh prej vendit. Vazhdojnë nënshkrimet; ndër to janë edhe patriotët Hysen Ceka, Fot Papajani etj. Nga shkronjëtorja e klubit “Vllaznia”. Elbasan, 25 prill 1909”.<sup>193</sup> Ngritja e këtij klubi patriotik u prit me entuziazëm nga qytetarët elbasanas të cilët u grumbulluan masivisht rreth tij. Një dukuri

<sup>188</sup> Historia e popullit shqiptar, Vëll. II, TOENA, Tiranë, 2002, fq. 389

<sup>189</sup> “Lirija”, Selanik, 1909, 7 shkurt.

<sup>190</sup> “Lirija”, Selanik, 19 Shëndre 1909, f. 3


<sup>191</sup> F. 102, D. 45, f. 1

<sup>192</sup> “Lirija”, Selanik, 1909, 25 prill, f. 2

<sup>193</sup> AQSH, F. 102, D. 45, f. 16



mjaft e rëndësishme që vihet re me krijimin e këtij klubi, shprehet në faktin se kryesia e klubit “Vllaznia”, ishte e përbërë kryesisht nga klerikë myslimanë e të krishterë, shprehje kjo e harmonisë dhe tolerancës fetare që ekzistonte në qytetin e Elbasanit. Midis ortodoksëve dhe myslimanëve kishte lidhje të gjera miqësore dhe unitet mes popullsisë me besime të ndryshme fetare. Librat e gazetat shqipe kishin përhapje të gjerë ndër të gjithë banorët e qytetit dhe të fshatit, pavarësisht nëse ishin ortodoksë ose myslimanë.<sup>194</sup> Brenda dy ditësh në klubin “Vllaznia” u regjistruan 300 anëtarë. Sipas vlerësimit të nënkonsullit austriak të Durrësit “shpirti i klubit të ri (Vllaznia) ishte Lef Nosi”.<sup>195</sup> Këtë rol e ka pohuar edhe studiuesja Nathalie Clayer e cila shprehet se: “Ky klub i quajtur “Vllaznia” ishte shumë aktiv, në drejtimin e Lef Nosit, një ortodoks i qytetit, që organizonte kurse nate dhe diskutime mbi temat e shqiptarizmit”.<sup>196</sup> Ashpërsimi në këtë kohë i konfliktit, për çështjen e shkrimit të gjuhës shqipe, mes rretheve patriotike shqiptare që mbështesnin alfabetin latin dhe xhonturqve që propagandonin shkronjat arabe, u reflektua edhe në



parakushtin që klubi “Vllaznia” do të vendosë për të kufizuar pjesëmarrjen në radhët e saj të përkrahësve të xhonturqve sipas të cilit: “anëtarësimi në klubin “Vllaznia” ishte i lirë për shqiptarët e të dyja besimeve, por jo për ata persona që cilësoheshin si turkomanë edhe nuk e dinin gjuhën shqipe”.<sup>197</sup>

Këshilli drejtues i klubit, i kryesuar nga Dervish Ibrahim, ku Lef Nosi ishte zgjedhur nënkryetar,<sup>198</sup> kundërshtoi hapur propagandën antishqiptare të xhonturqve, lidhur me shkrimin e shqipes me shkronja arabe, madje do t’i dërgojë një telegram proteste senatit turk në lidhje me vendimin e marrë për mbylljen e klubeve shqiptare që kishin për qëllim zhvillimin e gjuhës shqipe. “Ndër fletore kena pa me keqardhje se Parlamenti ka vendos me mbyll klubet shqiptare që shërbejnë me

përhap gjuhën t’onë amëtare... Lutena nga ai Këshill i Epër me pasë mirësinë me ndryshu këtë vendim që pengon përparimin e gjuhës sonë kombëtare”.<sup>199</sup> Kopja e telegramit iu dërgua edhe klubeve të Selanikut, Manastirit, Shkupit e Janinës, të cilëve iu kërkua të bashkohen me iniciativën e klubit “Vllaznia”.

Po gjatë këtij viti (1909), ndërsa vazhdon të jetë anëtar i Këshillit Administrativ të klubit “Vllaznia”,<sup>200</sup> Lef Nosi, bashkë me patriotë të tjerë elbasanas, do të bëhet nismëtar i themelimit, më 2/15 maj 1909, të shoqërisë “Afërdita” e cila do të përmbante edhe një bandë muzikore me të njëjtin emër (Banda

<sup>194</sup> Graceni, Bardhyl. Aleksandër Xhuvani, vepër e cituar, fq. 65

<sup>195</sup> Myzyri, Hysni. *Shkolla Normale...* Tiranë, albPAPER, 2004, fq. 184

<sup>196</sup> Nathalie Clayer, vepër e cituar, fq. 611.

<sup>197</sup> Peza, Majlinda. *Zhvillimet politiko-arsimore në trevën e Elbasanit në vitet 1878-1914*, Doktoratë, Tiranë, 2014, fq. 81

<sup>198</sup> AQSH, F. 102, D. 45-46, Klubi “Vllaznia” Elbasan, 1909, f. 1-4. Arkëtar u zgjodh Hysen Ceka, shkronjës: Fot Papajani, këshillëtarë: Demir e Sulçe Beu, Tahsim Myftiu, Isuf Skilja, Simon Pepa e Anton Beçja.

<sup>199</sup> AQSH, F. 102, D. 60, f. 2

<sup>200</sup> Po aty, D. 45, f. 23

muzikore “Afërdita”).<sup>201</sup> Kjo ishte shoqëria e parë e muzikës për qytetin e Elbasanit, e cila shpejt do të numërojë rreth 100 anëtarë. U porositën vegla muzikore që do të bliheshin jashtë me të hollat e mbledhura nga populli, të krishterë e myslimanë, sipas dëshirës. Lënda u ble me pagesa të përmuajshme, me dëftesa të rregullta për shoqërinë e muzikës “Afërdita”. Fillimisht mësimet e orkestrës u bënë në shkollën e kishës, por më pas, për shkak të rebelizmit, qendër e saj u bë shtypshkronja.<sup>202</sup>

Shoqëria “Afërdita” kishte edhe vulën e saj të shkruar shqip, ku ishte stampuar lindja e yllit të mëngjesit fakt i cili, së bashku me emërtimin që ajo mori, të bëjnë të mendosh se kjo shoqëri ishte vazhdim i shoqërisë “Ylli i Mëngjesit”, e themeluar në Elbasan para shpalljes së kushtetutës, në vitin 1907, me kryetar Dhimitër Kapedanin.<sup>203</sup>

Rregullorja e shoqërisë “Afërdita”, e përbërë nga 21 nene dhe e shtypur në Manastir nga shtypshkronja “Bashkimi i kombit”, një dokument ky me mjaft vlera historike, përcakton qartë qëllimin, aktivitetin dhe programin e saj.

Që në nenin e parë të saj shprehimisht thuhet: “Kjo shoqëri ka për qëllim të përhapunit e **Dashurisë, Vllaznisë e Njisisë** ndërmjet vendeve t’qytetit e të fshatrave rreth, që të marrin rrugën e qytetnimit”.<sup>204</sup> Në nenin e dytë të statutit të kësaj shoqërie parashtroheshin synimet që ajo kishte për shtrirjen e veprimtarisë së saj në një plan edhe më të gjerë për të ardhmen. Në të përcaktohej se: “Shoqëria sipas rregullores së saj ka ndër mend me përbamun sot për sot një Bandë Muzikore “Afërdita” e pas ca kohe t’i shtohet një stërvitore të trupit bashkë me një shenjëtore (mjedis qitjeje). Punërat e mëdha lypin ende ndihma”.<sup>205</sup>

Kryetar i shoqërisë “Afërdita” u zgjodh Lef Nosi, nënkryetar: Fot Papajani, arkëtar: Dhimitër Papajani, këshilltarë: Petër Dodbiba, M. H. Shijaku, Hysen Ceka, Myrteza Demeti, Petër Papamihali, Jorgji N. Paparisto dhe shkruar: Dhimitër Deliana.<sup>206</sup> Siç shihet nga kjo përbërje, shumica e anëtarëve të kësaj shoqërie janë të besimit ortodoks. Shoqëria “Afërdita” synonte ta shtrinte veprimtarinë e saj, përtej Elbasanit, edhe në vise të tjera, sidomos në qytetet e Shqipërisë së Mesme, si në “*Tiranë, Kavajë, Krujë, Peqin, Durrës e gjetkë, vise ku mjerisht përparimi kombëtar ndodhet në pengime të mëdha ... Dorë për dorë, - thuhet në një letër të kryesisë të kësaj shoqërie, - duam të përbajmë një Bandë Muzikore, e cila t’i shëtisë këto vise, e me kankë të flakta t’u mbjellë ndjenjën e shenjtë të kombësisë*”.<sup>207</sup> Me gjithë përpjekjet për përhapjen e kulturës shqipe, kjo shoqëri, për shkak të trazirave e ndryshimeve në vend, nuk arriti të veprojë gjatë. Megjithatë për sa kohë xhonturqit nuk i kishin konsoliduar pozitat e tyre, ata ishin të detyruar

<sup>201</sup> AME, F. 31, D. 2, nr. 5, f. 1

<sup>202</sup> AME, F. 1, D. 2, nr. 23, f. 2, “Kujtimet e Taq Delianës”

<sup>203</sup> AME, Elbasani qendër e Lëvizjes Kombëtare 1900-1912, D. 4, f. 7.

<sup>204</sup> AME, F. 31, D. 2, nr. 5, f. 2

<sup>205</sup> *Rregullore e shoqërisë “Afërdita”,* Elbasan. “Bashkimi i kombit”, Manastir, 1909, f. 10

<sup>206</sup> Po aty

<sup>207</sup> Myzyri, Hysni. *Shkolla Normale...*, Tiranë, albPAPER, 2004, fq. 186

ta pranonin këtë gjallërim të lëvizjes kombëtare shqiptare, ndërsa përgatiteshin për t'i dhënë goditjen përmes përdorimit të forcës.

Në këtë kohë, në Elbasan, vijnë misionarët amerikanë Fines Kenedi (Phineas B. Kennedy) nga Korça dhe Charl T. Erickson (Charls Telford Erickson) nga Tirana. Përmes një një letre dërguar nga Kenedi klubit “Vllaznia”, në 28 maj 1909, konstatohet se amerikanët në Shqipëri kishin zgjedhur qytetin e Elbasanit “...për të hapur një shkollë të mesme (Kolexhë) për djemtë shqiptarë” e cila do të kishte gjithashtu “...edhe një degë industriale”.<sup>208</sup> Ky projekt u mirëprit nga klubet “Vllaznia” e “Bashkimi” të cilët në mbledhjen e përbashkët që organizuan kryesitë e të dyja klubeve të Elbasanit vendosën që t'i përgjigjen kërkesës për ndihmë të misionarëve amerikanë me një shumë prej 100 lirash turke.<sup>209</sup> Po Kështu edhe Erickson erdhi në Elbasan me qëllim që të blinte një truall e të hapte një shkollë për vajza. Për realizimin e këtij misioni, ai bashkëpunoi edhe me figura të njohura të lëvizjes patriotike në qytet, Aqif Pashën e Lef Nosit, të cilët iu kërkuar misionarëve veprime më të shpejta për të përfutur “nga rasti jashtëzakonisht i përshtatshëm (1909) kur të gjithë udhëheqësit shqiptarë kudo, e kuptonin këtë detyrë- bashkimin e shqiptarëve drejt progresit, shkollimit, edukimit...- dhe janë të gatshëm të flijohen për të.”<sup>210</sup> Ajo që kërkonin veprimtarët elbasanas ishte përkrahja amerikane për lëvizjen shqiptare dhe jo krijimi i iluzioneve të bukura por pa aksione konkrete. Ky ishte edhe mesazhi që L. Nosi kërkon të përcjellë tek Erickson gjatë bisedës me të. “Ne e dimë që ju e keni ilačin e vërtetë – do të shprehet veprimtari elbasanas, i krishteri ortodoks, L. Nosi në takimin me misionarët amerikan, - të cilin, nëse ia jepni popullit tonë të sëmurë, do të shpëtojnë menjëherë shumë jetëra. Ndërkaq, ç’po ndodh? Ju vetëm po na tregoni ilačin. Kur ne ju lusim që ta hapni shishen e ilaçit e të na lini ta përdorim, ju na thonë: Prisni pak, ende s’jemi gati. Ne po vdesim. Nëse na doni me të vërtetë dhe nëse përnjimend doni të na shpëtoni hapeni shihen përnjiherë dhe na jepni ilačin. Nëse jo, atëherë, ju lutemi, na lini të marrim ndonjë ilaç tjetër, apo na lini të vdesim të qetë.”<sup>211</sup> Nga analiza e këtij opinioni del se L. Nosi ndonëse besonte dhe shpresonte tek ndihma e misionarëve amerikanë, ai ishte i bindur se nëse kjo ndihmë nuk realizohej në kohën e duhur e nesërmja mund të ishte tepër vonë. Liritë e fituara duheshin shfrytëzuar dhe për L. Nosit koha kërkonte të veprohej menjëherë. Sukseset që klubet dhe shoqëritë patriotike kishin arritur në fushën e arsimit në kushtet legale pas shpalljes së Hyrjetit kishin filluar ti vinin në lëvizje turqit e rinj, të cilët pas konsolidimit të pushtetit të tyre politik kishin filluar të tjetëronin qëndrimin ndaj lëvizjes kombëtare shqiptare e shprehur kjo si përmes ushtrimit të presionit dhe dhunës ndaj klubeve dhe shoqërive patriotike ashtu edhe përmes përdorimit të legjislacionit osman në funksion të kësaj politike.

<sup>208</sup> AQSH, F. 102, D. 50, f. 1

<sup>209</sup> Po aty, f. 4, dt. 29 qershor 1909.

<sup>210</sup> Erickson, Charls Telford. 5 vjet në Shqipëri, Tiranë, 2003, fq. 48

<sup>211</sup> Po aty, fq. 49

Është fakt se lëvizja arsimore e kulturore në trevat shqiptare pas Kongresit të Manastirit njohu një zhvillim të dukshëm e pasqyruar përmes ngritjes së një rrjeti të gjerë klubesh dhe shoqërish patriotike, hapjes së një vargu shkollash shqipe, të ditës e të natës, si edhe në rritjen e numrit të librave, revistave dhe gazetave. Mirëpo nga ana tjetër ky zhvillim kishte nxjerrë në plan të parë plotësimin e kërkesave për mësues të gjuhës shqipe.

Një detyrë të tillë të vështirë e mori përsipër ta zgjidhte Kongresi Kombëtar që u vendos të mbledhej posaçërisht në Elbasan në 2-9 shtator 1909. Në momentet e rëndësishme të organizimit të Kongresit ku morën pjesë përfaqësues të njëzet klubeve nga të gjitha krahinat shqiptare për të diskutuar probleme të rëndësishme të organizimit të shkollës kombëtare e cila tashmë ishte futur në një fazë të re të zhvillimit të saj, L. Nosi u bashkua me forcat më demokratike të kësaj periudhe të inkuadruara në rradhët e klubeve patriotike të qytetit të cilat u morën drejtpërdrejtë me përgatitjen e punimeve të kongresit dhe shpërndarjen e ftesave për klubet dhe shoqëritë patriotike shqiptare, brenda e jashtë kufijve të territorit shqiptar. Mbërritja në 1 shtator e delegatëve të Manastirit, Dibrës, Korçës, Shkupit dhe Selanikut e gjeti qytetin në një atmosferë të ngrohtë dhe miqësore e krijuar nga masa e madhe e banorëve dhe e fëmijëve të shkollave shqipe, të prirë nga figura të njohura të qytetit.<sup>212</sup> Në 20 gusht (2 shtator) 1909, në ambjentet e klubit “Bashkimi”, nisi punimet kongresi i cili prej disa kohësh po përgatitej të mbahej në Elbasan. “Pas shpalljes së konstitucionit – do të shkruante Lef Nosi në shënimet e tij për ngjarjet historike në vend, – në gusht të vitit 1909, u mbledh në Elbasan një kongres pan-shqiptar që do të vendosi hapjen e një shkolle normale që fillon në Nanduer t’ati viti...”.<sup>213</sup> Të nesërmen Kongresi i vazhdoi punimet në ndërtesën e klubit “Vllaznia”, ku u paraqitën mandatet, u zgjodh kryesia dhe u përcaktuan çështjet që do të shtroheshin për zgjidhje. Përveç delegatëve me të drejtë vote që përfaqësonin klubet “Bashkimi” e “Vllaznia” si dhe shoqërinë “Afërdita”, në të morën pjesë vullnetarisht edhe patriotë e dashamirës të tjerë të arsimit e kulturës shqiptare si Lef Nosi, Dhimitër Paparisto e Hysen Ceka.<sup>214</sup> Të nesërmen punimet vazhduan në lokalën e shkollës greqishte të lagjes Kala, ku edhe vetë L. Nosi kishte kryer shkollën fillore.

Kongresi i Elbasanit do të marrë në shqyrtim probleme që kishin të bënin me përhapjen e mëtejshme të arsimit në gjuhën shqipe, me përgatitjen e mësuesve për shkollat shqipe dhe me organizimin më të mirë të lëvizjes kulturore e asaj kombëtare në përgjithësi. Në këtë kontekst, ai mori një sërë vendimesh ndër më të rëndësishmet të cilave përmendim: “Të fillohet dhe të nisët këtë vjeshtë në Elbasan një mësonjëtorë për mësonjës, me gjashtë rreshta, për mbajtjen e së cilës janë të detyruem të gjithë klubet dhe shoqëritë mbrenda dhe jashtë Shqipnisë, sikundër edhe gjithë njerëzit që dëshirojnë përparimin e Kombit”.<sup>215</sup> Kongresi vendosi gjithashtu që, për të zgjidhur të gjitha problemet që lidheshin me mbarëvajtjen e Shkollës Normale, të

<sup>212</sup> “Lirija”, Selanik, shtator 1909.

<sup>213</sup> AQSH, F. 32, D. 39, f. 128

<sup>214</sup> Myzyri, Hysni. *Shkolla Normale...*, Tiranë, albPAPER, 2004, fq. 98

<sup>215</sup> “Lirija”, Selanik, nr. 58, dt. 25 shtator 1909

krijonte një këshill arsimor. “...u ba mend tu kërkohet me shkresë nga ana e kongresit këshillave sundimtarë të klubeve të Elbasanit “Bashkimi” ene “Vllaznia” sikurse ene të shoqërisë “Afërdita” së bashku të zgjedhin parësinë e këtushme të mësonjtores të mësonjësve, prej 8 vetash, vendas të Elbasanit, e cila bashkërisht me drejtimin e saj do të pajtojë mësonjësit që duhen e do të kujdeset për çdo gja që ka të bajë me të”.<sup>216</sup> Për rrjedhojë u zgjodh Këshilli Administrativ (Mbikqyrës) apo “Pleqësia Kujdestare”, e cila do të ndihmonte për drejtimin dhe mbarëvajtjen e Normales, anëtarë i së cilës u zgjodh edhe Lef Nosi<sup>217</sup> i cili në votimin e datës 24 gusht të v. 1909, të anëtarëve të klubeve të Elbasanit dhe shoqërisë “Afërdita” mori 13 vota.<sup>218</sup> Ky Këshill ftoi për të dhënë mësim në Normalen e Elbasanit Luigj Gurakuqin, Aleksandër Xhuvanin, Sotir Pecin e patriotë të tjerë të gjuhës dhe kulturës kombëtare.

Në kuadër të trajtimit të problemit mbi forcimin e lidhjeve dhe bashkërendimin e veprimeve ndërmjet klubeve e shoqërive që ekzistonin në Shqipëri kongresi, krahas vendimit për zgjedhjen e Klubit të Manastirit si klub qendror, miratoi edhe rregulloren e klubeve e të shoqërive shqiptare, që përveç dispozitave të përgjithshme e të detyrueshme për çdo klub apo shoqëri të hartohet edhe statusi individual, në përputhje me kushtet dhe nevojat konkrete. Në këtë kuadër theksohej shprehimisht: “*Të gjitha klubet e shoqëritë duhet të punojnë me të gjitha forcat e tyre në të mirën e kombit shqiptar e të vendit për përparimin e qytetërimit popullor etj*”.<sup>219</sup> Ky problem kishte zënë vend shpesh në faqet e shtypit të kohës qysh përpara mbledhjes së kongresit. Përmendim këtu gazetën “Dielli”, gazetë kjo politike, shoqërore, kulturore dhe ekonomike, e themeluar në Boston në shkurt të vitit 1909, nga shoqëria kombëtare “Besa-Besë”-“*me një program thjesht kombëtar dhe të zonjë t’u ngroh dhe t’u forcojë zemrat e gjithë shqiptarëve...*”,<sup>220</sup> e drejtuar fillimisht nga F. Noli e më pas nga F. Konica, korespondent i së cilës për qytetin e Elbasanit ishte Lef Nosi. Kjo gazetë ka qenë një nga tribunat më të rëndësishme të çështjes shqiptare, motoja kryesore e së cilës ishte “vetëqeverimi i Shqipërisë”.<sup>221</sup> “*Shqipëria do të jetë pjesë e Perandorisë turke ...për sa kohë rron Turqia në Evropë. Nëqoftëse Turqia s’rron dot në Evropë, Shqipëria do të bëhet më vete me një princ prej fëmijëve mbretërorë t’Evropës*”.<sup>222</sup> Ky kishte qenë programi i shoqërisë “Ana Kombëtare e Shqipërisë” në Londër, në vitin 1907, i cili që në pikën e parë të tij kishte parashtruar kërkesën : “Shqipëria të bëhëj një mbretëri më vete”<sup>223</sup> ndërkohë që vetë L. Nosi kishte shkruar se: “*është fat të besojmë se Evropa monarkiste do të na lejojë të jemi mbretëri me një princ nga dyet mbretërore të Evropës për mbret*”<sup>224</sup>. Edhe pas dy vjetës,

<sup>216</sup> Normalja në traditë, Elbasan, 1995, fq. 43

<sup>217</sup> AQSH, F. 102, D. 63, f. 2. Me votim të përbashkët u zgjodhën pleq të Pleqësisë Kujdestare për shkollën e mësonjësve, zotërinjtë: Emin Haxhiademi, Dhimitër Buda, Hysen Ceka, Lef Nosi, Dervish Beu, Ahmet Dakli, Dhimitër Paparisto e Petër Biba.

<sup>218</sup> AQSH, F. 102, D. 36, f. 1-2

<sup>219</sup> AME, *Dokumenta historike për ti shërbye histories sonë kombëtare*, Lef Nosi

<sup>220</sup> Revista “Albania”, Londër, 1909, nr. 1, fq. 37

<sup>221</sup> Cankja, D & Hatellari, M, *Kontributi i atdhetarëve elbasanas...*, Elbasan, 2012, fq. 17

<sup>222</sup> Revista “Albania”, Londër, 1909, nr. 1, fq. 38

<sup>223</sup> AQSH, F. 32, D. 6, f. 1

<sup>224</sup> Po aty, f. 4



tashmë drejtuesi i gazetës “Dielli”, F. Konica, dhe korespondenti i saj, Lef Nosi, në Elbasan, do të bëhen



përcjellësit e kërkesave të patriotizmit mbarëshqiptar në vend. Përmes shkrimeve të korespondentit të saj dhe patriotëve të tjerë elbasanas si Simon Shuteriqi, Aleksandër Xhuvani etj, kjo gazetë i bëri jehonë edhe hapjes së shkollës Normale dhe ecursisë së saj ndër vite. Në janar të 1910-ës xhonturqit vendosën të ndalonin gazetën “Dielli”, misionin e së cilës tashmë do ta përçojë mes shqiptarëve gazeta “Flamuri”, e drejtuar nga Faik Konica (Faik bey Konitza), e cila doli për herë të parë në 18 shkurt të v. 1910 e do të

vazhdojë deri në muajin prill. Korespondent i kësaj gazete për Elbasanin ishte bashkëhartuesi i programit të organizatës së Anës Kombëtare dhe miku i Konicës, Lef Nosi. Që “Flamuri” kishte nisur botimin e tij si organ i “Anës Kombëtare” na dëshmon edhe një letër që shqiptarë të Lowellit i dërgojnë kësaj gazete ku ndër të tjera shkruhej: “*Merni këtë ndihmë si një shënjë të dëshirës që kemi të vejë përpara Ana Kombëtare dhe Organi i saj*”.<sup>225</sup> Përmes lajmeve të përcjella nga korespondenti i saj dhe veprimtarëve të tjerë elbasanas, në faqet e gazetës do të jenë të shumtë artikujt për shkollën Normale dhe për luftën që bëjnë banorët e qytetit për të mbrojtur shkollën e shkronjat shqipe.

Ndonëse Normalja e Elbasanit, e para shkollë e mesme në gjuhën shqipe brenda vendit, për shkak të problemeve të natyrave të ndryshme nuk u hap as në datën e vendosur nga Kongresi dhe as kur u dha lajmërimi nga “Këshilli Mbikqyrës”, ajo hapi dyert e saj në 1 dhjetor të vitit 1909 duke finalizuar me sukses përpjekjet e vazhdueshmeve të patriotëve shqiptarë brenda dhe jashtë vendit. Mirëpo që në fillim xhonturqit u përpoqën të vinin nën kontroll drejtimin e shkollës duke imponuar zgjedhjen e strukturave drejtuese të Normales. Sikurse konfirmojnë edhe burimet e huaja në funksion të përmbushjes së këtij qëllimi xhonturqit do të përpiqen të emërojnë si drejtor të Normales një drejtor mysliman ndërkohë që mendimi i patriotëve shqiptarëve ishte për të emëruar një drejtues të krishterë.<sup>226</sup> Nisur nga ky fakt mendojmë se edhe zgjedhja e katolikut nga Shkodra, L. Gurakuqit për të drejtuar Normalen e Elbasanit ishte zgjidhja që patriotët shqiptarë i dhanë përpjekjeve të xhonturqve të cilët ndërkohë tentuan të mbjellin farën e fanatizmit fetar mes nxënësve myslimanë kundër mësuesve të krishterë të Normales. Madje në Elbasan u dërgua edhe një përfaqësues muhamedan nga Shkodra, z. Mahmut Nedim, kërkesat e të cilit synonin jo vetëm të ndryshonin

*Lef Nosi i dyti në këmbë, nga e djathta në të majtë*

<sup>225</sup> Gazeta “Flamuri”, Boston, Mass., 18 shkurt 1910

<sup>226</sup> Erickson, Charles Telford, *Shqiptarët Enigma e Ballkanit*, vëllimi II, Edualba, 2012, fq. 116.

programin e Normales, por planifikonin shumë ndryshime edhe në gjithë organizimin e saj. Nisur nga të dhënat e shtypit të kohës Lef Nosi si anëtar i komisionit të Shkollës Normale, bashkë me dy mësues të tjerë kristianë, ngritën zërin kundër “mendimeve regresive të turqve...dhe ngulën këmbë me kanosje se do të largoheshin nga Komisioni”,<sup>227</sup> qëndrim që çoi në largimin e z. Nedim nga Normalja. Edhe atëherë kur përfaqësues të lëvizjes kombëtare, ndër ta edhe F. Konica, me qëllim mbarëvajtjen e veprimtarisë së Normales në liri të plotë – larg presionit qeveritar dhe përtej ndikimit të fanatizmit vendas, hodhën idenë e vendosjes së Shkollës Normale jashtë Shqipërisë, Lef Nosi ishte i bindur se ndjenjat kombëtare të shqiptarëve qëndronin mbi përkatësitë fetare dhe me dashurinë e tyre për gjuhën ata do të bënin të dështonin çdo përpjekje për përçarje mes edukatorëve të rinj të shkollave shqipe. “Me gjithë këto që ndodhën – do të shkruante F. Konica nga Amerika – Lefit nuk i mbushet mendja e don t’i bjeri murit me krye dhe nuk e heq shpresën që mund të rrojnë e të punojnë bashkë të krishterë me muhamedanë”.<sup>228</sup> Menjëherë pas Kongresit



të Elbasanit, falë përpjekjeve të atdhetarëve shqiptarë për mësimin e gjuhës shqipe në të gjitha shkollat fillore, u zgjerua rrjeti i shkollave shqipe që u hapën në qytete të ndryshme të Shqipërisë dhe u bë e mundur mësimi i gjuhës shqipe në shkollat e huaja, turke e greke. Në këtë kohë L. Nosi do të bëhet një nga propaganduesit kryesorë të botimeve të

reja shqipe në trevën e Elbasanit e më gjerë.

Përhapja e shkollës dhe gjuhës shqipe në rajon e më gjerë, arritje e cila u siguria pas shumë përpjekjesh e me sakrifica të mëdha, shkaktoi një shqetësim dhe reaksion të menjëhershëm tek xhonturqit dhe fanatikët vendas. Nuk kaloi shumë kohë dhe u pa se turqit e rinj nuk do t’u njihnin shqiptarëve asnjë të drejtë kombëtare. Në fillim deshën të mbyllnin shkollat shqipe, por duke parë dëshirën e popullit për mësimin në gjuhën e vet, i ranë pas mendjes së çuditshme të Kara Rexhepit, të Mahfelit t’Aksarajit, për të ndërruar shkronjat shqipe e në vend të tyre të vinin shkronjat arabe.<sup>229</sup> Duke përdorur si mjet fanatizmin fetar në qytet, ata nxitën, ditët e para të shkurtit të 1910-ës, një “revoltë” të elementëve fanatikë vendas të cilët u përpoqën t’i detyronin shkollat shqipe të qytetit, në veçanti shkollën Normale, që ta shkruanin gjuhën shqipe me gërma arabe. Por duke qenë se shkronjat arabe jo vetëm që nuk kishin zanore por, si gjuhë semitike, nuk kishin as bashkëtingëllore, shkrimi i shqipes me shkronja arabe nuk ishte gjë tjetër veçse një

<sup>227</sup> Gazeta “Trumbeta e Krujës”, Saint Louis, Missouri, USA, nr. 1, 20 mars 1911, fq. 3

<sup>228</sup> Po aty

<sup>229</sup> Selenica, Teki. *Shqipëria në 1927*, Tiranë, 1928, fq. 21



propagandë mashtruese që synonte të pengonte shqiptarët të shkruanin në gjuhën e nënës. Në të njëjtën kohë kjo propagandë bëri që në Shqipëri të evidentohen dy qëndrime krejt të kundërta: në njërin anë qëndronin luftëtarët e shkronjave latine të përfaqësuar nga nacionalistët shqiptarë, dhe nga ana tjetër përkrahësit e shkronjave arabe që përbëheshin nga elementë fanatikë fetarë të cilët interesat e tyre i kishin lidhur me Perandorinë Osmane. Në këtë përballje mes tyre, grekët e serbët ndihmonin e përkrahnin propagandën xhonturke.

Orvatjet e qeverisë turke për të futur në shkolla alfabetin arab për mësimin e shqipes ndeshën në qëndresën e vendosur të nacionalistëve shqiptarë që ngritën zërin e protestës kundër autoriteteve shtetërore. Populli i Elbasanit, nën drejtimin e klubeve “Bashkimi” e “Vllaznia”, iu përgjigjën me një manifestim masiv më 18 shkurt 1910, në sheshin e Namazgjasë, me pjesëmarrjen e 7000<sup>230</sup> qytetarëve e fshatarëve të ardhur nga Shpati dhe nga katunde të tjera të Elbasanit, për të mbrojtur gjuhën shqipe dhe të shkruarit e saj me alfabetin shqip të vendosur në Kongresin e Manastirit. Në rradhët e ideatorëve të këtij mitingu gjendet edhe Lef Nosi.<sup>231</sup> Ky demonstrim, sikurse edhe të tjerë në qytete të ndryshme të vendit, gjeti mbështetjen e rretheve patriotike brenda e jashtë kufijve.

Shtypi i kohës do të shkruante për këtë miting të madh: “...u falem nderit nga ana e gjithë qytetit atdhetarëve të flaktë z. Lef Nosi, Muç Shqiptarit, Beqir Plangaricës, Ali Çiftes, Nexhip Haxhiademit, Ali Çeliramës, Tahsim Myftiut e të tjerë që patën mëndjen e bukurë për të parën herë të çfaqin mentimin qi duhet bamun një miting prej kombëtarëve të këtushëm...që të protestohet kundër mentimit të paarsyeshëm të shkruhet shqypia me shkronja arabishte...”.<sup>232</sup>

Ndërsa demonstruesit, me flamujtë e klubeve shqiptare në duar, protestonin kundër përpjekjeve antishqiptare të fanatikëve turkomanë, duke kënduar këngën “*Shkronjat tona janë të arta / ato duam ne*”, Pleqësia e mitingut e kryesuar nga Dervish Biçaku, i dërgon një telegram proteste kryeministrit turk dhe parlamentit duke e konsideruar aktin e imponimit të futjes me forcë të alfabetit arab në shkollat shqipe si antikushtetues.<sup>233</sup> Pavarësisht se burimet e kohës japin të dhëna të ndryshme lidhur me numrin e pjesëmarrësve,<sup>234</sup> ato i japin të njëjtën rëndësi përmasave që ky miting mori dhe jehonës që ai ushtroi. Mitingu i patriotëve elbasanas ishte më i madhi që ishte organizuar deri në atë kohë në Shqipëri dhe u bë nxitje edhe për mitingje e iniciativa të tjera patriotike në treva të ndryshme të vendit si në Korçë, Kolonjë etj.

Manifestimet, që u zhvilluan jo vetëm në Elbasan por në shumë qytete të Shqipërisë, ishin gjithashtu dëshmi e vendosmërisë së shqiptarëve për mbrojtjen e shkrimit e shkollës shqipe dhe kulturës kombëtare në

<sup>230</sup> *Elbasani-Enciklopedi*, “Klubet kulturore dhe patriotike”, R. Gjini, fq. 291

<sup>231</sup> *Normalja në fokus të bashkëkohësisë*, Elbasan, Silver, 1999, fq. 180

<sup>232</sup> “Dielli”, Boston Mass, 25 mars 1910, f. 2

<sup>233</sup> *Elbasani- Enciklopedi*, Sejko, Elbasan, 2003, fq. 117

<sup>234</sup> Ndërsa nënkonsulli austriak i Drr në informacionin e 11 prillit flet për 2000 pjesëmarrës, gazeta “Shqiptari” në Stamboll shkruan për 10000 demonstrues, kurse gazeta “Dielli” e Bostonit pohon pjesëmarrjen e 7000 vetëve.

tërësi. Gradualisht lufta midis patrotëve shqiptarë dhe qeveritarëve xhonturq mori trajta edhe më të ashpra. “Me politikën e tyre xhonturqit ishin armiqësuar me shqiptarët, të vetmen racë që mund ta kishin aleaten e tyre. – do të shkruante Miss Durham mbi rrjedhën e zhvillimit të ngjarjeve në vend. - Atëherë shqiptarët do të fillojnë luftën, që sikur turqit e rinj ta dinin, ishte fillimi i mbarimit.”<sup>235</sup> Këto manifestime proteste, të



organizuara nga klubet shqiptare në fillim të vitit 1910, jo vetëm që ngritën më lart lëvizjen tonë kombëtare, por ishin një risi si për Shqipërinë ashtu edhe për gjithë popujt e Perandorisë Osmane. Gjithashtu ato ishin këmbanat që paralajmëruan kryengritjen e armatosur që do të shpërthejë në pranverën e vitit 1910.

#### I.4 Gazeta “Tomorri” – zëri i propagandës së interesave shqiptare

Sikurse ishte në përgjithësi logjika e zhvillimeve të realitetit shqiptar në dhjetëvjeçarët e parë të shek. XX, aktiviteti intelektual në atë kohë fillonte, në më të shumtën e

rasteve, në fushën e publicistikës. Në këtë fushë do të ofrojë kontributin e tij edhe Lef Nosi. Në shkurt të 1910-ës ai ishte korrespondent i Elbasanit për gazetën “Flamuri” të Bostonit, e drejtuar nga F. Konica, kryefjala e së cilës ishte “Shqipëria për shqiptarët”.<sup>236</sup> Si veprimtar i Rilindjes Kombëtare, ai do të bëhet veçanërisht i njohur me botimin, në mars të vitit 1910, të së parës gazetë të qytetit të tij të lindjes, të përkohëshmes politike e letrare, “Tomorri”, e cila i dha jetë lëmit të publicistikës në qytetin e Elbasanit.

Lef Nosi ishte pronar përgjegjës dhe drejtues i këtij organi, i cili shpejt do të shndërrohet në tribunën ku përfaqësuesit e lëvizjes përparimtare e më demokratike të kohës do të ngrenë zërin rreth problemeve që rëndonin mbi çështjen shqiptare dhe ku iu bë jehonë ngjarjeve, problemeve dhe shqetësimeve të kohës. Bashkëpunëtori i tij, patrioti Josif Haxhimima (pseud. Rras’e bardhë) do të përshëndesë në shtyp daljen e kësaj të përkohëshmeje: “Z. Lef Nosi, i cili ka punuar prej shumë kohësh me mundime e po punon pa prajtnë për mbrohtësinë e gjuhës dhe për përhapjen e ndjenjave kombëtare, një lule qi ka kohë qi, ene sot ky burrë pati fatmirësinë me këtë lule, fletën “Tomorri” të na gëzojë gjithë qytetin e mëmëdhenë tonë Shqipërinë. Këtë fletë e urojmë megjithë zemër të ketë jetë të gjatë dhe përparim në të përhapunit e të

<sup>235</sup> Durham, Edith. *20 vitet e trazirave të mëdha*, Tiranë, 2001, fq. 233

<sup>236</sup> *Kontributi i atdhetarëve elbasanas...*, vepër e cituar, fq. 25

drejtave kombëtare e në lulëzim të gjuhës duke shpresun se do të ketë përherë guxim, durim e shpresë në çdo punë patriotike”.<sup>237</sup>

Një urim i kohës për gazetën “Tomorri”

*O moj fletë e bekuar*

*Që pate fatbardhësinë*

*Me shkronjat e arta shkruarë*

*Të lulëzonçë Shqipërinë*

*...Pas emërit që more*

*dhe pas programit të naltë*

*Perëndia sheshtërore*

*dot e ndristë atë natë.*<sup>238</sup>

Gazeta “Tomorri” kishte për qëllim **1.-** të përpiquej për përmbajtjen dhe forcimin e kostitucionit dhe të luftojë çdo njeri apo shoqëri që përpiket të shkelë të drejtat që jepte kushtetuta; **2.-** të përpiquej për zgjimin e ndjenjave kombëtare të shqiptarëve dhe për qytetërimin e tyre nën Perandorinë Osmane; **3.-** të merret gjithnjë me nevojat dhe mbarëvajtjen e shkollës Normale; **4.-** të ngrejë zërin nëpërmjet botimit të atyre çështjeve që prekin interesat kombëtare për botimin e të cilave vendos vetë drejtori, Lef Nosi.<sup>239</sup>

Figura të shquara, me përmasa kombëtare, si Aleksandër Xhuvani (pseud. Dokë Sula), Luigj Gurakuqi (pseud. Lek Gruda), Simon Shuteriqi (pseudo. Shkam'i Letanit), Kristo Dako etj, do të shfrytëzojnë faqet e kësaj gazete për të shprehur qëndrimin e tyre kundër politikës antishqiptare të ndjekur nga shtetet fqinje ballkanike dhe për të mbrojtur tezat e autoktonisë, gjuhës, arsimit e kulturës shqiptare.

Me një numër modest, katër faqe, gazeta pati një fillim të vrullshëm politik. Ndonëse për të siguruar mbijetesën e “Tomorrit”, artikujt që u botuan në numrat e kësaj gazete mbi zhvillimet e Lëvizjes Kombëtare, nuk kalojnë politikisht jashtë ombrellës së Perandorisë Osmane, qëndrim ky i imponuar për Lef Nosit në kohën kur situata në vend paraqitej jo pak e rrezikshme duke patur parasysh intrigat e fqinjëve ballkanikë, si edhe qëndrimin e Fuqive të Mëdha në lidhje me ruajtjen e *status-quo*- së në Ballkan. Megjithatë gazeta “Tomorri” nuk hezitoi t’i kundërvihet hapur politikës së xhonturqve që shkonte në dëm të të drejtave të shqiptarëve, arsimit e kulturës kombëtare. Që në numrin e saj të parë, gjatë parashtrimit të programit, në “Tomorri” prezantohet qartë qëndrimi politik dhe misioni që drejtuesi i saj, Lef Nosi, kishte marrë përsipër: *mbrojtjen e gjuhës dhe kombit shqiptar*.

Në prillin e vitit 1910, Aleksandër Xhuvani do të përkthjejë nga e përkohshmja “Temps” e Parisit e do të botojë në të përkohshmen “Tomorri” të Elbasanit artikullin “Austro- Hungaria dhe Besëlidhja ballkanike”, duke e përqëndruar shkrimin e tij në përpjekjet e vendeve sllave për krijimin e të ashtëquajturës “Besëlidhja Ballkanike”, e cila po merrte jetë vetëm për interesat e popujve sllavë të Ballkanit. “Një besëlidhje të tillë ne nuk e zëmë besë e si Shqiptarë nukë e dëshirojmë, përse do t’u shtonte fuqinë Sllavëvet

<sup>237</sup> “Lirija” Selanik, 1910, 20 mars, f. 3

<sup>238</sup> “Tomorri”, Elbasan, 1910, 22 mars, *Urim Tomorrit*. Petrit Përmeti

<sup>239</sup> Po aty, 30 maj, f. 1

*në dëmin t'ënë*".<sup>240</sup> Ky shkrim përbën një nga ngjarjet më të rëndësishme të trajtuara në editorinë e "Tomorrit". Identifikimi i problemeve shqiptare përmes zbulimit të synimeve të fqinjëve kundrejt Shqipërisë, bëri që në faqet e kësaj gazete, dy vjet para shpalljes së pavarësisë, të hidhet ideja e një Shqipërie të lirë e kushtetucionale e cila, në rrethanat aktuale politike, e kërkonte zgjidhjen brenda Perandorisë.

Në të përkohshmen "Tomorri" u botuan edhe pjesë të veprave të Hanit, shkrimet letrare të themeluesit të albanologjisë, Kostandin Kristofor Elbasanit (Kostandin Kristoforidhit- shënimi im), dëshmitë e sjella nga Kristo Dako mbi origjinën e shqiptarëve dhe burimin e gjuhës shqipe, abetarja e Dhimitër Paparistos "për shkollat fillore meshkujsh e femnash në ligjërojtë t'Elbasanit" etj.

Kontributi konkret që Lef Nosi dha në hapjen e shkollës Normale, tashmë do të pasohet me vendin e veçantë që ai do t'u lërë në "Tomorri" rubrikave kushtuar veprimtarisë e veprimtarëve të Normales: "Duhet të na gëzohen zemrat dhe të na forcohen shpresat për punën që asht bamun gjer më sot në fushë atdhesie për përparim e çështjes sonë kombëtare. – do shkruhej në faqet e kësaj gazete në prill të vitit 1910.- Vepra e shkëlqyer e Kongresit të Elbasanit, e cila asht një nga veprat ma të bukura edhe ma të lavduarshme me të cilat mund të mburremi dhe mund t'i kallëzojmë botës së qytetëruarë që për ne leu një kohë të re, një kohë shprese për përfitim të math të kombit na dhuroi të vlerëshme dhe atdhetarë të vërtetë të cilët të pajisur me dituni të kulluarë dhe me arësim krejt kombtar do të jenë padyshim nj'ata apostuj e shenjtëruarë që kanë për të derdhun gjithmonë djersën e tyre dhe kanë për me të punuar me dëshirë të hekurtë për të ngrehun mbi themelet e forta që kanë hedhun gjer më sot mundimet e të kaq atdhetarëve, atë ndërtesën madhështore të idealit tonë, i cili përmbledhet në zhvillësën mendore dhe qytetënimin e amës Shqipëni".<sup>241</sup>

Ndonëse çështja kombëtare kishte përparësi, të përkohshmes së Elbasanit nuk i munguan artikujt e karakterit informativ mbi të rejtat më të fundit politike, ekonomike, arsimore e kulturore në plan kombëtar e ndërkombëtar.

Sapo kishte dalë në qarkullim numri i parë i gazetës<sup>242</sup> dhe, ndërkohë, bëhet e ditur shkrirja, më 13 mars 1910, i klubeve "Bashkimi" e "Vllaznia" në një organ të vetëm (klub) me emrin "Bashkimi i ri", ku Lef Nosi ishte zgjedhur nënkryetar i këshillit drejtues i kryesuar nga Hysen Hastopalli, me anëtarësimin e Ahmet Daklit, Emin Haxhiademit, Demir Sulçes, Shefqet Daiut, Qamil Haxhifezës, Ali Çiftes e Simon Shuteriqit.<sup>243</sup> "E bashkuemja e këtyne dy fuqiave – shkruhej në faqet e "Tomorrit" – u prit me gëzim të math prej gjithë qytetit edhe shprehet [shpresohet] se pas këtaj një jetë e re e plot veprim nis për propagandën kombëtare këtu në qytet t'onë".<sup>244</sup> Përmes aktivitetit të shumëanshëm të patriotëve elbasanas,

<sup>240</sup> Po aty, 20 prill, f. 1

<sup>241</sup> Po aty, 10 mars 1910, f. 1

<sup>242</sup> Numri i parë i saj doli më 10 mars 1910 e vazhdoi deri në numrin e 13- të të datës 10 gusht 1910.

<sup>243</sup> "Tomorri", Elbasan, 1910, 31 mars, f. 4

<sup>244</sup> Po aty

ky klub i zgjeruar punoi dhe veproi më tej për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare dhe lëvizjes patriotike të popullit të Elbasanit, jo vetëm për të mbrojtur e përhapur arsimin shqip, por edhe për zgjerimin e lëvizjes së armatosur antiturke në vitet 1911- 1912.

Qysh prej fillimeve të tij, përkushtimi politik i Lef Nosit ishte i lidhur me zhvillimin e dijes e të kulturës, ishte shprehur me veprimtarinë krijuese e studimore të të dhënave gramatikore të shqipes që në kohët e vjetra, e tashmë pasqyrohej në botimin në “Tomorr”, të pjesëve të marra nga i pari libër në gjuhën shqipe të Gjon Buzukut: “Këtë copë...e botojmë me gëzim të math se asht mjaft e interesçme për ata që i bajnë prapa letraturës shqipe... do të shkruante drejtuesi i gazetës “Tomorri” - Gjith kush që sheh t’shkuarën e vjetër e të folët e sotme, mund të shohë sa t’paka e të vogla janë ndryshimet ndër djalektet të Shqipërisë; më kujton edhe se arbëreshët të Siçilias që ikën të shumtë nga Arbëria, sa të dëlirme e ka mbajtur gjuhën te dheu i huaj”.<sup>245</sup>

Angazhimi i Lef Nosit për çështjen kombëtare, përmes botimeve e shkrimeve në “Tomorr”, u mbështet dhe u lëvdua edhe nga atdhetarë shqiptarë në kolonitë e mërgimit. Në gazetën “Sopata” të Jani Vruhos, në Egjipt, në verën e 1910-ës, do të botohet një artikull që fliste për Elbasanin dhe historinë e tij, por ku, veç të tjerash, vihet theksi tek rëndësia e gazetës “Tomorri” dhe patriotizmi i drejtuesit të saj, Lef Nosit. “...Merrem me rregull fletën e nderime e plot pëlqim “Tomorre” këjo fletë q’ë e cila na bie erë Shqipëri, atdhesi, erë lule, erë gjthe e trëndelinë te shqiptarët, me shkrime të pastërta, me fjalë të ëmbëla eplot mallëngjim, përdorimi pendës të cilat shkruajn në këtë fletë anë më të rrallat sot në Shqipëri Kombëtar. ...Fjalë të gjalla plot shpirt, fjalë t’ëmbëla e të pëlqyera, këshilla të shqiptarta siç e do koha. Kush nuk do ta ketë kënduar ka humbur kohë. O burrani pra kërkoni tek i flakti Atdhetar z. Lef Nosi, Elbasan, Albania”.<sup>246</sup>

Gjatë vitit 1910 pakënaqësia e shqiptarëve, sidomos në Shqipërinë e Veriut, ndaj politikës së turqve të rinj për mbledhjen e taksave, për grumbullimin e armëve e të rekrutëve, kishte marrë formën e një lufte të armatosur kundër regjimit xhonturk. Qeveria reagoi për të penguar zgjerimin e kryengritjes së shqiptarëve përmes organizimit të një ekspedite ndëshkimore të kryesuar nga Shefqet Turgut Pasha, një prej gjeneralëve më të zotë të ushtrisë osmane, që nuk përfillte as ligj e as kushtetutë, i cili mbërriti në Elbasan në gusht të 1910-ës. Politika xhonturke ndeshi në kundërshtimin e menjëhershëm të deputetëve shqiptarë, që ngritën zërin në parlament për të ndalur zbatimin e ekspeditave ushtarake dhe, nga ana tjetër, kërkuan zbatimin e reformave rrënjësore në Shqipëri.

Situata e rëndë në viset e kryengritjes dhe në të gjitha trevat e tjera shqiptare, si edhe reagimi e qëndrimi i rretheve patriotike brenda vendit e në kolonitë shqiptare, gjeti pasqyrim të plotë në faqet e gazetës “Tomorri” ku krahas artikujve me frymë patriotike e karakter kombëtar, u botuan edhe artikuj të

<sup>245</sup> Po aty, 30 qershor, f. 1

<sup>246</sup> “Sopata”, nr. 2, 1 gusht 1910, f. 4

përkthyer, marrë nga shtypi evropian: “Ndë Ipek e ndë Prishtinë, ndë Çernalovë e ndë Kaçanik, ndë Rekë e ndë Gjakovë, tymi i barutit ka mbuluar rreth e rrotull qiellin si një mjergull sëmundjesjellëse e fatzezë; arat po ujiten me gjak... katundet po digjen, shtëpiat po rrëzohen, mëmat po mbeten pa djem, atdheu pa ushtarë... Vallë cili është shkaku i kësaj mënxyrë të madhe, i këtij tmerri, i këtij shkretimi, i këtij shëmtimi pa shok...?”<sup>247</sup>

Duke shfrytëzuar faqet e kësaj gazete deputetët shqiptarë, Hasan bej Prishtina, Nexhip bej Draga e Ismail Qemal Beu, fajësuan qeverinë e cila dërgonte ushtarë kundër shqiptarëve që kërkonin udhë e shkronja: “A thua qeveria kujton me të vërtetë se vetëm me pushkë e me topa mund të rrëfëhet fuqia, se vetëm me zjarr e me gjak mund të sjellet ndë udhë të drejtë populli...? Përgëzimet që i vijnë qeverisë nga shtetet fqinje e sidomos nga sllavët, për sjelljen e saj të ashpër kundra shqiptarëve, kanë një qëllim jo të mirë; ata gëzohen jo për fuqien e qeveries por për dobësimin tonë...Kështu ato do të mund t’i kryejnë lakmimet e tyre mbi Stara Serbien...!”<sup>248</sup>

Ngjarjet në Shqipërinë e Sipërme sollën reagime jo vetëm të ambjenteve patriotike shqiptare, por edhe të opinionit ndërkombëtar, i cili u pasqyrua në “Tomorri” përmes botimit të përshtypjeve të z. Berezovski, bashkëpërgjegjësit të ditarit “Novoie Vremya” me shkrimin: Nga ditari frëngjisht - “La Turquie”. “Qeveria do dërgojë ushtarë drejt Shqipërisë Veriore, do t’i luftojë shqiptarët me rreptësi e do ta mposht lëvizjen... - do të shkruhej në gazetën “Tomorri” në maj të 1910-ës - Por do të vijë një kohë e shqiptarët do të ngrihen përsëri...e Perandoria s’ka për të shpëtuar kurrë nga turbullimet dhe kryengritjet e brendshme; zjarrin do ta ketë gjithmonë në vatër...

Përkundrazi, është e nevojshme që qeveria të përmisojë shtetin ekonomik të tyre, t’u çel rrugën e qytetërimit e të përpiket për arsimimin e tyre përmes të cilit arrihet zhvillimi i vërtetë dhe përparimi i sigurt...Në vend që të hap andej- këtej shkolla në gjuhë turke, në vend që të shpenzoj duke luftu bijtë e saj e duke derdh gjak të pafajshëm, është më e udhës të çel në çdo qytet e fshat të Shqipërisë shkolla në gjuhën shqipe, t’u ndriçoj mendjen e shpirtin me dijet më themelore dhe jo t’i ashpërsojë duke i vrarë pa mëshirë”<sup>249</sup>

Shumë prej këtyre artikujve, për kohën kur u shkruan, binin ndesh me interesat e xhonturqve, të cilët kërkonin jo vetëm të shtypnin qëndresën e armatosur të shqiptarëve, por të likujdonin edhe vatrat e organizmat e lëvizjes kombëtare, të mbyllnin klubet e shoqëritë patriotike shqiptare. Nacionalizmi u bë përsëri një shkelje ligjore që dënohej me syrgjynosje, vdekje e konfiskim pronash. Në shumë raste jepeshin të treja dënimet për të njëjtin krim. “Elbasani, si një nga qendrat më të mëdha të Shqipërisë së Mesme dhe asaj Veriore – shprehet Charl T. Erickson në kujtimet e tij, - ndjeu i pari goditjen e përgjakshme e mizore të

<sup>247</sup> “Tomorri”, Elbasan, 1910, 20 prill, Ngjarjet e Kosovës, Lek Gruda

<sup>248</sup> Po aty, f. 1

<sup>249</sup> Po aty, 30 maj 1910, f. 2



dhunës xhonturke... Në 1910-ën u pa se turqit e rinj nuk ishin gjë tjetër veçse turq të vjetër reaksionarë, por me mjekër të rruar.”<sup>250</sup> Vizita e Turgut Pashës në Elbasan do të ruhet gjatë në kujtesën e banorëve. Si fillim ai i vendosi forcat e tij të armatosura, prej disa mijëra trupash, në pozicionet përreth qytetit në mënyrë që të shmangte çdo mundësi për t’u larguar. Më pas ai shpalli ndalim qarkullimin në tërë qytetin, duke lejuar vetëm një orë qarkullimi ditën e dytë dhe të tretë, në mënyrë që popullata të furnizohej me ushqime, kryesisht bukë. Pas kësaj rrugët e qytetit u pushtuan nga trupat xhonturke që qarkullonin pa pushim, rrugicë më rrugicë dhe shtëpi më shtëpi, duke kërkuar armë e çdo gjë që ishte botuar në gjuhën shqipe. “Turkofilë, grekofilë, spiunë e tradhtarë, shumica e të cilëve dihej se kush ishin- shkruante Erickson për situatën e rëndë të atyre ditëve, - filluan t’i denonconin emrat e të gjithë shqiptarëve, të cilët kishin marrë pjesë në lëvizjen kombëtare ose kishin shfaqur simpati e entuziazëm për çështjen kombëtare... Një numër i madh shqiptarësh të tillë, tani filluan të burgoseshin... Kontrollimi i qytetit, jo për “pushkë e gjalpë”...por për pushkë e libra që një bastisje sistematike dhe e rreptë.”<sup>251</sup> Në qytet, Shefqet Turgut Pasha hartoi listën e personave që do të arrestohen nën akuzën: “Asht përpjekë për *abecenë* latine,...ka lidh miqësi me të krishterët, ka sjellë gazeta e libra shqipe etj”, dhe përkrahësit e mësimi shqip i cilësonte si “banditë e kriminelë”.<sup>252</sup>

Filloi vala e arrestimeve, burgosjeve e internimeve të atdhetarëve shqiptarë përmes gjyqeve speciale. Pre e terrorit xhonturk u bë edhe Lef Nosi, drejtori i gazetës “Tomorri”, jeta e të cilit u rrezikua seriozisht. Me vendim të qeverisë u mbyllën të gjitha shkollat shqipe, u ndalua nxjerrja e gazetave dhe botimi i librave në gjuhën shqipe. Pasi u mbyll shkolla Normale, në 7 gusht të vitit 1910 në orën 11.30 të mbrëmjes, arrestohet e burgoset në Elbasan “patrioti veteran”, Lef Nosi. Në 9 gusht, i lidhur me zinxhirë, ai dërgohet për gjykim drejt Dibrës.<sup>253</sup> “Në ora 1 të drekës – do të shkruante L. Nosi në ditarin e tij personal – sosëm në Labinot dhe në 3 në han të Mirakës..” nga ku ai do të largohet po atë ditë bashkë me dy xhandarë kalorës që e shoqëronin. “Në mbramje arritëm te Kroji i Zgozdës, në Lunik – kujtonte Lef Nosi – dhe të nesërmen, në 10 gusht, në 11 të mbramjes, hymë në qytet të Dibrës.”<sup>254</sup> Të nesërmen Lef Nosi doli përpara Gjyqit Ushtarak ku u mor në pyetje për vetëm gjysëm ore. Në 13 gusht ai, i shoqëruar nga një xhandar dhe dy ushtarë rezervistë, u nis për në Manastir. Mbrëmjen e kalon në Ohër ku mbahet i burgosur dhe pas tre ditë udhëtimi arrin në Manastir ku dërgohet menjëherë në burg sëbashku me Demir Pashë Peqinin, Mustafa Dritën, Qamil bej Biçakun, Hafëz Ibrahimini etj, të gjithë të burgosur “për çështje kombëtare”.<sup>255</sup> “Ishte një dhomë përdhese me lagështirë – do të shkruante L. Nosi në ditarin e tij – nga e cila dilja veç dy herë në ditë

<sup>250</sup> Erickson, Charls Telford. *5 vjet në Shqipëri*, Tiranë, 2003, fq. 55. Gjatë bastisjes së 1910-ës u kontrollua edhe shtëpia e misionarit amerikan, Erickson, në të cilën u gjetën disa dhjetra libra shqip: abetare, poezi, një histori e shkurtër e Skënderbeut, pjesë të zgjedhura të Biblës në shqip etj, për të cilat ai u detyrua të largohej nga Elbasani për në Manastir, për t’u rikthyer në tetor të 1911-ës.

<sup>251</sup> Erickson, Charls Telford. *5 vjet në Shqipëri. 1980-1913*, Tiranë, 2003, fq. 54

<sup>252</sup> Myzyri, Hysni. *Shkolla Normale...*, Tiranë, albPAPER, 2004, fq. 257

<sup>253</sup> Vllamasi, Sejfi. *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897- 1942)*, Tiranë, 1995, fq. 36

<sup>254</sup> AQSH, F. 32, D. 30, f. 5

<sup>255</sup> Gazeta “Koha”, Korçë, 12 shtator 1925, f. 1.

nga gjysëm ore për me marr ajër.”<sup>256</sup> Takimet me miqtë, që vinin tu jepnin zemër e durim atdhetarëve të burgosur shqiptarë, bëheshin gjithnjë e më të vështira. “Shtërëngimi i Qeverisë Tyrke ishte kaq i madh as që asndonjëri nuk guxonte që të pyesë e jo ti vështrojë (takoje-E.A) ata”.<sup>257</sup> Nga Gjykata Ushtarake e Manastirit atij iu dha dënimi kapital, me vdekje. Vetëm pas ndërhyrjeve të patriotëve shqiptarë, deputetë në parlamentin turk, u bë e mundur që dënimi të kthehej në internim. Vendi i internimit ishte Anadulli. Megjithatë për më shumë se një muaj ai do të vazhdojë të mbahet i burgosur. Në 21 shtator 1910, L. Nosi e nisnin me tren për në Selanik. Kur mbërrin atje e dërgojnë në një dhomë, në katin e parë të Prefekturës, ku mbaheshin të gjithë ata që paraburgoseshin.<sup>258</sup> Ndërsa kërkesa e tij, për ndryshimin e vendimit, nuk u mor parasysh, Lef Nosi vazhdon të mbahet i burgosur çka dëmtonte edhe shëndetin e tij. “Meqë mbajtja në burg e një njeriu si unë, i dënuar me internim – do të shkruante Lefi nga burgu - është një masë më e fortë se dënimi i dhanë dhe sidomos i shtyrë deri në atë shkallë sa që efektet shkatërruese të lagështirës së vendit ku mbahem i burgosur ka vën në rrezik edhe jetën time, çka është edhe kundra drejtësisë dhe njerëzimit, lutem të vihet në zbatim vendimi për të më dërguar në vendin e internimit”.<sup>259</sup> Vetëm pas dy javësh, në 4 tetor, L. Nosi e nisnin për në Stamboll, ku mbërrin të nesërmen, dhe më pas, në 8 tetor, e dërgojnë në Brusë (Anadoll).<sup>260</sup> Por pasojat e qëndrimit në burg, për të tretën herë në jetën e tij 33- vjeçare, u shfaqën edhe gjatë kohës së internimit të tij. “... shumë u hidhëruam për sëmundjen gastrike që hoqe i huaj ndër të huaj – do t’i shkruaj i vëllai, Nikolla, në janar të 1911-ës, - por shqyr që ishte e shkuar dhe Zoti të ruajtë dhe të bëjë rojë të të kthejë shpejt në atdhe, për gëzimin e të gjithëve”.<sup>261</sup>

Shkakun, shkrimet në tre numrat e “Tomorrit”, dhe llojin e dënimit, internim i përjetshëm në Brusë, Lef Nosi e mëson tek ndodhej në burgun e Manastirit, vendim të cilin ai jo vetëm që e quan të jashtëligjshëm e antinjerëzor, por edhe shprehje të hapur të dhunës dhe të absolutizmit; mendim ky i parashtruar edhe në letër- kërkesën për pafajësi që ai ia dërgon si kryetarit të Gjyqit Ushtarak në vilajetin e Manastirit, ashtu edhe në drejtim të Kryeministrit dhe deputetëve shqiptarë (Hasan Prishtinës e të tjerëve) në parlamentin xhonturk.

*“I nënshkruemi – do të shkruante Lef Nosi në letrën e sipërpërmendur- jam nga populli i sanxhakut të Elbasanit, dhe pas shpalljes së luftës me qëllim që t’i shërbej atdheut të shenjtë dhe përparimit të arsimit, si edhe për të ndriçue mendimet, me cilësinë e redaktorit dhe drejtorit përgjegjës, isha duke nxjerrë në qytetin e Elbasanit..., një fletore politike, shkencore e tregtare në gjuhën shqipe me emrin “Tomorri” në konformitet me dispozitat e ligjit mbi shtypin duke arritur deri në numrin e 13- të pa u bërë objekt i asnjë*

<sup>256</sup> AQSH, F. 32, D. 6, f. 6

<sup>257</sup> “Koha”, Korçë, shtator 1925, nr. 237, f.1

<sup>258</sup> AQSH, F. 32, D. 6, f. 7

<sup>259</sup> Po aty, D. 8, f. 24

<sup>260</sup> Po aty, D. 30, f. 7

<sup>261</sup> Po aty, D. 57, f. 12-13

vërejtje. Që kur u shpall shtetrrrethimi në qytetin e Dibrës, për shkak të përmbajtjes së 4 artikujve,<sup>262</sup> që mbase nuk janë kuptuar mirë qëllimet e tyre të vërteta, me akuzën se janë të dëmshme, me vendim të Gjyqit Ushtarak të Dibrës u internova përjetësisht në vilajetin e Bursës, vendim ky i cili, siç shihet edhe nga kuptimi i vërtetë i artikujve, është krejtësisht në kundërshtim me drejtësinë dhe kushtetutën. Sipas mendimit tim – vazhdonte letrën e tij L. Nosi, - nuk shoh ndonjë shkak përgjegjësie në botimin, më 10 qershor 1910, të artikullit të nxjerr nga gazeta “Temps” e Parisit, “Nga vendet e kryengritjes”. Gjendja luftarake e shqiptarve, ku pasqyrohet taktika luftarake e shqiptarëve kundër ushtrisë otomane e përmbledhur në këto pika: 1- Kur ushtria otomane sulmon me fuqi të madhe shqiptarët shpërndahen. 2- Shqiptarët ngrenë pusi në vendet ku kalon ushtria otomane e sulmon mbi ta. 3- Shqiptarët sulmojnë me forcë në rrugë, gryka e vende të larta ku ka zënë vend ushtria otomane. 4- Kapin municionet dhe ushqimet që iu dërgohen ushtrisë otomane. 5- Në rast përpjekjesh përdoren armët kryesisht kundër oficerave. 6- Sulmojnë natën çadrat e ushtrisë otomane. 7- Për të penguar transportimin e topave, vrasin kuajt e ushtrisë otomane.

Për shkak të taktikave të përdorura nga shqiptarët dhe vështirësive të karakterit ushtarak, klimatik e gjeografik të trevave shqiptare, me të cilat po përballet, ushtria otomane po ndjen lodhjen dhe nuk po reziston dot.

Edhe në artikullin e dytë që bën fjalë për vrasjen e një gruaje shqiptare në një përpjekje që ka ndodhur ndërmjet shqiptarëve dhe ushtrisë otomane, që edhe ky është nxjerrë nga lajmet e marra prej gazetës “Bashkimi i kombit” në Manastir, e cila në atë kohë ishte e lirë dhe vetëm pas dy muajsh u pushua për arsye të tjera, edhe në këtë rast është e qartë si drita e diellit se nuk ka gjë që të shkaktojë përgjegjësi.”<sup>263</sup>

Në artikullin e tretë Lef Nosi kishte botuar tekstualisht përmbajtjen e një letre që kishte marrë nga korrespondenti i gazetës “Tomorri” në Dibër, mbi ngjarjet në Kosovë, tekstin e të cilës ai do ta parashtrojë edhe në letër- kërkesën e tij drejtuar Gjyqit Ushtarak të Manastirit ku ndër të tjera shkruhej:

“Sado që pas mbërritjes së ushtarëve që okupuan qytete e fshatra në fushë dhe mblodhën armët, u pa se punët u qetësuan. Por meqë çështja ndryshoi, filluan përpjekje të përgjakshme. Malësorët kujtuan se kërkesat e tyre, sipas premtimit të dhënë nga Mahmut Shefqet Pasha, u morën parasysh. Por kur panë se ushtarët bastisën katundet e brendshme të Malësisë, dogjën kullat dhe arrestuan shume njerëz për shkak të kryengritjes, gjë që shkaktoi zemërimin e tyre, u përgatitën për të bërë rezistencë të fortë. 10 000 dibranë të Grykës së Vogël, të Dibrës së Poshtme e të Fushës së dibrës duke lidhur besën për të sakrifikuar jetën e

<sup>262</sup> Letrën dhe këto artikuj i kam paraqitur të plotë në punim pasi pasqyrojnë qëndrimin e L. Nosit ndaj ngjarjeve që po zhvilloheshin në vend dhe vizionin e tij politik për të ardhmen e Shqipërisë.

<sup>263</sup> AQSH, F. 32, D. 8, f. 1-3

tyre, u nisën në drejtim të Gjakovës...Përfundimi s'dihet ku do të arrij".<sup>264</sup> - do të shkruhej në artikullin e botuar në "Tomorr".

Nëse çështja është pa themel apo gënjeshtër, - vazhdonte të shkruante L. Nosi, - ajo duhet të përgënjeshtrohet nga Qeveria; dhe përsëri unë nuk shoh nga vjen përgjegjësia."<sup>265</sup>

Artikulli i katërt përmbante opinionin e Lef Nosit përmes të cilit ai kërkonte të theksonte dëshpërimin e patriotëve shqiptarë mbi ngjarjet e hidhura që po ndodhin në Shqipërinë Veriore, ku ndër të tjera ai shprehej: "Cili është ai patriot që s'i kqyr me dëshpërim ngjarjet e hidhura që po jeton atdheu ynë dhe s'derdh lot dëshpërimi? Ka shqiptar të thjeshtë sot që të mos e ketë zemrën të plagosur dhe s'e kupton me dëshpërim se mjerisht po shkojnë shumë viktima nga ky taksirat i sotëm? Në një pjesë të atdheut tonë të dashur, Shqipëria Veriore po lahet me gjak në hijen e institucionit.

Nanat po qajnë me ngashërim e kuja e tyre arrin deri në qiell; Baballarët po vriten e po shtypen; toka po lyhet me gjak. O Zot, ki dhimbisuri e zgjatja dorën tënde mëshirëmirë popullit tonë të varfër dhe shpëtoje nga ngjarjet e hidhërueshme! A nuk qenë të mjaftueshme kaq vuajtje e mundime që ka pësuar ky popull i ngratë prej kaq shekujsh; por tani i duhet të pijë edhe një gotë të hidhët?!

Duke qenë së shqiptarët kanë luftu krahë për krahë e burrisht... për madhështinë e Mbretërisë Otomane (revolucionin e 1908-ës- shënimi im) s'ka njeri me logjik që të kuptojë shkaqet e shpallurit luftë dhe përdorimit të një politike të ashpër të Qeverisë kundrejt këtij populli trim. Thonë se shkaqet lidhen me zbatimin dhe respektimin e ligjit themelor... por ta vësh një komb, i cili prej shekujsh s'njeh rregull e urdhër, nën zgjedhën e ligjit, është gabim. Është faji i Qeverisë absolute që nuk është kujdesur t'u jap kulturë institucionale të ndryshme që jetojnë në tokën otomane, e t'i fusi në rrugën e përparimit duke përhapur arsimin dhe profesionet në këto vende... Është një detyrë e shenjtë e çdo qeverie me të vërtetë institucionale të përmisojë gjendjen e vajtueshme të tyre dhe duhet t'u çeli shkolla në gjuhën e tyre amtare duke përhapur drutën e arsimit... Me top e me barot, përveç që nuk fiton gjë, por përkundrazi do të dëmtohet, pasi duke i ndjek ato pa mëshirë e me masa të padrejta e çfarosëse, do të fitoj veç urrejtjen e tyre... e do të humbas besimin e një populli trim..."<sup>266</sup>

Fjalët e Lef Nosit shërbenin si një paralajmërim për ata që mbanin në duar frerët e qeverisjes të cilët me qëndrimin e tyre mohues ndaj të drejtave të shqiptarëve dhe me politikën e tyre ndëshkuese, të vetmen gjë që fitonin ishte armiqësia e një populli të tërë. "Qeveria përpara se të merrte masa të forta kundër shqiptarëve, - shkruante në letrën e tij Lef Nosi, - le t'i hapte shkolla në gjuhën e tyre dhe të përhapte zanate, që ata me anë të shkencës dhe të ekonomisë, të korrigjojnë vehten e të respektojnë vetvetiu urdhërat e ligjet.

<sup>264</sup> Po aty, f. 4

<sup>265</sup> Po aty

<sup>266</sup> Po aty, f. 7-10

*Duke rekomandu një politik të tillë, në vend që të lavdërohesha, u internova përjetësisht e që prej gjashtë muajsh po kaloj jetën me shumë mundime e vështirësi në veri të Brusës... Duke parë se sa e padrejtë është vendimi i dhanë kundra meje, lutemi të keni mirësinë të merren masat e duhura për faljen time”.*<sup>267</sup> Nga përmbajtja e kësaj letre vihet re se Lef Nosi i përmbahet tërësisht qëndrimit politik të Lëvizjes sonë Kombëtare e cila “nën hijen e kostitucionit” përpiket të ngrejë zërin e protestës kundër politikës shtypëse e shkombëtarizuese të xhonturqve kundër popullit shqiptar dhe përpiket të nxjerrë përfitime e t’ia arrijë qëllimit duke shfrytëzuar ato pak kushte legale që ishin krijuar.

Ndërkohë Lef Nosi do të shfrytëzojë faqet e gazetës “Bashkimi” për të falenderuar atdhetarët shqiptarë që ishin përpjekur dhe vazhdonin të kërkonin lirinë e tij: “U falem nderit botërisht të gjithë atyre zotërinjve e atdhetarëve të vërtetë që u munduan e erdhën për të më parë nëpër burgjet e Elbasanit, Dibrës, Manastirit, Selanikut e Stambollit; si edhe atyre që më përcollën kur ika nga këto qytete për të ardhur në vendet e mërgimit tim”.<sup>268</sup> Ndonëse përditë qeveria osmane jepte amnisti për të burgosurit, L. Nosi vazhdon të vuaj dënimin.

Në fillim të vitit 1911, në Elbasan mbërrin një komision me tre anëtarë, i drejtuar nga Qerim Pasha, për të hetuar rreth ndjekjeve që ishin bërë prej Gjykatës Ushtarake. Nëna e L. Nosit, Ana, e shqetësuar për shëndetin e të birit dhe për burgimin e tij të padrejtë, shkon vetë në Bashkinë e qytetit dhe i dorëzon komisionit kërkesën për lirinë e djalit, Elefther Nosit. Disa ditë më vonë mbërrijnë në Prefekturën e Elbasanit disa të dërguar nga ana e Qeverisë, të cilët filluan të pyesin për shkaku e arrestimit dhe dënimit të tij. Përgjigja që ata morën, bashkë me dosjen e gjyqit, ishin tre numrat e sekuestruar (8- 10- 11) të gazetës “Tomorri”.<sup>269</sup>

Ndërsa koha kalonte, familjarë dhe bashkëatdhetarë të tjerë, përveç letrave dërguar deputetëve dhe kryetarit të Parlamentit, do t’i drejtohen edhe gazetës “Shqiptari” për të ngritur zërin e për të kërkuar lirinë e Lef Nosit, “për të dhënë lirinë që aqë padrejtësisht i është hequr...”.<sup>270</sup> Telegrami u redaktua në greqisht e më pas edhe në turqisht, madje “sipas rekomandimit të bashkëatdhetarit tonë Dervish Beut – do ti shkruante Nikolla, të vëllait, Lefit, në burg – i dërguam me postë edhe tre numrat e “Tomorrit” në bazë të të cilave u dënove, që të paraqiten atje ku duhen për të ndriçuar të vërtetën dhe ngrirjen e interpretimit të keq që u bërë viktimë”.<sup>271</sup> I ndodhur në Brusë, shumë larg Shqipërisë, për L. Nosin i vëllai, Nikolla, do të bëhet syri dhe dora që do t’i shkruaj për problemet shqiptare e për miqtë e Shqipërisë. “Z. Erikson nuk ka ardh akoma...- do t’i shkruante Nikolla në letrën e datës 24 janar 1911 – por në vend të tij, para dy javësh erdhi z. Kenedi dhe z. Cilka me porosi të veprojnë për transkriptimin e tokave të blera pranë kalasë por, të cilin akoma nuk

<sup>267</sup> AQSH, F. 32, D. 8, f. 2- 16

<sup>268</sup> “Bashkimi”, 15 vjeshtë II, 1910, f. 4

<sup>269</sup> AQSH, F. 32, D. 57, f. 13

<sup>270</sup> Po aty, f. 15

<sup>271</sup> Po aty, f. 15

e kanë bërë për shkak të pengesave që u sjellin. Por shpejt a vonë do t'i arritim qëllimit dhe do të fillojmë të ngremë ndërtesën që kanë ndërment të befnë...”.<sup>272</sup>

Arrestimi i Lef Nosit ishte kryer në kohën kur qeveria kishte urdhëruar dhe realizuar mbylljen e shkollës Normale të Elbasanit. Pak muaj më vonë, pas shtypjes së kryengritjes, në vjeshtë të 1910-ës, u lejua zyrtarisht funksionimi i Normales, ndonëse për shkak të mungesave në mjete materiale, mësimi për atë vit nuk u bë e mundur të zhvillohej. Nga Brusa L. Nosi ndjek me shqetësim situatën e shkollave dhe mësimi të gjuhës shqipe në vend. “Zoti Dako (Kristo Dako) gjendet në Korçë, ku gjendet edhe shkrimtari i famshëm z. Peci (Sotir Peci). – do ti shkruante Nikolla nga Elbasani në letrën e radhës, - Do të vijë këtu (K. Dako) pas ardhjes së z. Erikson që tani zëvendëson në shkollën e vajzave të Korçës z. Kenedy... funksionimi i Normales u lejua zyrtarisht dhe me mirënjohje u kremtua, por fillimi i mësimave për sivjet s’është i mundur...në vend të saj thuhet se do të hapet një shkollë fillore, edhe pse dhe kjo duket problematike”.

Goditjet e xhonturqve ndaj vatrave të organizimit dhe luftëtarëve të lëvizjes kombëtare, nuk kishin dhënë rezultatet e pritura, madje kishin impulsuar efektin e kundërt; shqiptarët ishin të gatshëm që me forcën e armëve të mbronin gjuhën dhe identitetin e tyre kombëtar. “Përsa i përket dashurisë së gjuhës së nënës – vazhdonte Nikolla në letrën e tij – ajo dashuri jo vetëm që nuk është çdukur, por përkundrazi është shtuar. Sa për librat e tua - që për L. Nosit ishin pasuria më e madhe - rri i qetë, se janë të gjitha të rregulluara”.<sup>273</sup>

Kishin kaluar 6 muaj që “mëmëdhetari i ndershëm”<sup>274</sup> vuante dënimin e tij në Brusë pa ndonjë faj e për shkaqe të panjohura, por si rezultat i përpjekjeve për përparimin e lartësimin e kombit e të atdheut, që sikurse shprehet ai vetë, “...janë një shkak mburrje për mua”, kur më së fundi, pas presioneve e ndërhyrjeve të personaliteteve shqiptare tek autoritetet xhonturke, u bë e mundur që Lef Nosit ta lirojnë në 21 mars 1911. Në 1 prill ai merr në dorë letrën e Luigj Gurakuqit që i dha lajmin për lirimin e tij. “Ministria e lartë e Drejtësisë na njofton se, drejtori i gazetës shqiptare “Tomorri”, Lef Nosi, i cili ishte dënuar me internim të përjetshëm prej gjyqit ushtarak të Dibrës, u fal me dekret mbretëror”.<sup>275</sup>

Lajmi i lirimit të tij pushtoi faqet e shtypit shqiptar të kohës:

“Z. Lef Nosi u lirua!

*Nga Selaniku morëm një letër ku thuhet se z. Lef Nosi që qe dërguar në Bursë u lirua prej qeverisë e shkon për në Elbasan. Më në fund qeveria njohu pafajsinë e këtij mëmëdhetari të vërtetë...”.<sup>276</sup>*

Mbas faljes së dënimit, ai la pas Bursën, shkon në Stamboll e merr rrugën e kthimit për në atdhe. Pasi qëndron pak ditë në Stamboll, ku u mirëprit nga bashkëatdhetarët e tij dhe u përshëndet mes të tjerash me

<sup>272</sup> Po aty, f. 13

<sup>273</sup> Po aty, f. 16

<sup>274</sup> “Bashkimi”, 7 vjeshtë II, 1910

<sup>275</sup> AQSH, F. 32, D. 8, f. 1

<sup>276</sup> “Liri e Shqipërisë”, 1911, 31 mars, fq. 4



fjalët: “Atdhetari i shkëlqyer, drejtori i fletës kombëtare “Tomorri” erdhi këtu në Stamboll...ku na gëzoi fort me fjalët e ëmbla...”<sup>277</sup> kalon në Manastir, Ohër, Xhyrë dhe më në fund arrin në Elbasan në 9 prill 1911.

Ende pa mbërritur në qytetin e tij të lindjes, bashkëqytetari e bashkëudhëtari në rrugën e shqiptarizmit, Aleksandër Xhuvani, do t’i shkruajë: “Fort u gëzova kur më bane me ditë me kartolinën që më cove se u lirove e po nise për n’Elbasan...U poqa me Jani Vruhon e u gëzua pa anë për lajmen e mirë. Tani që u lirove, rri urtë e mos u ngatërro ma me “Tomorr” por shtroju punës e nxirri ma në dritë ato që po i ngroftash sa mot. Në kjoftë se me “Tomorr” e me të tjera kërkon degë përsëri, të këshilloj që mos rri n’Elbasan, po ngulu gjakunt përjashta, që të mos vujsh ma ligë se tjerat”.<sup>278</sup>

Në fakt koha kishte kaluar e politika e turqve të rinj, veçanërisht ndaj shqiptarëve, ishte krejt e ndryshme nga propaganda e ditëve të para të fitores së revolucionit xhonturk. Politika e terrorit e ndjekur prej tyre kishte forcuar bindjen tek shqiptarët se mund t’i fitonin të drejtat kombëtare vetëm me anën e kryengritjes së përgjithshme. Pikërisht në këto çaste vendimtare të luftës për çlirim kombëtar, lëvizja shqiptare ngrihet në një shkallë më të lartë dhe arrin pikën e saj kulmore me kryengritjet e mëdha antiosmane të viteve 1911- 1912, që çuan në shpalljen e pavarësisë dhe krijimin e shtetit të pavarur shqiptar. Gjendja e re e krijuar në Shqipëri i dha një shtytje të mëtejshme veprimtarisë politike të patriotëve shqiptarë. Lef Nosi, në këto momente kyçe për kombin shqiptar, do të marrë përsipër të realizojë një mision të ri.

## KREU II. NGA PAVARËSIA DERI NË PRAG TË LUFTËS SË PARË BOTËRORE (1912- 1914)

### II.1 Roli i Lef Nosit në rrugën drejt shpalljes së Pavarësisë

Pas shtypjes së kryengritjes në Kosovë (1910), ekspedita ushtarake e komanduar nga Shefqet Turgut Pasha u shtri edhe në Shqipërinë Veriore e atë të Mesme. Pasi dogjën e shkretuan, vranë e masakruan, xhonturqit pandehën se e nënshtruan popullsinë e viseve shqiptare. Në gusht të vitit 1910 gjenerali gjakatar, i njohur në popull me epitelin “Drufut Pasha”, mbërriti në Elbasan duke dhunuar figura patriotike të qytetit,

---

<sup>277</sup> “E vërteta”, mars 1911, fq. 2

<sup>278</sup> AME, F. 20, D. 10, nr. 10, f. 2

fakt i cili e acaroi edhe më tepër gjendjen, ndërsa lëvizjet e çetave të armatosura filluan të bëhen gjithnjë e më të shpeshta dhe më të mëdha.<sup>279</sup>

Gjendja e re që u krijua në vend pas egërsisë që xhonturqit treguan për të shtypur kryengritjen e 1910-ës, nxiti veprimtarinë politike të patriotëve shqiptarë tek të cilët u forcua bindja se kishte ardhur koha të rrëmbenin armët për të fituar autonominë administrative të Shqipërisë. Në fund të vitit 1910 dhe në fillim të vitit 1911, filluan përgatitjet për kryengritjen e re që ishte planifikuar të niste në pranverë të 1911-ës. Koha do të vërtetonte shumë shpejt se xhonturqit përmes shtypjes, me masa drakoniane, të kryengritjes së Kosovës kishin përgatitur fundin e tyre të pashmangshëm në Ballkan.

Në kushtet e zhvillimit të mëtejshëm të lëvizjes çlirimtare kishin nisur veprimtarinë në trevën e Elbasanit çetat antiosmane të Martaneshit, Shpatit, Bërzeshtës, e më pas edhe çeta e Byshekut të cilat kishin vendosur lidhje edhe me lëvizjen shqiptare në Maqedoni e në Kosovë. Në vitin 1911 këto çeta, në kuadrin e përpjekjeve për organizimin e një kryengritje të përgjithshme, kishin hyrë në fazën e riorganizimit.<sup>280</sup> Në pranverë të vitit 1911 me iniciativën e patriotëve elbasanas, do të krijohet në Shtërmën një “Komitet i Fshtetë” i cili kishte për qëllim organizimin dhe koordinimin e veprimeve luftarake të çetave ekzistuese që vepronin në trevën e Elbasanit duke synuar bashkërendimin e veprimtarisë së tyre edhe me çetat dhe komitetet e qyteteve të tjera veçanërisht me komitetet e krahinës së Korçës e të vilajetit të Manastirit, në mbështetje të kryengritjes që kishte filluar.<sup>281</sup> Mirëpo me përjashtim të disa aksioneve të ndërmara, ato nuk arritën të organizojnë një veprimtari luftarake në shkallë të gjerë. Vlejnë të përmenden aksionet e kryera nga Sadik Zharri, Isuf Qosja e të tjerë, kundër postës turke që transportonte shuma të mëdha të hollash, në Xhyrë dhe tek Gurrat e Zeza, në shtator 1911, nga ku u siguruan 27 mijë lira turke e angleze që ishin nisur drejt Shkodrës, një pjesë e të cilave iu dorëzua Komitetit të Elbasanit.<sup>282</sup> Një prej organizatorëve të këtyre aksioneve, në kuadrin e klubit “Bashkimi i ri” ishte edhe Lef Nosi<sup>283</sup>, i sapoliruar nga internimi në Bursë. Për të ndëshkuar popullsinë “për sulmin e pabesë dhe për grabitjen e postës otomane në sanxhakun e Elbasanit”, qeveria turke arrestoi 20 shqiptarë nga Bërzeshta dhe Shpati gjyqi i të cilëve zgjati plot një vit. Për mungesë provash shtatë shqiptarët nga Bërzeshta u liruan, kurse dymbëdhjetë të tjerët nga Shpati u dënuan nga 2 deri në 10 vjet burg dhe me zëvendësimin e shumës që mungonte nga të hollat e grabitura. Ndërsa drejtuesi i tyre, Sadik Zharri i arratisur, u dënua në mungesë me vdekje.<sup>284</sup> Ndonëse lëvizja e armatosur ishte kthyer në një domosdoshmëri, patriotët shqiptarë vazhdonin të punonin për zgjimin dhe ndërgjegjësimin e çdo shqiptari përmes gjuhës e shkollës shqipe. Nga Dibra, ku sapo kishte dalë nga burgu, Qamil Biçakçiu, i njohur si Qamil Shqiptari, do ti shkruante “zotnis n’derçëm”, Lef Nosit, në shkurt të vitit

<sup>279</sup> AME, F. 1, D. 2, f. 2. “Kujtimet e Taq Delianës”

<sup>280</sup> AME, F. 22, D. 1, f. 1

<sup>281</sup> *Elbasani-Enciklopedi*, vepër e cituar, fq. 102-103

<sup>282</sup> Po aty, f. 10

<sup>283</sup> Floqi, Thanas. *Fytyra e vërtetë e Haxhi Qamilit*, Tiranë, Sh.B.”55”, 2008, fq. 56

<sup>284</sup> AIH, Vj. 22-19-1998. Telegram i konsullit a-h, Halla, për ministrin e Jashtëm në Vjenë, Berchtold.

1911: “...lala me Gurakuqin gjinden në Stamboll dhe kan me t’sjell të holla për shkollën normale or vlla. Dibra me gjithë katunde janë tu mësu shqip dhe ju kërkojnë 5000 copë abetare...Dibra po shkon ma mir se të gjitha viset e Shqipnis...”.<sup>285</sup> Por tashmë lëvizja për shkollën e gjuhën shqipe ishte ngritur në një shkallë më të lartë dhe të drejtat e tyre shqiptarët kërkojnë ti arrijnë përmes grykës së pushkës.

Me gjithë zhvillimin në rritje, kryengritja e vitit 1911 nuk u kthye në një kryengritje të përgjithshme. Në rrethet e përparuara patriotike filloi të pique mendimi se kishte ardhur koha për përgatitjen e një kryengritje të re mbarëshqiptare. Fillimi i luftës italo-turke, pas aneksimit italian të Tripolit (shtator 1911), tregonte se *status quo*-ja tashmë ishte prishur dhe kjo do ti jepte zemër shteteve ballkanike për tu hedhur në luftë kundër Turqisë, duke rrëmbyer edhe tokat shqiptare. Mirëpo mungesa e armëve dhe e materialeve të tjera e vështirësuan mjaft vazhdimin e mëtejshëm të kryengritjes.

Zhvillimet politike në Perandorisë Osmane në fillim të vitit 1912 çuan në acarimin e situatës politike në trevat shqiptare sidomos në ato veriore ku kishin nisur përgatitjet për shpërthimin e një kryengritjeje të përgjithshme.<sup>286</sup> Nga ana tjetër edhe sllavët e Ballkanit, të strehuar nën ombrellën e politikës ruse, kishin filluar të thurnin rrjetin e aleancave të fshehta që Rusia mendonte t’i përdorte për të marrë Stambollit. Që prej shkurtit të 1912-ës ata bënë plane për të shpëputur territore të ëndërruara nga plaçka turke në Ballkan. Ishin plane që prej kohësh prisnin momentin të realizoheshin. Mirëpo fillimi i shkatërrimit të Perandorisë Turke erdhi prej vetë asaj. Frika e një Shqipërie autonome, që përfshinte të katër vilajetet shqiptare, shpejtoi fillimin e luftës ballkanike. Revolta e shqiptarëve solli rrënimin e xhonturqve. Për shkak të qëndrimit të pavendosur të qeverisë, të cilës i kishin rrëshqitur tërësisht frerët nga duart, anarkia ishte shtuar dhe situata ishte përkeqësuar.<sup>287</sup> Në kushtet e përballjes me politikën e egër që xhonturqit vazhdonin të ndiqnin ndaj shqiptarëve, në fillim të vitit 1912, drejtuesit e Lëvizjes Kombëtare nisën punën për organizimin dhe bashkërendimin e veprimeve të çetave të armatosura në të gjitha trevat shqiptare.

Në këtë kohë (1912) në përputhje me strategjinë e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, edhe në Elbasan u veprua me kujdes e maturi për të kaluar, pa mëdyshje, nga faza e shpërthimit të urrejtjes në mënyrë spontane e të kufizuar në atë të organizimit të hapur luftarak përmes krijimit të çetave vullnetare antiosmane.<sup>288</sup> Në këto kushte ishte detyrë e çdo patrioti të mendonte për shpëtimin e vendit i cili po përballlej me goditjet e vazhdueshme dhe arbitraritetin e Perandorisë Osmane. Zhvillimi i mëtejshëm i lëvizjes çlirimtare dhe politika e xhonturqve në Shqipëri forcuan bindjen tek Lef Nosi se rruga e shpëtimit të vendit ishte siguri i autonomisë me armë në dorë. Tashmë vendin e “luftës me penë” e kishte zënë angazhimi i Lef Nosit në lëvizjen e armatosur që kishte përfshirë vendin kundër terrorit xhonturk. Madje ai

<sup>285</sup> AME, F. 22, D. 6, f. 1

<sup>286</sup> Shatri, Muhamet. *Dokumente franceze për Shqipërinë dhe shqiptarët më 1912*, vëll. II, Tiranë, Toena, 2012, fq. 40.

<sup>287</sup> AIH, Vj. 22-6-646, nr. 3140. Teleg. i konsullit a-h në Manastir, Halla, për ministrin e Jashtëm në Vjenë, Berchtold.

<sup>288</sup> Kotherja, Hyqmet. *Historiku i Bashkisë së Elbasanit 1912- 2002*, Silver, 2003, fq. 24

organizon e drejton edhe çetën që vepronte në fshatrat Seltë e Nezhan të përbërë nga 23 luftëtarë.<sup>289</sup> I pozicionuar hapur kundër politikës qeveritare, Lef Nosi bashkë me trembëdhjetë përfaqësues të tjerë të parisë së qytetit, me Irfan Ohri, Hasan Biçakun, Ahmet Daklin, Abdulla Beun, Beqir Plangaricën etj, detyrohen të arratisen nga Elbasani dhe një pjesë e tyre nisen për tu bashkuar me kryengritësit në Dibër.<sup>290</sup> Kontaktet mes Elbasanit dhe forcave kryengritëse ishin bërë edhe më të shpeshta që prej qershorit të 1912-ës,<sup>291</sup> fakt i cili dëshmon për përpjekjet që bëjnë veprimtarët elbasanas për të koordinuar, në kuadër të kryengritjes së përgjithshme, veprimet e armatosura në trevën e Elbasanit me ato në shkallë kombëtare. Sipas raportimeve të konsullit austro-hungarez në Manastir, gjatë kësaj kohe (v.1912) ishte vënë re se shumë përfaqësues të parisë së Shqipërisë së jugut e të veriut ishin bashkuar me trupat e arratisura. “... *Kjo vlen për sanxhakun e Ohrit, të Elbasanit, Dibrës...*”- shkruante konsulli Halla në një njoftim dërguar kontit Berchtold.<sup>292</sup>

Me krijimin e Komitetit Revolucionar të Elbasanit, në mars 1912, lufta kundër pushtuesit kishte hyrë në një fazë të re, në atë të organizimit të veprimeve konkrete. Në fillim të muajit qershor, në shtëpinë e patriotit elbasanas, Ali Agjahut, u zhvillua mbledhja që vendosi shpërthimin e kryengritjes në trevën e Elbasanit në kuadrin e kryengritjes së përgjithshme. Në këtë mbledhje morën pjesë figura të njohura për aktivitetin e tyre patriotik si Lef Nosi, Ahmet Dakli, Hysen Sulova, Ali Çelirama, Ali Çausi, Ahmet Isai, Irfan Ohri etj. Komiteti Revolucionar i Elbasanit mori vendimin mbi krijimin e çetave të armatosura dhe caktoi personat që do të vepronin në krahinën e Elbasanit. Me përfundimin e mbledhjes, Lef Nosi nisët në drejtim të Shpatit për mobilizimin e forcave të armatosura në zonën e Gjinarit dhe të Valëshit.<sup>293</sup> Në 3 korrik, sëbashku me Gani Benë (Bungën), Servet Benë dhe Tahsim Myftiun, Lef Nosi mbërrin në Valësh ndërsa gjatë rrugës ishte takuar me Hasan Beun (Biçakun), i cili, bashkë me shokët e tij, kishte dalë për t’i pritur në Shtërmën.<sup>294</sup>

Dëshmitar dhe pjesëmarrës i ngjarjeve të vitit 1912, Lef Nosi mbledhi dhe ruajti një dokumentacion të plotë që përfshinte korrespondenca, fjalime, njoftime e kujtime të personaliteteve të ndryshme mbi ditët e zjarra që po kalonte Shqipëria.<sup>295</sup> Si një prej organizatorëve dhe drejtuesve të lëvizjes kryengritëse në zonën e Elbasanit, Lef Nosi do të përpiqet që të gdhend në kujtesën e kombit luftërat historike të shqiptarëve, “*që u trajtuan në mënyrë shtazarake*”,<sup>296</sup> për të fituar të drejtat e tyre të ligjshme. Në kujtimet që mbante një

<sup>289</sup> *Elbasani- Enciklopedi*, Elbasan, Sejko, 2003, fq. 102

<sup>290</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze 1912*, vëll. IV. Botimet Albanologjike, Tiranë, 2012, fq. 94. Përgatitur nga Ana Lalaj, Eriketa Kambo, Sonila Boçi. AIH, Vj. 22-6-646, nr. 77.

<sup>291</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze 1912*, vëll. III. Botimet Albanologjike, Tiranë, 2012. Përgatitur nga Hamit Kaba, Beqir Meta, fq. 150. Letër e konsullit a-h, Halla, në Manastir drejtuar kontit Berchtold.

<sup>292</sup> Po aty, fq. 171, dt. 27 qershor 1912

<sup>293</sup> *Normalja në traditë*, Tiranë, 1995, fq. 18-19

<sup>294</sup> AQSH, F. 32, D. 53, f. 13

<sup>295</sup> Këto materiale u bënë të njohura me botimin në vitin 1924 të “Dokumenta Historike në mbrojtje të çështjes sonë kombëtare. 1924”

<sup>296</sup> AME, F. 20, D. 10, nr. 66, fq. 1

luftëtar i njohur në zonën e Elbasanit, Xhile Liçi, ndër të tjera shkruhej: “Kur dolëm në Shpat dërguam në Elbasan që të lajmëronin kombëtarët e Elbasanit, dhe me ta sëbashku erdhi kombëtari i rrallë Lef Nosi me shokët e tij dhe na kishte prurë edhe një fotograf për të bërë fotografi si kujtim historik...”.<sup>297</sup> Ditët e korrikut të vitit 1912 janë të mbushura me letërkëmbime mes drejtuesve të kryengritjes në trevën e Elbasanit e cila arriti pikën e saj kulmore me tubimet e organizuara njëri në Kryezjarrth (10 gusht 1912) me pjesëmarrjen e çetave kryengritëse që numëronin 3 mijë luftëtarë, dhe tjetri në Bushek ku pritej veç urdhëri për t’u futur në qytet.<sup>298</sup> Lufta për çështjen kombëtare kishte mbledhur në këto tubime myslimanë e të krishterë bashkë.

Në 11 korrik 1912 Lef Nosit i vjen lajmi se Abdullah Beu (Tirana), Demir Zejnelhoxha, H. Topçia, Gani Bunga, Galo Elbasani e Sulejman Mitarja, që kishin kaluar Sulovën e kishin lënë pas Dumren, i ishin drejtuar Shpatit dhe po ngjiteshin për në vendin ku ishte lënë mbledhja.<sup>299</sup> Për në Kryezjarrth niset edhe çeta e Sadik Zharrit, i cili, siç shkruan në kujtimet e tij, “pas bisedimeve të zhvilluara në mbledhjen e gjithë çetave shqiptare në Frashër, merr rrugën drejt Elbasanit...e me flamur në dorë shfaqet në majat e Shpatit, nga ku lajmëruan Qendrën e komitetit të Elbasanit në katundin Shelcan, vend ku erdhën më pas nga Elbasani Lef Nosi me Gani Bungën e Fot Papajarin”.<sup>300</sup> Sapo ishte shpallur kryengritja e përgjithshme dhe vala e revoltës shqiptare po përhapej kudo. Elbasani, Peqini, Shijaku, Tirana e Kruja ishin krejt në duart e kryengritësve. Në Elbasan Aqif Pashë Biçaku i kishte vënë zjarrin selisë së guvernatorit, kurse Irfan beu (Ohri) kishte zënë Qafën e Balicës në rrugën e Manastirit.<sup>301</sup> Sadik Zharri me çetën e tij u lajmëruan nga qendra e komitetit të Elbasanit për t’u bashkuar me çetën e përgjithshme në Kryezjarrth. Aty u pa se ishin mbledhur të gjithë idealistët si L. Nosi, I. Ohri, G. Bunga etj.<sup>302</sup> Në 10 gusht paria shqiptare e sanxhakut të Elbasanit, e ikur me mbështetësit e saj, gjithsej rreth 1000 vetë, u mblodh në fshatin Kryezjarrth, rreth 6 kilometra në jugperëndim të Elbasanit, dhe prej atje i paraqitën mytesarifit kërkesën që të lejohen për t’u lidhur telegrafisht nga qyteti me komisionin qeveritar në Prishtinë dhe Hasan Beun. Pas bisedimeve të gjata me qeverinë, një delegacion prej tetë vetash i kryengritësve, anëtar i së cilit ishte edhe Lef Nosi,<sup>303</sup> të cilit iu bë një pritje e stuhishme prej një turme prej mijëra vetash në hyrje të qytetit, vajti në zyrën telegrafike dhe njoftoi Hasan Beun për miratimin prej tyre të kërkesave të shqiptarëve të Veriut.<sup>304</sup> Forcat kryengritëse të Elbasanit kishin planifikuar hyrjen në qytet që më 6 gusht të 1912-ës dhe prisnin vetëm udhëzimet e Hasan Prishtinës. “Në 6 do nisemi prej Busheku nga Ura e Shkumbinit drejt e në Namazgja. Pas bisedimeve prej

<sup>297</sup> Po aty, nr. 68, fq. 9

<sup>298</sup> *Normalja në traditë*, Elbasan, 1995, fq. 20

<sup>299</sup> AME, F. 20, D. 10, f. 1

<sup>300</sup> Po aty

<sup>301</sup> AIH, Vj. 22-18-1843

<sup>302</sup> AME, F. 20, D. 10, nr. 71, f. 5-7

<sup>303</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. IV, fq. 291-292. AIH, Vj. 22-17-1771, Manastir, 15 gusht 1912. Delegacioni përbëhej nga Irfan Ohri, Lef Nosi, Abdulla Beu, Gani Bunga, Ahmet Dakli, Asllan Shahini, Ali Çausi e Hysen agë Bajraktari.

<sup>304</sup> AIH, Vj. 22- 17-1771, nr. 90, viti 1912.

aty...do shkohet nga Drithmat e nga Bezistani drejt në Hyqymet”.<sup>305</sup> Ngjarje e cila u bë e mundur pak ditë më vonë.

Pas mbledhjes në Kryezjarrh, grupi revolucionar që do të shkojë në zyrën telegrafike të qytetit të Elbasanit, i përbërë nga 8 anëtarë mes të cilëve edhe Lef Nosi, dhe i kryesuar nga Irfan Ohri i bënë të ditur prefekturës së Elbasanit: “Na shqiptarët dolëm në mal me armë në dorë si kryengritës për me kërkue e me nxjerrë të drejtat t’ona e lirinë e vërtetë mbasi ç’prej katër vjetvet na u grabit çdo e drejtë dhe u trejtuem as me qenë robë të privuem prej çdo të drejte qytetnore...Po shofim se ndër zonat revolucionare të akcjonit t’onë, herë- herë, po enden ushtarë e gjindarmë. Prandaj që të mos dredhet gjak në rast të ndonjë takimi me ta, të tërhiqen prej këndeje...Për të ba të dijtun këtë gja, të gjitha çetat e Prefekturës së Elbasanit të mbledhuna në Kryezjarrh, redaktojnë këtë manifestë dhe ia paraqesin Qeveris s’Elbasanit”.<sup>306</sup>

Zhvillimi i mëtejshëm i situatës varej në rradhë të parë nga fakti nëse qeveria do të tregohej e arsyeshme ndaj kërkesave kombëtare të shqiptarëve për të siguruar një përmissim të situatës ekonomike dhe garantim të vetëqeverimit administrativ të tyre.<sup>307</sup> Mirëpo përgjigja vonon të vijë. Në këto kushte, me përfundimin e mbledhjes në Kryezjarrh, forcat kryengritëse iu drejtuan Busheku ku do të ngrihej qendra e veprimeve luftarake. Prej këtu do të pritej veç urdhëri për t’u futur në qytet. Nga Busheku Lef Nosi, bashkë me Emin Matraxhiun, nisen për në Valësh, e nga aty Lefi shkon në Shpat për të mbledhur shokët e tij. Nga Shpati ai do të shkruajë: “Sot erdhëm një komision 5 vetësh në qytet e po merremi vesh me telegraf me Hasan be Prishtinën në Ferizovik (Ferizaj - Shënimi im). 1000 shokë të armatosur i kemi lanë rreth qytetit. Çeta ime ka 150 shpatarak. Sot do të ikim e do të bashkohemi me shokët”.<sup>308</sup> Ndërkohë një pjesë e delegacionit të shqiptarëve të Elbasanit ishte nisur drejt Vlorës për të rënë në ujdi me Ismail Qemal Beun.<sup>309</sup>

Zhvillimi i shpejtë i ngjarjeve dhe domosdoshmëria për bashkërendimin e veprimeve të armatosura të zhvilluara në trevën tonë me ato në shkallë kombëtare në kuadrin e kryengritjes së përgjithshme, u reflektua edhe në veprimtarinë e Komitetit Revolucionar të Prefekturës së Elbasanit ku bënte pjesë edhe Lef Nosi. Dorëheqja e qeverisë xhonturke më 17 korrik 1912, u shoqërua me fillimin e bisedimeve me komisionin qeveritar turk. Në lidhje me çështjen e përfaqësimit në këto bisedime, Komiteti Revolucionar i Elbasanit, i përfaqësuar nga Irfan Ohri, Hasan Beu dhe Sheh Hyseni të cilët kishin shkuar në Prishtinë për të mbështetur kërkesat e memorandumit të dalë nga një kongres i krerëve shqiptar, i mbajtur pak kohë më parë në Vlorë,<sup>310</sup> në emër të 1000 kryengritësve të mbledhur në Kryezjarrh, vendosi t’ia delegojë të drejtën e përfaqësimit të kërkesave të kryengritësve të rajonit, Hasan Prishtinës. “As rrethanat, as koha nuk na premtojnë me çue një delegat të posaçëm për me ardh në kontakt me komitetin e atyshëm për një

<sup>305</sup> AME, F. 22, D. 10, f. 134

<sup>306</sup> AME, F. 20, D. 10, nr. 67, f. 8

<sup>307</sup> AIH, Vj. 22-6-651. Raport i konsullit a-h në Manastir, Halla, drejtuar minisrit të jashtëm në Vjenë, Berchtold.

<sup>308</sup> AQSH, F. 32, D. 132, f. 34

<sup>309</sup> AIH, Vj. 22-17-1771, nr. 90

<sup>310</sup> AIH, Vj. 22-17-1769, nr. 86, dt. 8 gusht 1912



bashkëpunim për të drejtat tona legjitime kombëtare. Prandaj populli i sanxhakut t'Elbasanit ka emnue Hasan bej Efendi Vuçiternin, ish deputetit të Prishtinës, për me fol ose me shkruar n'emën të komitetit të Elbasanit”<sup>311</sup>- thuhej në letrën e shkruar nga përfaqësuesit e Komitetit Revolucionar të rajonit. Ndërkohë, dokumentacioni i kohës flet edhe për përpjekjet që bëjnë kryengritësit e Elbasanit për tu njohur, përmes lidhjes telegrafike, me të rejtat e bisedimeve me komisionin qeveritar në Prishtinë. Në favor të këtij fakti flet edhe telegrami i Komitetit Revolucionar të Elbasanit në të cilin shkruhej: “*Ju lutena të na njoftoni se në ç'shikallë kanë mërrijtë bisedimet prej 14 pikash qi do të jenë një mjet shpëtimi për kombin tonë. . . Mbi ç'pika janë tue vijne bisedimet dhe cilët janë tue u pranue? Lutena na jepni shpjegime dhe na caktoni qëndrimin që duhet të mbajmë na*”.<sup>312</sup>

Ndërsa në janar të vitit 1912 qeveria xhonturke kishte hedhur poshtë kërkesën që Hasan Prishtina i kishte drejtuar ministrit të Jashtëm të Perandorisë Osmane, Asim Beut, për njohjen zyrtare të kufijve të Shqipërisë,<sup>313</sup> tani ajo pranonte të ulej në tavolinën e bisedimeve. Kështu fillimi i bisedimeve shqiptaro-turke dhe deklarata e 18 gushtit 1912 e qeverisë turke mbi pranimin e kërkesave të kryengritësve shqiptarë të formuluar në programin 14-pikësh, duke bërë disa ndryshime, u shoqëruan me thirrjen e Hasan Prishtinës kundrejt kryengritësve për t'u kthyer në vendet e tyre.<sup>314</sup> Pas miratimit të 12 pikave, Komiteti Revolucionar i Elbasanit organizon hyrjen e trupave kryengritëse në qytet të cilat, sikurse pasqyrohet në faqet e shtypit të kohës, u pritën me mjaft entuziazëm nga paria e qytetit nën drejtimin e Aqif Pashës. “*Sa po dilte turma prej qytetit veç kur dhanë ball për së largu parësia e kryengritësve Irfan Beu me shokë. – do të shkruhej në faqet e gazetës “Drita”, - U përqaftuan me një simpati të madhe kur u takuan dy parësitë...*”.<sup>315</sup> Ndonëse kryengritja e vitit 1912 përfundoi pa i arritur plotësisht objektivat e caktuara, ajo përgatiti truallin për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë. Tre javë pas këtij kompromisi, Luigj Gurakuqi, më 7 shtator 1912, me anë të një letre drejtuar parisë së Elbasanit, i bënte të ditur gjendjen në Kosovë dhe përçapjet e Ismail Qemalit pranë qeverisë turke për njohjen e autonomisë së Shqipërisë.<sup>316</sup>

Goditja që i dha kryengritja shqiptare Perandorisë Osmane dhe pranimi i kërkesave të saj, i shqetësoi dhe i vuri në lëvizje shtetet fqinje të Ballkanit. Siç shkruan zonja angleze Edith Durham, e konsideruar si “mbretëresha e pakurorëzuar e Shqipërisë”: “Efekti i këtij grushti shqiptar në Ballkan ishte i elektriktë. Secili shtet ballkanas kish shënuar një thellë nga tokat shqiptare. *Delenda est Albania* (Që të djegim Shqipërinë), ishte e vetmja pikë ku të gjithë ata pajtoheshin”.<sup>317</sup> Marrëdhëniet midis Turqisë dhe shteteve të aleancës ballkanike po acaroheshin gjithnjë e më shumë. Në fund të shtatorit të dyja palët filluan të bënin

<sup>311</sup> AME, F. 20, D. 10, nr. 45, f. 2-4

<sup>312</sup> AQSH, F. 32, D. 132, f. 44

<sup>313</sup> *Historia e popullit shqiptar*, Vëll II, TOENA, 2002, fq. 462

<sup>314</sup> AQSH, F. 32, D. 132, f. 5

<sup>315</sup> Gazeta “Drita”, Manatir, 16 gusht 1912, fq. 1-2.

<sup>316</sup> *Normalja në traditë*, Elbasan, 1995, fq. 21

<sup>317</sup> Durham, Edith. *20 vjet ngatërresa ballkanike*, Tiranë, 1994, fq. 224

mobilizimin e ushtrive të veta. Ndonëse Fuqitë e Mëdha vazhdonin të këmbëngulnin në ruajtjen e *status quo*- së territoriale në Ballkan, konflikti i armatosur dukej i pashmangshëm.<sup>318</sup> Tetori i atij viti shënoi edhe fillimin e Luftës së Parë Ballkanike e bashkë me të nisi për shqiptarët një nga periudhat më të vështira të historisë së tyre. Me shpërthimin e kësaj lufte shqiptarët u vunë mes dy zjarresh: në njërën anë pushtuesit shumëshekullorë osman e në anën tjetër shtetet ballkanike që sapo kishin nisur të vinin në jetë planet për copëtimin e tokave shqiptare. Patriotizmi dhe formimi atdhetar qenë shtysat kryesore që Lef Nosi të fitonte rolin e protagonistit në ngjarjet e stuhishme që pararendën ngritjen e flamurit kombëtar në Vlorë.

Me shpërthimin e Luftës së Parë Ballkanike në Shqipëri u krijua një situatë tepër kritike. Fillimisht shqiptarët menduan se popujt sllav të Ballkanit, sikurse edhe kishin deklarur, luftonin për çlirimin e bashkëatdhetarëve të tyre të një kombi e të një feje që akoma vazhdonin të qëndronin nën Perandorinë Osmane dhe askujt nuk i kishte shkuar nëpër mend që krahina të tëra me popullata të shëndosha shqiptare do të bëheshin pre e sulmeve pushtuese sllave. Ndërsa lufta kishte nisur kundër Perandorisë Osmane, komandanti i ushtrisë serbe, Bozhndar Janku, i drejtohet nga toka shqiptare, nga Podujeva, banorëve të Shqipërisë, tokat e së cilës kishte nisur të shkelte, se: *“...po vim n’ille t’juj e tonin qi na kan zaptue osmanllit, qe pesçin e përmbi vjet, ema s’po vim zullum me ju bo, por po vim zullumin me ju hjek...na po vim tu ju pru shpëtimin (seametin)...çeso bese po u apim se me u coptue ulçeja osmanllive, e na me ju, sikur ju me nee, me jetue vllaznisht...”*<sup>319</sup> Mirëpo kur ushtritë serbo-malazeze filluan ta përdorin tokën shqiptare si të tyren dhe të plaçkisin shtëpitë e banorëve vendas, ato u përballën me revoltën e malësorëve shqiptarë. Edhe Toskëria e pa se të vetquajturit “çlironjës” që u derdhën nga Greqia në tokat shqiptare, nuk ishin gjë tjetër veçse kusarë që kërkonin plaçkë dhe vrasje.<sup>320</sup> Shumë shpejt u kuptua se trupat greke ishin akoma më shtypëse se ato turke. Në darën greke tokat shqiptare ishin më zi se nën zgjedhën turke, kohë kur mes mundimesh e përpjekjesh shqiptarët kishin ngritur shkollat e tyre për të ndriçuar shpirtin dhe mendjen e njerëzve.

Të gjendur pa aleatë, me armikun e vjetër në vatër dhe të sulmuar nga agresorë të rinj, shqiptarët vendosën të mos u ndihmojnë më turqve dhe u orientuan drejt rrugës jo pak të vështirë, të shkëputjes përfundimtare prej tyre duke shpresuar se kështu do të mund t’u shpëtonin si pjesëmarrjes në luftë ashtu edhe ngatërresave që ajo sillte pas. Ndërkohë fitoret e shpejta të ushtrive ballkanike kishin ndikuar në ndryshimin e qëndrimit të Fuqive të Mëdha mbi ruajtjen e kufijve politik të shteteve të Ballkanit.<sup>321</sup> Tashmë frika për ekzistencën e kombit shqiptar nuk ndihej ndaj armikut të vjetër që po shembej nga themelet e tij, por ndaj armikut të ri që po trokiste në derë.

<sup>318</sup> *Historia e Shqipërisë*, Vëll II, Tiranë, 1984, fq. 489

<sup>319</sup> Nosi, Lef. *Dokumenta Historike...*, Tiranë, 2007, fq. 10

<sup>320</sup> Durham, Edith. *20 vitet e trazirave të mëdha*, Tiranë, 2001, fq. 262

<sup>321</sup> *Historia e Shqipërisë*, Vëll II, Tiranë, 1984, fq. 493

Sigurimi i përkrahjes së Fuqive të Tripalëshit dhe përparimi i ushtrive të aleatëve ballkanikë bënë që diplomatët shqiptarë të arrinin në përfundimin se e vetmja zgjidhje e drejtë e çështjes shqiptare, në kushtet e reja të krijuara nga lufta ballkanike, ishte jo më kërkesa për autonominë territoriale-administrative, por shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë. Tashmë në pikat e para të planeve të lëvizjes kombëtare ishte organizimi i një kuvendi mbarëkombëtar. Ideja e Pavarësisë dhe e mbledhjes së një kuvendi kombëtar u njoftua për herë të parë botërisht më 19 nëntor, në deklaratën që Ismail Qemali i dha gazetës austriake “Noie Fraje Prese” në Triesht.<sup>322</sup> Vetëm një ditë më parë, 5 vjeshtë III 1328 (18 nëntor 1912), zyra telegrafike e Elbasanit u shpërndau zyrave të tjera telegramin e ardhur nga Vlora i cili bënte të ditur fillimin e punëve për organizimin e Mbledhjes së Përgjithshme Kombëtare.<sup>323</sup> Ideja e një kuvendi kombëtar jo vetëm u konsiderua mjaft e arsyeshme por siguroi edhe mbështetjen e rretheve të gjera patriotike në vend. Mirëpo sedërtimi i saj praktikisht dukej tepër i vështirë pasi qytetet kryesore shqiptare në mos ishin pushtuar nga Aleatët Ballkanikë, ndodheshin ende nën administrimin e forcave osmane. Në këto kushte dukej e vështirë që një kuvend kombëtar i shqiptarëve ta ndalte vrapin e trupave serbe drejt Adriatikut e të forcave greke drejt kufijve veriorë të Epirit. Më e mira që mund të bëhej ishte që qytetet, ende të pashkelura nga trupat ballkanike, ta prisnin armikun e ri me flamurin shqiptar në dorë “ si mysafir në tokën e një shteti asnjans që nuk kishte të bënte me Turqinë”.<sup>324</sup> Lëvizja kombëtare për pavarësi u shoqërua me zhvillime të vrullshme e të gjithëanëshme ku spikatën kontributet e çmuara të disa prej politikanëve më të respektuar të historisë sonë kombëtare tek të cilët ndjenja e kombësisë qëndronte përmbi përkatësinë fetare e mes të cilëve do të dallohet edhe veprimtari elbasanas, Lef Nosi, i cili kohë më parë kishte projektuar në idealet e tij një shtet të pavarur shqiptar me aleatë në botën perëndimore. Kishte ardhur koha të vepronin realisht dhe menjëherë.

Në 21 nëntor Ismail Qemali e Luigj Gurakuqi arritën në Durrës, bashkë me disa krerë të kolonisë shqiptare të Bukureshtit, ku u pritën nga Don Nikollë Kaçorri. Sëbashku me atdhetarët durrësakë ai vendosi të ngrinte në qytet flamurin kombëtar. Mirëpo, ndërsa kauza, për të cilën patriotët shqiptarë i ishin vënë me zell punës, ishte e një rëndësie jetike, atmosfera në Durrës nuk dukej tepër entuziaste. Një situatë të tillë na e konfirmon edhe informacioni i përcjellë nga nënkonsulli austro-hungarez në Durrës, Rudnay, sipas të cilit popullsia e Durrësit veçanërisht klerikët myslimanë dhe fanatikët e qytetit kishin protestuar kundër mbajtjes së një Kuvendi Kombëtar duke u shprehur se donin të qëndronin nën sundimin e Kalifit dhe se : “Hoxhallarët kanë kërkuar pranë mytesarifit, nxjerrjen jashtë të delegatëve të huaj [të qyteteve të tjera] prej Durrësi”.<sup>325</sup> Nga ana tjetër edhe rreziku nga një sulm i mundshëm serb, i cili ndodhej në rrethinat e Tiranës,

<sup>322</sup> Qeveria e Përkohshme e Vlorës..., Tiranë, 1963, fq. 6

<sup>323</sup> Nosi, Lef. *Dokumenta Historike*..., Tiranë, 2007, fq. 70

<sup>324</sup> Kruja, Mustafa. *Antologji Historike*. Sejko, Elbasan, 2001, fq. 268

<sup>325</sup> *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912)*, vëll. VI. Botimet Albanologjike, Tiranë, 2012. Përgatiti Marenglen Verli, Ledia Dushku, fq. 172

ishte rritur mjaft në qytetin e Durrësit.<sup>326</sup> Kur ndodhej në Evropë për të siguruar aleatë për çështjen shqiptare, Ismail Qemali kishte marrë porosi nga Vjena dhe Roma që, për arsye të shumta që lidheshin me luftën që po zhvillohej, si vend për kuvendin kombëtar të zgjidhej një qytet në breg të Adriatikut.<sup>327</sup> Për vetë situatën në të cilën ndodhej Durrësi, e cila rëndohej edhe nga pengesat që sollën autoritetet turke të ndihmuara edhe nga dhespot Jakovi, bëri që delegatët të vazhdonin rrugën drejt Vlorës, qytet ku ishte caktuar të bëhej mbledhja e përfaqësuesve të kombit shqiptar.<sup>328</sup> Nga Durrësi ftesat u nisën telegrafisht drejt të gjithë qyteteve në mënyrë që të mos harxhohej më shumë kohë dhe delegatët të niseshin menjëherë për në Vlorë. Për më tepër në Vlorë gjendej edhe një kablo telegrafike e cila do të bënte të mundur transmetimin e ngjarjeve shqiptare drejt diplomacive evropiane. Bashkë me delegatët e Durrësit “karvani i pavarësisë”, me të cilin u bashkuan edhe përfaqësuesit e Tiranës, Krujës dhe Shijakut, morën rrugën drejt Vlorës ku mbërritën më 25 nëntor.<sup>329</sup>

Ditën që Ismail Qemali ndodhej në Durrës, Mit’hat Frashëri me Bedri Pejanin, Rexhep Mirovicën e Salih Gjukën arritën në Elbasan, qytet ku M. Frashëri mendonte të kryhej shpallja e pavarësisë.<sup>330</sup> Por depërtimi i shpejtë i ushtrive ballkanike dhe rezistenca që i bënte klani i Shefqet Vërlacit lëvizjes përparimtare për pavarësi, bëri që edhe nga kjo ide të hiqej dorë. Pavarësisht këmbënguljes së I. Qemalit për pjesëmarrjen e Aqif Pashës “... në mbledhjen ku do të diskutohen masa të jashtëzakonshme dhe do t’epet një vendim i prerë...”,<sup>331</sup> përballë rrezikut të afërt të pushtimit serb përpara të cilit I. Qemali kishte kërkuar të “...mbani qetësiën dhe bashkimin”,<sup>332</sup> Aqif Pasha vendos të qëndrojë në qytet, ku ishte i fortë edhe ndikimi i Sh. Vërlacit i cili pas zgjedhjeve parlamentare të prillit të vitit 1912 ishte shpallur deputet i sanxhakut të Elbasanit në parlamentin Osman. Ai do të nisë drejt Vlorës bashkëpunëtorët e tij në çështje atdhetarie; Lef Nosin dhe Shefqet Daiun të cilët vetëm më 23 nëntor 1912, sëbashku me Mit’hat Frashërin, morën rrugën drejt Vlorës. Nisja e përfaqësuesve të Elbasanit për në Kuvendin Kombëtar ishte vendosur që në 19 nëntor të vitit 1912. Për këtë flet edhe telegrami që Aqif Pasha i dërgon Xhemil Beut në Vlorë duke u shprehur se: “Përfaqësuesit u sgjodhën. Nesër do të nisen për Vlonë. Siguroni punën nëpër qytetet e tjera”.<sup>333</sup> Ndërkohë nisja e tyre u shty edhe dy ditë më vonë. Këtë e dëshmon edhe telegrami që Mid’hat Frashëri i dërgon Xhemil Beut në Vlorë nëpërmjet të cilit shpjegon edhe shkakun e vonës së nisjes së delegatëve të Elbasanit duke u shprehur: “Pasi bashkë me përfaqësuesit e Dibrës do të vijnë edhe Mehmet Pashë Dërralla, Ajdin Bej Draga e Isa Bej Buletini, e nismja jonë u shtyrë. Të Hanën do të nisemi së bashku”.<sup>334</sup>

<sup>326</sup> Lef Nosi. *Dokumenta historike...*, vepër e cituar, fq. 65

<sup>327</sup> Kruja, Mustafa, *Antologji Historike*, vepër e cituar, fq. 270

<sup>328</sup> Lef Nosi. *Dokumenta historike...*, vepër e cituar, fq. 65

<sup>329</sup> Puto, Arben. *Pavarësia shqiptare në tryezat e diplomacisë. (1912-1914)*, WESO, 2007, fq. 16

<sup>330</sup> Butka, Uran. *Gjeniu i kombit*, Tiranë, Drier, 2000, fq. 43

<sup>331</sup> Instituti i Historisë, Verli. M & Duka. F, *Dokumenta Historike. Lef Nosi*, Tiranë, 2007, fq. 75

<sup>332</sup> Po aty, fq. 70

<sup>333</sup> Lef Nosi. *Dokumenta historike...*, vepër e cituar, fq. 70

<sup>334</sup> Po aty, fq. 73, 8 vjeshta e Tretë 1328/21 nëntor 1912

Mirëpo një tjetër burim na konfirmon se nisja e delegatëve të Elbasanit është realizuar vetëm në datë 23 nëntor. Një fakt të tillë na e vërteton letra dërguar Dervish Bej Biçakçiu në Çermë në datë 25 nëntor ku ndër të tjera shkruhej se përfaqësuesit e Elbasanit “...*pardje u nisën për Vlonë*”.<sup>335</sup> Pikërisht ditën kur delegatët e Elbasanit, me të cilët ishin bashkuar edhe përfaqësuesit e Ohrit e të Strugës,<sup>336</sup> nisen drejt Vlorës, edhe Ismail Qemali bashkë me delegatët e Tiranës, Shijakut e Krujës lënë Durrësin e marrin rrugën drejt Vlorës.<sup>337</sup>

Në 12 vjeshtë III 1328 (25 nëntor 1912), nga zyra telegrafike e Elbasanit, Aqif Pasha e Shefqet Vërlaci do t’i telegrafojnë zyrës së Beratit:

Nr. ... Fjalë 23 O. T. Elbasan, 12 Vjeshta e Tretë 1328- 1912

ora e

Shk. Tija Aziz Pashës

Po, nga ana e popullit t’Elbasanit, u zgjodhën edhe u dërguan Dervish Beu, Shefqet Daiu, Lef Nosi, Midhat Frashëri.

Aqif Pashë Biçakçiu

Shefqet Bej Vërlaci<sup>338</sup>

Nisur nga fakti se ky telegram u dërgua menjëherë pas njoftimit se populli i Elbasanit kishte pranuar pavarësinë e Shqipërisë i po kësaj date por të orës 1.25 të natës, mendojmë se të dyja këto ngjarje datojnë në 26 nëntor 1912.<sup>339</sup>

Ndërsa delegatët nga krahina të ndryshme ishin drejtuar për në Vlorë, një varg qytetesh shqiptare ndodheshin përpara kërcënimit serioz të pushtimit serb. Ohri dhe Struga kishin rënë në duart e serbëve të cilët u kishin kërkuar edhe qukasve të dorëzoheshin pa rezistencë. Ishte e qartë se prej Qukësit rruga, shumë shpejt, do t’i sillte trupat serbe në Elbasan ku organizimi i qëndresës ishte shumë i vështirë pasi populli jo vetëm që nuk kishte armë, por ishte njëkohësisht në panik dhe i demoralizuar.<sup>340</sup> Për t’i vënë trupat pushtuese përpara një fakti të kryer paria e disa qyteteve, nisur edhe nga udhëzimet që vetë I. Qemali kishte dhënë,<sup>341</sup> vendosën të deklarojnë shkëputjen nga Perandoria Osmane. Patriotët elbasanas ishin të parët, të cilët në kushtet e një agresioni të mundshëm nga ushtritë serbe, pas mesnatës së 25 nëntor të 1912-ës do të njoftojnë Ismail Qemalin në Vlorë se: “*Gjithë populli ynë, (i Elbasanit) musliman e i krishterë, me një za kan pranue independencën e Shqipëniës*”.<sup>342</sup> Që paria e Elbasanit në këtë kohë kishte pranuar shkëputjen nga Turqia na e pohon edhe telegrami që Refik Bej Toptani dhe Myslim Agë Beshiri nga Tirana i dërgojnë

<sup>335</sup> Po aty, fq. 79

<sup>336</sup> Poaty, fq. 75

<sup>337</sup> Naska, Kaliopi. *Ismail Qemali*, vepër e cituar, fq. 132

<sup>338</sup> *Lef Nosi. Dokumenta historike...*, vepër e cituar, fq. 80

<sup>339</sup> Po aty

<sup>340</sup> Po aty, fq. 81

<sup>341</sup> Naska, Kaliopi. *I. Qemali...*, vepër e cituar, fq. 134

<sup>342</sup> IH, *Dokumenta Historike...*, Tiranë, 2007, Dok.nr. 12050, fq. 80

Shefqet Beut e Haxhi Ali Efendiut në Elbasan më 13 vjeshtë e Tretë 1328, në orën 3.40 të natës, në të cilin shkruhej: “*Dodhemi në një gjendje të mjerushme. Ju aty çfarë masash keni marrë? Po ndëgjojmë se keni shpallë independencën. Vallë mund të përfitohet prej këti veprimi?*”.<sup>343</sup> Fakti që Shefqet Bej Vërlaci nuk i kthen një përgjigje konfirmuese Refik Bej Toptanit<sup>344</sup> na bënë të mendojmë se në mbledhjen e organizuar në 25 nëntor 1912 nuk ishte vendosur shpallja e pavarësisë në Elbasan, pasi ky akt me rëndësi kombëtare pritej të realizohej nga një kuvend kombëtar që po organizohej në Vlorë. Rrjedhimisht, duke u mbështetur në këto të dhëna, mund të pohojmë se dalim në të njëjtin përfundim me atë të studiueses M. Peza e cila, duke iu referuar telegramit që përfaqësuesit e parisë së Elbasanit i dërguan I. Qemalit në Vlorë pas mesnatës së 25 nëntorit të 1912-ës, si edhe dokumentacionit të akumuluar nga Lef Nosi, konstaton se në mbledhjen e organizuar në 25 nëntor në Elbasan nuk kishte pasur ndonjë prononcim rreth shpalljes së pavarësisë në Elbasan apo ngritjes së flamurit por pjesëmarrësit ishin shprehur, në emër të popullit të Elbasanit, për pranimin e pavarësisë duke dërguar përfaqësuesit e tij në kuvendin kombëtar që po organizohej në Vlorë.<sup>345</sup>

Lajmi ishte telegrafuar drejt Vlorës por qeveria e Përkohshme në Elbasan akoma nuk ishte krijuar. Më 27 nëntor, nga zyra telegrafike e Vlorës, Lef Nosi do t'i shkruaj z. Cilkës (Thanas Floqit – E.A ) në Elbasan: “*Nesër në mëngjes kongresi do të shpalli Indipendencën e Shqipëniës edhe do t'ia komunikojë Shteteve të Mëdha; do të formohet Qeveria e Përkohshme e do të zgjidhen pjesëtarët e saj. Austria, Gjermania, Italia dhe Rumania janë zotuar ta njohin këtë rrugë që po ndjekim. Nga lajmet e ardhura këtu, merret vesht se në shumë qytete të Shqipëniës është shpall Indipendence. Ndiham e ushtrisë së Janinës u sigurve. Sepse gjithkush e kuptoi se përveç Indipendencës, tjetër mjet shpëtimi nuk ka. Mustafëzët e vullnetarët që janë në Himarë ngritën flamurin shqiptar kundrejt anmikut.*”<sup>346</sup>

Tre ditë pas pranimin të mëvehtësisë (15 vjeshtë e Tretë 1328) paria e qytetit u mblodh në prefekturë dhe vendosi unanimisht mbi krijimin e prefekturës së Elbasanit. Aqif Pasha ishte zgjedhur prefekt i Elbasanit,<sup>347</sup> i pari në historinë e shtetit të pavarur shqiptar. Mirëpo ndonëse ishte prononcuar i pari në mbështetje të pavarësisë që pritej të shpallej në Vlorë në bedenat e kalasë dhe në prefekturën e Elbasanit ende nuk po valëvitej flamuri kombëtar. “*Mbë një anë i dërgoni ushtrisë serbe komision të posaçëm – do t'i shkruante Lef Nosi e Shefqet Daiu, zyrës telegrafike të Elbasanit – dhe më tjetër anë flamurin nuk e ngrini. Si bahet kjo punë? Ngrini-e sa ma shpejt.*”<sup>348</sup> Ndonëse ky komunikim telegrafik mes Elbasanit dhe Vlorës ka datën e zhvillimit, 15 vjeshta e tretë 1328, por jo orën, një tjetër lidhje telegrafike mes dy qyteteve, ajo e një dite më parë, na ndihmon të kuptojmë kohën kur mund të jetë kryer kjo lidhje telegrafike. Më konkretisht në bisedën telegrafike të datës 14 vjeshtë e tretë 1328, Z. Cilka në Elbasan i kërkon Lef Nosit

<sup>343</sup> Po aty, fq. 82

<sup>344</sup> Po aty, fq. 84

<sup>345</sup> Peza, Majlinda. *Zhvillimet politiko-arsimore në trevën e Elbasanit në vitet 1878-1914*, Doktoratë, Tiranë, 2014, fq.170

<sup>346</sup> IH, *Dokumenta Historike...*, Tiranë, 2007, 14 vjeshtë III 1328, fq. 93

<sup>347</sup> Po aty, fq. 65

<sup>348</sup> IH, *Dokumenta Historike...*, Tiranë, 2007, fq. 93



dhe Shefqet Daiut në Vlorë të vazhdojnë komunikimin të nesërmen: “Në qoftë se vini nesër më ora 12 allaturka bahet mirë,...”.<sup>349</sup> Të nesërmen L. Nosi dhe Sh. Daiu do të lidhen me zyrën telegrafike të Elbasanit ku ndodheshin Mahmud Nedim (Hakani) dhe Hasan Osmanai të cilëve ndërsa u kërkojnë ngritjen e flamurit në qytet i informojnë edhe në lidhje me punët e Kuvendit Kombëtar. “Kongresi edhe nuk ka fillue. Ndashti do të hapet. Vendimet do t’ju njohtohen veçanërisht”.<sup>350</sup> Nisur nga këto të dhëna mendojmë se deri mesditën e 28 nëntorit, para hapjes së kuvendit të Vlorës, flamuri ende nuk ishte ngritur në Elbasan. Megjithatë, po nga kjo lidhje telegrafike, kuptojmë se flamuri shqiptar është ngritur po atë ditë në Elbasan. “Ndashti po e ngremë. – do të njoftonte zyra telegrafike e Elbasanit, - Qeveria e Përkohshme u ngref, edhe milicia u formue e nisi nga puna”.<sup>351</sup> Përmes analizës së këtij dokumenti, mendojmë se flamuri në Elbasan është ngritur në 28 nëntor 1912 dhe njëkohësisht, po atë ditë, është formuar Qeveria e Përkohshme e Elbasanit. Në favor të këtij fakti flet edhe telegrami i Elbasanit, i 28 nëntorit 1912, drejtuar Vlorës në të cilin thuhej: “**Elbasani shpalli Independencën n’emën të Shqipniës, ngriti flamurin edhe Turqit i përzeni krejt. Këtu ndashti asht formue një Qeverrië Shqiptare e Përkohshme e cila ka fillue nga detyra. T’a lajmërojmë kryetarin e Qeverriës edhe Komisionin apo jo? Sepse këtu në zyrët telegrafike nuk ka njiri**”.<sup>352</sup> Qëllimi ishte që trupat serbe, që priteshin të hynin në Elbasan, ta gjenin qytetin të pavarur dhe me institucione të ngritura. Prefektura e Elbasanit hyri drejtpërdrejtë në korrespondencë me gjeneralin serb Metoviç në Ohër, duke e njoftuar për ngritjen tashmë të flamurit shqiptar në qytet dhe dëbimin, prej andej, të turqve. “Tani këtu është formuar një Qeveri e Përkohëshme Shqiptare dhe ka filluar nga detyra”.<sup>353</sup>

Ndërkohë përfaqësuesit më të rëndësishëm nga mbarë viset shqiptare, që nga Mitrovica deri në Prevezë, u mbledhën në kuvendin kombëtar të Vlorës i cili mori përsipër të zgjidhë nyjën gordiane në të cilën historia e kishte mpleksur fatin e kombit tonë.<sup>354</sup> Sipas dokumentave që ndodhen në Arkivin e Shtetit (AQSH, Dokumentet e Kuvendit të Vlorës, F. 11, viti. 1912) në mbledhjen e parë të kuvendit morën pjesë 37 delegatë ndërsa 26 të tjerë mbërritën gjatë ditëve të zhvillimit të punimeve të tij. Në listën e politikanëve pjesëmarrës kishte figura drejtuese dhe udhëheqës krahinash, shumë prej të cilëve luajtën një rol kyç në zhvillimet politike të pas 1912-ës, fakt i cili na bënë të mendojmë se në Kuvendin e Vlorës mori pjesë elita e mendimit politik shqiptar.<sup>355</sup> Ndër këta elitarë, delegatë të krahinës së Elbasanit, ishin edhe Lef Nosi me Shefqet Daiun, Mit’hat Frashërin, Qemal Karaosmanin e Dervish Biçakun. Ndërsa Aqif Pashë Biçakçiu qëndroi në Elbasan për të mbrojtur flamurin e sapongritur në qytet si nga kërcënimet e jashtme ashtu edhe nga kundërshtitë e brendshme.

<sup>349</sup> Po aty.

<sup>350</sup> Po aty, fq. 103

<sup>351</sup> Po aty.

<sup>352</sup> *Qeveria e përkohshme e Vlorës*, Tiranë, 1963, Dok. Nr. 8122, fq. 38

<sup>353</sup> Po aty, Dok. Nr. 25, fq. 28

<sup>354</sup> *Kombi*, New Jork, 1997, sh.b. ONUFRI, fq. 272

<sup>355</sup> Krasniqi, Afrim. *Partitë politike në Shqipëri në vitet 1920- 2006*, Tiranë, 2006, fq. 35

Më 28 nëntor të 1912-ës kuvendarët shqiptarë shpallën njëzëri Pavarësinë kombëtare të Shqipërisë dhe vendosën të qëndrojnë asnjëherë në konfliktin ballkanik. Ndërsa zëri i pushkës shqiptare nuk u dëgjua, shqiptarët të shtrënguar prej rrezikut, të rrethuar prej armiqsh e duke parë vendin e tyre të mbytur në flakë e në tym, më 28 nëntor 1912 patën një zë të përbashkët e veç një qëllim; nga ky qëllim doli independenca shqiptare e në mes të tymit e të rrezikut lindi jeta politike e Shqipërisë.<sup>356</sup> Kështu Shqipëria shpresonte t'i tregonte botës vullnetin e saj për liri dhe duke u shkëputur nga Turqia të respektohej nga Evropa.

#### PROKLAMIMI I INDEPENDENCËS SHQIPTARE

Nr. 6 fjalë 33 O. T.

Vlonë, 15 Vjeshta e Tretë 1328- 1912

8 ora e natës

Të ndershmes Kryesisë të Qeverijës së Përkohshme. Elbasan  
Kongresi u hap. Independenca u proklamue. Ismail Qemal Beu u zgjodh kryetar.

Sonte do t'i komunikohet Shteteve të Mbëdha me kabllo. Ju urojmë.

Lef Nosi, Midhat Frashëri, Qemal Bej Karaosmani

Shkryesit e kongresit

Shefqet Daiu, Luigj Gurakuqi<sup>357</sup>

Ditët e para të dhjetorit, delegatët shqiptarë të Vlorës, pasi nuk e pranuan listën e propozuar nga kryetari i Qeverisë së Përkohshme në të cilën ishin përfshirë figura me përvojë politike në administratën osmane, të gjithë të besimit mysliman, zgjodhën nga rradhët e patriotëve më të shquar, të të gjithë besimeve fetare, 8 ministrat që formuan të parën qeveri kombëtare të kryesuar nga Ismail Qemali, mes të cilëve i zgjedhur ishte edhe Lef Nosi i cili mori 20 vota gjatë raundit të parë të votimit. Pas zgjedhjes së 5 ministrave u zhvillua një votim i dytë për të përcaktuar edhe 3 ministrat e tjerë që duhet të siguronin mbi gjysmën e votave të delegatëve. Në këtë votim L. Nosi siguroi 37 vota nga 57 përfaqësuesit e pranishëm në mbledhjen e datës 21/4/dhjetor 1912.<sup>358</sup> Ndërkohë që në mbledhjen e datës 17/30 vjeshtë e tretë 1912 ishte zgjedhur edhe Këshilli i Pleqësisë së shtetit shqiptar, si një organ kontrollues e këshillues i qeverisë, i përbërë nga 18 anëtarë dhe i kryesuar nga Vehbi Agolli (Dibra), ku Lef Nosi u zgjodh nënkryetar. Meqënëse ushtritë ballkanike ishin derdhur drejt tokave shqiptare, u vendos që kjo formë qeverisjeje të ruhej derisa të kthjellohej horizonti politik në qarqet e Ballkanit dhe në ato të Pushteteve të Mëdha.

Për Lef Nosit dhe patriotë të tjerë të mbledhur në Vlorë përkrahja që i dhanë konsujt italian dhe austro-hungarez I. Qemalit dhe independencës shqiptare, ngjallte shpresa të mëdha se çështja kombëtare do të gjente më në fund rrugëdaljen nga tuneli i errët pesë shekullor për të parë dritën mes popujve të lirë të qytetërimit perëndimor.

<sup>356</sup> Selenica, Teki. *Shqipëria në 1927*, Tiranë, 1928, fq. 25

<sup>357</sup> AME, F. 20, D. 10, f. 2

<sup>358</sup> *Dokumenta historike*, vepër e cituar, fq. 183

Mirëpo shpallja e Pavarësisë ishte një ngjarje fatlume për shqiptarët dhe Shqipërinë, dhe jo për Evropën. Shqipëria po hynte në familjen europiane si një foshnjë e lindur prej urrejtjes e jo prej dashurisë. U mallkua pse shpalli mëvehtësinë në një kohë të ligë për ata që e kishin dënuar me vdekje.<sup>359</sup> Aleatët ballkanikë kishin deklaruar se bënë luftë vetëm kundër turqve. Ndërsa në të vërtetë shpallja e pavarësisë i ndezi akoma më tepër grekët, serbët e malazezët kundër shqiptarëve. Ndonëse populli i qytetit të Elbasanit ishte shprehur unanimisht në favor të shkëputjes përfundimtare nga Porta e Lartë dhe daljes më vehte nën flamurin kombëtar, në krah të shtetit shqiptar që po ngrihej në këmbë, ky fakt nuk e ndali revanshin e forcave serbe të cilat në 29 nëntor 1912 hyn në qytet.<sup>360</sup> Kishte kaluar më shumë se një muaj e gjysëm që nga fillimi i luftës ballkanike dhe rrjedha e saj tashmë ishte bërë e qartë: ushtritë turke të thyera keqas ishin kudo në tërheqje dhe tokat shqiptare ishin shndërruar në shesh lufte madje ishin të parat që iu ekspozuan pasojave të disfatës së Perandorisë Osmane. Dhe ndërsa flaka e luftës mes Turqisë dhe forcave aleate po përhapej me shpejtësi në thellësi të tokave shqiptare, qeveria e Vlorës përcjell telegrafisht kërkesën, drejtuar si komandave të ushtrive pushtuese ashtu edhe qeverive përkatëse, për njohjen e shtetit të pavarur shqiptar dhe për ndërprerjen e veprimeve ushtarake në territoret e pushtuara shqiptare. Njoftimi për vendimin e shqiptarëve, për të jetuar të lirë dhe më vehte, iu dërgua edhe të gjitha Ministrive të Jashtme të Fuqive të Mëdha me shpresën se “...shqiptarët duke hymë prapë në familjet e popujvet t’Evropës Orientale...e duke ndjekun veçse një qëllim të vetëm – me jetu në paqe me gjithë shtetet ballkanike...”,<sup>361</sup> do të mirëpritej nga e gjithë bota e qytetëruar e cila, sikurse do të



shprehej kryetari i Qeverisë së Përkohshme, I. Qemali: “...do t’i presi me sy të mirë duke i mbrojtun qënien e tyne kombëtare nga çdo e mësyne, dhe tokën e tyne nga çdo coptim.”<sup>362</sup> Ndonëse kërkesa telegrafike për njohjen e Pavarësisë së Shqipërisë, nuk siguroi aprovimin e asnjë prej qeverive të Fuqive të Mëdha, diplomacia evropiane u mor gjatë me çështjen shqiptare, në veçanti tre Fuqitë më të interesuara: Austro-Hungaria që e shihte Shqipërinë si një barrierë për të penguar shtrirjen e sllavëve në Ballkan; Italia që e konsideronte Shqipërinë si “quinta sponta” (bregu i 5-të) i Perandorisë së saj koloniale; dhe Rusia e cila synonte rritjen e influencës së saj në Ballkan përmes zgjerimit të shteteve të reja, në veçanti atyre sllave.

<sup>359</sup> Normalja në fokus të bashkëkohësisë, Elbasan, Silver, 2000, fq 54-55

<sup>360</sup> AQSH, F. 32, D. 37, 16 vjeshtë III 1328, f. 85

<sup>361</sup> IH, *Dokumente Historike*, Tiranë, 2007, fq. 106

<sup>362</sup> Po aty

Edhe pse Rusia nuk ishte e vetmja fuqi mbrojtëse e të krishterëve të Ballkanit pasi në krahë të tyre dhe kundër interesave shqiptare ishte edhe Franca e cila, kur filluan të diskutohen kufijtë dhe pavarësia shqiptare, akoma më shumë se Rusia, mbrojti tezat greke e serbe kundër Shqipërisë. Pikërisht në një klimë të tillë politike nisi jetën Qeveria kombëtare e Vlorës.

## II.2 Veprimtaria e ministrit të Postë-Telegrafave në Qeverinë e Përkohshme të Vlorës

Në 4 dhjetor 1912 Kuvendi Kombëtar zgjodhi anëtarët e qeverisë së parë shqiptare, të cilët ishin përfaqësues të të gjitha besimeve e krahinave të vendit. Në këtë qeveri të krishterit ortodoks nga Elbasani, Lef Nosi 35- vjeçar, që ishte i vetmi zyrtar i postës së mëparshme osmane, iu besua Ministria e Postë-Telegrafave. Pasi ishte larguar nga puna si mësues në shkollën e infermierisë në Elbasan, ai kishte nisur detyrën në postën osmane dhe kishte pasur nën varësinë e tij 4 zyra postare në Vlorë, Fier, Gjirokastrë dhe Tepelenë.<sup>363</sup> Tashmë si ministër në Qeverinë e Përkohshme, me qendër në Vlorë, atij do t'i duhej të ndërmernte hapa të rëndësishëm dhe të punonte fort për vendosjen e shërbimit postar në ato pjesë të Shqipërisë të kontrolluara prej saj. Ministria që ai drejtoi gjatë viteve 1912- 1914, për shkak të ndërlidhjes së kohës, merrte rëndësi të posaçme. Për shtetin e ri shqiptar telegrafët e trashëguar ishin i vetmi mjet i komunikimit në kushtet e një lufte ballkanike dhe të një izolimi të plotë të vendit. Më 14 dhjetor Ministri i Postë- Telegrafave u njofton shpalljen e pavarësisë kombëtare të Shqipërisë, Drejtorive të Përgjithshme të Telegrafave të Kosovës, Shkodrës, Manastirit dhe Janinës si dhe drejtorive të qendrave të tjera duke kërkuar edhe bashkëpunimin e tyre: “Me unanimitet u shpall Pavarësia e Shqipërisë, që do të sigurojë shpëtimin e lumturinë e Atdheut. - do të shkruante në këtë njoftim të parë Lef Nosi si ministër i Qeverisë së Vlorës. - Ministria e Postë-Telegrafave të Qeverisë së formuar përkohësisht m'u ngarkua mua. Të gjithë nënpunësat e shërbyesit e tjerë të postë-telegrafave të lidhur me këtë Ministri do të veprojnë në emër të Shqipërisë dhe do t'u vërtetohet nënpunësia nga kjo Ministri”.<sup>364</sup>



Para vitit 1912 rregullorja turke e shërbimit dhe e tarifave postare, e shpallur me një ferman perandorak të 25 marsit 1862, ishte unike në gjithë perandorinë dhe ishte kjo rregullore që zbatohej në

<sup>363</sup> John S. Phipps, *Pullat dhe postat e Shqipërisë dhe Epirit. 1878-1945*, Korçë, 2002, fq. 103

<sup>364</sup> *Qeveria e Përkohshme e Vlorës...*, Tiranë, 1963, fq. 79

vendin tonë para shpalljes së pavarësisë<sup>365</sup> e cila u ruajt edhe gjatë fazës së parë të ngritjes së shtetit të ri shqiptar. Deri sa të bëheshin zgjedhjet dhe të formohej Këshilli Kombëtar, Qeveria e Vlorës vendosi të linte në fuqi ligjet, rregulloret e formalitetet e mëparshme dhe të mbeteshin në vendet e veta të punës nëpunësit që do ta njihnin dhe do ta pranonin Qeverinë e Përkohshme. “Rregulloret e sotme do të mbeten gjithnjë në fuqi. – shënonte Lef Nosi në njoftimin e mësipërm. – Ju porosisim t’u bëni komunikime në këtë vështrim nëpunësive e shërbënësve të drejtorisë suaj, duke kërkuar që secili prej tyre të kryejë detyrën drejt e besnikrisht. Të na dërgohet brenda 48 orëve lista emërore e atyre që nuk do të pranojnë të shërbejnë në emër të Qeverisë Shqiptare”.<sup>366</sup> Shtabi postar i Shqipërisë u vendos në një ndërtesë të vogël dykatëshe, të verdhë e me grila të kuqe, pa ndonjë tabelë identifikuese,<sup>367</sup> ku fillimisht ndodhej edhe selia e Ministrisë së Postë-Telegrafës. Kati i sipërm kishte 3 dhoma: në të parën ishte zyra e Ministrit, Lef Nosit, dhe Inspektorit të Përgjithshëm, Sotir Koleas; në të dytën ishte zyra e llogarisë dhe në të tretën ndodhej Telegrafa. Kati i poshtëm përbëhej nga dy dhoma: në njërën ishte zyra postare dhe në tjetrën ishte magazina.<sup>368</sup> Dërgesat postare në këtë kohë nuk shpërndaheshin në adresa por duhej të grumbulloheshin dhe të interesuarit duhet të vinin në zyrën e postës. Është e qartë se administrata postare e Qeverisë së Vlorës hasi mjaft vështirësi dhe kishte jo pak mangësi. Personeli që shërbente në zyrat postare ishte i vogël e ndërkohë, edhe nga pikëpamja ligjore, nuk ekzistonte asnjë dekret që të jepte të drejtën për të autorizuar emetimin e pullave të reja.<sup>369</sup>

Pas shpalljes së pavarësisë, një detyrë mjaft e rëndësishme e Qeverisë së Vlorës ishte ngritja dhe riorganizimi i menjëhershëm i administratës shtetërore kombëtare. Për të siguruar ruajtjen e rendit publik në vend, ndërsa qendra të rëndësishme shqiptare ishin zbrazur nga ushtritë ballkanike, në maj të 1913-ës u krijuan disa komisione për studimin e problemeve të ndryshme që kishin të bënin me organizimin e ri të drejtësisë, xhandarmarisë dhe policisë.<sup>370</sup> Në qershor filloi të funksionojë një zyrë e Shtatmadhorisë e cila hartoi “Rregulloren mbi formimin e milicisë shqiptare” që do të siguronte mbrojtjen e vendit derisa të krijohet një ushtri e rregullt për të cilën ishin bërë edhe porosi të shumta armësh në arsenalet e Austro-Hungarisë. Mirëpo këto masa rezultuan të pamjaftueshme për shtetin e ri shqiptar i cili nuk arriti t’i çimentojë bazat mbi të cilat përpiquej të ngrinte pushtetin e tij.

Përballimi i vështirësive të brendshme e të jashtme nuk mund të bëhej me nëpunësit e vjetër, shqetësim i cili përshkon edhe letrën që Nikolla i dërgon të vëllait, Lef Nosit, në maj të vitit 1913: “...rendi publik dhe siguria janë në gjendje të mirë” - por ai shpreh shqetësim se në administratë ishin përfshirë vetëm mysliman “sikur u bë autonomia vetëm për myslimanët e jo për të gjithë...- shkruhet në letër - ...Në 100 xhandarë veç 10 janë të krishterë. Në 20 kalorës xhandarë, as edhe një. Le që as një nëpunës nuk di

<sup>365</sup> Revista “Koleksionisti”, nr. 3, viti. 1999, fq. 5

<sup>366</sup> *Qeveria e Përkohshme e Vlorës...*, Tiranë, 1963, fq. 79

<sup>367</sup> Phipps. S. John, *Pullat dhe postat e Shqipërisë...*, Korçë, 2002, fq. 123

<sup>368</sup> Revista “Koleksionisti”, nr. 3, viti 1999, f. 9

<sup>369</sup> Phipps. S. John, *Pullat dhe postat e Shqipërisë...*, Korçë, 2002, fq. 124

<sup>370</sup> *Qeveria e Përkohshme e Vlorës...*, Tiranë, 1963, dok. Nr. 209, fq. 144



fare shqip, as interesohen fare për shqipen se kujtojnë dhe thonë se për shumë kohë do jetë në fuqi turqishtja!!! Me një fjalë forma e administratës nuk ka ndryshuar fare...”.<sup>371</sup> Nuk mund të pohojmë se Qeveria e Përkohëshme ushtroi një veprimtari shtetërore normale si për nga shtrirja territoriale ashtu edhe nga funksionet që ushtroi. Ndërkohë as nuk mund të mohohet se drejtimet në të cilat ajo zhvilloi veprimtarinë e saj ishin nga më themeloret. Gjatë kohës së qëndrimit të saj në fuqi, Qeveria e Vlorës bëri mjaft jo vetëm për organizimin e brendshëm të shtetit të ri shqiptar, por edhe për njohjen e të drejtave të Shqipërisë në shkallë ndërkombëtare.

Është fakt se gjatë historisë së pavarësisë shqiptare një pjesë e shqiptarëve myslimanë shfaqën menjëherë vullnetin për të shkëputur lidhjet me Perandorinë Osmane. Mirëpo në situatën e re politike të Shqipërisë së pavarur, funksionarë që i kishin shërbyer sulltanit vazhduan në shumë raste punën e vet, me metoda analoge, në administratën e shtetit të ri shqiptar, por duke pasur përkrahë levat e reja të të rinjve të rritur gjatë luftës për pavarësi. Pushteti i bejlerëve dhe çifligarëve të mëdhenj në Shqipërinë e Mesme e të Jugut, mbeti i paprekur. Kjo lloj klase feudale e kishte përkrahur lëvizjen e pavarësisë për aq sa qeveritarët e Bosforit e bezdisnin pushtetin e tyre lokal në Shqipëri.<sup>372</sup> Nga ana tjetër kur Qeveria filloi punën, në Vlorë u mblodhën shumë ish-nëpunës të administratës turke, disa me dëshirën e tyre e të tjerë të dëbuar nga turqit, të cilët donin të merrnin ndonjë nëpunësi në administratën e re e cila automatikisht ra në duart e tyre sa që të krishterët shqiptarë filluan ta shohin Shqipërinë e re e të pavarur si një Turqi të vogël në Ballkan. Dëshmi të vështirësive dhe e të përpjekjeve të bëra nga Qeveria e Përkohëshme për kapërcimin e tyre, vijnë jo vetëm nga informacionet që përcjellë organi zyrtar i qeverisë së Vlorës, “Përlindja e Shqypnies”, por edhe nga raportet e konsujve të huaj në Shqipëri e konkretisht, konsullit të Austro- Hungarisë, Berchtold, i cili në një telegram dërguar nënkonsullit Rudnay, në Durrës, dhe ambasadorit Merey, në Romë, flet për përpjekjet që po bëheshin për të nxitur myslimanë e ortodoksë të vireshin në krah të qeverisë së ngritur në Vlorë. “...Se autonomia nuk ka për të sjellë me vete nënshtrimin e tyre (shqiptarëve ortodoksë- E.A) nën shqiptarët myslimanë; se qeveria e re ka për të respektuar interesat dhe të drejtat e të gjithë shqiptarëve pa marr parasysh fenë të cilës ata i përkasin dhe se prandaj, në interes të së ardhmes së atdheut, detyra e tyre do të ishte që të bashkëpunonin në formimin e këtij regjimi.”<sup>373</sup> Vera e vitit 1913 karakterizohet nga një veprimtari më aktive e Qeverisë së Përkohëshme në procesin e ngritjes së hallkave të administratës shtetërore dhe organizimin e jetës së vendit mbi bazën e pavarësisë.

Krijimi i shtetit të pavarur shqiptar ishte premisa themelore jo vetëm për mbrojtjen e lirisë dhe të të drejtave të shqiptarëve në arenën ndërkombëtare, por edhe për organizimin e jetës së brendshme në të gjitha fushat. Mirëpo Qeveria e Përkohëshme e Vlorës e nisi veprimtarinë në rrethana dramatike, të krijuara nga

<sup>371</sup> AQSH, F. 32, D. 57, f. 25, 19 maj 1913

<sup>372</sup> Rocco, Roberto Morocco. *Kombësia dhe feja në Shqipëri. 1920-1944*, Tiranë, 1994, fq. 27

<sup>373</sup> AIH, Vj. 22-10-1053, dhjetor 1912



shpërthimi i Luftës së Parë Ballkanike. Ishte detyrë e saj të realizonte vendosjen e lidhjeve të pushtetit me krahinat e tjera shqiptare. Në fillim të dhjetorit 1912, gjithë Kosova, Shqipëria Veriore, Lindore dhe ajo e Mesme ishin të pushtuara nga ushtritë serbo-malazeze. Vetëm Shkodra e rrethuar vazhdonte qëndresën. Në jug trupat greke kishin rrethuar Janinën, kishin pushtuar Çamërinë dhe po marshonin drejt viseve të tjera të Shqipërisë së Jugut. Përveç bllokadës që kishin shpallur, luftanijet greke godisnin pika të ndryshme të bregdetit shqiptar, madje më 3 dhjetor, një skuadër detare greke bombardoi portin e Vlorës dhe preu kabllin telegrafik që lidhte qytetin, përmes kanalit të Otrantos, me Brindisin e cila ishte e vetmja lidhje e mbetur me botën e jashtme e që nga ai moment nuk funksiononte më. Në këtë kohë flota greke kishte bllokuar gjithë bregdetin jugor shqiptar. Qeveria e Vlorës ende nuk kishte një administratë shtetërore të organizuar, një ushtri dhe polici kombëtare që do të shërbente si mbështetje për zgjidhjen e situatës së rënduar. Ndërkohë edhe përparimi i forcave ballkanike në tokat shqiptare synonte të krijonte vështirësi dhe t'i paraqiste shqiptarët të paafte për një jetë kombëtare të bashkuar dhe për një shtet të pavarur.

Ndonëse në kushte tepër të vështira, Qeveria e Përkohshme nisi punën për të kryer detyrat më të rëndësishme që kërkonin zgjidhje të menjëhershme. Me dëshirën për t'u dhënë shqiptarëve një shtet të modelit europian, misionarët e kabinetit të parë qeveritar i kushtuan një vëmendje të veçantë ristrukturimit të shërbimit postar në vend, i cili do të zëvendësonte postat osmane. Këto përpjekje gjetën shprehje në ngritjen e kësaj strukture në rang ministrie të Postë Telegrafë-Telefonëve. Që prej 5 dhjetorit ministri i Postë-Telegrafave, Lef Nosi, kishte filluar punën për ngritjen dhe organizimin e sistemit të telegrafave, madje kishte realizuar edhe porositë në fabrikat italiane për pulla e tela telefoni. Por kjo nuk ishte një ndërmarrje aspak e lehtë në kushtet kur shtetit të sapolindur shqiptar i mungonin financat dhe arka ishte bosh. Në këto rrethana pagesat e kërkuara për shtypjen e pullave të para nga dy firmat e kontaktuara, “Modiano” në Trieste të Italisë dhe “Aspioti-Elka” në Korfuz të Greqisë ishin të papërballueshme nga qeveria.<sup>374</sup> Kjo shpjegon edhe faktin që gjatë muajve të parë, pas shpalljes së pavarësisë, në vend vazhdonin të funksiononin zyrat postare osmane dhe përdreshin pullat osmane.<sup>375</sup> Përballë pamundësisë financiare për t'i shtypur menjëherë pullat e reja postare jashtë vendit, qeveria dhe ministri i postave gjetën një zgjidhje realiste dhe mjaft praktike. Meqenëse në zyrat postare në vend kishte mbetur një sasi e konsiderueshme pullash osmane të viteve 1908, 1909, 1910 e 1911, nëpunësit e postës realizuan idenë e ministrit, Lef Nosit, për të prodhuar pullat e postave shqiptare me një kosto minimale. Në kushtet kur të ardhurat nga zyrat postare ishin aq të vogla sa nuk arrinin të mbulonin as rrogën e ministrit, Lef Nosi, gjatë një takimi me tregtarin austriak Pierron, i kërkon këtij të fundit një ndihmë financiare prej rreth 500 frangash për ta nxjerrë sistemin postar nga ngërçi ekonomik ku ai ndodhej. Pierron ia ofroi këtë shumë në shkëmbim të pullave turke. Ndërkohë ai u shpreh mjaft i interesuar për blerjen e këtyre pullave sidomos nëse ato do të ishin të

---

<sup>374</sup> Nika, Thimi. *Historia e filatelistë shqiptare*, Tiranë, 2013, fq. 58

<sup>375</sup> “Përlindja e Shqipëniës”, nr. 21, 28 mars 1914, f.4

mbishtypura me vulën shqiptare. Ky qëndrim i tregtarit austriak i bëri mjaft përshtypje ministrit të postave i cili kërkoi menjëherë që të përgatitej një vulë dore për të realizuar mbishtypjen e pullave ekzistuese. “U mor një copë gomë dhe u gdhend në të një shqiponjë me dy kokë dhe fjala Albanie u hoq nga një pullë ekzistuese biznesi...”.<sup>376</sup> Me këtë vulë Pierron bëri disa mostra për mbishtypje të cilat Lef Nosi i mori për t’i ua treguar kolegëve të tij. Këto prova të mbishtypjes të bëra me vulën e dorës primitive me Shqiponjën dykrerëshe dhe nënshkrimin Albanie, u realizuan me ngjyrë të kuqe për fjalën “Albanie”, disa të kuqe e të zeza, dhe disa me të dyja ngjyrat për “shqiponjën”. Ministrat e qeverisë së Vlorës e miratuan propozimin në parim duke pranuar ngjyrën e zezë për t’u përdorur por nuk pranuan të autorizonin emetimin e pullave me këtë mbishtypje “sepse ato nuk kishin përdorur emrin shqip të vendit...”.<sup>377</sup> Në të njëjtën kohë Lef Nosi u dha urdhër zyrtarë të tjera postare në vend, që mund të kontaktoheshin, që të dërgonin në Vlorë të gjitha pullat e mbetura osmane. Ishte marsi i vitit 1913 dhe Shqipëria kishte humbur kontrollin mbi Gjirokastrën dhe Tepelenën, për rrjedhojë edhe zyrtat postare të këtyre dy qyteteve. Por ndërkohë, me tërheqjen e pjesëshme të trupave serbe, gjatë prillit të atij viti, nga territoret të njohura ndërkombëtarisht shqiptare, bëri të mundur që të vihehin nën kontroll disa qytete të tjera si Elbasani dhe Berati, prej nga ku mund të tërhiqeshin tashmë pullat postare osmane. Me porosi të ministrit të Postës, L. Nosit, vula e dorës u realizua në Itali nëpërmjet të plotfuqishmit shqiptar të akredituar në Romë, Eqrem bej Vlorës.<sup>378</sup> Vula që u përdor për të vulosur serinë e parë të pullave ishte e rrumbullakët dhe rreth e qark kishte të shkruar “Ministeria e Post. Teleg. E Telefonevet”.<sup>379</sup> Pulla e parë, e cila ishte mbishtypur me këtë vule dore metalike që kishte shqiponjën dykrerëshe dhe nën të fjalën: “Shqipëria”,<sup>380</sup> doli në maj të 1913-ës dhe u hoq nga përdorimi në 30 qershor 1913. Si shqiponja edhe shkronjat në këtë pullë ishin me ngjyrë të zezë dhe vlera e tyre nuk ishte shkruajtur mbi to por shiteshin 1 grosh në të gjitha zyrtat postare që funksiononin në vend.<sup>381</sup> Ishte e qartë se kjo nuk përbënte një zgjidhje përfundimtare por u përdor si një zgjedhje e domosdoshme në kushtet e vështirësive të brendshme të sistemit postar e telegrafik dhe kur vendi përballë çdo ditë me situatën e rëndë ekonomike dhe politike. Vetëm pak javë pas emetimit të pullave të mbishtypura me shqiponjë, në Vlorë erdhën porosi të mëdha nga tregtarë nga e gjithë bota, kërkesa që nuk arritën t’i kënaqnin të gjithë pasi sasia e vogël e pullave osmane u konsumua shumë shpejt, dhe askush nuk arriti të sigurojë ndonjë blerje të madhe, për më tepër që në vend nuk kishte zotërues të rezervave të mëdha të këtyre pullave.<sup>382</sup> Pullën e parë, në formën e një zarfi, administrata postare e shiti në 11 qytete ku funksiononin zyrtat postare të ngritura që gjatë pushtimit osman: Vlorë, Lushnjë, Skrapar, Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Shijak, Tiranë,

<sup>376</sup> Phipps. S. John, *Pullat dhe postat e Shqipërisë...*, Korçë, 2002, fq. 103

<sup>377</sup> Po aty

<sup>378</sup> Po aty, fq. 106

<sup>379</sup> “Përlindja e Shqipërisë”, Vlorë, 28 mars 1914, fq. 5

<sup>380</sup> Nika, Thimi. Vepër e cituar, fq. 70

<sup>381</sup> “Përlindja e Shqipërisë”, Vlorë, 28 mars 1914, fq. 5

<sup>382</sup> Phipps. S. John, *Pullat dhe postat e Shqipërisë...*, Korçë, 2002, fq. 140

Qukës e Lezhë. Edhe tarifat mbetën po ato të administratës osmane.<sup>383</sup> Në këtë kohë dërgesat postare shpërndareshin me mjete primitive. Sikurse dëshmojnë kujtimet e asaj kohe,<sup>384</sup> shitja e pullave dhe pranimi i letrave bëhej nga një nëpunës. Tarifat për letrat e thjeshta ishin një grosh dhe për të porositurat ishte dyfishi i vlerës. Posta brenda vendit transportohej nga një kalorës poste-mbartës hipur në një kalë dhe i shoqëruar nga një xhandar i armatosur, edhe ky kalorës, i cili shkonte me postë-mbajtësin sa herë që përgjegjësi i Postës e shihte të nevojshme për të siguruar fondet që transportoheshin nga një qytet në tjetrin. Në atë kohë nuk kishte shërbim mandat-poste dhe fondet qarkullonin në monedha tringëlluese, ari dhe argjendi. Nëpërmjet shitjes së këtyre pullave të ardhurat që u derdhën në arkën e qeverisë ishin të konsiderueshme. Duke patur parasysh faktin që niveli i eksporteve në vend ishte thuhetse zero, kur të ardhurat nga burime të tjera ishin të papërfillshme, kur niveli ekonomik i vendit në përgjithësi ishte shumë i ulët, shitja e pullave me mbishtypje lehtësoi mjaft finanacat qeveritare. Këtë e dëshmon edhe fakti që as një muaj më vonë, në 1 qershor, u hodh në qarkullim pulla e dytë me mbishtypje, teknikisht e njëjtë me të parën, e shtypur mbi zarfe në disa ngjyra me një vulë dore, po të rrumbullakët, me mbishkrimin “Posta e Qeverisë së Përkohshme të Shqipërisë”.<sup>385</sup> Edhe këto pulla nuk e kishin çmimin të shënuar dhe as shqiponjë, por shiteshin gjithashtu me 1 grosh në të gjitha zyrat e postës ku ishte shitur edhe pulla e parë dhe, veç atyre edhe në zyrën e Shkodrës.<sup>386</sup> Kështu ishte gjetur një mënyrë e ligjshme për të shtuar të ardhurat në arkën e shtetit të sapongritur shqiptar. Këto fitime e nxitën Lef Nosit, që gjatë periudhës nga marsi në dhjetor, të hedhë në qarkullim 5 emisione pullash me mbishtypje të cilat do t’i sillnin financave të Qeverisë së Vlorës një shumë prej gjysëm milion grosh, që të konvertuara në lira turke (ar) me kursin e vitit 1914, do të arrinin shumën prej 4700 lira turke.<sup>387</sup> Falë këtyre fitimeve Ministri i Postave do të vendosë të realizojë një emision të përhershëm të pullave shqiptare të cilat jo vetëm në përmbajtje e grafikisht do të ishin kombëtare, por edhe vlera e tyre nuk do të ishte më në grosh, monedhë kjo osmane, por në franga, dëshmi kjo e përpjekjeve për t’u shkëputur nga elementët e “kulturës ekonomike” lindore dhe prirjes për përdorimin formave perëndimore në organizimin e brendshëm të vendit. Ditën kur shqiptarët festuan 1 vjetorin e shpalljes së pavarësisë së vendit, ministri i Postave, Lef Nosi, do të nxjerrë në qarkullim serinë e pestë të pullave të cilat kishin shqiponjën në qendër dhe çmimin nën të. Këto pulla të cilat u shitën vetëm në zyrën postare të Vlorës u përdorën deri në 30 dhjetor 1913.<sup>388</sup> Administrata postare e Vlorës vuri në përdorim vulat e para në gjuhën shqipe duke suprimuar vulat e mëparshme që ishin në turqisht. Për këtë ajo përgatiti edhe vulë-datat jo

<sup>383</sup> Revista “Koleksionisti”, nr. 3, viti 1999, f. 5

<sup>384</sup> Po aty, fq. 9-10, kujtime të Milto Korçarit, shpërndarës në zyrat postare shqiptare gjatë vjeshtës së 1913-ës.

<sup>385</sup> Po aty, f. 6

<sup>386</sup> “Përlindja e Shqipërisë”, Vlorë, 28 mars 1914, fq. 5

<sup>387</sup> Revista “Koleksionisti”, nr. 3, v. 1999, f. 5

<sup>388</sup> “Përlindja e Shqipërisë”, Vlorë, 28 mars 1914, fq. 6

vetëm për 11 zyrat postare në varësi të saj, por për 18 zyra duke përfshirë edhe Tepelenën, Starovën dhe Korçën, qytet ky i cili në këtë kohë ndodhej nën pushtimin grek.<sup>389</sup>

Ndonëse me shpalljen e Pavarësisë, pas përpjekjeve shekullore kundër invazionit perandorak ottoman, populli shqiptar i kishte treguar mbarë botës vullnetin e tij të palëkundur drejt lirisë e progresit, sidoqoftë çështja shqiptare nuk kishte arritur të gjente një zgjidhje politike përfundimtare në kuadrin e zhvillimeve rajonale. Për fat të keq, edhe pse me një qeveri kombëtare, kufijtë territorialë të Shqipërisë po përcaktoheshin në Londër pa praninë e ndonjë përfaqësuesi zyrtar shqiptar. Bllokada greke, e ngritur përgjatë bregdetit shqiptar, e pengoi Qeverinë e Përkohshme të komunikonte lirisht me përfaqësuesit e saj në Konferencën e Ambasadorëve – Mehmet Konicën, Rahsim Dinon dhe Filip Nogën. Gjatë pranverës së vitit 1913 pozita e Qeverisë së Përkohëshme ishte bërë më kritike. Ato pak lajme që vinin nga jashtë mbi shpëputjen e tokave të tjera prej trupit të Shqipërisë, shkaktonin një hutim dhe dëshpërim të përgjithshëm. Në këto kushte qeveria nuk mund të vazhdonte normalisht veprën për stabilizimin e gjendjes së brendshme të vendit dhe për ngritjen e të gjitha strukturave shtetërore. Për të mbrojtur tërësinë tokësore të Shqipërisë dhe të drejtat kombëtare të shqiptarëve, në pranverë të vitit 1913 (30 mars) një delegacion i Qeverisë së Vlorës, i kryesuar nga Ismail Qemali e me pjesëmarrjen e ministrit të arsimit, Luigj Gurakuqit, dhe të Isa Buletinit u larguan për rreth 3 muaj nga Shqipëria dhe udhëtoi në kryeqytetet e disa prej Fuqive të Mëdha evropiane.<sup>390</sup>

Ndërsa problemi i shtetit shqiptar priste zgjidhje në tavolinën e diskutimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër (17 dhjetor 1912), përfaqësuesve të Qeverisë së Përkohshme iu desh të përballen me situatën e rënduar në vend për shkak të pranisë së ushtrive pushtuese të fqinjëve ballkanas. Nga krahinat e pushtuara vinin lajme për mizoritë që bënin serbët e malazezët mbi popullsinë shqiptare. “Asnjë turk nuk ishte sjellë aq keq kundër armenëve, - do të shprehej zonja Durham, - sesa këta dy popuj serb kundër shqiptarëve.”<sup>391</sup> Në horizontin e politikës shqiptare, lajmet e hidhura që vinin nga Evropa e Ballkani sa vinin e shtoheshin dhe bëheshin shqetësuese. Ishte e pashmangshme që në Konferencën e Londrës Rusia të mos bënte përpjekje për t’u dhënë sa më tepër toka që të ishte e mundur të mbrojturve të saj pa marrë parasysh aspak dëshirat e popullsisë vendase.

Por edhe në vend gjendja nuk ishte më pak e vështirë, dhe kjo edhe për shkak të rivaliteteve të brendshme që po ia merrnin frymën shtetit të ri shqiptar që sapo kishte filluar veprimtarinë e tij. Situata rëndohej për shkak të veprimtarisë së Esat pashë Toptanit. Një fakt të tillë e dëshmon edhe qëndrimi i këtij personazhi të skenës politike shqiptare i cili, pikërisht në këto momente kur zgjidhja më e drejtë e problemeve të mëdha të kombit kërkonte bashkimin e tërë forcave politike në vend, ndjek rrugën e

<sup>389</sup> “Koleksionisti, nr. 3, v. 1999, fq. 10

<sup>390</sup> Myzyri, Hysni. *Shkolla Normale...*, Tiranë, albPAPER, 2004, fq. 290

<sup>391</sup> Durham, Edith. *20 vitet e trazirave të mëdha*, Tiranë, 2001, fq. 266

shkëputjes dhe kundërvënies ndaj Qeverisë së Vlorës dhe masës që ajo përfaqësonte. I ndodhur në Romë, pas qëndrimit dy ditë në Bari (Itali) “...për të mbledhur të holla në favor të Shqipërisë, në rradhët e shqiptarëve me banim në atë qytet”,<sup>392</sup> Luigj Gurakuqi i shkruan Ministrit të Postave, Lef Nosit. Tematika e kësaj korrespondence kapërcen kufijtë e përpjekjeve që duheshin bërë mbi mbarëvajtjen e punëve të Qeverisë së Vlorës dhe përqëndrohet në problemet që kishte shkaktuar qëndrimi i Esat Toptanit dhe përpjekjeve për izolimin e veprimtarisë së tij. “*Puna e Esatit duket se po merr fund...- shkruante Luigj Gurakuqi në pranverë të 1913-ës - ...nga lajme që erdhën këtu nga konsulli i Durrësit merret vesh se ka mbetur pa anëtarë. Që t’ia pres këmbët po mundohem që me anën e Italisë e të Austrisë të përgatis vajtjen tonë në Shkodër. Si të marrim dhe sundimin e Shkodrës atëherë Esadit nuk i mbetet më fuqi*”.<sup>393</sup> Situata kërkonte që të vepronin shpejt por edhe në fshehtësi. “*Këtë punë përveç shokëve të Ministrisë e miqve të afërm e besnikë mos ia trego askujt tjetër.- theksonte L. Gurakuqi në letrën dërguar L. Nosit- Kam lidhur edhe me Prenk Bibdodën...presim këto ditë Ismail benë e pastaj do nisemi për në Shkodër ku kemi dërguar njerëz të merren vesh me krerët e vendit e të bëjnë përgatitjet e nevojshme*”.<sup>394</sup>

Meqenëse vetëm qyteti i Shkodrës ndodhej nën administrimin ndërkombëtar, në korrik, nga Vlora u dërgua një komision qeveritar i kryesuar nga Luigj Gurakuqi në krahinat e rrethit të Shkodrës, ku nuk shtrihej pushteti i komisionit ushtarak për të vendosur lidhje të drejtpërdrejta me popullsinë vendase. Përballë vështirësive të mëdha të situatës në vend, qeveria e Vlorës vlerësoi si rrugën më të drejtë për kapërcimin e tyre, bashkimin e shqiptarëve e lidhjen e krahinave me njëra- tjetrën, në veçanti të krahinave që bënin pjesë në territorin e kontrolluar nga Qeveria. Shtypi i kohës nënvizonte se: “Të gjithë kanë dëshirë për paqe e për bashkim, e se për të kryer këtë qëllim krerët dhe të parët e malevet, të fushavet e të qytetit, për së shpejti do të mbajnë një mbledhje të madhe, ku shpresojnë të hedhin themelin e një bashkimi të plotë nga i cili do të rrjedhë pastaj edhe marrëveshja me qeverinë tonë të përkohshme”.<sup>395</sup> Paria e Malësisë së Madhe dhe Ded Coku, qeveritar i Lezhës, u bashkuan me administratën e Vlorës. Po kështu veproi edhe kapedani i Mirditës, Prek Bibdoda. Në fund të verës së 1913-ës Qeveria e Vlorës dukej se ishte vënë në rrugën e shtrirjes graduale të autoritetit të saj deri në përfshirjen e plotë të tokave që i mbeteshin Shqipërisë sipas marrëveshjeve të Fuqive të Mëdha.

Edhe L. Nosi do të punojë me një kujdes të veçantë për shtrirjen e autoritetit të qeverisë në zonat nga ku po tërhiqeshin forcat serbe. Fuqitë Perëndimore e kuptuan lakminë e Rusisë, e cila vepronte nën pretekstin e mbrojtjes së ortodoksëve sllavë, dhe kërkuan ta ndalojnë atë duke urdhëruar Malin e Zi dhe Serbinë të tërhiqen nga Shkodra e Durrësi. “Sot do të bëhet këtu (Vlorë - shënimi im) një miting për punë të Shkodrës, - i shkruante Lef Nosi, Shefqet Daiut dhe Idhomen Kosturit. – Lushnjën serbi e zbraz. Unë

<sup>392</sup> Puto, Arben. *Pavarësia shqiptare...*, Tiranë, 2007, fq. 156

<sup>393</sup> AME, F. 20, D. 10, nr. 20, f. 2, letër e datë s 18 maj 1913

<sup>394</sup> Po aty

<sup>395</sup> “Përlindja e Shqipëniës”, Vit’I, 23 gusht 1913, f. 3

mbase me Abdi benë (Toptanin) duhet të shkojmë në Durrës e Tiranë, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, sapo ato të zbrazen nga serbët”.<sup>396</sup>

Shkodra do të bëhet arena ku u pasqyruan qëndrimet e kundërta të Esat pashës dhe Qeverisë së Vlorës. Në janar të 1913-ës, Ismail Qemali, duke pasur edhe përkrahjen e patriotëve shkodranë, i kërkon gjeneral Hasan Riza Pashës, vazhdimin e qëndresës në Shkodër nën flamurin kombëtar shqiptar. Qëndrimi aprovues i komandantit të garnizonit turk nuk arriti t’i japë frytet pasi në 30 janar Riza Pasha vritet dhe pasuesi i tij Esat Pashë Toptani, sikurse e kishte dëshmuar edhe më parë, nuk ishte aspak një “luftëtar” i shqiptarizmit. Në rrethana të tilla, në shkurt, vetë Lef Nosi niset drejt Shkodrës për të përcjellë kërkesën e Qeverisë kombëtare të Vlorës për vazhdimin e rezistencës nën një zë të vetëm shqiptar.<sup>397</sup> Por, ndërsa fuqitë europiane kishin vendosur që Shkodra t’i mbetej Shqipërisë, Esat Pasha, më 23 prill, ia dorëzon Malit të Zi qytetin verior shqiptar. Vetëm në maj trupat malazeze zbrazën qytetin dhe Shkodra kaloi nën administrimin ndërkombëtar të drejtuar nga admiral Bërne (Burney)

Ndërkohë edhe nga Evropa nuk vinin aspak lajme të mira. Që në fillim Fuqitë e Mëdha ishin treguar indiferente mbi ekzistencën e shtetit të ri. Ai u krijua për leverdi e jo me dëshirë dhe interesat e tij jetike u sakrifikuan që të mund të ruhej paqja në Evropë. Vetë sër Eduard Grei (Grey) do të shprehet në dhomën e komuneve: “Vështirësia për të arritur në një marrëveshje për kufijtë e veçantë [të Shqipërisë] ka qenë shumë e madhe. ...Duhej sjellë ndërmend që në arritjen e kësaj marrëveshje çështja e parë thelbësore ishte të ruhej mirëkuptimi midis vetë Fuqive të Mëdha dhe, në qoftë se marrëveshja për Shqipërinë e ka siguruar këtë, atëherë është bërë puna që është më thelbësorja në interes të paqes në Europë”.<sup>398</sup>

Në Konferencën e Ambasadorëve po zhvillohej një luftë e ashpër diplomatike për kufijtë e Shqipërisë, sidomos ndërmjet përfaqësuesve të Austro- Hungarisë dhe Rusisë. Kundërshtimet dhe mosmarrëveshjet e vazhdueshme midis Vjenës e Petërburgut kishin për objektiv fatin e qyteteve të Shkodrës, Gjakovës e Dibrës, sesa për të tjerat që ishin menduar tashmë t’i shkëputeshin trungut shqiptar.<sup>399</sup> Punimet e Konferencës treguan se problemi shqiptar u trajtua po aq padrejtësisht edhe nga vetë Fuqitë që kishin dalë në rolin e përkrahësve kryesorë të çështjes shqiptare, gjë e cila u reflektua në qëndrimin tolerant, madje përkrahës ndaj pushtimeve serbo-malazeze të tokave shqiptare nëse Austro-Hungaria do të shpërblehej me hapësira territoriale në favor të Perandorisë Danubiane. Kështu shqiptarët ishin të dënuar të “paguanin haraçin” e disfatës për një luftë që nuk ishte lufta e tyre.

“Siç duket Shqipëria do të humbas Prishtinën, Mitrovicën, Gjilanin, Pashovën, Kaçanikun, Ferizovikun, Kumanovën, Plavën dhe Gucinë... - shkruante Lef Nosi në shkurt të vitit 1913, - ...madje edhe Janinën, për të cilën në tjetër anë kemi lajme të sigurt se duan t’ia lënë Shqipërisë. Këtë javë Kongresi i

<sup>396</sup> AQSH, F. 32, D. 53, f. 3, letër e datës 14 mars 1913

<sup>397</sup> Po aty, D. 30, f. 10

<sup>398</sup> Swire, Joseph. *Shqipëria...*, Tiranë, DITURIA, 2005, fq. 133

<sup>399</sup> Selenica, Teki. *Shqipëria në 1927*, Tiranë, 1928, fq. 29



Londrës po bisedon çështjen e kufijve e vendimi do të botohet. Por duhet të dimë se kjo punë u vendos më përpara mes Austrisë dhe Rusisë e pastaj filluan bisedimet e Kongresit”.<sup>400</sup>

Më 22 mars 1913 diplomacia evropiane, duke mos respektuar asnjë prej parimeve etnike, historike, ekonomike e gjeografike, vendosi kufijtë veriorë të shtetit shqiptar. Kështu, me këmbënguljen e Rusisë, toka etnikisht shqiptare u dorëzuan si një sakrificë e gjallë në altarin e ambicjeve sllave. Vendimet e ndërkombëtarëve, ndonëse copëtuan rëndë trungun etnik shqiptar, u shoqëruan me tërheqjen e trupave serbe nga qytetet e pushtuara. Në 21 prill 1913 serbët largohen nga Elbasani në të cilin u vendos rregulli që administrohej në mënyrë të admirueshme nga Aqif Pasha. Që nga ky moment Elbasani, sëbashku me rrethinat, u vunë nën autoritetin e Qeverisë së Përkohëshme, madje do të shndërrohet në kryeqendrën administrative të shtetit të ri shqiptar. Gjatë verës së 1913-ës, në Shkodër Lef Nosi merr letër nga i vëllai, Nikolla në Elbasan: “Qyteti ynë po zbrazet krejt prej ushtrisë së okupacionit dhe administrata lokale kalon tek bejlerët të cilëve iu dorëzua prej komandantit serb. Në drekën që u dha me rastin e përcjelljes, ku muarën pjesë edhe të krishterë, u çkëmbyen fjalime entuziaste për vëllazërimin e bashkëjetesën paqësore në të ardhmen. Uroj që koha të mbyll plagën dhe të mos shkojnë kot shpresat për shtetin shqiptar që po lind, por t’u përgjigjen ëndrrave të të gjithëve dhe ty të uroj kthim të shpejtë dhe vendin që të takon në jetën politike të atdheut tonë”.<sup>401</sup>

Ndërsa në viset veriore të Shqipërisë, Fuqitë e Mëdha kishin vendosur vijën e copëtimit të tokave shqiptare, vazhdonin ende përpjekjet për kufijtë jugorë. Në mars të 1913-ës, marrëveshja italo-austriake për kufirin shqiptaro-grek, parashikonte që Korça dhe Gjirokastra t’i liheshin Shqipërisë, kurse Janina mbetej jashtë saj. Pikërisht për këto përpjekje Lef Nosi do të informohet nga miku e kolegu i tij, Luigj Gurakuqi, në një letër të këtij të fundit në maj të vitit 1913. “Për kufirin e poshtëm të Shqipërisë, po mundohemi si në Londër, si këtu (Itali) me gjithë fuqinë, e po na sigurojnë se Korça e Konitza do të jenë tonat dhe nga ana e detit nuk do t’i japim Greqisë më tepër se deri në gji të Ftelias. Dr. Beratin e dërgova në Bukuresht të bëjnë edhe një meeting (takim) për Korçën...Të gjitha sa më ke lypun – do ta mbyll ai letrën dërguar Lef Nosit-po i bajmë gati edhe sa më shpejt t’i nisim...”.<sup>402</sup> Bëhej fjalë për porositë që ministri i Postave kishte bërë në fabrikat e Milanos dhe Torinos për pajisje telegrafike dhe pulla postare.

Ndërkohë pasi kishin arritur, sipas protokollit të Firences (17 dhjetor 1913), zotërimin e pjesës më të madhe të tokave të Çamërisë, një pjesë të Konicës dhe Kosturit, grekët tashmë, edhe më shumë, dëshironin të merrnin Korçën. “Pozita e saj gjeografike dhe strategjike e bën atë të paçmuar për të [Greqinë] dhe marrjen e saj thelbësore, ndërkohë që vlera e saj për Shqipërinë nuk do të ishte aq e madhe tani që Janina pa

<sup>400</sup> AQSH, F. 32, D. 55, f. 2, letër e Lef Nosit dërguar nënës së tij më dt. 21 shkurt 1913

<sup>401</sup> Po aty, D. 57, f. 30, letër e 21 korrikut 1913

<sup>402</sup> AME, F. 20, D. 10, f. 2

dyshim do të mbetet greke...”.<sup>403</sup> Pretendimet greke synonin zotërimin e rrugës Korçë- Ersekë, pjesë e rrugës kryesore nga Janina në Manastir dhe Selanik. Çështja ndërlikohej edhe nga lidhja e elementit të krishterë me kishën ortodokse “greke”, nga ekzistenca e shkollave greke, nga padituria e thellë e Evropës në lidhje me racën shqiptare dhe nga lidhja e saj sentimentale me Greqinë. Evropa as nuk mundej, as nuk donte ta kuptonte faktin thelbësor që një i krishterë greqishtfolës i Shqipërisë së Jugut nuk është aspak domosdoshmërisht grek nga kombësia apo nga ndjenjat.<sup>404</sup>

Veprimtaria e kishës greke vazhdonte të shkaktonte probleme madje u bë edhe më intensive jo vetëm në jug të vendit, po edhe në qytete që kishin dalë në mbështetje e kishin pranuar autoritetin e Qeverisë së Vlorës. Peshkopët grekë vazhdonin të ishin të pranishëm në jetën e vendit, madje duke punuar haptazi kundër interesave shqiptare. Kështu nga Elbasan, Lef Nosi informohet nga i vëllai, Nikolla, për vendimet dhe veprimet e dhespotit të Durrësit, jo vetëm ndaj priftërinjve ortodoksë shqiptarë, si në rastin e Papa Veniaminit të cilin e largon nga puna për ta zëvendësuar me një prift progrek, por edhe kundër Qeverisë së Vlorës. “Ay vetë (dhespoti) – theksohet në letër - bën propagandë në Durrës, Tiranë, Krujë, Shijak dhe fshatrat e tyre që të bëhet autonomi nën Turqinë me Guvernator Esatin...Pardie ka qenë propagandist serb, pastaj italian dhe sot merr rolin e një personi tjetër”.<sup>405</sup> Për Ministrin ortodoks të Postave, që e njihte dhe kishte kundërshtuar përpjekjet helenizuese të kishës greke dhe, që ishte përballur me veprimtarinë e dhespotit edhe gjatë ditëve kur shqiptarët e Elbasanit, Durrësit, Lushnjës etj ngrinin flamurin kombëtar e shpallnin shkëputjen nga Perandoria Osmane, tani, kur si pjesë e Qeverisë së Vlorës bëhen përpjekje për bashkimin e shqiptarëve “...kryepeshkopi, dita- ditës bie në gabime që janë në dëmin tonë...- do të shkruante Lef Nosi në pranverën e 1913-ës - ...dhe bëhet shkak lufte të ashpër mes vëllezërve tanë.”.<sup>406</sup>

Në këtë kohë Qeveria e Përkohshme u përballë edhe me kërkesën këmbëngulëse të Patrikanës së Stambollit për hapjen e një “shkolle ortodokse greke”, kërkesë që u kundërshtua fort nga ministri i Arsimit, L. Gurakuqi. Presionet për hapjen e shkollave të huaja në Shqipëri u bënë shkak për organizimin e mjaft protestave në Vlorë e qytete të tjera, të frymëzuara edhe nga thirrjet e bëra në organet e shtypit shqiptar brenda dhe jashtë vendit. “Ditën e enjte – do të shkruante “Përlindja e Shqipëniës” mbi mitingun e madh të mbajtur në Vlorë, - i tërë pazari i Vlonës u mbyll dhe populli me flamur në krye u përmbledh në sheshin Muradie ku mbajtën fjalë mbi çashtjen e qëllimit të mitingut z. Sabri Qyteza, Kosta Çekrezi dhe Muç Qulli duke treguar të tëra ngatërrimet që po dredhon qeveria Greke për me i futur ngatërrime qeverrimit shqipëtar dhe nevojën që asht me ia rrëfyer Fuqive të Mëdha të botës qytetnueme rreziqet qi don ti sjellin Greqia kombit shqipëtar dhe paqes së përgjithëshme”.<sup>407</sup>

<sup>403</sup> Swire, Joseph. *Shqipëria...*, Tiranë, DITURIA, 2005, fq. 141

<sup>404</sup> Po aty

<sup>405</sup> AQSH, F. 32, D. 57, f. 23, letër e dt. 1 maj 1913

<sup>406</sup> Po aty, f. 25, letër e Lef Nosit e dt. 19 maj 1913

<sup>407</sup> “Përlindja e Shqipëniës”, dt. 7/20 dhjetor 1913, fq. 5

Duke qenë se në pranverën e 1913-ës ndodhej larg Shqipërisë, Luigj Gurakuqi ia beson ministrit të Postave detyrën e prishjes së planeve të fqinjit tonë jugor për mësimin e gjuhës greke në territorin shqiptar. Për të mbajtur larg duart e Greqisë nga tokat shqiptare, Ministri i Arsimit i këkon Lef Nosit të ndërhyjë në shkatërrimin e projekteve për hapjen e shkollave greke në Vlorë e gjetkë. “Mbi këtë punë- i shkruan ai Lef Nosit- më shkruaj gjerë e gjatë pasi këtë shkollë duhet ta mbyllim me ndonjë shkak e mundohuni të hapni një shkollë shqipe të ditës për djemtë e një për vajzat”.<sup>408</sup>

Vetëm në shtatorin e vitit 1913, Qeveria e Përkohshme e Vlorës realizoi një nga kërkesat kryesore të rilindasve dhe patriotëve shqiptarë; gjuha shqipe u bë zyrtare në gjithë vendin. “Duhet që të gjithë t’a dinjë mirë se ç’në ditën fatbardhë që kur Shqipëria doli më vete, gjuha shqipe u bë gjuhë zyrtare e vendit”, - shkruante gazeta “Përlindja e Shqipënies” duke vënë theksin se nëpunësit që dinin gjuhën shqipe, me shkrim dhe lexim, do të hynin në shërbim të Qeverisë...<sup>409</sup>

Në korrik të 1913-ës Lef Nosi nga Shkodra niset në drejtim të Vlorës ku së shpejti do të mbërrinte At. Fan S. Noli. Ardhja e tij, në 8 korrik sëbashku me Dr. Turtullin,<sup>410</sup> entuziazmoi jo vetëm vlonjatët por edhe ortodoksët e Elbasanit të cilët “...kanë shkruar këtu ( në gazetën “Shqypnia e Re”, Shkodër – E.A) e kanë pyet kur do t’na vin Z. At Fan Noli për me na than meshën shqyp, se edhe pse nuk na kanë dhan urdhën dhespoti, na të gjithë e dona”. Gjatë kësaj periudhe rreth 120 familje nga malësia e Elbasanit, të cilët 20 vite më parë ishin konvertuar në fenë islame, kishin njoftuar Mitropolitin e Durrësit mbi dëshirën e tyre për tu rikthyer në ortodoks.<sup>411</sup> Por për shkak të problemeve shëndetësore Noli detyrohet të largohet nga Shqipëria. Ato ditë, nga Shkodra, Lef Nosi do të marrë lajmin për hapjen në qytet të zyrës së Postave dhe të Telegrafës “ ...që do të fillojë nga puna në gjuhën të ambël t’onën”.<sup>412</sup> Lajmi u prit me mjaft gëzim nga ministri i Postave i cili nuk do të vonojë por lidhet menjëherë me Shkodrën: “ U falemi nderës për përpjekjet qi batë qi të ndreqej vija Shkodër-Lezhë, - do të telegrafonte L. Nosi në drejtim të qytetit verior shqiptar – edhe iu përgëzojmë për bashkimin e Shkodrës trime me gjytete tjera të atdheut me anë të telegrafit. E rroftë Shqypnia e bashkueme e përparoft!”<sup>413</sup> Tashmë edhe Shkodra ishte përfshirë në hartën e zyrave postare të shtetit shqiptar. Por puna sapo kishte nisur dhe rruga ishte e gjatë. Dy ditë më vonë Lef Nosi do të shfrytëzojë faqet e gazetës “Shqypnia e Re” të Shkodrës, për të botuar “Urdhërin për Nëpunës të Postave e të Telegrafave” duke vënë theksin tek përdorimi i gjuhës shqipe në të gjitha zyrat e postë-telegrafave të shtetit shqiptar. “Telegrafistët do të stërviten me mësim domosdo, e do të dinjë me shkruar e me marrë telegrafat në gjuhën shqyp mirë dhe shpejt – bënte të ditur L. Nosi në këtë njoftim, - Edhe shkronjësit e

<sup>408</sup> AME, F. 20, D. 10, f. 2

<sup>409</sup> “Përlindja e Shqipënies”, Vit’I, nr. 10, dt. 30 shtator 1913

<sup>410</sup> “Dielli”, Boston Mass, 15 gusht 1913

<sup>411</sup> AIH, Vj. 22-15-1549. Njoftim i nënkonsullit a-h në Durrës, Rudnay për ministrin e Jashtëm, Berchtold.

<sup>412</sup> “Shqypnia e Re”, Mot’i I, nr. 8, dt. 27 korrik 1913

<sup>413</sup> Po aty

Postave lypset të dijnë mirë me shkrue gjuhën shqyp, se për nryshej nuk do të merren në shërbim”.<sup>414</sup> Në të njëjtën kohë ai do të dërgojë specialistë drejt Shkodrës për të plotësuar nevojat e ndërtesës së Telegrafës në qytet si edhe për të vendosur tre linja telegrafike “... njëra drejt për Romë, e dyta drejt për Vlonë dhe e treta me ndalime nëpër vende të tjera”.<sup>415</sup>

Në fund të verës ministri i Postave do niset në drejtim të qytetit të tij të lindjes. Gjatë rrugës atij iu desh të inspektojë edhe dëmet që një bandë turko-shqiptarësh kishte shkaktuar duke prerë telat e telegrafës në rrugën ndërmjet Elbasanit dhe Peqinit.<sup>416</sup> Në shtator ai mbërrin në Elbasan “në kryeqytetin e pastajshëm të Shqipërisë së re” – sikurse shprehet dhe vetë.<sup>417</sup> Dhe s’ ishte i vetëm në idenë e “Elbasanit- kryeqytet”, madje kjo çështje ishte bërë objekt diskutimi mes figurave kryesore të lëvizjes për pavarësinë e Shqipërisë e që shpesh gjendej e pasqyruar edhe në faqet e shtypit shqiptar të kohës. Aqif Pashë Biçaku, duke përfaqësuar edhe mendimin patriotëve të tjerë, veçanërisht elbasanas, që në ditët e para të përgatitjes së kuvendit kombëtarë në Vlorë, kishte shprehur kërkesën dhe kishte marrë edhe aprovimin nga Ismail Qemali për ta vendosur qendrën e shtetit të ri shqiptar, që pritej të ngrihej në Vlorë, në “kërthizën” e hapësirave të populluara nga shqiptarë, në Elbasan.<sup>418</sup> Ndonëse vendimet e Fuqive të Mëdha, për mosnjohjen e qeverisë së Vlorës si qeveri kombëtare të shqiptarëve, kishin filluar të zbehnin shpresat e Aqif Pashës për fjalën e dhënë, Ismail Qemali, përballë vështirësive jo të vogla, të brendshme e të jashtme, pas gati një vit qeverisjeje në krye të Qeverisë së Përkohshme, vazhdon të sigurojë nacionalistin elbasanas “...që e vlerësonte për dashurinë e njohur ndaj Atdhesë” se ndonëse koha kishte kaluar “...jam i sigurt se shpejt do të jemi në gjendje me ju dhanë sihariqin se Elbasani do të çpallet kryeqendër e Shqipërisë”.<sup>419</sup> Kjo ide kishte nisur të qarkullonte edhe në mendimet e studiuesve të huaj që vizitonin ato ditë të 1913-ës realitetin shqiptar. Miss Edith Durham do të shkruajë në shënimet e saj: “Elbasani ëndërron për një të ardhme të ndritur dhe vetë pozita e tij në qendër të vendit do të ishte ideale për kryeqytet... Patriotizmi në këtë krahinë është i zjarrtë dhe qëndron mbi të gjitha doktrinat fetare”.<sup>420</sup> Dëshmi të këtij patriotizmi vijnë edhe nga misionarët amerikanë që kishin ardhur në qytet me qëllimin për të blerë tokë e për të ndërtuar një kolegji, të cilin popullsia vendase e shikonte si një nga veprat e para të ringjalljes kombëtare. Ishte koha kur prindërit filluan të kundërshtojnë për të mos i dërguar më fëmijët në shkollat greke, pavarësisht thirrjeve të priftërinjve grekë.<sup>421</sup>

Edhe botuesi i famshëm anglez, Charles Woods, autori i librave “The Danger of Europe – La Turquie et ses voisins”, që kishte ardhur në Vlorë dhe kishte shëtitur edhe vise të tjera të Shqipërisë, gjatë

<sup>414</sup> Po aty, nr. 9, dt. 3 gusht 1913

<sup>415</sup> Po aty

<sup>416</sup> AQSH, F. 136, “Zv. Mitropolia. Durrës.” D. 11, f. 2

<sup>417</sup> AQSH, F. 32, D. 55, f. 2

<sup>418</sup> AQSH, F. 68, “Aqif Pashë Biçaku”, D. 5, f. 54. Letër (rumanisht) e I. Qemalit dërguar Aqif Pashës.

<sup>419</sup> Po aty, f. 53

<sup>420</sup> Durham, Edith. *Brenga e Ballkanit*, Tiranë, 1990, fq. 81

<sup>421</sup> Durham, Edith. *20 vitet e trazirave të mëdha*, Tiranë, 2001, fq. 274

kthimit për në Angli i deklaroi korrespondentit të gazetës “La Tribuna” në Romë: “Tri çashtje kanë një randësi të madhe për Shqipërinë:

**I.** Princ të jetë Wied-i, siç duket me qenë, dhe të vejë në Shkodër.

**II.** Me t’arrijtunit e princit lypset të çpallet Elbasani kryeqytet i Shqipëries.

**III.** Asht e nevojshme për t’u kujdesur, sa ma shpejt, për t’ikurit, një shumicë e madhe e të cilëve, gjindet në Shkodër, Tiranë, Elbasan e ndër shumë qytete të tjera... e ma të shumtët janë shqiptarë që rroshin ndër viset që janë dhanë Serbiës nga Konferenca e Londrës”.<sup>422</sup>

Fillimi i vjeshtës së vitit 1913 e gjen Lef Nosit në vendlindje ku ai u prit me mjaft entuziazëm nga bashkëqytetarët e tij. “Lef Nosi, Ministri i Postave, arriti këtu (Elbasan). Rrallë priti Elbasani njerëz ashtu si e pritë birin e tij, Lef Nosit.- do të shkruhej në faqet e “Përlindjes së Shqipërisë” atë fillim vjeshte të 1913-ës - Kalorës, flamurë, djem shkolle, as gja nga ato që mund t’a zbkuronin këtë pritje, nuk mungoi”.<sup>423</sup> Prej këtej Lef Nosi, bashkë me Eshref bej Kapon, inxhinier i dërguar nga Ministri i Punëve Botore, Mit’hat Frashëri, për të inspektuar rrugën që lidhte Elbasanin me Durrësin, nisen për në qytetin bregdetar. Ato ditë sapo kishin mbërritur nga Evropa mjaft pajisje telegrafike për Ministrinë e Postave dhe po shpërndaheshin në të gjitha zyrat e Shqipërisë. “Me këtë mënyrë, për së shpejti, sendet për të cilat ndjen aq shumë nevojë vendi ynë, telegrafi dhe posta, do të punojnë fare tjetërsoj. Shpejtësia, rregulla e të tjera cilësie të mira të këtyre zyrave do të tregojnë se administrata shqipëtare u largua dhe po largohet prapa prej administratës jetike të Turqisë”.<sup>424</sup>

Lef Nosi bëri mjaft përpjekje për ngritjen e rrjetit telegrafik në të gjithë territorin shqiptar. Nga kjo pikëpamje Shqipëria bëri mjaft përparime të shpejta e të shënuara, arsye që na bënë të kuptojmë edhe falenderimet në adresë të Ministrit të Postë-Telegrafave. “Me gëzim të math ju lajmërojmë çeljen e Telegrafit sot, në ora 12...- shkruante sundimtari i Shëngjinit, Ded Coku – dhe ju përgëzoj për lulëzimin, bukuriën dhe çeljen të Shqipërisë. Ene i falemi nderjes për të çpejtat përpjekje që keni treguar. Rroftë Shqipëria! ”.<sup>425</sup> Gjatë kësaj kohe u arrit të ngriheshin në mbi 10 zyra postare e telegrafike në qendra të ndryshme, urbane e rurale, të Shqipërisë. Konkretisht ky rrjet, gati një vit nga fillimi i aktivitetit të kësaj ministrie, ishte shtrirë në Berat, Fier, Lushnjë, Skrapar, Mollas, Elbasan, Qukës, Starovë, Lezhë, Shëngjin e Shkodër.<sup>426</sup> Megjithatë të ardhurat e siguruar nga shitja e pullave të mbivulosura ishin të konsiderueshme, ministri i postave nuk kishte hequr dorë nga ideja për prodhimin e pullave të mirëfillta shqiptare me një nivel cilësor sipas standarteve të kohës. Nisur nga ky qëllim ai kishte porositur në Torino (Itali) një seri

<sup>422</sup> “Përlindja e Shqipërisë”, Vlorë, 30 vjeshtë e III, 1913, f. 6

<sup>423</sup> Po aty, 4 vjeshtë e I, 1913, f. 5

<sup>424</sup> Po aty, 6 vjeshtë e I, 1913, f. 5

<sup>425</sup> Po aty, 7 vjeshtë e I, 1913, f. 5

<sup>426</sup> AQSH, F. 32, D. 54, f. 6

pullash me gjashtë vlera me portretin e Heroit Kombëtar, Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Por shtypja e tyre u vonua përtej çdo parashikimi. Përballë një realiteti të tillë kur ardhja e porosive nga jashtë vonohet ndërsa në sportelet e zyrve postare ndjehet mungesa e pullave, përtej punës së madhe që ishte bërë, kritikant nuk munguan. “Me një gëzim të madh muermë lajmin se telegrafa u vu në Shqipëri... – shkruante gazeta e Shkodrës në nëntor të 1913-ës - Na thanë qysh sot e gjashtë muej se pullat e Shqipërisë ishin të porositura dhe për së shpejti posta do të fillonte shërbimin e saj, por jo”.<sup>427</sup> Posta e brendshme nuk po arrinte të funksiononte siç duhet. “... na vjen keq t’i shkruajmë këto pak rreshta, se ministri i postave e i telegrafave asht një mik i dashtun i j’oni”- vazhdonte shkrimi në këtë gazetë, kopjet e së cilës shkonin deri në Elbasan e më pas nuk dihej fati i tyre kurse letrat nga Vlora arrinin në Shkodër përmes postave austriake dhe atyre italiane. Në fillim të dhjetorit, vështirësitë teknike u arritën të kapërcehen dhe pullat e postës shqiptare, të porositura në Torino, arritën në Shqipëri. Ndonëse, për fat të keq, mbishkrimi rreth portretit të heroit tonë kombëtar kishte gërmëzuar jo drejt emrin e tij, të shkruar “Skanderberg”, këto pulla, gjithsesi, përbëjnë serinë e parë të shtypur në mënyrë profesionale dhe të emetuara zyrtarisht nga qeveria shqiptare. Megjithatë në 1 dhjetor filloi emetimi i pullave me Skënderbe, nisur nga fakti se furnizimi i të gjitha zyrave postare shqiptare me pullat e reja nuk mund të kryhej menjëherë, Lef Nosi vendosi që të gjitha pullat e emetuara deri atëherë, me mbishtypje me shqiponjë, të mbeteshin të vlefshme edhe për disa ditë të tjera. Gjithashtu ai synonte që përmes shitjes së këtyre pullave, për të cilat kërkesat ishin të mëdha, si brenda edhe jashtë vendit, të mund të rriteshin të ardhurat për shtetin e ri shqiptar.

Por tashmë situata për qeverinë e Vlorës sa vinte e vështirësohej dhe kjo jo vetëm për shkak të rritjes së presionit nga Fuqitë e Mëdha. Ndasitë e brendshme dhe qëndrimi i Esat Pashës ndaj veprimtarisë së qeverisë së përkohshme, kishin sjellë mjaft probleme jo vetëm për shërbimin postar por për tërë veprimtarinë e shtetit shqiptar. “...Të gjitha këto vërejtje ia bëjmë edhe pleqësiës së Shqipërisë së Mesme, - vazhdonte shkrimi i mësipërm - e cila ka një të metë që s’i falet...se pse qysh sa na asht kurdisun nuk i len gazetat tona me shkue për në Elbasan me anë të Durrësit...prej shkakut se tuj kenë fleta e jonë e fjeshtë kombtare, nuk mund të bahet tarafi i saj”.<sup>428</sup> Prej gati dy muajsh kabineti i Qeverisë së Përkohshme, pas tërheqjes së Esat Pashë Toptanit (Ministër i Brendshëm) e të Myfid bej Libohovës (Ministër i Jashtëm), gjendej pa dy ministri. Pas tërheqjes edhe të Hasan Prishtinës e Avokat Çakos, ministrinë që mungonin u bënë katër. Por pavarësisht nga shkopinjë që i vinin në rrota nga anë të ndryshme, qeveria vazhdonte të rrinte në këmbë me 6 ministrat e tjerë. “Si do që të jetë puna,- do të shkruante “Shqipëria e Re” e Shkodrës,- kabineti i Vlonës rri i patundun dhe mbetet monopol i atyne patriotave që e përbajnë”.<sup>429</sup>

<sup>427</sup> “Shqipëria e Re”, Shkodër, nr. 39, dt. 20 nëntor 1913

<sup>428</sup> Po aty

<sup>429</sup> Po aty, dt. 14 dhjetor 1913



Për kapërcimin e vështirësive e për realizimin e detyrës që kishte marrë përsipër të kryente, Ministri i Postë-Telegrafave, përmes faqeve të shtypit të kohës, do t'u bënte thirrje të gjithë atyre shqiptarëve që kishin shërbyer apo vazhdonin të shërbenin në postat evropiane, që dinin mirë gjuhën shqipe, në shkrim e lexim, dhe njihnin një gjuhë të huaj perëndimore (frëngjisht), të viheshin në shërbim të sistemit postar e telegrafik shqiptar. Madje, nga kjo Ministri u kërkuan edhe mësues të gjuhës shqipe për të dhënë mësim, ortografike e kaligrafike, për zyrat e mëdha postare në fshat.<sup>430</sup> Çështja e arsimit shqip kishte marrë një rëndësi të madhe pasi “vetëm me një arsim të vërtetë mund të ngjallet e mund të mëkambet kombi i ynë e mund të fitojë të drejtën me hymun në rradhë të popujvet të qytetënuem” – do të shprehet edhe Ministri i Arsimit në Qeverinë e Përkohshme në thirrjen drejtuar të gjithë atyre që ishin të aftë për të kryer detyrën e mësonjësit për zhvillimin e shkollës shqipe.<sup>431</sup>

Kishte kaluar një vit që kur përpjekjet shumëvjeçare të rilindasve shqiptarë ishin kurorëzuar me shkëputjen përfundimtare të Shqipërisë nga sundimi pesëshekullor otoman. Mirëpo solidariteti dhe mirëkuptimi i fundit të vjeshtës së 1912-ës, një vit më pas, ishte cënauar rëndë. Pleqësia e Esat Pashë Toptanit kishte tërhequr me vehte edhe shumë përfaqësues të klasës së bejlerëve konservatorë, që ishin përfshirë në jetën politike një vjeçare të shtetit shqiptar. Përballë kritikave në rritje, të brendshme e të jashtme, qeveria e Vlorës kishte filluar të provonte edhe shijen e braktisjes e cila derdhi retë e ftohta të mosbesimit edhe midis patriotëve të rradhëve të para të betejës për pavarësi. Ditët e para të nëntorit të 1913-ës, Aqif Pasha ishte njohur, përmes letrës së Ismail Qemalit, me pamundësinë e shpërnguljes së qendrës së qeverisë kombëtare nga Vlora në Elbasan.<sup>432</sup> Por ftohja nuk prodhoi braktisje të nacionalistit elbasanas nga idealet e lëvizjes kombëtare. Madje në këtë kohë vijnë lajme se Qeveria e Përkohshme e Vlorës “mendon të ftojë një mbledhje kombëtare në Elbasan. Qëllimi ma i parë i kësaj mbledhje do të jetë të zgjidhunit e ngatërresave të brendshme”.<sup>433</sup> Bëhej fjalë për përpjekjet që qeveria e përkohshme po bënte për t'i mbyllur problemet e brendshme para se princ Vidi, i zgjedhuri i Evropës, të mbërrinte në Shqipëri.

Më 28 nëntor 1913, nga zyra e “Administratës së Telegrafëve të Shtetit Shqiptar”, Lef Nosi bashkë me Luigj Gurakuqin dhe Pandeli Calen i drejtojnë një telegram urimi Aqif Pashë Biçakut në Elbasan: “Në këtë ditë fatbardhë në të cilën u ngrit flamuri kombëtar iu dërgojmë urimet t'ona të nxehta”.<sup>434</sup> Po atë ditë Lef Nosi u telegrafon të gjitha zyrave postare të vendit: “Dita e sotme e Pavarësisë tonë Kombëtare, që të huajt na e kishin grabit sot e 500 vjet, është më e shenjata dhe më e lumtura ditë për të gjithë kombin shqiptar. Sot stërgjyshit tonë që derdhën gjakun pa kursim për të mos e humb atë, çojnë kryet nga varret e marrin pjesë

<sup>430</sup> “Liri e Shqipërisë”, 1913, 13 shtator

<sup>431</sup> “Përlindja e Shqypëniës”, Vit' I, 6 shkurt 1913

<sup>432</sup> AQSH, F. 68. D. 5, f. 54, dt. 10 nëntor 1913

<sup>433</sup> “Shqypnia e Re”, Shkodër, nr. 36, dt. 9 nëntor 1913

<sup>434</sup> AQSH, F. 68, D. 5, f. 63

në këtë kremtim; dhe vllazërit që mbetën nën zgjedhën e armiqve, festojnë me zemër bashkë me ne duke prit përherë bashkimin me mëmën Shqipëri...”.<sup>435</sup>

Pasi ishte rivendosur lidhja telegrafike e Shqipërisë së Poshtme me botën e jashtme përmes kabllit të Vlorës, në dhjetor të 1913-ës u vendosën marrëdhënie të drejtpërdrejta telegrafike të Shqipërisë së Sipërme me Italinë përmes shtrirjes së një kablli nën det midis skelës së Shëngjinit dhe Brindisit.<sup>436</sup> Përmisimi i rrjetit postar shqiptar i kishte dhënë mundësisë ministrit të Postës dhe veprimtarit të përhershëm të gjuhës dhe librit shqip, t’u drejtohej rretheve të shqiptarëve në Itali për të sjellë në vend libra shqip e për Shqipërinë. Në dhjetor të 1913-ës, nga Bolonja, Lef Nosit i vijnë libra italisht që flasin për Shqipërinë.<sup>437</sup>

Me fillimin e vitit 1914, Lef Nosi, vazhdonte përpjekjet për shtrirjen e linjës telegrafike në të gjithë territorin shqiptar, madje ai kishte dërguar në Evropë Mehmet Rizën, inspektor të Postë-Telegrafave, për të siguruar material postaro-telegrafik. Pas disa javë qëndrimi në Evropë M. Rizai kthehet në Vlorë duke sjellë me vete, midis shumë materialeve të nevojshme për modernizimin e zyrave postare, edhe 40 makina telefonike e 150 km tel të posaçëm për telefona. Një pjesë e këtyre makinave do t’u shpërndareshin postave të xhandarmarisë që do të ngriheshin në viset e lëshuara nga trupat greke. Vetë ministri i Postave, L. Nosi, do të përdorë gazetën zyrtare të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës për të dhënë informacion në lidhje me mënyrën sesi do të shpërndareshin këto materiale. Fillimisht Vlora do të lidhej me Fierin dhe ky i fundit me Beratin. Më pas vija telefonike do të kishte stacione në Berat, Lushnjë, Elbasan, Qukës, Starovë e Korçë. Këto ishin vetëm hapat e parë pasi synimi ishte që të gjitha zyrat postare të lidheshin me njëra-tjetrën. “Si një qendër e natyrshme telegrafike, – shkruante ai në faqet e gazetës “Përlindja e Shqipënisë” - do të jetë, sikundër duhet, Elbasani me të cilin do lidhen gjithë qytetet, e kështu Elbasani do të jetë kyçi i telefonave të Shqipërisë”.<sup>438</sup>

### **II.3 Qëndrimi i Lef Nosit ndaj veprimtarisë së Esat Pashë Toptanit**

Çështja e njohjes së pavarësisë së Shqipërisë ishte bërë shkak për thirrjen e Konferencës së Ambasadorëve në Londër dhe njëkohësisht objekt i diskutimeve të mprehta midis palëve pjesëmarrëse. Megjithatë, pas muajsh të tërë përpjekjesh e kompromisi dhe nën kërcënimin e vazhdueshëm të një lufte të përgjithshme, konferenca shpalli vendimin e saj përfundimtar më 29 korrik 1913:

- a. Shqipëria bëhet principatë autonome, sovrane dhe e trashëguar..., nën garancinë e Gjashtë Fuqive. Princi do të caktohet nga të Gjashtë Fuqitë.

---

<sup>435</sup> AQSH, F. 32, D. 54, f. 6

<sup>436</sup> “Përlindja e Shqipënisë”, Vlorë, 27 dhjetor 1913, f. 5

<sup>437</sup> AME, F. 22, D. 3, f. 7

<sup>438</sup> “Përlindja e Shqipënisë”, 15/28 janar 1914, f. 5

- b. Çdo lidhje suzereniteti midis Turqisë e Shqipërisë përjashtohet.
- c. Shqipëria është asnjënjë; asnjënjësia e saj garantohet nga të Gjashtë Fuqitë.
- d. Kontrolli i administratës civile dhe i financave të Shqipërisë i besohet një komisioni ndërkombëtar të përbërë nga delegatët e të Gjashtë Fuqive dhe një delegat shqiptar.
- e. Ky komision do të ngarkohet të përpunojë një projekt organizimi të hollësishëm për të gjitha degët e administratës së Shqipërisë...
- f. Qetësia dhe rendi publik do të sigurohen nga organizata ndërkombëtare e xhandarmarisë...<sup>439</sup>

Ministri amerikan në Greqi e quajti këtë plan “një mrekulli të paafëtisë”, por në kushtet e një vendi të rrethuar nga fqinjë lakmitarë, përkrahja ndërkombëtare që iu dha shtetit të ri, ishte ndoshta garancia më e mirë për mbijetesën e Shqipërisë.<sup>440</sup> Ndonëse vendimi i 29 korrikut ishte një hap mbrapa krahasuar me dëshirën e shqiptarëve, pasqyruar në vendimin e 28 nëntorit 1912 në Vlorë, ai mbarte në vetvehte një rëndësi të madhe pasi vuloste përfundimisht dështimin e planeve të aleatëve ballkanikë lidhur me copëtimin, mes tyre, të tokave shqiptare. Personalitetet shqiptare që vunë nënshkrimin në aktin e Kuvendit të Vlorës, pavarësisht nga trauma që pësuan me cungimin e trojeve të tyre, e përshëndetën vendimin e Konferencës së Ambasadorëve, pasi u krijua një shtet i pavarur shqiptar, që do të shërbente si pikëmbështetje për të realizuar në të ardhmen programin madhor të Rilindjes Kombëtare.

Pavarësia e Shqipërisë më në fund u njoh nga Fuqitë e Mëdha, të cilat caktuan edhe kufijtë e saj. Por gjendja në Shqipëri vazhdonte të ishte e turbullt. Vështirësi jo të vogla i dolën Qeverisë së Përkohshme në realizimin e projektit për bashkimin e krahinave shqiptare rreth saj. Në maj të vitit 1913 Fuqitë e Mëdha u kërkuan trupave serbe e malazeze të tërhiqeshin nga Shqipëria Qendrore dhe Veriore. Serbia, e cila po humbiste portet e Shkodrës e të Durrësit, la pas një vazhdë shkatërrimesh gjatë tërheqjes së forcave të armatosura nga “dritarja e hapur drejt botës”, aq shumë e dëshiruar prej saj.<sup>441</sup> Pasi u tërhoqën nga një pjesë e Shqipërisë së Mesme e asaj Veriore, serbët caktuan arbitrarisht një “kufi strategjik” për të siguruar gjoja mbrojtjen nga sulmet eventuale shqiptare. Ndërkohë grekët vazhdonin të mbanin të pushtuara krahinat jugore të vendit. Por zgjidhja e problemeve për shtetin e ri shqiptar bëhej akoma më e vështirë për shkak të veprimtarisë së Esat Pashë Toptanit. Dikur shërbëtor i Turqisë së vjetër, më pas anëtar i komitetit “Bashkim dhe Përparim” i turqve të rinj, duke punuar gjithmonë për fuqi vetjake, ishte bërë tashmë shërbëtor i sllavëve. Dorëzimi i Shkodrës Malit të Zi, në prill 1913, shënon edhe hyrjen e Esat Toptanit në historinë shqiptare. Këtu zuri fill edhe lëvizja e tij përçarëse që do t’i qëndrojë si një trup i huaj Lëvizjes Kombëtare Shqiptare deri në mbarim të Luftës së Parë Botërore.<sup>442</sup> Duke përfituar nga tërheqja e autoriteteve serbe, Esat Pasha në krye të forcave të armatosura shqiptaro-turke që kishte marrë me vete nga Shkodra, pasi ia

<sup>439</sup> *Qeveria e Përkohshme e Vlorës...*, Tiranë, 1963, fq. 160

<sup>440</sup> *Kombi*, New York, USA, shb ONUFRI, 1997, fq. 272-273

<sup>441</sup> Jacques, Edwin. *Shqiptarët...*, Tiranë, 1995, fq. 378

<sup>442</sup> Puto, Arben. *Pavarësia shqiptare...*, Tiranë, 2007, fq. 176

kishte dorëzuar qytetin verior shqiptar Malit të Zi, ishte vendosur në Shqipërinë e Mesme e po përpiquej të ngrinte pushtetin e tij në këtë rajon duke iu kundërvënë kështu autoritetit të Qeverisë së Vlorës. “Rezervat e Shkodrës erdhën – do t’i shkruante Lef Nosit i vëllai, Nikolla, nga Elbasani në prill të 1913-ës, - veç ushtrisë së rregullt të cilët mbahen në Tiranë prej Esatit bashkëatdhetarët e të cilit e pritën me brohoritje ushtrinë e mundur!... Qyteti ynë (Elbasani) tani paraqet heshtje varreze për arsye të zbrazjes së plotë. Serbërit u zëvendësuan prej një shumice oficerësh turq të cilët po sillen si zot shtëpie”.<sup>443</sup>

Në maj të 1913-ës Esat Pasha hapi fjalë se kishte ndërmend të krijonte një qeveri në Durrës, veprim ky që do të ishte vërtetë i pabesë dhe dashakeqës për shtetin e ri shqiptar, ende të panjohur ndërkombëtarisht. Por nuk do të vonojë shumë që të shfaqet dobësia e pozitës së Esat Pashës. Sapo Vjena (maj 1913) pohoi njohjen e qeverisë së Vlorës si përfaqësuese të të gjithë Shqipërisë, erdhi dhe marrëveshja e Fuqive për tërheqjen e trupave turke nga Shqipëria, fakt ky që i hoqi Esat Toptanit mbështetjen kryesore dhe e detyroi atë të pranojë, në qershor, ofertën që iu bë nga Ismail Qemali, me rekomandim edhe të Vjenës e të Romës. Ndonëse formalisht e pranoi drejtimin e Ministrisë së Brendshme në Qeverinë e Përkohshme, në Vlorë ai qëndroi vetëm pak ditë, pasi aktivitetin e tij do ta përqëndrojë në Durrës. Ai nuk u ul kurrë në karriken e Ministrit të qeverisë së Vlorës pasi pak ditë më vonë do niset në drejtim të Tiranës, nga ku më 13 korrik 1913, do të deklarojë dorëheqjen nga posti i ministrit. Në fillim të verës së 1913-ës, Grigor Nosi i shkruan të vëllait, Lef Nosit, në Vlorë: “...kam marr vesh prej burimi të mirë se i mallkuari Esat Pasha përpiket të hedh farën në Shën Gjoni, Fikaj e gjetkë; do të infektojë edhe Çermenikën. Për këtë na vjen shumë keq mos na sjell ndonjë ngatërrim”.<sup>444</sup> Veprimet e Esat Pashës u ndikuan fort edhe nga mosnjohja si qeveri kombëtare e Qeverisë së Vlorës nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër. Ky vendim do të nxisë një lidhje akoma më të fortë të elementëve konservatorë me Esat Toptanin tek i cili ata shihnin rrugën e ruajtjes së pushtetit dhe privilegjeve që gëzonin që në kohë të Turqisë. Në këto kushte forcat nacionaliste të ndodhura në Vlorë bënë përpjekje për formimin e një partie “nën emrin kombëtare”, që synonte forcimin e unitetit në rradhët e rretheve patriotike shqiptare, në të cilën merrnin pjesë atdhetarë si Luigj Gurakuqi, Lef Nosi, Sotir Peci etj.<sup>445</sup> Këto përpjekje u shtrinë edhe në rradhët e nacionalistëve elbasanas. “...Sikurse e kishim lajmëruar edhe përpara, dihet shumë mirë, se edhe në Elbasan, për mbas iniciativës së Midhat Bej Frashërit... – do të shkruhet në faqet e gazetës “Shqypnia e Re” - ...do ngrehun edhe atje një parti kombëtare me një program të përkohshëm...”.<sup>446</sup> Në korrik, Lef Nosi informohet përsëri nga Grigori për veprimet e rradhës të Esat Pashës dhe përkrahësve të tij. “...Sul Skuqi, i cili vjen me Postë nga Tirana, më thotë se Esat Pasha, Dervish beji kanë mbledh disa fshatarë, i ushqejnë dhe i shtytin që të kërkojnë përsëri Tyrqinë d.m.th

<sup>443</sup> AQSH, F. 32, D. 57, f. 20, letër e dt. 25 prill 1913

<sup>444</sup> Po aty, f. 41, Elbasan, 6 qeshor 1913

<sup>445</sup> “Shqypnia e Re”, Shkodër, 1913, nr. 48, f. 1

<sup>446</sup> Po aty

Babën; por qyteti ynë bashkë me rrethinat thotë se – baba vdiq”.<sup>447</sup> Në gusht ai kishte ndërprerë çdo lidhje me qeverinë e Vlorës, por akoma nuk kishte ardhur koha të dilte hapur.

Ishte marshimi i trupave serbe drejt tokave në brendësi të kufirit shqiptar, të përcaktuara dhe pranuar ndërkombëtarisht, që i dhanë zemër Esat Toptanit “të zbulojë kartat” në tavolinën e skenës së brishtë të politikës shqiptare. Ai shfrytëzoi këto momente për të organizuar, kundër Qeverisë së Vlorës, mitingje në Durrës, Kavajë, Shijak, Peqin e Krujë, duke minuar përpjekjet e saj për zgjerimin e kufijve të ushtrimit të autoritetit të shtetit shqiptar. Ngjarjet pasonin njëra-tjetrën dhe ambicjet e interesat personale arritën deri aty sa të tronditnin unitetin qeverisës të vendit dhe të rrezikonin fitoret kombëtare. Këto veprime bënë që në verën e 1913-ës në qarqet e Konferencës së Londrës të përhapet mendimi se Shqipëria, në pritje të vendimeve përfundimtare të Fuqive, ndodhej e copëtuar në një numër pushtetesh lokale.

Ndonëse Konferenca e Ambasadorëve ishte shprehur për kufirin verior të Shqipërisë, qeveria serbe ende në fillim të shtatorit nuk tregonte shenja se do të tërhiqej nga tokat brenda kufirit shqiptar që ajo vazhdonte t’i mbante në mënyrë arbitrare. Beogradi herë bënte fjalë për tërheqje e herë hapte posta doganore në kufirin shqiptar duke treguar se nuk kishte ndërmend t’i lëshonte ato territore. Javën e fundit të shtatorit popullsia e këtyre zonave, e zhytur në një dëshpërim të thellë nga keqbërjet e panumërta të autoriteteve serbe në të dyja anët e kufirit, nisi një lëvizje të fuqishme antiserbe. Kjo i detyroi serbet që të heqin çdo maskë diplomatike dhe të shpërthejnë me një valë të re mizorish mbi popullsinë shqiptare. “*S’e shkruan penda barbarizmin që punojnë serbët në viset që pushtojnë*”- do të shkruhej ato ditë në faqet e gazetës “Përlindja e Shqipënies”. Ndërsa komisioni i caktimit të kufijve ende s’ishte nisur, për shkak të pengesve ruse, serbët hynë në tokat krejt shqiptare pa pyetur aspak për forcat ndërkombëtare, ndërsa malazezët filluan shfarosjen e popullsisë shqiptare të Gashit e të Krasniqit. Ngadalësia me të cilën Fuqitë e Mëdha po organizonin komisionet e kufijve ishte një vonesë vrastare për shqiptarët. Vala e dhunës serbo-malazeze kundrejt tokave me popullsi cilësisht shqiptare kishte për qëllim paraqitjen e këtyre territoreve në sytë e komisionit, si toka me një shumicë sllave ku popullsia shqiptare të paraqitej në minorancë.

Në përpjekje për t’i qëndruar besnikë politikës së fqinjësisë së mirë, ministri i Qeverisë së Vlorës, Lef Nosi do t’i drejtohet me një letër kolonelit Milaievitch, të trupave serbe në Strugë, me qëllim shmangien e gjakderdhjes dhe zgjidhjen e konfliktit. “...mësova për operacionet tuaja mbi kufirin...- do t’i shkruante L. Nosi në shtator të 1913-ës - ...Ju lutem t’me informoni për qëllimet tuaja për të mos ngjarë një keqkuptim i ndonji natyre që t’errësojnë marrdhëniet t’ona të fqinjësisë.”<sup>448</sup> Këto territore pas largimit të trupave serbe në pranverë të 1913-ës, ishin zaptuar për pak ditë nga forcat greke. Por me tërheqjen e grekëve territori ishte vënë nën administrimin e trupave të xhandarmarisë shqiptare të kufirit “...që të ndalonte turbullirat. Me

<sup>447</sup> AQSH, F. 32, D. 57, f. 47, Elbasan, 8 korrik 1913

<sup>448</sup> AQSH, F. 32, D. 53, f. 4

afrimin tuaj xhandarmët tanë e lanë vendin.”<sup>449</sup> Mirëpo shteti shqiptar nuk u konsiderua asnjëherë “një fqinj i mirë” nga shtete ballkanike. Për përballimin e situatës, Qeveria e Vlorës, e përkrahur edhe nga krerët patriotë të Kosovës, mori masa për organizimin e rezistencës. Ndërkohë sjellja e serbëve në krahinën e Dibrës u bë kaq e keqe sa që popullata e zemëruar, duke përfituar nga rasti kur garnizoni ishte i pakët në forca, i ndoqi serbët jashtë territorit shqiptar. U çlirua Dibra, Ohri e Struga dhe brenda pak ditësh kryengritja u përhap në Gjakovë, Prizren e Tetovë.<sup>450</sup> Ndërsa valët e lëvizjes së armatosur kundër trupave serbo-malazeze godisnin fort ditët e 1913-ës, Lef Nosi merr letrën e Luigj Gurakuqit të përshkruar nga gëzimi për fitoret e arritura. “Sot po lahen turpet që hangrën nga të huajt. Kombet kanë nevojë për një histori faqebardhë e për zakone fisnike që të rrojnë e të zhvillohen. Jepuni guxim kryengritësve... pasi sot është koha ta tregoj veten kombi shqiptar”.<sup>451</sup> Ishte presioni i Fuqive të Mëdha që e bindi qeverinë serbe të tërheqë trupat e saj nga tokat e “Shqipërisë autonome”. Në kohën kur situata në kufijtë shqiptarë vazhdonte të ishte kaotike dhe e rrezikshme, një tjetër shqetësim i madh ishte bërë Esat Pasha dhe njerëzit e tij, si Dervish bej Biçaku në Elbasan, “i cili – siç shkruante Lef Nosi – kishte ngritur Çermenikën kundër Aqif Pashës duke goditur forcat e tij në Godoles”.<sup>452</sup> Shtatori i atij viti (1913) regjistron një korrespondencë të dëndur mes dy patriotëve, frymëzuesve dhe organizatorëve të lëvizjes shqiptare, me pushkë e me penë, Lef Nosit e Luigj Gurakuqit. Problemi qendror në komunikimin mes tyre do të jetë kufizimi i lëvizjeve të Esat Pashë Toptanit dhe masave që duheshin marrë për t’ju kundërvënë përpjekjeve të tij që dëmtonin rëndë çështjen kombëtare. Ndërsa Luigj Gurakuqi po përgatitej që me malësorët e Bregut të Matit të sulmonte forcat esadiste në Durrës, Lef Nosi dhe Aqif Pashë Biçaku po organizonin veprimet në zonën e Elbasanit për t’iu kundërvënë veprimtarisë së Pashait Toptanas në Shqipërinë e Mesme. Megjithatë populli i Elbasanit, me përjashtim të një pakice të vogël, ishte kundër veprimeve esadiste, ai nuk pranonte të mobilizohej në masë dhe të fillonte, në rast se shfaqej nevoja, një luftë vëllavrasëse.<sup>453</sup> “*Mbi ç’forcë mund të mbështeteni – kërkon të dijë Luigj Gurakuqi në letrën dërguar Lef Nosit, - nëse do të na duhet të nisim sulmin kundër Esat Pashës? A do të ishin të gatshëm burrat e Shpatit e të Martaneshit të marshonin drejt Peqinit e Kavajës? Dhe përpjekjet nuk mungonin nga patriotët elbasanas. “Por çështja është mjaft serioze, - shkruante Lef Nosi – dhe kemi filluar të marrim forca të tjera nën armë”.*<sup>454</sup> Të njëjtin mendim me të ndante edhe Aqif Pasha në letrën dërguar kryesisht së Qeverisë së Vlorës, sipas të cilit vetëm një fuqi qeveritare mund t’i bënte ballë situatës së vështirë që kishte krijuar Esat Toptani.

<sup>449</sup> Po aty

<sup>450</sup> *Qeveria e Përkohshme e Vlorës...*, Tiranë, 1963, fq. 17

<sup>451</sup> AME, F. 22, D. 10, nr. 21, f. 1

<sup>452</sup> Po aty, F. 20, D. 10, nr. 47, f. 1

<sup>453</sup> *Qeveria e Përkohshme e Vlorës...*, Tiranë, 1963, fq. 172

<sup>454</sup> Po aty, nr. 19, dorëshkrimi original është italisht: Luigj Gurakuqi: “...su quale forza potete contare se dovessimo fare una spedizione seria contro Essad Pasha? Gli uomini di Shpati e quelli di Martaneshi sarebbero disposti a marciare per occupare Peqini e Kavaja?”. Lef Nosi: “...la questione è molto seria ed abbiamo già cominciato a prendere anche altri gendarmi sotto le armi”.



Koha kërkonte të veprohej me mjaft kujdes, pasi pozitat e brendshme dhe të jashtme të Qeverisë së Vlorës ishin ende të dobëta, armët mungonin dhe situata në vend nuk ishte në favor të shpërthimit të një revolucioni. Për më tepër që Esat Pasha, duke shfrytëzuar postin e Ministrit të Punëve të Brendshme, kishte nisur përpjekjet për të fituar përkrahjen e Fuqive Perëndimore në realizimin e synimeve për kalimin e pushtetit në duart e tij. Madje, sapo u kthye në Shqipëri gjatë muajit gusht, pas vizitave në Romë e Vjenë, Esat Toptani u vendos në Durrës dhe filloi të organizonte xhandarmarinë. Gjatë vizitës së konsujve austro-hungarez dhe italian në Tiranë, Esat Pasha u kishte deklaruar atyre besnikërinë e tij ndaj Qeverisë së Përkohshme. Ndërkohë, fakti që ai kishte nën kontroll rreth 9000 burra i jepte atij një ndikim në vend, që nuk mund të mos merrej parasysh.<sup>455</sup>

Ndërmarrja e sulmit, pikërisht në këto momente, kundër Esat Toptanit dhe forcave të tij, për Ministrin e Postë-Telegrafave, ishte një hap që do t'u kthente kundër Qeverisë së Vlorës si opinionin publik të brendshëm ashtu edhe atë evropian. *“Mendoj se – shkruante Lef Nosi – qeverija jonë s’duhet të marrë përgjegjësinë mbi fillimin e gjakderdhjes e të një lufte vëllavrasëse... Me sa duket Esad Pasha nuk ka ndërmend të kthej armët kundra nesh por të fitojë autoritet në popull e të krijojë një qeveri të tij, qëllim që e ka shprehur edhe më parë”*.<sup>456</sup> Ato ditë të fundit të shtatorit, kur kishte nisur kryengritja e shqiptarëve kundër forcave serbe, Esat Pasha i kërkonte Qeverisë të ndërhynte dhe të tregojë energji se përndryshe do të fitonte urrejtjen e mallkimit të tërë botës. Pas kësaj kërkese qëndronte synimi për ta paraqitur Qeverinë e Vlorës përpara Fuqive të Mëdha si organizatoren e kryengritjes. Ky qëllim duket qartë në telegramin që ai i dërgon pas disa ditësh Aqif Pashës në Elbasan, ku ngjarjet e Dibrës i konsideronte të parakohshme e pa vend dhe rezultat i politikës së keqe të Qeverisë (I. Qemalit). Madje, ai fillon të shfaqet hapur kundër Qeverisë së Vlorës pikërisht në kohën kur ndaj saj ishin rritur kritikët e forcave patriotike në vend e të kolonive shqiptare të mërgimit, lidhur me disa dobësi në punën e saj.<sup>457</sup> Esat Toptani u tërhoq në Tiranë dhe kërkoi ristrukturimin e kabinetit, i cili, sipas tij, ishte armiqësor ndaj myslimanëve dhe zhvendosjen e tij në Durrës. Edhe përpjekjet e Myfit Libohovës e Pjetër Pogës, që u dërguan për të negociuar me Esat Pashën, nuk mundën të konkludojnë me arritjen e ndonjë marrëveshje. Rrjedhimisht *“duke qenë të paorganizuar e të papajisur me pushkë e topa, nuk do të mundeshim as ta sulmojmë e as ti shkatërrojmë planet e tij. E vetmja gjë që mund të bëjmë – deklaronte Lef Nosi, kur Fuqitë e Mëdha ishin shprehur për mosnjohjen e Qeverisë së Përkohshme dhe krijimin e një qeverie të re nga Princi i zgjedhur prej dyerve evropiane, - është të përpiqemi të mbajmë të bashkuara me Qeverinë krahinat e Shkodrës, Elbasanit dhe Vlorës, duke e shtrënguar Esadin të kufizohet veç në zonën e Durrësit*. Por kjo politikë kërkonte mbështetje të gjerë popullore dhe – *nuk duhet që peshën e presionit ndaj tij ta mbështesim veç tek katolikët e Shpatit dhe*

<sup>455</sup> Swire, Joseph. *Shqiptarët...*, Tiranë, DITURIA, 2005, fq. 154

<sup>456</sup> AME, F. 20, D. 10, nr. 19, f. 1 Përmbajtja e letrës do të jepet më poshtë në origjinal.

<sup>457</sup> *Qeveria e Përkohshme...*, Tiranë, 1963, fq. 19

bektashinjtë e Martaneshit, pasi kjo do t'i jepte luftës një përmbajtje të rrezikshme fetare – mendim të cilin Lef Nosi e kishte ndarë edhe me Aqif Pashën dhe kishte gjetur mbështetjen e këtij të fundit. Madje ai kishte mundur të siguronte edhe premtimin e Herbertit, që ishte nisur për në Tiranë, se – *do të përpiqej ta bindte Esadin të hiqte dorë nga planet e tij*".<sup>458</sup> Luigj Gurakuqi, ndërsa e pranonte arsyetimin e ndjekur nga Lef Nosi, ngre hijen e dyshimit se veprimet e Esat Pashës, që ishte kthyer në vegël në duart e grekëve dhe serbëve, që kishte prerë komunikimin mes Durrësit e Elbasanit, që vazhdonte të grumbullonte forca të armatosura, me ngritjen e një qeverie në Durrës, mund të shkaktonte fillimin e luftës mes forcave të tij (myslimane) dhe katolikëve të rajonit. "*Ndaj – shkruante Luigj Gurakuqi – i vetmi mjet që do ti impononte respekt Esadit dhe do të shmangte një konflikt të përgjakshëm do të ishte siguri i një force të madhe ushtarake çka do e bënte Esad Pashën të kuptonte se përpjekjet e tij ishin të kota*".<sup>459</sup> Por rritja e trupave të armatosura, në situatën ekonomike që ndodhej vendi, nuk ishte një ndërmarrje e lehtë. Shtimi i forcave të xhandarmarisë varej nga mjetet materiale (financiare), "*nga shuma e parave që mund të vëmë në dispozicion. – shkruante Lef Nosi – Ne mendojmë ta rrisim këtë forcë deri në 600- 700 vetë. Por na mungojnë armët ndaj edhe arrijmë të regjistrojmë vetëm ata që sjellin me vete edhe armën ...*".<sup>460</sup> Ndërkohë edhe regjistrimi i njerëzve, si xhandarë, me armët e veta ishte përsëri i vështirë, fakt që e pohon edhe Aqif Pasha kur njoftonte se "*deri tani janë regjistruar si të tillë vetëm nga 50- 60 veta*". "*Ndaj do të ishte më mirë – shkruante Lef Nosi – që këto ditë të mund të blinim disa municione, çka do të shkaktonte shqetësim e do të mund të dekujaronte disi forcat rebele...*".<sup>461</sup> Në këto kushte, nisur nga konflikti i mundshëm që mund të niste së afërmi me Esat Pashën, Qeveria e Përkohshme, sipas raportit të konsullit austro-hungarez në Vlorë, kishte realizuar tashmë porositë në fabrikën e armatimeve në Shtjar (A-H) dhe pranë firmave tregtare austriake të armëve dhe municioneve për mitralozë, fishekë, topa e predha.<sup>462</sup> Në kushtet e vazhdimit të rezistencës antiesadiste në Elbasan, Lef Nosi kërkon që qëndresa të shtrihet në të gjitha viset shqiptare të cilat nuk ishin bërë pjesë e influencës politike të Esat Toptanit. *Gjithsesi përpiquni – i drejtohet ai Luigj*

<sup>458</sup> AME, F. 20, D. 10, nr. 19, f. 3 Letër e Lef Nosit drejtuar Luigj Gurakuqit: "...abbiamo già cominciato ad aumentare la gendarmeria. Però ci mancano i fucili e le cartucce necessarie...il frutto di questa impreparazione è stata la nostra impotenza di oggi di non poter affrontare la rivoluzione. (Come ti dissi) io penso che sarebbe una cosa inutile e pericolosa se noi cominciassimo primi ad aprire le ostilità contro lui (Essad Pasha) perché allora avremo contro di noi l'opinione pubblica del Europa e del nostro paese, sarà certamente sfavorevole e addirittura contro di noi. Credo che noi dobbiamo tenirci sulla difensiva e non sulla offensiva e che il nostro governo non deve assumere la responsabilità di un spargimento di sangue e di una Guerra fraternal. Io penso che Essad non ha intenzione di prendere le armi contro di noi e tutta la sua opera consiste nel farsi reclamare dalla popolazione e formare un governo suo come era sua intenzione prima. Essendo disorganizzati e sprovvisti di armi e di canoni, noi non possiamo ne attaccarlo, ne distruggere i suoi piani. L'unica cosa che possiamo fare è quella di cercare di tenerci uniti e d'accordo con i distretti di Skutari, di Elbasan e di Valona, e di poter restringere così la sua opera limitandola nel sindacato di Durazzo. Non dobbiamo contare sulla forza dei basci-bozuk di Shpat e di Martaneshi perché allora la lotta prederebbe una piega religiosa e pericolosa, essendo come sai i shpatioti cristiani ed i martaneshi bektashi. Anche il governatore Aqif Pasha e dello stesso parere e mi disse di aver risposto a Qemal bej. Herbert mi ha promesso di cercare dissuadere Essad dai suoi piani ed è partito alla volta per Tirana..."

<sup>459</sup> AME, F. 20, D. 10, f. 4

<sup>460</sup> Po aty

<sup>461</sup> Po aty, f. 5

<sup>462</sup> Hoxha, Teuta. *I. Qemali*. Tiranë, 1982, fq. 322. Vlorë, 16 shtator 1913

Gurakuqit në vazhdim të shkrimit të mësipërm, - *që katolikët e Shkodrës e të Malësisë së Madhe të protestojnë kundër veprimeve të Esat Pashës duke e vënë atë në pozita të vështira. Të njëjtën gjë mund të bëjmë edhe ne këtu (Shqipëria e Mesme), veprime që do ta kthenin opinionin publik kundër Esadit*".<sup>463</sup>

Më 6 shtator 1913 Malësia e Mbishkodrës, pasi protestoi kundër vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve lidhur me aneksimin e Hotit dhe Grudës nga Mali i Zi si dhe të vilajetit të Kosovës nga Serbia, kishte shpallur bashkimin me Qeverinë e Vlorës. "*Fiset e maleve (malësorët) e njohin Qeverinë e Përkohshme në Vlorë dhe ulen në të gjitha urdhërat e saj*". Këtë bashkim e kishin deklaruar edhe më parë Malësia e Madhe, Lezha e Mirdita.<sup>464</sup> Gjatë këtyre ditëve populli i qytetit të Elbasanit dhe i fshatrave përreth, do të mbledhet në një miting për të protestuar kundër vendimit të Fuqive të Mëdha, në Konferencën e Londrës, mbi kalimin brenda kufirit të shtetit grek të "*Çamërisë së Shqipërisë së Jugut, e cila bën pjesë në integritetin e Shqipërisë dhe që flet gjuhën e kulluar kombëtare... Ky akt që në të ardhmen do të sjellë shkatërrimin dhe zhdukjen e kësaj pjese të Shqipërisë... pikëlloi tepër popullin e këtushëm... që vendosi t'i lutet të ndershmes Konferencë të caktohet një kufi që t'i lërë Çamërinë, që është thjesht shqiptare, e Shqipërisë, të cilës i përket*".<sup>465</sup>

Ndërkohë vala e mizorive serbe që shpërtheu në shtator, gjatë tetorit shkretoi krahinat e Dibrës, Strugës, Ohrit dhe Gollobordës në viset qendrore, si edhe Gashin, Krasniqin e Valbonën në veri. Drejtuesit e kryengritjes për Elbasanin, Irfan beu, Lef Nosi dhe Hafiz Sherifi, që kishin krijuar një grup prej 50 vetësh që do të drejtohej në ndihmë të popullsisë në Ohër e Strugë, vise etnikisht shqiptare që padrejtësisht iu njohën Serbisë nga Konferenca e Londrës, vazhduan të mbanin lidhje të pandërprera me Luigj Gurakuqin, Hasan Prishtinën dhe Ismail Qemalin, të cilët po përpiqeshin të fitonin përkrahjen e konsullit austriak për lëvizjen shqiptare si edhe për të siguruar armë, fishekë e të holla për revolucionin.<sup>466</sup> Ardhja e afërt e KNK-së në Shqipëri, me qëndrimin e saj tashmë të njohur kundrejt Qeverisë së Vlorës, shënonte edhe afatin e fundit e të papërsëritshëm, brenda të cilit lëvizja për shkëputje mund të kishte më tepër shanse për të minuar autoritetin qendror të Qeverisë së Përkohëshme. Pikërisht në këto momente Esat Pasha vendosi të realizojë shkëputjen përfundimtare nga Qeveria e Vlorës dhe formoi më 12 tetor 1913, në Durrës, "*Pleqësinë e Shqipërisë së Mesme*" të kryesuar prej atij vetë, si një pushtet i veçantë që nxirrte jashtë kontrollit të qeverisë së Vlorës, Durrësin e Tiranën me zonat përreth. I vetëdijshëm për territorin e gjerë ku mund të kishte dhe kishte ndikim, Esat Pasha filloi të ndërtojë një strukturë paralele. Vendimi i tij e bëri Shqipërinë

<sup>463</sup> Po aty, f. 3, "... abbiamo già cominciato ad aumentare la gendarmaria... ma l'aumento della forza dei gendarme dipende dai mezzi materiali, cioè dalla soma del denaro che potremo disporre. Noi pensiamo di poter aumentare la forza fino a seicento o settecento. Però ci mancano i fucili ed è perciò che possiamo iscrivere soltanto quelli che portano con se il fucile... Sarebbe meglio se si potesse coprire qualche cannone in questi giorni per incutere timore il che potrebbe scoraggiare alquanto il ribelle... Cercate ad ogni modo che i cattolici di Skutari e la Malissia protestassero contro Essad per poter così intimidirlo. Anche noi qui possiamo fare lo stesso. Questa opinione pubblica è contro di Essad".

<sup>464</sup> "Përlindja e Shqipërisë", Vit'I, 6 shtator 1913.

<sup>465</sup> *Qeveria e Përkohshme...*, Tiranë, 1963, fq. 226, dok. Nr. 11254

<sup>466</sup> AME, F. 20, D. 10, f. 2

me dy qeveri dhe dy administrata paralele. Vetëm pak ditë më parë Lef Nosi, në letrën dërguar kryetarit të Qeverisë së Përkohshme, e njoftonte Ismail Qemalin se Esat Pashë Toptani po përgatiste ushtri për të përmbysur Qeverinë e Vlorës. “Esad Pashai ban gati një ndryshim të qeverimit të Shqipëniës.- shkruante L. Nosi- Nji njeri që erdhi sot nga Durrësi më thotë se ish pjekun udhës me Dervish Benë që po shkonte nga Çërma për në Durrës. Ai i kish thënë se për tri ditë do të merrni vesht shumë të reja. Esadi po mbëledh njerës për të bamë nji ushtëri gjendarmësh 2000 vetësh me rrogë mujore 200 groshësh. Kamejkami i Kavajës thirri Pal Xhumarin edhe ia dha t’i këndojë nji letrë në gjuhë greqishte dërgue nga dhespoti i Durrësit atij të Beratit... Letra shkruente këto: Mas disa ditësh do të krijohet ndën kryesitë të Esad Pashës nji qeveri e re në Tiranë. Esad Pashai do të urdhënojë kabinetin e Vlonës të shkojë atje...”.<sup>467</sup>

Ndërsa vendimi i 11 gushti 1913-ës, Korçën ia la Shqipërisë, fati i Gjirokastrës u la në dorë të komisionit të kufijve të cilit iu dha orientimi që gjatë caktimit të vijës së kufirit në vend të merrte për bazë parimin e përzierjes “etniko-geografike” dhe, në mënyrë të veçantë, elementin e gjuhës së folur në familje.<sup>468</sup> Kështu lufta diplomatike rreth kufijve të shtetit shqiptar nuk mbaroi me mbylljen e punimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër. Ajo vetëm ndërroi selinë. Komisionet kufitare, në veçanti ai në jug, do të bëhen arenë e një ballafaqimi të gjatë e të vështirë.

Pashai Toptanas përpiket të shfrytëzojë vështirësitë e shtetit të ri shqiptar për ta paraqitur veten, në sytë e opinionit kombëtar e ndërkombëtar, “si shpëtimtarin e fuqishëm që kërkonte koha”.<sup>469</sup> Gjendja në vend rëndohet shumë më tepër se më parë. Duke filluar prej tetorit 1913 një faktor tjetër ndërhyri në jetën e brendshme politike të vendit. Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit (KNK) si edhe komisionet ndërkombëtare të caktimit të kufijve veriorë e verilindorë dhe atyre jugorë e juglindorë, mbërritën në Shqipëri. Kjo situatë u shfrytëzua nga qeveria greke e cila do të provokojë një të ashtuquajtur “lëvizje të banorëve toskë” për të justifikuar më tej depërtimin ushtarak të forcave greke që dogjën fshatrat shqiptare dhe masakruan banorët vendas. Nga Skrapari, Themistokli Gërmenji do t’i shkruante Ministrit të Postë-Telegrafave në Qeverinë e Vlorës, Lef Nosit, për situatën e rëndë të krijuar në vend: “*Ushtria greke me andartët vetdashës po bëjnë dëme të mëdha. Këtu përditë po vijnë shqiptarë të ikur nga frika se mos i vrasin. Myslimanëve iu merren armët dhe po armatosen të krishterët...*”.<sup>470</sup>

Gjatë përgatitjeve për vizitën e Komisionit Ndërkombëtar të Kufijve në Korçë, forcat pushtuese greke bënë të pamundurën që të inskenonin një demonstrim të besnikërisë ndaj Greqisë dhe të shpornnin apo shfarosnin popullsinë besnike shqiptare. Grekët, sigurisht, e njihnin Korçën si qendrën e hershme të shqiptarisë. Mirëpo Korça ishte edhe selia e një armiku të betuar të Shqipërisë, Peshkopit të Kishës

<sup>467</sup> *Qeveria e Përkohshme...*, Tiranë, 1963, fq. 227, dok. Nr. 318

<sup>468</sup> Puto, Arben. *Pavarësia shqiptare në tryezat e diplomacisë*, Tiranë, 2007, fq. 106

<sup>469</sup> Jacques, Edwin. *Shqiptarët...*, Tiranë, 1995, fq. 382

<sup>470</sup> AQSH, F. 32, D. 9, f. 1, letër e datës 31 dhjetor 1913

Ortodokse Greke, i cili kërkonte helenizimin me çdo kusht të popullsisë shqiptare.<sup>471</sup> Në qytetet jugore të Shqipërisë qenë ngritur reparte vullnetare për mbrojtjen e vendit. Ato mbanin lidhje të vazhdueshme me Qeverinë e Vlorës, të cilës i kërkonin ndihmë në të holla, ushqime dhe në forca ushtarake. Ndërkohë Qeveria, e ndodhur në kushte të vështira, kur nuk po mundte të krijonte një ushtri të rregullt, të cilën ta pajiste me armë dhe ta hidhte në luftë për mbrojtjen e atdheut, arrinte të dërgonte veç forca vullnetare e drithë në ato krahina ku situata ishte më e rëndë.<sup>472</sup> Në këto momente Lef Nosi do t'i shkruante Ministrit të Punëve të Brendshme, Myfit Bej Libohovës: “50 vetëdashës të krishterë duan armë për të shkuar në Korçë. Urdhëroni Prefektin që të na japë nga ato që erdhën sot këtu”.<sup>473</sup>

Ndërkohë, i kujdesshëm në grumbullimin e faktit historik, Lef Nosi mban shënime mbi ngjarjet kryesore të vitit 1913, rreth operacioneve serbe në veri të vendit dhe mbi veprimet e ushtrisë greke që vazhdonte të mbante të pushtuara viset jugore të Shqipërisë e kishte filluar një fushatë të dendur propagandistike për ta paraqitur popullsinë shqiptare të këtyre viseve, para syve të KNK-së, si popullsi greke që kërkonte bashkimin me Greqinë.<sup>474</sup>

Megjithëse Fuqitë e Mëdha e njohën pavarësinë e Shqipërisë më 29 korrik 1913, ato nuk e njohën Qeverinë e Vlorës si qeveri kombëtare. Nga ana tjetër, edhe Komisioni Ndërkombëtar i caktimit të Kufijve përcaktoi në terren vijën e copëtimit të Shqipërisë, duke shpërblyer fqinjët në veri, lindje dhe në jug me afro gjysmën e popullsisë shqiptare dhe të territorit të saj. Për shkak të këtyre vendimeve, për vite të tëra, hartat në muret e zyrave postare shqiptare i paraqisnin të hijezuara ato zona të “Shqipërisë së Skllavëruar”.<sup>475</sup>

Në kushte të tilla, kur Shqipërisë i mungonte një qeveri e njohur *de jure* në arenën ndërkombëtare, kur Qeveria e Vlorës trajtohej si një pushtet lokal nën kontrollin e KNK-së, dhe përpjekjet e saj për t'u shtrirë në gjithë territorin shqiptar gjetën kundërshtimin e Esat Pashë Toptanit, situata politike e shtetit të ri shqiptar mbetej shumë kritike.

---

<sup>471</sup> Jacques, Edwin. *Shqiptarët...*, Tiranë, 1995, fq. 380- 381

<sup>472</sup> Naska, Kaliopi. *Ismail Qemali...*, Tiranë, 1987, fq. 150

<sup>473</sup> AQSH, F. 32, D. 54, f. 7

<sup>474</sup> Po aty, D. 134, f. 1- 4

<sup>475</sup> Jacques, Edwin. *Shqiptarët...*, Tiranë, 1995, fq. 376

### KREU III. LEF NOSI GJATË VITEVE TË KONFLIKTIT TË PARË BOTËROR (1914-1918)

#### III-1 Realiteti politik shqiptar në prag të Luftës së Parë Botërore

Pas njohjes së pavarësisë së Shqipërisë nga Fuqitë e Mëdha në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, më 29 korrik 1913, në tetor mbërriti në vend Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit (KNK) i cili kishte për mision të realizonte organizimin e shtetit shqiptar, vepër që ai do ta kryente pa marrë parasysh aspak rolin dhe kontributin e Qeverisë së Vlorës në organizimin e brendshëm të vendit. Madje, që në fillim, ai shfaqti tendenca të hapura për ta mënjanuar Qeverinë e Vlorës duke e trajtuar atë njëllë si pushtetet e tjera lokale. Ndaj saj u adaptua vija e një kontrolli të rreptë dhe e ndërhyrjes së hapur në punët e saj të brendshme.

Luftërat e popullit shqiptar më në fund ishin shpërblyer me njohjen e Shqipërisë nga mbretëritë evropiane. Por shpejt qeverisë së përkohshme shqiptare iu desh të përballej me pengesa të shumta dhe për mëse një vit ajo luftonte mes vështirësish të panumërta me armiq të vjetër e të rinj. Ndërsa përgatitej të priste ardhjen në vend të princit të zgjedhur nga Fuqitë e Mëdha, qeverisë së përkohshme i duhej të merrte masa kundër veprimtarisë së Pashait Toptanas i cili në janar të vitit 1914 kishte hedhur forcat e tij të armatosura kundër bastionit kryesor të qeverisë së Vlorës dhe kishte pushtuar disa fshatra të kazasë së Elbasanit. Këto veprime kishin ngjallur reagimin jo vetëm të opinionit të gjerë vendas por edhe të shtypit të huaj. Për aksionet ushtarake të Esad Pashës në Elbasan gazeta italiane “Corriere delle Puglie” do të shkruante: “*Manovra e Esadit shifet sheshazi. Asht thanë se princ Wied ka për qëllim ta baj Elbasanin kryeqytet të shtetit të ri. Tani Esadi që asht një njeri shumë kujtues don ta zgjanoj gjer te ky qytet qarkun e viseve që janë shtruar, për me e pasun Princ Wied në grushtin e tij*”.<sup>476</sup> Gjithnjë përmes informacionit të përcjellë nga shtypi i kohës mësojmë për situatën e rënduar në të cilën ndodhej vendi. “*Lufta ndërmjet t’vedit ka krisë n’Shqypni. – do të shkruhej në faqet e gazetës “Taraboshi” atë mes janari të vitit 1914. – Esat Toptani rrethon Elbasanin; n’Polis asht luftu gjith një ditë; Ismail Qemali asht nën gjykim...*”<sup>477</sup> Në fshatrat që pushtonin, forcat esadiste regjistronin nga 20-30 xhandarë me rroga të mëdha (250 groshë), të cilët, pasi i armatosnin, i merrnin me vehte duke shtuar mjaft fuqinë e tyre.<sup>478</sup> Përballë këtyre veprimeve fuqia ushtarake e qeverisë së përkohshme jo vetëm ishte e pamjaftueshme por as nuk do të mundej ta ndalte

<sup>476</sup> “Përlindja e Shqipëniës”, dt. 11/24 kallnuer 1914

<sup>477</sup> Gazeta “Taraboshi”, Shkodër, 17 kallnuer 1914.

<sup>478</sup> Hoxha, Teuta. *I. Qemali*, Tiranë, 1982, fq. 378



gjakderdhjen pasi sulmi i forcave rebele jo vetëm vazhdonte por ishte bërë akoma edhe më intensiv. Forcat e Musa Qazimit kishin arritur në komunën e Çermenikës dhe synonin të hynin në Elbasan drejt të cilit ishte nisur, me forcat e tij nga Peqini, edhe Dervish bej Elbasani i cili, siç shkruhej në faqet e gazetës “Përlindja e Shqipërisë”,<sup>479</sup> kishte për qëllim ta shpallte veten kryetar të qeverisë (prefekturës - E.A) jo vetëm në zonën e Starovës, Dumresë dhe Çermenikës, që i konsideronte krahina nën kontrollin e tij, por edhe në Elbasan duke rivalizuar hapur pushtetin e Aqif Pashës dhe njëkohësisht autoritetin e qeverisë së Vlorës që ky i fundit përfaqësonte. Në zonë ndodheshin vetëm xhandarët e Elbasanit të cilët, të shpërndarë në vende të ndryshme për të siguruar mbrojtjen nga sulmet e toptanasve, e kishin lënë qytetin pa fuqi. Në një përballje që forcat e xhandarmarisë patën me forcat rebele në fshatrat Babje dhe Polis, në juglindje të Qukësit, u detyruan të tërhiqen pasi forca me të cilën u përballën ishte shumë më e madhe në numër (rreth 500 vetë). Vija telegrafike e Elbasanit ishte pre.<sup>480</sup> Me marrjen e qytetit forcat esadiste synonin jo vetëm t’i jepnin një goditje të fortë qeverisë së përkohshme, ndoshta përfundimtare për mënyrën sesi planifikoheshin të rridhnin ngjarjet, por edhe të ndikonin në opinionin vendas dhe ndërkombëtar, për ta kaluar atë në favor të Pleqësisë së Durrësit. Kjo gjë u vërtetua edhe nga kërkesat që Dervish Beu u parashtrroi Grigor Cilkës, Mithat bej Frashërit dhe Abdyl Bej Ypit, të dërguar nga Prefektura e Elbasanit për të biseduar me Dervish Benë, i cili bëri dy kërkesa: e para - Aqif Pasha të hiqet nga nëpunësia e Prefektit të Elbasanit, dhe e dyta - Elbasani të bashkohet me Durrësin.<sup>481</sup> Sikurse pritej, këto bisedime as nuk sollën dhe as nuk mund të sillnin përmbledhim të situatës. Të dytën ditë pas këtij takimi një tjetër përplasje, mes forcave esadiste dhe trupave qeveritare, ndodhi në Kepishtë, (Pekisht, pranë Peqinit – E. A) në afërsi të kishës së Shën Thanasit. Forcat rebele, me të cilat ishin bashkuar edhe xhandarët e Durrësit, Kavajës, Tiranës dhe Peqinit, duke pasur në krye të tyre oficerë e njerëz të Esad Pashës, që kishin ndikim tek popullsia e zonës, një pjesë ndodheshin në Labinot nën komandën e Dervish Beut, i cili prej shumë ditësh njihej si komandant i fuqive të grumbulluara në Durrës, dhe një pjesë tjetër në fshatin Polis i Vogël nën drejtimin e Qamil Beut, vëllait të Dervish bej Elbasanit. Forcat esadiste të kryesuara nga Dervish Bej Biçaku sulmuan zonën e Elbasanit dhe mbërritën deri në Shmil dhe në periferitë e Godoleshit në janar 1914.<sup>482</sup> Mëngjesin e 13 janarit këto forca sulmuan postën në fshatin Godolesh, në verilindje të qytetit, dhe vetëm pas gjysëm ore luftimesh u detyruan të tërhiqen.<sup>483</sup> “N’ket çast po lajmohet qi ndërmjet t’xhandarmave t’Vlonës e t’djelmve t’Esatit asht liftue afër Elbasanit. - do të shkruhej në shtypin vendas të asaj kohe. – Thohet qi fituesat kanë kenë xhandarmat t’cilët kanë marr Godoleshin e Ljabinin.”<sup>484</sup> (Labinotin – E.A) Të gjitha këto zhvilloheshin përpara syve të Komisionit të

<sup>479</sup> Gazeta “Përlindja e Shqipërisë”, 8/21 kallënduer 1914, fq. 2

<sup>480</sup> Hoxha, Teuta. *I. Qemali*, Tiranë, 1982, fq. 379-380. Telegram i prefektit të Elbasanit drejtuar Qeverisë së Përkohshme mbi sulmet e forcave esadiste mbi qytetin e Elbasanit dhe rreziqet e propagandës së tyre në popull.

<sup>481</sup> Gazeta “Përlindja e Shqipërisë”, 8/21 kallënduer 1914, fq. 5

<sup>482</sup> AME, F. 22, D. 1, nr. 9, fl. 5

<sup>483</sup> Hoxha, Teuta. *I. Qemali*, vepër e cituar, fq. 381

<sup>484</sup> Gazeta “Taraboshi”, Shkodër, 22 kallnuer 1914

Kontrollit i cili me qëndrimin e tij dukej se ishte pozicionuar tashmë në favor të Esat Pashës dhe politikës që ai ndiqte. Që pas caktimit të përfaqësuesit shqiptar në KNK qeveria e përkohshme ishte përballur me braktisjen e politikës austro-hungareze dhe Esat Toptanin konsiderohej si figura politike kryesore në vend.

Kjo situatë pati për epilog të ashtuquajturin “komplot të Beqir Grebenesë” që u pasua nga dorëheqja e Ismail Qemalit dhe kabinetit të tij qeveritar më 22 janar 1914. Zbulimi i këtij komploti nuk mund të bëhej në një kohë më të përshtatshme për kundërshtarët e Qeverisë së Vlorës se sa në momentet kur ishin të shumta akuzat e formuluar në drejtim të Ismail Qemalit dhe qeverisë së tij. Bëhej fjalë për figura të cilat Prof. Puto i cilëson “zëra me influencë” si Mit’hat Frashëri, Faik Konica, Dervish Hima që bënë thirrje për të marrë anën e Esat pashës kundër I. Qemalit.<sup>485</sup> Në një situatë të tillë, për t’i dhënë fund përçarjes dhe anarkisë në vend e për t’i hapur rrugë formimit të një qeverie të vetme për të gjithë Shqipërinë, kryetari i Qeverisë së Përkohshme, I. Qemali, ia dorëzon pushtetin Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit i cili do të qeveriste derisa në Shqipëri të mbërrinte mbreti i caktuar nga Fuqitë e Mëdha. Përmes një telegrami lamtumire, dërguar prefekturave të Elbasanit dhe Beratit, ai do të vinte theksin tek përpjekjet që kishte bërë gjatë 14 muajve të vështirë qeverisjeje për të realizuar bashkimin kombëtar dhe për të siguruar tërësinë tokësore shqiptare.<sup>486</sup> Ndërkohë pas zbulimit të komplotit të Beqir Grebenesë, në Vlorë ishte krijuar një Gjykatë Ushtarake e përbërë nga Maz’har Nepravishta, tog. Fevzi Libohova, tog. Tahir Libohova, Kasem Gjyrokastër, Xhavit Leskoviku, lietnant Mallinckrodt, pyetës Kristo Floqi, sekretar Kostë Çekrezi e drejtuar nga koloneli holandez De Weer<sup>487</sup> e cila gjatë gjykimit të të arrestuarve mori në pyetje edhe anëtarë e ish-anëtarë të Qeverisë së Përkohshme mes të cilëve edhe Lef Nosin, Pandeli Calen, Syrja bej Vlorën e Myfit Libohovën.<sup>488</sup> Kjo gjykatë vendosi të përjashtojë nga ndjekja penale Ismail Qemalin pasi ky pranoi të jepte dorëheqjen e të largohej nga vendi dhe qeverisjen e vendit ia kaloi KNK-së. Ishte nevoja për një shkak dhe ai u gjet në “puçin” e Vlorës.<sup>489</sup>

Rënia e Qeverisë së Vlorës ishte goditja më e rëndë që merrte projekti i ngritjes së pavarësisë shqiptare mbi themele kombëtare por ishte një sakrificë e nevojshme për t’i dhënë fund agresionit të jashtëm dhe anarkisë së brendshme. Lajmi i largimit nga kryesia e qeverisë e I. Qemalit u prit me keqardhje nga rrethet e gjera patriotike në vend, por njëkohësisht ky akt fitoi vlerësimin e gjithë atyre shqiptarëve, që e kishin mbështetur edhe kur mbi të derdheshin një lum akuzash, të cilët vazhduan të shpresonin në rikthimin e tij të shpejt me ardhjen e princit të zgjedhur për fronin shqiptar. Fakti që kreu i shtetit shqiptar vinte nga gjiri i familjes evropiane, mbante akoma gjallë shpresën tek veprimtarët e ditëve të mundimshme të shpalljes së pavarësisë, se ideali nacionalist kishte triumfuar dhe Shqipëria do të jetonte mes shteteve të

<sup>485</sup> Puto, Arben. *Shqipëria politike 1912-1939*, TOENA, Tiranë, 2009, fq. 106

<sup>486</sup> *Qeveria e përkohshme...*, Tiranë, 1963, fq. 329-330, dok. Nr. 399.

<sup>487</sup> Gazeta “Përlindja e Shqipërisë”, Vlorë, 14 janar 1914

<sup>488</sup> Gazeta “Shqypnia e Re”, Shkodër, 25 kallnuer 1914, nr. 55

<sup>489</sup> Puto, Arben. *Shqipëria politike 1912-1939*, TOENA, Tiranë, 2009, fq. 114

perëndimit. Më 23 janar 1914, Lef Nosi, nga Vlora, do t'i shkruajë ish-kryetarit të Qeverisë së Përkohshme të Shqipërisë, I. Qemalit: *"Kujtimi i ditës së shenjtë, kur në mes të mbledhjes së kombit proklamuat Atdhenë e dashur përpara botës së lirë e independent edhe bashkëpunimi i ynë në mes kaqi të vështirash e pengimesh në këto katërmëdhitë muaj do të mos na dalin nga mendja e jeta jonë. Largimi i zotëries tuaj nga qeverimi i fatit të atdheut i lutemi zotit të jetë i shkurtër edhe në një kohë të afërt t'ju shohim të ktheheni prapë shëndoshë në gjij të atdheut për të kryer veprën e madhe që nisët më 28 vjeshtë e 3-të, 1912. Udhëtimi që bani sot të qoftë i mbarë edhe sjelltë lirinë e vërtetë në Shqipëni"*.<sup>490</sup> I. Qemali u largua nga Shqipëria dhe shkoi në Evropë, për t'u rikthyer vetëm katër muaj më vonë në Vlorë, kur u ftua të merrte pjesë në një mbledhje të të gjithë krerëve shqiptarë për të diskutuar për gjendjen e rëndë në të cilën ndodhej vendi.<sup>491</sup>

Me kalimin e pushtetit në duart e KNK-së, ky Komision caktoi një Drejtor të Përgjithshme të përbërë nga pesë degë,<sup>492</sup> për të administruar punët në të gjitha qarqet në vend. Kjo Drejtori, dy ditë pas tërheqjes së Ismail Qemalit, do t'u kërkonte ministrave të Qeverisë së Përkohshme "...me ndejtë n'shërbim t'vendit si drejtor t'shërbimeve qeveritare nën kryeparinë e Fetzi Beut- Ministër i luftës."<sup>493</sup> Që nga ai moment Lef Nosi do të vazhdojë punën si Drejtor i Përgjithshëm i Postë-Telegrafave, deri në ardhjen e princ Vidit, kohë gjatë së cilës ai do të çojë përpara projektet për konsolidimin e rrjetit të postave e telegrafave shqiptare. Pikërisht ato ditë kthehet në Vlorë Mehmet Rizai, inspektor i postave dhe telegrafave, i cili prej disa javësh ishte dërguar në Evropë për të siguruar material telegrafo-postar.

Ndonëse nga KNK-ja bëhej thirrje për ruajtjen e rendit dhe qetësisë, realiteti shqiptar nuk paraqitet as i qetë dhe as i sigurt. Largimi i I. Qemalit do t'i hapë rrugën Esat Toptanit, të cilin Fuqitë vazhdonin ta quanin si të vetmen "forcë reale" në vend, përderisa kishte me vete forcën e armatosur që nxori nga Shkodra pas dorëzimit të saj.<sup>494</sup> Gjendja e vështirë që ishte krijuar në vend me Esat Pashën i cili përpiquej të mbante gjallë ndjenjat orientale tek shqiptarët, nxitën veprimtarinë e klerit ortodoks shqiptar i cili në shkurt të 1914-ës përpiqet të sigurojë lejen nga KNK-ja për të rihapur në Shqipëri shkolla në gjuhën greke të financuara nga Patrikana e Stambollit, duke minuar një nga sukseset kryesore të qeverisë së Vlorës, e në veçanti të punës së ministrit të Arsimit e atij të Postë-Telegrafave, të cilët kishin arritur ta vendosnin arsimin mbi baza tërësisht kombëtare, sipas të cilit mësimi në të gjitha shkollat, përfshi edhe ato të komunitetit ortodoks, do të zhvillohej në gjuhën shqipe. Për Lef Nosin, boshti i orientimit politik të të cilit ishte ngritur mbi themelet e luftës për mbrojtjen e gjuhës dhe shkollës shqipe, projekti grek për helenizimin e ortodoksëve shqiptar

<sup>490</sup> AQSH, F. 20, "I. Qemali", D. 4, f. 17

<sup>491</sup> Puto, Arben. *Shqipëria politike*, vepër e cituar, fq. 116

<sup>492</sup> Gazeta "Përlindja e Shqipërisë", Vlorë, 31 janar 1914. Administrata shqiptare ishte e përbërë nga pesë drejtorë: Fejzi Alizoti – i Punëve të Brendshme, Petro Poga- i Dretësisë, Gjergj Çako- i Financës, Luigj Gurakuqi- i Arsimit dhe Lef Nosi- i Postë Telegrafave.

<sup>493</sup> Gazeta "Taraboshi", Shkodër, 24 kallnuer 1914

<sup>494</sup> Puto, Arben. *Shqipëria politike*, vepër e cituar, fq. 115

përmes shkollës greke, nuk ishte aspak një qëndrim i panjohur. As për të e as për të gjithë ata shqiptarë, që në forma të ndryshme, ishin përfshirë prej kohësh në luftën për sigurimin dhe mbrojtjen e të drejtave kombëtare.

Këto përpjekje ndeshën në qëndresën e forcave patriotike në pararojë të të cilave do të vihen pikërisht të krishterët e Elbasanit që do të protestojnë kundër veprimeve të Dhespotit të Beratit dhe përkrahësve të tij. Në 9 shkurt 1914 të krishterët e qytetit, mes të cilëve ishte edhe i vëllai i Lef Nosit, Grigori,<sup>495</sup> do të ngrenë zërin në mbrojtje të shkollës shqipe dhe i dërgojnë një telegram Administratorit të Arsimit në Vlorë, z. Leon, ku ndër të tjera shkruhej: “...Shkolla jonë shqipe do të rrojnë e do të përparojnë e asnjë gjuhë e huje nuk do të lamë që të zej vendin e gjuhës sonë.”<sup>496</sup> Zëri i patriotëve elbasanas do të bëjë një përshtypje të madhe në opinionin dhe shtypin vendas për të cilin do të shkruhej: “Fjalët e telegramës s’Elbasanit qenë një mësim i bukur dhe një shuplakë për anmiqt e Atdheut e janë një pasqyrë e çmueshme edhe për ata shqiptarë që janë të ftofët ndaj gjuhës amtare e që s’dinë me ruejtun e me mprojtun të drejtat e Nanës Shqipënie...”<sup>497</sup> Pas elbasanasve protesta u shtri edhe tek popullsia e Vlorës, Fierit, Lushnjës etj, të cilat e detyruan KNK-në që edhe në shkollat ortodokse greke, mësimi i gjuhës shqipe të ishte i detyrueshëm. “KNK vendosi: 1- Të hap përsëri shkollat orthodokse të dyta të nalta ku mund të bahet mësimi në gjuhën shqipe ose greqishte, por n’u bafte greqisht, atëherë shqipja do të mësohet domosdo. 2- Leje për me hap shkolla shqipe orthodokse do mund të jepen me 2 kushte: I. mësimi i parë do të bahet shqip, II- mësimi të jenë shqiptar”.<sup>498</sup> Ndonëse punonte për mirëfunksionimin e shërbimit postar e telegrafik, Lef Nosi vazhdonte të përpiqej e t’i gëzohej arritjeve në fushën e shkollës shqipe. Duke iu referuar informacionit dokumentar arkivor mësojmë se në fillim të marsit të 1914-ës L. Nosi do të hapë dyert e shtëpisë së tij për shkollën fillore të vajzave që u çel në qytetin e Vlorës.<sup>499</sup> Më pas nënprefekti i Vlorës, Qazim Kokoshi, pasi kishte mbledhur parësinë e të krishterëve të qytetit, kishin vendosur që për shkollën të përdorej ndërtesa ku më parë mësohej greqishtja. “Një ditë u mbledhën që të gjithë, - do të shkruante Lef Nosi në letrën dërguar Luigj Gurakuqit, - nën-prefekti, nëpunësit tok me sheheller dhe hoxhallar bashk me priftërinjt, të tanë dhe si jan 400-500 shpirtra me flamur përpara erdhën dhe e ngritën shkollën si duhet dhe vajzat hynë brenda.”<sup>500</sup> Por ky vendim do të përballet me kundërshtimin e elementëve grekomanë të qytetit të cilët kërkuan largimin e vajzave nga shkolla greke. “...nënprefektura pranoi një karar- vazhdonte letrën L. Nosi, - që deri kur të bahet shkolla e re, vajzat t’i dërgojmë tek një shkollë e vogël ku këndohej përpara turqisht ...pasi këta

<sup>495</sup> Gazeta “Përlindja e Shqipëniës”, Vlorë, 12/25 shkurt 1914. Letra e të krishterëve të Elbasanit është e firmosur nga Grigor Nosi, Nikoll Papajani, Nikoll Andrea, Simon Popa, Taqe Buda, Nikoll Thasari, Venemin Thasari, Sif Xhufka, Tas Dodbiba, Jorgji Paparisto, Leonidha Kristo, Marko, Nikoll Suteriqi, Nikoll Deko, Jan Leshnja, Filip Papajani, Jorgji Santos.

<sup>496</sup> Gazeta “Taraboshi”, Shkodër, 14-15 mars 1914

<sup>497</sup> Po aty

<sup>498</sup> Po aty.

<sup>499</sup> AQSH, F. 32, D. 9, f. 13

<sup>500</sup> Po aty.

grekomanë kan ndërmend ti hekin vajzat prej këndeje dh e ta bajnë si ishte, në ia arrifshin këta”<sup>501</sup> - fjalë me të cilat L. Nosi mbyll letrën e tij duke nënkuptuar vazhdimin e përpjekjeve për të mos lejuar mësimin e gjuhës greke në Vlorë apo qytet tjetër të Shqipërisë. Pas përpjekjeve të shumta për gjuhën e shkollën shqipe, më në fund qeveria e parë e shqiptarëve e kishte shpallur gjuhën shqipe, gjuhë zyrtare në shtetin e ri që po ngrihej në këmbë jo pa sakrifica e po me aq shumë sakrifica patriotët shqiptarë, mes të cilëve edhe L. Nosi, do të vazhdojnë të luftojnë jo vetëm për të siguruar fitore të reja por edhe për të mbrojtur fitoret e arritura me shumë mundim.

Por problemet me të cilat do të përballej vendi gjatë vitit 1914 ishin shumta. Në realitetin politik shqiptar vazhdonin të përshfaqeshin hera-herës momente të vështira që orvateshin të errësonin sukseset që ishin arritur, përmes shumë sakrificave, nga qeveria kombëtare tashmë e tërhequr. Ndërsa për shumë shqiptarë, sikurse edhe për Lef Nosin, zgjedhja e princit gjerman për Shqipërinë ishte dëshmi e njohjes dhe mbështetjes së Fuqive të Mëdha ndaj shtetit të ri shqiptar, për Esat Pashën, princ Vidi me paaftësitë e tij për të njohur dhe vlerësuar çështjet ballkanike, u vlerësua si zgjedhja që do ti jepte mundësinë të realizonte planet e tij. Ndonëse askush nuk ngurronte ta cilësonte Esatin si “prishësin kryesor të njësisë shqiptare”,<sup>502</sup> përsëri përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha duket se kishin rënë në një mendje për ta trajtuar atë si faktorin kryesor në situatën shqiptare i cili kërkonte një trajtim më vehte. Ky qëndrim shpjegon edhe dorëheqjen e Esat Toptanit vetëm pas dy javësh të rrëzimit të qeverisë së Vlorës, kohë gjatë së cilës ai siguroi premtimin nga KNK-ja për zhvendosjen e qendrës së shtetit shqiptar nga Vlora në Durrës, drejtimin e Ministrisë së Luftës si dhe kryesinë e delegacionit që do të shkonte në Noi-Vid (Neue-Wied), në Gjermaninë jugperëndimore, për t’i ofruar Wied-it kurorën e Shqipërisë. Në 4 shkurt Esat Pasha dha dorëheqjen; në 12 shkurt dërgata shqiptare e përbërë nga 14 anëtarë u nisën me avulloren “Servizi Maritimi” për në Potsdam për t’i dhuruar kurorën Wilhelm von Wied-it,<sup>503</sup> me ardhjen e të cilit shumë shqiptarë shpresonin se “gjithë punët do t’a gjejnë vendin e vet e do të fillojë, sakaq, vepra europësimit, e mirësiës dhe e përparimit”.<sup>504</sup> Nga krahina të ndryshme të vendit ishin zgjedhur përfaqësuesit shqiptarë që do të takonin Vidin në Gjermani, zgjedhje e cila ishte kryer sipas rregullit “një i krishterë e një musliman për çdo prefekturë a mytesarifllëk, si ka qenë ndarë Shqipëria më parë”.<sup>505</sup> Në delegacion merrnin pjesë, si përfaqësues të Elbasanit, edhe Lef Nosi, Shefqet Vërlaci e Ahmet Hostopalli.<sup>506</sup> Pjesëmarrja e L. Nosit në delegacionin shqiptar, të cilën ai vetë e kishte kërkuar,<sup>507</sup> ishte jo vetëm shprehje e entuziazmit me të cilin ai e priti zgjedhjen e princit protestan gjerman në fronin mbretëror të Shqipërisë, por edhe e shpresës që kishte lindur

<sup>501</sup> Po aty.

<sup>502</sup> Puto, Arben. *Pavarësia shqiptare...*, WESO, 2007, fq. 221.

<sup>503</sup> “Liri e Shqipërisë”, 1914, 20 shkurt, f. 4

<sup>504</sup> “Përlindja e Shqipëniës”, 29/11 kallënduar 1914, f. 4

<sup>505</sup> Po aty, f. 1

<sup>506</sup> Vlora, Eqrem. *Kujtime 1885-1925*, Tiranë, 2003, fq. 361

<sup>507</sup> AME, F. 20, D. 10, f. 7

tek patrioti elbasanas për konsolidimin e ndërtesës së brishtë të shtetit shqiptar që ai bashkë me patriotë të tjerë ishin përpjekur të ngrinin që nga vjeshta e 1912-ës, për 14 muaj rresht. Njëkohësisht zgjedhja e L.Nosit në këtë grup përfaqësimi duket se lidhet edhe me përpjekjet që forcat patriotike të Elbasanit bënin për të kontrolluar ndikimin politik, në këtë delegacion, të krahut esadist i cili në Elbasan përfaqësohej dhe drejtohej nga Sh. Vërlaci. Tek princi evropian L. Nosi, i orientuar qysh herët drejt perëndimit, kishte mbështetur shpresën e shpëtimit të vendit nga përçarjet e brendshme e nga rreziku i copëtimit të mëtejshëm të tokave shqiptare. Madje edhe “padituria” e princit mbi realitetin shqiptar u vlerësua nga rrethet patriotike si një mundësi që do e mbante Vidin larg situatës së ngatërruar politike shqiptare, të papërfshirë në ndasitë krahinore e fetare, dhe të paanshëm në ushtrimin e autoritetit të tij në favor të kombit shqiptar dhe progresit të tij.

Në 7 mars Vidi, me titullin- mbret Vilhelm i Parë, dhe mbretëresha Sofi arritën në Durrës me një luftanije austro-hungareze të shoqëruar nga njësi të flotës italiane, angleze e franceze.<sup>508</sup> Në qytet ata gjetën një atmosferë festive. Mbas shumë shekujsh robërie, shqiptarët shihnin tek mbreti i tyre realizimin e ëndrrës së një Shqipërie të lirë e sovranë, dëshirë që Lef Nosi e kishte projektuar në letër që në 1907-ën, në Londër. Tashmë vetë Fuqitë e Mëdha kishin caktuar një princ nga gjiri i familjes evropiane për të drejtuar shtetin shqiptar sipas modeleve perëndimore. Më 17 mars Vidi formoi qeverinë e re të kryesuar nga Turhan Pashë Përmeti, për të cilin situata në vend ishte po aq e huaj sa edhe për vetë mbretin e shqiptarëve. Fatkeqsisht edhe shumë ministra të tjerë të kabinetit kreu i shtetit shqiptar nuk i zgjodhi nga rradhët e lëvizjes kombëtare madje pati nga ata që kishin qenë edhe kundërshtarë të saj. Një prej tyre, dhe figura kryesore e qeverisë, ishte Esat Pashë Toptani i cili arriti të sigurojë dy nga postet ministrore më të rëndësishme; Ministrinë e Luftës dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, pra kishte nën varësi edhe forcat e rendit edhe ushtrinë. Ndërsa Lef Nosi do ti duhet t’i mbyll llogaritë me Ministrinë (Drejtorinë) e Postave që ai kishte drejtuar deri në atë kohë dhe vet ai do ti transferojë të gjitha dokumentat e pullat postare për në Durrës. Pullat me portretin e Skënderbeut, të realizuara gjatë kohës kur L. Nosi ishte në zyrën e tij në Vlorë, ishin bërë pothuajse të gjitha me mbishtypje, me vlerë në para dhe në grosh, dhe ai insiston në mospajisjen e zyrave postare me pulla të reja nga qeveria.

Ndonëse të papërfshira në qeverisje, rrethet patriotike në vend të cilat që në nëntor të 1913-ës ishin bashkuar me vendimin e Fuqive të Mëdha mbi zgjedhjen e princit gjerman në fronin shqiptar, duke e parë Vidin si simbol të Shqipërisë së pavarur, jo vetëm nuk e braktisën por vazhduan të përkrahin mbretin dhe qeverinë e tij për të kapërcyer vështirësitë e brendshme e për të përballuar rreziqet e jashtme. Ditën që Vidi do të shkelte në tokën shqiptare, Lef Nosi, nga Vlora ku së shpejti do të lërë drejtimin e postë-telegrafave shqiptare, do të shkruajë: *“I lutemi Perëndisë natë dhe ditë që na erdhi Lart Madhëria tij. Mbreti dhe*

<sup>508</sup> Selenica, Teki. *Shqipëria në 1927*, Tiranë, 1928, fq. 35



Mbretnesha na kjoftshin me këmbë të mbarë, se Shqipnien e bani Perëndia të jetë edhe kjo si një shtet si shtetet e tjerë të Evropës; për këtë të gjithë neve jemi të gëzuar tepër... sot e tutje do të punojmë të gjithë si shqiptarë që jemi, të rrokemi prej durësh që ta bajmë një shtet si lypset”.<sup>509</sup> Pasi lë Vlorën Lef Nosi kthehet në vendlindje dhe vazhdon të jetë aktiv në jetën politike të vendit madje gjatë vitit 1914 ai ishte një ndër fituesit e zgjedhjeve të Katundarisë së Elbasanit.<sup>510</sup>

Por pengesat për mbretin shqiptar ishin të mëdha, pasi situata në vend paraqitej mjaft e vështirë. Gjendja e rëndë ekonomike përbënte vetëm një aspekt të realitetit kaotik shqiptar. Pavarësisht veprimtarisë së gjerë që L. Nosi kishte bërë për sistemimin e postave shqiptare suksesi final ende nuk ishte arritur. “...ka ardhur koha që të vihet rregull i përmbaruem në Postat Shqypnare. – do të shkruhej në gazetën “Shqypnia e Re” në fundin e marsit të 1914-ës. – Mbasi edhe tuj iu falë veprimit të palodhun të ish-ministrit, Lef Nosit, janë përgatitë të gjithë veglat e nevojshme për posta, telegrafa e telefoni. Pse ma të lëngojnë Shqypnia në marrdhënie?”<sup>511</sup>

Mbreti vendin nuk e njihte dhe kjo e kishte shtyrë të mbështetej tek Esad Toptani duke i besuar dy shtylla të fuqishme të qeverisë. Ndërkohë, Esad Pasha, me gjithë pozitën mbizotëruese që kishte në qeveri, nuk kishte hequr dorë nga synimi për të zotëruar kreun e pushtetit. “Unë prapë në atë fjalë jam- do të shprehet E. Toptani në rrethin e përkrahësve të tij- por pres kohën”.<sup>512</sup> Dhe në një vend si kryeqyteti shqiptar, ku lojërat politike të shteteve evropiane ishin në kundërshtim dhe rivalitet, kjo “kohë” nuk dukej e largët. Rivaliteti austro-italian i jepte dorë pashait Toptanas. Në Romë ishin të bindur se Vidi ishte përçues i interesave austro-hungareze, kurse Esati mund të shërbente si një kundërpeshë për llogari të Italisë. Me pretekstin e dërgimit të trupave të armatosura kundër manovrave të përsëritura greke në jug të vendit, ai shpërndau armë në Durrës, Elbasan e qendra të tjera të Shqipërisë së Mesme. Ndërkohë, me anë të përkrahësve, përhapte urrejtje kundër princit dhe qeverisë së tij dhe ndizte zjarrin për një princ turk, nën të cilin fshihej ai vetë. Ai “nuk punonte as për Shqipërinë, as për independencën e saj, ai donte një copë tokë, Shqipërinë e Mesme ku vetë t’ishite Princ e Bej”.<sup>513</sup>

Nuk kaloi shumë kohë dhe u pa se qeverisja e princ Vidit ishte një falimentim i plotë. Qeveria e tij dështoi si në politikën e saj të brendshme, ashtu edhe në marrëdhëniet me jashtë. Në krye të saj ishte Turhan Pashë Përmeti, i njohur pothuajse në të gjitha rrethet diplomatike të Evropës pasi kishte zënë poste me rëndësi në diplomacinë osmane e kishte qenë ambasador i Turqisë në disa vende evropiane, por që nuk kishte as dijeni, as ndjeshmëri për problemet reale të vendit. “Shtet’i ri, - do të shkruante Mustafa Kruja për Shqipërinë e kësaj kohe, - nuk kishte as armë, as municion, as mjete transporti, as ndonji farë organizimi

<sup>509</sup> AQSH, F. 32, D. 9, f. 13

<sup>510</sup> AQSH, F. 32, D. 10, f. 1, Lef Nosi fitoi 100 vota duke u futur në rradhën e fituesve, së bashku me Shefqet Daiun dhe Emin Matraxhiun.

<sup>511</sup> Gazeta “Shqypnia e Re”, Shkodër, 26 mars 1914, nr. 71.

<sup>512</sup> Selenica, Teki. *Shqipëria në 1927*, Tiranë, 1928, fq. 36

<sup>513</sup> Po aty, fq. 37

ushtarak, madje as gjindarmëri...”<sup>514</sup> Vetë Vidi nuk kishte asnjë cilësi për të dalë si “shpëtimtari i situatës” në Shqipëri. Sikurse vë në dukje edhe Joseph Swire në studimin e tij për këtë periudhë të historisë shqiptare “...gabimi i princit Vilhelm ishte mosnjohja e diplomacisë në format e saj më të ulëta, që e bënte atë të paaftë të ruante pozitën e vet me njerëzit e pandershëm dhe budallenj që e rrethonin”.<sup>515</sup> Ai erdhi si i zgjedhuri i Fuqive të Mëdha të Evropës, por Evropa, që qëndronte prapa tij, vazhdonte të ishte e ndarë. Luhatjet në politikën europiane pashmangërisht do të reflektoheshin edhe në realitetin e brendshëm shqiptar. Ndërsa zgjedhja e princit europian për shqiptarët i ishte besuar Austro-Hungarisë dhe Italisë, dy Fuqitë europiane nuk e vlerësuan njësoj dhe as nuk mbajtën të njëjtin qëndrim ndaj politikës së Vidit dhe Shqipërisë. Italia, teksa e shihte Vidin si përfaqësues të interesave austro-gjermane në Shqipëri, vendosi të përdorë Esad Toptanin si instrument të politikës së saj. Në këto kushte pashai Toptanas, me dy ministri kyçe në qeveri, paraqitej si faktori kryesor i çdo pushteti në Shqipëri, i cili priste veç momentin që princi t’i drejtohej si “dorë e fortë”.<sup>516</sup> Situata e krijuar nga intrigat greke në jug të vendit dhe fillimi i trazirave popullore në Shqipërinë e Mesme, ishin rasti që Esadi priste. Por plani i tij nuk funksionoi. Esad Toptani u akuzua për komplot kundra Vidit dhe vetëm falë ndërhyrjes së Italisë u bë i mundur largimi i tij në drejtim të Brindisit. Në rrethet e patriotëve shqiptarë, mes të cilëve edhe tek L. Nosi, ikja e Esad Pashës krijoi iluzionin se forcat e të djathtës antikombëtare pësuan disfatë dhe kjo i nxiti të rrisnin përkrahjen për qeverinë e princ Vidit.

### III-2 Fillimi i kryengritjes së Shqipërisë së Mesme dhe largimi i princ Vidit

Esad Pasha nuk ishte i vetmi faktor destabilizues në gjendjen e brendshme të vendit. Në maj të vitit 1914, në Shqipërinë e Mesme, në Shijak, shpërtheu vala e pakënaqësisë ndaj regjimit të Vidit. Kështu shpjegohet edhe fakti që largimi i E. Toptanit nuk solli fundin e problemeve për shtetin shqiptar madje lëvizja fshatare nga një revoltë antividiste, sikurse nisi, u shndërrua në një kryengritje rebele që solli shkatërrime të mëdha në të gjitha zonat ku ajo u përhap. Gjatë muajve qershor-korrik kjo kryengritje mori akoma edhe më shumë forcë. Grekët gjendjen e vështirë të Shqipërisë e njihnin mirë, madje edhe më mirë se Turhan Pasha, e ndërsa në jug nxisnin kryengritjen epirote, në Korçë e Gjirokastrë, dhe pengonin ndihmat për popullsinë e rajonin që po vritej e digjej, në Shqipërinë e Mesme kishin ngritur një organizatë të posaçme, të drejtuar nga mitropoliti grek i Durrësit, Jakovi, e cila kishte për qëllim që, përmes zgjimit të fanatizmit fetar të myslimanëve të rajonit, t’i largonin ata nga qeveria e princ Vidit. Nga ana tjetër serbët gjetën një tjetër mënyrë për të minuar ndërtesën e brishtë të shtetit shqiptar. Duke shfrytëzuar elementit

<sup>514</sup> Kruja, Mustafa. *Antologji historike*, vepër e cituar, fq. 282

<sup>515</sup> Swire, Joseph. *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie*, Tiranë, 2005, fq. 165

<sup>516</sup> Puto, Arben. *Historia diplomatike e çështjes shqiptare*, Tiranë, 2003, fq. 208

fanatik shqiptar ata filluan të mbillnin, përmes një propagande intesive, tek popullsia muhamedane kërkesën për të sjellë në Shqipëri një princ turk.

Kryengritja që filloi si një lëvizje kundër Princ Vidit në të vërtetë ishte drejtuar kundër shtetit të pavarur shqiptar pasi krerët e saj ishin për drejtimin e shtetit shqiptar nga një princ turk, duke e shndërruar kështu Shqipërinë në një satelit të Turqisë. Ngjarjet rrodhën shumë shpejt drejt anarkisë dhe shteti i ri nuk arriti më të ngrihej në këmbë. Me largimin e Esad Pashës, përkrahësit e tij u bashkuan me kryengritësit të cilët u kthyen me esadistët por duke ndjekur të njëjtin qëllim si edhe në fillim: të sillnin “Babën” në Shqipëri. Ata ngulnin gjithnjë këmbë për largimin e Vidit dhe emërimin e një princi turk.<sup>517</sup> Edhe ndryshimet në kabinetin qeveritar ku vendin bosh të Esad pashë Toptanit e zuri kushëriri por njëkohësisht kundërshtari i tij politik, Aqif Pashë Biçakçiu, nuk e ndalën përparimin e forcave kryengritëse. Kryengritja u përhap edhe në Tiranë, Kavajë e Peqin. Ndërsa Elbasani, duke qenë se forcat nacionaliste ishin të shumta dhe kishin një ndikim të konsiderueshëm në popullsinë vendase, u bë më vonë pjesë e hapësirës në të cilën u shtri kryengritja. Në të gjitha qytetet ku hynin, forcat kryengritëse dëbonin me forcë përfaqësuesit e administratës së Vidit dhe ngrinin këshillat e kryengritjes të cilët dënonin ashpër të gjithë ata që nuk e mbështesnin kryengritjen e atë më tepër ata që ishin kundër saj apo programit të shpallur për bashkimin me Turqinë. Synimin e kësaj kryengritje e gjejmë të pohuar edhe në letrën që kryetari i Qendrës së Përgjithshme të Durrësit, Mustafa Ndroqi, “... pas pushtimit të kryeqytetit dhe shpëtimit të myslimanëve nga sundimi katolik”<sup>518</sup> i dërgon kryesisë së Këshillit të kryengritjes në Elbasan në 26 gusht 1330 (8 shtator 1914): “Qëllimi i ynë kryesor ka qenë: shpallja e Osmanlillëkut edhe bashkimi me Mbretëriën Ottomane.”<sup>519</sup> Në të gjitha viset që ranë në duart e rebelëve u ngrit flamuri me gjysmëhënën turke ndërsa kujtdo që i gjendej famuri shqiptar dënimi ishte shumë i rëndë. Turqishtja u shpall gjuhë zyrtare, kurse për shkollat shqipe as që bëhej fjalë. Burgimet e vrasjet, djegiet e shkatërrimet e pasurive, rrahjet e poshtërimet publike ishin ngjarje që përbënin kryefjalën e atyre ditëve.

Më 10 qershor 1914, Elbasani ishte rrethuar nga rebelët e kryengritjes fshatare të cilët po përparonin drejt qytetit. Forcat nacionaliste u gjendën të pafuqishme për të ndaluar zjarrin e kryengritjes që dita-ditës po përhapej gjithnjë e më shumë. Është për t’u vlerësuar fakti se L. Nosi, si mendimtar largpamës dhe veprimtar i kujdesshëm, mbante rregullisht shënime për ngjarje e dukuri të rëndësishme të kohës. Mbledh e ruan kujtime e letërkëmbime të personazheve të njohur të historisë kombëtare, grumbullon e arkivon letra, telegrame e thirrje drejtuar popullit shqiptar. Shpesh shënime të tij, të ruajtura me shumë kujdes, na shërbejnë si burim kryesor historik për të studiuar ngjarje historike të shqiptarëve. Edhe në këtë rast, sipas shënimeve që Lef Nosi mbante për rrjedhën e ngjarjeve në vend, në 6 qershor 1330( 19/6/1914) zhvillohet

<sup>517</sup> Puto, Arben. *Shqipëria politike*, vepër e cituar, fq. 141

<sup>518</sup> Verli, Marenglen & Duka, Ferit. *L. Nosi. Dokumente Historike*, Kujtime të Thanas Floqit. 1914,Tiranë, 2007, fq. 220

<sup>519</sup> Po aty.

edhe beteja e fundit në Elbasan me forcat rebele. Beteja kishte rezultuar vendimtare pasi të nesërmen rebelët kishin hyrë në qytet,<sup>520</sup> Elbasan, i cili u bë një qendër e rëndësishme e kësaj kryengritje madje në të u krijua edhe këshilli i kryengritjes. Në këtë këshill u përfshinë elementë nacionalistë, pronar të mëdhenj tokash, që ishin kundër Vidit, si Dervish Biçakçiu, i njohur për qëndrimin e tij proesadist. Por bashkëpunimi i esadistëve me krerët e kryengritjes nuk zgjati shumë. Pozicionimi i Esad Pashës, në politikën e jashtme, në favor të vendeve të Antantës e paraqiti atë, në sytë e drejtuesve proturq të kryengritjes, si tradhëtar të platformës së bashkimit me Turqinë. Lëvizja mori karakter antiesadist dhe tashmë ajo do ta kthej teshun e goditjeve edhe kundër pronarëve të tokave. Kjo bëri që shumë shpejt në rradhët e kryengritësve të përfshihen turma të tëra fshatarësh të cilët ngritën krye ndaj gjendjes së mjeruar ekonomike. Në ballë të kësaj mase qëndronte fshatari i pashkollë dhe aventurier, Haxhi Qamili, i cili në korrik të vitit 1914 me forcat e tij rebele, hyri në Elbasan. Menjëherë filloi vala e përndjekjes ndaj të gjithë atyre atdhetarëve, të shtresave të ndryshme shoqërore, që ishin përpjekur për çështjen kombëtare, për të drejtën e mësimin në gjuhë amtare në shkollat shqipe. U goditën nacionalistët shqiptarë që kishin mbështetur dhe vazhdonin të përpiqeshin për ruajtjen e regjimit princëror të cilin e shihnin si simbolin e pavarësisë dhe tërësisë tokësore të shtetit shqiptar të njohur nga Fuqitë e Mëdha europiane. Të gjithë largoheshin për t'i shpëtuar dhunës ndërsa shtëpitë e tyre digjeshin. Në qytet vepronte një trupë xhandarmarie e përbërë nga 200 vetë që drejtohej nga gjashtë çaushë e cila "... asht ngarkue me ruajtje Elbasanit, me sigurue qetësinë plotësisht, me dërgue ushtarët e prapambetun, me sigurue kthimin e t'arratisunve si edhe me i ndjekun ata".<sup>521</sup> Në të tilla rrethana Lef Nosi, luftëtar i Shqipërisë së lirë e përkrahës i regjimit të Vidit, detyrohet të largohet dhe strehohet në fshatrat përreth Elbasanit. Gjatë muajve qershor-korrik 1914 ai ka qëndruar në fshatrat Shelcan, Gjinar, Valësh, Nezhani e Seltë derisa në 19 korrik filloi vala e burgosjeve në Elbasan.<sup>522</sup> Haxhi Qamili kërkoi të dënojë të gjithë ata shqiptarë që kishin marrë pjesë si vetëdëshës kundra osmanllinjve, dhe jo vetëm ata. Ai shpalli se do të dënoheshin edhe ata që kishin ngritur zërin dhe kishin sharë dheshpotin grek të Korçës edhe pse për sa kohë H. Qamili ishte në Elbasan këmbana e kishës së kalasë nuk u dëgjua asnjëherë. Pra do të ndëshkoheshin të gjithë ata shqiptarë që kishin luftuar ndaj kujtdo dhe ndaj gjithçkaje për të mbrojtur të drejtat kombëtare. Në qytet filluan të goditen jo vetëm figura që kishin përkrahur qeverinë e Vidit, por edhe pronarë të thjeshtë tokash e personalitete të njohura të Elbasanit.<sup>523</sup> Në burg shkoi edhe Sadik Zharri i cili kishte sulmuar postën e Manastirit në kohë të Turqisë përmes një aksioni të përgatitur nga "...Lef Nosi dhe Ymer Dervishi prej Shpati të cilët i kishin thanë atij se paret do ti përdornin për shkollën Normale t'atëhershme që ishte çel në Elbasan."<sup>524</sup> Bëhej fjalë për aksionin e Gurrës së Zezë të Dardhës së

<sup>520</sup> AQSH, F. 32, D. 30, f. 8

<sup>521</sup> Nosi, Lef. *Dokumente historike*, vepër e cituar, fq. 197

<sup>522</sup> AQSH, F. 32, D. 30, f. 8

<sup>523</sup> *Elbasani- Enciklopedi*, Elbasan, 2003, fq. 315- 316

<sup>524</sup> Floqi, Thanas. *Fytyra e vërtetë e Haxhi Qamilit*, Tiranë, Sh.B."55", 2008, fq. 56

Qukësit që L. Nosi e patriotë të tjerë, në kuadër të klubit “Bashkimi i ri”, në vitin 1911, organizuan kundër postës turke që vinte nga Manastiri gjatë të cilit u siguruan një shumë e madhe të hollash në lira turke, një pjesë e të cilave u vu në dispozicion të klubit për mbajtjen e shkollës Normale. Kjo e detyroi Lefin dhe nacionalistë të tjerë të largohen nga zona e Elbasanit. Në burg shkuan edhe vëllezërit e tij, Grigori i cili me shkathtësi arriti ti shpëtoj burgut; kurse Veniamini u burgos nën akuzën e borxheve që duhej të paguante për kohën kur ishte kontraktor i ushtrisë serbe, madje ai u përball edhe me dhunën që vetë Haxhi Qamili përdori kundër tij nga e cila arriti ta shpëtojë vetëm shuma e madhe e parave që u detyrua të paguajë.

Ndërsa kryengritja fshatare përhapej me shpejtësi në Kavajë, Peqin, Krujë, Elbasan, Myzeqe, Fier dhe Berat, pa ndeshur në kundërshtimin e forcave të qeverisë, e cila nuk kishte arritur të krijonte një ushtri të rregullt, kryengritësit morën vendimin të sulmonin Durrësin. Shpresa e vetme e shpëtimit ishin forcat shqiptare në jug të vendit. Por, të mbërthyer në luftë me grekët, ato nuk mund t’i vinin në ndihmë qeverisë së Durrësit.

Në vigjilje të shpërthimit të Luftës së Parë Botërore pozita e regjimit të Vidit ishte tejet e rëndë dhe praktikisht pa rrugëdalje si nga pikëpamja e situatës në vend, ashtu edhe nga zhvillimet në shkallë ndërkombëtare. Përveç Durrësit, qeverisë së Princit i kishte mbetur vetëm Vlora ku ishin mbledhur qindra shqiptarë “që rënktonin në mjerim në ullishtat e Vlorës”.<sup>525</sup> Gjithë pjesa tjetër e territorit kishte dalë jashtë kontrollit. Shqipëria e Mesme ishte në dorë të kryengritësve rebelë, bandat vorio-epirote bënë ligjin në Shqipërinë Jugore, ndërsa në veri po shfaqeshin kërcënueshëm trupat serbe. Kështu trazirat e brendshme në vend kishin nxitur edhe një herë dëshirat e ballkanasve për copëtimin e tokave shqiptare. Ndërkohë ndezja e konfliktit midis Austro-Hungarisë dhe Serbisë, që u bë shkak për fillimin e luftës në Evropë, e bëri ekzistencën e regjimit të Vidit krejt të pashpresë. Me shpërthimin e konfliktit Roma e Vjena kishin realizuar një marrëveshje të re mbi Shqipërinë dhe kishin arritur dakordsinë për ta rrëzuar princ Vidin dhe për t’i dhënë fund regjimit të tij. Ky qëndrim nuk ndryshonte asgjë në politikën permanente që Roma kishte ndjekur ndaj Vidit, por nga ana tjetër përbënte një kthesë thelbësore në politikën austro-hungareze, e cila pasi hodhi drejt harresës vendimet që ambasadorët e Fuqive të Mëdha morën në Londër në lidhje me neutralitetin e shtetit shqiptar, i kërkoi Vidit të hynte në luftë kundër Serbisë. Dilema e Princit solli braktisjen e tij prej Austro-Hungarisë. Kështu fundi erdhi shumë shpejt. Ndërsa ushtarët e fundit të fuqive ndërkombëtare po largoheshin nga Shkodra dhe fatin e vendit po ia dorëzonin një komisioni të formuar në vend të përbërë nga 6 katolikë dhe 6 myslimanë,<sup>526</sup> Vlora kishte nisur bisedimet me rebelët, të cilët më 1 shtator, hynë në “djepin e lirisë”.<sup>527</sup> Refugjatët e strehuar në Vlorë shpresonin se Princi, si i dërguari i pushteteve të mëdha, do të vinte me ushtri dhe do t’i dëbonte grekët jashtë tokës shqiptare e ata do të mund

<sup>525</sup> Selenica, Teki. *Shqipëria në 1927*, Tiranë, 1928, fq. 41

<sup>526</sup> Dervishi, Kastriot, *vepër e cituar*, fq. 69. Ky komision ishte i përbërë nga Preng Pasha, Shuk Serreqi, Shan Deda, Filip Kraja, Ndoc Çoba, Sulçe Bushati, Muharrm Kazazi, Alush Lohja, Jusuf efendi Golemi, Myrto Llazani dhe Haxhi Seferi.

<sup>527</sup> Selenica, Teki. *Shqipëria në 1927*, Tiranë, 1928, fq. 42

të ktheheshin përsëri në shtëpitë e tyre. Por në ato momente Princi kishte humbur edhe kartën e fundit që i kishte mbetur- përkrahjen e Austro-Hungarisë. Në 3 shtator 1914 (13 Sheval 1330)<sup>528</sup> Vidi, bashkë me mbretëreshën dhe kabinetin e tij qeveritar, lë pas Durrësin dhe me stacionerin italian “Misurata” niset për në Lugano, duke i dhënë lamtumirën shqiptarëve “që po shihnin të binte flamuri kombëtar me shqiponjën e moçme në qiell të kuq, nga pallati mbretëror i mbetur shkretë dhe vendin e tij po e zinte flamuri turk, simbol i robërisë pesëshekullore.”<sup>529</sup>

Largimi i princit nga Shqipëria ishte dëshmi e dështimit të pranisë evropiane në organizimin e shtetit shqiptar, kurse Shqipëria u shndërrua në fushë betejë të palëve ndërluftuese gjatë Luftës së Parë Botërore.

### III-3 Angazhimi politik i Lef Nosit gjatë Luftës së Parë Botërore

Në gusht të vitit 1914 në Ballkan do të nisë lufta e cila shpejt do të marrë përmasa botërore. Edhe sakrifikimi i të drejtave themelore të Shqipërisë, të cilat, sikurse e kishte pohuar edhe ministri i jashtëm anglez E. Grey, njëkohësisht kryetar i Konferencës së Ambasadorëve në Londër: “u bënë fli për të shpëtuar *“koncertin e Fuqive”* si kusht i ruajtjes së paqes në Evropë”,<sup>530</sup> nuk e kishte shmangur shpërthimin e luftës në Evropë. Fillimi i konfliktit botëror solli prishjen e ekuilibrit të interesave ndërmjet shteteve të interesuara për çështjen shqiptare; Austro-Hungarisë që u bë pjesë e aleatëve të Bllokut Qendror dhe Italisë e cila para se të bashkohej me Antantën ruajti pozitat e asnjansisë për të nxjerr përfitimet e mundshme nga situata ndërkombëtare konfliktuale. Prishja e këtij ekuilibri mes këtyre dy Fuqive evropiane u bë faktori përcaktues në paqëndrueshmërinë e pushtetit të princ Vidit në Shqipëri i cili, i sulmuar brenda vendit dhe pa mbështetje të jashtme, ia lëshon drejtimin e shtetit shqiptar KNK-së. Me Princin që largohej, më 3 shtator 1914, shqiptarët shihnin ëndërrën e tyre evropiane të venitej. Shqipëria asnjansë, në hapat e para të organizimit të shtetit, do të kthehet në arenë lufte për Fuqitë e Mëdha. Në një luftë gjatë të cilës kishte zgjedhur të ishte asnjansë, ajo do ta pësojë më shumë se palët ndërluftuese. Ndërkohë situata e krijuar nga shpërthimi i një kryegritje të brendshme që kishte nisur në mbrojtje të flamurit turk do të zgjojë edhe një herë lakmitë e fqinjëve tanë ballkanikë të cilët u hodhën mbi territoret, të cilat prej kohësh i lakmonin, por që deri atëherë ua kishin mohuar.<sup>531</sup> Shqipëria e zhytur në kaos, me shtëpi që digjeshin, me shqiptarë që vriteshin e burgoseshin, me pasuri që rrëmbeheshin e plaçkiteshin, krejt e paralizuar po kalonte momente shumë të vështira. Viti 1914, me shkatërrimin e Shqipërisë po mbyllte ditët e fundit në Shkodër ku shqiptarët luftonin “për të mbajtur lart nderin e flamurit të kombit”.<sup>532</sup> Kaosi i atyre ditëve arriti edhe në qytetin verior shqiptar

<sup>528</sup> AQSH, F. 32, D. 37, f. 72

<sup>529</sup> Selenica, Teki. *Shqipëria në 1927*, Tiranë, 1928, fq. 42

<sup>530</sup> Puto, Arben. *Shqipëria politike...*, vepër e cituar, fq. 84. Nga E. Grey, *Speeches on Foreign Affairs*, London 1913, pg. 219

<sup>531</sup> Jacques, Edwin. *Shqiptarët*, Tiranë, 1995, fq. 397

<sup>532</sup> Selenica, Teki. *Shqipëria në 1927*, Tiranë, 1928, fq. 49



ku, e nxitur nga propaganda e huaj, filloi lufta mes myslimanëve që donin të ngrinin flamurin e Turqisë dhe popullsisë katolike të qytetit që luftonin për të mbrojtur me pushkë dhe gjak flamurin kombëtar të shqiptarëve. Me largimin e pinc Vedit kryeqyteti shqiptar, Durrësi, kishte rënë në duart e kryengritësve të cilët ngritën në qytet flamurin turk. Këshilli Bashkiak i qytetit u dorëzoi kryengritësve të gjithë dokumentacionin që zotëronin, financat, madje edhe armët. Anarkisë së përgjithshme në të cilën ishte përfshirë vendi nuk i munguan edhe aktet shkatërruese sikurse ishte djegia e zyrave të kadastrave. Ndërsa e gjithë Shqipëria e Mesme ishte në duart e kryengritësve, drejtuesit e tyre nisën përpjekjet për ta kaluar qeverisjen e shtetit shqiptar në duart e një princi turk.

Në këto momente rishfaqet në skenën shqiptare Esad Toptani i cili nuk kishte hequr dorë nga synimet e tij politike. Në faqet e shtypit të kohës botohet një letër që Esad Pasha i dorëzon mjekut të princ Vedit, dr. Berghausen, për kreun e shtetit shqiptar ku ndër të tjera shkruhej: *“Gjer sa të ketë jetë a gjer sa Ay (princ Vidi- E. A) të heqë dorë nga froni, kurrë një njeri tjetër, s’ka për t’u bamun Regj’ i Shqipëniës; e në qoft se Lartësia e Tij heq dorë o vdes, vetëm unë kam për të qenë për t’i za vendin”*.<sup>533</sup> Sado që kjo letër botohej me mjaft rezerva, për shkak të dyshimeve mbi vërtetësinë e mundësisë që pashai Toptanas të shprehet në të tillë mënyrë, ajo gjithsesi hedh dritë mbi opinionin që ekzistonte në vend në lidhje me synimet politike të Esad Pashës. Në fakt, duke përfutur nga situata e krijuar në vend në gusht të 1914-ës, Esadi largohet nga Italia, vendoset fillimisht në Athinë dhe më pas në Nish, në qendrën e qeverisë serbe. Në fillim të tetorit ai erdhi në Durrës, me rreth 4000 dibranë, ku menjëherë e shpall vehten “kryetar të qeverisë së përkohëshme” dhe “komandant të përgjithshëm të ushtrisë”.<sup>534</sup> I vëmendshëm ndaj situatës në të cilën ndodhej vendi dhe në veçanti ndaj lëvizjeve të Esat pashë Toptanit, Lef Nosi do të mbaj shënim në ditarin e tij personal: *“5 vjesht I’14 kryengritësit hynë në Durrës...2 vjesht II’14 Esat pasha hyn në Durrës me 3-4000 dibranë”*.<sup>535</sup> Rikthimi i tij ishte një sfidë e re që i bëhej asaj pjese të lëvizjes nacionaliste në vend, me orientim perëndimor e cila jo vetëm vazhdonte të mbështeste Vidin, por përmes tij shpresonin në një zhvillim më demokratik antifeudal të shoqërisë shqiptare. Ky fakt shpjegon edhe valën e zemërimit që përfshiu shtresat e gjera të popullsisë dhe që gjeti shprehjen e vet në rritjen e fuqishme të lëvizjes antiesadiste. Në këtë lëvizje u përfshinë elementë të ndryshëm, nga emisarët e xhonturqve që dolën me parrullën e “luftës së shenjtë” të myslimanëve, deri tek qarqet nacionaliste që shpresonin tek një disfatë e Serbisë e cila kishte dalë në krahë të Esad Pashës, e për t’i kthyer Shqipërisë tokat që i ishin shkëputur.<sup>536</sup> Këto bindje bënë që L. Nosi të bëhet pjesë e rretheve nacionaliste shqiptare të cilat, sikurse thekson në kujtimet e tij Eqrem bej Vlora, i kishin lidhur shpresat me Austrinë duke qenë të bindur se fitorja e Fuqive të Boshtit do të bënte të mundur që

<sup>533</sup> “Përlindja e Shqipëniës”, Vlorë, 15/28 kallënduer 1914, f. 4

<sup>534</sup> *Historia e popullit shqiptar*, Vëll. III, Tiranë, 2007, fq. 68

<sup>535</sup> AQSH, F. 32, D. 37, f. 72

<sup>536</sup> Puto, Arben. *Historia diplomatike...*, Tiranë, 2003, fq. 233-234

Shqipërisë t'i bashkohen edhe tokat shqiptare në Serbi e Mal të Zi.<sup>537</sup> Në këtë kushte Lef Nosi, përkrahës i kthimit të Vidit në Shqipëri dhe kundërshtar, edhe më parë, i politikës esadiste në vend, do të pozicionohet edhe një herë kundër veprimeve të Esad Toptanit, i cili si kryetar i vetshpallur i qeverisë së tij, do ta rreshtojë Shqipërinë në krahun e fuqive të Antantës. Ky akt, me mbarrimin e luftës, u cilësua si shkelje e neutralitetit nga vetë shqiptarët, atij neutraliteti të njohur e garantuar nga Fuqitë e Mëdha përmes akteve ndërkombëtare duke vënë për rrjedhojë në rrezik edhe arritjet e deriatëhershme politike. Si politikan e diplomat, Lef Nosi, që prej 1913-ës në Qeverinë e Vlorës, ishte përpjekur ta kufizonte veprimtarinë e Esat Pashës e të shmangte luftën vëllavrasëse mes shqiptarëve. Por tashmë dëmi ishte bërë. Esat Toptani, i ndihmuar nga Serbia, nga kundërshtari i përhershëm i ekzistencës së shtetit shqiptar, nga lakmitari i tokave shqiptare dhe masakruesi i popullsisë së pafajshme që jetonte në trojet e veta të përfshira në kufijtë e shtetit serb, kishte zënë kryet e shtetit shqiptar, ndërkohë që princ Vidi nuk kishte abdikuar. Nga ky pozicion ai fillon goditjet ndaj të gjithë atyre shqiptarëve që nuk pajtoheshin me qëndrimin e tij. Në kuadër të reformës agrare që ndërmori në vend, Esadi do të urdhërojë konfiskimin e rreth 50 personave të pasur në vend, mes të cilëve edhe Biçakçijtë në Elbasan (por jo Dervish Biçakçiun) si edhe të kundërshtarëve të tij politik.<sup>538</sup> Kjo solli reagimin e krahut nationalist, mes të cilëve ishte edhe Lef Nosi i cili, sipas të dhënave arkivore, gjatë lëvizjes së vitit 1914 kishte krijuar një repart vullnetarësh shqiptarë për t'iu kundërvënë forcave të Esad Pashë Toptanit,<sup>539</sup> vullnetarë të cilët ai i mbante me shpenzimet e tij duke i paguar me 78 groshë çdo 2-3 ditë.<sup>540</sup> Dhe përplasjet e armatosura duket se nuk kanë munguar mes të dyja palëve e një fakt të tillë na e pohon edhe studiuesi J. Swire i cili ndër të tjera thekson se në qytetin e Elbasanit, "...pasuan luftime ndërmjet esadistëve dhe përkrahësve të qeverisë".<sup>541</sup>

Kështu gjendja në Shqipëri, në fazën fillestare të luftës, karakterizohet nga ballafaqimi i dy forcave kryesore: Esat Toptani dhe rrethi i tij që ishin vazhdimisht në tërheqje derisa u mbyll në Durrës; nga ana tjetër ishin forcat kryengritëse që e shtrinë kontrollin në Shqipërinë e Mesme e më tej në jug. Pa dyshim që antiesadizmi përbënte një platformë solide për realizimin e një fronti të përbashkët. Por aleanca e vërtetë mes gjithë forcave të shëndosha patriotike e përparimtare të bashkuara rreth një programi të vetëm nuk u arrit të formohej.<sup>542</sup> I ndodhur nën presionin e "qeverisë" së Esat Pashës dhe nën goditjen e lëvizjes kryengritëse, Lef Nosi, bashkë me nacionalistë të tjerë, detyrohet të largohet nga zona e Elbasanit dhe në fillim të 1915-ës nisat drejt Shqipërisë së Veriut ku rreziku i sulmeve serbo-malazeze ishte bërë mjaft evident, sidomos pas zbarkimit të trupave italiane në Vlorë në dhjetor të 1914-ës. "Në 23 Kallindur 1915 –

<sup>537</sup> Vlora. Eqrem, *Kujtime 1885-1925*, Tiranë, 2003, fq. 418

<sup>538</sup> Dervishi, Kastriot, *vepër e cituar*, fq. 61.

<sup>539</sup> AQSH, F. 32, D. 11, f. 1

<sup>540</sup> Po aty, D. 10, f. 7

<sup>541</sup> Swire, Joseph. *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie*, Tiranë, 2005, fq. 157

<sup>542</sup> Puto, Arben. *Historia diplomatike...*, Tiranë, 2003, fq. 235

do të shkruante Lefi në ditarin e tij, - ora 11<sup>15</sup> *allaturka, rrebelat burgosën 45 nacionalista*".<sup>543</sup> Në 13 shkurt Lefi nisët drejt Matit dhe e kalon natën në shtëpinë e Ahmet bej Zogollit, shtëpia e të cilit "...pret e përcjell çdo atdhetar që shtrëngohet me marr malet nga frika e kryengritësve",<sup>544</sup> - do të shkruante Thanas Floqi në kujtimet e tij. Të nesërmen L. Nosi do të nisët për në Lezhë dhe në 18 shkurt do të arrijë në Shkodër duke u vendosur fillimisht në hotelin e Ndoc Shkrelit. L. Nosi do të qëndrojë në Shkodër deri në fillim të muajit korrik,<sup>545</sup> kohë kur trupat malazeze do të pushtojnë qytetin verior shqiptar të vendosur nën administrimin ndërkombëtar. Ditëve të para të janarit, në Shkodër, e cila ishte bërë strehë e figurave të njohura të lëvizjes sonë kombëtare, kishin mbërritur edhe Aqif Pasha e Luigj Gurakuqi të cilët asistuan edhe në riorganizimin e klubit "Lidhja Kombëtare", parijs e të cilit pasi u këshillua me shumë anëtarë të parisë së qytetit, hartuan një protestë, drejtuar trupit konsullor në Shkodër, për të kundërshtuar "sjelljet e damshme për Shqypnin të Esat Toptanit dhe ankohen që një shtet i madh fqinj, jashtë zërit ndërkombëtar, përkrah sjelljet e Toptanit duke i mundësuar atij të marr Lezhën e Shëngjinit...".<sup>546</sup> Edhe Lef Nosit, i cili që prej 1913-ës ishte pozicionuar totalisht kundër veprimeve të Esat Pashës, do t'i bashkohet protestës së këtij klubi i cili për t'i dalë përpara ngatërresave e armiqësive të brendshme e të jashtme shpalli një program të hartuar në katër pika që parashikonte:

1. Të ndiqte përfundimisht ngatërrestarët e tradhtarët prej Shëngjinit deri në Shkodër e rreth e rrotull
2. Organizimin e një ushtrie kombëtare
3. Ruajtjen e paanësisë së Shqipërisë në luftën evropiane deri në mbarimin e saj
4. thirrjen e një kongresi në Shkodër me pjesëmarrjen e prijësve e përfaqësuesve nga e gjithë popullsia shqiptare që do të bënte të mundur formimin e një qeverie të përkohshme për gjithë Shqipërinë e rreth së cilës do të bashkohej i gjithë populli shqiptar".<sup>547</sup>

Mirëpo në fund të qershorit Mali i Zi lajmëroi Fuqitë Aleate mbi vendimin që kishte marrë për pushtimin e qytetit verior shqiptar. Më 27 qershor 1915 Shkodra u pushtua nga trupat malazeze.<sup>548</sup> Menjëherë malazezët filluan ndjekjet, internimet e vrasjet e veprimtarëve të lëvizjes patriotike kombëtare që kishin gjetur strehim politik në Shkodër. Ndërsa Aqif Pashë Biçakçiu, Luigj Gurakuqi e atdhetarë të tjerë u internuan në Mal të Zi, Lef Nosi arrin të largohet nga Shkodra e nisët drejt Elbasanit.<sup>549</sup>

Nënshkrimi i Traktatit të Fshehtë të Londrës nga Italia, në 26 prill 1915, që i trajtoi tokat shqiptare si plaçkë lufte, i hapi rrugën shndërrimit të territorit shqiptar në shesh luftimesh. Ky akt i dha fund hezitimeve të qeverive të Beogradit dhe Cetinjes të cilat nisën të vënë në jetë planet për të hyrë ushtarakisht në tokat

<sup>543</sup> AQSH, F. 32, D. 37, f. 111

<sup>544</sup> Verli, Marenglen & Duka, Ferit. *L. Nosi. Dokumente Historike*, Kujtime të Thanas Floqit. 1914, Tiranë, 2007, fq. 307

<sup>545</sup> AQSH, F. 32, D. 30, f. 8

<sup>546</sup> "Lidhja Kombëtare", Shkodër, 29 mars 1915, nr. 10, f. 1

<sup>547</sup> Po aty.

<sup>548</sup> Çami, Muin. *Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare 1914-1918*, Tiranë, 1987, fq. 198

<sup>549</sup> AQSH, F. 32, D. 30, f. 8

shqiptare. Me sulmin e forcave malazeze ndaj Shkodrës dhe vërshimin e serbëve ndaj viseve të Shqipërisë së Mesme, duke shpëtuar Esadin nga rrethimi, lëvizja kryengritëse antiesadiste u shtyp. Në tokat shqiptare u ndez fronti i parë i luftës mes trupave serbo-malazeze dhe atyre austro-hungareze. Në qershor të vitit 1915 ushtritë serbe pushtuan qytetin e Elbasanit. Vendin e flamurit turk tashmë e zuri flamuri serb, simbol i sundimit të ri ushtarak që u vendos në qytet e që do vazhdojë për shtatë muaj, deri në shkurt të 1916-ës, kohë kur filloi ofensiva e trupave austro-hungareze të cilat detyruan ushtritë serbe, të mundura, të braktisin tokat e pushtuara shqiptare. Në janar 1916 ushtritë austro-hungareze depërtojnë në brendësi të kufirit verior shqiptar, pushtojnë Shkodrën dhe nisen drejt qyteteve të Shqipërisë së Mesme. Duke përfutur nga kjo situatë, niset drejt Elbasanit Aqif Pasha, i cili sapo kishte ngritur flamurin kombëtar në pallatin mbretëror në Durrës e po kthehej në Shijak. Fillimisht në qytet mbërriti ushtria bullgare e cila u mirëprit nga popullsia vendase dhe për ngjarjen u mbajt edhe një proces-verbal që u nënshkrua nga oficerët bullgarë dhe përfaqësuesit e qytetit: Lef Nosi, Kasem Sejdini, Filip Papajani e Emin Matraxhiu. “Sot më 29 Kallinduer 1916 ora 4<sup>30</sup> pas mesdite – shkruante Lef Nosi në përpjekje të grumbullimit e ruajtjes së ngjarjeve historike, - fuqia priëse e Ushtriës Bulgare të të 23<sup>tit</sup> regjiment infanterie hyni në qytet Elbasan (Shqipënië), i cili ish stolisë me flamurë kombëtarë Bullgarë e Shqipëtarë. Ushtria, me një herë muer masat për me mbajtë qetësiën e rregullin mbrenda në qytet.”<sup>550</sup> Ardhja e bullgarëve, aleatë të Austro-Hungarisë në Bllokun Qendror, i dhanë fund pranisë serbe në qytet. Pas bullgarëve mbërritën në Elbasan, nga Shëngjergji përmes grykës së Zaranikës, edhe forcat shqiptare të Ahmet Zogut ( rreth 500 pushkë) nën komandën e kapiten Leon De Gilhardit, Selahudin Blloshmit e të Zija Bej Gjakovës,<sup>551</sup> gjë e cila i dha frymë dhe solli forcimin e krahut nationalist në qytet. Por dy ditë më vonë, më 9 shkurt, ushtritë bullgare u detyruan të tërhiqeshin nga Elbasani duke ia lanë vendin trupave austro-hungareze.<sup>552</sup> Pushtimi i ri, ndonëse mbetej një pushtim i huaj, kishte një ndryshim të madh jo vetëm nga sundimi serb, por edhe nga “qeverisja” e rebelëve apo e esadistëve. Në kushtet kur vendi ishte i tëri i pushtuar nga trupat ushtarake të fqinjëve ballkanikë dhe Italia, për Lef Nosin, sikurse edhe për shumë patriotë të tjerë, Monarkia Danubiane paraqiste rrezikun më të vogël. Gjithashtu ai dhe rrethet patriotike në vend mendonin të shfrytëzonin në interes të çështjes kombëtare kontraditat midis vendeve ndërluftuese. Për më tepër ushtria austro-hungareze kishte ardhur në Shqipëri duke ndjekur nga këto toka ushtritë serbe e malazeze dhe si e tillë ajo shihej si “mbrojtësja” e viseve shqiptare dhe e popullit shqiptar. Madje figura të njohura politike në vend si Luigj Gurakuqi, Aqif pashë Elbasani etj, në kontakt të vazhdueshëm me të cilët ishte edhe Lef Nosi, do t’u bëjnë thirrje shqiptarëve që t’i prisnin austro-hungarezët “...si rojtës e libruës e....Most’i qesim n’harresë, t’tana ato kujdesime

<sup>550</sup> Verli, M & Duka, F. *Dokumenta Historike...*, Tiranë, 2007, fq. 246

<sup>551</sup> AQSH, F. 32, D. 37, f. 117

<sup>552</sup> *Elbasani Enciklopedi*, Elbasan, 2003, fq. 347

*t'viejshme e mirsina t'ushtrinave Austro-Ungare...*".<sup>553</sup> Në përgjithësi rrethet patriotike shqiptare prisnin shumë nga një fuqi si Austro-Hungaria, e cila në Konferencën e Ambasadorëve në Londër kishte dalë në mbrojtje të pavarësisë së Shqipërisë dhe kundër copëtimit të viseve të banuara nga një shumicë popullsie shqiptare. Tani prania e forcave ushtarake në vend ushqente shpresa se në mbarim të luftës një Austro-Hungari fitimtare do të përkrahte jo vetëm rimëkëmbjen e pavarësisë, por edhe caktimin e kufijve në bazë të kriterit etnik.<sup>554</sup>

Autoritetet ushtarake të Monarkisë Dualiste u treguan shumë më liberalë ndaj Shqipërisë dhe më dashamirës ndaj kulturës shqiptare. Interesi austro-hungarez për territoret shqiptare, - sikurse e vlerëson edhe studiuesi Oliver J. Schimtt - duhet vështruar edhe në sfondin e konstelacioneve të atëhershme politike, të protektoratit kulturor austro-hungarez ndaj katolikëve në territoret shqiptare të veriut, të konkurrencës me Italinë për hegjemoninë në Adriatikun Jugor dhe të frezistencës ndaj pretendimeve territoriale serbe për Shqipërinë e veriut dhe atë Qendrore.<sup>555</sup> Rrjedhojë e kësaj politike në Shqipëri ishte edhe rifillimi i punës, në mars të 1916-ës, në shkollën Normale të Elbasanit e cila do të vazhdojë të funksionojë deri në korrik të 1918-ës. Patriotëve shqiptarë iu ngjallën shpresat se me praninë ushtarake të Austro-Hungarisë, e cila ishte shfaqur si faktori ndërkombëtar më i favorshëm për pavarësinë e Shqipërisë, ishte rasti më i mirë për të krijuar një bërthamë të administratës kombëtare dhe për të hedhur themelet e shtetit të ri shqiptar që do të rimëkëmbej pas mbarimit të luftës, ndoshta edhe në kufijtë e rivendosur etnikë. Madje, në këtë drejtim, autoritetet austro-hungareze të pushtimit nuk i kursyen shpalljet dhe sigurimet se vinin në Shqipëri si "miq" kundër "armiqve të përbashkët serbë e italianë", prandaj u bënë thirrje shqiptarëve të bashkoheshin me ta në luftë.<sup>556</sup> Në këto kushte një pjesë e mirë e personaliteteve shqiptare, që kishin luajtur një rol të madh në ditët e pavarësisë dhe që kishin bindjen se gëzonin përkrahjen e Vjenës, bënë plane e filluan përgatitjet për të thirrur në mars të vitit 1916, në Elbasan, një kongres kombëtar me përfaqësues nga krahina të ndryshme të Shqipërisë, i njohur edhe si Kongresi i Dytë i Elbasanit. Ndër organizatorët e këtij kongresi u dallua edhe Lef Nosi, i radhitur përkrahë personaliteteve të tjera të shquara të skenës politiko-historike shqiptare, si Aqif Pashë Biçakçiut. Përpjekjet për një organizim më të mirë të qëndresës shqiptare dhe të jetës politike në vend kishin nisur që prej momenteve të fundit të pranisë së trupave bullgare në qytet, kohë gjatë së cilës Ahmet Zogu bashkë me kapiten Gilhardin, Salahedin Blloshmin e të tjerë nisen drejt Elbasanit. Më 31 janar ata takuan në qytet Aqif Pashën, Lef Nosin dhe Mit'hat Frashërin. Menjëherë pas ardhjes së forcave austro-hungareze dhe vendosjes së rendit, përpjekjet filluan të konkretizohen. Atdhetarët e mbledhur në Elbasan kishin ngritur një Asamble Kombëtare të përkohshme dhe kishin zgjedhur një Komision Nismëtar.<sup>557</sup> Lef

<sup>553</sup> *Dokumenta Historike...*, Tiranë, 2007, fq. 244

<sup>554</sup> Puto, Arben. *Shqipëria politike*, vepër e cituar, fq. 179

<sup>555</sup> Schimtt, Oliver Jens. *Historia e shqiptarëve*, Tiranë, 2012, "*Monada e Ballkanit*", fq. 70

<sup>556</sup> Puto, Arben. *Historia diplomatike...*, Tiranë, 2003, fq. 252

<sup>557</sup> Swire, Joseph. *Shqipëria...*, Tiranë, 2005, fq. 214

Nosi ishte zgjedhur anëtar i këtij komisioni për organizimin e kongresit, në të cilin bënë pjesë edhe Ahmet Zogu, Qemal Karaosmani, Simon Shuteriqi, Ymer Stringa, Sava Papajani, Ahmet Sinani, Shefqet Daiu dhe Thanas Floqi. Ky komision, me miratimin e njëzëshëm të Asamblesë Kombëtare, më 18 shkurt vendosi që një muaj më vonë, më 18 mars 1916, të mbahej një kongres kombëtar, i cili kishte për qëllim “të bisedojë për shtetin që ndodhen punët e atdheut sot edhe për masat që duhen marrë për forcimin e Shtetit Shqiptar”.<sup>558</sup> Ky kongres merrte përsipër të zgjidhte 3 detyra parësore:

1. Përcaktimin e masave që duheshin marrë për forcimin e shtetit shqiptar,
2. shfaqjen e dëshirës për ardhjen e shpejtë në Shqipëri të Princ Vidit,
3. dhe realizimin e bisedimeve mbi mënyrën e qeverisjes së Shqipërisë deri në ardhjen e Vidit.<sup>559</sup>



Gjatë mbledhjes së 18 shkurtit anëtarët e komisionit u shprehën në favor të kthimit të shpejtë të Princ Vidit në krye të shtetit shqiptar por njëkohësisht ata diskutuan edhe mbi formën e qeverisjes së vendit

deri në ardhjen e tij. “Pasi kur u largua Mbreti prej Shqipërie – shkruhet në procesverbalin e 18 shkurtit të 1916-ës, - u shtrëngua edhe Qeveria të përndahet pa hekun dorë ministrit prej detyrave që kishin, komisioni do t’i propozojë z. Aqif Pashë, Ministrit të Punëve të Brendshme për me thirrur këtu (Elbasan- E.A) edhe ministrit e tjerë që të marrin së bashku masat e nevojshme për me nisë prap punën që kishin lanë kur u përdanë”.<sup>560</sup>

Në këto kushte Aqif Pashë Elbasani, si ministër në qeverinë e princ Vilhelm Vidit, i cili nuk kishte dhënë kurrë dorëheqjen, ftoi të gjithë kolegët e tij të mbledheshin në Elbasan e të vazhdonin të qeverisnin vendin. Për postet ministrore të lëna vakant, në mbledhjen e shkurtit ishte vendosur t’i propozohej Aqif Pashës një listë e përbërë nga 16 anëtarë ku do të zgjidhej ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Punëve të Jashtme, ministri i Udhëheqjes së Forcës së Armatës, ministri i Punëve të Brendshme të Elbasanit, ministri i Punëve të Brendshme të Vlorës, dhe Ahmet Zogu i cili gëzonte mjaft autoritet në zonat ku kishte qenë i fortë ndikimi i E. Toptanit, të cilët duke qenë në Komisionin Nismëtar të Kongresit, vendosën të mos pranonin të merrnin poste të tjera.<sup>561</sup> Menjëherë pas mbledhjes Komisioni Nismëtar nisi punën për organizimin e kongresit kombëtar përmes thirrjes së delegatëve, dy delegatë me mandat

<sup>558</sup> Verli, M & Duka, F. *Dokumenta Historike...*, Tiranë, 2007, fq. 248

<sup>559</sup> *Elbasani-Enciklopedi*, Elbasan, 2003, fq. 303

<sup>560</sup> Po aty

<sup>561</sup> Selenica, Teki. *Shqipëria në 1927*, Tiranë, 1928, fq. 47



përfaqësimi, jo vetëm nga krahinat shqiptare por edhe nga kolonitë shqiptare në mërgim. Sipas ditarit ku Lef Nosi mbante shënim të gjitha ngjarjet në vend, vihen re lëvizje të shpeshta të tij në qytete të ndryshme të vendit, Tiranë, Durrës, Kavajë, Lezhë e Shkodër.<sup>562</sup> Sipas një urdhërese të Komandës austro-hungareze në Elbasan, dalja e qytetarëve elbasanas nga qyteti drejt Durrësit e më tej, mund të kryhej vetëm me lejen Kryekomandës së Durrësit e cila sigurohej përmes Komandës së vendit në Elbasan.<sup>563</sup> Në këto kohë Lef Nosi bashkë me Islam Bej Vrionin, pasi siguruan lejen nga toger Gilhardi, i cili vuri në dijeni mbi lëvizjen e tyre edhe komandën në Mamurras që kontrollonte rrugën Milot-Shkodër, u nisën me kuaj në drejtim të Shkodrës. Këtu, ndër punë të tjera zyrtare, “morën përsipër të zgjidhnin edhe problemin e ushqimit në vend”.<sup>564</sup> Nisur nga informacioni që ka dërguar përfaqësuesi austro-hungarez, August Kral, në Austri: “...më 22 mars 1916, Aqif Pasha ka emnue prefektë në Elbasan, Berat, Durrës dhe nënprefektë në Peqin, Gramsh, Fier, Lushnjë, Mallakastër, Skrapar e Mat dhe pastaj 30 mydyrë, policë etj Rrogat i paguan nga të ardhurat e tatimeve që mbledhen... Autoritet që emëroi në Qukës, Starovë, Malësinë e Dibrës së Poshtme nuk u lejuan të ushtronin funksionet e tyre nga pushtuesit bullgarë”.<sup>565</sup> Rrjedhimisht në vend u krijua një situatë e tillë ku në Shqipërinë e Mesme ekzistonin autoritetet drejtuese kurse në Shqipërinë Veriore ende nuk kishte të tilla.

Mirëpo ndryshe nga sa shpresonin shqiptarët, Vjena kishte ide të tjera dhe variante të ndryshme për sa i përket të ardhmes së Shqipërisë. Diskutimet shkonin që nga rimëkëmbja e Principatës Shqiptare nën Vidin e deri tek projektet për copëtimin e mëtejshëm të Shqipërisë midis shteteve fqinje dhe në aneksimin e tokave shqiptare prej Malit të Zi e një pjese të Serbisë nga ana e Austro-Hungarisë.<sup>566</sup> Ndaj autoritetet ushtarake austriake, me pretekste të ndryshme, nuk e lejuan mbajtjen e kongresit në Elbasan, madje shpallën ndalimin e çdo aktiviteti politik në territorin e kontrolluar nga trupat e Monarkisë. Ata ndaluan ngritjen e flamurit shqiptar apo çdo formë vetëqeverisje, duke përfshirë edhe kthimin në fron të princit gjerman Vilhelm Vidit.

Në rrethanat e rënduara të luftës, komandanti austro-hungarez i distriktit të Elbasanit, Czapek Majn, njoftoi Bashkinë: “...lutemi të keni ndërmend se asmbletë që kanë një qëllim politik janë të ndaluara në viset e shkelura prej ushtrisë perandorake mbretnore, ashtu si në kohë lufte edhe në Austro-Hungari janë të ndaluara...”<sup>567</sup> Pas kësaj shpallje, më 14 prill, Aqif Pasha njoftoi dorëheqjen e tij duke shprehur besimin se marrja në dorë e qeverisjes së Shqipërisë nga austro-hungarezët ishte vetëm një masë e përkohshme që bëhej e domosdoshme prej situatës ushtarake.

Ndërkohë, për të mos lënduar ndjenjat e shqiptarëve dhe për të shmangur kalimin e tyre në krahun e kundërt, atë proitalian, autoritetet austriake realizuan disa kërkesa të shqiptarëve me karakter kombëtar, për

<sup>562</sup> AQSH, F. 32, D. 30, f. 11

<sup>563</sup> Verli, M & Duka, F. *Dokumenta Historike...*, Tiranë, 2007, fq.252

<sup>564</sup> AQSH, F. 32, D. 10, f. 14

<sup>565</sup> Kotherja, Hyqmet. *Pavarësia e Elbasanit*, Tiranë, 2012, fq. 27

<sup>566</sup> Swire, Joseph. *Shqipëria...*, Tiranë, 2005, fq. 218

<sup>567</sup> *Elbasani-Enciklopedi*, Elbasan, 2003, fq. 303

të cilat ishte veçanërisht i ndjeshëm opinionin patriotik i vendit. Kështu në kuadër të respektimit të zakoneve dhe gjuhës së vendit u hap një tjetër Normale në Shkodër në fund të vitit 1917. Një arritje akoma më e rëndësishme ishte formimi i “Komisissë Letrare” për lëvrimin e gjuhës shqipe. Ata ngritën një administratë civile me nëpunës shqiptarë me qendër në Shkodër, por nën kontrollin e autoriteteve pushtuese. Këto lëshime që bënë austro-hungarezët në fushën kulturore u shfrytëzuan nga patriotët shqiptar për interesa thjesht kombëtare. Nisur nga përvoja dhe kontributi që Lef Nosi kishte dhënë për ngritjen e sistemin postar e telegrafik shqiptar si edhe nga përpjekjet që vazhdonte të bënte për ruajtjen e linjës së komunikimit mes qyteteve shqiptare,<sup>568</sup> në shtator të 1916-ës ai do të emërohet nga autoritetet austriake në *Stappen-Post* të Elbasanit, detyrë të cilën ai do ta mbajë deri në 10 tetor të 1918-ës.<sup>569</sup> Pas vdekjes së perandorit Franc Jozef, një delegacion shqiptar i përbërë nga 34 anëtarë nga vise të ndryshme të Shqipërisë, në të cilin Lef Nosi e Irfan bej Ohri përfaqësonin qytetin e Elbasanit, niset nga Shkodra, në 14 prill 1917, drejt Vjenës për ti uruar hipjen në fron Perandorit të ri, Karlit I.<sup>570</sup> Gjatë takimit me përfaqësuesit shqiptarë, perandori austriak thekson se “ të dy vendet kishin armiq të përbashkët dhe se Vjena kishte dëshirë t’i jepte Shqipërisë një administratë të rregulluar që të rregullonte fetë, fiset, gjuhën, shijet kombëtare e të drejtat e hershme të popullit shqiptar”.<sup>571</sup> Megjithatë autoritetet vjeneze me politikën e tyre jo vetëm që nuk e lejuan ngritjen e një administrate të pavarur shqiptare por nuk u angazhuan as në ndërmarrjen e masave konkrete që tu vinin në ndihmë kushteve të rënda ekonomike të popullsisë vendase e cila me shumë vështirësi mundahej të kapërcente shkatërrimet e shkaktuara gjatë pushtimit serb të 1915-ës. Kështu ndërsa ndërtonin, nga njëra anë, rrugë, teleferik, linjë dekovili apo përmisonin skelat në bregdetin shqiptar, nga ana tjetër, grumbullimi me forcë i gjësë së gjallë dhe i prodhimeve bujqësore e blegtorale për ushqimin e ushtrisë austriake, mobilizimi i detyruar i popullsisë për ndërtimin e objekteve ushtarake etj po e çonin popullsinë shqiptare drejt rrënimit ekonomik. Duke qenë se një vit më parë (v.1915) drithi në Shqipëri kishte qenë shumë i paktë pasi një pjesë e madhe e tij ishte mbledhur nga serbët gjatë ekspeditës së tyre ushtarake, filloi të vihej re se për muajt në vazhdim vendi do të përballej me siguri me vështirësi të mëdha “dhe një zi shumë të madhe ka me kallë në dhetë mijëra shpirta”.<sup>572</sup> Numri i njerëzve pa të ardhura dhe pa mjete jetese, ishte jo i paktë. Aty-këtu kishte edhe vdekje nga uria. Nga mungesa e ushqimeve disa njerëz nuk ishin në gjendje t’i rezistonin as sëmundjeve më të lehta. Në qytet kishte shumë lypsa.<sup>573</sup> Në këto kushte Katundaria e qytetit të Elbasanit, duke e parandjerë në kohë këtë mjerim, në mbledhjen e 7 gushtit të 1916-ës, zgjodhi një komision të kryesuar nga Qemal Bej (Karaosmani) e ku merrnin pjesë Lef Nosi dhe figura të tjera respektuara të

<sup>568</sup> AQSH, F. 32, D. 53, f. 7. Letër e 25 gushtit 1916 nga Elbasani që Lef Nosi ia dërgon Shefik Efendiut në Berat për ti bërë të ditur vonesën në dërgimin e pullave postare “...për shkak se nuk kemi komunikacion të rregullt me Beratin.”

<sup>569</sup> Po aty, D. 37, f. 118

<sup>570</sup> Gazeta “Vëllazëria”, Shkodër, 28 prill 1917.

<sup>571</sup> Dervishi, Kastriot. *Historia e shtetit shqiptar...*, Tiranë, 2006, fq. 80

<sup>572</sup> AQSH, F. 271 “Prefektura e Elbasanit”, D. 36, f. 6, viti 1916.

<sup>573</sup> Frashëri, Kristo. *Historia e Tiranës*, Tiranë, Toena, 2004, fq. 394

qytetit si Rrapush Demeti, Emin Haxhiademi, Ibrahim Miraku, Xhaferr Dardha, Hysein Dakli, Grigor Nosi e Gr. Cilka, komision i cili kishte për qëllim që të përkujdesej për mënyrën sesi do të sigurohej shpëtimi i popullit nga zia dhe uria. Nisur nga fakti se sigurimi i ushqimit në vend ishte i pamundur, komisioni vendosi të dërgojë në Zvicër një delegacion të përbërë nga 3 anëtarë i cili kishte si mision të takonte ambasadorët e Fuqive pjesëmarrëse në luftë për tu kërkuar atyre gjetjen e mënyrave për dërgimin në vend, përmes limaneve të Shqipërisë, të sasive të nevojshme të drithit nga Amerika, i cili do të mund ti shitej popullsisë nga një komision amerikanësh, mënyrë e cila ishte përdorur edhe më parë në Belgjikë. “...Misioni i delegacionit – theksohej në bisedimet e këtij komisioni, - do të jetë vetëm njerëzor e jo politik dhe të gjitha Katundaritë që po ndihmojnë ( Elbasani, Durrësi, Tirana, Fieri, Berat, Lushnja, Peqini e Kavaja) do të japin nga një shkresë përfaqësimi për me u njoft jashtë misioni i tyre”.<sup>574</sup> Anëtarë të këtij delegacioni u zgjodhën Gr. Cilka, Lef Nosi dhe Mit’hat Bej Frashëri. Pak ditë më vonë ky komision, mbi bazën e shkresës së 7 gushtit të hartuar nga Lef Nosi, Shefqet Daiu e aktivistë të tjerë të shpëtimit kombëtar, vendosi që të hartohet një lutje, në dy kopje: njëra për Kamejkamin e tjetra për Stacionkomandën, ku të kërkohej rishikimi e ndryshimi i sistemit të shitjes së të 10-tave të mëparshme të drithërave dhe gjetja e një mënyre të re shitjeje. Për hartimin e kësaj lutje punoi Lef Nosi sëbashku me Aleksandër Xhuvanin, Shefqet Daiun e Emin Haxhiademin. Pak ditë më vonë ky komision, nisur nga çmimet e larta me të cilat po shiteshin drithërat në treg, do t’i drejtojë një lutje edhe Katundarisë së Elbasanit: “I lutemi të ndershmes kryesi të katundariës që të bajë çapat e nevojshme atje ku e kërkon puna për me u ndreq ky gabim i tmerrshëm dhe të guditet (rregullohet-unë) puna në një mënyrë që të shitet drithi, m’ato çmime që mund t’i përgjigjet fuqia ekonomike e popullit tonë që asht i vobekët”.<sup>575</sup> Ajo që kërkonte Lef Nosi, bashkë me anëtarët e tjerë të komisionit, ishte që e 10-ta e drithit të mos shitej si përherë në treg, por drithi të vendosej në depot e shtetit që edhe shtresat e varfëra të mund ta blinin miellin me okë me çmime që nuk do ta kalonin çmimin e depozitave. Por, për fat të keq, zëri i tyre nuk u dëgjua pasi autoritetet pushtuese preferuan ta shisnin drithin në treg duke futur në arkën e financave të tyre të ardhura prej disa milion groshësh, të cilat u depozituan nëpër banka të ndryshme, dhe aspak nuk u interesuan të shpëtonin jetën e një populli të varfër, qëllim për të cilin ishte “mirëpritur” qeverisja e tyre e cila “ kishte si mision ta nxirrte popullin shqiptar nga prapambetja, e të përkrahte përparimin e tij ekonomik e kulturor”.<sup>576</sup>

Rrethanat e krijuara nga Lufta e Parë Botërore, trazirat e brendshme në mjedisin politik shqiptar, ndërhyrjet e huaja dhe agresiviteti i fqinjëve ndaj tokave shqiptare, e nxitën diplomacinë vjeneze të rishikonte qëndrimin e saj ndaj shqiptarëve dhe të hartojë projekte që planifikonin protektoratin austro-hungarez për Shqipërinë. Politika zhgënjyese që autoritetet pushtuese ndoqën ndaj shqiptarëve solli

<sup>574</sup> AQSH, F. 271 “Prefektura e Elbasanit”, D. 36, f. 6, viti 1916.

<sup>575</sup> Po aty, f. 15

<sup>576</sup> *Historia e popullit shqiptar*, Vëll. III, TOENA, Tiranë, 2007, fq. 87


gradualisht humbjen e besimit dhe zbehjen e shpresave edhe tek rrethet patriotike që tek Austro-Hungaria kishin kërkuar rrezen e shpëtimit të pavarësisë së vendit të tyre. Madje edhe proklamata që autoritetet austro-hungareze shpallën në 23 janarit 1917, jo vetëm që u premtonte shqiptarëve veç autonominë, dhe atë në një kohë të pacaktuar, por la në heshtje edhe çështjen e rëndësishme të kufijve politik të shtetit shqiptar, qëndrim i cili solli rritjen e mosbesimit të opinionit të gjerë shqiptar.<sup>577</sup>

Por në kushtet kur fundi i luftës ende nuk shihej e kur grupimi fitues akoma nuk mund të përcaktohej, forcat patriotike e ndërtuan qëndrimin e tyre mbi bazën e konjunkturave politike të pushtuesve në vend. Duke përfutur nga rritja e pakënaqësisë së shqiptarëve mbi çështjen e “autonomisë” së ofruar nga austriakët, vjen në qershor të 1917-ës proklamata e autoriteteve italiane që shpallte “unitetin e pavarësinë e gjithë Shqipërisë”<sup>578</sup> e cila jo pa qëllim e bë e njohur botërisht në qytetin e Gjirokastrës, qytet shqiptar i lakmuar historikisht nga qarqet politike greke. Me këtë qëndrim italianët kërkonin të siguronin tërheqjen e shqiptarëve drejt politikës së tyre, mbështetje të cilën jo vetëm që nuk e siguruan por, “mbrojtja” italiane për shtetin shqiptar, solli reagimin dhe kundërshtimin e rretheve patriotike shqiptare brenda e jashtë vendit.

### III-4 Lef Nosi dhe “Kopështi Letrar”

Ndërsa autoritetet pushtuese në vend luanin politikën e “favorizimit të nacionalizmit shqiptar”, veprimtarët e çështjes kombëtare, mes të cilëve edhe L. Nosi, u përpoqën të shfrytëzonin nga liritë e ofruara për të mbajtur gjallë ndjenjat kombëtare mes shqiptarëve. Në këto kushte, më 15 shkurt 1918, Lef Nosi së bashku me Shefqet Daiun, Dervish Himën, Thanas Floqin, Ahmet Gashin, Aleksandër Xhuvani, Dhimitër Pappariston, Petër Dodbibën, Ismail Haxhi Hysenin, Emin Haxhiademin, Salih Çekën, Simon Shuteriqin, Fot Papajanin, Ahmet Hastopalli, Ahmet Daklin etj, formuan “Qarkun Letrar të Elbasanit”. Kjo shoqëri kulturore kishte për qëllim zhvillimin e letërsisë shqipe dhe përhapjen e qytetërimit duke botuar:

- 1- libra shkollorë e popullorë
- 2- revistën e përmuajshme, shoqërore e kulturore “Kopështi Letrar”, “...që do të përmbajë folklorën shqipe e artikuj ditunie”,
- 3- gazetën “Shkumbini”,



<sup>577</sup> Po aty

<sup>578</sup> Po aty, fq. 93

4- dhe “ duke ngritun një bibliotekë dhe një muze të vogël ”.<sup>579</sup>

Lef Nosi u zgjodh nënkryetar i Pleqësisë së Qarkut Letrar, i kryesuar nga Aleksandër Xhuvani, si dhe anëtar i Komissisë Letrare. Mjaft i rëndësishëm mendojmë se ka qenë roli i Lef Nosit edhe në botimin e revistës “Kopështi Letrar” e cila filloi të dalë në qarkullim në fund të verës së 1918-ës dhe do të vazhdojë të botohet deri në korrik të vitit 1919, kur Lefi, i zgjedhur anëtar në delegacionin shqiptar në Konferencën e Paqes, niset drejt Parisit. I njohur si mbledhës i antikave dhe materialeve të tjera arkeologjike, grumbullues i materialit arkivor, folklorist e etnograf, ai sëbashku me Filip Papajanin, drejtuan punët për mbledhjen e materialit historik, arkeologjik, artistik etj., i cili do të shërbente për ngritjen e muzeut. “*Qarku letrarë i lutet gjithë atyne zotënive – do të shkruhej në njoftimin e botuar në faqet e “Kopështit Letrar”, - qi kanë në dorë gjana me vleftë historike, arkeologjike, artistike etj, edhe kanë dëshirë me ia falë muzeumit qi do të formohet ti a dorëzojnë ose ti a dërgojnë kujdestarvet të muzeumit Z. z. Lef Nosi e Filip Papajani*”.<sup>580</sup> U desh një punë e gjatë disavjeçare që ky muze të hapet vetëm në vitin 1935, në katin e sipërm të bibliotekës popullore të Elbasanit e cila ishte ngritur në ndërtesën e familjes Baholli.<sup>581</sup>

Gjatë periudhës gusht 1918 - korrik 1919 dolën në qarkullim dymbëdhjetë numra të “Kopështit Letrar”, në të cilat u botuan shkrime të karakterit patriotik, të natyrës shkencore- popullore, materiale nga trashëgimia letrare e Kostandin Kristoforidhit, Dhaskal Todrit si edhe këngë popullore, legjenda, biografi etj.<sup>582</sup> Sikurse edhe paraardhësit e tij edhe L. Nosi synonte që përmes botimit në këtë revistë të pjesëve të ndryshme të kulturës shpirtërore e materiale të paraqiste konceptin e identitetit etnik dhe kombëtar shqiptar duke iu kundërvënë përçarjes së popullit në rajone të ndryshme dhe mënyrës tepër të shtrirë të ngulimeve që ishin të përhapura në shtete të tjera kombëtare.<sup>583</sup> Në funksion të realizimit të qëllimit të “Qarkut Letrar” mbi botimin e librave shqip, pothuajse në të gjitha numrat e saj revista “Kopështi Letrar” njoftonte rreth botimeve të shtypshkronjës “Elbasani” ndër të cilat përmendim: “Librin e gjuhës” për shkollat fillore të A. Xhuvanit, Abetaren me dialektin e Elbasanit<sup>584</sup> dhe “Këndimin për shkollat fillore çunash e cucash” të Dh. Paparistos,<sup>585</sup> dhe shumë botime të tjera. Midis artikujve të botuar në të përkohshmen letrare, spikasin shkrimet e Lef Nosit mbi jetën dhe veprën e Theodhor Haxhi Filipit, botimi i plotë i liturgjisë së Shën-Gjon Gojartit si “*e vetmja shenjë e veprës së Todhrit, qi muji me u ruajtun gjer më sot e plotë... sepse copa të tjera përkthimesh, qi kemi ndër durë, përveç qi janë të paka, por edhe janë të trazuese me përkthime të*

<sup>579</sup> “Kopështi Letrar”, Elbasan, gusht 1918

<sup>580</sup> Po aty, nëntor 1918, nr. 4

<sup>581</sup> AQSH, F. 32, D. 39, f. 1

<sup>582</sup> *Elbasani- Enciklopedi*, Elbasan, 2003, fq. 305

<sup>583</sup> Sipas të dhënave të etnologut Kujtim Bevapi, tek “Antropologjia dhe etnologjia”, ide të mbrojtura edhe nga Stephanie Schëandner-Sievers, “Rreth sfidave ndërkombëtare të etnologjisë shqiptare...”, Tiranë, 2012, fq. 226: këto kishin qenë edhe synimet e punës së Kristoforidhit i cili iu përkushtua jo vetëm studimeve gjuhësore por edhe përshkrimit etnografik të traditave dhe zakoneve, të kulturës materiale dhe prejardhjes etnike të shqiptarëve.”

<sup>584</sup> “Kopështi Letrar”, Elbasan, viti i I, shëndre 1918, nr. 5

<sup>585</sup> Po aty, qershor-korrik 1919, nr. 11-12

*tjera bamun prej priftënish të paditun*".<sup>586</sup> Si mbledhës e gjurmues i folklorit shqiptar ai do të botojë në faqet e "Kopështit Letrar" proverba e pjesë të gojëdhënave popullore mbi luftërat e Skënderbeut, luftërat në Mëlizë e në Sopot dhe do të paraqesë të plotë "*Kankën e luftës qi u ba në Fushë-Kosovë në 1389*", mes rreshtave të së cilës shkëpusim vargjet: *...Gjak i madh aty konka derdhun / vet sulltani rrugën e kish marrun / Për Kaçanik besa për me shkumun / Kaçanikit besa tuj'afumun / Kaçanikit pushkën ja kish nisun / dhe kish luftu tri dit e net / Kaçanikin besa s'un p'e bajke fet / edh aty shum shehit i paskan metun*.<sup>587</sup> Përveç materialeve që panë dritën e botimit në faqet e "Kopështit Letrar", Lef Nosi kishte shkruar e grumbulluar ndër vite edhe shumë e shumë dokumenta e shënime të tjera, dëshmi e të cilave është edhe fondi i gjerë i këtyre materialeve të arkivuara në Arkivin Shtetëror Shqiptar ku vlen të përmenden fraza popullore e gojëdhëna të shkruara prej tij për qëllime studimore si edhe shënime gramatikore të mbledhura nga krahina të ndryshme.<sup>588</sup> Gjithashtu ai kishte grumbulluar edhe materiale mbi historikun e disa familjeve bejlerësh në vend, si Taushant, Biçakçinjtë, Vërlacët, Karaosmanët, Allajbejtë etj,<sup>589</sup> të dhëna për njerëz të shquar si Ali pashë Tepelena, Bushatllinjtë, Zogollajt etj,<sup>590</sup> biografi të disa patriotëve shqiptar si Ali Çaushtit, Hamdi Ohrit, Sadik Zharrit, Xhile Liçit etj,<sup>591</sup> si edhe mjaft të dhëna të karakterit gjuhësor e gramatikor, një pjesë e të cilit u pasqyrua në dymbëdhjetë numrat e "Kopështit Letrar".

Në faqet e kësaj reviste u dha lajmi edhe për formimin në Elbasan, në 10 qershor 1918, të një grupi teatror i cili në 4 gusht "muer titullin Shoqëria Theatre e Elbasanit" që drejtohej nga një Pleqësi me kryetar Thanas Floqin dhe që më vonë u mbështet edhe nga një Pleqësi tjetër ndihmëse, e kryesuar nga Ahmet Dakli, "e cila do të merret me financat e tjera punë të jashtme të shoqënisë". Propagandimi, nga "Kopështi Letrar", i punës së kësaj shoqërie e cila arriti të vërë në skenë disa herë dramën "Besa" të Sami Frashërit, dy komeditë "Dhandër me Përdhunë" dhe "E bija e banqerit" të Kristo Floqit dhe shumë pjesë të tjera të autorëve shqiptarë e të huaj, nuk përbënte një akt të thjeshtë përmbushje të veprimtarisë së kësaj shoqërie, por ishte një zë i fortë i kësaj reviste dhe i drejtuesve të saj, mes të cilëve edhe L. Nosi, në mbështetje të qëllimit të saj. "*Kopështi Letrar i uron kësaj shoqërie të dobishme një zhvillim të mbarë, për me e kryemun plotësisht qëllimin e naltë, qi asht tyke ndjekun për përparim t'atdheut*".<sup>592</sup>

Por ndërkohë Austro-Hungaria nuk dukej e sigurt në ndjekjen e një boshti të qartë politik ndaj shqiptarëve dhe kjo pavendosmëri çoi në përpjekje të dështuara për të dhënë një zgjidhje. Teksa sapo ishin bërë publike projektet e Italisë, në kuadër të Traktatit të Fshehtë të Londrës, për copëtimin e tokave shqiptare dhe dominimin e saj në atë pjesë që mbetej nga Shqipëria e 1913-ës, një tjetër plan, i cili nuk

<sup>586</sup> "Kopështi Letrar", Elbasan, janar 1919

<sup>587</sup> Po aty, shkurt 1919

<sup>588</sup> AQSH, F. 32, D. 33

<sup>589</sup> Po aty, D. 47

<sup>590</sup> Po aty, D. 48

<sup>591</sup> Po aty, D. 50

<sup>592</sup> "Kopështi Letrar", Elbasan, gusht 1918



merrte aspak parasysh dëshirën e popullsisë vendase e aq më pak ndjenjat nacionaliste të tyre, do të përpiqet të marrë jetë në fillim të vitit 1918. Në Dibër, Hasan Basriu, shpall formimin e një qeverie të përkohshme me synimin e vendosjes në fron të princ Cirilit të Bullgarisë. Ky projekt dhe propozimet e bëra nga ministri bullgar në Berlin, Dr. Rizovi, për ndarjen e copëtimit të Shqipërisë ndërmjet shteteve të Ballkanit, shkaktoi zemërimin e popullit të Elbasanit, Peqinit, Kavajës, Gramshit, Tiranës e Durrësit të cilët në mbledhjen e organizuar në Durrës më 26 shkurt 1918, hartuan një notë proteste drejtuar qeverisë së Monarkisë Austro-Hungareze në të cilën shpreheshin se: “Protestojmë kundër çdo mendimi e dëshire që ka për qëllim copëtimin e Shqipërisë edhe shkeljen e të drejtës së saj shtetnore, të njoftun prej Konferencës së Londrës më 1912.”<sup>593</sup>. Në këtë mbledhje L. Nosi, bashkë me A. Daklin e T. Malëziun,<sup>594</sup> si delegatë të Elbasanit, dhe të gjithë përfaqësuesit e qyteteve të tjera pjesëmarrëse deklaruan se turbullirat e përgatitura nga intrigat e huaja, që çuan në “*largimin e përkohshëm të mbretit tonë Vilhelmit I, që u njoh nga Fuqitë e Mëdha dhe u miratua nga shqiptarët*”<sup>595</sup> nuk mund të shfrytëzohen si argumente në favor të ndarjes dhe njëkohësisht kërkuar të ripohohet ndërkombëtarisht vendimi i 29 korrikut të 1913-ës që shpall pavarësinë e shtetit shqiptar. “Kombi shqiptar ka shpresë të madhe se: - shkruhej në protestën e delegatëve shqiptarë në Durrës, - Monarkia e fuqishme e Austro-Hungarisë, q’i u ka gjindun projtës Shqipërisë në kohë të çdo rreziku, jo vetëm që do të përpiqet të kthejë prap në Shqipëri trajtën e Qeverrimit që u vendos në Konferencë të Londrës, por edhe do të mundohet t’i apë Shtetit Shqiptar kufit e natyrshëm duke bashkuar me të edhe gjithë viset e Shqipërisë që padrejtësisht Konferenca e Berlinit edhe ajo e Londrës ia lëshuan shteteve fqinj. Sepse njerëzit e atyne viseve, me kryengritje e kundërshtime të përgjakshme e kundërshtuan padrejtësinë që qe bërë, edhe kërkuar bashkimin e tyre me Shqipërinë.”<sup>596</sup>

Menjëherë pas kësaj deklarate Lef Nosi, bashkë me Ahmet Daklin dhe Tajar Malasin, në mars të vitit 1918, do të shkojnë në Shkodër për t’u kërkuar autoriteteve austro-hungareze të atjeshme që të pranojnë kthimin e princ Vidit në Shqipëri.<sup>597</sup> Por situata mbeti e pandryshuar. Gjatë pushtimit austro-hungarez, për shkak të qëndrimit të tij lidhur me asnjësinë e Shqipërisë, kthimi i Vidit nuk gjeti mbështetje.

Ndonëse vala e zhvillimeve ndërkombëtare godiste Shqipërinë, duke e kthyer atë në arenë luftimesh, Lef Nosi jo vetëm vazhdoi aktivitetin e tij politik por edhe nuk e ndali asnjë çast punën e tij studimore, duke grumbulluar dhe regjistruar materiale dokumentare me mjaft vlerë, të cilat nëse nuk do të ishin mbledhur prej tij, në atë kohë, një pjesë e mirë e tyre do të kishin humbur, sikurse ka ndodhur edhe me dokumente të tjera të periudhave të ndryshme historike. Në vitet 1916-1917, në Shqipëri nuk pati asgjë përveç ndeshjeve sporadike mes austro-hungarezëve dhe italianëve. Ndërkohë Austro-Hungaria gradualisht humbi pikë në

<sup>593</sup> Verli, M & Duka, F. *Dokumenta Historike...*, Tiranë, 2007, fq. 269

<sup>594</sup> Bëhet fjalë për Tajar Malasin, për të cilin Lef Nosi në shënimet e tij përdor mbiemrin Malëziu

<sup>595</sup> Swire, Joseph. *Shqipëria...*, Tiranë, 2005, fq. 218

<sup>596</sup> Verli, M & Duka, F. *Dokumenta Historike...*, Tiranë, 2007, fq. 269

<sup>597</sup> *Elbasani-Enciklopedi*, Elbasan, 2003, fq. 319

shkallën e besimit të shqiptarëve ndaj saj. Në këtë drejtim ndikuan sa faktorët e brendshëm ashtu edhe ata të jashtëm. Ndonëse autoritetet austriake kishin lejuar të valëvitej flamuri kombëtar, administrimi lokal të kryhej nga zyrtarë shqiptarë, të hapeshin shkolla shqipe e të bëheshin mjaft ndërtime, vendimi i prillit të 1916-ës, që urdhëronte dorëzimin e të gjitha armëve, shkaktoi pakënaqësinë e shqiptarëve. Për më tepër, pagesa me kartmonedha i furnizimeve të rekuizuara, gjatë 1918-ës, nxiti kundërshtimin e popullsisë vendase. Është e kuptueshme se nën goditjen e kësaj politike monetare do të bjerë edhe ekonomia tregtare e familjes së Nosëve në Elbasan.

Por gjatë viteve të konfliktit botëror, kur Shqipëria e pushtuar nga trupat austriake, greke, italiane, franceze e serbo-malazeze më shumë se një shteti i ngjante një arene të egër luftimesh dhe plaçkitjesh e ku fati i vendit u caktua sa nga rrjedha e luftës aq edhe nga fuqitë e interesuara të kohës, shumë udhëheqës politikë e shpirtërorë të pavarësisë u detyruan të largohen nga vendi.<sup>598</sup>

Në këto kushte, në verën e 1918-ës, Lef Nosi do të largohet në Itali. Pavarësisht dëmeve të mëdha që kishte sjellë lufta për familjen tregtare të Nosëve përmes izolimit, taksave të shumta apo zhvlerësimit drastik të monedhës austriake, vështirësitë ekonomike nuk ishin faktori i vetëm që e orientuan atë në drejtim të fqinjit perëndimor. Mjaft i fuqishëm ishte edhe impulsi politik që e nxiti L. Nosi ta zhvendosë tashmë e luftës së tij politike jashtë Shqipërisë. Ndryshe nga viti 1912 kur, teksa patriotët shqiptarë shpallnin pavarësinë e vendit, Shqipëria ishte ende e pushtuar nga ushtritë turke të cilat e kishin humbur luftën, në vitin 1918 territori shqiptar ishte i pushtuar nga trupat e fuqive fituese të Luftës së Parë Botërore të cilat do të kërkonin të shpërbleheshin për kontributin e dhënë. Lufta kishte nxjerrë nga skena politike ndërkombëtare edhe Austro-Hungarinë e cila, në 1912-ën, kishte qenë avokatja e çështjes shqiptare në tryezën diplomatike evropiane. E ndërsa Esat Pasha në Selanik, me ndihmën e aleatëve të Antantës në Ballkan, synonte të risillte në pushtet “qeverinë” e tij në mërgim, diplomatët shqiptar, në kushtet kur opinioni publik vendas ishte mjaft i përçarë e kur në vend mungonte një qendër politike kombëtare, u përpoqën ta mbështesin boshtin e politikës shqiptare në politikën elastike të Romës. Ky qëndrim ishte nxitur edhe nga fakti se futja e SHBA-së në luftë, në krah të Antantës, kishte zbutur disi rrezikun e zbatimit të Traktatit të Fshehtë të Londrës, e shprehur kjo në deklaratën e presidentit amerikan, Wilson, se “*asnjë komb të mos kërkojë ta shtrijë mënyrën e tij të qeverisjes mbi një komb apo popull tjetër*”.<sup>599</sup>

Nga Italia, Lef Nosi bashkë me personalitete të tjera shqiptare, si Mehdi Frashërin e Mustafa Krujën, ndjek me vëmendje zhvillimin e ngjarjeve në Shqipëri, ku vendin e trupave austro-hungareze e bullgare po e zinin forcat italiane e serbe. Për ato ditë shtatori të 1918-ës, Mehdi Frashëri do të shkruajë në “Kujtimet” e tij: “*Kjo periudhë pritjeje për ne (M. Frashëri, L. Nosi, M. Kruja e shokë të tjerë- E.A) ishte plot shpresë e plot dëshpërim pasi nuk dihej se si do të zgjidhej çështja shqiptare... Por ne, nga dy të këqijat, pranë m*

<sup>598</sup> Hysi, Gramoz. *Organizimi i shtetit shqiptar e lufta politike rreth tij në 1920-’24*, Tiranë, 1988, fq. 149

<sup>599</sup> Swire, Joseph. *Shqipëria...*, Tiranë, 2005, fq. 219

të lehtë, duke parapëlqyer okupacionin italian mbi atë të serbëve, prandaj u jepmim guxim italianëve që, me t'u hequn ushtria austriake, të shpejtonin të zinin vendet para serbëve”.<sup>600</sup> Sikurse edhe tek shumë shqiptarë të tjerë, prania e trupave serbe ngjallte edhe në kujtesën e Lef Nosit dhimbjen dhe revoltën ndaj dhunës e mizorive serbe mbi popullsinë e pafajshme shqiptare të vitit 1913 e më pas. Si politikan, por edhe si njohës e studiues i historisë së trojeve e popullit shqiptar, për Lef Nosit ishte mjaft e njohur ëndërra historike e Cetinjës për zgjerimin e kufijve jugorë të saj në kurriz të tokave shqiptare. Në të njëjtën kohë edhe një tjetër e keqe parashihej tek okupacioni serb, që kishte të bënte me mbështetjen që ata i kishin dhënë Esat Pashë Toptanit dhe përkrahësve të tij. Ndaj ekzistonte dyshimi se përparimi i serbëve do t'u jepte mundësi njerëzve të Esatit të formonin një qeveri e të fillonin përsëri, si në vitin 1915, përndjekjen ndaj popullsisë e nacionalistëve të tjerë shqiptarë.

Gjatë kohës së qëndrimit të tij në Itali, Lef Nosi iu ndodh pranë patriotit, bashkëluftëtarit në kryengritjen e përgjithshme të 1912-ës dhe nacionalistit antiesadist, Ali Agjahut i cili, që prej 1914-ës ishte larguar në Itali për t'i shpëtuar dhunës që kishte shpërthyer në vend. Tashmë i sëmurë rëndë, po jetonte momentet e fundit të jetës së tij. “I ndjeri Ali Agjah Elbasani ishte i internuem n'Itali për shkaqe politike prej Qeveris s'Esat Toptanit tue mos mundun me ardhe në Shqipni ma tepër edhe prej luftës së përgjithshme të vazhdueme n'atë kohë dhe nga sëmundja e tmerrshme, tue pamë se jetën e kishte në rezikë, për të treguem një shembëll të paharruem Atdhetarije, me dishirën e tij të plotë gjithë pronat e tokat i a ka falun Arësimit kombtar me një testament të redaktuem para Notarit në Romë...”<sup>601</sup> Lef Nosi do të jetë i pranishëm gjatë hartimit të testamentit të Ali Agjahut në Romë, më 7 qershor 1918 dhe anëtar i komisionit të këtij testamenti i përbërë nga bashkëqytetarë të tij: Aqif Pashë Elbasani (Biçaku), Lef Nosi, Hysen Dakli, Taq Buda, Halim Bej Elbasani e Emin Haxhiademi. Falë përpjekjeve të anëtarëve të këtij komisioni u arrit që në vitin 1937 të sigurohej prej testamentit shuma e nevojshme për ngritjen e një ndërtese shkollore femërore në sheshin e Namazgjasë që mori emrin e A. Agjahut.<sup>602</sup> Qëndrimi i Lef Nosit në Itali do të përfundojë sapo trupat austro-hungareze të largohen nga Elbasani (tetor 1918). Në këtë kohë ai siguron lejen nga qeveria italiane për t'u kthyer në atdhe. Bashkë me shqiptarë të tjerë, ai nisët nga Taranto me një kryqëzor luftarak për në drejtim të Vlorës e prej këtej për në Elbasan.<sup>603</sup>

Prej shtatorit ushtritë austriake kishin filluar të tërhiqeshin drejt veriut. Nga kjo tërheqje kishin përfituar trupat italiane, të cilat e shtrinë pushtimin në të gjithë Shqipërinë e Mesme dhe në një pjesë të madhe të asaj veriore. Ndërsa francezët, duke përparuar në drejtim të verilindjes, ua kishin dorëzuar viset shqiptare trupave serbe. Në 11 nëntor 1918 Lufta e Madhe përfundoi.

<sup>600</sup> Frashëri, Mehdi. *Kujtime...*, Tiranë, 2005, fq. 49-50

<sup>601</sup> “Fletorja zyrtare”, Tiranë, 5 Nanduer 1922, f. 1

<sup>602</sup> *Elbasani-Enciklopedi*, Elbasan 2003, fq. 6

<sup>603</sup> Frashëri, Mehdi. *Kujtime...*, Tiranë, 2005, fq. 51

## KREU IV. POZICONIMI I LEF NOSIT NË JETËN POLITIKE TË VENDIT GJATË VITEVE 1920-1924

### IV-1 Lef Nosi në Kongresin e Durrësit dhe në Konferencën e Paqes në Paris

Me mbarimin e Luftës së Parë Botërore situata në Shqipëri nuk i përgjigjej gjendjes së saj ndërkombëtare të caktuar në 1913-ën, në Konferencën e Ambasadorëve në Londër. Me mijëra ishin viktimat që shkaktoi lufta në radhët e popullsisë shqiptare si rrjedhojë e operacioneve ushtarake të fuqive ndërluftuese e të epidemive që shpërthyen në radhët e vendasve të mbërthyer nga mjerimi. Ndërsa popujt e botës festonin paqen, për popullin shqiptar do të vazhdojë kalvari i mundimeve tashmë në përpjekje për t'u rinjohur nga Fuqitë e Mëdha në gjirin e shteteve europiane. Pjesa më e madhe e territorit të saj ishte nën kontrollin e trupave italiane, francezët mbanin të pushtuar krahinën e Korçës, forcat serbe ishin rreshtuar përgjatë “vijës strategjike”, kurse në Shkodër u rivendos administrimi ndërkombëtar i drejtuar nga koloneli francez Dë Furtu (De Fourthou). Në këto kushte vendi, i zhytur në një kaos të vërtetë dhe në një mjerim të thellë, u ndodh edhe një herë tjetër në udhëkryqet e historisë.

Në prag të mbarimit të Luftës së Parë Botërore, më 20 tetor 1918, Elbasani zbrazet prej trupave të ushtrisë austro-hungareze të cilat do t'ia lënë vendin ardhjes së forcave italiane e atyre franceze. Të parët që mbërritën ishin trupat italiane të cilat ngritën flamurin e tyre në periferinë lindore të Elbasanit. Ndërsa francezët i vendosën garnizonet e tyre jashtë qytetit ku hynin e dilnin vetëm për të bërë blerje të ndryshme. Më pas forcat franceze u tërhoqën drejt verilindjes duke ia lënë të gjithë prefekturën e Elbasanit ushtrive italiane. Mbërritja e italianëve në qytet solli për pasojë edhe rikthimin e Shefqet Vërlacit i cili ishte larguar nga Elbasani që prej trazirave të 1914-ës në Shqipërinë e Mesme.<sup>604</sup>

---

<sup>604</sup> AME, Kutia nr. VII, Dosja 22, dok. 6, f. 1

Kjo ishte Shqipëria e 1918-ës, e okupuar në çdo kënd, ku nuk kishte asnjë shenjë vetëqeverimi dhe asnjë qeveri të sajën që të mund të përfaqësohej para fuqive fituese e të kërkonte të drejtat e saj jetike. Situatës së rëndë politike tashmë, me përfundimin e konfliktit botëror, i peshonin rreziqet e reja që u shfaqën jo vetëm për mbrojtjen e kufijve të Shqipërisë, por edhe për rimëkëmbjen e pavarësisë së saj politike. Zhvillimi i lojës diplomatike në arenën ndërkombëtare riaktivizoi qarqet patriotike shqiptare, brenda e jashtë vendit, për të cilat ishin të njohura planet dhe projektet e hartuara gjatë luftës e që prisnin të realizoheshin në Konferencën e Paqes. E ekspozuar përballë rreziqeve reale, Shqipëria kishte nevojë për një qeveri përfaqësuese, të dalë nga një asamble kombëtare, e cila do të bashkonte forcat politike për mbrojtjen e të drejtave kombëtare të popullit shqiptar dhe njëkohësisht do kishte të drejtën të përfaqësonte vendin në Konferencën e Paqes në Paris. Ndërkohë italianët, me përfundimin e Luftës, të ndodhur para rrezikut të rritjes së ndikimit jugosllav në Shqipëri, menduan të mbështesnin aspiratat e forcave nacionaliste dhe patriotike shqiptare për t'u vetorganizuar në një qeverisje që do të mbronte interesat e vendit. Madje qeveria italiane bëri përpjekje për t'u vendosur në kontakt me shqiptarë me ndikim dhe njëkohësisht përfaqësues, me qëllim të konsolidimit të opinionit publik në të mirë të protektoratit italian.<sup>605</sup> Duke gëzuar “mbështetjen” e Italisë, meqë ajo dëshironte të ringrinte Shqipërinë – nën kontrollin e saj – brenda kufijve sa më të gjerë që të ishte e mundur,<sup>606</sup> lëvizja kombëtare shtroi kërkesën e organizimit të një mbledhje me përfaqësues të krahinave të ndryshme shqiptare. Pas shumë hezitimesh dhe porosish të dhëna nga Roma, u arrit që, më 25 dhjetor 1918, të mbledhet Kongresi Kombëtar në Durrës. Ndërsa në dokumentacionin zyrtar rezultojë pjesëmarrës në kongres mbi 50 delegatë,<sup>607</sup> sipas të telegramit të komandantit të forcave italiane në Ballkan, Setimo Piacentinit, në të morën pjesë rreth 60 delegatë nga krahina të ndryshme të vendit,<sup>608</sup> në të cilin Elbasani u përfaqësua nga Lef Nosi, Shefqet Vërlaci e Ahmet Dakli.<sup>609</sup> Jo vetëm pjesëmarrës në këtë kongres, L. Nosi, i vetëdijshëm për rëndësinë historike të kësaj ndërmarrje politike të forcave patriotike shqiptare, ruan dhe grumbullon të gjithë dokumentin zyrtar të kongresit, punime, fjalime, propozimet e qëndrimet që u vunë re gjatë zhvillimit të mbledhjes në Durrës, materiale të cilat do të shohin dritën e botimit pak vite më vonë. Pjesëmarrjen në këtë kongres të L. Nosit dhe njëkohësisht edhe kujdesin e tij për të arkivuar të gjithë dokumentacionin zyrtar gjatë punimeve të kongresit, e shohim të lidhur ngushtë edhe me opinionin politik të disa forcave patriotike në vend, në veçanti në Elbasan, që lidhet me qëndrimin e një numri nacionalistësh shqiptar ndaj Princ Vilhelm Vidit, të cilin vazhdonin ta njihnin si sovranin e ligjshëm të shtetit shqiptar të pranuar ndërkombëtarisht në korrik të 1913-ës nga Fuqitë e Mëdha. Ky qëndrim si edhe

<sup>605</sup> Gurakuqi, Romeo. *Shqipëria e çështja shqiptare pas Luftës së Parë Botërore*, Shkodër, 2007, fq. 18-19

<sup>606</sup> Swire, Joseph. *Shqipëria...*, Tiranë, 2005, fq. 233

<sup>607</sup> *Historia e popullit shqiptar*, vëll. III, fq. 127

<sup>608</sup> *Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920*, I, Tiranë, 1975, fq. 71. Telegram i komandantit të forcave italiane në Ballkan, S. Piacentinit, dërguar ministrit të Punëve të Jashtme të Italisë, S. Sonino. Ndërkohë burime të tjera tregojnë se në Kongresin e Durrësit morën pjesë 50 delegatë nga thuajse e gjithë Shqipëria politike.- Duka Valentina. *Çështje të histories bashkëkohore të shqiptarëve*, Tiranë, 2003, fq. 140

<sup>609</sup> *Dokumenta historike 1912-1918*, Tiranë, 2007, fq. 289

mosbesimi ndaj italianëve të cilët dikur, për qëllimet e veta kishin dalë kundër qeverisë shqiptare në kohën e princ Vedit, duke mbështetur Esat Pashë Toptanin, kishte bërë që Aqif Pashë Biçakçiu,<sup>610</sup> miku, bashkëudhëtari në rrugën e nacionalizmit shqiptar dhe përkrahës i idealeve të përbashkëta politike me L. Nosit, nuk pranoi të marrë pjesë në këtë kongres. Por sikurse kishin vepruar edhe më parë, përveç Shefqet Vërlacit, nga Elbasani për në Durrës do të nisen edhe Lef Nosi e Ahmet Dakli, të cilët mesa duket morën përsipër të kufizojnë ndikimin në kongres të Vërlacit i cili, edhe më parë, kishte shfaqur qëndrime pro politikës italiane në vend. Madje dokumente në arkivin e muzeut të Elbasanit që mbajnë firmën e Shyqyri Demirit e cilësojnë Sh. Vërlacin si agjent të italianëve “me mbështetjen e të cilëve ai kishte mundur të shtinte në dorë administrimin e katundarisë (bashkisë) së Elbasanit”.<sup>611</sup>

Teksa mbledhja në Durrës nisi punimet pasdrekën e 25 dhjetorit, një pjesë e delegatëve pjesëmarrës, mes të cilëve edhe L. Nosi do të hartojnë një deklaratë e cila do të lexohet në formën e urdhërit të ditës, deklaratë e cila përshkohet nga fryma e gëzimit, nga njëra anë, “...tue pamë se Kombi i ynë mbririni sot me anën e përfaqësuesave të vet t’i dalë zot me të tana mënyrat të drejtave të pa humbëshme të Shqiptaris...”<sup>612</sup> dhe nga ana tjetër shprehet keqardhja mbi pamundësinë e pjesëmarrjes në këtë mbledhje kombëtare të përfaqësuesve të Peshkopisë, Lumës, Starovës, Korçës, Himarës e Vlorës “qi janë pjesë e padame e Shqipnis, e uron qi në të parën rasë qi mund të çfaqet për një mbledhje të përgjithshme kombtare, të mos mbetet asnjë pjesë e Atdheut t’onë të dashun pa u përfaësue”<sup>613</sup> Me entuziazmin për këtë iniciativë të shqiptarëve, Lef Nosi si delegat i Elbasanit “uron qi kjo mbledhje kombtare të japi pemë të mira për t’ardhmen e Shqipnis”<sup>614</sup>.

Kur u mbledh Asambleja, italianët ngulnin këmbë që të mos formohej një qeveri por të zgjidhej një “këshill kombëtar”, i cili do të kishte si mandat të vetëm të shprehte dëshirat e popullit shqiptar për të gjitha çështjet që do të shtroheshin në Konferencën e Paqes lidhur me Shqipërinë. Por vendimet e Kongresit rezultuan të ndryshme nga kërkesa italiane. “Delegatët e të gjithë viseve të Shqipniës të mbledhun në qytet të Durrësit, në Mbledhje Kombëtare të Përgjithshme: Tye pasun besim të plotë mbi dritimet e bamuna prej Qeverrivet të Mëdha të Marrëveshjes, mbi mbrojtjen e të drejtave të kombeve të vegjël;...Tye u themeluem sidomos mbi vendimin e Konferencës së Londrës 1912-1913 qi njohu e proklamoi një Shqipnië të lirë e të pa-varme me formën shtatore të caktueme prej saj;... vendojnë me zana të plota themelimin e një Qeverrie të Përkohshme për me u bamun ballë nevojave të sotme t’Atdheut.”<sup>615</sup> Formimi i qeverisë së përkohshme, sukses ky i krahut mbështetës të shtetit të pavarur shqiptar gjatë punimeve të kongresit, ishte rrjedhojë e

<sup>610</sup> Gurakuqi, Romeo. *Shqipëria e çështja shqiptare...*, Shkodër, 2007, fq. 26

<sup>611</sup> AME, Kutia nr. VII, Dosja 22, Dokumenti 6, fl. 11. Shyqyri Demiri, 4/6/1974

<sup>612</sup> Revista “Hylli i Dritës”, maj 1944, Shkodër, nr. 5, fq. 56

<sup>613</sup> Po aty, fq. 56. Ky dokument është i nëshkruar nga Qazim Bej Elbasani, Ismail Kadiu, M. Xhavit, Muharrem Pengili, Lef Nosi, Mustafa Asim Kruja, Qerim Bej Begolli, Ndrek Çoba, Ahmet Dakli, Sotir Peci, Ymer Del Alliu, Luigj Gurakuqi, Xhemal Belegu, Dr. Syreja Pojani, Abas Kupi, Riza Dani, Rexhep Jella, H. Zogolli e A. Çela.

<sup>614</sup> Po aty

<sup>615</sup> Nosi, Lef. *Dokumenta historike...*, Instituti i Historisë, Tiranë. 2007, fq. 291-292



nevojës për t'u përballur me rreziqet që i kanoseshin çështjes shqiptare në mbarim të Luftës së Parë Botërore, si në planin e brendshëm ashtu dhe atë të jashtëm. Mungesa e një qendre të brendshme organizative që përfaqësonte të gjithë shqiptarët, në formën e një qeverie, bënte që përfaqësimi i shqiptarëve në Konferencën e Paqes t'i kalonte automatikisht Esad Pashës i cili e kishte shpallur vehten, kryetar të qeverisë shqiptare, e cila ishte larguar nga Shqipëria në vitin 1916, ishte vendosur në Selanik<sup>616</sup> dhe kishte tashmë edhe mbështetjen e Francës. Vetëm si përfaqësues të një qeverie kombëtare, delegatët shqiptarë do të mund të paraqiteshin në Konferencën e Parisit për të mbrojtur të drejtat e shtetit shqiptar të shpallur e të njohur si i pavarur në Konferencën e Londrës së viteve 1912-1913.

Në qeverinë e Turhan Pashës, të dalë nga ky kongres, Lef Nosi u zgjodh të drejtojë Ministrinë e Ushqimit dhe të Ekonomisë,<sup>617</sup> duke i besuar kështu një nga fushat më problematike por edhe më të rëndësishme për Shqipërinë e shkatërruar nga lufta e të mjeruar nga pikëpamja ekonomike. Sikurse më 1912-ën, në Qeverinë e Vlorës, edhe tashmë ai do t'i përkushtohet detyrës së re në qeverinë e Durrësit e cila në programin e saj shpallte këto dy pika: a). Mbajtjen e qetësisë dhe të rendit si edhe riorganizimin e degëve të ndryshme të administratës brenda vendit; b). Mbrojtjen jashtë shtetit të pavarësisë dhe të tërësisë tokësore të Shqipërisë dhe të drejtave sovraane të popullit shqiptar brenda kufijve etnikë.<sup>618</sup> Në këto kushte në themel të veprimtarisë të L.Nosit, në krye të Ministrisë së Ushqimit dhe Ekonomisë, qëndronte marrja e masave imediate për kapërcimin e situatës së rëndë në të cilën ndodhej vendi. Mirëpo përpjekjet për ndryshim u përballën me një realitet aspak të lehtë që karakterizohej nga struktura të dobëta ekonomike, sociale e politike të cilat vazhdonin t'i bënin rezistencë ideve të reja reformatore.

Veç aktivitetit politik, Lef Nosi nuk e reshti punën e tij hulumtuese në fushën e historisë edhe gjatë kohëve të vështira që Shqipëria kaloi në Luftën e Parë Botërore. Materialet që ai grumbulloi e që do t'i botojë disa vite më vonë tek "Dokumenta Historike në mbrojtje të çështjes kombëtare", në vitin 1924, nuk janë vetëm dëshmi të ngjarjeve apo kronikave historike të kohës, por ato përbëjnë një kontribut të vyer në fushën e historiografisë shqiptare. Në skedarët historikë që ai krijoi gjejmë të prezantuara edhe punimet e Kongresit të Durrësit dhe qëndrimet që janë mbajtur gjatë tij. Kështu në mbledhjen e Asamblesë u lexua edhe letra e dërguar nga Aqif pashë Elbasani, i cili këmbëngulte në mbrojtjen e indipendencës shqiptare të pranuar ndërkombëtarisht në vitin 1913: "Ai vendim as nuk asht prishun, as nuk asht vjettrue aq tepër saqë të mos zihet në gojësot ...të kërkohet Shqipnia me fomën e vendue me në Konferencën e Londrës, tue u ndreqë gabimet o padrejtësitë që u banë atëherë në caktimin e kufijve ...duhet përpjekë që të ruhet status quo- ja e Shqipnisë në kohën e mbretit (V. Vidit-E.A) edhe gjithë kërkimet të mbështeten mbi këtë bazë".<sup>619</sup> Por përfshirja e Vidit në ushtrinë gjermane gjatë luftës, duke u renditur në rradhën e fuqive humbëse,

<sup>616</sup> Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar, 1918-1920, Tiranë, 1975, fq. 68

<sup>617</sup> AQSH, F. 32, D. 12, f. 2

<sup>618</sup> Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar, 1918-1920, Tiranë, 1975, fq. 107

<sup>619</sup> IH, Verli. M & Duka. F, Dokumenta historike në mbrojtje të çështjes kombëtare, 1924. Lef Nosi, Tiranë, 2007, fq. 91-92

vështirësonte madje e bënte të pamundur kthimin e tij në Shqipëri. Ndaj edhe qëllimi kryesor i qeverisë së re ishte “të mbrojtunit e të drejtave të kombit shqiptar plotësisht e kudo që ndodhet; kërkimi i kufijve kombëtar; mëvehtësi e plotë e shtetit shqiptar”.<sup>620</sup> Për realizimin e politikës së jashtme të qeverisë, në kongres u parashikua dërgimi i një delegacioni në konferencën e ardhshme të paqes, për të përfaqësuar aty interesat shqiptare, të cilat aktualisht po prezantoheshin keq nga Esat Pasha dhe “ministrat” e tij. “Nga këta pjesëtarë (të qeverisë së Durrësit – E.A) disa do të dalin përjashta nën Kryesin e Turhan Pashës për të mprojtun të drejtat e Shqipnis ethnografike në Konferencën e paqës e të tjerët do të mbeten për veprim përbrendam”<sup>621</sup> Ndërsa delegacioni i Qeverisë së Përkohshme të Durrësit niset për në Paris, pjesa tjetër e kabinetit, e mbetur në vend, filloi punën për zbatimin e programit të qeverisë. Mirëpo në kushtet kur kjo qeveri vendoset nën kontrollin e drejtpërdrejt të komadës së pushtimit italian në Shqipëri dhe kur administrata shtetërore që varej prej saj u lejua të shtrihej vetëm në katër prefetura: në atë të Beratit, Elbasanit, Durrësit e Shkodrës me qendër në Lezhë,<sup>622</sup> veprimtaria e saj, për tu përballur me sfidat më të vështira të kohës, u cënua rëndë. E gjithë kjo ndodhte kur bazat ekonomike mbi të cilat ngrihej realiteti shqiptar ishin tejte të dobëta. Pikërisht mbi këto baza duhej të mbështetej Ministri i Ekonomisë Kombëtare, Lef Nosi, për hartimin e projekteve që do ta shpëtonin vendin nga rrënimi i plotë. Në këtë aspekt Qeveria e Përkohshme shqiptare kishte planifikuar edhe arritjen e një marrëveshje, me ndërmjetësinë e qeverisë italiane, me një bankë italiane për ngritjen e një dege të saj në Shqipëri.

Me vendosmërinë permanente në mbrojtje të çështjes kombëtare, me përkushtimin në luftën kundër copëtimit të tokave shqiptare, me kontributin e vyer në ruajtjen e vlerave kulturore e historike të popullit të tij, Lef Nosi kishte zënë vend në pararojën e veprimtarëve të lëvizjes patriotike shqiptare. I vlerësuar për atdhetarizmin e tij, në qershor të vitit 1919, ai ishte zgjedhur nga Shoqëria “Përparimi” e Elbasanit, drejtor i Teatrit Kombëtar të qytetit dhe anëtar i komisionit të këtij Teatri. “Shoqnia e këtushme e djelmënies,- do ti shkruante komisioni i kësaj shoqërie, - ...tue punue pa pushim e tue marrë parasysh se nuk munt të gjejë aq të zotin e atdhetarë sa zotënien e juej, ja propozoi Zotënin e juej Paries, për drejtor të Theatros, e cila ... e priti me gëzim të math këtë propozim e tue e çmue Atdhetarin e madhe të zotnies juej si edhe tue ditë zellin e math për të punumë për kombin, me një za e vendosi që t’ju lutet të pranoni këtë barrë, tue qenë të sigurt qi s’do ktheni prapë këtë lutje për një vepër kombtare”.<sup>623</sup>

Ndonëse formalisht autoritetet italiane në Shqipëri kishin pranuar formimin e qeverisë së Durrësit, ata e kishin kufizuar shtrirjen e saj kryesisht në Shqipërinë e Mesme, kurse krahinat e Korçës, Gjirokastrës e Vlorës nuk ishin lejuar të vireshin nën varësinë e saj politike e cila teksa rrezikonte vetë ekzistencën e popullsisë shqiptare të këtyre rajoneve, i kishte dhënë një shtytje të re rritjes së Lëvizjes kombëtare

<sup>620</sup> *Lufta e popullit shqiptar...*, Tiranë, 1975, fq. 75

<sup>621</sup> Revista “Hylli i Dritës”, nr.5, maj 1944, Shkodër, fq. 57

<sup>622</sup> *Historia e popullit shqiptar...*, Vëll. III, Toena, 2007, fq. 139

<sup>623</sup> AQSH, F. 32, D. 13, f. 1-2. Letra në fund është e nënshkruar nga shkronjësi i komisionit, Vasil Andoni.

shqiptare. Ndonëse në kushtet e një kontrolli të rreptë që italianët kishin vendosur mbi të gjitha linjat telegrafike e telefonike shqiptare, në prill të 1919-ës, Lef Nosi, si ministër i qeverisë së Durrësit por edhe si mbrojtës e veprimtar i çështjes kombëtare, kishte marrë në dorë letrën e dërguar nga Komiteti i Korçës, me anë të së cilës ai njoftohej mbi qëndrimin antishqiptar të forcave franceze, të cilat më 28 mars 1919 kishin ulur flamurin kombëtar shqiptar “*simbolin e shenjtë të shqiptarëve, dhe nuk duan që flamuri madhështor i Skënderbeut të valojë jo më vetëm në godinat zyrtare, por edhe nëpër shtëpitë tona*”.<sup>624</sup> Politika e ndjekur nga francezët u kishte dhënë zemër andartëve grekë, të cilët të grumbulluar e organizuar në çeta përgjatë kufirit shqiptaro-grek, kishin për qëllim të hynin në Korçë e të inskenonin një lëvizje kryengritëse, e cila do të mund të influenconte në vendimet e konferencës së Parisit. Në letër parashtroheshin edhe pikëpamjet politike që ekzistonin në Korçë mbi rrugët që duheshin ndjekur për shpëtimin e vendit nga rreziku i fqinjëve. Qëndrimet e lëkundura të përfaqësuesve shqiptarë në Paris dhe propaganda antishqiptare e vendosjes së protektoratit të huaj në Shqipëri dukej se tashmë ishte shtrirë edhe tek shqiptarët e këtij rajoni, i lakmuar historikisht nga fqinjët grekë. “*Ne – vazhdonte letra – protestuam në qeveritë e Antantës dhe presidentit të SHBA-së, duke kërkuar që qarku ynë të bashkohet me mëmën tonë Shqipëri nën mbrojtjen e Italisë, edhe pse ... fjala mbrojtje nuk do me thënë protection*”.<sup>625</sup>

Por për Lef Nosin, veprimtarin e Shqipërisë së pavarur, ministrin e qeverisë së Vlorës, mbrojtësin e shtetit shqiptar nën drejtimin e princ Vedit, nuk kishte kthim mbrapa. Shqipëria e kishte shpallur pavarësinë në 1912-ën dhe Fuqitë e Mëdha e kishin pranuar atë në gjirin e shteteve të lira në korrik të 1913-ës. Ky realitet ishte shkruar tashmë në faqet e historisë falë përpjekjeve e luftërave të vazhdueshme të shqiptarëve. Ky ishte qëndrimi politik i Lef Nosit, që përfaqësonte në të njëjtën kohë opinionin patriotik të popullsisë së Elbasanit, e cila kundërshtoi propozimin për festimin e përvjetorit të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë nga ana e autoriteteve italiane. “*Mbledhja e përgjithshme (Këshilli i Katundarisë së Elbasanit) – shkruhet në një dokument të kohës – tue marrë*



*parasysh se dita e indipendencës së Shqipërisë asht më 28 vjeshtë e tretë, e cila tue pasë ma të parën faktyrë mbretërinë e madhe, Italinë, gjenden nën vërtetimin e Fuqive të Mëdha të Evropës, me vota të plota e pa të panevojshme festimin popullarisht të çdo dite tjetër si ditë shpallje e vetqeverimit të Shqipnisë*”.<sup>626</sup> Vazhdimësia e jetës së pavarur të shtetit shqiptar – ishte mendimi politik që përfaqësonte jo vetëm rrethet

*Lef Nosi në të majtë*

<sup>624</sup> Po aty, D. 56, f. 41

<sup>625</sup> Po aty

<sup>626</sup> AQSH, F. 273, “*Katundaria e Elbasanit*”, D, 1, f. 1

patriotike por thuajse gjithë popullsinë e Shqipërisë së Mesme. “Dëgjojmë se në Shqipërinë e Mesme – shkruante Komiteti i Korçës – mejtimi i shumicës së popullit është kundër mbrojtjes italiane dhe për fillimin e një Shqipërie vetëqeveritare. Ky mejtim është vërtetë shumë i mirë dhe çdo shqiptar atë qëllim duhet të ketë; por mjerisht Shqipëria ... rrethohet prej fqinjëve armiq, qëllimet lakmitare të të cilëve mbi Shqipërinë janë të ditura”.<sup>627</sup>

Pas largimit, për arsye shëndetësore, të drejtuesit të delegacionit qeveritar në Paris, Turhan Pashë Përmetit, dhe sidomos për shkak të qëndrimeve të kundërta të përfaqësuesve shqiptarë, në qershor të 1919-ës u bënë disa ndryshime rrënjësore. Kryesinë e delegacionit të ri të Qeverisë së Përkohshme shqiptare në Konferencën e Paqes e mori Luigj Bumçi, ndërsa Lef Nosi, Mehdi Frashëri e Luigj Gurakuqi u zgjodhën anëtarë të rinj të tij. Në 17 korrik L. Nosi nisët nga Shqipëria për në Brindisi ndërsa në 2 gusht arrin në kryeqytetin italian, Romë, ku qëndron vetëm një ditë për t’u nisur të nesërmen drejt Parisit<sup>628</sup> për t’u bashkuar me pjesën tjetër të delegacionit shqiptar. Ky delegacion kishte për qëllim t’i jepte fund ndasive dhe qëndrimeve të ndryshme të përfaqësuesve shqiptarë në Paris dhe “do të ndjekë pikë për pikë programin kombëtar” të shpallur në memorandumin e 12 shkurtit 1919 të delegacionit të Qeverisë së Durrësit, dërguar Konferencës së Paqes. Delegacioni i ri vuri theksin në çështje kryesore si: “Po kërkojmë me u ba të zotët e vendeve shqiptare që na janë këputë me traktatin e Berlinit e me Konferencën e Londrës; po kërkojmë mëvetësinë e tanësinë tokësore të Shqipnisë e respektimin e të drejtave syprane të kombit shqiptar. Po kërkojmë edhe shpërblime ekonomike për një numër të madh katundesh të djeguna nga ana e grekëve në anën e poshtme të Shqipnisë e për rrënimet që kanë ba ushtritë e Mbretërive Qendrore sa kanë mbajtë vendin nën pushtim të tyre”. Gjithashtu ky delegacion synonte t’i kundërvihej çdo përpjekjeje që kërkonte “me prishë tanësinë, pavarësinë e të drejtat sovraane të shtetit shqiptar”.<sup>629</sup> Me platformën politike të prezantuar nga delegacioni i ri qeveritar u bashkuan edhe përfaqësuesit e kolonive shqiptare në Paris. Mirëpo anëtarët e delegacionit dhe përfaqësuesit shqiptarë në kryeqytetin francez nuk ndoqën të njëjtën linjë mendimesh në rrugën për të siguruar një mbrojtje sa më të mirë të çështjes kombëtare çka e vështirësoi akoma më shumë misionin e tyre për të zbërthyer qëndrimin indiferent të diplomacisë ndërkombëtare përballë kërkesave shqiptare. Ndërsa për shqiptarët problemi i tyre kishte rëndësi jetike, për disa nga paqebërësit e mëdhenj çështja shqiptare ishte veç një pjesë e vogël e problemeve të mëdha që kishte sjellë Lufta e Parë Botërore ishte “një çështje e vogël e çështjes së madhe të shtruar për t’u zgjidhur, pra: çështjes së Adriatikut dhe çështjes Greke në tërësi”.<sup>630</sup> Lajmi mbi arritjen e marrëveshjes italo-greke, të 29 korrikut, shtoi shqetësimin në rradhët e përfaqësuesve shqiptarë të cilët hartuan një memorandum, ku protestohej para

<sup>627</sup> AQSH, F. 32, D. 56, f. 42

<sup>628</sup> AQSH, F. 32, D. 30, f. 10, v. 1919

<sup>629</sup> *Lufta e popullit shqiptar...*, Tiranë, 1975, fq. 120

<sup>630</sup> Gurakuqi, Romeo. *Shqipëria e çështja shqiptare...*, Shkodër, 2007, fq. 37

Këshillit të të Pestëve kundër çdo vendimi që mund të merrej mbi çështje që interesojnë drejtpërdrejtë Shqipërinë, pa u konsultuar më parë me këtë.<sup>631</sup>

Në mbledhjen e 31 korrikut të 1919-ës, të anëtarëve të delegacionit qeveritar, u vendos përfshirja në të edhe e Mihal Turtullit, në cilësinë e delegatit këshilltar, dhe e Mehmet Konicës i cili u zgjodh në cilësinë e anëtarit të ri të këtij delegacioni. Zërat që filluan të qarkullonin mbi mundësinë e pranimi nga Fuqitë e Mëdha të një mandati të huaj mbi Shqipërinë, shkaktuan përplasjen mes përfaqësuesve shqiptarë në Paris lidhur me hapat që duheshin ndjekur për të shmangur miratimin e këtyre propozimeve nga Konferenca e Paqes. Ndërsa përfaqësuesit e kolonive shqiptare kërkonin vazhdimin e mbrojtjes së tezës së pavarësisë së plotë të shtetit shqiptar, disa anëtarë të delegacionit qeveritar, përballë presionit ndërkombëtar i cili as nuk pranonte të dëgjonte në tavolinën e bisedimeve kërkesën e delegatëve shqiptarë, rishikojnë, në qëndrimin e tyre, mundësinë e sigurimit për shtetin shqiptar të një “asistence dashamirëse e të përkohshme”. Për këtë arsye delegacioni vendosi: *“Tue qenë se çështja e Shqipnisë mund të vij për së shpejti në bisedim e tue qenë se asht nevojë e madhe që një përfaqësues i qeverisë të ndodhet pranë qarqeve politike inglize për t’i ndritë mbi të drejtat tona e për të fitue simpatinë e ndihmën e tyre, z. Mehmet bej Konica do të niset sa më parë për në Londër për të krye këtë punë”*.<sup>632</sup> Më tej në këtë mbledhje u theksua se përsa i përket problemit të *“pranimi të asistencës së ndonjenës prej Qeverive të Mëdha të Besëlidhuna e të Shoqueme, dërgata do të rregullohet mbas shpirtit të notave të paraqituna deri më sot në Konferencë mbi këtë çashtje, domethanë do të kërkojë që asistenca të jetë e përkohshme e që të mos lëndojë të drejtat syperane të shtetit shqiptar, as përparimin e zhvillimin e tij ekonomik”*.<sup>633</sup>

Ndërkohë nënshkrimi i marrëveshjes italo-greke, të 29 korrikut në Paris, i dhanë zemër riaktivizimit të qarqeve greke. Gjatë muajit gusht, në Korçë forcat greke ia kishin dalë të zëvendësonin trupat franceze dhe ky veprim iu ishte bërë e ditur banorëve publikisht. Menjëherë shumica e popullsisë e braktisi qarkun dhe iku në zonën italiane, ndërsa të tjerë, burra që zotëronin armë e municione, u mbledhën për t’u bërë qëndresë grekëve.<sup>634</sup> Kundërshtimi i qeverisë shqiptare bëri që Korça të kalojë përsëri nën administrimin francez dhe banorët të kthehen në shtëpitë e veta. Por, ndërkaq, incidenti shkaktoi mjaft shqetësim edhe tek populli i Elbasanit i cili do të protestojë në shtator kundër përpjekjeve të Greqisë për të pushtuar Korçën: *“Populli i Elbasanit, i mbledhur sot gjithë mbarë, dëfton habitjen, idhënimin e zemërimin e tij për largimin e bamë nga autoritetet frënge, qytetarëve të Korçës, që po zbrazet krejt, e vendësit po arratisen me gra e me fëmijë nëpër viset e tjera të Shqipnisë, tue mos durue që atdheu i tyre të hyjë nën zgjedhë të huej. Do të ishte një padrejtësi e madhe të shkelet nga greku Korça të cilën Konferenca e Londrës në 1913-ën ... e njohu për qytet krejt shqiptar. Në këtë kohë kur shqiptarët po presin që t’u shpërblehej e drejta që u humbi në 1913-*

<sup>631</sup> Lufta e popullit shqiptar..., Tiranë, 1975, , dok. 206, fq. 305

<sup>632</sup> Po aty, dok. 195, fq. 292

<sup>633</sup> Po aty

<sup>634</sup> Swire, Joseph. Shqiptarët..., Tiranë, 2005, fq. 236



ën, tue iu kthy prapë Shqipnisë, Kosova e Çamëria që janë vise krejt shqiptare, dëgjojnë lajmin e sipërpërmendun që shkakton humbjen e kombit shqiptar nga faqja e dheut. Ndaj populli i Elbasanit proteston kundër shkeljes së Korçës prej ushtrisë greke e shpreson se Konferenca e Paqes do ta sprapë këtë padrejtësi që mund të shkaktojë paqetësinë e turbullinë në Ballkan”.<sup>635</sup>

Për gjendjen në qytetin e Korçës, Lef Nosi njoftohet nga i vëllai, Veniamini i cili, në tetor të 1919-ës, i shkruan: “Populli i Korçës, që ish larguar para një muaji e gjysëm nga frika, po kthehet në atdhen e vet. Dhëntë Zoti që të qetësohen punët e të marr fund çështja e Shqipnisë e të jemi si edhe më parë zotër të Atdheut tonë e jo skllevër”.<sup>636</sup> Por situata vazhdon të jetë e rënduar. Kishte kaluar një muaj nga letra e Veniaminit, kur Grigor Nosi i shkruan vëllait të tij në Paris (L. Nosit) mbi gjendjen që vazhdonte të ishte e pasigurt në Korçë: “Çështja e Korçës zor të shpjegohet. Ndërsa komandanti frëng nga njëra anë thërret refugjatët, nga ana tjetër u thot se deri në fund të shtatorit duhet të jenë këtu, pastaj nuk dimë kujt do t’ia dorëzojmë Korçën. Kjo gjë i vë në dyshim korçarët e gjithë shqiptarët kanë kërkuar përkrahjen e qeverisë italiane, por mjerisht ende s’e dinë nëse ajo do t’i përkrahë”.<sup>637</sup> Shqetësimin për situatën në Korçë përfaqësuesit shqiptarë në Londër, imzot Bumçi e Dr. Turtulli, ia përcollën edhe kryetarit të Konferencës së Paqes, z. Lloyd George, si edhe ambasadorit amerikan në Londër. “Mbassi muerëm vesh në Londër se Greqia kishte mbledhun në kufi të Shqipëniës 7000 ushtarë, kalorës e topçinj, e se ishte gati të dërgonte edhe 7000 të tjerë për të marrë masat për të pushtuem Gjirokastrën, shkuem menjherë në Ministri të punëve të jashtme dhe hoqëm vërejtjen e Qeveriës inglize mbi rrjedhat e liga qi mund të kishte një çap i tillë nga ana e Greqiës....Në dy pjekjet që patëm...përsëritëm të gjitha argumentat mbi çashtje të Korçës e Gjirokastrës, ashtu dhe mbi punë të Vlonës, të Shkodrës e të mandatit të Italiës duke përfunduem se të gjithë Shqiptarët janë gati të derdhin gjakun deri në fund e se të pranojnë copëtimin e Atdheut e mandatin e Italiës, të Greqiës a të Jugoslaviës.”<sup>638</sup>

Në mbledhjet e delegacionit shqiptar në Paris zinin vend të rëndësishëm diskutimet mbi mënjanimin e mandatit të huaj mbi Shqipërinë. Në fund të shtatorit ishte bërë i qartë qëndrimi i SHBA-së ndaj çështjes shqiptare dhe kjo duket edhe nga bisedimet private mes ekspertit të dërgatës shqiptare, Fuat bej Zembrakut, me këshilltarin amerikan, z. Bukler: “Konferenca e Paqes nuk do bajë një ndryshim për shqiptarët përse i përket mandatit, por në qoftë se këta (shqiptarët) duen të shpëtojnë nga një mandat me ngjyrë koloniale, duhet të kërkojnë një formë asistence që të mund të mbështetet prej dërgatës amerikane e të pranohet prej Konferencës”.<sup>639</sup> Mosdeklarimi zyrtar i këtij qëndrimi, ngriti hijen e dyshimit tek një pjesë e delegacionit, ndër të cilët edhe Lef Nosi që shprehu “dëshirën e tij për t’i dëgjuar këto fjalë nga goja e z. Fuat beut, pse

<sup>635</sup> Lufta e popullit shqiptar..., Tiranë, 1975, fq. 361

<sup>636</sup> AQSH, F. 32, D. 57, f. 72

<sup>637</sup> Po aty, f. 68

<sup>638</sup> Revista “Hylli i Dritës”, prill 1944, Shkodër, nr. 4, fq. 79-80

<sup>639</sup> Lufta e popullit shqiptar..., Tiranë, 1975, fq. 400



atëherë do të mund t'i bajë edhe pyetje të tjera e do të mund të formojë një ide ma të qartë mbi qëllimin e z. Bukler". Ndërkohë ai këmbëngul që t'i jepen fund qëndrimeve të kundërta të përfaqësuesve shqiptarë në Paris dhe shton se " duhet të porositen delegatët e Stambollit që të pushojnë nga kundërshtimet e tyre, të cilat i kanë sjellë dam çashtjes sonë".<sup>640</sup> Lef Nosi, i cili kishte arritur në Paris në verën e 1919-ës, e dinte mirë se kundërshtitë mes përfaqësuesve shqiptarë jo vetëm e kishin lëkundur misionin politik që kishin marrë përsipër të realizonin, por kishin mbjell edhe mosbesimin e shqiptarëve ndaj qeverisë së tyre. Rrjedhimisht, gjatë diskutimeve, ai nuk e mbështeti idenë e hedhur nga disa anëtarë të delegacionit, për t'i kërkuar Konferencës zgjedhjen në krye të Shqipërisë të një princi nga dera mbretërore e Savojës, si e vetmja zgjidhje për të shpëtuar Shqipërinë nga vendosja e mandatit kolonial italian. Ai vëren se "dërgata shqiptare nuk mund të kërkojë një mbret tjetër gjersa princ Vidi të mos ketë dhanë dorëheqjen, ja se populli të mos e ketë rrëzue".<sup>641</sup> Në anën tjetër, duke qenë se delegatët në Paris duhet të përcillnin versionin zyrtar të dëshirës së shqiptarëve, Lef Nosi këmbëngul se "...asht mirë të pyetet edhe qeveria përpara se të merret një vendim mbi këtë çashtje". Ndërkohë zgjedhja e princit italian, për Lef Nosin, mbarte edhe një rrezik tjetër që kishte të bënte me të ardhmen e qytetit të Vlorës. Ndaj ai kërkon garanci, nëse ndodh një gjë e tillë – a mund ta shpëtojë dikush Vlorën nga pushtimi i Italisë?<sup>642</sup> Ndaj këtij rreziku kishte reaguar edhe paria e qytetit dhe krahinës së Vlorës të cilët përmes një letre dërguar kryetarit të delegacionit të SHBA-së, pranë Konferencës së Paqes, shprehin gadishmërinë e të gjithë popullit të Vlorës për të kundërshtuar me forcë orvajtjet për shkëputjen e saj nga shteti shqiptar.<sup>643</sup> Në këtë pikë Lefi u mbështet fort edhe nga Luigj Gurakuqi i cili, edhe ai, kërkonte nga delegacioni "të mos heqë dorë nga mbrojtja e tanësisë tokësore e nuk duhet kurrë t'i njohë Italisë pushtimin e Vlonës me një akt ndërkombëtar... Nuk duhet pra të bajë asnjë çap për çështjen e mandatit, gjersa të mos jenë caktue kufijtë e Shqipënisë e të mos jenë marrë vesh mirë puna e mandateve".<sup>644</sup> Për më tepër, për Lef Nosin, njohja e sovranitetit italian mbi krahinën e Vlorës jo vetëm që shkelte pavarësinë e tërësinë territoriale të shtetit shqiptar por njëkohësisht u hapte rrugën realizimit të mëtimeve territoriale të fqinjëve ballkanikë përmes "simpative" të diplomacisë ndërkombëtare, ndërsa shpresa për shpëtimin e Kosovës shuhej përfundimisht. Ky qëndrim përbënte edhe boshtin e mendimit politik të rretheve nacionaliste në Elbasan, të cilin L. Nosi, Aqif Pasha e patriotë të tjerë elbasanas e kishin mbështetur e vazhdonin ta mbronin. Dëshmi e këtij orientimi politik është edhe kërkesa e Aqif Pashës në letrën që i dërgoi kryesisë së mbledhjes në Durrës në dhjetor të 1918-ës: "Mbretëria italiane duhet të detë

<sup>640</sup> Po aty, fq. 402

<sup>641</sup> Po aty

<sup>642</sup> Po aty, fq. 403

<sup>643</sup> Po aty, fq. 434. Deklaratë e përfaqësuesve të lagjeve të Vlorës dhe të mbi 40 fshatrave të krahinës: 1)Vlora, qytet e krahinë, është shqiptare nga origjina, nga gjuha dhe nga ndjenjat, 2)Vlora dëshiron të bëj pjesë në shtetin e pavarur shqiptar, ashtu siç e kishin vendosur pa ngurrim në 1913Fuqitë nënshkruese të protokollit të Londrës; 3)Vlora është kryekëput kundër çdo aneksimi, edhe në formë të maskuar qoftë, në favor të çdo fuqie të huaj; 4)Vlora fton me urgjencë Fuqitë që të dërgojnë përfaqësues për të vërtetuar këto ndjenja të thella të popullsisë.

<sup>644</sup> Po aty, fq. 404

Shqipëniën me formën e vendueme prej Konfrencës së Londrës me zgjanim kufijsh, se ndryshe i çel rrugën kërkimeve t'anmiqve të Shqipëniës...”<sup>645</sup>

Ndërsa fuqitë fituese të Luftës së Parë Botërore po vendosnin për fatin e popujve, Lef Nosi do të paraqesë gjatë konferencës dokumenta autentike në favor të të drejtave të popullit shqiptar për të jetuar i lirë në trojet e veta. Përmes diskutimesh të shumta mbi gjetjen e rrugëve për shpëtimin e pavarësisë dhe sovranitetit të Shqipërisë, delegacioni qeveritar vendosi:

1. Të qëndrojë gjithnjë në kërkim të respektimit të tërësisë tokësore të Shqipërisë së krijuar në Konferencën e Londrës dhe në kërkim të pranimit të kërkesave kombëtare...

2. Të mos pranojë asnjë mandat pasi Shqipëria e kishte pavarësinë e vet, të njohur prej Konferencës së Londrës në 1913-ën.

3. Të mundahej të kufizonte qarkun e asistencës italiane duke u mbështetur në vendimet e Konferencës së Ambasadorëve.<sup>646</sup>

Nga fillimi i gushtit e deri në fillim të tetorit 1919 fuqitë aleate vazhduan bisedimet për Çështjen e Adriatikut, brenda të cilës ishte inkorporuar edhe Çështja Shqiptare, periudhë gjatë të cilës u paraqitën një sërë propozimesh por nuk u arrit asgjë konkrete as për statusin dhe as për kufijtë politikë të shtetit shqiptar. Në tetor përfaqësuesit e qeverisë së Durrësit në Paris i paraqitën një notë proteste kryetarit të Konferencës, Zh. Klemanso, drejtuar kundër planeve të fuqive evropiane, në veçanti të marrëveshjes Tittoni-Venizellos e cila shkonte në dëm të tërësisë tokësore të shtetit shqiptar dhe të pavarësisë së tij. Ndër të tjera këtu shkruhet: *“Dërgata shqiptare proteston kundër të gjitha këtyne vendimeve që u sjellin një cënim të randë tanësisë, mëvetësisë e sypranisë së popullit shqiptar dhe që janë në kundërshtim me parimet e drejtësisë e me të drejtat e kombeve të vogla...”*<sup>647</sup> Mirëpo përballë qëndrimit të fuqive evropiane në Paris, rreziqeve eventuale që po shfaqeshin për shqiptarët nga fqinjët ballkanas dhe zhvillimit të ngjarjeve në Shqipëri, delegacioni qeveritar, më 9 tetor, i propozoi Konferencës “një ndryshim të arsyeshëm dhe në pajtim me shpirtin e kohës e me nevojat e vendit, të dispozitave të Konferencës së Londrës të 1913-ës mbi ngritjen e shtetit shqiptar”.<sup>648</sup> Të shqetësuar nga rreziqet e vazhdueshme që i kanoseshin tokave shqiptare prej dy fqinjëve ballkanikë, Greqisë e Jugosllavisë, disa anëtarë të delegacionit filluan të anonin nga Italia të cilën e vlerësonin si Fuqinë e vetme që ishte e interesuar për ekzistencën e një shteti shqiptar dhe njëkohësisht ajo ishte e prirur të kundërshtonte çdo pretendim të shteteve ballkanike ndaj hapësirës territoriale të Shqipërisë. Tashmë, orientimi proitalian i delegacionit shqiptar është pranuar edhe nga vetë kryetari i saj, Luigj Bumçi i cili do të pohojë se *“... për të mbrojtur të drejtat tona, që të na dëgjohet zëri ynë, duhet të kemi mjaft fuqi*

<sup>645</sup> *Dokumente historike...*, vepër e cituar, fq. 300

<sup>646</sup> *Lufta e popullit shqiptar...*, vepër e cituar, fq. 402

<sup>647</sup> *Lufta e popullit shqiptar...*, vepër e cituar, dok. 274, fq. 425

<sup>648</sup> *Historia e Shqipërisë*, Vëll. III, Tiranë, 1984, fq. 201

*për t'u imponuar; kush nuk ka fuqi, mbështetet në fuqinë e miqve të vet. Duke parë rreth e rrotull, ne nuk shohim një tjetër fuqi ku të mbështetemi kundër grekëve e serbëve, veçse te Italia...".*<sup>649</sup>

Viti 1919 po mbyllej dhe fati i Shqipërisë vazhdonte të endej në rrugët pa krye të diplomacisë evropiane. Pikërisht në një situatë të tillë anëtarët e delegacionit qeveritar hartuan një memorandum me propozimet që do t'i paraqiteshin Konferencës së Paqes lidhur me disa ndryshime të vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve të 1913-ës, mbi njohjen e të drejtës së Italisë për garantimin e asnjësisë së shtetit shqiptar dhe caktimin e dukës së Aostës si Princ të shqiptarëve i cili do të shoqërohej nga një trupë e armatosur ushtarake që do të qëndronte në vend deri në stabilizimin e shtetit shqiptar, me fjalë të tjera për një periudhë të papërcaktuar. Atëherë kush i garantonte shqiptarët që ushtria shoqëruese e Princit nuk do të shndërrohej në një ushtri pushtuese kur ndërkohë prania e trupave italiane në Vlorë kishte kohë që për popullsinë vendase shihej si një pushtim italian i qytetit dhe rrethinave të tij?! Nisur nga ky gjykim duket se Lef Nosi nuk ka qenë i një mendje me propozimet e memorandumit pasi në fund të këtij projekti gjenden nënshkrimet e L. Bumçit, M. Konicës, M. Frashërit e L. Gurakuqit, dhe mungon emri i anëtarit të fundit të delegacionit, L. Nosit.<sup>650</sup> Përveç këtyre ndryshimeve, në fund të dhjetorit 1919, delegacioni shqiptar hartoi një notë të re ku u propozuan edhe disa lëshime në favor të shteteve fqinje me qëllim që këta të mos shkelin tërësinë tokësore të Shqipërisë. Por mjerisht edhe këto sakrifica nuk i kënaqën lakmitë e sheteve fqinje. Ndërsa përpjekjet diplomatike të përfaqësuesve shqiptarë në Paris për të ripohuar pavarësinë e shtetit shqiptar dhe për të mbrojtur tërësinë tokësore të tij, rezultuan të pasuksesshme, zgjidhja mbetej të kërkohej veç në organizimin e brendshëm të qëndresës shqiptare.

Mbërritëm në këtë konkluzion në një kohë që edhe autoriteti i trupave italiane në vend ishte dëmtuar rëndë e ku nuk mungonin as përplasjet me popullatën vendase. Kjo ndodhi në korrik të 1919-ës në fshatin Gryksh ku gjatë përplasjes mbetën të vrarë disa ushtarë italianë e për rrjedhojë komandanti i trupave italiane, Giacinto Ferrero, u hakmorr mbi popullatën e Grykshit e të Pajovës.<sup>651</sup> Kjo ngjarje acaroi më tej marrëdhëniet me italianët dhe e bëri akoma më të fortë kërkesën që qarkullonte dëndur mes shqiptarëve mbi thirrjen e një kongresi kombëtar, jashtë çdo ndikimi të huaj e për më tepër jashtë ndikimit italian. Thirrjes së këtij kongresi i paraprinë mbledhje në qytete të ndryshme të vendit. Kështu në mbledhjen e katundarisë së Elbasanit u evidentuan dy rryma apo dy degë, sikurse thuhet në dokumentin e mbajtur në mbledhje: njëra që kërkonte thirrjen e një mbledhje të përgjithshme kombëtare në Lushnjë, për të cilin kishin filluar të lëshoheshin edhe ftesat nga grupi iniciator, dhe tjetra që drejtohej nga Shefqet Vërlaci që njihej për qëndrimin e tij proitalian, e cila kërkonte vetëm mbledhjen e senatit, sikurse ishte vendosur në kongresin e Durrësit, e më vonë thirrjen e një mbledhje të përgjithshme. Pasi u hodhën në votë të dyja qëndrimet, nën

<sup>649</sup> *Lufta e popullit shqiptar...*, vepër e cituar, dok. 299, fq. 460

<sup>650</sup> Po aty, dok. 323, fq. 500

<sup>651</sup> AME, Kutia VII, Dosja 22, dok. 6, f. 2

dikimin e Shefqet Beut, fitoi rryma e dytë. Mirëpo në kohën kur gjendja e brendshme në vend ishte e acaruar e kur kishte fituar mjaft terren opinioni antiitalian, forcat përparimtare të drejtuara nga Aqif Biçaku kërkuar që të kryheshin në katundari (bashki) zgjedhjet për delegatët në mbledhjen e përgjithshme. Përfundimi i zgjedhjeve në katundarinë e Elbasanit nuk nxori fituese asnjërën nga dy rrymat përfaqësuese, as atë të Aqif Pashës dhe as atë të Shefqet Beut. Por si kryetar i katundarisë, Sh. Vërlaci kishte të drejtën e dy votave, kështu që rryma që ai drejtonte siguroi shumicën në Elbasan dhe zgjodhi delegatë Kasem Sejdinin dhe Filip Papajinin.<sup>652</sup> Delegatët përparimtarë fituan në Dumre, Sulovë, Gramsh, në Peqin fituan Aqif Biçaku e Adem Gjinishi.<sup>653</sup> Nisur nga mënyra se si ishin zhvilluar votimet në katundarinë e Elbasanit dhe për të mos lejuar që edhe mbledhja e përgjithshme të vihej nën ndikimin e forcave proitaliane, përfaqësuesit e forcave përparimtare morën iniciativën dhe formuan disa forca të armatosura, rreth 180 veta, në Dumre, Shalës e Belsh të cilat u nisën drejt Lushnjës dhe hynë të parat në qytet duke e detyruar komandantin italian të tërhiqet përballë vendosmërisë së forcave të ardhura nga Dumreja e Elbasani. Më pas të tjera forca të armatosura do të mbërrijnë në Lushnjë.<sup>654</sup>

Fundi i qeverisë së Durrësit lidhet me zhvillimet politike të vitit 1920, kohë në të cilën vendi kishte probleme të mëdha, populli ishte i përçarë, niveli ekonomik tepër i ulët, analfabetizmi ishte i lartë dhe korrupsioni, i trashëguar nga Perandoria Osmane, ishte i përditshëm. Ky vit i dha fund një deкаде krize, luftërash e kaosi të përgjithshëm. Fatin e vendit do ta marrë në dorë kuvendi kombëtar në Lushnjë në janar të 1920-ës. Delegatët e mbledhur arritën në përfundimin se pozita e vendit të tyre ishte e dëshpëruar, se ata kishin qenë të gabuar në besimin se parimet e drejtësisë dhe të vetëvendosjes do të zbatoheshin në rastin e tyre, kishin gabuar në besimin ndaj dashamirësisë së Fuqive të Mëdha. Ata vendosën që, ndërsa do të vazhdonin përçapjet tek këto fuqi, ata vetë duhej të ndërmerrenin hapa aktivë për të çliruar tokën e tyre nga trupat dhe ndikimi i huaj dhe për t'i treguar botës vendosmërinë për ruajtjen e pavarësisë e tërësisë tokësore të vendit të vet.<sup>655</sup> Të bashkuar nga ndjenja e uniteti kombëtar, përfaqësues të grupimeve të ndryshme politike në vend do të mbledhen në Lushnjë për t'i dhënë jetë një qëllimi: të ndërtonin një politikë të përbashkët në mbrojtje të pavarësisë së Shqipërisë dhe të drejtave të shqiptarëve brenda e jashtë kufijve të vitit 1913.

U formua qeveria e re e Tiranës e kryesuar nga Sulejman Delvina dhe u riformua delegacioni shqiptar që do të dërgohej në Paris. Informacionet, ndonëse nga burime jo zyrtare, për rrëzimin e qeverisë së Durrësit mbërritën edhe në kryeqytetin francez, tek përfaqësuesit shqiptar në konferencë, mes tyre edhe Lef Nosi, të cilët me mjaft qetësi pranuan t'i nënshtohen pa asnjë kusht vullnetit të shqiptarëve. Përmes një letre dërguar kryetarit të Këshillit të Lartë të Shqipërisë, Aqif Pashë Biçakçiu, ata i bëjnë të ditur se “ndë një mbledhje qi

<sup>652</sup> Po aty, f. 3

<sup>653</sup> Selenica. Teki, *Shqipëria 1927*, Tiranë, 1928, Pasqyra A, fq. 21

<sup>654</sup> AME, Kutia VII, Dosja 22, dok. 6, f. 4

<sup>655</sup> Swire, Joseph. *Shqiptarët...*, Tiranë, 2005, fq. 253

mbajtëm më 9 të këtij mueji (shkurt 1920- E.A) vendosëm që t'i shtohemi me një herë vullnetit të ligjshëm të popullit e të qëndrojmë këtu deri sa t'emnohet Dërgata e re të cilës do t'i dorzojmë llogariët dhe archivët. Ky emnim duhet të bahet një orë e më parë tue qenë se do t'ishte një dam i math për çashtjen t'onë po të lihej këtu zbrastë vendi i Dërgatës zyrtare ndë një kohë kaqë të kritikshme për fatin Atdheut t'onë".<sup>656</sup> Përpos këtij vendimi, kjo letër shoqërohet edhe nga një pasqyrë përmbledhëse që ky delegacion i bën mënyrës se si po trajtohej çështja shqiptare nga fuqitë pjesëmarrëse në Konferencën e Paqes. Njëkohësisht njoftime të vazhdueshme vinin edhe nga Londra mbi veprimtarinë e përfaqësuesve të delegacionit zyrtar shqiptar i cili ishte nisur drejt kryeqytetit britanik "...qi të mund të vepronim me anën e miqvet qi kemi atje për t'i zbritun mendjen Qeveriës inglize mbi të drejtat e kombit shqiptar e mbi paudhësiët qi po punohen kundër tij, si dhe mbi aftësiën e Shqiptarvet me u qeverisun vetvetiu, punë e cila u ep të drejtë për një sundim të pavarun e syperan".<sup>657</sup>

Tashmë qëndrimin të përfaqësuesve të qeverisë së Durrësit në Paris i kishte ardhur fundi. Në letërën që L. Bumçi e M. Turtulli i dërgojnë Aqif Pashës, më 25 shkurt 1920, ndërsa vihet theksi në hapat që ata kishin ndërmarrë e "... që përpiqen një më një me programin e venduem prej Mbledhjes së Lushnjës", parashtrohej edhe dorëheqja e përfaqësuesve qeveritar në Paris bashkangjitur kërkesës për emërimin e menjëhershëm të delegacionit të ri qeveritar për në Konferencën e Paqes. "Këtu po ju mbyllim edhe dorëheqjet tona tue ju lutun edhe një herë qi të mirrni masat për t'emnuem sa ma shpejt delegatët e tjerë në vendin tonë pse nuk mund të rrijmë për shumë kohë këtu."<sup>658</sup> Ndonëse kishin dhënë dorëheqjen, përfaqësuesit e delegacionit do të vazhdojnë të qëndrojnë, pa detyrë zyrtare, edhe pak kohë në Paris derisa qeveria e Lushnjës të siguronte pozitat e saj në Tiranë, qytet i cili për L. Nosit dhe anëtarët e tjerë të delegacionit, konsiderohej si bastion i Esad pashës i cili ndonëse vazhdonte betejën e tij politike në kryeqytetin francez, mund të përpiquej me anë të mbështetësve të tij, autoritetit që gëzonte në Shqipërinë e Mesme dhe parave që mund t'i vinin nga Serbia, të rrëzonte qeverinë e Tiranës.<sup>659</sup> Dërgimi i një përfaqësie të posaçme nga Tirana, të përbërë nga Fuat bej Toptani, Imer bej Shijaku, njerëz mbështetës të Esad Toptanit, dhe Bajram Fevziu, përfaqësues i krahut nacionalist,<sup>660</sup> për t'u marr vesh Esad pashën në Paris, i dha fund qëndrimin të ish-anëtarëve të delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes, të cilët në prill të 1920-ës, nisën rrugëtimin e tyre drejt Shqipërisë. Pasi u larguan nga Parisi, stacioni pasardhës ishte kryeqyteti italian, ku qëndruan pak ditë për t'u nisur në ditët e para të majit drejt brigjeve shqiptare. Ndërsa L. Bumçi dhe M. Turtulli u thirrën në Këshillin e Regjencës, L. Nosi e M. Frashëri, më 14 maj 1920, zbritën në Durrës. "Mbasi u nis dërgata e Tiranës për të shkuar pranë Esad Pashës, unë – shkruan në "Kujtimet" e tij Mehdi Frashëri – L. Gurakuqi, monsinjor

<sup>656</sup> Revista "Hylli i Dritës", Shkodër, 1944, fq. 45

<sup>657</sup> Po aty, fq. 79. Raport i dt. 30 mars 1920

<sup>658</sup> Po aty, fq. 46

<sup>659</sup> Frashëri, Mehdi. *Kujtime*, Tiranë, 2005, fq. 79

<sup>660</sup> Po aty, fq. 80

Bumçi e L. Nosi u nisëm për në Shqipëri... Kur u kthyem nga Parisi, ndejtëm disa ditë në Romë dhe mbasandaj imzot Bumçi e Gurakuqi shkuan në Shkodër, kurse L. Nosi dhe unë u nisëm për në Durrës e Tiranë”.<sup>661</sup> Në 18 maj 1920 Lef Nosi mbërrin në Elbasan, qytet ku, që prej 1918-s, kishte rinisur veprimtarinë e saj shoqëria “Afërdia”, e ngritur që në 1909-ën por që për shkak të trazimeve në vend e kishte ndërprerë veprimtarinë e saj, si edhe banda e saj muzikore me të njëjtin emër. Të hollat për bandën u mblodhën nga populli elbasanas më 1917-ën por aktivitetin e saj ajo do ta nisë në verën e 1918-ës.<sup>662</sup> Pothuajse çdo javë ajo jepte koncerte në sheshin e Bezistanit. Drejtimin artistik të kësaj bande muzikore, të përbërë kryesisht nga nxënës normalist, e kishte marrë përsipër mësuesi Ahmet Gashi i ndihmuar edhe nga kryetari i bandës muzikore austro-hungareze, çeku Anton Cimfel.<sup>663</sup> Mësimin e veglave muzikore pjesëtarët e bandës në fillim e patën nga muzikantët austriakë, të cilët kishin bandën e tyre muzikore në qytetin e Elbasanit. Mbasi ikën austriakët dhe erdhën italianët, atëherë mësimin e bandës muzikore e morën instruktorët italianë. “Dëshira e zjarrtë e të rinjve, - do të shkruante ish kryetari i saj, Qamil Çela, - për të dalun para popullit me bandën e re muzikore, që ishte fruti i ndihmës së qytetarëve, bani që për një kohë të shkurtën, ata të mësojnë shumë marshe e këngë patriotike.”<sup>664</sup>

E shoh me vend të vë theksin në aktivitetin e kësaj shoqërie jo vetëm se me veprimtarinë e saj që në momentet e para kur ajo është ngritur gjej të vendosur, përkrah patriotëve të tjerë elbasanas, edhe veprimtarin L. Nosi, por edhe për rëndësinë që ajo mori në momentet e vështira të ringritjes së saj në kohën kur monarkia dualiste, që nuk lejonte asnjë organizim të karakterit politik në vend, i dha mundësinë zhvillimit të aktiviteteve të natyrës kulturore e artistike. Për rithemelimin e kësaj shoqërie gjatë Luftës së Parë Botërore ja se çfarë shkruan ish kryetari i saj, Q. Çela: “Studentët patriotë t’Elbasanit qi gjatë okupacionit (austro-hungarez) nuk lejoheshin me u organizue, veçse në lamin e kulturës e t’artit, me qëllim qi të zgjanojshin dhe të gjallnojshin aktivitetin e tyne patriotik, rithemeluan shoqërinë “Afërdita”, qi kishte pasë ekzistue n’Elbasan para shpalljes së independencës. Shoqnia u pagzue me këtë emën, me qëllim qi të trashigojë fondet e lanuna prej sajë.” Kujtojmë se në 1916-ën Aqif Pashë Biçakçiut e Lef Nosit, bashkë me patriotë të tjerë elbasanas, u ishte mohuar kërkesa nga autoritetet austro-hungareze për organizimin e një kongresi në Elbasan, si një aktivitet politik i palejueshëm në kohë lufte në territoret e pushtuara nga Monarkia Danubiane. Ndoshta kjo mund të jetë arsyeja që në rithemelimin e shoqërisë “Afërdita”, kryetar i së cilës Lef Nosi kishte qenë në 1909-ën, tashmë në 1917, ai nuk përmendet. Këtë mendim na e forcon edhe fjalët e Qamil Çelës kur shkruan: “Kryesia e shoqnisë përbahesh vetëm prej studentash dhe në fillim anëtarët aktivë të saj, ishin po studenta. Kjo lejoi qi të mos binte shumë në sy t’pushtuesave dhe të bejlerëve

<sup>661</sup> Po aty, fq. 81

<sup>662</sup> AME, Fondi. 1, Dosja. 2, nr. 23, f. 2, ose “Kopështi Letrar”, nr. 1, gusht 1918, Elbasan.

<sup>663</sup> AME, Kutia. 7, Dosja. 22, dok. 6, fl. 8

<sup>664</sup> AME, Fondi 31, Dosja. 2, fl. 3



shoqnia Afërdita dhe ta kryej misionin e saj patriotik ma me lehtësi .”<sup>665</sup> Me të hollat që kishte pasur të mbledhura shoqëria “Afërdita”, gjatë v. 1916-1917, u blenë veglat muzikore në Austri dhe filloi aktivitetin e saj në një shtëpi të marrë me qira pranë sahatit të qytetit e cila shërbeu si qendra e shoqërisë ku bëheshin mbledhjet e këshillit, zakonisht një herë në dy javë, mbledhjet e përgjithshme, si edhe mësimi e ushtrimi i veglave muzikore. Pasi dilte nga porta e Kalasë, banda muzikore shëtiste në rrugët e qytetit e më pas vendosej në Rrapin e Bezistanit ku luheshin marshe e këngë patriotike.<sup>666</sup> Përmes muzikës ajo përcillte frymën patriotike tek turma e gjerë e popullit që afrohej për të dëgjuar e kënduar bashkë me të.

Në vitin 1919 shoqëria “Afërdita” ishte riorganizuar dhe kishte nisur një fushatë të gjerë për mbledhjen e të hollave e plaçkave të ndryshme për të ndihmuar luftën e Vlorës. Populli i Elbasanit nuk u kursye dhe kjo duket pikërisht në fjalët e patriotit A. Gashi i cili ndër të tjera do të shkruante: “...banda jonë ka shëtir derë më derë në të gjitha lagjet e Elbasanit tue ekzekutue marshe e hymne patriotike, tue i dhan zjarr e nxitje patriotike banorëve të pasun e të vorfën pa përjashtim dhe ka mbledhur një ndihmë prej mase 200 napolona ar”.<sup>667</sup> Nga Elbasani për çlirimin e Vlorës u nisën edhe mjaft vullnetarë e luftëtarë. Njerëz të ndryshëm që posedonin armë e fishekë, i dorëzonin ato vullnetarisht në katundari dhe kjo ia shpërndante luftëtarëve vullnetarë që nuk kishin armë.<sup>668</sup> Ky ishte mjedisi patriotik që Lef Nosi do të gjejë në qytetin e tij kur kthehet në atdhe në pranverën e 1920-s. Vetëm një muaj më vonë, më 30 qershor 1920, në Elbasan u mbajt një miting i madh ku morën pjesë banorë të qytetit edhe fshatarë të zonës përreth nga ku iu dërgua kryetarit të Konferencës së Paqes në Paris, z. Miterland, një rezolutë në të cilën shfaqej solidariteti i popullit të Elbasanit me luftëtarët e Vlorës.<sup>669</sup> Këshilli i luftës për çlirimin e Vlorës thirri edhe vet bandën muzikore për të shkuar në Drashovicë, prej nga, sëbashku me luftëtarët, do të shkonin në qytetin e Vlorës që vazhdonte të ishte i pushtuar nga trupat italiane.

#### **IV-2 Qëndrimi i Lef Nosit në situatën politike të viteve ‘20**

Periudha e viteve 1920-1924 ishte një nga më kaotiket në historinë e Shqipërisë. Një ndër problemet themelore me të cilin do të përballlet Shqipëria gjatë kësaj kohe ishte mungesa e unitetit mes forcave politike shqiptare lidhur me hapat që duheshin hedhur drejt zhvillimit demokratik të vendit. Megjithatë kjo periudhë e kaosit politik shënoi edhe kulmin e jetës politike shqiptare dhe ishte periudha më demokratike në historinë politike të shtetit shqiptar midis dy luftërave botërore. Pas vitit 1920 Shqipëria hodhi hapat e parë të rëndësishëm drejt organizimit të shtetit të saj mbi baza ligjore. Ishte qeveria e Iliaz Vrionit që përgatiti

---

<sup>665</sup> AME, Fondi 31, Dosja. 2, fl. 2

<sup>666</sup> Po aty, fl.3

<sup>667</sup> AME, Kutia. 7, Dosja. 22, dok. 6, fl. 8

<sup>668</sup> Po aty

<sup>669</sup> Po aty, fl. 9

zgjedhjet e para parlamentare në vend. Fushata zgjedhore e vitit 1921 u përshkua nga lufta politike dhe debati i ashpër midis grupimeve të ndryshme. Ndonëse vendosi t'i qëndrojë larg luftës elektorale në betejat për zgjedhjet në parlamentin e parë shqiptar, ose siç quhej atëherë Këshilli Kombëtar, Lef Nosi vazhdon të jetë i vëmendshëm ndaj zhvillimeve politike në vend të cilat pasqyrojnë përplasje edhe brenda vetë qeverisë shqiptare. Kjo duket edhe nga vendimet që dilnin nga kjo qeveri sikurse ishte ai që ndalonte hyrjen në Shqipëri të Fan S. Nolit i cili kishte mbërritur në brigjet shqiptare në shtator të vitit 1920 por nuk lejohej të zbresë nga vaporit dhe detyrohej të kthehej pas urdhërit të posaçëm qeveritar “ prej shkaqesh politike të brendshme të elementëve ortodoks”.<sup>670</sup> Në këtë kohë në faqet e gazetës “Koha”, të drejtuar nga Mihal Grameno, jepet lajmi për një arrestim të mundshëm të atdhetarit elbasanas, L. Nosit, pasi ai nuk i ishte drejtuar prefektit me titullin “Pashë”.<sup>671</sup> Këtë fakt e dëshmojnë edhe shënimet që Lefi mban në ditarin e tij ku ai shkruante: “9 korrik 1920 - u burgosa nga Feim Leskoviku. 13 korrik - u lirova nga burgu”<sup>672</sup> Ashtu sikurse e përshkruan edhe prof. R. Gurakuqi në studimin e tij mbi zhvillimet politike në vend gjatë kësaj kohe, Shqipëria e sapodalë nga sundimi i gjatë otoman ishte vendi më i prapambetur i Europës ku pjesa më e madhe e popullsisë ishte analfabete, në mënyrë masive, ndërsa liderët e klasës politike ishin kryesisht bejlerë të trashëguar nga Perandoria Osmane që dashurinë për atdheun e kishin identifikuar si dashuri dhe prirje drejt pushtetit. Personat e arsimuar ishin të paktë në numër, kryesisht nga radhët e popullsisë së krishterë, të cilës nuk i ishte lënë asnjë e drejtë nga klasa e bejlerëve që kishte zënë vendet në administratë dhe në kushtet politike primitive që ekzistonin në vend i kishte drejtuar sytë nga marrja e pushtetit.<sup>673</sup> Pikërisht këto tipare të klasës politike shqiptare bënë që qeveri jetëshkurtra ti lënë vendin njëra-tjetrës pa arritur të konsolidojnë pozitat e tyre shtetërore. Rrëzimi i qeverisë së S. Delvinës u pasua nga formimi më 15 nëntor 1920 i kabinetit të ri, i kryesuar nga Iljaz Vrioni që vinte nga një familje e madhe që zotëronte prona të mëdha tokësore në Myzeqe, i cili shpalli ndër të tjera në programin e tij se “synonte përgatitjen e ligjit të posaçëm për zgjedhjet legjislative,...rregullimin e financave..., sigurimin e qetësisë dhe drejtësisë për gjithë shtetasit shqiptarë dhe bërjen e çdo sakrifice për arsimin kombëtar”.<sup>674</sup> Formimi i kabinetit të ri qeveritar u mirëprit nga një pjesë e mirë e veprimtarëve nacionalistë elbasanas, mes të cilëve L. Nosi, A. Xhuvani e të tjerë, të cilët tek qeveria e re jo vetëm shikonin mundësinë e kapërcimit të krizës politike në vend por ishin entuziastë në lidhje me përbërjen e kësaj qeverie të cilët “...ishin të gjithë burra pa ndonji leqe politike e madje thuejse të gjithë a ma të shumtët nga Partia Popullore”.<sup>675</sup> Shpejt do të fillonte puna për përgatitjen e fushatës zgjedhore e cila parashikohej të zhvillohej me fillimin e vitit pasardhës. Përplasjet

<sup>670</sup> Hysi, Gramoz. *Organizimi i shtetit shqiptar dhe lufta politike rreth tij në vitet 1920-1924*, Tiranë, 1988, fq. 65

<sup>671</sup> AQSH, F. 32. D. 9.

<sup>672</sup> AQSH, F. 32. D. 37, f. 115.

<sup>673</sup> Gurakuqi, Romeo. *Shqipëria dhe çështja shqiptare...*, Shkodër, 2007, fq. 192-193

<sup>674</sup> Dervishi, Kastriot. *Historia e shtetit shqiptar 1912-2005*, Tiranë, 2006, fq. 125

<sup>675</sup> Mita, Rudina. *Elbasani. Jeta politike në vitet 1920-1924*, Tiranë, 2007, fq. 125. Bëhet fjalë për “Partinë Popullore” që kishte ngritur A. Zogu gjatë Qeverisë së Sulejman Delvinës.

do të jenë jo pak të ashpra edhe në mjedisin politik të qytetit të Elbasanit pjesë aktive e së cilës ishte edhe L. Nosi. Tensionet parazgjedhore në Elbasan u ngritën mbi një tokë e cila kishte nisur të lëkundej që prej nëntorit të atij viti (1920) dhe kulmoi në mëngjesin e 18 dhjetorit me një tërmet të fuqishëm i cili u shoqërua me shumë shtëpi të shkatërruara, madje dhe humbje të jetëve njerëzore. Sipas shënimeve që L. Nosi hidhte në ditarin e tij, në këtë tërmet humbën jetën 15 qytetarë dhe u plagosën 21 të tjerë.<sup>676</sup> Reshjet e vazhdueshme që shoqëruan atë dimër e vështirësuan edhe më shumë situatën e rënduar të popullsisë vendase të cilës i ishte premtuar, nga qeveria e I. Vrionit, përmisimi i gjendjes së tyre ekonomike.

E tillë ishte situata kur filloi fushata e zgjedhjeve për në Këshillin Kombëtar e cila nisi me ardhjen e pranverës së vitit 1921 dhe gjatë së cilës nuk munguan presionet, premtimet, mashtrimet të cilat në disa raste, si në Elbasan, u pranuan edhe nga vetë qeveria e cila shpalli zyrtarisht se “në Elbasan, mbasi u bënë përdorime kundër ligjit të zgjedhjeve u dha urdhër për prishjen e tyre”.<sup>677</sup> Gjatë kësaj fushate për zgjedhjet e para parlamentare në vend, në zonën e Elbasanit u ballafaquan dy grupime politike: 1- Popullorët që përfaqësonin krahun përparimtar në këto zgjedhje e ku bënin pjesë përfaqësues të borgjezisë tregtare, elementë liberal e demokratë që synonin zhvillimin demokratik të vendit. Mes tyre ishin rreshtuar figura si Lef Nosi, Ahmet Dakli, Rrapush Demeti etj<sup>678</sup> të cilët ishin mbështetës të Aqif pashë Biçakçiut i cili për shkak të kundërshtive dhe rivalitetit me Vërlacin u bashkua në këto zgjedhje me “Popullorët”; 2- Pleqësorët (Përparimtarët) që përfaqësonin krahun konservator të drejtuar nga Shefqet bej Vërlaci e ku bënin pjesë pronarë të pasur, elementë nacionalistë dhe një pjesë e borgjezisë elabasanase,<sup>679</sup> me të cilin ishin bashkuar Shefqet Daiu, Behxhet Hyti,<sup>680</sup> Ahmet Hostopalli, Andon Bexha, Musa Harja etj. Fushata zgjedhore në trevën e Elbasanit ishte pasqyrë e rivalitetit të ashpër jo vetëm mes grupimeve politike por edhe e figurave të veçanta me autoritet të fortë në popullsinë e zonës të cilët e përdorën të gjithë influencën e tyre për të siguruar fitoren në këto zgjedhje. Ndonëse u vunë re raste të abuzimeve si nga ana e zyrtarëve ashtu edhe nga ndërhyrja e përfaqësuesve të klasës së bejlerëve, në përgjithësi nuk ndodhën ngjarje që do të ndryshonin rrjedhën e jetës politike në vend. Përtej përpjekjeve të krahut politik që L. Nosi mbështeste në këto zgjedhje për të propaganduar zhvillimin e reformave demokratike në vend dhe për të kundërshtuar padrejtësitë, shkeljet, parregullsitë madje edhe kërcënimet e Sh. Vërlacit për të bërë për vehte zgjedhësit e dytë,<sup>681</sup> rezultatet përfundimtare nxorën fitues, në prefekturën e nënprefekturat e Elbasanit, kandidatët e grupit “Pleqësor” të Sh. Vërlacit. Në parlamentin e parë pluralist, të dalë nga zgjedhjet e vitit 1921, u regjistruan 77 deputetë, nga të cilët 40 përfaqësonin “Përparimtarët”, 30 ishin “Popullorët” dhe 7 ishin

<sup>676</sup> AQSH, F. 32, D. 37, f. 87

<sup>677</sup> Hysi, Gramoz. *Organizimi i shtetit shqiptar dhe lufta politike rreth tij në vitet 1920-1924*, Tiranë 1988, fq. 95

<sup>678</sup> Kito, Petro. *Elbasani në luftën për çlirim*, Tiranë, 1971, fq. 44

<sup>679</sup> Mita, Rudina. *vepër e cituar*, fq. 138

<sup>680</sup> Gazeta “Shkumbini”, Elbasan, 27 qershor 1921.

<sup>681</sup> Mita, Rudina. *Vepër e cituar*, fq. 141

deputetë të pavarur.<sup>682</sup> Me gjithë problematikat që u vunë re gjatë zgjedhjeve është i rëndësishëm fakti se tashmë me votën e shqiptarëve po hidheshin hapa drejt ngritjes së institucioneve të shtetit shqiptar.

Fillimi i jetës parlamentare në qershor të vitit 1921 u shoqërua me krijimin e një kabineti të ri qeveritar të kryesuar nga Iliaz Vrioni veprimtaria e të cilit kushtëzohej si nga gjendja e brendshme politike në vend ashtu edhe nga mungesa e stabilitetit në kufijtë e Shqipërisë. Shteti shqiptar kishte nevojë të përtërihej si një organizëm shtetëror, të forconte institucionet e tij, të shkëputej nga mbeturinat e trashëguara feudale e të ecte drejt demokratizimit të jetës politike, ekonomike, sociale e kulturore. Të rëndësishme ishin arritjet në fushën e arsimit ku u bënë përpjekje për rritjen e numrit të shkollave fillore e shtrirjen e arsimit edhe në fshat, për unifikimin e shkollës me program të njëjtë dhe zgjerimin e rrjetit të mësuesve ku kontribut të vyer dha edhe Normalja e Elbasanit që drejtohej në këtë kohë nga A. Xhuvani.<sup>683</sup> Përballë qëndrimeve të ndryshme që mbajtën forcat politike shqiptare në lidhje me domosdoshmërinë dhe mënyrën e zgjidhjes së detyrave të qeverisë, Lef Nosi vendosi të japë kontributin e tij në mbështetje të përpjekjeve të qeverisë për zhvillimin e arsimit e të kulturës. Një fakt të tillë e dëshmon edhe letërkëmbimi me Aleksandër Xhuvanin, i cili ishte zgjedhur kryetar i Komisionit Letrare që do të kujdesej për të gjitha problemet e përmbajtjes dhe organizimit të shkollës. Ai i kërkon Lef Nosit të përdorë influencën që ka tek banorët dhe paria e zonës së Valëshit për të bërë të mundur çeljen në këtë krahinë të shkollës shqipe dhe frekuentimin e saj nga të rinjtë vendas. “Po të lutem për punën e atij Dhimitër Cipos, - i shkruante A. Xhuvani mikut të tij, L. Nosit – qi me të vojtun mësues në Valësh e me u përpjekun me ata pleqt e katundit, qi ta qasin e t’i çojnë çunat. Në qoftë se nuk e hapin shkollën keq do t’ju bjerë atyne, pse Ministrija nuk ka me hapun shkollë tjetër në katundet përreth”.<sup>684</sup>

Gjatë kohës që parlamenti ishte me pushime ndodhën një sërë ngjarjesh të rëndësishme në jetën shqiptare mes të cilave dallohet krijimi i federatës “Atdheu” dhe shumë degëve të reja të saj. Në prill të vitit 1921 Lef Nosi merr pjesë në kongresin që u mbajt në Vlorë, me iniciativën e Avni Rustemit. Kongresi u mbajt në ndërtesën e kinemasë së qytetit ku u mbledhën 47 delegatë të 25 shoqërive shqiptare dhe përfaqësues nga 15 krahina të ndryshme.<sup>685</sup> Secila shoqëri delegoi nga një deri në tre përfaqësues, kurse qytetet ku nuk kishte shoqëri, bashkitë vendore dërguan përfaqësuesit e vet.<sup>686</sup> Pjesëmarrja e gjerë nga treva të ndryshme shqiptare i dhanë kësaj ngjarje një karakter mbarëkombëtar dhe kongresi mori pamjen e një parlamenti ku përfaqësohej e gjithë Shqipëria, nëpërmjet personaliteteve përparimtare më në zë të kohës,<sup>687</sup> mes të cilëve dallohet edhe L. Nosi të cilit iu ngarkua kryesija e Kongresit duke u zgjedhur *chairman* <sup>688</sup>i tij.

<sup>682</sup> Po aty, fq. 145

<sup>683</sup> Puto, Arben. *Shqipëria politike...*, Tiranë, 2009, fq. 327

<sup>684</sup> AME, F. 20, D. 10, nr. 8, f. 1, dt. 10 korrik 1921

<sup>685</sup> Dervishi, Kastriot. *Historia e shtetit shqiptar 1912-2005*, Tiranë, 2006, fq. 137

<sup>686</sup> Gurakuqi, Romeo. *Shqipëria dhe çështja shqiptare pas Luftës së Parë Botërore*, Shkodër, 2007, fq. 220

<sup>687</sup> Po aty, fq. 221

<sup>688</sup> AQSH, F. 32, D. 170, f. 5

Kongresi më 25 prill 1921, mori vendimin për krijimin e qendrës së madhe të Federatës, me karakter arsimor, kulturor e politik, të quajtur “Atdheu”, që erdhi si rezultat i bashkimit të më shumë se 20 shoqatave të ndryshme. Federata “Atdheu” nxori edhe organin e saj me të njëjtin emër e miratoi edhe një statut të përbërë nga 7 kapituj dhe 42 nene.<sup>689</sup> Për hartimin e statutit të federatës u zgjodh një komision i përbërë nga: Lef Nosi, Mustafa Kruja, Karl Gurakuqi, Dhimitër Berati, Avni Rustemi, Ahmet Dakli, Dr. Sezai Çomo e Sait Qemali. Mbas shumë diskutimesh, Komisioni i hartimit të statutit vendosi që federata të quhej “Atdheu” dhe që kjo organizatë të mos merrej me politikë, por vetëm me kulturë, që shoqëritë e deriatëhershme të vareshin nga Qendra e Përgjithshme, të mbante secila emrin e vet, por pranë të kishin emrin e federatës.<sup>690</sup> Gjithashtu u hartua edhe një program në të cilin federata “...zotohej që nëpërmjet arsimit, fjalës së lirë e të shtypit të përpiqej për përparimin ekonomik e shoqëror të vendit dhe për pavarësinë e tij ekonomike;”<sup>691</sup> Ndër të tjera në pikat e statutit u theksua se Federata do të kujdesej me të gjitha mjetet për krijimin e një teatri kombëtar, të merrte masa për mbajtjen në këmbë të bandave muzikore, të themelonte biblioteka dhe të luftohej mendësia e vjetër e të ruheshin zakonet e bukura shqiptare.<sup>692</sup>

Kur Këshilli Kombëtar filloi punimet u diskutua edhe për mbledhjen që ishte mbajtur në Vlorë, në 25-28 prill, madje deputetët miratuan edhe një ndihmë financiare për këtë federatë, e cila u hoq pak kohë më vonë.<sup>693</sup> Si kryetar i kongresit që vendosi formimin e federatës “Atdheu”, L. Nosi do t’i shkruaj federatës “Vatra” në Korçë për t’i dhënë lajmin. “ Kongresi i Bashkimit kombëtar pagëzoi shoqërinë e re me emrin Atdheu. – do të shkruante ai në pranverën e 1921-it, - Urojmë të gjithë anëtarët për patriotizmin e lartë që treguan duke marrë pjesë në bashkim. Rroftë shoqëria Atdheu!”<sup>694</sup> Njëkohësisht ai njoftoi edhe Kol Tromarën, që në atë kohë ishte prefekt në Gjirokastër, se ishte zgjedhur kryetar i shoqërisë “Atdheu” ku merrnin pjesë edhe Bedri Pejani, Ahmet Dakli, Said Kemali e Karl Gurakuqi.<sup>695</sup> Degë të kësaj Federate u krijuan në qendrat më të rëndësishme të vendit, me qëllim përhapjen e arsimit edhe në zonat më të thella të vendit. Me këtë qëllim, L. Nosi bashkë me Ahmet Daklin, si delegatë të kongresit, kthehen në Elbasan për të ngritur aty degën e kësaj Federate dhe bëjnë këtë njoftim: “Janë të lutur të gjithë anëtarët e shoqërisë Afërdita e Përparimi të mbledhen në Kafën e Madhe për të formuar qendrën e këtushme të Federatës së madhe Atdheu”.<sup>696</sup> Fillimisht Federata u mbështet financiarisht nga qeveria e cila pak kohë më vonë vendosi ta ndërpresë ndihmën mujore. Idetë përparimtare që Federata proklamonte nuk do ta kishin të lehtë të mbijetonin përballë politikave qeveritare të kohës të cilat fillimisht kufizuan me ligj lirinë e shtypit dhe më pas ishte qeveria që urdhëroi mbylljen e shumë degëve të saj duke e bërë të pamundur mbijetesën e kësaj

<sup>689</sup> Dervishi, Kastriot. *Historia e shtetit shqiptar 1912-2005*, Tiranë, 2006, fq. 138

<sup>690</sup> Gurakuqi, Romeo. *Shqipëria dhe çështja shqiptare...*, Shkodër, 2007, fq. 221

<sup>691</sup> *Historia e popullit shqiptar III*, Tiranë, 2007, fq. 203

<sup>692</sup> Gurakuqi, Romeo. *Shqipëria dhe çështja shqiptare...*, Shkodër, 2007, fq. 221

<sup>693</sup> Dervishi, Kastriot. *Historia e shtetit shqiptar...*, Tiranë, 2006, fq. 138

<sup>694</sup> AQSH, F. 32, D. 190, f. 1

<sup>695</sup> AQSH, F. 32, D. 170, f. 5

<sup>696</sup> Po aty, D. 159, f. 32

federate. “Qeveria qendrore në bazë të programit të paraqitur nga Federata “Atdheu” kishte pranuar pagimin e një ndihme të përmujshme të vendosur edhe prej Këshillit Kombëtar. Këshilli Ministrues, tue pamë qi Shoqnia në fjalë me gjithë qi nuk mundi me kurr një mënyrë me përmbush pikat e programit të vet mbi bashkimin e klubeve të ndryshme të shtetit, ... po e mbetun në influencën e disa personave filloj me u përziepër së tepri në çdo punë politike, vendosi qi t’i pritet qysh prej ditës së sodit (sotme - E. A) ndihma mujore e dhanun deri tash...”.<sup>697</sup>

Edhe pas zgjedhjeve të vitit 1921 situata politike në vend vazhdonte të paraqitej jo e sigurt. Në korrik ishte bërë e ditur formimi i “Republikës së Mirditës”, e drejtuar nga Marka Gjoni i cili, nën goditjen e trupave qeveritare, u tërhoq përtej Drinit. Ndërsa në kufi vihej re përqëndrimi i trupave greke e jugosllave. Një situatë e tillë nuk ishte aspak në interes të çështjes kombëtare në një kohë kur rreziku i jashtëm ishte evident e kërcënues dhe gjendja e brendshme karakterizohej nga mungesa e stabilitetit. Aspak e mirë nuk paraqitet situata për Shqipërinë edhe në tryezën e diplomacisë evropiane ku çështjes shqiptare ende nuk po i jepej një zgjidhje e drejtë e përfundimtare. Në verën e vitit 1921, gjendjen e vështirë të qeverisë shqiptare, u përpoq ta shfrytëzojë përsëri Athina për të ripohuar synimet e saj mbi Shqipërinë Jugore përmes shfrytëzimit të tezës së prishjes së neutralitetit shqiptar gjatë luftës nga Esad Pasha të cilin ajo vazhdonte ta konsideronte si sundimtar të Shqipërisë gjatë konfliktit botëror. Zhvlerësimi që i bëri kësaj teze Noli në fjalën që ai mbati në mbledhjen e Këshillit të Lidhjes, në 25 qershor 1921,<sup>698</sup> u mbështet fort edhe nga populli i Elbasanit i cili, në 13 korrik 1921, do të mbledhet në një miting të madh, në sheshin Namazgjah të qyteti, të organizuar nga patriotët elbasanas mes të cilëve edhe Lef Nosi. Drejtuesit e mitingut theksuan se diplomacia e vendeve fqinje po përpiquej të përgatiste plane aneksioniste për copëtimin e atdheut, duke shpërfillur vendimet e Konferencës së Ambasadorëve për “njohjen e kufijve të Shqipërisë”, në korrik të vitit 1913. Të indinjuar nga këto pazarllëqe, u aprovua njëzëri dërgimi i telegrameve, drejtuar sekretariatit të Lidhjes së Kombeve dhe zyrës së shtypit në Paris, si vijon: “...Populli i kësaj krahine i mbledhun sot në një miting të madh, pa dallim feje, deklaroi, se nuk ka me e leju kurrë një ndukje të kufijve të 1913-ës, për të cilat, ka me u betue me vdekë...”.<sup>699</sup> Telegrami është firmosur nga Dervish Beu (Biçakçiu), Lef Nosi, Dhimitër Dhimitruka, Dhimitër Papajani, Beqir Plangarica, Ibrahim Bumçi, Emin Haxhiademi, dr. Simon Popa e Nikolla Andoni.

Kjo situatë do të gjejë pasqyrim edhe në punën e kabinetit qeveritar ku kishin filluar të viheshin re edhe përpjekje për reformimin e tij, fakt ky që dëshmohet edhe gjatë korespondencës mes dy patrioteve elbasanas, A. Xhuvanit dhe L. Nosit. “Deri në këtë minutë – i shkruante A. Xhuvani mikut të tij, L. Nosit,-

<sup>697</sup> “Dit’ e Re”, Tiranë, 17 qershor 1922, f. 3

<sup>698</sup> Puto, Arben. *Shqipëria politike...*, Tiranë. 2009, fq. 303

<sup>699</sup> Gazeta “Shkumbini”, Elbasan, nr. 27, 15 korrik 1921



divergjenca vijon e nuk dihet se si ka me marr puna”.<sup>700</sup> Veç kësaj Iliaz Vrioni, që vuante nga probleme shëndetësore, nuk mund ta drejtonte vendin përmes stuhisë që pritej të niste. Në tetor ai jep dorëheqjen dhe formohet qeveria e re e Pandeli Evangjelit. U shpall mobilizimi i përgjithshëm për mbrojtjen e kufijve veriorë të Shqipërisë. Ndërkohë veprimet e Jugosllavisë sollën një qëndrim të ri të Britanisë së Madhe e cila e njohu “qeverinë shqiptare si qeveri *de jure* të të gjithë Shqipërisë”.<sup>701</sup> Më 9 nëntor 1921, Konferenca e Ambasadorëve, më në fund, shpalli vendimin e saj në lidhje me kufijtë e Shqipërisë. Pas 10 ditësh, komisioni hetimor i Lidhjes së Kombeve arriti në tokën e shtetit shqiptar ku problemet ishin të shumta.

Gjatë kësaj kohe nisi të zbatohet ligji organik i arsimit që synonte të disiplinonte organizimin shkollor dhe mënyrën e shpërndarjes së bursave për studimet jashtë shtetit, u krye riorganizimi i Normales së Elbasanit, ishte zgjeruar rrjeti i shkollave fillore në vend dhe ishte rritur numri i mësuesve që jepnin mësim në këto shkolla.<sup>702</sup> Por kjo nuk i kishte dhënë fund problemeve të arsimit në vend. “*I dashuni Lef! Punët e arsimit, ka 3 muaj e tëhu, qi nuk po venë mirë fare* – do të shkruante gjithë shqetësim A. Xhuvani në letrën që i dërgonte L. Nosit në nëntor të atij viti, - *Janë hap shkolla pa nevojë, janë emnu mësues pa zotësi, janë dërgu në Evropë bursiarë pa aftësi, janë shpërngul andej e ktej mësues pa ndonji nevojë e kto të gjitha janë ba pas kapriçës së ndonji deputeti e pas gjykimit të ndonji të pazoti*”.<sup>703</sup> Në situatën e ndryshimit të kabineteve dhe krizave qeveritare, për A. Xhuvanin do të lërë postin e zëvendësministrit të arsim dhe do të kthehet në Elbasan për të marr në dorë drejtim e shkollës Normale gjatë vitit shkollor 1922-1923.

Në dhjetor kabineti i “Bashkimit të Shenjtë” dha dorëheqjen. Aqif Pashë Elbasani, në mungesë të dy anëtarëve të tjerë të Regjencës, të cilët ishin jashtë vendit, emëroi kryeministër Hasan Prishtinën i cili nuk kishte mbështetje të gjerë në opinionin publik. Ndaj pas 4 ditësh ai dha dorëheqjen dhe u formua qeveria e Xhaferr Ypit, kurse Aqif Pasha e Mihal Turtulli u ftuan të largoheshin nga vendi. Aqif Pasha, bashkë me fuqinë e tij prej 250 vetësh, tërhiqet në Elbasan ku ende nuk i shpërndan forcat edhe pas kërkesës së qeverisë. Në Elbasan ai pati përkrahjen edhe të mikut e këshilltarit të tij, Lef Nosit, e që të dy shpresonin se së shpejti do niste një kryengritje nën drejtimin e Bajram Currit, Elez Isufit, Halit Lleshit e Hamid Toptanit.<sup>704</sup> Shkak ishte bërë politika e Ministrit të Brendshëm, Ahmet Zogut, i cili kishte vendosur të çarmatoste popullsinë civile, masë e cila u kundërshtua nga malësorët e Shqipërisë Veriore. Në shkurt të vitit 1922, Bajram Curri nisi organizimin e kryengritjes e cila u përhap edhe në Dibër ku Elez Isufi bashkon forcat e tij me kryengritësit. Në këtë kohë Hamid Toptani mori Durrësin dhe iu drejtua Tiranës, kurse Halit Lleshi kaloi kufirin nga Jugosllavia por u s’mbraps nga trupat qeveritare. Dikur në të njëjtin front lufte, sëbashku në përpjekjet për organizimin e Kongresit të Dytë të Elbasanit (1916), tashmë orientimet politike

<sup>700</sup> AME, F. 20, D. 10, nr. 8, f. 1

<sup>701</sup> Swire, Joseph. *Shqiptarët...*, Tiranë, 2005, fq. 293

<sup>702</sup> Dervishi. Kastriot. *Historia e shtetit shqiptar...*, Tiranë, 2006, fq. 187

<sup>703</sup> AME, F. 20, D. 10, nr. 8, f. 2, dt. 21 nëntor 1921

<sup>704</sup> Vllamasi, Sejfi. *Ballafaqime politike...*, Tiranë, 1995, fq. 193

të Lef Nosit dhe Ahmet Zogollit do të ndjekin dy rrugë të ndryshme, të cilat në rrjedhën e tyre do të njohin si përplasje edhe bashkëjetesë. Pas shtypjes së kryengritjes, Ministri i Brendshëm, me ndikim mbizotërues në qeveri, iu përvesh punës për vendosjen e rendit. Në qershor të vitit 1922, qeveria e Xh. Ypit vendosi të shpërndajë Federatën “Atdheu” në vend të së cilës, në tetor, do të formohet organizata “Bashkimi” me qendër në Tiranë, e drejtuar nga Avni Rustemi,<sup>705</sup> që u bë baza kryesore e mbështetjes së forcave opozitare të cilat kërkonin t’i jepnin fund klasës politike që vazhdonte të qëndronte në pushtet. Në verën e vitit 1922, në Tiranë u organizua kongresi i II-të arsimor në të cilin Lef Nosi ishte ftuar si anëtar nderi bashkë me M. Frashërin, B. Pejanin, T. Toçin e L. Gurakuqin. Por për shkaqe udhëtime ai dhe L. Gurakuqi nuk arritën të marrin pjesë në këtë kongres.<sup>706</sup> Në dhjetor Zogu ishte bërë kryeministër i qeverisë shqiptare.

Ndërsa viti 1922 mbyllet relativisht i qetë, në fillim të vitit 1923 u rishfaqën mosmarrëveshjet e brendshme. Megjithatë i njohur për kontributin e tij në mbrojtje të çështjes dhe kulturës kombëtare, angazhimin e tij në mbledhjen dhe ruajtjen e dokumentave historike e gjuhësore, i vlerësuar si njohës e propagandues i vlerave kombëtare, në prill të 1923 L. Nosi do të emërohet nga prefektura e Elbasanit si anëtar i komisionit që ishte krijuar për t’u vendosur emra shqip atyre fshatrave që thërriteshin në gjuhë të huaj.<sup>707</sup> Ndërsa një muaj më vonë ai zgjidhet nga shumica e popullsisë së qytetit si anëtar i komisionit që do të merrej me mbledhjen e ndihmave për ngritjen e një spitali civil në Elbasan.<sup>708</sup> Epidemia e kolerës dhe e gripit spanjoll që kishin shpërthyer në qytet gjatë viteve 1915-1918 dhe tërmeti i fuqishëm i dhjetorit të 1920-ës, kishin lënë pas pasojë që pjesa më e madhe e popullsisë vazhdonte ti vuante. Një panoramë të qartë të gjendjes në Elbasan na e jep edhe shkrimi i M. Gramenos në gazetën “Koha” pas një udhëtimi që ai kishte kryer në Elbasan në verën e vitit 1923. “Elbasani kishte ndryshuar, nga njëra anë ndërtesa të prishura nga tërmeti, nga ana tjetër ishin ngritur godina të reja e të bukura. Mespërmes një bulevard i gjerë përshkonte qytetin...Shefqet Be Vërlaci si kurdoherë përkujdesjen e tij e ka tek kopështi, një kopsht që nuk e kish tjetër në Shqipëri. Dervish Beu merret me bujqësi dhe kish ngritur e zbukuruar një kopsht jashtë qytetit. Shtypshkronja ka përfunduar e gjitha dhe dita-ditës përmisohet nën kujdesin e z. Lef Nosi. Një krizë e madhe mbretëronte edhe në Elbasan”.<sup>709</sup> Në verën e v.1923 shenjat e rebelimit në vend erdhën duke u shtuar dukshëm ndërsa ishte thelluar së tepërmi hendeku mes liberalëve e konservatorëve. Sikurse e vë në dukje edhe studiuesja M. Vickers edhe nga të huajt që vinin në Shqipëri evidentohet se shumica e myslimanëve e kishin shumë të theksuar ndjenjën e epërsisë ndaj të krishterëve. Madje, sikurse ajo thekson, një nga shkaqet

<sup>705</sup> Puto, Arben. *Shqipëria politike...*, Tiranë, 2009, fq. 328

<sup>706</sup> Dervishi, Kastriot. *Historia e shteti shqiptar...*, Tiranë, 2006, fq. 187

<sup>707</sup> AQSH, F. 32, D. 14, f. 1

<sup>708</sup> Po aty, f. 3

<sup>709</sup> Gazeta “Koha”, Korçë, 28 korrik 1924, f. 1

kryesore të pakënaqësisë midis të krishterëve ortodoks ishte fyerja e tyre nga çifligarët mysliman dhe trajtimi me përparësi nga ish zyrtarët osman.<sup>710</sup>

Ndërsa në vend po rritej pakënaqësia, për të stabilizuar pozitën e vet në pushtet, Zogu vendosi të thërrasë zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese. Në shtator doli ligji për zgjedhjet e reja që do të zhvilloheshin në dy shkallë, me zgjedhës të parë e të dytë. Në fushatën elektorale opozita u paraqit me shumë grupime politike. Gjatë vjeshtës së v. 1923 vendi hyri në një luftë të ashpër politike elektorale, që mori fund vetëm në dhjetor të atij viti. Gjatë kësaj fushate zgjedhore në Elbasan vepronin dy grupe politike: “Klubi Pleqësor” i drejtuar nga Shefqet Vërlaci dhe grupi politik “As i Pashës, as i Beut” i themeluar, sipas informacionit të përcjellë nga gazeta “Ura e Shkumbinit”, në 26 tetor të vitit 1923 nga demokratët elbasanas Lef Nosi, Ahmet dakli, Rrapush Demeti, Abdulla Atai, Tahsim Myftiu, Hysen Plangarica, K. Shabani, Mustafa Kotherja, Qamil Shkodra, Ibrahim Hostopalli e Thanas Floqi. Të mbledhur në katin e sipërm të kafenesë “Shkumbini” ata vendosën: “**1-** Formimin e një grupi me emënin “As e Pashës as e Beut”, për me punuem qi delegatët e Asamblesë, të Prefekturës t’onë të përfaqësojnë mendimin e popullit e jo të përsonavet. **2-** Vendi ku grupi ka qendrën e vet të përkohshme asht dhoma e sipërtregueme. **3-** Këshilli i përkohshëm i këtij grupi përbahet prej z. Rrapush Demeti kryetar, Lef Nosi e Ahmet Dakli anëtarë e Mustafa Kothere sekretar”.<sup>711</sup> Ky grup i premtonte popullit “shpëtim nga mjerimi, lumturi e ditë të bardha ...Partija Pleqësore asht e Beut dhe partija As e Pashës as e Beut asht e popullit, me popullin e për popullin”.<sup>712</sup> Ky klub elektoral përfaqësonte një grupim politik e jo një parti, çka dëshmohet edhe nga njoftimi në gazetën “Ura e Shkumbinit”, e cila shërbente si organ i shtypit të këtij klubi (pa arritur shkallën e organizimit partiak). Në faqet e kësaj gazete ky grupim paraqiti edhe programin e tij elektoral që ishte më pranë vegjëlisë dhe mbështetës i opozitës demokratike në vend. Ky program, i ngjashëm me atë të një partie elektorale, përcaktonte se për formën e regjimit “kandidatët e grupit janë të lirë të veprojnë sipas rrjedhës së bisedimeve në Kuvendin Kushtetues; sovraniteti i popullit të sigurohej përmes Parlamentit Kombëtar: sistemi i votimit të jetë i drejtpërdrejtë dhe i fshehtë: parimet demokratike të lirisë, vllazërisë, barazisë e bashkimit të jenë bazë e shtetit shqiptar; liri e plotë e fjalës, ndërgjegjes, shtypit, mbledhjes e shoqnimit; pavarësi e plotë e institucioneve të Drejtësisë; rregullimi i çështjes agrare; rrëzimi i ndikimit feudal: liri e besimit fetar...”.<sup>713</sup> Me një thirrje të posaçme në faqet e kësaj gazete, ky grup demokrat iu drejtua popullsisë së Elbasanit, Çermenikës, Mokrës, Shpati, Dumresë, Krrabës, Grykës së Zaranikës, Peqinit, Darsisë, Malësisë së Vërçës e Sulovës që të përkrahnin në votime përfaqësuesit e këtij grupi që kishte për qëllim të dërgonte në Asamblenë Kushtetuese zërin dhe mendimin e popullit dhe jo të Pashës e të Beut. “...në Elbasanin plak, ka, rron dhe vlon një shpirt i lirë, një ide kombëtare; shpirt qi frymëzoi disa atdhetar ti


<sup>710</sup> Vickers, Miranda. *Shqiptarët –një histori modrene*, Bota shqiptare, 2008, fq. 173

<sup>711</sup> Gazeta “Ura e Shkumbinit”, 2 vjeshtë e III-të, 1923, Elbasan, f. 5

<sup>712</sup> Po aty.

<sup>713</sup> Po aty

përvishen punës për ngritjen e kësaj partie elektorale e cila do të përpiket që në zgjedhjet e afërme populli të drejtojë vetfeten e tij ...dhe të shpëtojë nga thonjtë e pamëshirshëm të feudalizmit”.<sup>714</sup> Si përfaqësues i këtij grupimi, L. Nosi figuron në listën e zgjedhësve të dytë të qytetit të Elbasanit. Gjatë zhvillimit të fushatës zgjedhore ky grup, përmes organit të tij të shtypit, ngriti shpesh zërin kundër shkeljes së lirisë së mendimit e të ndërgjegjes, kundër dhunës së përdorur ndaj popullsisë së thjeshtë dhe manipulimeve të bëra nga forcat në pushtet. Ky qëndrim do të bëhet shkak që ai shpesh të thërritet në gjyq, nga Gjykata Hetuese e Elbasanit, herë për shkaqe të deklaruara e herë të përfshira në një shprehje të vetme: “landa e padijes – Qëllim i keq”.<sup>715</sup> Këto veprime të forcave në pushtet nuk e smbrapsën Lef Nosit nga beteja politike që kishte nisur dhe ai pa hezitim do të ngrejë zërin kundër parregullsive të vëna re gjatë zgjedhjeve dhe do të kërkojë zhvillimin e zgjedhjeve të reja: “Për shkak të çrregullimeve dhe ndërhyrjeve arbitrare i paraqesim zotërisë suaj, Kryetarit të Komisionit të zgjedhjeve, këtë protestë ...dhe në emër të ligjit kërkojmë anulimin e zgjedhjeve të bëra, duke urdhëruar fillimin e zgjedhjeve të reja, me komision e sekretar të paanshëm, me liri të plotë e pa pengime”.<sup>716</sup> Megjithatë në zgjedhjet e dhjetorit opozita, që mbështetej nga ky grupim politik elektor, nuk arriti të fitojë. Me përfundimin e zgjedhjeve ky grupim pushoi së vepruari. Tashmë Lef Nosi iu vu punës për të nxjerrë në dritë thesarin e mbledhur prej vitesh dhe në muajt e parë të vitit 1924 ai do të botojë “Dokumenta Historike për t’i shërbye historisë tonë kombëtare”, një revistë historike e përmuajshme e cila doli në 13 numra.<sup>717</sup> Ky botim do të përmbledhë dokumenta të periudhës 1912-1918, etapë historike e cila u ndriçua në shumë aspekte të saj nga kjo pjesë dokumentore e ruajtur me aq fanatizëm nga Lef Nosi. Aty pasqyroheshin materiale të shpalljes së pavarësisë kombëtare, veprimtarisë së qeverisë së Vlorës,



luftërat ballkanike, periudhës së drejtimit të shtetit shqiptar nga Princ Wied-i, pushtimi serb, austriak, italian, i tokave shqiptare, punimet dhe vendimet e Kongresit të Durrësit etj. Sikurse është shprehur edhe vet Lef Nosi në parathënien e kësaj reviste historike, qëllimi i këtij botimi ka qenë “me qitë në dritë ngjarje që përfytyrojnë fazat e ndryshme t’evolucionit politik të këti vendi”.<sup>718</sup> Shumë dokumente të kësaj periudhe ishin në gjuhën turke, ndaj gjatë procesit të botimit të tyre në revistën e përmuajshme L. Nosi mori përsipër e realizoi përkthimin e tyre në gjuhën shqipe. Për këtë punë madhore Ahmet Dakli do të shkruajë në gazetën “Ura e Shkuminit”, që ai vetë e drejtonte: “Z. Lef Nosi ka pas një kujdes të madh e një durim të fortë

<sup>714</sup> Po aty, f. 6

<sup>715</sup> AQSH, F. 32, D. 3, f. 1-2-3

<sup>716</sup> AQSH, F. 32, D. 54, f. 8

<sup>717</sup> Floqi, Thanas. *Fytyra e vërtetë e Haxhi Qamilit*, Tiranë, 2008

<sup>718</sup> “Dokumenta historike...”, vepër e cituar, Parathanje, fq. 9

për të mbledhur dokumenta historike me randësi të madhe për Rilindjen kombëtare. Në këto dokumenta më tepër parashtrohen fazat e ndryshme të jetës shtetërore të Shqipërisë prej 1912-ës e këtej. Kjo vepër, që përmban një visar të paçmushëm dokumentash, meriton të lexohet me kujdes prej çdo shqiptari që dëshiron të dijë ngjarjet ma me randësi t'atdheut t'vet".<sup>719</sup> Pas rrëzimit të qeverisë së Nolit, L. Nosi si kryetar bashkie në Elbasan, i emëruar nga qeveria, u largua nga detyra dhe pak muaj më vonë<sup>720</sup> revista historike nuk do të vazhdoj të botohet më.

#### IV-3. Lef Nosi në krye të bashkisë së Elbasanit

Ndërkohë në zgjedhjet e dhjetorit të 1923-it grupimi prozogist kishte arritur të siguronte shumicën e vendeve në Asamblenë Kushtetuese e cila nisi punimet në janar të vitit 1924. Këto zgjedhje i mundësuan Zogut postin kryeministrit, por nuk e qetësuan lëvizjen opozitare e cila nisi të kërkojë rrëzimin e qeverisë. Lufta politike u acarua në kushtet e keqësimit të gjendjes ekonomike. Për të fituar kohë, Shefqet Vërlaci, tashmë në vendin e kryeministrit pas atentatit të 23 shkurtit ndaj Zogut, pranoi t'i japë opozitës disa vende në qeveri. Por ndërkaq atentati, me pasojë vdekjen, ndaj Avni Rustemit, në prill të v. 1924, e çoi krizën në kulm dhe u bë shkak i kundërvënies së forcave opozitare ndaj kabinetit qeveritar. Lef Nosi, Ahmet Dakli, H. Plangarica e nacionalistë të tjerë do të shfrytëzojnë organin zyrtar të grupit opozitar në qytet, gazetën "Ura e Shkuminit", për të shprehur dhimbjen për humbjen e "zemrës së nacionalizmit të vendit tonë, prijësit të idealistëve të Arbërisë fatkeqe e shtyllës së demokracisë...".<sup>721</sup> Ditën e varrimit të Avni Rustemit, L. Nosi ka qenë në Vlorë si përfaqësues i popullit të Elbasanit, si i deleguar i Bashkisë së Elbasanit por me sa duket në këtë ceremoni e ngjarjet që e pasuan atë L. Nosi duhet të jetë pozicionuar në krahun opozitar duke u atakuar me organet e pushtetit vendor. Kjo duket në njoftimin e dt. 3 maj 1924 të Kryetarit të Bashkisë së Elbasanit, Kasem Sejdit, i cili në faqet e gazetës "Republika" do të njoftojë: "Ende bashkija e jonë e ka deklarue se një nga delegatët e saj, që e pat çue në ceremoninë e heroit kombëtar Avni Rustemit, z. Lef Nosi, nuk ka kompetencë e tagër me firmue e me e përzie me punë të tjera mendimin e Elbasanit."<sup>722</sup> Të njëjtin veprim kishin ndërmarrë edhe bashki të tjera në vend, përfaqësuesit e të cilave në Vlorë duket se ishin rreshtuar në krah të forcave opozitare. Kjo të bën të kuptosh se L. Nosi kishte shkuar përtej detyrës së përfaqësimit të Bashkisë së Elbasanit në varrimin e një prej figurave kryesore të opozitës parlamentare dhe ishte përfshirë në lëvizjen opozitare që kishte nisur në Vlorë. Por çfarë kishte ndodhur në Vlorë? Në 21 prill 1924, pas atentatit ndaj A. Rustemit, një miting i madh prej 5000 vetësh ishte organizuar në këtë qytet nga krahun opozitar ku ky atentat ishte konsideruar një komplot dhe njëkohësisht i ishte dërguar një telegram

<sup>719</sup> Gazeta "Ura e Shkuminit", Elbasan, 12 prill 1924, f. 2

<sup>720</sup> Numri i fundit i kësaj reviste historike daton në shkurt të vitit 1925.

<sup>721</sup> Gazeta "Ura e Shkuminit", Elbasan, 20 prill 1924, f. 1

<sup>722</sup> Gazeta "Republika", Shkodër, 5 maj 1924, fq. 4

Këshillit të Lartë, Kryesisë së Asamblesë dhe Qeverisë në të cilin kërkohet zbulimi i vrasësve dhe largimi i Asamblesë nga Tirana. Gjithashtu organizatorët e mitingut ishin shprehur se mosrealizimi i këtyre kërkesave do të shoqërohej me mungesën e besimit të popullit për Qeverinë në pushtet.<sup>723</sup> Pas varrimit të A. Rustemit në sallën e bashkisë së Vlorës përfaqësuesit e krahut opozitar organizuan tre mbledhje, më 1 e 2 maj 1924 nga ku u konsolidua ideja e fillimit të një kryengritje të armatosur. Në mbledhjen e parë kryetari i saj, Fan Noli, propozoi krijimin e një komisioni që do të përfaqësonte çdo prefekturë dhe që do t'i bashkëngjitej 26 deputetëve që po zhvillonin këtë mbledhje. Anëtar i këtij komisioni si përfaqësues i prefekturës së Elbasanit u zgjodh edhe Lef Nosi. Nga kjo mbledhje u dërguan dy telegrame drejtuar organeve shtetërore qendrore, bashkive e gazetave, të cilat kryeministri, Sh. Vërlaci, i kishte konsideruar “letra të mbërritura nga njerëz që nuk kishin asnjë përfaqësim”.<sup>724</sup> Pikërisht për këtë veprim bashkia e Elbasanit e konsideron kapërcim të kompetencave të L. Nosit në Vlorë. Në këto kushte kur opozita ishte e vendosur të merrte pushtetin edhe me anë të forcës, L. Nosi merr rrugën e kthimit nga Vlora, kalon në Fier dhe në 8 maj 1924 mbërrin në Elbasan.<sup>725</sup>

Për shkak të përplasjeve të forta politike në vend, në përgjithësi, e në Elbasan, në veçanti, Lef Nosi do të përjetojë një situatë jo të mirë shëndetësore. Depresioni shpirtëror që ai po kalonte e gjente burimin edhe tek shqetësimi mbi gjuhën e ashpër që qeveria kishte zgjedhur të përdorte për të goditur forcat e opozitës. I. Vrioni, kryeministri i qeverisë së re të krijuar në 30 maj 1924 pas dorëheqjes së Sh. Vërlacit, kishte filluar përgatitjet për operacionin antikryengritje duke caktuar në 1 qershor Ahmet Zogun komandant të këtij operacioni për veriun dhe Mustafa Arianitasin për viset e jugut.<sup>726</sup> Lajmet e gazetave ishin kontradiktore, me akuza nga të dyja palët, që e çorodisnin mendjen e njerëzve dhe ndikonin në njëfarë mënyre edhe në gjendjen shpirtërore të Lef Nosit. Mjekët e këshilluan të pushonte për disa kohë.<sup>727</sup> Por tashmë i ndodhur në zemër të “vorbullës” politike ai nuk ishte i zoti as të rrinte e të vazhdonte kurën dhe as të nxiste një situatë që mund të prodhonte rreziqe edhe më të mëdha. Tashmë që rreziku i jashtëm ishte kapërcyer dhe ishte arritur konsolidimi i pozitave ndërkombëtare të shtetit shqiptar, punët e brendshme nuk po shkonin aspak mirë.

Në maj krahu i armatosur i forcave opozitare nisi kryengritjen dhe më 10 qershor opozita hyri në Tiranë. Që në momentet e para të triumfit, Prefektura e Elbasanit i kërkon Lef Nosit të zërë vendin e kryetarit të Bashkisë,<sup>728</sup> Por si një veprimtar i organizimit të një shteti sipas modeleve të përparuara të perëndimit ai e dinte se si kryetar bashkie nuk mund të emërohesh por duhesh zgjedhur nga vetë populli. Ndaj katër ditë më vonë, në 14 qershor 1924, ai jep dorëheqjen kërkesë e cila nuk pranohet nga Prefektura e

<sup>723</sup> Po aty, 25 prill 1924

<sup>724</sup> Dervishi, Kastriot. *Historia e shtetit shqiptar...*, Tiranë, 2006, fq. 210-211

<sup>725</sup> AQSH, F. 32, D. 30, f. 13

<sup>726</sup> Gazeta “Shqipëri e Re”, 15 qershor 1924

<sup>727</sup> AQSH, F. 32, D. 2, f. 1

<sup>728</sup> AQSH, F. 32, D. 16, f. 3



qytetit e cila këmbëngul në kërkesën e saj ndaj Lef Nosit.<sup>729</sup> Pas shumë hezitimesh dhe me kërkesën e rretheve intelektuale të Elbasanit, ai e pranon detyrën vetëm në muajin gusht (1924). Në këtë kërkesë thuhet: “Djelmëria intelektuale e Elbasanit, e cila e ka për nder e për lavdi tju ketë si prijs në çdo vepër të bukur, e lidhun me një fjalë e me një zemër e shef me udhë e po ju lutet sot nxehëtishtë qi të mos qëndroni në mendimin e parë, por të pranoni kryesinë e Bashkisë qi e bardha uzdaja e atdheut, djelmëria e populli mbarë i ktij qyteti, duke mos harru shërbimet e paçmuara që i keni sjellë çështjes kombëtare, e gjen të arsyshme me jua blatur”.<sup>730</sup>

Ndërkohë, në korrik, një parti nacionalistësh intelektualë e cila kishte marrë jetë pas mbledhjes së 28 prillit të 1924 në sallën e parlamentit shqiptar ku kishin marrë pjesë shumë shqiptarë nacionalistë, prej gati gjithë viseve shqiptare, dhe që kishte vendosur të organizonte një kongres në Tiranë në tetor të atij viti, i drejtohet dhe i kërkon mbështetje “Fort të Ndertit Z. Lef Nosi”.<sup>731</sup> Siç duket kjo parti kishte për qëllim organizimin e zgjedhjeve të parakohshme, zgjedhje të cilat tashmë, pas ngjarjeve të qershorit, për Lef Nosit kishin marrë një rëndësi akoma edhe më të madhe. Për të mbledhur të gjithë nacionalistët intelektualë në këtë kongres ishte zgjedhur edhe një komision i kryesuar nga K. Paftali, ku merrnin pjesë M. Kruja, Bahri Omari, Numen Ferizi, Nush Bushati e dr. Sabri Tefiku, i cili do të lajmëronte të gjithë patriotët për të zgjedhur delegatët për në kongres dhe për të përgatitur nga një program për t’ia paraqitur kongresit. Ishte ky komision që do të njoftojë L. Nosit se ishte emëruar (sëbashku me A. Daklin) organizator për zgjedhjet e zgjedhësve të dytë në prefekturën e Elbasanit, “...detyrë të cilën si patriot i njoftun, do të keni mirësinë ta pranoni e të na epni ndihmën tuaj të vlefshme”.<sup>732</sup> Kjo kërkesë u mirëprit prej L. Nosit i cili shpresat i kishte mbështetur tek ngritja e shtetit të ri mbi baza ligjore. Këto lëvizje politike i dhanë atij forcën për të punuar e për të marrë në dorë drejtimin e bashkisë së Elbasanit. Por as kongresi dhe as zgjedhjet nuk u bënë realitet.

Si kryetar bashkie ai ndoqi me kujdes punimet për pastrimin e rremave të ujit që kalonin në lagjet Alejdine dhe Bobolle të cilat influenconin në ndotjen e rrugëve që ndodheshin në pjesën lindore të qytetit.<sup>733</sup> Vendosi rregull për therjen e bagëtitve në vendet e caktuara nga Bashkia dhe kontrolloi respektimin e gramaturës së bukës nga njësitet tregtare të qytetit.<sup>734</sup> Prefektura e Elbasanit e emëroi anëtar të komisionit për ndërtimin e shkollës Normale dhe për ndërtimin e spitalit civil në Elbasan.<sup>735</sup> Për të kujtuar emrin e A. Rustemit, Këshilli Bashkiak vendosi që t’i vërë emrin e tij rrugës Kamo Sejдини, ndërsa rruga Meleq Frashëri mori emrin Dylgjer Hyseni. U ndërtua me kalldrëm rruga nga Tri Urat deri tek ndërtesa e fabrikës SAIDE.

<sup>729</sup> Po aty, f. 4

<sup>730</sup> Po aty, f. 5. Letra është e firmosur nga Kostaq Cipo, Ymer Karaj, Fadil Gurmani, Halit Narazani, Behexhet Haxhiademi, A. Demiri, I. Shuteriqi, B. Ceka, O. Hoxholli, Demir Bunga e shumë të tjerë.

<sup>731</sup> Po aty, D. 15, f. 1

<sup>732</sup> Po aty, f. 3

<sup>733</sup> Po aty, D. 48, f. 3

<sup>734</sup> Po aty, D. 49, f. 7

<sup>735</sup> Po aty, D. 14, f. 8

Në fundin e verës së v. 1924 për Elbasanin doli një problem i ri, ai i shpërnguljes së Normales nga Elbasani në Shkodër dhe nuk ishte hera e parë që flitej për shpërnguljen e saj, madje nuk do të jetë as hera e fundit. Kjo kërkesë ishte shtruar edhe në v.1920, por pa sukses. Për një ndërmarrje të tillë, ideatorët e këtyre ndryshimeve nuk kishin diskutuar aspak dhe as nuk e kishin marrë parasysh mendimin e drejtuesve të qytetit e, aq më pak, të popullsisë vendase. Kjo bëri që L. Nosi të mendojë edhe mundësinë e largimit nga bashkia, pak ditë pasi e kishte pranuar atë vend.<sup>736</sup> Në këtë çast të vështirë për kultin e arsimit elbasanas, mes L. Nosit dhe A. Xhuvanit është zhvilluar një letërkëmbim i dendur që karakterizohej nga shqetësimi dhe gjetja e rrugëve përmes të cilave duhej vepruar. “Propaganda asht ba se Elbasani është me malarie – do t’i shkruante A. Xhuvani mikut të tij në Elbasan – dhe mësues e nxënës janë sëmuni dhe punë në shkollë s’bahet. Më ja kishin mbush mendjen njerzit edhe Gurakuqit e Vinjaut që të ngrihet Normalja nga Elbasani. Puna është me rrezik e çështja do bisedohet në kryeministri ndaj duhet të mbledhësh Këshillin e Belediesë (Bashkisë- E.A) e t’i çoni delegatë kryeministrit e Ministrisë së Arsimit për të rrëzu fjalët që thuhet për Elbasanin e më pas të bëni edhe një miting për të protestu”.<sup>737</sup> Në 16 gusht Këshilli Bashkiak kundërshtoi përpjekjet e qeverisë për transferimin e shkollës Normale duke argumentuar historikisht domosdoshmërinë e qëndrimit të saj në qytetin e Elbasanit.<sup>738</sup> Gjithashtu u vendos të organizohej edhe një demonstratë e madhe proteste. Në orën e caktuar tregu u mbyll dhe populli vërshoi nga të katër anët duke u grumbulluar në sheshin e Namazgjasë.<sup>739</sup> Kjo ishte hera e dytë, pas ngjarjeve të vitit 1920, që populli i Elbasanit protestonte për të njëjtën çështje. Ishte hera e dytë që patriotët elbasanas, në krye të popullsisë së qytetit e fshatrave përreth, ngrinin zërin për të mbrojtur ikonën e arsimit shqiptar që ishte lindur dhe rritur, me shumë sakrifica, në Elbasan. Mbas mbarimit të mitingut, populli i revoltuar u nis drejt zyrave të PTT-së, duke e detyruar drejtorin e saj të thërriste urgjentisht në telefon zësvendëskryeministrin, Sulejman Delvinën, për t’i bërë të ditur vendosmërinë e tij për të mbrojtur, edhe me armë, Normalen në Elbasan. Pasi morën premtimin nga zv.kryeministri se: “Normalja do të mbetet aty ku u hap për herë të parë”<sup>740</sup> demonstruesit u shpërndanë dhe Normalja nuk u shpërngul në Shkodër. Në krye të Bashkisë së Elbasanit, Lef Nosi do të aprovojë kërkesën e drejtorit të Normales, A. Xhuvanit, për sistemimin e saj përkohësisht në shkollën K. Kristoforidhi, në lagjen Kala, për aq kohë sa të përfundonte godina e re e Normales.<sup>741</sup> Gjatë kësaj kohe ai vazhdon të kontribuojë e të jetë ndihmëtar i shoqërisë “Bashkimi” në Elbasan, e drejtuar nga Ahmet Burburia,<sup>742</sup> shoqëri e cila ndonëse luftonte për “rrënjosjen e demokracisë së vërtetë”<sup>743</sup> nuk mori pjesë në qeverinë revolucionare por përgatitej për zgjedhjet e reja që duhej dhe pritej të organizoheshin. Ndonëse punon me ngulm për

<sup>736</sup> Po aty, D. 16, f. 2

<sup>737</sup> AME, F. 22, D. 10, nr. 6, f. 2

<sup>738</sup> AQSH, F. 32, D. 88, f. 27

<sup>739</sup> Kito. Petro, *Elbasani në luftë për çlirim*, Tiranë, 1971, fq. 51

<sup>740</sup> Po aty, fq. 52

<sup>741</sup> AQSH, F. 32, D. 89, f. 8

<sup>742</sup> Po aty, D. 21, f. 1

<sup>743</sup> Gazeta “Bashkimi”, 8 korrik 1924

realizimin e programit të propaganduar nga qeveria e re e Fan Nolit, për kryebashkiakun e Elbasanit ishte e qartë se bazat e shtetit nuk do të mund të ishin solide për sa kohë ato nuk ishin legjitimuar nga zgjedhjet e përgjithshme dhe demokratike, fakt i cili kishte prodhuar edhe mosnjohjen ndërkombëtare të shtetit shqiptar. Rreziku bëhej edhe më tepër evident në kushtet kur kundërshtarët e qeverisë vazhdonin të ishin aktivë jo vetëm në kufi, por edhe në vend. Në vjeshtë kudo filloi të flitej fort për organizimin e zgjedhjeve në vend. Në Tiranë u formuan dy parti politike: Partia Demokrat-Nacionale dhe Partia Radikal-Demokrate të cilat erdhën si një nevojë e kapërcimit të krizave të shpeshta politike në vend dhe përgatitjes së opinionit vendas për zgjedhjet e reja në vend. Kjo është fryma që përshkon edhe deklaratën që Partia Demokrat Nacionale i drejton popullit shqiptar përmes faqeve të gazetës “Koha”. “U bënë 12 vjet që Shqipëria ndodhet në një kaos t’ideve të ndryshme e që vuan ndënë influenza të personave t’hedhun në fushën e politikës prej rasjeve që ka krijuar koha në periudhat e rezikshme t’Atdheut të dashur....Ambicjet e pakufizuara nga nj’anë, egoizma e zemërimi nga ana tjetër, kanë qenë nga shkaqet më kryesore që kanë penguar formimin e një partie politike me një program të çkoqur...Si kudo nëpër botë edhe ndër ne, shpëtimtare e përparimprurëse do të jetë vetëm një parti politike e përbërë prej njerëzish, të cilët në mënyrën e rregullimit të punëve të Popullit e të Qeverisë janë të bashkuar me ide dhe ushqejnë një respekt reciprok.”<sup>744</sup>

Në mesin e dhjetorit të 1924-ës nisi sulmi i forcave zogiste për rrëzimin e qeverisë së Nolit dhe brenda pak ditësh revolucionin u shtyp e A. Zogu rimerr pushtetin. Menjëherë në vend u shpall gjendja e jashtëzakonshme. U pushuan nga puna të gjithë nëpunësit e qeverisë së Fan Nolit. Filluan të përndiqeshin e të arrestoheshin të gjithë ata që cilësoheshin si elementë të rrezikshëm për qeverinë. Në 23 dhjetor 1924, me triumfin e Legalitetit, L. Nosi largohet nga detyra e kryetarit të Bashkisë. Dora e fortë e politikës zogiste, e drejtuar kundër opozitës, do të godasë edhe Lef Nosit i cili do të plagoset.<sup>745</sup> Të gjitha klubet e organizatat politike u shpërndanë, u hoq liria e fjalës dhe shtypi u vu nën një censure të rreptë të cilës i nënshtroheshin edhe letërkëmbimet apo botimet që vinin nga jashtë. Revista historike “Dokumenta Historike për t’i shërbye historisë tonë kombëtare”, që L. Nosi kishte nisur të botonte në fillim të atij viti, tashmë nuk do të botohej më. Pas v. 1924 ai studion, grumbullon dhe sistemon dokumenta të shumta për veprat e ardhshme. Por e gjithë puna e tij studimore, për arsye të ndryshme, që nga shkurti i v. 1925 nuk arriti ta shohë më dritën e botimit. Që nga kjo kohë L. Nosi ka qenë pak i pranishëm në jetën politike shqiptare, përveç momenteve të Luftës së Dytë Botërore, dhe do t’i kushtohet studimeve gjuhësore, historike, etnografike, mbledhjes së librave e dokumentave me vlerë për historinë e popullit tonë.

Në v. 1925, kur forcat demokratike, pasi nuk kishin fituar asnjë përkrahje ndërkombëtare, ishin shtypur dhe dëbuar me forcë nga vendi, Lef Nosi dhe patriotët të tjerë që qëndruan në vend vendosën të mos i kundërshtojnë qeverisë “pasi çdo kundërshtim që i bëhej asaj sillte trazime të tilla që mund të shkaktojnë

<sup>744</sup> Gazeta “Koha”, Korçë, 25 tetor 1924, f.1

<sup>745</sup> Fischer. Bernd, *Mbreti Zog e përpjekjet për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë, 2004, Bot. 3, fq. 88

humbjen e vendit”.<sup>746</sup> Për më tepër ishte në të mirën e vendit e të gjithë shqiptarëve që të kapërceheshin mosmarrëveshjet, t’i pritej rruga anarkisë e të mos shkatërrohej nga vetë shqiptarët ndërtesa e ngritur me aq shumë vështirësi e shtetit shqiptar. Ky qëndrim shpjegon edhe tërheqjen e përkohshme të Lef Nosit nga jeta politike e vendit.

---

<sup>746</sup> AME, F. 10, D. 2, f. 1

## NË VEND TË EPILOGUT

### LEF NOSI GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

#### 1. Pozicionimi i tij politik para e pas pushtimit italian

Pas përmbyesjes së Qeverisë së Nolit dhe rikthimit në pushtet të Ahmet Zogut L. Nosi, ndonëse shkëputet përkohësisht nga skena politike, vazhdon të jetë një figurë e rëndësishme në rrethet e brendshme politike të qytetit të Elbasanit. Ai nuk ishte përkrahës i politikës së Zogut, por ishte mbështetës i shtetit ligjor të cilit revolucion i qershorit të 1924-ës nuk kishte mundur ta ndërtonte. Përkundrazi ngjarjet e vitit që kishin lënë pas kishin dobësuar jo vetëm pozitat e brendshme të shtetit shqiptar por kishin çënuar edhe sukseset e arritura me shumë mund në politikën e jashtme. Ndoshta në këtë qëndrim mund të ketë ndikuar edhe linja politike që do të ndjek Zogu i cili në përpjekje për të konsoliduar pushtetin e tij do të përpiqet të sigurojë përkrahjen e bashkësive të ndryshme fetare në vend. Ndërsa e pati të vështirë vendosjen e marrëdhënieve të qeta me katolikët e Veriut, me largimin e Nolit, Zogu do të arrijë të afrojë një pjesë të ortodoksëve në politikën e tij, duke mbështetur fuqimisht formimin e Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Personeli shtetëror do të vazhdojë të përbëhet kryesisht nga myslimanë, megjithatë në vitet '30 në funksionet publike do të hyjnë edhe pjesëtarë të borgjezisë ortodokse, të paktë numerikisht por të kulturuar në njëfarë mase.<sup>747</sup> Për meritat dhe kontributin e tij në çështjen kombëtare Lef Nosi gëzon mbështetjen e popullsisë së qytetit të tij dhe në mars të 1929-ës emërohet anëtar i Këshillit Arsimor të Prefekturës së Elbasanit.<sup>748</sup> Një muaj më vonë emërohet nga bashkia e Elbasanit anëtar i komisionit për ndërtimin e Muzeut Arkeologjik “Zogu I” në Elbasan.<sup>749</sup> Në maj Prefektura e Elbasanit e emëron L. Nosit anëtar të Odës Ekonomike ku ai do të vazhdojë të punojë edhe gjatë viteve 1930, 1931 dhe 1935.<sup>750</sup> Në 29 tetor 1929 ai do të zgjidhet anëtar në këshillin e bashkisë së Elbasanit.<sup>751</sup> Edhe në zgjedhjet e nëntorit të 1934-ës për kuvendin e bashkisë, ai do të fitojë 1573 vota duke u zgjedhur kështu Mis i këtij kuvendi.<sup>752</sup> Deri në prag të pushtimit italian të vendit, në prill të 1939-ës, L. Nosi rezulton të jetë anëtar i këshillit bashkiak të Elbasanit.<sup>753</sup> Që prej vitit 1931, me kërkesë të prefektit të Elbasanit, z. Zef Kadarja, L. Nosi ishte angazhuar në ngritjen e shkollës së re “në emër të të ndjerit Ali Agjah”.<sup>754</sup> I njohur dhe i vlerësuar nga miqtë dhe bashkëkohasit e tij për thesarin gjuhësor, folklorik e historik që ai kishte mbledhur e ruajtur në vite, në

<sup>747</sup> Dela Roka, Roberto Moroko. *Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, Tiranë, 1994, fq. 134

<sup>748</sup> AQSH, F. 32, D. 19, f.1

<sup>749</sup> Po aty, D. 20, f. 1

<sup>750</sup> Po aty, D. 18, f. 1

<sup>751</sup> Po aty, D. 16, f. 6

<sup>752</sup> Po aty, f. 7

<sup>753</sup> AQSH, F. 272 “Bashkia Elbasan”, D. 7, f. 43-44, dt. 19/10/1943. Në vitin 1939 ky këshill bashkiak ishte i përbërë nga L. Nosi, Shefki Miraku, Beqir Rusi, Dh. Papajani, Q. Karaosmani, Nexhip Haxhiademi, Ibrahim Hostopalli, Xhavit Biçaku, Qamil Shkodra, Shefik Kulla, Dhimitër Bebi, Shevqet Baholli, Emin Bakalli dhe Riza Qorri.

<sup>754</sup> AQSH, F. 32, D. 14, f. 4

1935-ën Lazer Çeta, profesor në gjimnazin shtetëror të Tiranës, i kërkon L. Nosit që për arsye familjare e ekonomike, t'i shes atij bibliotekën e tij private. "Sipas këshillës të eprorit tem të dashtun z. A. Xhuvani do të lejohem me ju dërgue inventarin e kësaj biblioteke. Ju lutem merrni mundimin dhe e shqytoni. Besoj se veprat e shënume në të kanë me ju pëlqë sepse jam mundue me mbledh në to ajkën e mendes së shkrimtarëve sa shqiptarë aq të huej".<sup>755</sup> Ishte koha, viti 1935, kur vëllezërit Baholli në Elbasan kishin nisur punën për ngritjen e ndërtesës së një biblioteke popullore në Elbasan. Kjo bibliotekë u ngrit në ndërtesën që Nasif Baholli i fali Bashkisë së Elbasanit në kujtim të djalit të tij të vdekur, Qemalit, në katin e sipërm të së cilës u hap muzeumi i Elbasanit "i cili përmbledh vjetërsina të ndryshme historike lokale e të përgjithshme".<sup>756</sup> Për pasurimin e kësaj biblioteke dhe ngritjen e muzeut L. Nosi dha një kontribut të vyer. Ai vetë kishte formuar një bibliotekë personale të pasur me shumë libra në gjuhë të ndryshme dhe më tepër me libra që flisnin për Shqipërinë. Por përveç librave në të kishte edhe shumë dokumente në gjuhën turke, dorëshkrime të moçme, kodikë të vjetër dhe dokumenta të ndryshme historike.<sup>757</sup> Për botimin e një pjese të kësaj pasurie ai do të bashkëpunojë edhe me mikun e tij A. Xhuvanin korespondenca me të cilin dëshmon për komunikimin e tyre të vazhdueshëm për problemet e arsimit shqip. "Po pate ndonjë gjë për folklorën - do t'i shkruante A. Xhuvani në janar të vitit 1933, në një letër që mban simbolet e sekretarisë së përgjithshme të Ministrisë së Arsimit, - na dërgo që ta botojmë, se dua ti jap randësi botimit të folklorës."<sup>758</sup> Kështu u bë e mundur të botohen një këngë e Mujit dhe Halilit dhe dy gojëdhëna popullore.

Në verën e 1936-ës, përmes mbështetjes financiare të mbretit Zog për ujësjellësin e qytetit, iu dha zgjidhje çështjes së ujit të pijshëm i cili ishte një problem i madh për komunitetin elbasanas. Për të shprehur mirënjohjen e popullit të Elbasanit, këshilli bashkiak do të dërgojë Lef Nosit, Hysein Daklin e Beqir Rusin të cilët u pritën në audiencë nga mbreti Zog më 2 qershor 1936.<sup>759</sup> Por vjeshta e atij viti nuk do të sjell lajme të mira për Elbasanin pasi edhe një herë, sikurse në 1924-ën, kishte dalë në skenë kërkesa për zhvendosjen e Normales nga qyteti i saj i lindjes. Për të kundërshtuar vendim e qeverisë për transferimin e Normales në Shkodër, në tetor '36, në Elbasan u organizua një miting i fuqishëm proteste. Me përmasa edhe më të mëdha se në vitin 1924 do të jetë demonstrata e tetorit të 1936-ë për të cilën u hapën fjalë në Tiranë se iniciatorët e organizimit të saj ishin Lef Nosi dhe Aleksandër Xhuvani.<sup>760</sup> Normalistët dolën në rrugët e qytetit me flamur kombëtar dhe duke kënduar këngë patriotike, demonstruan kundër vendimit të qeverisë për shpërnguljen e Normales nga Elbasani në Shkodër. Tregu u mbyll dhe i gjithë populli u mbledh në sheshin e qytetit për të demonstruar para organeve qeveritare. Për kundërshtimin e këtij vendimi të qeverisë iu dërgua kryeministrit një telegram proteste ku shprehej qartë se Normalja ishte mbajtur dhe mëkëmbur në Elbasan

<sup>755</sup> AME, F. 20, D. 10, nr. 10, f. 2-3

<sup>756</sup> AQSH, F. 32, D. 39

<sup>757</sup> Revista "Hylli i dritës", viti 1943, fq. 43

<sup>758</sup> AME, F. 20, D. 10, nr. 1

<sup>759</sup> Gazeta "Shqiptare", nr 132, 3\6\1936

<sup>760</sup> AME, F. 20, D. 10, f. 3



me përpjekjet e atij populli dhe se nuk do të lejohej kurrë shpërngulja e saj. Organet lokale urdhëruan përdorimin e forcës së xhandarmarisë, e cila u përlesh me normalistët, që demonstironin nëpër rrugë duke e ngritur gjithë qytet në këmbë. Urgjentisht arriti në qytet Ministri i Brendshëm, Ethem Toto i cili, kur pa se përdorimi i forcës së armëve nuk jepte rezultat, u tërhoq.<sup>761</sup>

Një pjesëmarrës jep këtë kronikë për demonstratën e vitit 1936: “Populli ish mbledh në Bezistan ku u mbajt një fjalim mbi historikun e Shkollës Normale. Prej këtij shpërtheu demonstrata dhe u mbyll pazari. Populli shkoi drejt post-telegrafit dhe bëri telegram proteste. Afër Portës së Kalasë dhe në sheshin e Dëshmorëve populli u përlesh me xhandarët, të cilët shtinë me pushkë por pa dëme në njerëz. Mbasi xhandarmaria s’mundi t’i shpërndajë masat, ndërhyri ushtria. Por as ajo s’mundi t’i shpërndajë por vetëm i rrethoi në lagjen Kala. Demonstruesit sulmuan tek Porta e Kalasë, hodhën xhandarët nëpër vijat e ujit, hapën rrugën dhe dolën prap në treg duke demonstruar. Demonstrata zgjati 14 orë. U arrestuan disa prej pjesëmarrësve dhe u mbajtën ca kohë në burg. Por Shkolla Normale nuk u transferua”.<sup>762</sup> Revolta e Elbasanit numëroi rreth 500 demonstrues të cilët jo vetëm nuk e lejuan ndarjen e shkollës qytetëse nga Normalja për në Shkodër por përmasat e saj vunë në vështirësi edhe pozitat e qeverisë së M. Frashërit.

Gjatë kësaj kohe L. Nosi bashkëpunoi dhe ndihmoi në fushën e studimeve të folklorit dhe të etnografisë me studiuesen angleze Margaret Hasluck e cila mbërriti në Elbasan në fund të vitit 1927 dhe u largua prej këtij qyteti vetëm në 1939 kur u dëbua nga italianët si agjentë britanike. Nisur nga pritja që ai i kishte bërë të huajve që vinin në Shqipëri, e jo vetëm të zonjës Hasluck, duke i njohur ata me traditat e historikun e zonave që vizitonin, në vitin 1934 L. Nosi do të zgjidhet anëtar nderi i klubit turistik e automobilistik mbretëror.<sup>763</sup> Në vitin 1937, me rastin e 25-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së shtetit shqiptar ai do të botojë dokumentin e shpalljes së pavarësisë<sup>764</sup> i cili deri më sot për shqiptarët është i vetmi burim informacioni i aktit të shpalljes së pavarësisë në Vlorë në 28 nëntor 1912.

Në kushtet e rritjes së influencës italiane në Shqipëri L. Nosi vazhdon të jetë një figurë qendrore e rretheve nacionaliste që luftojnë për të mbrojtur pavarësinë politike shqiptare. Në zgjedhjet e fillimvitit 1939 (24-25 kallnuer), për kuvendin pranë bashkisë së Elbasanit, ai fiton 692 vota duke u zgjedhur Mis i këtij kuvendi.<sup>765</sup> Qëndrimi i tij kundërshtues ndaj përpjekjeve të Italisë dhe elementëve italoofil në vend, për ta shndërruar Shqipërinë në zonë të ndikimit absolut italian, ai e kishte shprehur më herët e do të vazhdojë ta mbrojë edhe në këtë kohë. Lef Nosi u vu në mbrojtje të pavarësisë së shtetit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris (1919), kohë kur ai nuk u bashkua me memorandumit të qeverisë shqiptare i

<sup>761</sup> Graceni, Bardhyl. *Aleksandër Xhuvani*, Tiranë, fq. 135

<sup>762</sup> AME, F. 1, D. 2, nr. 28, f. 1, Material i shkruar nga Riza Tirana

<sup>763</sup> AQSH. F. 32, D. 24, f. 1

<sup>764</sup> Po aty, D. 40

<sup>765</sup> Po aty, D. 16, f. 10

cili synonte t'i propozonte Konferencës njohjen e të drejtës së Italisë për garantimin e asnjësisë së shtetit shqiptar dhe caktimin e dukës së Aostës si princ të Shqiptarëve.<sup>766</sup>

Këtë qëndrim ai do të vazhdojë ta ruaj edhe në mars të vitit 1939 në takimin që ai zhvilloi me profesorin italian, Pietro Maurea, inspektor i shkollave italiane në Ministrinë e Arsimit. Interesimit të italianit Lef Nosi iu përgjigj duke thënë se shteti shqiptar jetonte në kushte të ndryshme, duke pasur përqark Greqinë, Jugosllavinë e Italinë, të cilat nuk ia donin të mirën. Përgjigja e Nosit e kishte befasuar profesorin italian, i cili kishte ardhur me idenë se shqiptarët e mërguar, për më tepër në Itali, e dëshironin bashkimin e shtetit të tyre me Italinë, madje edhe qëllimi i ardhjes së tij në Shqipëri ishte shqyrtimi i mundësive të hapjes së një konsullate italiane, pikërisht në Elbasan.<sup>767</sup> Është e vërtetë që politika italiane në Shqipëri kishte njohur momente afrimi me lëvizjen patriotike në vend, fakt ky i përjetuar gjatë dhjetëvjeçarit të dytë të shekullit XX, e sidomos gjatë Luftës së Parë Botërore, kjo lidhej me orientimin politik të Romës që kundërshtonte daljen e Serbisë në detin Adriatik qëndrim i cili shkonte në të njëjtën linjë të përpjekjeve të popullit shqiptar për të kundërshtuar pushtim sllav të hapësirave etnikisht shqiptare. Nëse shqiptarët në rrethanat e një konflikti botëror kishin preferuar më tepër praninë në tokat e tyre të forcave italiane, sesa trupat serbe e greke, kjo nuk mund e nuk duhej interpretuar as si pranim dhe as si nënshtrim ndaj politikës italiane, por përpjekje për t'u vendosur në një pozicion sa më të përshtatshëm në platformën e lojërave politike të diplomacisë ndërkombëtare që mund t'u siguronte mbrojtjen e të drejtave kombëtare. Dhe në fakt ky qëndrim u kishte dhënë mundësinë shqiptarëve të organizonin një kongres në Durrës, të krijonin një qeveri të tyre e të dërgonin një delegacion zyrtar shqiptar në Konferencën e Paqes. Por njëkohësisht shqiptarët nuk i kishin pranuar dhe u ishin kundërpërgjigjur, në 1920-ën, përpjekjeve italiane për t'u vendosur ushtarakisht dhe definitivisht në tokën shqiptare.

Pas agresionit fashist të 7 prillit të vitit 1939, Shqipëria humbi pavarësinë, fakt ky që solli reagimin e rretheve nacionaliste shqiptare në kohën kur Fuqitë e Mëdha, që e kishin pranuar Shqipërinë në radhën e shteteve të pavarura, vazhdonin ta konsideronin atë si zonë të influencës italiane. “Mjerisht kriteret morale të qeverive evropiane – do të shkruajë T. Zavalani në rreshtat e “Historisë së Shqipnis”, - kishin ranë aq poshtë saqë asnjë za nuk u ngrit për të protestuar kundër martirizimit të një kombi të vogël në skajin e kontinentit...”.<sup>768</sup> Ndërsa qeveria londineze, në përpjekje të ruajtjes të një politike paqësore me fuqitë nazi-fashiste, nuk protestoi aspak ndaj pushtimit italian të Shqipërisë, ishin forcat nacionaliste ato që morën në dorë organizimin e lëvizjes së rezistencës në vend. Lufta e Dytë Botërore solli zhvillime të reja në mjedisin shqiptar jashtë të cilave nuk mund të qëndronte Lef Nosi. Ndërsa shpallën vendosjen e gjendjes së shtetrrethimit dhe deklaruan pushkatimin e menjëhershëm të kujtdo që kapej me armë, nga ana tjetër

<sup>766</sup> *Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar. 1918-1929*, Vëll. I, Tiranë, 1975, fq. 500

<sup>767</sup> Dervishi, Kastriot. *Historia e shtetit shqiptar 1912-2005*, Tiranë, 2008, fq. 401

<sup>768</sup> Zavalani, Tajar. *Histori e Shqipnis*, vepër e cituar, fq 310.

autoritetet pushtuese italiane, në përpjekje për të legjitimuar aneksimin e tokave shqiptare, do të mbledhin me forcë në Tiranë përfaqësues të parisë së krahinave shqiptare, të zgjedhur nga një listë, për të luajtur rolin e përfaqësuesve të kombit në një kuvend kushtetues. Arsyen, për të cilin ishin sjellë në kryeqytet, këta të ashtuquajtur “delegatë” e kishin marrë nga i dërguari i Jakomonit, Xhaferr Ypi. Qëllimi ishte aprovimi i nocionit që shpallte rrëzimin nga fronti të mbretit Zog dhe bashkimin e kurorës së Shqipërisë me atë të Italisë.<sup>769</sup> Simboli fashist u vendos në flamurin e kuq shqiptar. Politika e jashtme dhe e brendshme e shtetit shqiptar iu nënshtrua emblemës litoriane të shtëpisë mbretërore të Savojës. Për të fashitur natyrën pushtuese në sytë e shqiptarëve e për të siguruar jetëgjatësinë e sundimit të tyre në Shqipëri, italianët u përpoqën të depërtojnë në idetë, mendimet, në vetëdijen e popullit përmes gjuhës së tyre. Kështu filloi italizimi i qyteteve, fshatrave, rrugëve e shkollave. Të parët që do të rreshtohen në pararojë e kundërshtarëve të politikës italiane në Shqipëri do të jenë pikërisht luftëtarët e dikurshëm të gjuhës dhe shkollave shqipe, mbrojtësit e pavarësisë së shtetit dhe kombit shqiptar, midis të cilëve ishte radhitur edhe Lef Nosi. Ndonëse nuk ishte përkrahës i regjimit të Zogut, L. Nosi nuk i doli as kundër regjimit të vendosur prej tij me synim krijimin e kushteve të favorshme për konsolidimin e themeleve të brishta të shtetit shqiptar përmes kapërcimit të kundërshtive të brendshme. Por pushtimi fashist i vendit bëri që veprimtari elbasanas të dalë nga heshtja politike dhe të pozicionohet hapur kundër projekteve italiane në tokën shqiptare.<sup>770</sup> Për pasojë Lef Nosi do të mbahet nën kontrollin e autoriteteve pushtuese qëndrim ky i cili do të lidhej jo vetëm me të kaluarën e tij patriotike, si një ndër veprimtarët e çështjes kombëtare dhe arkitektët e pavarësisë së vendit, por njëkohësisht mbi të, për shkak të bashkëpunimit me znj. angleze M. Hasluck, të ardhur në Elbasan, do të rëndojnë edhe hijet e dyshimit për lidhje me qarqet politike sekrete britanike. Vendosija e pushtimit fashist në vend u shoqërua me daljen e shumë vendimeve dhe urdhëresave që parashtronin listën e librave, shqip e në gjuhë të huaj, për të cilat zbatoheshin menjëherë vendimi i heqjes së tyre nga qarkullimi<sup>771</sup> pasi binin në kundërshtim me kulturën fashiste dhe me misionin e saj për italizimin e popullsisë vendase. Nisur nga këto masa, është e kuptueshme se L. Nosi, i njohur si koleksionist dhe shpërndarës i librave që dëshmojnë mbi lashtësinë, historinë, kulturën e kombit shqiptar, dhe i mjaft botimeve të tjera propaganduese të demokracive perëndimore, do të bëhej shumë shpejt pre e mbikqyrjes dhe e goditjes fashiste. Në këtë kohë Lef Nosi kishte krijuar edhe një bibliotekë personale me një numër të konsiderueshëm librash në gjuhë të ndryshme, por kryesisht me libra që flisnin për Shqipërinë dhe shqiptarët. Në këtë bibliotekë, veç librave, ai ruante edhe shumë dokumente në gjuhën turke, dorëshkrime të moçme, kodikë të vjetër dhe dokumente të ndryshme historike.<sup>772</sup> Me emrin, influencën dhe respektin që gëzonte në popull Lef Nosi shihej nga autoritetet pushtuese si një pengesë në përpjekjet italiane për fashistizimin e popullsisë shqiptare. Për të

<sup>769</sup> Po aty, fq. 312

<sup>770</sup> Neuwirth, Hubert. *Qëndresë e bashkëpunim në Shqipëri...*, Tiranë, 2006, fq. 19

<sup>771</sup> AQSH, F. 153, “Prefektura e Elbasanit”, D. 3-5-7-8, viti 1939.

<sup>772</sup> Revista “Hylli i dritës”, viti 1943, fq. 43

shmangur trazirat e mundshme në vend, me dekret të mëkëmbësit italian F. Jakomoni, u krijua një Komision i posaçëm i cili shqyrtonte jo vetëm çështjet e pjesëmarrësve në luftimet e prillit të vitit 1939, të demonstruesve, sabotuesve por edhe të gjithë personave të tjerë “jo të sigurt”.<sup>773</sup>Filloi vala e arrestimeve, burgosjeve e internimeve të atdhetarëve shqiptarë që dyshoheshin si frymëzues të rezistencës antifashiste.

Si kundërshtar i regjimit të ri, në vitin 1940, Lef Nosi, bashkë me vëllain e tij, Grigorin, do të internohen për një vit në Itali.<sup>774</sup> Këto masa nuk bënë gjë tjetër veçse ndezën edhe më fort ndjenjën e armiqësisë kundër okupatorit dhe nxitën bashkimin e forcave kombëtare në luftë kundër zgjedhës së huaj. Gjatë ditëve të internimit në Itali L. Nosi jo vetëm do të ruaj kontaktet me nacionalistët shqiptarë në emigracion, por, mesa duket, në Itali ai do të njihet edhe më gjerë edhe me platformën komuniste dhe opinionin ndërkombëtar perëndimor ndaj kësaj vije ideologjike ekstremisht të majtë. Këtu ai do të njohë e do të takojë edhe të riun elbasanas, militant të lëvizjes komuniste shqiptare, Qemal Stafën, me të cilin nuk e lidhte aspak bindja politike, e cila i bënte të ndryshëm por jo kundërshtarë, por ndjenja e atdhedashurisë dhe e respektit për historinë e kombit shqiptar. Nga qyteti i Firenzes, ku Qemal Stafa vazhdonte studimet në Fakultetin e Drejtësisë, do t’i shkruajë Lef Nosit në mars të vitit 1941: “...me një nderim të thellë e me gëzimin shpirtëror, që më ka shkaktuar njoftja me ju, po ju shkruaj lidhur me gjetjen e një historie të Skënderbeut në antikuariumin Bibliapolis...”.<sup>775</sup> Tradita dhe ndërgjegja nacionaliste, e ushqyer me idealet e Rilindjes Kombëtare, ishin dominuese në vend dhe mbizotëronte dukshëm opinionin vendas. Ndërsa platforma komuniste, si një ideologji e huazuar nga jashtë, ishte ende sipërfaqësore dhe e papërthithur nga popullata shqiptare tek e cila, në këtë kohë, ishte jo vetëm e fortë por edhe imponuese bindja nacionaliste. Për më tepër ajo që i bashkonte komunistët dhe antikomunistët shqiptarë, lufta në një front kundër pushtuesit të huaj, ishte më e fortë se ajo që i ndante.

Pas kthimit në atdhe Lef Nosi përballet me pasojat, ndër to edhe ato ekonomike, që pushtimi italian kishte sjellë, si për gjithë shqiptarët, edhe për familjen tregtare të Nosëve. Ndonëse kishte përfunduar afatin e internimit e kthehet në vendlindje ai nuk trajtohet si një qytetar i lirë por si një element me potencial rrezikshmërie që vazhdon të mbahet nën vëzhgim. Këtë fakt e dëshmon edhe liria e kushëzuar që i imponohet atij përmes lëshimit nga komandanti i Brigadës italiane në Elbasan, Corradino Tricoli, i një leje qarkullimi (Tessera di liberta Circolazione) që i jepte atij mundësinë të lëvizte në qytet nga ora 7 e mëngjesit deri në 9 të mbrëmjes.<sup>776</sup>

Një ndër përparësitë e politikës italiane në Shqipëri ishte vënia nën kontroll e jetës ekonomike të vendit. Përpjekjet e qeverisë italiane, të nisura që në kohën e mbretit Zog, e që synonin kontrollin italian të tregtisë së jashtme e të ekonomisë shqiptare në tërësi, u bënë realitet në prill të 1939-ës pas nënshkrimit të

<sup>773</sup> Smirnova, Nina. *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*, Tiranë, 2004, fq. 213

<sup>774</sup> AQSH, F. 253 “Drejtorja e Përgjithshme e Policisë”, viti 1939-1940, D. 27, f. 67

<sup>775</sup> AME, F. 20, D. 10, f. 3

<sup>776</sup> AQSH, F. 32, D. 4, f. 1. Dokument në italisht

marrveshjes për bashkimin doganor mes dy vendeve. Në bazë të kësaj marrëveshje i gjithë eksporti dhe importi vendas do të realizohej vetëm me Italinë dhe nëpërmjet saj. Në këtë mënyrë shteti italian, përmes Bankës Kombëtare që kontrollohej prej tyre, mbante nën kontroll të gjithë jetën industriale dhe financiare të vendit. Tregtia ishte një ndër degët e ekonomisë vendase që ishte goditur më rëndë nga pushtimi italian, në shumë qytete të Shqipërisë por në veçanti në Elbasan. Kjo pasi kontaktet tregtare që tregtarët elbasanas kishin vendosur me jashtë, veçanërisht me Greqinë u ndërpre në një masë të madhe duke imponuar tregtinë vetëm me mallrat italiane. Sipërmarrësit vendas filluan të ndjehen të përjashtuar.<sup>777</sup> Por shkatërrimi ende nuk kishte prekur fundin pasi për shkak të qëndrimit të tyre ndaj pushtuesve italianë Nosëve u sekuestrohet pasuria dhe ajo me të cilën Lef Nosi e familja e tij sigurojnë jetesën e përditshme është një triskë ushqimi për katër persona që atij i lëshohet nga Këshilli Krahinor i Ekonomisë, në Elbasan.<sup>778</sup> Rrënimi ekonomik kishte kllapuar shtresa të gjera të popullsisë vendase e cila me shumë vështirësi u mbijetonte vuajtjeve të përditshme.

Ndërkohë sulmi italian mbi Greqinë do të sillte për pasojë jo vetëm dëme të mëdha ekonomike por edhe humbje të shumta jetësh njerëzore nga radhët e ushtarakëve dhe civilëve shqiptarë. Nga ana tjetër kundërsulmi i shpejtë i forcave greke u shoqërua me shkatërrimin e një pjese të mirë të tokave në Shqipërinë Jugore.<sup>779</sup> Në kushtet kur ishte vënë në rrezik vetë ekzistenca e kombit shqiptar Lef Nosi, luftëtar i hershëm i çështjes kombëtare, patrioti me bindje antizogiste që nuk e pranoi kërkesën e mbretit Zog I për t'u bërë ministër<sup>780</sup>, demokraci antifashist e gjen me vend të pozicionohet në krahun e djathtë të rezistencës e cila që në momentet e para të pushtimit të ri kishte nisur luftën për çlirim kombëtar.

## 2. Lef Nosi dhe Balli Kombëtar

Gjatë kohës së internimit në Itali ai ishte njohur me propagandën antikomuniste të fuqive perëndimore. Kur kthehet në Shqipëri ai do të shohë se pakti i mossulmimit Ripentrop-Molotov ishte reflektuar edhe në qëndrimin pasiv në luftë të komunistëve shqiptarë nga radhët e të cilëve, gjatë kësaj kohe, nuk munguan as thirrjet e lavdërimit “për udhëheqësin gjenial të proletariatit botëror...” dhe akuzoheshin e sulmoheshin fuqitë Perëndimore “si shkaktare të luftës imperialiste kundër Boshtit”.<sup>781</sup> Vetëm pas sulmit gjerman kundër Bashkimit Sovjetik, në fund të qershorit të 1941, lufta pushoi së qeni imperialiste dhe u bë antifashiste. Në 1939 në Shqipëri nuk kishte ndonjë parti komuniste, madje as pas pushtimit gjerman të Jugosllavisë dhe Greqisë komunistët shqiptarë nuk kishin arritur të krijonin ndonjë parti të tyre. Dhe vetëm

<sup>777</sup> Neuwirth, Hubert. *Qëndresë e bashkëpunim në Shqipëri...*, Tiranë, 2006, fq. 25

<sup>778</sup> AQSH, F. 32, D. 5, f. 1

<sup>779</sup> *Historia e popullit shqiptar IV*, TOENA, Tiranë, 2008, fq. 35

<sup>780</sup> Revista “Koleksionisti”, nr. 2, Tiranë, 1998, fq. 39

<sup>781</sup> Zavalani, Tajar, *Histori e Shqipërisë*, vepër e cituar, fq. 323

hyrja në luftë e Bashkimit Sovjetik në krah të Aleatëve Perëndimorë, e thjeshtoi situatën për komunistët shqiptarë, të shpërndarë e të përçarë në fraksione të ndryshme në qytetet e Shqipërisë, të cilët duke filluar ta identifikojnë veten me patriotizmin, gjetën një çështje rreth së cilës mund të bashkoheshin. E pohuar kjo edhe nga P. Kamp, përfaqësues i misionit britanik në Shqipëri, i cili ndër të tjera shkruan: “Komunistët nuk morën pjesë në rezistencë deri ditën kur u sulmua Rusia. Pas qershorit të 1941 u rrit me shpejtësi në male një lëvizje rezistence komuniste e udhëhequr nga Titoja...”<sup>782</sup>

Ishte konferenca e Pezës, e cila erdhi vetëm pak kohë para deklaratës së Aleatëve të Mëdhenj mbi njohjen e forcave të rezistencës shqiptare dhe që bëri të mundur të bashkojë të majtën e të djathtën shqiptare dhe ngriti në këmbë Lëvizjen Nacional Çlirimtare, që e shndërroi luftën në një qëndresë kombëtare. Si një organizatë mbipartiake, Fronti Antifashist synonte të bashkonte të gjitha forcat antifashiste shqiptare pa dallim, patriotë nga i gjithë vendi, pavarësisht nga përkatësia shoqërore, nga dallimet fetare, nga origjina krahinore dhe nga bindjet politike, por që ishin të gatshëm të ngriheshin në luftën kundër pushtuesit e cila do të kishte karakter nacionalçlirimtar e jo klasor, do të zhvillohej në kuadrin e koalicionit Antifashist Botëror me anë të çetave partizane e atyre vullnetare dhe do të synonte krijimin e një Shqipërie të lirë, të pavarur e demokratike.<sup>783</sup> Por fatkeqësisht nacionalizimi i luftës nuk u shoqërua nga uniteti i grupeve të rezistencës shqiptare. Zgjerimi i propagandës komuniste, e cila po fitonte gjithnjë e më tepër terren edhe në zona ku qëndresa antifashiste ishte inspiruar dhe drejtuar nga çetat nacionaliste, i nxiti edhe forcat e djathta nacionaliste shqiptare, mjaft më aktive në ditët e para të pushtimit fashist të vendit, të futen në fazën e organizimit dhe formojnë forcën e tyre politike, Ballin Kombëtar, një parti socialdemokrate, liberale, properëndimore, antimonarkiste e antikomuniste. Ndonëse ekzistojnë të dhëna nga shtypi i kohës si gazeta *Robni o liri* e Shkodrës, Vjet i II, nr.1, mars 1944, me artikullin “Bashkimi” ose gazeta *Oshëtim e Korçës*, viti.I, nr.1 që tregojnë për fillesat e krijimit të kësaj organizate që në verën (31-gusht) e ’39-ës të pushtimit fashist të vendit, ajo arriti në nivel organizimi partiak në 28-11-1942 (organi zyrtar i BK “Lufta e çlirimit kombëtar.”1942). Lajmi për formimin e BK u transmetua edhe përmes valëve të Radio-Londrës e cila bënë të njohur lajmin e ardhur në kryeqytetin britanik përmes një telegrami të mbërritur nga Kajro se “në Shqipëri ishte formuar një organizatë thjesht nacionaliste e përbërë prej patriotëve shqiptarë dhe mban emrin Balli Kombëtar. ...Kjo organizatë kombëtare e popullit heroik shqiptar është prit me gëzim të madh në qarqet politike të Amerikës e ato të Londrës.”<sup>784</sup> Balli Kombëtar lindi si një alternativë e forcave të djathta të cilat synonin ta kthenin organizatën e tyre në një front të gjerë politik, në të cilin do të bënin pjesë nacionalistë të të rrymave të ndryshme, pavarësisht nga pikëpamjet e tyre politike, mjafton që të ishin demokratë

<sup>782</sup> Kamp. Peter, *Kujtime që nuk shlyhen*”TOENA, Tiranë, 1997, fq. 190

<sup>783</sup> *Historia e popullit shqiptar IV*, TOENA, Tiranë, 2008, fq. 56

<sup>784</sup> AQSH, F. 270 “Arkivi i Partisë”, Dosja. 11. “Për Ballin Kombëtar”



antikomunistë, antifashistë e antizogistë.<sup>785</sup> Grupi i ri properëndimor përbëhej nga “pronar përparimtarë e patriotë” të cilët “predikonin dëbimin me forcë të italianëve nga trualli shqiptar, përfshirjen në Shqipëri të të gjitha trojeve etnike shqiptare..., reformë agrare dhe hapa të tjera progresiste, veçanërisht në krijimin e një demokracie të tipit perëndimor”.<sup>786</sup>

Të dyja organizatat, BK dhe FNÇ e konsideronin okupatorin si shkelës të sovranitetit, të lirisë dhe të pavarësisë së Shqipërisë, si një armik që duhej luftuar pa asnjë kompromis. Ky qëndrim shprehet qartazi edhe në thirrjen që kryetar i BK, Mit’hat Frashëri, i drejton popullit shqiptar ku ndër të tjera theksohet se vetëm përmes luftës së armatosur kundër pushtuesit italian duhej të arrihej jo vetëm çlirimi i vendit, por edhe bashkimi kombëtar, si shprehje e vullnetit dhe e luftës së popullit shqiptar dhe jo si një bashkim i realizuar nga okupatorët për interesat e tyre. Në këtë thirrje u kërkohej të gjithë shqiptarëve “të mos kursehen dhe të ndihmojnë me gjithë mjetet ushtarët e lirisë në ballë të luftës. Çdo mungesë dhe bishtëni do të jetë tradhëti kundrejt Atdheut.”<sup>787</sup> Dega e Ballit Kombëtar u krijua edhe në qytetin e Elbasanit po atë vjeshtë të ‘42-it dhe Lef Nosi u zgjodh kryetar i komitetit qarkor të saj për këtë qytet ku bënë pjesë edhe Sotirag Paparisto, Skënder Sejдини, Qamil Xhaja, Ethem Haxhiademi dhe Zija Luniku.<sup>788</sup>

Eshtë për t’u theksuar se në zonën e Elbasanit marrdhëniet ndërmjet nacionalistëve dhe komunistëve ishin të natyrshme dhe aspak armiqtësore. Secilën palë, të ndryshme në ide dhe organizimin e vet, i bënte bashkë tradita luftarake dhe urrejtja ndaj pushtimit italian të vendit. Moskonfrontimi dhe toleranca vinin edhe prej faktit se brenda krahinës, qytetit, fisit apo familjes, ballistët dhe komunistët ishin ndërmjet tyre në lidhje gjaku, miqësie dhe tradite. Ndodhte që brenda një familje të takojë dhe ballistin edhe komunistin, babë e bir të mbrojnë bindje të ndryshme. Ishte koha kur njerëz me lidhje të tilla familjare apo fisnore, i bashkonte jo vetëm afërsia, por edhe ideali patriotik dhe antifashist i luftës së përbashkët. Ajo që i bashkonte ishte më e fortë se ajo që i ndante. Duke pasur si qëllim kryesor luftën kundër pushtuesve fashistë, forcat e Ballit Kombëtar në zonën e Elbasanit bënë përpjekje që në fillim për të bashkërenduar veprimet me forcat partizane, madje u arrit edhe një marrëveshje mes drejtuesve të FNÇ e atyre të çetave luftëtare të Ballit Kombëtar të zonave të Çermenikës, Polisit, Shpatit, Bërzeshtës, Qukësit e Mokrës për luftë të përbashkët kundër armikut.<sup>789</sup> Ky takim përfundoi me hartimin e një rezolucioni të përbashkët ku shprehej vullneti i përbashkët i të dy palëve për luftë kundër pushtuesve, për ndihmë reciproke në rast rreziku, për kontakte, kombinime e biseda rreth këtij bashkëpunimi. “Kryetarët e çetave partizane e vullnetare të Këshillit Nacionalçlirimtar ose të deleguarit e tyre dhe ata të luftëtarëve vullnetarë të lirisë shqiptare të Ballit Kombëtar e të deleguarit e tyre që veprojnë në Çermenikë, Polis, Shpat, Bërzeshtë, Qukës

<sup>785</sup> *Historia e popullit shqiptar IV*, TOENA, Tiranë, 2008, fq. 58

<sup>786</sup> Jacques, Edwin. *Shqiptarët...*, Tiranë, 2005, fq. 118

<sup>787</sup> AQSH. F. 270/AP. D. 11, viti 1943

<sup>788</sup> *Elbasani në luftën për çlirim*, Tiranë, 1971, fq. 158

<sup>789</sup> *Elbasani-Enciklopedi*, Elbasan, Sejko, 2003, fq. 39

dhe Mokër, të imponuar nga dëshira e flaktë dhe nga nevoja e domosdoshme për bashkëpunim, u mbledhën në kuvend në prezencën edhe të elementëve të të dyjave organizatave, pasi përkujtuan në mënyrë solemne me dy minuta heshtje të gjithë të rënë dëshmorë për Atdhe dhe pasi vunë në evidencë rradhazi situatën aktuale të përgjithshme si të jashtme ashtu edhe të brendshme, parashtruan pikëpamjet e tyre rreth zhvillimit të propagandës dhe luftës, si dhe mënyrën e bashkëpunimit në luftë kundër armikut okupator...”.<sup>790</sup>

Balli Kombëtar dhe LNÇ, të dyja lëvizje të përfutuara si një reagim ndaj pushtimit të huaj, por me mendësi politike krejt të ndryshme, mobilizuan secila prej tyre në luftë pjesë të konsiderueshme të popullsisë së fshatit dhe qytetit për të arritur një qëllim të përbashkët: çlirimin e Shqipërisë nga okupatori fashist. Gjithsesi, duhet theksuar se marrëveshjet ndërmjet dy rrymave politike të kundërta kishin kryesisht karakter ushtarak, duke ruajtur çdo organizatë platformën e fushën e vet të veprimit. Një fakt të tillë e dëshmojnë jo vetëm vendimet e marrëveshjeve lokale, por edhe një letër e Mit’hat Frashërit, e pranverës së 1943-it, ku ndër të tjera shkruhej: “Marrëveshja jonë me komunistët është bërë vetëm përse i përket aksioneve ushtarake dhe nga kjo, propaganda jonë nuk duhet të vuaj aspak...”<sup>791</sup> Në shumë raste çetat e të dyja organizatave angazhoheshin për aksione të përbashkëta, ndihmë të menjëhershme në rast rrethimi nga armiku, politikë vllazërimi e jokonfrontimi, si edhe për mbështetje të plotë nga këshillat respektivë. Këshillat përgatisnin bazat për të dyja palët dhe populli lihej i lirë të zgjidhte organizatën në të cilën donte të merrte pjesë. Lufta kundër pushtuesit i bashkonte shqiptarët dhe ky bashkim i orientonte organizatat politike drejt bashkëpunimit e koordinimit të veprimeve antifashiste.<sup>792</sup>

Rrjedhojë e luftës së shqiptarëve ishte edhe deklarata e qeverisë britanike e dhjetorit të v. 1942 e cila u përftua shumë më tepër nga logjika e luftës në përgjithësi sesa nga diçka e njohur mbi atë që po ndodhte në Shqipëri apo nga ndonjë kërkesë imperative që ndihej në Londër nga fundi i 1942 lidhur me politikën kundrejt Shqipërisë.<sup>793</sup> Ndërkohë duhet theksuar se realiteti shqiptar i Luftës së Dytë Botërore as nuk u ngrit i veçuar nga situata ndërkombëtare dhe as nuk mund të kuptohet apo të shpjegohet pa analizuar përmbajtjen e politikave ndërkombëtare. Ndikimi që lufta e Të Mëdhenjve pati mbi shqiptarët ishte shumë i rëndësishëm. Lufta ndryshoi çdo gjë madje ajo bëri të mundur që struktura politike dhe sociale e periudhës së paraluftës të mos rimëkëmbej më. Sikurse shprehet edhe Bernd J. Fischer, lufta e nxori Shqipërinë nga një formë izolimi dhe e hodhi në një tjetër. Eksperienca e luftës e vuri Shqipërinë në kontakt me grupe të ndryshme të huajsh, me idetë dhe armët e tyre. Madje lufta u përdor, nga një pjesë e shqiptarëve, për të legjitimuar e për të mbajtur pushtetin, bazuar kjo mbi një ideologji që ishte e huaj për shqiptarin e zakonshëm.<sup>794</sup>

<sup>790</sup> AQSH, F. 42/AP, D. 22, viti 1943, dt. 17. 04. 1943

<sup>791</sup> AQSH, F. 253 “Drejtorja e Përgjithshme e Policisë”, D. 860, viti 1943

<sup>792</sup> AQSH, F. 272/AP, viti 1943. Ka dokumenta të aksioneve të përbashkëta të forcave nacionaliste e atyre partizane.

<sup>793</sup> Hibbert, Reginald, *Fitorja e hidhur*, Tiranë, 1994, fq. 69

<sup>794</sup> Fischer, Bernd. J. *Lufta e Dytë Botërore në Shqipëri*, vepër e cituar, fq. 137

Ndryshimet në situatën ndërkombëtare, zhvillimet politike dhe ushtarake në Ballkan dhe Evropë gjatë verës së v. '43, kushtëzuan edhe nevojën për bashkim të të gjitha grupimeve të qëndresës shqiptare. Disfatat e ushtrisë italiane në Afrikën e Veriut, thyerja e ushtrisë naziste në fillim të vitit 1943 në Stalingrad (shkurt '43) dhe gjatë verës në Kursk (korrik '43), zbarkimi i Aleatëve Perëndimorë në Siçili dhe rënia e Musolinit në 25 korrik 1943 shënuan pikën e kthesës në teatrin e luftimeve dhe fillimin e humbjes së ushtrive të Boshtit edhe pse konfliktit ndërkombëtar do t'i duket fundi vetëm pas gati dy vjet lufte të përgjakshme. Vërshimi i ushtrive gjermane në gadishullin Ballkan dhe atë Apenin për të përballuar zbarkimin e paralajmëruar të trupave aleate, e vuri Shqipërinë përballë një situatë edhe më të rëndë edhe më të pasigurt ku pushtimi nazist dukej i pashmangshëm.

Rënia e Musolinit nga pushteti e çoi në panik ushtrinë italiane në Shqipëri. Dezertimi i elementëve shqiptarë nga xhandarmaria dhe gjithë formacionet ushtarake dhe administrative u bë i përgjithshëm. Regjimi fashist në vend po jetonte minutat e fundit dhe në këto çaste historike do bëhej realitet bashkimi i të gjithë shqiptarëve kundër pushtuesit. Marrëveshja kombëtare u arrit në Mukje ku shqiptarë me bindje të ndryshme politike, sikurse etërit e tyre të mbledhur në kuvendin e Lezhës, të Prizrenit apo të Vlorës, përballë rreziqeve që i kanoseshin vendit e kombit, lanë mënjanë ndasitë dhe gjetën gjuhën e mirëkuptimit. Por ky bashkim, në vitin 1943, solli me vehte rrezikun e anarkisë dhe të vëllavrasjes të nxitur nga interesat e huaja. Lëvizja komuniste shqiptare kishte rënë nën ndikimin, madje nën kontrollin, e një lëvizje më të gjerë e drejtuar nga komunistët jugosllavë të cilët minuan bazat e brishta të unitetit mes shqiptarëve. Marrëveshja e Mukjes kishte ndezur shpresat e të gjithë nacionalistëve, mes të cilëve edhe të Lef Nosit, se me vendimet që u morën në të jo vetëm u rikonfirmua vazhdimi i luftës për liri kundër okupatorëve fashist, luftë që e rreshtonte Shqipërinë përkrah Aleatëve të Mëdhenj Antifashistë, por u ofrua edhe një zgjidhje e re politike që shmangte arbitraritetin apo sundimin e ndonjë force të caktuar politike përmes sistemit të zgjedhjeve të lira që do të përcaktonin qeverisjen dhe formën e regjimit. Njëkohësisht ngritja e një fronti të përbashkët të luftës antifashiste të të gjithë shqiptarëve do ti hapte rrugën bashkimit kombëtar dhe rilidhjes së fijeve të këputura me gjysmën tjetër të trojeve shqiptare, rivendosjes së komunikimit të ndërprerë ekonomik, kulturor, shpirtëror dhe do t'i jepte jetë vullnetit kombëtar për bashkim realizuar në pajtim me parimin e vetvendosjes të njohur universalisht e të garantuar prej Kartës së Atlantikut e firmosur më 14 gusht 1941 nga F. Ruzvelt dhe Ë. Çurçill. Por ndërsa për L. Nosit dhe nacionalistët e BK çështja e Kosovës shihej si pjesë e pandarë e luftës për çështjen kombëtare që përjashtonte ndryshimin e kufijve me dhunë apo bashkimin nëpërmjet okupatorëve fashistë, për udhëheqjen komuniste shqiptare, e cila mesa dukej ishte vënë nën kontrollin e jugosllavëve, për të cilën duket se aleanca me lëvizjen komuniste të vendeve të Ballkanit dhe Internacionalen Komuniste ishte më e rëndësishme se bashkëpunimi me forcat politike brenda vendit, Kosova vazhdonte të ishte çështje e Jugosllavisë. Ndoshta tek anëtarët e PKSH-së mund të ekzistonte shpresa, se pas marrjes së pushtetit do të kishin mundësinë ta diskutonin çështjen e Kosovës me

aleatin e tyre, PKJ-ve. Por kjo shpresë nuk i përgjigjej realitetit historik pasi asnjë shqiptar, me sado pak dije nga e kaluara kombëtare, nuk do të mund tu besonte të ardhmen e tokave shqiptare hartuesve të platformës së “Serbisë së Madhe” dhe të tregohej njëkohësisht skeptik ndaj forcave politike shqiptare që mbrojnë çështjen e trojeve etnike dhe jo të “Shqipërisë së Madhe”.

Marrëveshja e Mukjes filloi të mishërohej me veprime konkrete përmes ndërmarrjes së aksioneve të përbashkëta të çetave balliste vullnetare dhe çetave partizane kundër forcave italiane në disa zona të Shqipërisë. Por ky bashkëpunim mes shqiptarëve i alarmoi emisarët jugosllavë në Shqipëri e për rrjedhojë edhe krerët e PKSH të cilët jo vetëm nuk e pranuan bashkëpunimin me nacionalistët e djathtë por kundërshtuan fort vendosjen e drejtimit të luftës në duart e Komitetit pluralist për Shpëtimin e Shqipërisë. Duke qenë se tek komunistët shqiptarë u mboll ideja se nuk duhej të kishte asnjë luftë tjetër jashtë Frontit, ata bënë përpjekjet maksimale për të mohuar apo shtrembëruar grupet e rezistencës dhe çetat e krijuara nga forcat e djathta shqiptare. Shumë shpejt forcat e Ballit u trajtuan si kundërshtarë të luftës. Vendimet e Mukjes u shkelën ende pa u tharë boja në letër dhe bashkë me të e mohua edhe vendimi, me një rëndësi të madhe jetike, i luftës së përbashkët për realizimin e unitetit kombëtar brenda kufijve etnikë të Shqipërisë. Urrejtjen e popullit shqiptar kundër pushtuesve italianë u munduan ta shfrytëzojnë për interesat e tyre komunistët jugosllavë të cilët mbanin kontakte dhe drejtonin udhëheqjen e lëvizjes komuniste shqiptare e cila kundërshtonte orientimin politik të Ballit Kombëtar e të gjithë forcave jokomuniste në vend. Përmes deklaratave me veshje patriotike drejtuar masës së madhe të njerëzve të varfër, komunistët shqiptarë arritën të ndezin shpirtin liridashës të popullit shqiptar për ta hedhur atë në luftë jo vetëm kundër pushtuesve por kryesisht kundër atyre që rrugën e marrjes së pushtetit ia bënë gjithnjë e më të vështirë. Nëse nuk ke se çfarë të humbësh, pushtuesi nuk ka përparësi ndaj teje dhe njëkohësisht është më e lehtë që t'i kundërvihesh.<sup>795</sup> Në një kohë kur pjesa më e madhe e popullsisë shqiptare ishte e shkatërruar ekonomikisht gjatë pushtimit fashist italian, të varfërit, në një numër shumë të madh, nuk kishin se çfarë të humbnin. Për më tepër kur tek ata nuk ishte aspak e perceptueshme rritja e rrezikut sllav përmes komunistëve shqiptarë, teksa në vend kishin hyrë ushtritë pushtuese që po luftoheshin nga Aleatët e Mëdhenj, të kërkoje mbrojtjen e tyre ishte krejt e papranueshme dhe ajo që mund të bënin ishte ta luftonin atë. Ndërkohë nacionalistët shqiptarë, të vendosur për ta parë komunizmin sllav si armikun më të madh, ishin të bindur se Aleatët Perëndimorë do të dëshironin ta mbanin në këmbë Shqipërinë e madhe si një barrierë kundër këtij kërcënimi. Të sigurt se Gjermania po e humbte luftën dhe se fitorja shumë shpejt do të ishte në duart e Fuqive Antifashiste ata nuk mundën ta parashikojnë se në mbarim të luftës Britania nuk do të ishte aq e fortë sa të projektonte pushtetin e saj në zemër të Ballkanit. Sikurse shprehet gjenerali anglez Davies në

<sup>795</sup> Gjenerali Davies, “Aventura Ilire”, Londër, 1952, fq. 22

kujtimet e tij “ndërsa situata ndërkombëtare e Britanisë nuk ishte vlerësuar dot drejt nga shumë anglezë, është e vështirë ta quash të habitshme përse dhe shumë shqiptarë kishin pikëpamje të gabuara.”<sup>796</sup>

Është e vërtetë e pamohueshme se asnjë shqiptar nuk e dëshironte që një ushtri e huaj të hynte në Shqipëri, po aq sa është e vërtetë se ky popull, i vogël dhe i rrënuar, nuk e kishte në dorë dhe as nuk mundej që me luftën e tij ta largonte këtë okupim nga tokat shqiptare. Në kushte të tilla një pjesë e klasës së vjetër politike shqiptare, mes të cilëve figura me kontribute të vlerësuara në historinë e kombit të tyre, u vunë përpara dilemës: të vazhdonin luftën rezultatet e së cilës nuk do të përcaktoheshin nga gjaku i derdhur i shqiptarëve; apo të organizonin shtetin e ri shqiptar aty ku hallka ishte këputur, të përpiqeshin të shmangnin shkatërrimin e të ndalnin vëllavrasjen që po e çonte vendin në anarki si edhe të përgatiteshin për konferencën e Paqes. Dihet se politika e një vendi përfshin një numër të madh problemesh të ndërlikuara e sikurse problemet edhe zgjidhjet janë të ndërlikuara. Për më tepër për një vend si Shqipëria që ishte në mëshirën e politikës së shteteve të mëdha dhe nën influencën direkte të fqinjëve, mjaftonte një ndryshim i vogël i politikës së tyre për të përmbysur krejt situatën në vend. Në një Shqipëri të vogël me pak tradita shtetërore, e ndarë në disa besime, me përgatitje të dobët politike, e varfër, pa përkrahje të jashtme, e lakmuar historikisht nga fqinjët që mbështeteshin tek Fuqitë e Mëdha, çdo politikan sado i aftë mund të ketë edhe dështime, mund të bëjë edhe gabime, madje është i detyruar t’i nënshtrohet fatit.

Tek analizon lëvizjet politike të Lef Nosit në prag të okupimit nazist të vendit të bën të kuptosh se ai vendosi të kryej lëvizjen e fundit politike, në aktivitetin e tij thujse gjysëm shekullor, për të përmbushur dy detyra: 1- për t’iu shkëputur Fuqive të Mëdha atë të drejtë të shqiptarëve që ato ua kishin mohuar në kohë lufte dhe paqeje, të drejtën për të jetuar në kufijtë etnikë të tyre. 2- në kushtet kur ushtria gjermane, që pas betejës së Kurskut (Korrik 1943), po shkonte drejt humbjes së sigurt dhe kur Ushtria e Kuqe shihet si boshti kryesor i rezistencës antinaziste, e djathta shqiptare e kishte për detyrë ta mbronte vendin nga duart e zgjatura të komunitëve jugosllavë. Në kohën kur politika britanike kishte pranuar shtrirjen e influencës sovjetike mbi Rumaninë, Bullgarinë e Jugosllavinë dhe kishte mbajtur Greqinë nën influencën e saj, fati i Shqipërisë ishte lënë i papërcaktuar.<sup>797</sup> Në vitet e para të Luftës së Dytë Botërore nuk ishte aspak e sigurt nëse do të mund të rindërtohej përsëri një Shqipëri e pavarur. Pika e kthesës ndodhi në vitet 1943-1944, kur lufta e shqiptarëve dhe interesimi për të nga ana e Britanisë së Madhe dhe SHBA-së e bën të sigurt se vendi do të ringjallej brenda kufijve të para 1939-ës, me shumë mundësi i shndërruar në një shtet komunist, të goditur nga varfëria, të shkatërruar tejprtej dhe pothuajse pa asnjë mik në botë e aq më pak pa asnjë mik të pasur apo të besueshëm.<sup>798</sup> Rusia historikisht kishte qenë zëri ndërkombëtar i sllavëve të Ballkanit. Por si mund të besonin patriotët e 1912-ës se Rusia Aleate do t’u njihte shqiptarëve të drejtën për të jetuar të lirë e

<sup>796</sup> Hibbert, Reginald. *Fitorja e hidhur*, Tiranë, 1993, fq. 169

<sup>797</sup> “*Kujtime që nuk shlyhen*”, vepër e cituar, .fq. 75

<sup>798</sup> Hibbert, Reginald. *Fitorja e hidhur*, Tiranë, 1994, fq. 11

të bashkuar në trojet e tyre? Sa aktuale vinin në mendimet e Lef Nosit fjalët e mikut të tij, Luigj Gurakuqit, që pati fatin të mos i shihte shqiptarët se si vriteshin mes njëri-tjetrit gjatë viteve të fundit të Luftës së Dytë Botërore, i cili do të shkruante në 1919-ën “duhet ta dini ju shqiptarë se anmiqtë e atdhesë e të kombit tënë punojnë, siç kanë punuem gjithmonë...për me na qitun para botës...jo si një komb që meriton jetën e vet më vete, por si disa fise qi s’kanë pasun kurrë bashkim njani me tjetrin, si njerëz të egjër e të padisiplinë qi, po të lihen më vete, kishin me ngranë shoqi-shoqin për së gjalli...”<sup>799</sup> A nuk ndodhi kjo me shqiptarët që nga fundi i vitit 1943?! Përballë një rivaliteti gjithnjë e më shumë në rritje mes forcave nacionaliste e atyre komuniste, që mund të shkatërronte gjithçka që shqiptarët kishin arritur deri në atë kohë madje rrezikonte vetë ekzistencën e tyre si komb, Lef Nosi, e të tjerë që ndanin të njëjtin mendim me të, dhe këta jo shok partie, vendosën të marrin barrën e marrëzisë për të shpëtuar kolonat e brishta të kombit e shtetit shqiptar duke ia besuar veten dhe aktin e tyre gjykimit të popullit dhe faqeve të historisë.

### 3. Pushtimi gjerman dhe qëndrimi ndaj tij

Me besimin se kombi shqiptar, pas kapitullimit të Italisë fashiste, kishte shpëtuar nga armiku më i rrezikshëm, përfaqësues të klasës së dikurshme politike vendosën të bëhen urë për shqiptarët për të kaluar në një gjendje më normale dhe të disiplinuar.<sup>800</sup> Bindja se zbarkimi i Aleatëve do ti jepte fund së shpejti luftës së shteteve të Boshtit dhe rrjedhimisht edhe pushtimit nazist të vendit, ushqeui shpresën tek L. Nosi, se ndërtesa e shtetit shqiptar, e djegur në flakët e luftës së dytë botërore, do të arrinte të mbijetonte vetëm nëse ajo nuk do të lejohej të binte në duart e komunistëve jugosllavë të cilët historikisht qëndronin në pritje për ti dhënë veç goditjen finale që ajo të shembej përfundimisht. Në asnjë rast e me asnjë veprim orientimi i tij politik nuk e drejtua kundër luftës që rinia shqiptare kishte zhvilluar kundër pushtimit të huaj, madje ai vetë kishte qenë një ndër kundërshtarët e pushtimit fashist të vendit. Por ai nuk mundi të heshte dhe as të hiqej mënjane kur shihte se si kjo luftë e ndershme po përdorej nga një pjesë e komunistëve shqiptarë të cilët që prej gushtit të 1943 nuk bënë gjë tjetër por vinin në jetë të gjitha orientimet e komunistëve sllavë. Nga ana tjetër L. Nosi, kryetari i BK në Elbasan, politikan nationalist dhe njohës i mirë ideologjisë komuniste e pasojave shkatërrimtare të platformës bolshevike në Rusi, e gjykonte tepër të rrezikshëm zbatimin e modelit komunist në vend i cili kishte filluar të mishërohej në organizimin e brendshëm partiak të komunistëve shqiptar dhe përpjekjet e tyre për të përdorur luftën çlirimtare në funksion të synimeve politike për të qenë i vetmi pushtet në fuqi. Hapin final PKSH e ndërmori në 8 shtator 1943, në Konferencën e II të Labinotit kur filloi të përdorë etiketimin “tradhëtar e bashkëpunëtor i armikut” për BK dhe të gjitha forcat nacionaliste jashtë FNÇ duke i dhënë frymë një ngjarje të paprecedentë në historinë kombëtare, vëllavrasjes mes shqiptarëve. Ndonëse u cilësuan bashkëpunëtor në një kohë kur armiku i ri, ai nazist, ende nuk e kishte

<sup>799</sup> *Historia e popullit shqiptar*, vëll. III, TOENA, Tiranë, 2007, fq. 132

<sup>800</sup> *Bisedimet e Kuvendit Kombëtar*, tetor 1943, fq. 46



instaluar pushtimin e tij në vend, përfaqësues të klasës nacionaliste shqiptare, që edhe në këto çaste dramatike vazhdojnë të besojnë tek bashkëpunimi mes shqiptarëve, do t'u drejtohen komunistëve e gjithë shqiptarëve të ndershëm me fjalët: “Le të luftojmë të bashkuar rreth fjalëve që na lanë të parët: Ja vdekje, ja liri! Jemi vëllezër, s’na ndajnë dot”.<sup>801</sup> Kjo kishte qenë parrulla e miratuar nga të majtë e të djathtë në Mukje por që më pas ishte mohuar nga krerët e revolucionit komunist. Në të gjitha krahinat e vendit komunistët organizuan atentate kundër nacionalistëve. Vetë Lef Nosi do të jetë objekt i një atentati që njësitet guerile komuniste në Elbasan organizuan më 23 shtator 1943 ndaj tij, A. Daklit dhe Beqir Rusit, i cili mbeti i vrarë, pasi kishin dalë prej shtëpisë së Aqif Pashës.<sup>802</sup> “Komunistët vendosën të zhdukin çdo rival të mundshëm, para se të ndodhte zbarkimi i pritshëm i Aleatëve, - do të shkruaj Xh. Emeri (J. Amery). – Për këtë arsye ata i drejtuan të gjitha energjitë e tyre kundër BK, pjesëtarët e të cilit ishin natyrisht armiq të tyre të klasës.”<sup>803</sup> Tashmë lufta çlirimtare kundër okupatorëve të huaj po e humbte karakterin e luftës së përbashkët patriotike e kombëtare dhe po merrte trajtat e një lufte ideologjike, klasore e politike. Betejat propagandistike dhe goditjet fizike ndaj çdo qëndrimi antikomunist shënuan edhe fillimin e luftës civile në Shqipëri e cila siç shihet nisi para përpjekjeve të nacionalistëve, kryesisht të BK, për krijimin e një Asambleje kombëtare që do ti jepte fund rivaliteteve mes të majtës dhe të djathtës dhe do të mbronte nga shkatërrimi shtyllat e ndërtesës së kombit dhe shtetit shqiptar nga rreziqet e brendshme e ato të jashtme. “Do ishte e thjeshtë- do të shprehet Bernd J. Fisher në analizën e tij rreth realitetit shqiptar gjatë Luftës së II Botërore, - që këta krerë shqiptarë t’i gjykoje sikur të ishin Quisling-u, bashkëpunëtori famëkeq norvegjez i fashistëve, dhe t’i etiketoje si tradhtarë, por një gjë e tillë do t’u atribuonte atyre një nivel zhvillimi të nacionalizmit që ata ende nuk e kishin bërë të vetin. Shumë aspekte të përvojës shqiptare, nën pushtimin gjerman, janë unike. Kushtet e brendshme të veçanta të Shqipërisë, si edhe nevojat e gjermanëve, mundësuan krijimin e një regjimi pushtimi çuditërisht të pavarur. Qeveritë nën këtë regjim, shumë prej të cilave nuk e pranuan fasadën e fashizmit dhe ndoqën një kurs reformist politik dhe ekonomik, ia dolën mbanë të tërhiqnin pas vehtes një pjesë domethënëse mbështetjeje, që shpesh herë ishte vërtetë popullore. Një pjesë e mirë e asaj që ndodhi ishte vërtetë një befasi si për gjermanët, ashtu edhe për Aleatët, duke bërë që të dyja palët të hynin në garë për të marrë informacione të dobishme, mbi të cilat të ndërtonin një politikë frytdhënëse. Në një prespektivë afatgjatë, asnjëra nga palët nuk ia doli plotësisht mbanë t’i kuptonte shqiptarët dhe po të dyja dështuan që ta kontrollonin me efikasitet situatën.”<sup>804</sup>

<sup>801</sup> AQSH, F. 270/AP, D. 69, viti 1943

<sup>802</sup> Butka. Uran, *Lufta Civile*, Drier, 2006, fq. 151

<sup>803</sup> Amery. Julian, *Bijtë e shqipes*, Tiranë, 2002, fq. 84

<sup>804</sup> Fischer, Bernd J. “*Lufta e Dyrë Botërore në Shqipëri: Historia dhe përdorimi i historisë*”, Tiranë, 2012, “Historia e shqiptarëve”, fq. 135

Asambleistat e 14 shtatorit të mbledhur në Tiranë, një prej të cilëve edhe L. Nosi i cili vazhdonte të shpresonte tek gjetja e zgjidhjeve përmes mirëkuptimit të brendshëm mes palëve, nisur nga ndërgjegja kombëtare, morën përsipër të krijonin një Qeveri e të thërrisnin përfaqësuesit e kombit shqiptar në një Kuvend Kombëtar kryetar i të cilit u zgjodh më i vjetri, pra L. Nosi, kurse sekretar u zgjodh më i riu, Xhelal Mitrovica.<sup>805</sup> Zëri i Komitetit Ekzekutiv të Përkohshëm që u formua iu drejtua të gjithë shqiptarëve, të majtëve e të djathtëve, duke u bërë thirrje “patriotizmës, mënçurisë dhe urtësisë së popullit shqiptar që të ndalë mjerimin ... dhe të mos ia shtojnë vendit fatkeqësitë që po i çelin atij një varr të math mbi të cilin ata pak që do të mbeten gjallë, mbas kësaj përleshje gjigande, do të lexojnë pak fjalë të skalitura me shkronja të zeza: *“këtu pushon një nanë e mbytur prej bijve të sajë”*.”<sup>806</sup> L. Nosi, luftëtari i pushkës dhe i penës i fillimshkullit XX, mbështetës i politikave paqësore e larg qëndrimeve ekstremiste që kishte prodhuar Lufta e Dytë Botërore në mjedisin shqiptar, me përfshirjen e tij në Asamblenë e shtatorit, nuk kishte dalë kundër luftës së popullit të tij, luftë që e kishin nisur të gjithë bashkë, nacionalistë e komunistë, kundër pushtuesve fashistë. Por ai nuk mund të pranonte që interesat sllave të shndërroheshin në idealet e komunistëve shqiptarë duke vënë në rrezik vetë ekzistencën e kombit shqiptar. Ai vazhdonte të mendonte për një kryengritje të përgjithshme, por pasi të ishte realizuar bashkimi i të gjithë faktorëve politik shqiptar, bashkim i cili do të kishte siguruar edhe mbështetjen ushtarake të Aleatëve. Kjo përbënte edhe pikëpamjen



*Lef Nosi i pesti, në qendër.*

që kishin dhe vetë Aleatët për Shqipërinë në gushtin e 1943-it, e cila shprehej edhe në rekomandimet që vinin prej tyre të cilat udhëzonin organizimin brenda mundësive të luftës kundër pushtuesve, pa çuar në shkatërrim krahina të tëra dhe pa shkaktuar masakra të panevojshme të popullatës civile, ndërsa kryengritja e përgjithshme të bëhej në momentin e duhur dhe me mbështetjen e Aleatëve. “....popullata civile

të rrije e qete si dhe aktiviteti i patriotëve të qendroje në nivelin e tanishëm, duke e shtyrë kryengritjen e përgjithshme kundër gjermanëve, kur ne të jemi në gjendje të mbështesim”- shkruhej në njërin prej rekomandimeve britanike.<sup>807</sup> Këto udhëzime bazoheshin në planin e Çërcillit për hapjen e frontit të dytë të luftimeve në Ballkan dhe zbarkimin e trupave aleate në funksion të luftës së përgjithshme. Për këtë arsye dhe në funksion të bashkimit kombëtar thirrja e KEP-it iu drejtua edhe, dhe në veçanti, vëllezërve

<sup>805</sup> AQSH, F. 23 “Jashar Erebara”, D. 31, f. 8

<sup>806</sup> AQSH, F.149, D I/479, f. 2, viti 1943

<sup>807</sup> Butka. Uran, *Lufta civile në Shqipëri. 1943-1944*, Drier, Tiranë, 2006, fq. 118

komunistë shqiptarë. Madje “*ne të Komitetit Ekzekutiv do ta quanim vehten shumë të lumtur sikur ata të vinin t’a formonin Qeverinë dhe ne të shkonim prapa tyre.*” - thuhej në këtë thirrje. - *I thirrme e i thirrme të gjithë, për hatërin e Kombit në rrezik... Gjermanofili, anglofili, rusofili komunizmi veç përçarje sjellin. Si popull i vogël duhet të jemi të bashkuar që të mund të rregullojmë punët t’ona.*”<sup>808</sup> Por nga udhëheqësit komunistë koha deri në zbarkimin Aleat në Ballkan u shfrytëzua për eliminimin e kundërshtarëve politikë dhe për t’iu dalë para Aleatëve vetëm me një pushtet, atë komunist.

Lef Nosi, i njohur për idealet e tij kombëtare e antifashiste dhe njëkohësisht për popullaritetin që kishte tek bashkëkombasit e tij, do të jetë një ndër ata të cilët morën përsipër misionin gati të pamundur, fakt që e vërtetuan edhe ngjarjet që pasuan, të ringritjes së ndërtesës shtetërore shqiptare e cila do të ballafaqohej si me lakmitë e vjetra edhe me politikat e reja ndërkombëtare. Nga ana tjetër, ndonëse me orientim perëndimor, veprimtari i vjetër elbasanas nuk mund të pajtohej me mbështetjen e njëanëshme të Aleatëve, në veçanti të oficerëve britanikë, të cilët e kushtëzuan ndihmën e tyre për ata që vrisnin më shumë gjermanë, pa shikuar më tej. Pas kapitullimit të Italisë, trupat gjermane, nga Jugosllavia, ishin futur në tokën shqiptare, veçanërisht në zonën bregdetare ku ishte e mundur të zbarkonin trupat aleate, dhe ishin hakmarrë për poshtërimin që aleatët e tyre italianë kishin pësuar në Shqipëri duke shkatërruar, djegur, plaçkitur e vrarë shumë shqiptarë. Për Lef Nosin vrasja e një ushtari gjerman, që ishte sllogani i lëshuar nga Çerçilli, nuk e justifikonte zhdukjen nga faqja e dheut të fshatrave dhe krahinave të tëra sikurse ndodhi realisht në shumë zona të Shqipërisë. Për më tepër kur nënshkrimi i paqes mes marshall Badolios dhe Aleatëve, në shtator 1943, ishte shoqëruar me shpërbërjen e forcave italiane të cilat, të pakomanduara, endeshin në shpëtim të kokës së tyre nëpër tokat shqiptare. Për pasojë qytete e fshatra vihen nën kontrollin e grupeve të rezistencës, pa luftë.<sup>809</sup> Për një moment dukej se Shqipëria ishte në prag të çlirimit. Në një situatë kur në shumë pjesë të vendit e sidomos në Shqipërinë Veriore kishte një ndjenjë të fortë antikomuniste, tek L. Nosi, mori jetë bindja se tokave dhe kombit shqiptar shpëtimi i vërtetë do ti vinte nga vetë shqiptarët dhe jo nga “dashamirësia” e Fuqive të Mëdha apo nga “miqësia” e fqinjëve sllavë.

Rrjedhimisht vihet re se tek e djathta shqiptare filloi të rritet prirja për të gëlltitur propagandën antikomuniste të gjermanëve duke shpresuar se me ndihmën e tyre jo vetëm do të arrijnë të ruajnë kontrollin në viset veriore, por nën ombrellën e pushtuesve të rinj të mund ta shtynin lëvizjen partizane, të kontrolluar nga PKSH, në skajet e jetës shqiptare. Mirëpo të besojë në 1943-in se lëvizja partizane shpejt do të merrte fund ishte po aq e gabuar sa edhe ideja e partizanëve se brenda pak javësh do ta vinin përpara BK dhe njëkohësisht do t’u bënin ballë forcave gjermane.<sup>810</sup> Ndërsa zbarkimi i Aleatëve nuk po bëhej realitet, madje vihet re një rritje e mbështetjes së tyre për LNÇ, këta burra, që kishin marrë angazhimin të shpëtonin

<sup>808</sup> *Bisedimet e Kuvendit Kombëtar*, tetor 1943, fq. 47

<sup>809</sup> Bethel, Nikolas. *Tradhëtia e madhe*, Tiranë, 1993, fq. 24

<sup>810</sup> Hibbert, Reginald, vepër e cituar, fq. 183

Shqipërinë e shqiptarët, u gjendën papritur përballë dilemave të njëpasnjëshme. *Ndërsa pushtimi gjerman tashmë shihej si një realitet që mund të zgjaste, dhe fatkeqësisht kjo nuk varej nga shqiptarët,-* sikurse shkruan gjenerali anglez Davies, - *mundësia e tërheqjes ishte një obsion që nuk mund të merrej në konsideratë për më tepër kur lëvizjet taktike të PKSH të veshura me petkun e luftës çlirimtare, që u kishte siguruar edhe përkrahjen e Perëndimorëve, kishte nisur ti derdhte armët e Aleatëve, hapur dhe pa mëshirë, kundër të gjitha forcave të djathta antikomuniste shqiptare dhe më pak edhe kundër gjermanëve.*<sup>811</sup> Për L. Nosin ideologjia fashiste ishte po aq e rrezikshme sa edhe ideologjia komuniste. Për të ishin njëlloj shkatërrimtare si revolucioni bolshevik ashtu edhe lufta civile që kishte nisur në vend në prag të kapitullimit të Italisë fashiste. Nga ana tjetër, sikurse kishte dëshmuar historia, Të Mëdhenjtë e Evropës gjithmonë ishin udhëhequr, për së pari dhe kryesisht, nga interesat e tyre. Ky qëndrim u pasqyrua edhe në takimin e Teheranit, ku ndërsa gjetën mbështetje forcat monarkiste në Greqi dhe ato komuniste në Jugosllavi, Shqipëria ishte trajtuar nga tre Fuqitë e Mëdha si një degëzim provincial, fare pak i rëndësishëm për të shqetësuar mendjet e tre të Mëdhenjve.<sup>812</sup> Kjo situatë u reflektua edhe në qëndrimin e oficerëve britanikë që erdhën në Shqipëri në v. 1943 e që nuk dinin asgjë për zbrazëtinë politike prapa kurrrizit të tyre. Ata kishin marrë për detyrë të ndiqnin luftën kundër Italisë e Gjermanisë dhe t'i shmangeshin politikës, por shpejt do ta shohin se politikës nuk mund t'i shmangeshe.<sup>813</sup> Misionarët britanikë ishin ushtarakë që njihnin mirë të vepronin në situata lufte dhe kishin për mision të ndihmonin rezistencën në Shqipëri të çfarëdo platforme politike dhe nuk i njihnin aspak as çështjet ballkanike e për më tepër situatën në Shqipëri e cila ishte përfshirë në një luftë të brendshme për pushtet. Mungesa e informacionit për këtë mjedis politik shqiptar bëri që ata menjëherë të përballeshin nga njëra anë me qëndrimin dyshues të të djathtës shqiptare e cila, ndonëse kishte qenë e para që kishte organizuar çetat e qëndresës antifashiste, tashmë e gjykonte të tepërt derdhjen e mëtejshme të gjakut të shqiptarëve për interesat strategjike të Aleatëve të Mëdhenj, lufta e të cilëve do të përcaktonte rezultatet finale; dhe nga ana tjetër do të ballafaqohen me “etjen” e drejtuesve të grupimit të majtë të cilët përpiqen të kapen fort pas hallkës së fundit të zinxhirit Aleat për të dalë nga vështirësitë e mëdha të luftës dhe për të fituar potencialin e munguar politik që do t'u jepte pushtetin. Shumë shpejt u bë e qartë se partitë politike shqiptare ishin kryesisht të interesuara për atë që do të ndodhte pas luftës. Nëse ata përpiqen të krijojnë përshtypje tek unë se po luftonin – tregon në kujtimet e tij gjenerali anglez Davies,- për të përfituar më shumë armatime dhe furnizime, ata do të kishin një shans më tepër kur të zgjidhej pozita e pasluftës”.<sup>814</sup> Të vetmit që kishin informacion dhe njihnin mjedisin politik shqiptar, ishin dy miqtë e Shqipërisë të kohës së paraluftës e që ishin marrë në punë nga SOE (Drejtoria e operacioneve të

<sup>811</sup> Gjen. Davies, *Aventura Ilire*, Londër, 1952, fq. 69

<sup>812</sup> Bethel, Nikolas, *Tradhëtia e madhe*, Tiranë, 1993, fq. 25

<sup>813</sup> Hibbert, Reginald. *Fitorja e hidhur*, Tiranë, 1994, fq. 72

<sup>814</sup> Gjenerali Davies, *Aventura Ilire*, Londër, 1952, fq. 60

posaçme – Special Operations Executive) ku më i vjetri ishte kolonel Starling dhe Margaret Hasluck<sup>815</sup> e cila kishte jetuar mbi 10 vjet në Shqipëri, më saktë në një shtëpi përdhese të Elbasanit, qytet ku ajo takoi dhe bashkëpunoi, për të njohur traditat, zakonet, folklorin vendas, me njeriun shumë të respektuar për banorët e zonës dhe më gjerë, me L.Nosin, dhe ku përmes bisedave me të, ajo kuptoi vizionin e tij për Shqipërinë e për kombin shqiptar. Bashkëpunimi me nacionalistin elbasanas do ta bëjë vejushën angleze objekt të sulmeve të autoriteteve italiane, që para pushtimit fashist të vendit, të cilat disa herë kishin kërkuar largimin e saj nga Shqipëria. Madje tre javë para pushtimit ato kishin dërguar Musa Jukën të kërkonte që zonja Hasluck të largohej për në Greqi, nën dyshimin se ishte agjente angleze. Prej Athinës ajo do të shkojë në Stamboll ku u rekrutua nga Shërbimet Sekrete Britanike. Përfundimisht znj. Hasluck do të kthehet në Kajro dhe shërbeu si instruktore për misionet britanike të dërguara në Shqipëri.<sup>816</sup> Gjatë gjithë kohës ajo ruajti një vlerësim të lartë për L.Nosin edhe kur ai u përfshi në Këshillin e Regjencës. Nëse Lef Nosi bëri këtë zgjedhje, që mund të mos ishte më e mira e që rezultoi e dëmshme, mbi të gjitha për atë vetë, shkaqet e saj nuk mund të kërkohen tek antikombëtarizmi i L. Nosit por tek situatat e vështira që ishin shfaqur në mjedisin politik-jetësor shqiptar gjatë gjysmës së dytë të luftës së Dytë Botërore. “Në ditët e para të luftës – do të shkruante M. Hasluck në korrik të v. 1944, teksa vazhdonte të qëndronte në qendër të rrjetës së SOE-së për Shqipërinë edhe gjatë verës e vjeshtës së atij viti, në përpjekje për të pajtuar mesazhet që vinin nga misioni aleat Concensus me njohuritë e saj të mëparshme për Shqipërinë, - ndikimi komunist në Shqipëri ishte i papërfillshëm... Gazetat klandestine përmendnin Partinë Komuniste Shqiptare...partizanët e vullnetarët (nacionalistë) luftojnë në të njëjtën çetë dhe ku një çetë partizane ishte e zënë ngushtë, një çetë vullnetare nxitonte që ta shpëtonte dhe anasjelltas.”<sup>817</sup>

M. Hasluck, si i vetmi burim për informacion autentik rreth Shqipërisë, bëri ç’ishte e mundur që ta kthente Shqipërinë në një vend të kuptueshëm në sytë e misionarëve të huaj për të cilët realiteti shqiptar ishte krejt i panjohur. Por një ndikim mjaft të fuqishëm kishin luajtur edhe qëndrimet e ndërkombëtarëve perëndimorë, të cilët qysh pas fitores së ushtrisë së kuqe ndaj ushtrisë gjermane në Stalingrad, në fillim të v. 1943, kishin deklaruar hapur mbështetjen e tyre për forcat komuniste të rezistencës.

Për L. Nosin, me një përvojë të gjatë në jetën politike të vendit të tij, braktisja e Shqipërisë në duart e komunistëve mund të prodhonte braktisjen e vendit nga Evropa. Rreziku bëhej edhe më i madh kur shihej se aleatë të komunistëve shqiptarë shfaqen pikërisht lakmitarët e vjetër të tokave shqiptare, fqinjët ballkanikë sllavë. Një fakt i tillë ishte i pohuar edhe nga gjenerali anglez në Shqipëri, Davies, i cili në telegramin e nëntorit të 1943 dërguar në Londër, parashtroi përshtypjen e tij se LNÇ pa dyshim ishte komuniste por më

<sup>815</sup> Po aty, fq. 79

<sup>816</sup> Vickers, Miranda. *Shqiptarët. Një histori modern*. BOTA SHQIPTARE, 2008, fq. 241

<sup>817</sup> Hibbert, Reginald. *Fitorja e hidhur*, fq. 109

tepër ishte nën ndikimin e Titos sesa të rusëve.<sup>818</sup> Jo përshtypje, por këtë bindje kishin edhe pjesa më e madhe veprimtarëve të hershëm të çështjes kombëtare, Lef Nosi, Mehdi Frashëri, Bedri Pejani, Fiqri Dine etj të cilët të udhëhequr nga nacionalizmi i tyre i lënduar dhe nga besimi se çështja e tyre kundër të gjithë fqinjëve ishte e drejtë dhe do të shpërblehej, u përqëndruan në përpjekjet për të mbajtur larg komunizmin dhe nuk e kuptuan se në kushtet e luftës së ashpër që kishte shpërthyer në Evropë nga Italia e Gjermania, shqiptarëve e Shqipërisë do t'u duhej të kalonin përmes gjakut dhe zjarrit të luftës, që të fitonin të drejtën për një pozitë të mirë kur të vinte paqja. Ata kishin vendosur të mbronin idealet e tyre në kohën e gabuar me aleatin e gabuar. Por ndërsa në fillim të shekullit të XX aleanca me Turqinë u kishte mundësuar shqiptarëve mbrojtjen ndaj synimeve aneksioniste të sllavëve e grekëve kundrejt trojeve të tyre kjo kishte ndodhur pasi Turqinë e mbante Evropa, ndërsa Gjermaninë ishte po ajo Evropë që po e luftonte dhe po e çonte drejt fundit.

Nga ana tjetër po aq e pamundur ishte edhe të luftoje gjermanët dhe forcat balliste në të njëjtën kohë pavarësisht ndihmave që LNÇ merrte nga Aleatët. Kjo e bënte të qartë se qëllimi i tyre ishte që ti përdornin armatimet e siguruar për të sulmuar Ballin derisa të ndiheshin të fortë dhe ta çonin drejt disfatës të djathtën shqiptare. Vetëm atëherë ata do të mund të luftonin pak kundër gjermanëve. A do të mund t'u qëndronte Balli këtyre sulmeve? Përballë kësaj dileme, sikurse shprehet studiuesi E. Jacques, erdhi momenti kur “antikomunizmi i Ballit të spikasë më shumë se antifashizmi i tij”. Kishin zgjedhur të kërkonin ndihmën e Gjermanisë kur ishin Aleatët ata që po fitonin luftën. Përtej situatës së ndërlikuar në vend një pjesë të përgjigjes na e japin edhe oficerët anglez në Shqipëri, F. Makinli, D. Smiley e J. Amery për të cilët Britania nuk kishte arritur ta kuptonte që në fillim se komunizmi ishte kundërshtari i ardhshëm.<sup>819</sup> Figura drejtuese të të djathtës shqiptare ishin të njohura për kontribute të vyera në historinë e vendit të tyre dhe në moshën, që shumë prej tyre kishin, vështirë të besosh se pushteti iu verboi sytë kur në të vërtetë, me një Gjermani në tërheqje, një pushtet të sigurt nuk mund ta kishin. Realiteti politik shqiptar kërkonte që nacionalistët të ishin në krye të qeverisë dhe një plan e kishin për Shqipërinë. Kishin formuar dy grupe të armatosura, njërin në mal e tjetrin në qytet. Madje kishin bërë marrëveshje edhe me Myslym Pezën. Grupi i qytetit bënte politikë të ndryshme nga ai i malit duke u futur në bisedime me gjermanët derisa të vinte momenti i volitishëm e të dy grupet të bashkëpunonin.<sup>820</sup>

Në këtë çast kritik, kur njëri pushtim i kishte lënë vendin një pushtimi të ri edhe më të egër, dhe kur shqiptarët kishin nisur një tjetër luftë mes njëri-tjetrit, grupi nationalist i qytetit vendosi të marrë përgjegjësinë mbi vehte përmes krijimit të një Komiteti të Përkohshëm që do të përpiqej ti jepte fund anarkisë e të shmangte vëllavrasjen. Për rrjedhojë zëvendësimi i trupave fashiste italiane nga forcat

<sup>818</sup> Po aty, fq. 116

<sup>819</sup> Bethel, Nikolas. Vepër e cituar, fq. 27

<sup>820</sup> Gazeta “55”, “Burgosja e njerëzve të besës”, K. Dervishi, Rrëfim i Vasil Nosit, dt. 29. 03. 2008



gjermane, të cilat deklaruan se kishin pushtuar vendin për shkak të nevojave të luftës dhe se nuk do të përziheshin në punët e saj të brendshme, derisa nuk ishte në rrezik sigurimi i ushtrisë së gjermane,<sup>821</sup> u shoqëruan me hyrjen në qeveri të figurave me autoritet dhe kontribut të njohur në çështjen kombëtare të cilët, të ndërgjegjeshëm për karakterin dogmatik të propagandës naziste, u detyruan të pranojnë ofertën e pushtetit duke u bazuar në angazhimin gjerman për njohjen e shtetit etnik shqiptar, të një qeverie të pavarur dhe asnjëse shqiptare si edhe në frikën në rritje ndaj rrezikut komunist. Për më tepër e gjitha kjo ndodhte kur, për një pjesë të mirë të shqiptarëve, gjermanët nuk shiheshin si armiq të më të këqinj, emër të cilin ata e kishin në tokat e pushtuara të Evropës. Në këtë ndërmarrje politike figurat shqiptare u ndikuan si nga kushtet historike e gjeopolitike në të cilën ndodhej vendi dhe nga mungesa e trupave të bashkuara ushtarake, ashtu edhe nga fakti se vendosja e divizioneve XXI dhe XXII gjermane, nuk kishte për qëllim pushtimin e Shqipërisë por kontrollin e vijës bregdetare, të zonave të brendshme strategjike e të qyteteve kryesore nga ku kalonin rrugët drejt Greqisë apo ato të tërheqjes së forca naziste drejt veriut. “Udhëheqësit e BK përfshinin njerëz që padyshim kanë patriotizëm dhe parime të larta, -do të shkruante majori anglez Antoni Kuejl në një nga raportet e tij për Shqipërinë,- njerëz me pikëpamje politike të moderuara. Duke i mbajtur sytë hapur, këta njerëz janë rreshtuar me gjermanët kundër LNÇ. Ndoshta ata kanë menduar se rreziku komunist është më kërcënues sesa pushtimi gjerman. Duke menduar që çlirimi i Ballkanit t’u lihet Aleatëve, ata, Ballkomi, do të përqëndroheshin në armiq të trashëguar e të ardhshëm, siç janë grekët e jugosllavët, për çështjen e kufijve të të cilëve Aleatët nuk do të bënin deklarata të hapura. Ndoshta ata e besonin propagandën gjermane, gjë e kuptueshme kjo po të shihet sesa shumë gjermanë e kanë besuar atë dhe ende e besojnë, se Aleatët, d.m.th. Demokracitë, do ta përfundojnë luftën duke u bashkuar me Gjermaninë për të thyer Rusinë”.<sup>822</sup> Ata, e djathta shqiptare, nuk mund ta parashikonin se idealet dhe qëllimet parësore të fillimit të konfliktit botëror, shpejt do të vjetëroheshin dhe aleancat e reja të mesit të luftës do të përcaktonin fatet e popujve pas përfundimit të saj.

Krijimi, në kushtet e pushtimit gjerman, i një Qeverie të Përkohshme shqiptare ishte një përpjekje shumë e vështirë e cila kërkonte bashkimin e sa më shumë nacionalistëve me ndikim në popull e që kishin luajtur rol të rëndësishëm në jetën politike të vendit. Përballë një situatë me shumë pikëpyetje e rreziqe sa të brendshme e të jashtme, politikanë me bindje antikomuniste morën vetë në dorë fatin e vendit e vendosën t’iu impononin Aleatëve të Mëdhenj, që po e fitonin luftën, vullnetin e të gjithë shqiptarëve në trojet etnike. Për këta politikanë formimi i qeverisë nuk ishte marrje e pushtetit por ishte një mundësi për të përfituar, aq sa mund të përfitohej, në kushtet e një pushtimi të huaj që ishte në ditët e fundit të ekzistencës së tij. Ky qëndrim lidhet me faktin se ishin pikërisht vendimmarrësit e Konferencës së Ambasadorëve, Italia e Gjermania, që duke njohur padrejtësitë e dikurshme, ndonëse nisur nga interesat e tyre sikurse kishin bërë

<sup>821</sup> Zavalani, Tajar. *Histori e Shqipërisë*, PHOENIX, 1998, fq. 325

<sup>822</sup> Reginald, Hibbert. *Fitorja e hidhur*, Tiranë, 1994, fq. 213

edhe më parë, tashmë pranonin t'u njihnin shqiptarëve të drejtën të jetonin në tokat, që po ata “të Mëdhenjtë” në 1913-ën, kishin vendosur t’ia shkëpusnin trungut të saj. Këtë shans që historia ofronte ata menduan se duhej shfrytëzuar sidomos në kushtet kur drejtimin e luftës çlirimtare, falë ndihmës së Aleatëve Perëndimorë, e kishin monopolizuar forcat komuniste që me luftën e tyre nuk kërkonin t’i jepnin zgjidhje çështjes kombëtare, por të siguronin marrjen e pushtetit ende pa mbaruar lufta. A duhet të mbështetej Shqipëria e varfër, e përgjakur, e shkatërruar edhe më rëndë se më parë tek Jugosllavia komuniste? Për të gjithë ishte e qartë se Gjermania naziste po shkonte drejt humbjes së luftës, dhe Shqipëria që e kishte nisur betejën e saj kundër fashizmit në një kohë kur ende s’ishte dëgjuar krisma e parë e Luftës së Dytë Botërore, tashmë kishte mundësinë të paraqitej në tryezën e diplomacisë evropiane me një shtet që përfaqësonte të gjithë shqiptarët të bashkuar, jo me forcë, por të pranuar, si një realitet i mohuar më parë prej Fuqive të Mëdha. E nëse kjo e vërtetë nuk mund të pranohej pasi ishte realizuar në kohë lufte, të paktën shqiptarët do të viheshin përpara provës së parimit të vetvendosjes së popujve, duke shmangur njëkohësisht edhe mundësinë e protektoratit të huaj, aq më shumë kur kjo “mbrojtje” po u ofrohej shqiptarëve nga komunistët jugosllavë. Këto nuk ishin vetëm parimet që frymëzonin veprimtarinë politike të L. Nosit dhe klasës politike që ai përfaqësonte, por ishte njëkohësisht edhe ideali për të cilin kishin luftuar e vazhdonin të luftonin shqiptarët e Kosovës e të të gjitha viseve shqiptare të shkëputura në 1913-ën nga trungu kombëtar. Një fakt të tillë e dëshmojnë edhe vendimet e Kongresit të II të Prizrenit, mbajtur në 16-19 shtator 1943, vetëm dy ditë më vonë nga vendimi i grupit të nacionalistëve shqiptarë në Tiranë, të cilët ishin të vetëdijshëm për rrezikun që kishin marrë mbi supe, kishin rishpallur pavarësinë shqiptare dhe ishin vënë në mbrojtje të sovranitetit kombëtar. Ky kongres i organizuar me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga tokat e liruara dhe nga të gjitha tokat e tjera të ish mbretërisë Jugosllave vendosi të themelojë organizatën nacionaliste “Lidhja e Dytë e Prizrenit” e cila kishte për qëllim “mbrojtjen e tokave të lirueme, të Kosovës, të qarkut të Dibrës, si dhe të tokave tjera shqiptare t’ish Jugosllavis. Si mjet për këtë qëllim do të përpiqet të mbledhi dokumenta për Shqiptarësinë e viseve në fjalë dhe të organizojë popullsinë fizikisht dhe moralisht për mbrojtjen e këtij qëllimi”.<sup>823</sup>

Nacionalistët shqiptarë u vetsakrifikuan për çështjen e Kosovës. Por ndërsa përpjekja e nacionalistëve shqiptarë, si Lef Nosi, për ta shpëtuar Shqipërinë etnike, ishte vënë nën goditjen e propagandës së PKSH-së, ajo nuk la indiferent të gjithë ata që njihnin angazhimin patriotik të figurave të përfshira në qeverinë shqiptare të ngritur në kushtet e pushtimit të huaj. Vija politike e qeverisë së Regjencës- do të shprehet M. Hasluck në një vështrim informativ të datës 15 dhjetor 1943, në Kajro –do të kishte gjetur miratimin tonë të ngrohtë nëse ne nuk do të kishim qenë në luftë me një vend, forcat e armatasura të të cilit tani kishin pushtuar Shqipërinë...Për më tepër ata (qeveritarët e Regjencës- E.A) i kanë bërë thirrje rinisë që t’i

---

<sup>823</sup> Fletorja zyrtare, 17 mars 1944, fq. 2

shmanget luftës civile dhe ta ruajnë të paprekur Shqipërinë, të cilën ata, burrat më të vjetër në qeveri, e kishin bërë, por të cilën ata, të rinjtë, do ta trashëgonin nesër. Në të vërtetë këta burra të vjetër – vazhdonte letrën e saj znj. Hasluck, - duhet të kenë një dhimbje të madhe duke vështruar kaosin në të cilin e ka zhjytur vendin lëvizja guerile. Ata lindën për të hequr qafe sundimin e degraduar turk. Ata u rritën për të luftuar për pavarësinë; shumë njerëz si vëllezërit Butka dhe i ndjeri Idromen Kosturi e bënë në luftë çetash; disa të paktë si Lef Nosi dhe i ndjeri Preng Pasha i Mirditës e bënë me vitet e burgimit, të internimit e të mërgimit. Kur u arrit pavarësia, ata, si myslimanët edhe të krishterët, i kthyen fytyrat nga perëndimi dhe ata bënë për vehte e ndihmuan brezin më të ri për të fituar një farë shkalle të qytetërimit perëndimor. Ata u gëzuan duke parë qeveritë e mëpastajme, që ia hoqën popullsisë armët, të cilat shërbenin vetëm për të ruajtur barbarinë mesjetare. Tani ata shohin sesi akrepat e orës janë kthyer prapa, në vitet '20 ose dhe më parë, armët janë në duart e çdo njeriu, jeta e njeriut nuk vihet në hesap dhe anarkia është harbuar. Ata nuk do të ishin aspak njerëzor nëse nuk do të bënin pyetjen: A do ta vllente dëmin ekonomik e politik që do të pësonte vendi, ai përfitim, që do të vinte nga impenjimi ushtarak i Aleatëve, i cili arrihej nga taktika guerilje duke goditur e duke ikur?<sup>824</sup>

Ky do të jetë edhe boshti ideor që do të përshkojë thirrjen me të cilën Lef Nosi, Ibrahim Biçaku, Ahmet Dakli, Vehbi Frashëri, Bedri Pejani, Hasan Ceka e shumë burra të tjerë do t'i drejtohen nga kryeqyteti, Tirana, gjithë kombit shqiptar në shtator të vitit 1943. “ Shqiptarë! Qëndresa heroike e kombit t'onë gjatë fazave të ndryshme të luftës u shpërbly definitivisht me shkatërrimin e një sundimi të huaj. Të gjithë shqiptarët mbrënda kufijvet etnik jetojnë me përfytyrimin e një ardhmënie kombëtare të lumnueshme. Ndër luftra t'ona kombtare, të cilat kanë vazhdu të papreme e në shekujt, kanë ra fli breznit t'ona të mëparshme. Populli ynë do të jetë gati me ndjekun gjurmat e tyre për ta mbrojtun Lirinë e vet e fitueme me gjakun e kaq dëshmorve kundra cilitdo që do të mundohet me ia grabitë.

Shqiptarë! Për me ia pre hovin anarkisë së krijueme me ndryshimin e situatës e tue besue fetarisht n'ardhmërinë e shkëlqyeshme t'Atdheut Arbnor, legalizimi i të cilit do të bahet nga vendimi i një Asambleje Kombtare që do të mblidhet sa më parë dhe do të përfaqësojë vullnetin e të gjithë popullit shqiptar. Qysh sot qeveria e ditëve të robnisë deklarohet e rrëzueme dhe vendin e saj e zën një komitet i përkohshëm i cili do të marr gjithë masat për me konvokue Asamblenë kombëtare, prej gjinit të së cilës do të dali qeveria.

Shqiptarë! Në këto çaste vendimtare të Historisë së kombit t'onë të tronditun duhet që burra me vetëdije të plotë t'i tregojnë popullit udhën e Lirisë duke marr barrën e përfaqësis së tij dhe gjithë përgjegjësitë e randa të çastit. Rroftë Shqipnija e Lirë!<sup>825</sup> Ishin pikërisht këta burra që shpallën atë ditë në Tiranë formimin e një Komiteti Kombëtar, të përbërë nga shqiptarë të trojeve etnike, dhe zhvilluan një

<sup>824</sup> Hibbert, Reginald, *Fitorja e hidhur*, Tiranë, 1994, fq. 106

<sup>825</sup> AQSH, F. 149 “Këshilli i Ministrave”, D. I/479, f. 1, viti 1943. Thirrja daton në 14 shtator 1943 e firmosur nga 22 politikan shqiptarë.

propagandë aktive për të siguruar mbështetjen e opinionit të brendshëm në përpjekjen për të ngritur në këmbë organet e administratës të shpërbërë thuajse tërësisht në Shqipëri, në javët e fundit të pushtimit fashist të vendit, por që vazhdonte të funksiononte në territoret shqiptare të Kosovës e Çamëris.

BK protestoi jo vetëm kundrejt Komitetit Kombëtar por edhe ndaj pjesëmarrjes në të të anëtarëve të vet, Lef Nosit dhe Ismail Sefës. “Zoti Lef Nosi ka marr pjesë në këtë Komitet si individ dhe, meqenëse me këtë akt ka dalë jashtë direktivave të Ballit, të cilat janë dhe do të jenë gjithmonë për një luftë të paprerë kundër çdo okupatori, organizata nacionaliste “Balli Kombëtar” vendosi dëbimin e z. Lef Nosit nga radhët e saj.”<sup>826</sup> Nuk mund ta themi me siguri nëse distancimi i BK nga figurat nacionaliste balliste pjesëmarrëse në

Komitetin Ekzekutiv të Tiranës ishte pjesë e planeve të tyre në prag të pushtimit nazist të vendit, i koordinimit të veprimeve midis grupit të armatosur të malit dhe grupit të qytetit që do të futej në bisedime me gjermanët, ishte rezultat i presionit të oficerëve britanikë që kishin ardhur në Shqipëri e që këmbëngulnin që edhe ballistët të vrisnin gjerman, apo ishte reflektim në kushtet e luftës civile që kishte përfshirë grupet politike e ushtarake shqiptare, në kushtet kur terrori i kuq



*Lef Nosi i pesti, nga e djathta në të majtë*

kishte prodhuar për pasojë edhe terrorin e djathtë. Ajo për të cilën mund të shprehemi pa ekuivoke është qëndrimi i Lef Nosit i cili me veprimet e tij as nuk largohet nga bindjet e tij të djathta politike por njëkohësisht, i ndërgjegjshëm për barrën morale që kishte marrë përpara shqiptarëve, përpiqet të ndal luftën vëllavrasëse që po përgjakte gjithë Shqipërinë.

Kuvendi Kombëtar u thirr më 16 tetor 1943. Ai nisi punimet përmes fjalës së urimit të mbajtur nga kryetari i Komitetit Ekzekutiv të Përkohshëm, Ibrahim Biçakut, i cili vuri theksin në mendimin dhe vullnetin “për të rrojtur midis kombeve të tjera si shtet i lirë e i pavarur” zot në tokën shqiptare.<sup>827</sup> Lef Nosi, më i moshuari, 67 vjeç, i zgjedhur Kryetar i Përkohshëm i Kuvendit Kombëtar, çeli fillimin e punimeve të tij me ligjëratën: “Gjendja që u krijua kohët e fundit në Shqipëri, i shtyu patriotët shqiptarë të mendohen seriozisht për fatin e atdheut dhe me ndjek me emocione të mëdha zhvillimin e ngjarjeve, rrjedhimisht me marrë masat dhe vendimet që ia kërkon puna. Kapitullimi i Italisë që nuk pritej të ishte aq i shpejtë, na e shtoi emocionin, dhe Shqipëria an’ e mb’anë zu të çqetësohet. Atëherë u kuptua mirë se për patriotët shqiptarë kishin ardhur momente veprimi e sakrificash të ç’do lloji e se një detyrë e shenjtë i thërriste, që të veprojnë me e shpëtue Shqipërinë nga katastrofa që i kërcënohej. Tyke qenë puna kështu, një grup patriotësh

<sup>826</sup> AQSH, F. 270, D. 11, dt. 27.09.1943

<sup>827</sup> Dervishi, Kastriot. Vepër e cituar, fq. 533

u mblodhën me shpejtësi, këtu në kryeqytet për me rishpallun Indipendencën e për me e bamë prap Shqipninë të lirë, nj'ashtu si ishte përpara ditës së 7 prillit 1939 kur forca e bajonetës e futi nën zgjedhën e fashizmit italian. Kjo rishpallje që e solli prap në jetë sovranitatin tonë Kombëtar, u realizua prej atij grupi patriotësh në 14 shtator 1943, qi ka me qenë për ne një ditë me randësi të madhe historike. Pas këtij vendimi shpëtimtar, u ç'faq nevoja dhe u formue nga gjini i nisëtorëve, një Komitet Ekzekutiv i cili mori përsipër drejtimin e vendit dhe rivendosjen e qetësisë, që në këto momente kaq të vështira e kritike, asht një punë tepër e randë.”<sup>828</sup>

Ky Komitet menjëherë filloi përgatitjet për mbledhjen e këtij Kuvendi Panshqiptar që kishte për qëllim të përfaqësonte gjithë kombin shqiptar, Shqipërinë Etnike. Mbi misionin e këtij Kuvendi flasin qartë dy vendimet e tij: “1- Çështja e lirisë dhe e indipendencës etnike të Shqipnisë asht një gja e paprekshme dhe kurrë ma ky popull nuk do të pranojë një liri të kufizueme, një liri në letër, një liri me dozë si përgatiten barnat në farmaci, si edhe ajo e katër vjetëve të fundit; 2- Kosova kreshnike me çdo kusht do të jetë e bashkueme me Shqipëninë dhe solemnisht u vendos këtu qi Kosova e Shqipnija e vjetër janë një, të pandara njana nga tjetra. Çështja e Kosovës është në krye të çështjeve t'ona kombëtare; na kurrë nuk do ta shtrojmë Kosovën në tryezën e bisedimit, sepse Kosova për ne asht një çashtje e mbaruar, asht e jona, ka qenë, asht e do të jetë shqiptare”.<sup>829</sup> Duke besuar tek vëllazëria mes shqiptarëve, e trashëguar që nga koha e Skënderbeut, mbrojtësit e idealit të bashkimit kombëtar do tu kërkojnë të gjithë shqiptarëve “ kudo që ndodhen, të çfarëdo besimi apo parimi politik, të mendonin se ekzistenca fizike e popullit ishte në rrezik... se gjatë 4 vitesh sundimi të huaj, të pabarazueshëm në gjithë analet e historisë sonë kombëtare, kishte disorganizuar, shthurë e shpartalluar të gjitha vlerat landore e morale të kombit arbënor...”.<sup>830</sup> Me këtë bindje ata besojnë se ishte koha që shqiptarët, pasardhësit e një fisi mijëvjeçar që kishte mbijetuar gjatë shekujve për meritë të trimërisë dhe urtësisë së tij, të tregonin se ishin në gjendje ta rimëkëmbnin ose ta rrënonin krejtësisht këtë komb heroik i mbetur i gjymtuar, i djegur dhe i përgjysmuar prej shumë pushtimeve të huaja. Këta burra, të mbledhur në një kuvend kombëtar, duke parë pasardhësit e arbërve të kërcënuar nga armiq, si nga brenda ashtu edhe nga jashtë, armiq që i kërcënonin të drejtën e jetës, duke parë një pjesë të popullit të tyre në anarki morale e mendore dhe vendin të rënë në gjendje të turbullt, duke ndjerë nevojën e pajtimit të mendimeve të ndryshme që përçanin shqiptarët dhe pengonin bashkimin e fuqive kombëtare për të qenë gati për të mbrojtur atdheun me armë në dorë, duke qenë të bindur se detyrën e shenjtë për të luftuar për liri, e ndjente i gjithë populli, vendosën: “me u lidh me Besa-Besë që ja të rrojmë të lirë e të bashkumun, ja të vdesim:1) për me mbrojt indipendencën e Shqipniës dhe kufijtë e saj etnike; 2) për me organizu fuqitë ushtarake dhe me e përgatit Kombin për sakrificat që do të kërkohen prej tij; 3) për

<sup>828</sup> *Bisedimet e Kuvendit Kombëtar. 1943, Mbledhja e III, 20 tetor 1943*

<sup>829</sup> *Bisedimet e Kuvendit Kombëtar, tetor 1943, fq. 65*

<sup>830</sup> AQSH, F. 149 “Këshilli i Ministrave”, D. I/479, f. 2, viti 1943

me u bë ballë fuqinave t'armatosuna të kombeve fqinj në rast se mësyjnë kufijtë t'onë, më qëllim përvetsimi të ndonjë pjese të tokës s'onë Arbënore; 4) për me i dhanë Qeverisë Kombëtare ndihmën e përkrahjen t'onë morale dhe materiale, dhe 5) për me lanë mënjane çdo armiqësi dhe marrje gjaku deri në mbarimin e luftës.”<sup>831</sup> “Por mjerisht e për fat të keq, – do të shprehej ndër të tjera L. Nosi në fjalën e tij në Kuvendin Kombëtar, - tyke qenë ne këtu në kët pallat, të mbledhun për të kryem një detyrë që asht vetëm e vetëm për të mirën e Atdheut t'onë, disa prej vllëznish tanë që nuk e kuptojnë randësinë e gjendjes së sotme, godasin me top e na pengojnë të realizojmë një punë kaq patriotike. Asht e ditun se kjo ngjarje, në kundërshtim me karakterin dhe burrin shqiptar, nuk bani tjetër veçse na e forcoi vullnetin tonë për mos me iu shmang detyrës që na u ngarkue me e ba Shqipërinë prap të lirë e për të rrëzuar një dinasti të huaj e cila na u imponua me anë të forcës së bajonetave”.<sup>832</sup> Nëse kjo lëvizje politike e Lef Nosit nuk ishte zgjedhja më e mirë, kjo nuk e bën atë automatikisht politikan me etje për pushtet, ndërsa nuk pati dhe as nuk priste në moshën e tij, asnjë përfitim personal apo politik, veçse i udhëhequr nga ndërgjegjja e tij dhe i vetëdijshëm për barrën që po merrte mbi supe, vepro i siç mendonte se ishte më e mira për vendin dhe popullin e tij. Në prill të 1943 ai numëronte 66 vjet jetë dhe ishte i ndërgjegjshëm se vendit e popullit të tij i kishte dhënë aq sa mund t'u jepte, por me shpirt dhe mendje vlerësoi se do t'i duhej të luftonte edhe për pak kohë që të mos lejonte t'i shkatërroheshin përpara syve shumë e shumë vite mundime e përpjekje për të ngritur në këmbë shtetin e pavarur shqiptar. Sikurse do të shprehej miku i tij, Luigj Gurakuqi në v. 1921, “influenca e ambientit ka një fuqi të madhe mbi veprimet e njerëzve”.<sup>833</sup> Edhe pas më shumë se dy dekadash Lef Nosi do të gjendet nën presionin e një zgjedhje të vështirë midis “bashkëpunimit” me pushtuesin gjerman apo t'i lëshonte kryet e shtetit shqiptar në duart e komunistëve jugosllavë që kontrollonin lëvizjen komuniste shqiptare sipas interesave të tyre. Ky as nuk është dhe as nuk do të shërbente si një justifikim për zgjedhjen që Lef Nosi bëri, pasi kjo zgjedhje sido që ta gjykojmë nuk u bë faktor përcaktues as për fituesit e as për humbësit. Por me këtë zgjedhje ai mendonte se po realizonte misionin e tij patriotik. Këtë e dëshmojnë edhe fjalët e Lefit në bisedë me mikun e tij, Afëz Musa Pasha. “Çunat janë të rinj, serbi jua ka me hile...”.<sup>834</sup> Që prej 1913-ës tokat e mbetura jashtë kufijve të shtetit shqiptar, vazhdonin të qëndronin të inkorporuara në kufijtë politik të fqinjëve tanë veriorë e jugorë. Për të ishte e qartë se me ndihmën e serbëve fati i Kosovës nuk do të gjente kurrë zgjidhjen e shumë dëshiruar nga L. Nosi e veprimtarëve të tjerë të Shqipërisë etnike, dhe për më tepër të shqiptarëve të Kosovës. Pranimi i ndihmës gjermane kundër rrezikut komunist duhet të shihet më tepër si një veprim oportunist, se sa pro Boshtit.<sup>835</sup> Dhe nëse këtu mendoj gabim kjo më shumë është çështje konceptesh pasi sipas L. Nosit diplomacia mbështetet në gjetjen e një

<sup>831</sup> *Bisedimet e Kuvendit Kombëtar*, tetor 1943, fq. 66

<sup>832</sup> AQSH, F. 32, D. 29, f. 5

<sup>833</sup> Gurakuqi, Mark. *Luigj Gurakuqi*, vepra të zgjedhura, Tiranë, 1961, fq. 291

<sup>834</sup> “Panorama”, 2012, 31 janar. “*Dokumentet, si u pushkatua Lef Nosi, miku i Qemal Stafës*”

<sup>835</sup> Hibbert, Reginald. Vepër e cituar, fq. 229



rruge të mesme të cilën e gjen vetëm përmes mbrojtjes me rigorozitet të parimeve duke përputhur të drejtat dhe nevojat e vendit me kushtet e politikës ndërkombëtare. Është fakt se kjo rrugë e mesme i çoi patriotët kuislingë në një udhë pa krye dhe kjo sepse momenti historik kërkonte tek ai një udhëheqës patriot si ai i kryengritjeve të viteve 1911-1912. Pavarësisht gabimeve, për aq sa mund të quhen të tilla, ajo që duhet vlerësuar janë edhe përpjekjet që ai bënte për të mbajtur në këmbë ndërtesën e shkatërruar të shtetit shqiptar i cili në përvjetorin e 31 të themelimit të tij paraqitej edhe më rëndë se ditëve të para të jetës së tij.

Nisur nga situata tepër e rëndë në të cilën ndodhej vendi si edhe nga domosdoshmëria për marrjen e masave për kapërcimin e vështirësive ekonomike tragjikisht të mëdha, në mbledhjen e datës 20 tetor kryetari i Kuvendit Kombëtar, Lef Nosi, propozoi krijimin e një komisioni të veçantë për shqyrtimin e të gjitha çështjeve ekonomike-doganore si edhe të çështjeve të tjera me rëndësi kombëtare.<sup>836</sup> Në mbledhjen e datës 21 tetor u zgjodh Këshilli i Lartë i Regjencës i përbërë nga “shkëlqesat e tyre Mehdi Frashëri, Fuat Dibra, Lef Nosi e Patër Anton Arapi”.<sup>837</sup> Me kërkesën që L. Nosi i drejtoi Papës Piu XII në Vatikan, ai arriti të sigurojë edhe lejen papnore që mundësoi vendosjen e Patër Anton Arapit në krye të shtetit shqiptar të ’43-it.<sup>838</sup>

Vetëm tre ditë pas shpalljes së anëtarëve të Regjencës vetë Radio Londra, e ndërgjegjshme për rrezikun dhe misionin që pushtetarët shqiptarë kishin marrë mbi vehte, do ti vlerësojë ata si atdhetarë që e kishin pranuar detyrën e caktuar nga pushtuesit gjerman në kundërshtim me vullnetin e tyre.<sup>839</sup> Por a do ta kishin çuar përpara misionin e tyre këta burra me përvojë politike nëse mesazhi i ardhur nga perëndimi do të kishte qenë ndryshe? Apo ishte ndryshimi i rregullave të lojës politike në mes të luftës që u dha dorë komunistëve shqiptarë që të akuzojnë këta burra, me kontribute në çështjen kombëtare dhe gjithë krahun politik që ata përfaqësonin, si antishqiptarë?

Lef Nosi do të qëndrojë anëtar i Regjencës deri në 25 tetor 1944. Duke parë përparimin e forcave komuniste, politikanë e ushtarakë me bindje antikomuniste në vend u grumbulluan në qytetin e Shkodrës. Në 12 nëntor 1944 ata zhvilluan një mbledhje në kuvendin françeskan të Shkodrës me pjesëmarrjen e Mehdi Frashërit, Patër Anton Arapit, Lef Nosit, Ibrahim Biçakut, Mit’hat Frashërit, Mustafa Krujës, Ali Këlcyrës etj. Synimi kryesor i tyre ishte organizimi i një qëndrese deri në një zbarkim të menduar anglo-amerikan, tek i cili kishin besim se do të ndalonte vendosjen e plotë të regjimit komunist në Shqipëri. Pjesëmarrësit në këtë mbledhje u ndanë në dy grupe, njëri i kryesuar nga Mehdi Frashëri që ishte për largimin nga Shqipëria dhe tjetri i drejtuar nga Patër Anton Arapi që këmbëngulte për qëndrimin në vend dhe për organizimin e qëndresës.<sup>840</sup> Me këta të fundit u bashkua edhe Lef Nosi i cili shpresonte edhe në ndryshimin e gjendjes

<sup>836</sup> *Bisedimet e Kuvendit Kombëtar*, 20 tetor 1943, fq. 18

<sup>837</sup> Po aty, f. 7

<sup>838</sup> Revista “Koleksionisti”, nr. 2, Tiranë, 1998, fq. 39

<sup>839</sup> *Historia e LANÇ të popullit shqiptar, 1939-1944*. Vëll. 3, Tiranë. 1988, fq. 369

<sup>840</sup> Dervishi, Kastriot. Vepër e cituar, fq. 533

ndërkombëtare. Për më tepër mosha e tij e thyer, 68 vjeçare, e bënte edhe më të vështirë largimin nga Shqipëria e kalimin e viteve të fundit të jetës në emigracion.<sup>841</sup>

Ndërkohë në faqet e shtypit komunist do të shkruhej: “Lef Nosi, Ibrahim Biçaku e Shefqet Vërlaci, të cilët përbëjnë boshtin apo trekëndëshin e tradhëtisë në Elbasan, duke parë rrezikun e humbjes së pozitave të tyre sunduese apo klasore, si rezultat i zhvillimit të LNÇ-re, lanë mënjanë grindjet mes tyre dhe u bashkuan nën drejtimin e padronit të ri, nazismit gjerman”.<sup>842</sup> Në funksion të së vërtetës historike duhet thënë se, gjatë kohës së pushtimit gjerman të vendit, në shtëpinë e “regjentit nazist e tradhëtarit”, Lef Nosit, gjetën strehim dy familje çifute, duke u bërë kështu pjesë e atyre që mbrojtën hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore, të cilët kurrësesi nuk mund të ishin aleatë të platformës naziste apo përkrahës të politikës së tyre.

Në fund të vitit 1944, forcat komuniste nisën operacionet për mënjanimin fizik të kundërshtarëve politik që ishin përzier ose jo me luftën. Në gjithë vendin filloi përndjekja e kundërshtarëve të regjimit të ri komunist që nuk ishin larguar nga Shqipëria e që kishin nisur një qëndresë antikomuniste të armatosur, të cilët komunistët e etiketonin si lëvizje “bandash”apo “diversantësh”.<sup>843</sup> Sikurse shprehet studiuesi H. Bogdan, në librin e tij “Nga Varshava në Sofje”, mbi zhvillimet politike të pasluftës, ai i jep rëndësi faktit se FNC-ar, i drejtuar nga komunistët filloi të eliminojë çdo forcë



Lef Nosi në gjyq. Viti 1946

opozitare. Nacionalistët, të njohur për nivelin e lartë të edukimit, për aftësitë e për forcën intelektuale, u ndodhën përballë komunistëve, të njohur për ideologjinë e tyre të masave, për konceptet sovjetike të luftës së klasave dhe për zëvendësimin e inteligjencës me grupet militante. Pa asnjë arbitër në mes e pa asnjë rregull loje, situata politike e nëntorit 1943- nëntor 1944 i ngjasonte një lufte të ashpër për pushtet.<sup>844</sup> Me mbarimin e luftës komunistët shqiptarë, që erdhën në pushtet pa institucionin e zgjedhjeve të lira, burgosën, luftuan e madje likujduan, jo vetëm politikisht por edhe fizikisht, kundërshtarët e tyre politik, po shqiptarë. Regjimi i ri gjykoi *a priori* një periudhë historike dhe një klasë politike, pa analizuar rrethanat, aktivitetin e qëndrimet konkrete të secilit protagonist të kësaj klase. Faktet tregojnë se pjesa kryesore e këtyre politikanëve ishin figura të njohura me kontribute të çmuara në historinë e kombit shqiptar, personalitete që gëzonin respekt në opinionin publik. Midis tyre gjendet edhe figura e Lef Nosit, emri i të cilit ndodhet në listën e 107 të pushkatuarve pa gjyq, në qytetin e Elbasanit, nga pushteti i ri popullor.<sup>845</sup>

<sup>841</sup> Gazeta “55”, Rrëfimet e Stiliano Nosit, dt. 29 mars 2008

<sup>842</sup> AME, F. 1, D. 6, f. 171

<sup>843</sup> Dervishi, Kastriot. Vepër e cituar, fq. 544

<sup>844</sup> Krasniqi, Afrim. *Partitë politike në Shqipëri në vitet 1920-2006*, Tiranë, 2006, fq. 89

<sup>845</sup> AME, F. 22, D. 4, f. 2

## PËRFUNDIME

Në përfundim të këtij studimi, nëpërmjet trajtimit të aspekteve kryesore të veprimtarisë politike të Lef Nosit në rrugën e vështirë të ngritjes, mëkëmbjes, ringritjes e konsolidimit të shtetit të pavarur shqiptar deri në mesin e dekadës së tretë të shekullit XX, bëmë përpjekje të ridimensionojmë figurën e Lef Nosit në faqet e historisë sonë kombëtare, vend të mohuar për gati gjysëm shekulli. Ndryshimet e erës së re demokratike sollën reformimin e plotë të sistemit politik dhe ekonomik të vendit, të cilat ndryshuan për pasojë, edhe pse me ritme më të ngadalëta, modelin e studimeve historike për personalitete dhe ngjarje të shekullit të kaluar, sipas të cilit cilido personalitet publik që dënohej politikisht nga mbartësit e drejtuesit e ideologjisë komuniste, etiketohej po kaq ashpër nga historiografia shqiptare e cila niste të ngrinte “akt- paditë” ndaj personazheve “negativë” të historisë së Shqipërisë.

Viktimat politike të viteve 1944-1946, nga rradhët e kundërshtarëve të regjimit, nuk ishin viktimat të luftës civile pasi “nuk kishte dy por një palë që kishte në dorë armën dhe vriste palën tjetër. Pra ishte luftë kundër një pjese të popullsisë”.<sup>846</sup> Regjimi u tregua i ashpër sidomos me të gjithë funksionarët e lartë që kishin bërë pjesë në qeveritë e viteve 1939-1944 apo kishin mbajtur poste drejtuese në administratën e kësaj periudhe. Ndër ta ishte edhe Lef Nosi i cili, pas largimit nga Regjenca, për 10 muaj qëndroi i fshehur në miq e shokë që nga malësia e Shkodrës e deri në qytet e rrethinat e Elbasanit.<sup>847</sup> Fillimisht shkoi në Shkodër ku Patër Anton Harapi e strehoi për disa kohë në institucionet fetare katolike të qytetit verior të Shqipërisë me shpresën se do të bëhej e mundur të gjendej gjuha e ndërmjetësimit me qeverinë komuniste. Por ndërsa zgjidhja nuk po gjendej e situata po rëndohej niset drejt qytetit të tij të lindjes për t’u strehuar tek miqtë e tij. Ai qëndroi për rreth 2-3 muaj në fshatrat e Elbasanit, në Shën-Gjon (Shijon) e më pas në Godolesh ku Komanda e Mbrojtjes së Popullit dërgoi menjëherë njerëz për të kryer kontrollat. Prej këtej strehohet në fabrikën e Nosëve në Elbasan. Lëvizja ishte kryeqyteti.<sup>848</sup> Në fillim të vitit 1945 ai zbulohet në Tiranë nga agjentët e sigurimit, teksa ishte nisur të dorëzohej tek anglezët. Nga dokumentet që ndodhen në arkivin e Sigurimit të Shtetit, Lef Nosi akuzohej si agjent i Shërbimit të Inteligjencës angleze (Intelligence Servis) të cilët, sipas këtyre burimeve, po përpiqeshin të organizonin largimin e tij jashtë vendit përmes misionit anglez në Shqipëri.<sup>849</sup> Arrestohet dhe bashkë me Patër Anton Arapin e Maliq Bushatin, në shkurt të 1946-ës iu zhvillua gjyqi në Tiranë, gjatë të cilit Lef Nosi as nuk pranoi t’u përgjigjej pyetjeve pasi e quante të paracaktuar vendimin e gjyqit. Ai u akuzua se kishte vrarë e plagosur 50 mijë shqiptarë dhe dënohet me vdekje.<sup>850</sup> Kjo akuzë L.Nosit iu bë jo nga turqit, as nga fashistët por nga ata shqiptarë që dorëzuan në duart e

<sup>846</sup> Krasniqi, Afrim. Vepër e cituar, fq. 89

<sup>847</sup> Revista “Koleksionisti”, nr. 2, 1998, fq. 40

<sup>848</sup> Gazeta “55”, Rrëfim i Stiliano Nosit, dt. 29 mars 2008

<sup>849</sup> Gazeta “Tema”- online, 2016, 9 prill. Auron Tare, “Si e arrestoi Sigurimi Lef Nosit”.

<sup>850</sup> Dervishi, Kastriot. Vepër e cituar, fq. 546

armiqve të ngahershëm, serbo-grek, të qindra e mijëra shqiptarëve, që kishin luftuar gjatë luftës, por edhe më parë, për të realizuar ëndrrën e bashkimit të shqiptarëve në një shtet të vetëm. Sikurse bëhet e ditur në lajmet e gazetës “Bashkimi”, gjyqi kundër regjentëve dhe kryeministrit, i quajtur “gjyqi ushtarak i Tiranës”, ndonëse asnjë nga të akuzuarit nuk ishte ushtarak, brenda pak ditësh dha dënimin kapital për tre të akuzuarit, ekzekutim me pushkatim.

Lef Nosi përpara se të ishte anëtar i Regjencës në shtetin shqiptar të 1943-1944-ës, kishte qenë nacionalisti që luftoi, bashkë me patriotë të tjerë, përmes shumë vështirësive, për ngritjen dhe mbajtjen në këmbë të shtetit shqiptar. Ai ishte patrioti, veprimtari, luftëtari, studiuesi, politikani, me një fjalë të vetme, ishte shqiptari i cili nuk e braktisi çështjen për të cilën punoi, Shqipërinë, gjatë gjithë jetës edhe në ditët kur jeta e tij u vu vërtetë në rrezik. Vendi i tij, do të mbetej kauza për të cilën ai do të sakrifikojë edhe jetën.

Lef Nosi provoi, bashkë me shumë shokë të tjerë të tij, ngushtësinë dhe padrejtësinë e gjyqimit të personazheve të politikës së asaj periudhe, moskuptimin e vëzhguesve të cekët të ngjarjeve historike dhe mungesën e mirënjohjes që duhet të kishte marrë pas një veprimtarie të gjatë e të pakursyer për vendin e tij. “Atdhetarë të shquar...- sikurse ishte edhe Lef Nosi – na shqiptarët i vramë me dorën tonë...i hoqëm jetë me plumba pushke.”- do të shprehej Ernest Koliqi në 1957-ën. Gjykimi mbi vlerën e një jete njerëzore e kaluar me dëshirën dhe vullnetin për t’i shërbyer çështjes kombëtare është një domosdoshmëri, në veçanti përballë të ardhmes.

Përtej vlerave të merituara të veprimtarisë shumëdimensionale të Lef Nosit, figura e këtij personaliteti nuk do të ishte plotësisht e qartë nëse nuk pasqyrohet tërësisht dhe vërtetësisht qëndrimi dhe aktiviteti i tij politik që nga faza e formimit deri në atë të ekzistencës dhe mbijetesës së shtetit shqiptar përballë goditjeve të konflikteve botërore. Aktiviteti politik i Lef Nosit paraqet një tërësi qëndrimesh në situata të ndryshme të realitetit të brishtë politik shqiptar, të cilat u bënë nxitje për ndërmarrjen e këtij studimi.

Figura e tij komplekse, e përfshirë tërësisht në historinë bashkëkohore shqiptare, mbarte jo pak përgjegjësi për t’u trajtuar. Për të kuptuar përmasat e aktivitetit të tij patriotik doli nevoja të rrëmoj në dokumentacionin e shumtë, por kompleks, të fillimshkullit të kaluar, për të shpërndarë mjergullën e dendur që ngriti diktatura komuniste, nëpërmjet zbulimit jo vetëm të dokumentave përshtues por edhe të fakteve të pakontestueshme mbi kontributin politik, publicistik e hulumtues të Lef Nosit. I parë në këtë kontekst, ky punim nuk ka për qëllim gjykimin apo vlerësimin e qëndrimit të tij politik, por parashtrimin në mënyrë koherente të veprimtarisë së tij që në momentet embrionale të procesit shtetformues në rradhët e shqiptarëve e deri në periudhën kur vet ekzistenca e shtetit shqiptar rrezikohej jo vetëm nga faktorë të jashtëm por edhe prej lojës së brendshme politike në vend.

Kontributet e para të Lef Nosit në veprimtarinë atdhetare, politike e shoqërore datojnë që në të kthyer të shekullit XIX dhe spikasin më konkretisht në fillim të shekullit XX. Ai iu bashkua radhëve të

veprimtarëve të lëvizjes kombëtare në një kohë kur kërkesat e tyre për shkronjat e shkollat shqipe i kalonin kufijtë e një lëvizje thjesht arsimore, pasi gjuha, si shprehje e identitetit të një kombi, ishte shtylla e bashkimit politik të shqiptarëve. Me veprimtarinë e kryer në fushën e arsimit, publicistikës e të kulturës kombëtare, me të drejtë sot, i është dhënë një vend i merituar përkrah aktivistëve më në zë të lëvizjes patriotike shqiptare. Lef Nosi punoi dhe veproi për kombin e tij, u rezistoi përndjekjeve e burgimit nga pushtuesit osmanë dhe për këtë u vlerësua nga bashkëkohësit e tij. *“Unë punën tuaj që keni bërë me Tomorri dhe me shumë të tjera gjëra atdhetarie, i di, i kuptoj dhe gjithnjë i kam simpatizuar, - i shkruante Kristo Dako në maj të vitit 1911.- E di se gjithnjë keni punuar për të mirën e të tjerëve...pa dyshim shpejt do të vijë koha kur shërbimet e tua do të çmohen nga të gjithë”*.<sup>851</sup>

Ai mbështeti dhe propagandoi projektin e një shteti të pavarur shqiptar të organizuar sipas modeleve përëndimore shumë më herët se kjo fitore të arrihet në vjeshtën e 1912-ës. Përvoja e fqinjëve ballkanikë, por edhe më gjerë, kishte krijuar tek ai bindjen se pa mbështetjen e një fuqie të madhe europiane suksesi i lëvizjes sonë kombëtare nuk do të ishte i plotë. Këtë bindje e vërtetuan vendimet që u morën në Londër në vitin 1913, kur pa këtë mbështetje ndërkombëtare, trojeve tona kombëtare iu shkëputën gjysma e tokave etnikisht shqiptare. Edhe kur në Paris, në vitin 1919, shtetet fituese të Luftës së Parë Botërore po vendosnin edhe për fatin e shqiptarëve, Lef Nosi do të mbrojë e do t'i qëndrojë pa mëdyshje kërkesës e të drejtës legjitime të shqiptarëve për të jetuar të bashkuar. Periudha e luftërave botërore përplasi në skenën politike shqiptare rryma të fuqishme interesash kombëtare e ndërkombëtare me ide aspak të qarta, herë përtëritëse e herë shkatërruese, saqë erdhi një çast në të cilin ngjarjet u bënë më të mëdha se njerëzit.

Nuk e shkëputi vëmendjen nga çështja kombëtare edhe gjatë internimit nga pushtuesit italianë, qëndrim që e bëri atë të gëzojë respekt të lartë në popull. Ndërsa me mbarimin e luftës ai u vra nga një pjesë e shqiptarëve dhe u vlerësua nga të huajt. Gjatë kohës së arrestimit, mikesha e tij Margaret Hasluck, me cilësinë e graduates së një ushtrie aleate, i shkruan një letër Enver Hoxhës ku i kërkonte anulimin e vendimit duke e përligjur mesazhin e saj me dokumenta e fakte që dëshmonin atdhetarinë e tij të kulluar. Por një javë më pas, në shkurt, Lef Nosi, në moshën 69 vjeçare, u pushkatua.<sup>852</sup>

Kur dëgjon për fatin e tij, Edwin Jacques u shpreh: “I gjori Lef! Ai kishte qenë një patriot shqiptar i klasit të parë, një nga etërit themelues të republikës së re. Kishte qenë një nga delegatët që miratoi vendimet e Kongresit historik të Manastirit në vitin 1908, duke i bërë një sfidë të hapur Perandorisë Osmane. Në kohën e turqve kishte rrezikuar vehten duke ndihmuar Klubin Shqiptar më 1910-ën, duke redaktuar gazetën kombëtare të Elbasanit *Tomorri*, duke përkrahur sistemin shkollor shqiptar të ndaluar dhe Shkollën Normale të Elbasanit, gjëra për të cilat mund të burgosej dhe të vdiste. Për këtë qeveria turke e kishte dëbuar me internim të përjetshëm, por e kishte liruar në prill të 1911-ës. Me t'u kthyer në Shqipëri ai e kishte vënë

<sup>851</sup> AQSH, F. 32, D. 55/1, f. 70

<sup>852</sup> *Elbasani-Enciklopedi*, Elbasan, Sejko, fq. 240

sërisht jetën në rrezik duke marr pjesë së bashku me Ismail Qemalin e patriotë të tjerë në mbledhjen historike të Shpalljes së Pavarësisë më 28 nëntor 1912 në Vlorë, ku kishte nënshkruar dokumentin si delegat i Elbasanit. Ai rrezikoi të akuzohej për tradhëti duke pranuar postin e ministrit të Postë-Telegrafave në qeverinë e re shqiptare dhe ishte zgjedhur nënkryetar i Senatit të Qeverisë së Përkohshme. Gjithashtu, ai kishte qenë ndër ata që paraqitën kërkesën për një Shqipëri të lirë në Konferencën e Paqes në Versajë në vitet 1919-1920. Lef Nosi! Ç’njëri që ishte! Ai ishte një fisnik i kulturuar dhe një patriot i flaktë. Mirëpo regjimi komunist e demaskoi si *armik të popullit* dhe e ekzekutoi. Ja pra ç’ironi! Ai dhe patriotë të tjerë gjetën vdekjen jo nga shtypësit turq, por nga *çlirimtarët shqiptarë!*”<sup>853</sup>

Ndonëse ishin nisur nga një qëllim fisnik, të mos sakrifikonin Shqipërinë për një luftë, fatin e së cilës nuk mund ta impononin, dhe për të mos vlarë më kot shqiptarë në mes tyre, pasi ky kishte qenë efekti parësor i aleancës së Fuqive Perëndimor me Rusinë komuniste në mjedisin politik shqiptar, forcat nacionaliste, të përfshira në përpjekjet për ngritjen në këmbë të ndërtesës shtetërore shqiptare, u përballën jo vetëm me braktisjen e Aleatëve perëndimorë por edhe me humbjen e mbështetjes nga masat e gjera të popullit, fakt i cili, ndër shumë faktorë të tjerë, solli edhe dështimin e masave të tyre qeverisëse. Duhet theksuar se një nga faktorët kryesorë të disfatës së nacionalistëve, të përfshirë ose jo në qeverisje, pra edhe e L. Nosit, ishte lufta e brendshme, e pamëshirshme, e përgjakshme e cila vuri në lëvizje edhe makinën ushtarake gjermane e që solli për pasojë me mijëra të vlarë në rradhët e shqiptarëve liridashës. Pas kapitullimit të Italisë fashiste përfaqësues të kastës politike ekzistuese në vend, nacionalistë, luftëtarë të pavarësisë, diplomatë të çështjes kombëtare u vunë përpara dilemës: ose të organizoheshin për t’u mbrojtur përmes vlerave shqiptare, ose ta dorëzonin fatin e vendit tërësisht në dorë të vendimeve diplomatike të së nesërme. Për një figurë si Lef Nosi, që eksperiencën e tij politike e kishte ngritur mbi tabanin e luftës për zgjidhjen e çështjes kombëtare, dhe që njëkohësisht i njihte mirë marrëdhëniet diplomatike ndërkombëtare, duket se kishte dalë në përfundimin: Diplomacia ishte një armë në duart e Fuqive të Mëdha dhe një Shqipëri e vogël, e shkatërruar nga lufta, sikurse edhe më parë, rrezikonte të përdorej përsëri si monedhë shkëmbimi. Shqipëria në kufijtë e 1913-ës për të nuk do të ishte një Shqipëri as e fortë politikisht dhe as e realizuar etnikisht. Ndërsa në 1912-ën shqiptarët të bashkuar i gëzoheshin shpalljes së shtetit të parë të pavarur shqiptar, tre dekada më pas ata jo vetëm janë të përçarë politikisht, por kishin drejtuar armët kundër njëri-tjetrit.

Tjetërsimi dhe mosrespektimi i figurave dhe vlerave të kombit shqiptar i kishte fillesat pikërisht tek kjo përplasje e brendshme, e organizuar dhe e armatosur midis forcave politike e ushtarake në vend, të cilat duke përfshirë me vete edhe masat popullore që i mbështesnin ato, i vunë shqiptarët përballë njëri-tjetrit, në dy kampe armiqësore dhe ndërluftuese mes tyre. Ky konflikt ushtarak mes të djathtës e të majtës jo

<sup>853</sup> Jacques, Edwin. *Shqiptarët...*, Tiranë, 1995, fq. 381-382



vetëm përbën natyrën vetvrasëse të Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri, por u shoqërua me pasoja tragjike jo vetëm për atë kohë por edhe për gati gjysëm shekulli më vonë, efektet e të cilit ende nuk janë fshirë tërësisht. Historia filloi të shkruhet e të lexohet ndryshe, duke u shmangur dukshëm nga e vërteta. Figura të njohura të botës shqiptare, sikurse ishte edhe Lef Nosi, u trajtuan në mënyrë të njëanëshme duke marrë parasysh vetëm aspekte të veçanta të angazhimit të tyre në çështjen kombëtare. Pavarësisht baticave e zbaticave në veprimtarinë e tij, ai do të punojë me përkushtim në shërbim të çështjes kombëtare duke i qëndruar përherë besnik idealit kombëtar, shqiptarizmit. Nuk mund të përparojë ajo shoqëri e cila përbuzë me lehtësi vlerat dhe përpjekjet e bëra në dobi të idealeve kombëtare.

Lef Nosi u mënjanua në mënyrë të qëllimshme nga forcat që kishin marrë pushtetin, pasi në duart e tij u valëvit i vetmi flamur që mbante simbolet e atdhetarizmit, flamuri i shqiptarëve të kudondodhur, dhe se qëndroi në kahun e kundërt të forcave politike që erdhën në pushtet pas përfundimit të luftës. Pasuria e tij u bë pre e një plaçkitje të pashembullt. Por kur komunistët bastisën shtëpinë e tij gjetën aty koleksionet e trakteve të tyre, të cilat as ata vetë nuk ishin kujtuar t'i ruanin, e që Lef Nosi i kishte grumbulluar në mes të luftës si koleksione.<sup>854</sup>

Ai la pas jo vetëm gjurmët e aktivitetit të tij politik, dëshmi të angazhimit atdhetar, por u la brezave trashëgim thesarin e mbledhur gjatë një jete, pronë e kujtesës sonë kombëtare historike. Biblioteka e tij e pasur, e cila cilësohet e dyta pas asaj të Mithat Frashërit, përbën bërthamën e fondit të albanologjisë dhe ballkanologjisë në bibliotekën e Elbasanit dhe është një pasuri e vyer kombëtare. Me ato 10-ra e 100-ra faqe të shkruara e të përkthyer,<sup>855</sup> figura e veprimtaria e Lef Nosit krijon hapësira për përgjithësime. Duke hulumtuar aktivitetin e tij, arrijmë të shohim tek ai njeriun e përkushtuar e të sakrifikuar për kombin e tij, si dëshmi historike. Një jetë kushtuar çështjes kombëtare, përtej dritë-hijeve që mund të shquhen në të, kërkon një gjykim të drejtë jo vetëm prej atyre që ia kanë njohur dhe vlerësuar meritat e tij kundrejt Atdheut, por edhe, dhe sidomos prej atyre që vetë nuk kanë vënë as edhe një gurë në ndërtesën e shqiptarizmit.

Figura si Lef Nosi u bënë pre e diktaturës komuniste, u përndoqën, u vranë, vdiqën së menduari; por çdo vdekje ka qenë disa herë lindje e në këtë lindje është përfutur e ardhmja. Sikurse shprehet studiuesi i njohur elbasanas, Prof. Tomorr Plangarica: “Vetë koha nuk pati pushtet mbi veprën e Lef Nosit që ta shkulë nga kujtesa shoqërore, nga Historia!”

Nderim për gjakun e atyre mijëra shqiptarëve të vrarë gjatë pushtimit nazi-fashist të vendit, nderim dëshmorëve të kombit, respekt për jetët e pakursyera të martirëve të diktaturës komuniste që nisi të instalohej në Shqipëri ndërsa Lufta e Dytë Botërore ende nuk kishte përmbyllur faqet e fundit të historisë së saj.

<sup>854</sup> Gazeta “55”, Tiranë, 28 mars 2008

<sup>855</sup> L. Nosi ishte njohës i pesë gjuhëve të huaja: turqisht, greqisht, gjermanisht, frëngjisht e italisht.

## BIBLIOGRAFIA

### 1. BURIMET ARKIVORE

#### A- Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH I RSH):

- Fondi “Lef Nosi”, nr. 32
- Fondi “Faik Konica”, nr. 13
- Fondi “Aqif Pashë Biçaku”, nr. 68
- Fondi “Ismail Qemali”, nr. 20
- Fondi “Jashar Erebara”, nr. 23
- Fondi “Dokumentet e Kuvendit të Vlorës”, nr. 11
- Fondi “Koleksioni i klubeve e shoqërive patriotike”, nr. 102
- Fondi “Prefektura e Elbasanit”, nr. 153
- Fondi “Katundaria e Elbasanit”, nr. 273
- Fondi “Bashkia Elbasan”, nr. 272
- Fondi “Prefektura Elbasan”, nr. 271
- Fondi “Zv. Mitropolia Durrës”, nr. 136
- Fondi “Drejtorja e Përgjithshme e policisë”, nr. 253
- Fondi “Këshilli i Ministrave”, nr. 149
- Fondi “Arkivi i Partisë”, nr. 42/AP, 270/AP, 272/AP

#### B- Arkivi i Institutit të Historisë. Dokumentat e Arkivit të Vjenës.

*Shqipëria në dokumentet austro-hungareze 1912*, vëll. II-III-IV-V-VI. Botimet Albanologjike. Tiranë, 2012

#### A- Arkivi i Muzeut Etnografik Elbasan (AME)

#### B- Arkivi i bibliotekës së Elbasanit. Fondi i Albanologjisë

### 2. LITERATURA

- Akademia e Shkencave të Shqipërisë *Historia e Shqipërisë*, Vëll. II, Tiranë, 1984
- Akademia e Shkencave të Shqipërisë *Historia e popullit shqiptar*, Vëll. II, TOENA, 2002
- Akademia e Shkencave të Shqipërisë *Historia e popullit shqiptar*, Vëll. III, Tiranë, 2007
- Akademia e Shkencave të Shqipërisë *Historia e popullit shqiptar*, Vëll. IV, Tiranë, 2008
- Akademia e Shkencave, *Aleksandër Xhuvani*, Vepra II, Tiranë, 1990

- Instituti i Historisë, Verli. Marenglen & Duka. Ferit, *Dokumenta historike në mbrojtje të çështjes kombëtare, 1924. Lef Nosi*, Tiranë, 2007
- *Dokumenta historike për ti shërbye histories sonë kombëtare*, Lef Nosi, 1924
- *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj*, Tiranë, 1963
- *Hstoria e LANÇ-it të popullit shqiptar*, Vëllimi III, Tiranë, 1988
- *Bisedimet e kuvendit kombëtar*, Tiranë, 1943
- *Kujtime nga lëvizja për çlirim kombëtar*, Tiranë, 1962
- *Elbasani- Enciklopedi*, Elbasan, Sejko, 2003
- *Normalja në traditë*, Elbasan, 1995
- *Normalja në fokus të bashkëkohësisë*, Elbasan, Silver, 1999
- *Kombi*, New Jork, USA, shbONUFRI, 1997
- *Rreth sfidave ndërkombëtare të etnologjisë shqiptare*, Tiranë, 2012
- Selenica, Teki. *Shqipëria në 1927*, Tiranë, 1928
- Kito. Petro, *Elbasani në luftën për çlirim*, Tiranë, 1971
- Myzyri, Hysni. *Shkollat e para kombëtare shqipe*, Tiranë, 1978
- Hoxha, D. Ibrahim. *Nëpër udhën e penës shqiptare*, TR: 1986
- Hoxha, Teuta. *Ismail Qemali. (Përmbledhje dokumentash)*, Tiranë, 1982.
- Shkodra, Zija. *Qyteti shqiptargjatë Rilindjes Kombëtare*, Tiranë, 1984
- Hoxha, D. Ibrahim. *Nëpër udhën e penës shqiptare*, Tiranë, 1986
- Naska, Kaliopi. *I. Qemali në lëvizjen kombëtare shqiptare*, Tiranë, 1987
- Durham, Edith. *Brenga e Ballkanit*, Tiranë, 1990
- Durham, Edith. *20 vjet ngatërresa ballkanike*, Tiranë, 1994
- Durham, Edith. *20 vitet e trazirave të mëdha*, Tiranë, 2001
- Vllamasi, Sejfi. *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897- 1942)*, Tiranë, 1995
- Duka, Valentina. *Shqipërisë në vitet 1912-1914*, Tiranë, Toena, 1997
- Shatri, Muhamet. *Dokumente franceze për Shqipërinë dhe shqiptarët më 1912*, Tiranë, Toena, 2012
- Frashëri, Mehdi. *Nacionalizma shqiptare*, Tiranë, 1943
- Frashëri, Mehdi. *Probleme shqiptare*, Tiranë, 2001
- Frashëri, Mehdi. *Kujtime*, Tiranë, 2005
- Gurakuqi. Karl, *Luigj Gurakuqi*, Tiranë, 1961
- Graceni. Bardhyl, *Aleksandër Xhuvani*, Tiranë, 1980
- Çami, Muin. *Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare 1914-1918*, Tiranë, 1987
- Vllamasi, Sejfi. *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)*, Tiranë, 1995
- Zavalani. Tajar, *Historia e Shqipnis*, Tiranë, 1998

- Hysi, Gramoz. *Organizimi i shtetit shqiptar dhe lufta politike rreth tij në vitet 1920-1924*, Tiranë 1988
- Butka, Uran. *Gjeniu i kombit*, Tiranë, Drier, 2000
- Jorgaqi, Nasho. *Faik Konica*, Vepra 3-4, Tiranë, 2001
- Kruja, Mustafa. *Antologji Historike*, Sejko, Elbasan, 2001
- Duka, Valentina. *Çështje të historisë bashkëkohore të shqiptarëve*, Tiranë, 2003
- Kotherja, Hyqmet. *Historiku i Bashkisë së Elbasanit 1912- 2002*, Silver, 2003
- Kotherja, Hyqmet. *Pavarësia e Elbasanit*, Tiranë, 2012
- Vlora, Eqrem. *Kujtime 1885-1925*, Tiranë, 2003
- Puto Arben. *Historia diplomatike e çështjes shqiptare*, Tiranë, 2003
- Puto Arben. *Pavarësia shqiptare në tryezat e diplomacisë. (1912-1914)*, ËESO, Tiranë, 2007
- Puto Arben. *Shqipëria politike 1912-1939*, Tiranë, 2009
- Myzyri, Hysni. *Shkolla Normale e Elbasanit*, Tiranë, albPAPER, 2004
- Frashëri, Kristo. *Historia e Tiranës*, Tiranë, TOENA, 2004
- Dervishi, Kastriot. *Historia e shtetit shqiptar 1912-2005*, Tiranë, 2006
- Butka. Uran, *Lufta civile në Shqipëri, 1943-1944*, Tiranë, 2006
- Mita. Rudina, *Elbasani. Jeta politike në vitet 1920-1924*, Tiranë, 2006
- Krasniqi, Afrim. *Partitë politike në Shqipëri në vitet 1920-2006*, Tiranë, 2006
- Gurakuqi, Romeo. *Shqipëria e çështja shqiptare pas Luftës së Parë Botërore*, Shkodër, 2007
- Floqi, Thanas. *Fytyra e vërtetë e Haxhi Qamilit*, Tiranë, 2008
- Shatri, Muhamet. *Dokumente franceze për Shqipërinë dhe shqiptarët më 1912*, Vëllimi II, Tiranë, 2012
- Cankja, D. & Hatellari, M. *Kontributi i atdhetarëve elbasanas*, Elbasan, 2012
- Peza, Majlinda. *Zhvillimet politiko-arsimore në trevën e Elbasanit në vitet 1878-1914*, Doktoratë, Tiranë, 2014
- Nika, Thimi. *Historia e filatelistë shqiptare*, Tiranë, 2013
- Rocco, Roberto Morocco. *Kombësia dhe feja në Shqipëri. 1920-1944*, Tiranë, 1994
- Clayer, Nathalie. *Feja, krijimi i kombit dhe shoqëria*, Tiranë, 2012
- Clayer, Nathalie. *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*, Tiranë, 2009
- Jelavich, Charles & Barbara. *Themelimi i shteteve kombëtare të Ballkanit, 1804- 1820*, Dituria, 2004
- Erickson, Charl Telford. *5 vjet në Shqipëri*, Tiranë, 2003
- Erickson. Charles Telford, *Shqiptarët. Enigma e Ballkanit*, vëllimi II, Edualba, 2012
- Swire, Joseph. *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie*, Dituria, 2005
- Neuwirth. Hurbert, *Qëndresë e bashkëpunim në Shqipëri*, Tiranë, 2006

- Kamp. Peter, *Kujtime që nuk shlyhen*, Tiranë, 1997
- Hibbert. Reginald, *Fitorja e hidhur*, Tiranë, 1984
- Fischer. Bernd J, *Lufta e Dytë Botërore në Shqipëri*, Tiranë, 2012
- Gjenerali Davies, *Aventura ilire*, Londër, 1952
- Amery. Julian, *Bijtë e shqipes*, Tiranë, 2002
- Bethel. Nikolas, *Tradhëtia e madhe*, Tiranë, 1993
- Vickers. Miranda, *Shqiptarët. Një histori moderne*, Tiranë, 2008
- Phipps. S. John, *Pullat e postat e Shqipërisë dhe Epirit.1878-1945*, Korçë, 2002


### 3. PERIODIKË


- Gazeta “Albania”, Londër, 1907-1909
- Gazeta “Drita”, Sofje, 1902- 1907
- Gazeta “Drita”, Manastir, 1912
- Gazeta “Kalendari Kombiar”, Sofje, 1905- 1908
- Gazeta “Kombi”, Boston Mass, 1908
- Gazeta “Bashkimi i kombit”, Manastir, 1909
- Gazeta “Lirija”, Selanik, 1908- 1910
- Gazeta “Flamuri”, Boston, Mass., 1910
- Gazeta “Tomorri”, Elbasan, 1910
- Gazeta “Bashkimi”, Selanik, 1910
- Gazeta “Dielli”, Boston Mass, 1910
- Gazeta “Sopata”, Egjipt, 1910
- Gazeta “Liri e Shqipërisë”, Sofje, 1911
- Gazeta “E vërteta”, Pera, Stamboll, 1911
- Gazeta “Trumbeta e Krujës”, Saint Louis, Missouri, USA, 1911
- Gazeta “Koha”, Korçë, 1925
- Gazeta “Përlindja e Shqipëries”, Vlorë, 1913-1914
- Gazeta “Liri e Shqipërisë”, Sofje, 1913-1914
- Gazeta “Shqypnia e Re”, Shkodër, 1913-1914
- Gazeta “Vëllazënija”, Shkodër, 1917
- Gazeta “Lidhja kombëtare”, Shkodër, 1915
- Gazeta “Taraboshi”, Shkodër, 1914
- Gazeta “Fletorja zyrtare”, Tiranë, 1922

- Gazeta “Shkumbini”, Elbasan, 1921
- Gazeta “Dit’ e Re”, Tiranë, 1922-1923
- Gazeta “Ura e Shkuminit”, Elbasan, 1923-1924
- Gazeta “Koha”, Korçë, 1924
- Gazeta “Republika”, Shkodër, 1924
- Gazeta “Shqipëria e Re”, Kostancë, Rumani, 1924
- Gazeta “Bashkimi”, Elbasan, 1924
- Gazeta “Shqiptare”, Tiranë, 1936
- Gazeta “55”, Tiranë, 2008
- Gazeta “Panorama”, Tiranë, 2012
- Gazeta “Tema” online, Tiranë, 2106
- *Fletorja zyrtare*, Tiranë, 1943-1944
- Revista “Albania”, Bruksel, 1907
- Revista “Albania”, Londër, 1909
- Revista “Kopështi Letrar”, Elbasan, 1918-1919
- Revista “Hylli i dritës”, Shkodër, 1943-1944
- Revista “Koleksionisti”, Tiranë, 1998-1999











*Një herë vdes njeriu. Unë iki me ndërgjegje të pastër se nuk kam kryer asnjë faj,  
kam punuar për Shqipërinë!*

*Lef Nosi*



**PËRMBLEDHJE NË ANGLISHT**

This study on the topic: "**Lef Nosi in the Albanian political life of 1900-1924**" aims to objectively reflect by shedding light on the entire political activity of Lef Nosi, an activity which is as wide as it is complex and extends over a period of time packed with educational, cultural and liberation movements, in which he has been an active participant as an organizer, as a leader and as a politician. This work, the fruit of several years of work, started as an incentive, which in the framework of the requests for reviewing the history of the Albanian people in the light of new archival sources, aims to identify, realistically and far from subjectivism, the totality of views, actions and the political attitudes of Lef Nosi. This impetus became the basic motive to research, with truth and seriousness, the activity of the activist from Elbasan, a city which was identified from an early age as an important center of Albanian education and national movement, since the first years of the century XX, a time when L. Nosi began to stand out with his activity within the movement for the acquisition of national rights, until the end of the conflict situations, which produced in the Albanian political environment, the First World War and the political clashes in the middle of 20s of the century XIX.

At the end of the war, the Albanian communist forces that came to power, without the institution of free elections, imprisoned, fought and even liquidated, not only politically but also physically, their political opponents who were also Albanians. One of these opponents of the political line of the communist leadership was Lef Nosi who was among those figures who for decades was denied by the regime, who not only ignored him, but made accusations that took life from his position. delicate in the moments of supra-political clashes of 1943-1944 and at the same time were inspired by the political convictions of L. Nosi, who, in fact, hated communism. Albanian historiography was silent, faded, even denied or alienated the traces he had left in history. Even when we started this paper, focused on L. Nosi's contribution to the political life of the country, what I had known or read in the pages of history books was not only very little but also very different. Even in those cases when I had encountered his name, mainly, he was part of the "black chronicle" in the communist press of the time. As I became acquainted with his activity, I found him completely different and much more Albanian than those who had undertaken to judge him for anti-Albanianism. Calm, serious, a man who held no political grudges, sober in his thoughts and persistent in the ideals he defended. Based on these elements, I began to understand all the events, all his useful and useless actions for the Albanian reality.

Meanwhile, after the '90s, the process of reviewing the facts and evaluating the role and activity of the figures who had run the country or had played important roles in certain periods of our history had begun. The discovery of new documents and facts had made it possible to refute a large part of the theses and conclusions of the official Albanian historiography during the period of communist dictatorship, thus presenting the rest of the historical truth which shed light on the political platform of Lef Nosi.

Thousands of pages of historical documents, with many study values, collected and fanatically preserved by Lef Nosi, today constitute one of the most valuable treasures in the field of albanological sciences. In the history of a nation, the heritage is the "school" to nurture knowledge about the activity of those who, in the midst of sacrifice and risk, worked to preserve alive the history and values of a people; it is the "diploma" that proves the existence of today.

Lef Nosi's multidimensional activity, as an interesting series of events, with all the ups and downs in the intensity of his enterprises, with the totality of light-shadows that make up the spectrum of commitments he has realized, began to attract the attention of scholars, fellow citizens. and many genuine historians in the field of Albanian historiography who through their writings, with important study values, became a motivating factor for undertaking such an initiative to present, through a scientific paper, the political activity of Lef Nosit. Seen in this perspective, this paper aims to address and analyze the involvement of L. Nosi in the political and educational movement, liberation and state-building in a period of time that begins

with the developments of the national movement of the early twentieth century, develops further with the events that precede and followed the declaration of Independence and the creation of the first Albanian state and its position in the internal political clashes from v. 1913 to v. 1924. The study also seeks to identify the factors that have conditioned his attitudes, views and commitments, political or with political influences, in the life of the country but always seriously adhering to objective treatment, away from subjective and one-sided interpretations. For this reason in the process of scientific research we have relied on the methodology of recognizing and evaluating used documents, archival sources, journalistic articles or other studies, in the context of confrontation and comparison with other scientific materials, having as main criterion authenticity. and their reliability. This paper undertakes in the light of new data to convey a story of the political life of Lef Nosi, seen through documents, to fill that part which was empty, was changed or was ignored, for many reasons, by historical thought first official v. '90 in Albania. In this context, in the attitudes and interpretations presented for certain aspects of this platform, the political figure of L. Nosi has been treated starting not from the prejudice for the "hero" or "traitor", but seen in relation to what he has actually given.

In highlighting this wide range of Lef Nosi's engagements in the Albanian political life, spanning several decades, a diverse source material, archival and bibliographic, official and publicist, public and personal, has been used. Thus, for the material used, in the first place, the documentary material extracted from the funds of the Central State Archive was used, in which the personal fund of Lef Nosi and other historical personalities, I. Qemali, Fan Noli, L. was examined. Gurakuqi, Aqif Pasha Bicakciu, Mit'hat Frashëri and many others, with whom he cooperated or had contacts and correspondence; the funds of the Prefecture of Elbasan, of the organizations and institutions where he not only adhered but through which his political attitude and commitment is evidenced; The archive of the Institute of History has been researched, mainly the funds of the Vienna archive and English and German documents, the publication of the Institute of History with documents issued from the fund of Lef Nosi "Historical documents 1912-1918" etc. Lef Nosi's activity and political opinion has been reflected through the official acts that bear his signature, as well as through the correspondence he has had with Albanian and foreign friends. Among the archival sources, the material collected from the Archives of the Ethnographic Museum of the region of Elbasan, memories of his contemporaries, funds of Albanology in the National Museum and the Museum of Elbasan, etc. were used.

Referring to the topics that this study conveys, through the evidence of Lef Nosi's activity according to the chronological criteria, we have conceived a structure consisting of an introduction, four chapters, each divided into several sub-topics, an epilogue and a section of conclusions. The introduction provides an overview of Lef Nosi's family background, the environment in which he was born, raised and educated, and in particular where his first engagements in the national movement will begin. An important place is also occupied by the general presentation of his activity in sync with the chronological criterion of the development of the main political events in the country. It focuses on the reflection of the main aspects of L. Nosi's role during the most important stages of modern Albanian history during almost the first three decades of the twentieth century. Also, a summary of the multidimensional activity of Lef Nosi as an archivist, folklorist, ethnographer, collector of archaeological material is given, a task for which he was appreciated not only by Albanians but also by foreign friends of Albania and Albanians. As such, the introduction serves as a prologue to L. Nosi's engagements in the political life of the country during the years 1900-1924, issues that constitute the main axis of analysis in our topic.

The first chapter "In the beginnings of political activity. (1900-1911)", aims to present and address the involvement of Lef Nosi in the development of political and educational events of the early twentieth century, a time when in the region of Elbasan were identified the first forms of anti-Ottoman resistance which had begun since the involvement of the population of the region in the political developments produced by the Albanian League of Prizren (1878). At this time in the Elbasan region the movement for the Albanian school was fused with the armed struggle that had united Muslims and Orthodox for the benefit of the cause of national liberation. The young man from Elbasan will also find it appropriate and will work in support of the demands of



an autonomous nature aimed at the official recognition of the Albanian language and the opening of national schools during which he will have to face the pressure of the Ottoman central government. as well as the position of the Patriarchate of Istanbul that with its policy was placed in a diametrically opposed position to any attempt aimed at the national awakening of the Albanians. As soon as he returned from Athens, where he had come in contact with the patriotic districts in exile, Lef Nosi will give his contribution, even financially, for the secret introduction of books, newspapers and brochures in the Albanian language, thus coming to assistance to the activity of Albanian patriots abroad. In the continuation of this chapter, an important place is occupied by the presentation of Lef Nosi's political views both regarding the relations that the Albanians should establish with the Great Powers and the efforts that he will make to design in a western country, the leading center. of the national movement. Returning from the USA, where among the Albanians living there he had heard often talked about the necessity of creating, in one of the capitals of Europe, a party which would propagate the political program of the Albanians in the world, which would provide them with international support, on October 4, 1907, L. Nosi will become one of the propagandists of the program of another society, the "National Albanian Party" based in London, a city that for the Elbasan activist with pro-Western orientation, which during his years of study in Athens was known for the role played by Great Britain in the struggle for independence of Greece and the other peoples of the Balkans, was "the best country from a political point of view".<sup>856</sup> This is where his political ideas about the establishment of an Albanian state based on the values of Western civilization were reflected, which were reflected in the program of the society "Albanian National Nation", which, according to its initial name, was conceived as a political party, concept that was foreign to the Albanian districts of the time, but that could not become part of the tangible Albanian reality. The following study reflects the efforts and contribution that L. Nosi will give in the new situation created after the promulgation of the Constitution (1908) in order to develop Albanian education and schools, through the establishment during this period of some of the patriotic clubs and societies of cultural, which not only became nationwide educational and cultural institutions, but also undertook the organization and preparation of conditions for the development of the work of the Educational Congress in Elbasan. Such were the clubs "Bashkimi", "Vllaznia", "Bashkimi i ri" and the music society "Aferdita", the central and very active figure of which was L. Nosi. Although under the conditions of foreign rule and under the pressure of religious divisions fueled by the Greek Patriarchate, the patriots of Elbasan, within the national educational movement, did not stop the efforts to make possible the teaching of the Albanian language in foreign schools, Turkish and Greek, of the city. Even in December 1908, the club of Elbasan, in order to avoid the obstacles that the young Turks posed to the efforts for the opening of Albanian schools, had proposed to all Albanian clubs to forward to the Turkish parliament and the Albanian deputies in it, the request for official recognition of Albanian nationality, the completion of which would provide Albanians with national rights in the field of culture and education.<sup>857</sup> At the same time, we have reflected here the efforts that he, along with other patriots, will make for the proper functioning of the Elbasan Normal as well as the resistance to the attempts of the Turkish government to introduce the Arabic alphabet in schools for learning the Albanian language. In the last issue of this chapter we have emphasized the intellectual activity of L. Nosi in the field of journalism, realized through the publication of the temporary political and literary "Tomorri", which will become the tribune where the representatives of the progressive and more democratic movement of the time will raise their voice about the problems that weighed on the Albanian issue and where the events, problems and concerns of the time were echoed. Lef Nosi's commitment to the national cause, through publications and articles in "Tomorri", while being supported and praised by Albanian patriots in the country and in the colonies in exile, on the other hand, in the face of the punitive policy that the Young Turk government had begun put him in front of a serious danger to life.

---

<sup>856</sup> Central State Archive, Fund. 32, File. 6, sheet. 4

<sup>857</sup> *History of the Albanian people*, Vol. II, TOENA, 2002, p. 402

In the second chapter, "From the fight for independence in the first Albanian state (1912-1914)", we are focused on addressing the role of L. Nosi in the most important event in the history of the Albanian people, on the road to the Declaration of Independence, which starts with his active activity in the framework of the anti-Ottoman detachments that were formed in the area of Elbasan during the uprisings of 1911-1912, where he will be one of the central figures of the Revolutionary Committee of Elbasan. Witness and participant of the events of 1912, Lef Nosi collected and preserved a complete documentation that included correspondence, speeches, announcements and memoirs of various personalities on the fiery days that Albania was going through.<sup>858</sup> As one of the organizers and leaders of the insurgent movement in the Elbasan area, Lef Nosi will try to engrave in the memory of the nation the historic wars of the Albanians to gain their legitimate rights. His activity culminates with the continuous and persistent work as Minister of Posts and Telegraphs in the new Albanian government elected by the National Assembly of Vlora. In this context, we have especially reflected the main directions of his activity for the establishment and organization of the Albanian postal system and for the establishment of telegraphic contacts not only in the entire Albanian space but also, especially, with the outside world, the connection with which, in those moments when the fate of the lands and the Albanian population were being discussed, it took on an even greater importance. In the conditions when the new Albanian state lacked finances and the coffers were empty, Lef Nosi aimed that through the sale of postage stamps, which he himself had devised and for which the demands were great, both inside and outside the country, he could state revenues increased. Although he was appointed to head the Ministry of Posts, he will work hard to use the Albanian language in all postal and telegraph offices, as well as to protect and expand the network of Albanian schools. Through the use of official sources of the Provisional Government of Vlora, articles in the press of the time and in particular the materials that Lef Nosi has collected and preserved on the activity of the Albanian state, in the last issue of this chapter we intend to present the position he took towards the separatist attempts and political ambitions of Esad Pasha Toptan for power. Through his correspondence, especially with Luigj Gurakuqi, we aimed to reflect the efforts he makes to avoid bloodshed and fratricidal war between Albanians and consequently to maintain and strengthen the internal and external positions of the Albanian national state.

In the chapter "Lef Nosi during the years of the First World War (1914-1918)", we tend to highlight the situation in the country since January 1914, when the Government of Vlora resigned and at the same time ended the activity of L. Nosi as Minister of Post, but not his contribution in this area. Although not included in the government, the patriotic districts in the country which in November 1913 had joined the decision of the Great Powers on the election of the German prince on the Albanian throne, seeing Wied as a symbol of independent Albania, not only did not they abandoned him but continued to support the king and his government to overcome internal difficulties and to face external dangers. Careful in gathering the historical fact, Lef Nosi keeps notes on the main events of 1913, on the Serbian operations in the north of the country and on the actions of the Greek army that continued to occupy the southern areas of Albania. The following are the political developments after the arrival of Prince Wied at the head of the Albanian state, an event that was welcomed by the Elbasan activity but which unfortunately did not realize its ideal for an Albanian state of the western model. The chaotic Albanian domestic reality and the failures in foreign relations led to the bankruptcy of Prince Wied's government in Albania. In the continuation of this chapter, an important place is occupied by the treatment of the general political situation in the country after the departure of Prince Wied from the Albanian capital, an action which will not only ignite even more the demand for the Turkish prince from the insurgents of Central Albania, but will awaken once again the political intentions of Esad Pasha to occupy the head of the Albanian state. In the face of the general anarchy that had gripped the country and when Albanian lands, in the north and south of the country, were occupied by Balkan neighbors, Lef Nosi chooses to oppose, not only politically but also militarily, Pasha Toptanas's plans for power and organize resistance. anti-serbian in the north of the country. It is to be appreciated that L. Nosi, as a far-sighted thinker and careful

---

<sup>858</sup> These materials became known with the publication in 1924 of "Historical Documents in defense of our national cause. 1924 "

activist, regularly kept records of important events and phenomena of the time. Collects and preserves memories and correspondence of well-known personalities of national history, collects and archives letters, telegrams and appeals to the Albanian people.

An important place will be occupied by the coverage of L. Nosi's activity in the new situation that was created after the Austro-Hungarian occupation of the country and his efforts, as part of a group of initiating activists, to organize a national congress in Elbasan which would seek to re-establish the pre-war Albanian government and indirectly identify Elbasan as the new center of the nation-state. Albanian patriots were raised to hope that the Austro-Hungarian military presence, which had emerged as the most favorable international factor for Albania's independence, was the best opportunity to establish a nucleus of national administration and to lay the foundations of the state of young Albanian who would recover after the end of the war, perhaps even in the restored ethnic borders. The focus of this study, during this chapter, will be the contribution he made, through the insistence of the Austro-Hungarian authorities in the city, to save the population from the misery and destruction caused by the Serbian occupation of these territories. Part of this activity is his participation in the formation of the cultural society "Literary Region" in Elbasan which through the propaganda of cultural values, material and spiritual, aimed to put in defense of the ethnic Albanian national identity. He accomplished this mission through the publication in the pages of the magazine "Literary Garden" of very valuable pieces of Albanian folklore that he had collected over the years with so much care.

The paper continues with the chapter "Positioning of Lef Nosi in the political life of the country in the years 1920 -1924" where, mostly, we are focused on addressing the attitudes that L. Nosi will hold towards political developments in the country during v.'20, described as the most democratic period in the political history of the Albanian state between the two world wars. This period was preceded by the participation of L. Nosi in the Congress of Durrës and in the government that emerged from it. Although in very difficult conditions, he will give his contribution as Minister of Economy and Food in the government of Durres and then as a representative of the government delegation at the Peace Conference in Paris to defend the Albanian cause and endangered national rights. by the winners of the First World War. In Paris, Lef Nosi will oppose the recognition of Italian sovereignty over the province of Vlora, an act which not only violated the independence and territorial integrity of the Albanian state but also paved the way for the realization of territorial claims of Balkan neighbors through "sympathetic" international diplomacy, while the hope for the salvation of Kosovo was finally extinguished. During this time he will be one of the main figures who participated in the establishment of the federation "Fatherland" which aimed to achieve economic and social progress of the country through the development of education and culture. In particular, this chapter deals with the involvement of L. Nosi in the fierce election campaign of 1921, during which he joined the progressive wing represented by the political group "People", and in 1923 as part of the political group. Neither Pasha nor Bey"who will fight for the separation of the country from feudal backwardness and the beginning of the path towards democratic developments. During this time Lef Nosi set to work to bring to light the treasure he had amassed over the years, and in the first months of 1924 he would publish "Historical Documents to Serve Our National History," a monthly historical magazine in its pages. of which documents of the period 1912-1918 will be published, a historical stage which was illuminated in many aspects by this documentary part preserved so fanatically by Lef Nosi. In the last issue we have tried to highlight the work that L. Nosi did at the head of the Municipality of Elbasan, after the triumph of the June uprising of 1924, after which he will be temporarily withdrawn from the political life of the country.

At the end of this paper, throughout the epilogue, we have identified the position of L. Nosi and his political views at some key moments. First, during the years of the Albanian monarchy, in terms of economic, political and military penetration of Italy until the fascist occupation of the country. During this time, although he was withdrawn from the front line of political life in the country, he continues to remain an important figure in the domestic political districts of the city of Elbasan. He was not a supporter of Zog's policy, but he was a supporter of the rule of law which the June 1924 revolution could not build. While in the

country there is an increase of Italian influence in almost all areas of life, L. Nosi will stand out as a central figure of nationalist districts that fought to protect Albanian political independence. L. Nosi, known as a collector and distributor of books that testify to the antiquity, history, culture of the Albanian nation, and many other propaganda publications of Western democracies, would soon fall prey to fascist surveillance and crackdown. At this time Lef Nosi had also created a personal library with a considerable number of books in different languages, but mainly with books that spoke about Albania and Albanians. With the name, influence and respect he enjoyed among the people, Lef Nosi was seen by the occupying authorities as an obstacle in the Italian efforts for the fascism of the Albanian population. As an opponent of the new regime, in 1940, Lef Nosi was interned for a year in Italy.<sup>859</sup> Secondly, his position on the conditions of organizing the anti-fascist resistance and shaping the organizations and political parties in the country is elaborated. The fascist occupation of the country made the Elbasan activity emerge from the political silence and openly position itself against Italian projects on Albanian soil.<sup>860</sup> The expansion of communist propaganda, which was gaining more and more ground even in areas where the anti-fascist resistance was inspired and led by nationalist gangs, encouraged the Albanian right-wing nationalist forces, much more active in the first days of the fascist occupation of the country. to enter the stage of organization and form their political force, the National Ball, a social democratic, liberal, pro-Western, anti-monarchist and anti-communist party. It is the time when L. Nosi finds it appropriate to join the Albanian anti-communist right, taking the leading role of the branch that this political force (Balli Kombëtar) created in the city of Elbasan. Third, we have tried to analyze L. Nosi's position during the German occupation of the country by reflecting both the internal political and military situation as well as the developments in the international arena after the capitulation of fascist Italy. L. Nosi, the rifle and pen warrior of the early twentieth century, supporter of peaceful policies and far from the extremist attitudes that World War II had produced in the Albanian environment, with his inclusion in the Assembly of September 1943, had not come out against the war of his people, a war they had all started together, nationalists and communists, against the fascist invaders. But he could not accept that Slavic interests were transformed into the ideals of the Albanian communists, endangering the very existence of the Albanian nation. He continued to think of a general uprising, but after the unification of all Albanian political factors was realized, a unification which would have provided the military support of the Allies. Here we also reflect his engagement in the High Council of the Regency, as well as Lef Nosi's confrontation with the communist forces which, at the end of the war, came to power. Lef Nosi will remain a member of the Regency until October 25, 1944. If this political movement of was not the best choice, it does not automatically make him the politician with a thirst for power, while he had neither nor expected at his age, any personal or political gain, but guided by the conscience of his and aware of the burden he was carrying on his shoulders, acted as he thought was best for his country and people. Seeing the progress of the communist forces, politicians and military with anti-communist convictions in the country gathered in the city of Shkodra. On November 12, 1944, they held a meeting in the Franciscan Assembly of Shkodra with the participation of Mehdi Frashëri, Father Anton Arapi, Lef Nosi, Ibrahim Bicaku, Mit'hat Frashëri, Mustafa Kruja, Ali Këlcyra, etc. Their main goal was to organize a resistance until a deliberate Anglo-American landing, in which they trusted that it would stop the full establishment of the communist regime in Albania. The participants in this meeting were divided into two groups, one led by Mehdi Frashëri who was for leaving Albania and the other led by Father Anton Arapi who insisted on staying in the country and organizing the resistance.<sup>861</sup> The latter was joined by Lef Nosi who also hoped for a change in the international situation. Moreover, his old age, 68 years old, made it even more difficult to leave Albania and spend the last years of his life in emigration.<sup>862</sup> Meanwhile, in the pages of the communist press it would be written: "Lef Nosi, Ibrahim Bicaku and Shefqet Vërlaci, who constitute the axis or triangle of betrayal in Elbasan, seeing the risk of losing their

<sup>859</sup> Central State Archive, Fund. 253 "General Directorate of Police", year 1939-1940, D. 27, p. 67

<sup>860</sup> Neuwirth, Hubert. *Resistance and cooperation in Albania ...*, Tirana, 2006, p. 19

<sup>861</sup> Dervishi, Kastriot. Cited work, p. 533

<sup>862</sup> Newspaper "55", Confessions of Stiliano Nosi, dt. March 29, 2008

ruling or class positions, as a result of the development of LNC "They put aside their quarrels and united under the leadership of the new master, German Nazism."<sup>863</sup> In view of the historical truth it should be said that, during the German occupation of the country, in the house of the "Nazi traitor and traitor", Lef Nosi, two Jewish families found refuge, thus becoming part of those who protected the Jews during the War of The Second World, who could never be allies of the Nazi platform or supporters of their policy.

In late 1944, communist forces launched operations to physically remove political opponents who were or were not involved in the war. Persecution of opponents of the new communist regime began throughout the country, who had not left Albania and had launched an armed anti-communist resistance, which the communists labeled as "gang" or "saboteur" movements.<sup>864</sup> As the scholar H. Bogdan puts it, in his book *From Warsaw to Sofia*, on post-war political developments, he attaches importance to the fact that the communist-led FNC began to eliminate any opposition force. The nationalists, known for their high level of education, skills, and intellectual strength, confronted the communists, known for their mass ideology, Soviet concepts of class warfare, and for replacing intelligence with militant groups. With no referees in the middle and no rules of the game, the political situation of November 1943-November 1944 resembled a fierce power struggle.<sup>865</sup> At the end of the war, the Albanian communists, who came to power without the institution of free elections, imprisoned, fought and even liquidated, not only politically but also physically, their political opponents, but Albanians. The new regime judged a priori a historical period and a political class, without analyzing the circumstances, activity and concrete attitudes of each protagonist of this class. The facts show that the main part of these politicians were well-known figures with valuable contributions to the history of the Albanian nation, personalities who enjoyed respect in public opinion. Among them is the figure of Lef Nosi, whose name is on the list of 107 people shot without trial in the city of Elbasan, by the new popular government.<sup>866</sup>

By addressing the main aspects of Lef Nosi's political activity in the difficult path of establishment, recovery, re-establishment and consolidation of the independent Albanian state until the middle of the third decade of the twentieth century, we tried to re-dimension the figure of Lef Nosi in the pages of our national history, a place denied for almost half a century. The changes of the new democratic era brought about the complete reform of the political and economic system of the country, which consequently changed, albeit at a slower pace, the model of historical studies on personalities and events of the last century, according to which any personality The public, which was politically condemned by the bearers and leaders of the communist ideology, was labeled just as harshly by the Albanian historiography, which began to file "lawsuits" against the "negative" characters of the history of Albania.

The political victims of the years 1944-1946, from the ranks of opponents of the regime, were not victims of the civil war because "there were not two but one side who had a gun in his hand and killed the other side. "So it was a war against a part of the population."<sup>867</sup> The regime was harsh, especially with all the senior officials who had been part of the governments of 1939-1944 or held leading positions in the administration of this period. Among them was Lef Nosi who, after leaving the Regency, for 10 months stayed hidden from friends from the highlands of Shkodra to the city and the suburbs of Elbasan.<sup>868</sup> He first went to Shkodra where Father Anton Harapi housed him for some time in the Catholic religious institutions of the northern city of Albania in the hope that it would be possible to find the language of mediation with the communist government. But as the solution was not being found and the situation was getting worse, he left for his hometown to take refuge with his friends. He stayed for about 2-3 months in the villages of Elbasan, in Shën-Gjon (Shijon) and then in Godolesh where the People's Defense

<sup>863</sup> Archive of the Museum of Elbasan, Fund. 1, File. 6, sheet. 171

<sup>864</sup> Dervishi, Kastriot. Cited work, p. 544

<sup>865</sup> Krasniqi, Afrim. *Political parties in Albania in the years 1920-2006*, Tirana, 2006, p. 89

<sup>866</sup> Archive of the Museum of Elbasan, Fund 22, File 4, sheet 2

<sup>867</sup> Krasniqi, Afrim. cited work, pg. 89

<sup>868</sup> "Collector" Magazine, no. 2, 1998, p. 40

Command immediately sent people to carry out the controls. From here it is housed in the Nos factory in Elbasan. The movement was the capital.<sup>869</sup> At the beginning of 1945, he was discovered in Tirana by security agents, as he had started to surrender to the British. From the documents in the State Security archive, Lef Nosi was accused of being an agent of the English Intelligence Service who, according to these sources, were trying to organize his departure abroad through the British mission in Albania.<sup>870</sup> He was arrested and together with Father Anton Arapi and Maliq Bushati, in February 1946 a trial took place in Tirana, during which Lef Nosi did not even refuse to answer questions because he considered the court decision to be predetermined. He was accused of killing and injuring 50,000 Albanians and was sentenced to death.<sup>871</sup> This accusation was made against L.Nosi not by the Turks, nor by the fascists, but by those Albanians who surrendered to hundreds of thousands of Albanians, who had fought during the war, but also before, to realized the dream of uniting Albanians in a single state. According to the news of the newspaper "Bashkimi", the trial against the regents and the Prime Minister, called the "military trial of Tirana", although none of the accused was military, within a few days gave the capital sentence for the three accused, execution by shooting.

Lef Nosi before being a member of the Regency in the Albanian state of 1943-1944, had been a nationalist who fought, along with other patriots, through many difficulties, for the creation and maintenance of the Albanian state. He was a patriot, activist, fighter, researcher, politician, in a word, he was an Albanian who did not abandon the cause for which he worked, Albania, throughout his life even in the days when his life was really in danger. His place would remain the cause for which he would sacrifice his life. Lef Nosi proved, along with many of his other comrades, the narrowness and unfairness of the judgment of the political figures of that period, the misunderstanding of the shallow observers of historical events, and the lack of gratitude he should have received after an action unsparing for his country. "Outstanding patriots ... - as was Lef Nosi - we killed the Albanians with our own hands ... we took their lives with rifle bullets" - Ernest Koliqi would say in 1957.

Judging the value of a past human life with the desire and willingness to serve the national cause is a necessity, especially in the face of the future. Beyond the deserved values of the multidimensional activity of Lef Nosi, the figure of this personality would not be completely clear if it is not fully and truly reflected his attitude and political activity from the stage of formation to the existence of the state the blows of world conflicts. Lef Nosi's political activity presents a set of attitudes in different situations of the fragile Albanian political reality, which became the impetus for undertaking this study. His complex figure, completely immersed in contemporary Albanian history, bore quite a few responsibilities to be treated. To understand the scale of his patriotic activity, it was necessary to delve into the many but complex documentation of the beginning of the last century, to disperse the dense fog raised by the communist dictatorship, through the discovery not only of descriptive documents but also of indisputable facts. on the political, journalistic and research contribution of Lef Nosi. Seen in this context, this paper does not aim at judging or evaluating his political stance, but at presenting in a coherent manner his activity from the embryonic moments of the state-building process in the ranks of the Albanians to the Albanian was endangered not only by external factors but also by the internal political game in the country.

Lef Nosi worked and acted for his nation, resisted persecution and imprisonment by the Ottoman invaders and for this he was praised by his contemporaries. "I know your work that you have done with Tomorr and many other patriotic things, I understand them and I have always sympathized with them," Kristo Dako wrote in May 1911. "I know that you have always worked for the good of to others ... no doubt the time will soon come when your services will be appreciated by all".<sup>872</sup> He supported and propagated the project of an independent Albanian state organized according to Western models long before this victory was achieved in the autumn of 1912. The experience of the Balkan neighbors, but also beyond, had created in him the

---

<sup>869</sup> Newspaper "55", Story of Stiliano Nosi, dt. March 29, 2008

<sup>870</sup> Newspaper "Tema" - online, 2016, April 9. Auron Tare, *"How Security Arrested Lef Nosi"*.

<sup>871</sup> Dervishi, Kastriot. Cited work, p. 546

<sup>872</sup> Central State Archive, Fund. 32, File. 55/1, sheet. 70



conviction that without the support of a great European power the success of our national movement would not be complete. This conviction was confirmed by the decisions taken in London in 1913, when without this international support, half of the ethnically Albanian lands were separated from our national lands. Even when in Paris, in 1919, the victorious states of the First World War were also deciding the fate of the Albanians, Lef Nosi will defend and will unequivocally stand by the demand of the legitimate right of the Albanians to live together. The period of world wars clashed in the Albanian political scene with strong currents of national and international interests with not at all clear ideas, sometimes renewing and sometimes destructive, until there came a moment in which the events became more intense. He did not divert attention from the national issue even during the exile by the Italian occupiers, an attitude that made him enjoy high respect among the people. At the end of the war he was killed by some Albanians and was appreciated by foreigners. During the time of his arrest, his friend Margaret Hasluck, in the capacity of a graduate of an allied army, wrote a letter to Enver Hoxha requesting the annulment of the decision, justifying her message with documents and facts proving his pure patriotism. But a week later, in February, Lef Nosi, aged 69, was shot.<sup>873</sup>

While the attempt of Albanian nationalists, such as Lef Nosi, to save ethnic Albania, was under attack by the SNP propaganda, it did not leave indifferent all those who recognized the patriotic commitment of the figures involved in the Albanian government set up in the conditions of foreign invasion. The political line of the government of the Regency - will express M. Hasluck in an informative look of December 15, 1943, in Cairo - would have found our warm approval if we had not been at war with a country, the armed forces whose they had now invaded Albania ... Moreover, they (the governors of the Regency - EA) have called on the youth to avoid the civil war and to keep intact Albania, which they, the oldest men in government, they had done, but which they, the young people, would inherit tomorrow. Indeed these old men - continued her letter to Mrs. Hasluck, - must be in great pain watching the chaos in which the guerrilla movement has plunged the country. They were born to get rid of degraded Turkish rule. They grew up fighting for independence; many people like the Butka brothers and the late Idromeni Kosturi did it in gang warfare; a few like Lef Nosi and the late Preng Pasha of Mirdita did it with years of imprisonment, exile and exile. When independence was achieved, they, both Muslims and Christians, turned their faces away from the west and they did for themselves and helped the younger generation to gain some degree of western civilization. They rejoiced to see subsequent governments remove weapons from the population, which served only to preserve medieval barbarism. Now they see how the hands of the clock are back, in the '20s or even earlier, guns are in the hands of every man, human life is not taken into account and anarchy is raging. They would not be at all humane if they did not ask the question: Would it be worth the economic and political damage that the country would suffer, the benefit that would come from the military engagement of the Allies, which was achieved by guerrilla tactics by hitting and leaving?<sup>874</sup>

When he heard about the fate of Lef Nosi at the end of the war, Edwin Jacques said: "Poor Lef! He had been a first-class Albanian patriot, one of the founding fathers of the new republic. He had been one of the delegates who approved the decisions of the historic Congress of the Monastery in 1908, making an open challenge to the Ottoman Empire. In the time of the Turks he had risked himself helping the Albanian Club in 1910, editing the national newspaper of Elbasan *Tomorri*, supporting the banned Albanian school system and the Normal School of Elbasan, things for which he could be imprisoned and die. For this the Turkish government had deported him to life in exile, but released him in April 1911. Upon his return to Albania, he had put his life in danger again by participating together with Ismail Qemali and other patriots in the historic meeting of the Declaration of Independence on November 28, 1912 in Vlora, where he had signed the document as the delegate of Elbasan. He risked being accused of treason by accepting the post of Minister of Posts and Telegraphs in the new Albanian government and was elected vice-president of the Senate of the Provisional Government. He was also among those who presented the demand for a free

---

<sup>873</sup> *Elbasani-Encyclopedia*, Elbasan, Sejko, p. 240

<sup>874</sup> Hibbert, Reginald, *Bitter Victory*, Tirana, 1994, p. 106

Albania at the Versailles Peace Conference in 1919-1920. Lef Nosi! What a man he was! He was a cultured nobleman and an ardent patriot. But the communist regime unmasked him as an enemy of the people and executed him. Here is the irony! He and other patriots were killed not by the Turkish oppressors, but by the Albanian liberators! ”<sup>875</sup>

Although they had started from a noble goal, not to sacrifice Albania for a war, the fate of which they could not impose, and not to kill Albanians in vain among themselves, as this had been the primary effect of the alliance of Western Powers with Russia communist forces in the albanian political environment, the nationalist forces, involved in the efforts to erect the albanian state building, faced not only the abandonment of the western Allies but also the loss of support from the broad masses of the people, a fact which, among many other factors, also brought about the failure of their governing measures. It should be noted that one of the main factors in the defeat of the nationalists, involved or not in the government, including L. Nos, was the civil war, ruthless, bloody which set in motion the German military machine and which brought consequence with thousands killed in the ranks of freedom-loving Albanians. After the capitulation of fascist Italy, representatives of the existing political caste in the country, nationalists, independence fighters, diplomats of the national cause were faced with the dilemma: either to organize to defend themselves through Albanian values, or to leave the fate of the country entirely in the hands of tomorrow's diplomatic decisions. For a figure like Lef Nosi, who had built his political experience on the floor of the war for the solution of the national question, and who at the same time knew international diplomatic relations well, seemed to have come to the conclusion: Diplomacy was a weapon in the hands of the Powers Greater and a small Albania, destroyed by the war, as before, risked being used again as an exchange currency. Albania on the borders of 1913 for him would not be a Albania neither politically strong nor ethnically realized. While in 1912 the united Albanians rejoiced in the proclamation of the first independent Albanian state, three decades later they were not only politically divided, but had turned their weapons against each other.

The alienation and disrespect of the figures and values of the Albanian nation had its beginnings precisely in this internal clash, organized and armed between the political and military forces in the country, which, including the popular masses that supported them, put the Albanians opposite each other, in two hostile and warring camps between them. This military conflict between the right and the left not only constitutes the suicidal nature of the Second World War in Albania, but was accompanied by tragic consequences not only for that time but also for almost half a century later, the effects of which have not yet been erased. completely. History began to be written and read differently, clearly deviating from the truth. Well-known figures of the Albanian world, such as Lef Nosi, were treated unilaterally taking into account only specific aspects of their engagement in the national cause. Despite the tides in his activity, he will work diligently in the service of the national cause, always staying true to the national ideal, Albanianism. A society that easily despises the values and efforts made for the benefit of national ideals cannot prosper.

Lef Nosi was deliberately removed from the forces that had taken power, as the only flag bearing the symbols of patriotism, the flag of the ubiquitous Albanians, was waved in his hands, and that he stood on the opposite side of the political forces that came to power after the end of war. His fortune fell prey to an unprecedented plunder. But when the communists raided his house, they found there the collections of their tracts, which they themselves had not remembered to keep, which Lef Nosi had collected in the middle of the war as collections.<sup>876</sup> He left behind not only the traces of his political activity, evidence of patriotic commitment, but he left to generations the treasure collected during a lifetime, the property of our national historical memory. His rich library, which is considered second after that of Mithat Frashëri, is the core of the fund of albanology and Balkanology in the library of Elbasan and is a valuable national treasure. With those 10 and 100 pages written and translated,<sup>877</sup> the figure and activity of Lef Nosi creates space for generalizations. By researching his activity, we come to see in him the man

---

<sup>875</sup> Jacques, Edwin. *Albanians ...*, Tirana, 1995, p. 381-382

<sup>876</sup> Newspaper "55", Tirana, March 28, 2008

<sup>877</sup> L. Nosi was fluent in five foreign languages: Turkish, Greek, German, French and Italian.

devoted and sacrificed for his nation, as historical evidence. A life dedicated to the national cause, beyond the shadows that can be seen in it, requires a fair trial not only from those who have recognized and appreciated its merits towards the Homeland, but also, and especially from those who have not not even a stone in the building of Albanianism. Figures like Lef Nosi fell prey to the communist dictatorship, were persecuted, killed, died thinking; but every death has been several times birth and in this birth the future is obtained.